KOALICIONI PËR REFORMA, INTEGRIM DHE INSTITUCIONE TË KONSOLIDUARA
COALITION FOR REFORMS, INTEGRATION AND CONSOLIDATED INSTITUTIONS

në bashkëpunim me:

RAPORT PËRFUNDIMTAR VËZHGIMI

MBI PROCESIN E ZGJEDHJEVE PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË TË 25 PRILLIT 2021

SHTATOR 2020 - JANAR 2022

TIRANË, SHKURT 2022

KRIIK

KOALICIONI PËR REFORMA, INTEGRIM DHE INSTITUCIONE TË KONSOLIDUARA

COALITION FOR REFORMS, INTEGRATION AND CONSOLIDATED INSTITUTIONS

në bashkëpunim me:

RAPORT PËRFUNDIMTAR VËZHGIMI

MBI PROCESIN E ZGJEDHJEVE PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË TË 25 PRILLIT 2021

SHTATOR 2020 - JANAR 2022

TIRANË, SHKURT 2022

Përgatiti: © KRIIK **KOALICIONI PËR REFORMA, INTEGRIM DHE INSTITUCIONE TË KONSOLIDUARA**
COALITION FOR REFORMS, INTEGRATION AND CONSOLIDATED INSTITUTIONS

Të drejtat e botimit të këtij Dokumenti janë të rezervuara.
Pjesë të këtij materiali mund të përdoren lirisht. Në një rast të tillë lutemi citoni burimin.

A: Rr. "Ymer Kurti", Nd.4, H.2, Ap.3, Nj.Adm.5, Tirana, 1019 | Mailing Address: P.O.Box. 2396 Tirana, 1001, Albania;
T: + 355 4 2245078 | M: + 355 673890174; + 355 682039297 | E: info@kriik.al | W: www.kriik.al ;

Aksioni i Vëzhgimit të Zgjedhjeve prej KRIIK për Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të 25 Prillit 2021 u mbështet financiarisht nga:

UK Government
Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar
Government of the United Kingdom

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra
Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC
Qeveria e Konfederatës së Zvicrës

bashkëpunimi gjerman
DEUTSCHE ZUSAMMENARBEIT
Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës Federale të Gjermanisë
Ministry of Foreign Affairs of the Federal Republic of Germany

LUXEMBOURG
LET'S MAKE IT HAPPEN
Ministria e Punëve të Jashtme e Dukatës së Madhe të Luksemburgut
Ministry of Foreign Affairs of the Grand Duchy of Luxembourg

Opinionet dhe këndvështrimet e shprehura në këtë Raport dhe në çdo publikim tjetër në kuadër të këtij aksioni vëzhgimi, janë përgjegjësi e KRIIK dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pozicionin zyrtar apo opinionin e donatorëve.

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	**6**
I. HYRJE	**10**
II. KONTEKSTI POLITIK DHE INSTITUCIONAL	**13**
III. KUADRI LIGJOR DHE SISTEMI ZGJEDHOR	**15**
III.1. KUADRI LIGJOR	**15**
III.2. SISTEMI ZGJEDHOR	**20**
IV. ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE	**22**
IV.1. KOMISIONI QENDRORI ZGJEDHJEVE (KQZ)	**23**
IV.1.1. Funksionet e Organeve Drejtuese të KQZ-së dhe përzgjedhja e anëtarësisë së tyre	**23**
IV.1.2. Aktiviteti i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve	**25**
IV.1.2.1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve	**25**
IV.1.2.1.1. Shpërndarja e mandateve	**27**
IV.1.2.2. Komisioni Rregullator (Rregullatori)	**28**
IV.1.2.2.1. Shpallja e moskompetencës për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit	**29**
IV.1.2.2.2. Miratimi i rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve	**29**
IV.1.2.3. Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve	**30**
IV.1.3. Përdorimi i teknologjisë në zgjedhje	**31**
IV.1.3.1. Sistemi Elektronik i Identifikimit të Votuesve (SEIV)	**31**
IV.1.3.1.1. Ankimimet që përdorën si provë identifikimin elektronik	**32**
IV.1.3.2. Votimi dhe numërimi elektronik	**33**
IV.2. KOMISIONET ZONALE TË ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR	**34**
IV.2.1. Vendimmarrja e KZAZ-ve	**37**
IV.3. KOMISIONET E QENDRAVE TË VOTIMIT (KQV)	**39**
IV.3.1 Qendrat e Votimit	**39**
IV.3.2. Konstituimi i Komisioneve të Qendrave të votimit (KQV)	**40**
IV.4. VENDET E NUMËRIMIT TË VOTAVE DHE ANËTARËSIA E GRUPEVE TË NUMËRIMIT TË VOTAVE	**41**
V. REGJISTRIMI I ZGJEDHËSVE	**42**
V.1. HARTIMI I LISTAVE TË ZGJEDHËSVE	**42**
V.2. NJOFTIMI I ZGJEDHËSVE MBI PRANINË NË LISTË DHE QENDRËN PËRKATËSE TË VOTIMIT	**44**
I.2.1. Publikimi ciklik i listave të zgjedhësve	**45**
V.2.2. Njoftimi me shkrim i zgjedhësve	**45**
V.3. ZGJATJA E AFATIT TË VLEFSHMËRISË SË DOKUMENTEVE TË IDENTIFIKIMIT	**47**
V.4. AUDITËT TEKNICIENË	**49**
V.5. REGJISTRIMI I VOTUESVE ME BANIM JASHTË VENDIT	**49**
V.6. E DREJTA E VOTËS PËR PERSONAT NË VETËIZOLIM (TË INFEKTUAR ME VIRUSIN SARS-COV-2 DHE FAMILJARËT E TYRE)	**50**
VI. REGJISTRIMI I SUBJEKTEVE ZGJEDHORE DHE KANDIDATËVE	**51**
VI.1. REGJISTRIMI I PARTIVE POLITIKE	**52**
VI.1.1. Mandati i kryetarit të partisë sipas statutit të partisë	**53**
VI.2. REGJISTRIMI I KOALICIONEVE ZGJEDHORE	**55**
VI.3. REGJISTRIMI I KANDIDATËVE	**55**
VI.3.1. Numri i kandidatëve në listën e PD-AN	**57**
VI.4. PROCESI I DEKRIMINALIZIMIT	**57**
VI.4.1. Referimi për verifikim të thelluar në Prokurorinë e Përgjithshme	**60**
VII. FUSHATA ZGJEDHORE	**61**
VII.1. MJEDISI I FUSHATËS	**61**
VII.2. PUBLIKIMI I BAZËS SË TË DHËNAVE TË QYTETARËVE TË TIRANËS	**65**
VII.3. PËRDORIMI I BURIMEVE SHTETËRORE PËR PËRFITIM ELEKTORAL	**67**
VII.3.1. Sjellja e institucioneve dhe e administratës publike	**68**
VII.3.1.1. Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil	**69**
VI.3.1.2. Angazhimi i nëpunësve civilë si kandidatë apo në administratën zgjedhore	**69**
VI.3.1.3. Denoncimet në ndërfaqen e KMSHC-së	**70**
VII.3.2. Raportimi i aktiviteteve në KQZ	**70**
VII.3.2.1. Denoncimet	**71**
VII.3.3. Publikimi i kontakteve	**72**
VII.3.4. Akte normative që lidhen me përdorimin e burimeve shtetërore	**72**
VII.3.5. Zyrat Zgjedhore dhe materialet propagandistike	**73**
VII.3.5.1. Zyrat Zgjedhore	**73**
VII.3.5.2. Materialet propagandistike	**74**

VIII. FINANCIMI I FUSHATËS ZGJEDHORE 75
VIII.1. KUADRI LIGJOR 75
VIII.2. TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET 76
VIII.2.1. Të ardhurat 76
VIII.2.1.1 Fondet nga buxheti i shtetit 76
VIII.2.1.1.1 Ri-shpërndarja e fondeve pas shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve 78
VIII.2.1.2. Fondet jo-publike 78
VIII.2.1.2.1. Donacionet 78
VIII.2.1.2.2. Të ardhura të krijuara nga vetë subjektet 80
VIII.2.1.2.3. Të ardhurat e kandidatëve 80
VIII.2.2. Shpenzimet për fushatën zgjedhore 81
VIII.2.2.1. Shpenzimet për aktivitete elektorale dhe mitingje 82
VIII.2.2.2. Shpenzimet për zyra elektorale 83
VIII.2.2.3. Shpenzimet për media 85
VIII.2.2.4. Shpenzimet për reklama politike në Facebook 86
VIII.2.2.4.1. Reklamat nga partitë politike dhe kandidatët e pavarur 87
VIII.2.2.4.2. Reklamat e kandidatëve të subjekteve zgjedhore 88
VIII.3. TRANSPARENCA 89
VIII.3.1. Vetëdeklarimi i subjekteve zgjedhore 89
VIII.3.1.1. Bilancet e aseteve dhe detyrimeve 91
VIII.3.1.2. Problematika që lidhen me përmbajtjen e raporteve të vetëdeklarimit 92
VIII.3.1.2.1. Financieri i partisë ka qenë njëkohësisht edhe kandidat për deputet 92
VIII.3.1.2.2. Publikimi në web-in e partisë 92
VIII.3.1.2.3. Raporte të paplotësuara 93
VIII.3.1.2.4. Dhurime më shumë se 50 mijë lekë të kryera cash 93
VIII.3.1.2.5. Raporte ku nuk përputhet kategoria e shpenzimit me përshkrimin e tij 93
VIII.3.1.2.6. Deklarimi i shpenzimeve 94
VIII.3.1.2.7. Pagesa më shumë se 150.000 lekë të kryera cash 94
VIII.3.1.2.8. Shpenzimet e kryera pas përfundimit të fushatës elektorale 94
VIII.3.2. Vetëraportimi i kandidatëve 95
VIII.3.2.1. Shpenzimet e kandidatëve 95
VIII.3.2.2. Raporte të paplotë dhe me mangësi 96
VIII.4. KONTROLLI 97
VIII.4.1. Monitorimi i fushatës zgjedhore 97
VIII.4.2. Auditimi i shpenzimeve 100
VIII.5. FONDET VJETORE PËR PARTITË POLITIKE 102
IX. MEDIA 103
IX.1. MJEDISI MEDIATIK 103
IX.2. MEDIA AUDIOVIZIVE 106
IX.3. MEDIA E SHKRUAR 111
IX.4. MEDIAT ONLINE 113
IX.4.1. Portalet 113
IX.4.2. Fushata në platformat e medias sociale. 114
X. ANKESAT DHE APELIMET 115
X.1. ANKESA DHE APELIME PARA DITËS SË ZGJEDHJEVE 116
X.1.1 Ankimimet e shqyrtuara nga KAS 116
X.1.2. Ankimimet e shqyrtuara nga Kolegji Zgjedhor 117
X.2. ANKESA DHE APELIME PAS DITËS SË ZGJEDHJEVE 117
X.2.1. Ankimimet e shqyrtuara nga KAS 117
X.2.1.1. Vendimmarrja për gjobat e anëtarëve të disa KZAZ-ve 118
X.2.1.2. Vendimmarrja për kundërshtimin e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve 118
X.2.1.3. Ankimimet në lidhje me Vendimin nr. 9 të Komisionit Rregullator 119
X.2.1.4. Vendimmarrja lidhur me sanksionet ndaj partive politike 119
X.2.2. Ankimimet e shqyrtuara nga Kolegji Zgjedhor 119
XI. INSTITUCIONE TË TJERA QË KANË ROL NË PROCESIN ZGJEDHOR 119
XI.1. MINISTRIA E BRENDSHME 119
XI.2. PREFEKTURAT 120
XI.3. NJËSITË E QEVERISJES VENDORE 121
XI.4. POLICIA 121
XI.5. PROKURORIA 122
XI.6. GJYKATAT 123

XI.6.1. Gjykata Kushtetuese 123
XI.6.1.1. Ankimimi i Partisë Republikane në Gjykatën Kushtetuese mbi Urdhrin e Ministres së Shëndetësisë 123
XI.6.1.2. Ankimimi i Partisë Bindja Demokratike dhe Lëvizja Demokratike Shqiptare mbi pikën 3 të nenit 163 të Kodit Zgjedhor 124
XI.6.1.3. Ankimimi i Shoqatës së Bashkive mbi antikushtetueshmerinë e procesit zgjedhor të 30 qershorit 2019 124
XI.6.2. Gjykata Administrative 125
XI.6.3. Gjykatat e Rrethit Gjyqësor 125
XII. VËZHGUESIT 126
XIII. PJESËMARJA E GRAVE 127
XIII.1. PJESËMARRJA E GRAVE NË LISTAT E KANDIDATËVE 127
XIII.2. PJESËMARRJA E GRAVE NË ADMINISTRATËN ZGJEDHORE 128
XIII.3. ÇËSHTJET GJINORE NË FUSHATË 128
XIV. PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA 129
XV. PAKICAT KOMBËTARE 130
XVI. DITA E ZGJEDHJEVE DHE NUMËRIMI I VOTAVE 131
XVI.1. AKTIVITETI I KZAZ-SË PËRPARA DITËS SË ZGJEDHJEVE 131
XVI.2. PROCESI I VOTIMIT 131
XVI.2.1. Procedurat e hapjes së qendrave të votimit 132
XVI.2.2. Procedurat e votimit 134
XVI.2.3. Mbyllja e qendrave të votimit 137
XVI.3. NUMËRIMI I VOTAVE 138
XVI.3.1. Marrja në dorëzim e materialeve zgjedhore 138
XVI.3.2. Procesi i numërimit 138
XVII. AUDITIMI POST ZGJEDHOR 140
XVII.1. KUADRI LIGJOR 140
XVII.2. PROBLEMATIKAT QË SHOQËRUAN PROCESIN E KËQYRJES PAS ZGJEDHORE 141
XVII.3. RAPORTI I KQZ-SË PËR PROCESIN E AUDITIMIT PASZGJEDHOR 144
XVII.4. GJETJE MBI TË DHËNAT E DALA NGA PROCESI I VERIFIKIMIT 145
XVII.4.1. Gjetje nga verifikimi sasior 145
XVII.4.2. Verifikimi cilësor 146
XVII.4.3. Verifikimi i funksionimit të pajisjeve PEI 147
XVII.4.4. Votat e pavlefshme 148
XVII.5. VERIFIKIMI I QV-VE NË ZAZ NR. 40 148
XVIII. REKOMANDIME 149
REKOMANDIME PARËSORE 149
REKOMANDIME TË TJERA 149
XIX. MBI KRIIK 152
MBI ORGANIZATËN 152
ANGAZHIMI NË LIDHJE ME INTEGRITETIN ZGJEDHOR 152
XX. AKRONIME 153
XXI. SHTOJCA 155
SHTOJCA A - TË DHËNA STATISTIKORE NGA VËZHGUESIT STACIONARË NË QENDRAT E VOTIMIT 156
SHTOJCA B - DEVIJIMI I NUMRIT TË MANDATEVE PËR NUMËR SHTETASISH NGA MESATARJA KOMBËTARE PËR ÇDO ZONË ZGJEDHORE 170
SHTOJCA C - VOTAT E PA PËRFAQËSUARA 171
SHTOJCA D - NUMRI I VOTAVE QË DUHET TË MERRTE NJË KANDIDAT PËR TË THYER HERËSIN DHE RI-RENDITUR NË LISTË, SIPAS ZONAVE ZGJEDHORE DHE SUBJEKTEVE ZGJEDHORE 172
SHTOJCA E - KANDIDATËT QË KANË THYER HERËSIN (PAVARËSISHT RENDITJES NË LISTË) .. 172
SHTOJCA F - KANDIDATËT QË NUK DO TË ISHIN MANDATUAR NËSE LISTAT DO TË ISHIN TOTALISHT TË HAPURA DHE ZËVENDËSUESIT E TYRE 173
SHTOJCA G - KANDIDATËT QË NUK DO TË ISHIN MANDATUAR NËSE LISTAT DO TË ISHIN TOTALISHT TË HAPURA DHE ZËVENDËSUESIT E TYRE 174
SHTOJCA K - ECURIA E TË DHËNAVE STATISTIKORE TË LISTËS SË ZGJEDHËSVE 175
SHTOJCA L - SHPËRNDARJA E VOTAVE TË PAVLEFSHME SIPAS BASHKIVE 176
SHTOJCA M - KËRKESAT ANKIMORE TË PARAQITURA NË KAS DHE NË KOLEGJIN ZGJEDHOR 178
SHTOJCA N - LIRIMET DHE EMËRIMET NË TRUPËN E KOMISIONEVE ZONALE TË ADMINISTRIMIT TË ZGJEDHJEVE 199
SHTOJCA O - TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET SIPAS VETDEKLARIMEVE TË SUBJEKTEVE ZGJEDHORE 204
SHTOJCA P - TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET E KANDIDATËVE 206
SHTPJA R - SHPENZIMET E KANDIDATËVE DHE SUBJEKTEVE ZGJEDHORE PËR MEDIAN SOCIALE SIPAS RAPORTIT TË VETDEKLARIMIT DHE SIPAS LIBRARISË SË REKLAMAVE NË FACEBOOK DHE INSTAGRAM 214
SHTOJCA S - KANDIDATË TË CILËT NUK KANË DORËZUAR RAPORT VETDEKLARIMI 228
SHTOJCA SH - KANDIDATË TË CILËT KANË DORËZUAR RAPORT VETDEKLARIMI ME 0 TË ARDHURA DHE SHPENZIME 238
SHTOJCA T - FONDET E SHPENZUARA DHE TË DEKLARUARA NGA SUBJEKTET ZGJEDHORE DHE KANDIDATËT PËR MEDIA 242
SHTOJCA V - DEKLARATA PUBLIKE TË KRIIK LIDHUR ME PROCESIN ZGJEDHOR 246

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK Albania) ka ndjekur në vazhdimësi thuajse gjithë proceset institucionale, ligjore e politike që kanë lidhje, drejtpërdrejt ose jo, me integritetin e zgjedhjeve në Shqipëri. Procesin e Zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të 25 Prillit 2021, KRIIK ka nisur ta monitorojë në tërësi që prej momentit të shpalljes së datës së zgjedhjeve nga Presidenti i Republikës me një ekip ekspertësh në nivel qendror, 22 vëzhgues afatgjatë dhe vëzhgues afatshkurtër të cilët ndoqën procesin e votimit dhe të numërimit të votave, deri në shpalljen e rezultatit final, ndërkohë që vijon të monitorojë nga afër elemente të procesit zgjedhor të cilët ende nuk janë përmbyllur, si "auditi zgjedhor", auditimi i financave të subjekteve zgjedhore, etj.

KRIIK e vlerëson procesin zgjedhor nga pikëpamja e përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga kuadri ligjor shqiptar dhe detyrimet ndërkombëtare të shtetit shqiptar (standardet e njohura ndërkombëtarisht për zgjedhje demokratike).

Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të 25 prillit 2021 u mbajtën në një klimë politike tejet të polarizuar dhe konfliktuale, me një mungesë besimi të theksuar mes palëve. Marrëveshja politike e 5 Qershorit 2020, e ndërmjetësuar nga partnerët ndërkombëtarë të vendit dhe si rrjedhojë e së cilës u amendua kuadri ligjor zgjedhor, duket se rivendosi për një periudhë të shkurtër komunikimin dhe bashkëpunimin mes palëve, komunikim ky që u dëmtua sërish në mënyrë serioze pasi maxhoranca aktuale ndërmori ndryshime kushtetuese e ligjore të njëanshme në korrik dhe tetor 2020. Maxhoranca hyri në këto zgjedhje me përparësinë e të qenit në kontroll të plotë të institucioneve publike, në nivel qendror e lokal, çka i dha asaj përparësi në procesin zgjedhor dhe zbehu dukshëm vijën ndarëse mes shtetit dhe partisë përgjatë gjithë procesit.

Ajo çka është më shqetësuese është se polarizimi i klimës politike nxori në pah, më shumë se në proceset e shkuara zgjedhore, politizimin e fortë të institucioneve publike, në të gjitha nivelet. Në një numër rastesh u vu re një sjellje partizane dhe e anshme nga ana e këtyre institucioneve, përfshi këtu edhe institucionet e pavarura apo organet ligjzbatuese.

Retorikës së ashpër politike dhe akuzave mes subjekteve zgjedhore iu shtua edhe përfshirja e panatyrshme e Presidentit të Republikës në garën zgjedhore duke mbajtur gjatë gjithë fushatës një qëndrim të qartë kundër maxhorancës qeverisëse dhe duke e angazhuar institucionin e Presidencës në fushatën zgjedhore, kundër maxhorancës. Nga ana tjetër, Partia Socialiste, e nxiti dhe vendosi në pah këtë qasje joinstitucionale të Presidentit duke e shënjestruar këtë të fundit si një palë të përfshirë në procesin zgjedhor, duke e unifikuar atë me drejtuesit e opozitës, dhe përdorur narrativën e mësipërme institucionalisht, si dhe në funksion të fushatës së vet zgjedhore. Një sjellje e tillë, qoftë nga ana e Presidentit, qoftë nga ana e maxhorancës vlerësohet të ketë ndikuar edhe më tepër në uljen e nivelit të besimit të qytetarëve shqiptarë në institucionet kryesore të shtetit.

Kuadri ligjor garanton kryerjen e zgjedhjeve në përputhje me standardet ndërkombëtare për zgjedhjet demokratike, nëse zbatohet me vullnet të mirë. Zgjedhjet u kryen me një kuadër ligjor të ndryshuar në masë të konsiderueshme. Amendimet ligjore, pavarësisht se sollën ndryshime të cilat përmirësojnë kuadrin ligjor, dështuan të prekin apo trajtojnë në thellësi problematika të mprehta, të cilat pritet të adresohen nga Legjislatura e re e Kuvendit.

Megjithëse kishin në dispozicion kohë të mjaftueshme, dhe në kushtet kur ishte më se e qartë se zgjedhjet e këtij viti do të organizoheshin në kushtet e emergjencës shëndetësore, si pasojë e COVID-19, ligjvënësit nuk ndërmorën asnjë masë që të garantonte një proces zgjedhor sa më normal, i cili të siguronte edhe mbrojtjen e shëndetit publik. Institucionet e shëndetit publik dhe ato të administrimit zgjedhor u treguan pasivë dhe të ngadaltë në adresimin e rregullave që duhet të ndiqeshin lidhur me mbajtjen e zgjedhjeve gjatë pandemisë. Megjithatë, pandemia u përdor nga institucionet e shëndetit publik për të ndaluar të ushtronin të drejtën e votës qytetarët shqiptarë që jetojnë në Greqi apo Maqedoni, një masë e cila nuk dukej të bazohej në arsye racionale të shtimit të rasteve në këto vende dhe duket të ketë qenë e bazuar në përllogaritje elektorale të maxhorancës në pushtet.

Dy qarqe devijojnë nga mesatarja e numrit të shtetasve për mandat në Zgjedhjet e 25 prillit, megjithatë ky devijim është në përputhje me praktikat e mira për zgjedhjet. Megjithatë, nëse numri i mandateve përllogaritet bazuar në numrin e shtetasve me të drejtë vote, apo të zgjedhësve që realisht votojnë, diferencat mes qarqeve dëmtojnë parimin e barazisë së votës dhe devijojnë nga praktikat e mira.

Barrierat fiktive ligjore që u vendosën me ndryshimet ligjore të tetorit 2020 për rirenditjen e kandidatëve e bënë thuajse nul efektin e votave parapëlqyese të zgjedhësve, duke dëmtuar përfaqësimin dhe lënë pa zë real qytetarët në përzgjedhjen e përfaqësuesve të vet, edhe pse ndryshimet kushtetuese të njëanshme të korrikut 2020 u justifikuan pikërisht me fuqizimin e qytetarëve. Pragu ligjor prej 1% në rang vendi, u tregua të ishte një barrierë e pakapërcyeshme për kandidatët e propozuar nga zgjedhësit. Ky prag e kufizon dukshëm mundësinë e grupimeve qytetare për të propozuar kandidatë, duke avantazhuar partitë politike.

Pas amendimeve ligjore, të cilat reflektuan Marrëveshjen politike të datës 5 Qershor 2020, institucioni i KQZ-së u rimodelua në një institucion me strukturë drejtuese trelaterale. Përgjatë funksionimit të vet, trupat drejtuese të KQZ-së reflektuan një sjellje që nuk ishte ajo e një institucioni të vetëm, por e tre të tillave, të ndara funksionalisht nga njëra-tjetra.

Përfshirja e ish-funksionarëve politikë, apo edhe ish-funksionarëve të kabineteve, në radhën e individëve që lejohen të kandidojnë, nuk është në frymën e aspiratës për një administratë zgjedhore të paanshme dhe të pavarur nga politika dhe le hapësirë për përzgjedhjen e kandidaturave politike. Pavarësisht se riformatimi i KQZ-së duhet të ishte një hap drejt krijimit të një institucioni të pavarur, në reflektim edhe të frymës së Marrëveshjes politike të 5 Qershorit 2020, KRIIK vëren se influenca politike ishte e pranishme në sjelljen, dhe ndonjëherë edhe votimin e anëtarësisë së Rregullatorit . Ndërkohë që KAS me vendimarrjen favorizuese ndaj mazhorancës, sjelljen e njëanshme dhe diskrecionin e treguar zhbëri aspiratën e paanësisë dhe profesionalizmit ndaj trilateralitetit të institucionit të ri të KQZ-së.

KQZ i administroi zgjedhjet në mënyrë eficiente dhe transparente, por nuk tregoi një qasje proaktive në lidhje me elementë të tjerë të procesit, të cilat janë në kompetencë e saj, të tilla si mbikëqyrja e sjelljes së medias gjatë fushatës zgjedhore, monitorimi i fushatës zgjedhore apo mbikëqyrja e përdorimit të burimeve publike për përfitim elektoral. Në tërësi vendimmarrja e KQZ-së ishte transparente dhe rregullisht e publikuar në faqen e institucionit, përfshi materialet paraprake të mbledhjeve.

Implementimi i verifikimit elektronik të shtetasve konsiderohet se lehtësoi në mënyrë të konsiderueshme procesin e administrimit të zgjedhjeve, si dhe rriti garancinë e procesit, pavarësisht kufizimeve, të tilla si moslidhja e pajisjeve me njëra tjetrën në kohë reale apo moslidhja mes shenjës së gishtit dhe zgjedhësit, apo edhe problematikave në implementim gjatë ditës së zgjedhjeve.

KZAZ-të i përmbushën detyrat e tyre në mënyrë eficiente për sa i përket procesit të administrimit të zgjedhjeve në ZAZ. Megjithatë, nuk mungon nevoja që në aspekte të veçanta të administrimit zgjedhor të kryhen përmirësime të mëtejshme në drejtim të zëvendësimeve në momentin e fundit dhe trajnimeve të anëtarëve të rinj. Në raste sporadike janë vërejtur mosnjohje të kuadrit ligjor dhe mungesë transparence ndaj vëzhguesve.

Numri total i shtetasve shqiptarë me të drejtë vote për zgjedhjet e datës 25 prill 2021 ishte 3.588.869. Kufizimi i të drejtës së votës për personat me çrregullime të shëndetit mendor, qoftë edhe nëpërmjet një vendimi gjykate, konsiderohet nga KRIIK të jetë në kundërshtim me detyrimet ndërkombëtare të shtetit shqiptar. Eliminimi *a priori* nga lista e zgjedhësve e shtetasve mbi 100 vjeç konsiderohet gjithashtu si një shkelje e të drejtës së tyre për të zgjedhur dhe diskriminim moshor. Mosrealizimi i votimit të emigrantëve rezultoi një rast i humbur si dhe një shkelje e angazhimeve politike të palëve, sipas Marrëveshjes së 5 Qershorit 2020.

Disa bashki patën probleme me publikimin e listave të zgjedhësve, veçanërisht gjatë tri muajve të parë. Këto probleme konsistonin në publikim me vonesë të ekstrakteve të përbërësve zgjedhore apo edhe mospublikim të tyre në vende të përshtatshme dhe që përmbushin kriteret ligjore, në disa raste.

Njoftimi me shkrim i zgjedhësve vuajti nga të njëjtat problematika që e kanë shoqëruar atë në procese të mëparshme zgjedhore. Problematika që nisin nga mënyra se si modeli i njoftimit u hartua, progresi i tij në terren, mungesa e informacionit të besueshëm në lidhje me realizimin e procesit dhe informacionet kontradiktore të mbledhura nga vëzhguesit e KRIIK dhe nga bashkitë në drejtim të Ministrisë apo Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Procesi i regjistrimit të subjekteve zgjedhore u realizua sipas përcaktimeve ligjore. Në një proces gjithëpërfshirës dhe eficient, KQZ regjistroi 17 subjekte zgjedhore - dy koalicione, dhjetë parti politike dhe pesë kandidatë të pavarur. Numri i firmave mbështetëse për t'u regjistruar si subjekt zgjedhor në mungesë të një mandati parlamentar është në përputhje me praktikat e mira për zgjedhjet. Pavarësisht kësaj, mbledhja e firmave mbështetëse u tregua të ishte një barrierë për kandidimin e kandidatëve të pavarur.

Mungesa e një përkufizimi të qartë të fushatës në ligj, krijon mundësinë që subjektet zgjedhore ta anashkalojnë dispozitën ligjore dhe ta nisin fushatën më herët se afati ligjor i 30 ditëve përpara ditës së zgjedhjeve. Partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhje, shpalosën programet politike dhe zhvilluan takime me karakter të qartë elektoral me qytetarët disa muaj përpara nisjes zyrtare të fushatës, në shkelje të ligjit.

Fushata zgjedhore u dominua nga drejtuesit e partive politike dhe asaj i mungoi debati racional, i bazuar në programe e oferta qeverisëse konkrete. Liria e shprehjes dhe e grumbullimit u respektua përgjatë fushatës pavarësisht kufizimeve të vendosura për mbrojtjen e shëndetit publik, si rezultat i pandemisë së shkaktuar nga Covid-19. Partitë politike bënë fushatë duke injoruar kufizimet e vendosura për të mbrojtur shëndetin publik dhe vendosur jetën e qytetarëve në risk.

Fushata ishte e varfër në ballafaqim platformash dhe asaj i mungoi fokusi ndaj qytetarëve. Liderët e partive politike ishin në qendër të saj dhe kandidatët individualë u spostuan në plan të dytë. Një pjesë e retorikës së fushatës u bazua në diskutimin e karakteristikave individuale të liderëve të partive, në disa raste kjo u përshkallëzua në fushata denigruese personale. Akuzat për intimidim të zgjedhësve, blerje votash, angazhim të elementëve kriminalë në fushatë, e manipulime të tjera të zgjedhjeve mbizotëruan gjatë fushatës. Gjuha konfliktuale e përdorur gjatë fushatës u përshkallëzua në incidente të dhunshme, përfshi një konflikt të armatosur, i cili shkaktoi një viktimë dhe disa të plagosur në Elbasan.

Publikimi i një baze të dhënash të zgjedhësve potencialë gjatë fushatës nxori në pah problemin e mprehtë të kontrollit total të votës dhe patronazhimit politik, i cili shkon përtej organizimit partiak legjitim. Informacioni i përmbajtur në bazën e të dhënave, për sa është bërë publike në media, përbën shkelje të hapur të legjislacionit vendas mbi të dhënat personale, ndërkohë që mundësia që këto të dhëna të jenë siguruar nga platforma digjitale *e-Albania* do të përbënte një rast flagrant e shumë të rëndë të abuzimit me burimet shtetërore.

Zyrtarët e lartë, në nivel qendror e lokal u angazhuan intensivisht në fushatë, duke e përdorur ofiqin publik për avantazh elektoral. Në përgjithësi, aktivitetet institucionale dhe shtetërore gjatë fushatës u përdorën në thuajse të gjitha rastet për fushatën zgjedhore, çka zbehu vijën ndarëse mes partisë dhe shtetit. Pjesëmarrja e administratës publike aktivisht në evente të fushatës elektorale ishte prezente edhe në këto zgjedhje, si fizikisht ashtu edhe në rrjete sociale.

Mekanizmi që synonte të adresonte problemin e keqpërdorimit të burimeve shtetërore, një prej risive të sjella nga amendimet ligjore të korrikut 2020, dështoi në qëllimin e vet dhe u kthye në një formalitet burokratik pa efekt real në praktikë. Institucionet shtetërore dështuan madje e shpërfillën në një masë të konsiderueshme të raportojnë sipas kërkesave të kuadrit ligjor. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, nuk reflektoi një qëndrim proaktiv në funksion të sanksionimit të zyrtarëve shtetërorë, sidomos pas vendimmarrjes së KAS-it që shfuqizoi sanksionet ndaj kryetarit të Bashkisë Tiranë.

Fushata hije vazhdon të jetë një fenomen shumë shqetësues dhe një nga mënyrat për të fshehur shpenzimet e fushatës zgjedhore. Në këto zgjedhje fushata hije mund të identifikohet qartë nga sasia e shpenzimeve të kryera për reklama politike në *Facebook* nga faqe të paafiluara politikisht me asnjë subjekt zgjedhor, por që kanë shpenzuar shuma të konsiderueshme për reklama politike.

Mediat, si ato tradicionale dhe *online* ishin të angazhuara gjerësisht në pasqyrimin e fushatës së parakohshme zgjedhore, asaj zyrtare dhe deri në zyrtarizmin e rezultatit në këto zgjedhje. Vijon të mbetet shqetësuese mungesa e qasjes kritike të shëndetshme ndaj informacionit që transmetohet nga media. Transmetimi i kronikave të gatshme propagandistike, zbehu rolin e medias dhe funksionin e saj të raportimit të pandikuar. Debatet mes kandidatëve munguan, pavarësisht numrit të lartë të emisioneve televizivë me karakter politik. Publiku nuk pati mundësinë që të shohë të ballafaquar platformat elektorale.

Në raportet javore që AMA i dërgoi KQZ-së, i tërhoqi vëmendje në mënyrë të përsëritur OSHMA-ve për të kompensuar balancat e pasqyrimit në edicionet informative. Megjithatë, OSHMA-të e evidentuara, përveçse nuk zbatuan kërkesën e AMA-s, rritën diferencat deri në përfundim të fushatës. Pavarësisht, se ligji parashikon gjoba deri në ndalim transmetimi të sinjalit për mosrespektim të balancave gjatë fushatës zgjedhore, KQZ-ja nuk ndërmori asnjë hap ndaj OSHMA-ve cilat e ripërsëritën këtë shkelje. Mekanizmi mbikëqyrës për mediat dhe vetë mediat dështuan të siguronin që qytetarët shqiptarë të informoheshin në mënyrë të paanshme e objektive përgjatë fushatës.

Gjatë shqyrtimit të ankesave dhe apelimeve, KAS tregoi shpesh një të lexuar të ngushtë të ligjit, si dhe një qasje e vendimmarrje diskrecionale, duke injoruar frymën e tij. Përtej një vendimmarrje që lidhet me një proces të caktuar zgjedhor, këto vendime dhe qasje të KAS, vendosin precedentë negativë për vendimmarrjen e tij në vazhdimësi, jo vetëm në këtë proces zgjedhor, por edhe në të ardhmen.

Mbetet shqetësues fakti që pavarësisht përcaktimit ligjor që i detyron partitë politike të respektojnë kuotën gjinore duke i sanksionuar ato me refuzim të listës shumëemërore në rast të mosplotësimit të saj, për disa subjekte lista u kthye për plotësim nga KQZ edhe për shkak të mos përmbushjes së këtij detyrimi.

Në zgjedhjet e 25 prillit votuan 46,33% e zgjedhësve të regjistruar; 44,99% e zgjedhësve që votuan ishin gra. Nga 17 subjekte zgjedhore garuese, rezultuan si parti parlamentare katër: Partia Socialiste e Shqipërisë me 48,67% të votave dhe 74 mandate, Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim me 39,43% të votave dhe 59 mandate, Lëvizja Socialiste për Integrim me 6,81% të votave dhe 4 mandate dhe Partia Socialdemokrate 2,21% të votave dhe tri mandate.

Numri jashtëzakonisht i lartë i fletëve të votimit të pavlefshme në këto zgjedhje, të cilat në praktikë janë të barasvlershme me rreth shtatë mandate është një problem madhor. Mbetet e paqartë se sa është pesha reale në këtë numër votash e mosinformimit të qytetarëve apo e tjetërsimit potencial të tyre gjatë procesit të numërimit.

Retorika e ashpër politike dhe konfliktualiteti që shoqëruan fushatën zgjedhore nuk u shtrinë në ditën e zgjedhjeve, e cila u zhvillua pa incidente apo problematika serioze. Procesi i votimit ishte i qetë dhe proceduralisht u administrua mirë, me përjashtim të problematikave me Pajisjen Elektronike të Identifikimit në një numër qendrash votimi. Shkeljet procedurale të vëzhguara gjykohet se nuk e ndikuan negativisht dhe në mënyrë domethënëse procesin. Një shqetësim madhor mbetet ndikimi i paligjshëm dhe i paduhur ndaj zgjedhësve në afërsi të qendrave të votimit, në linjë me indikacionet gjatë fushatës zgjedhore, për struktura të organizuara të drejtimit të votës.

Votimi familjar dhe fotografimi i votës ishin fenomene të cilët u vërejtën në një numër relativisht të lartë të Qendrave të Votimit. Ajo që ishte më shqetësuese ishte toleranca e komisionerëve të Qendrave të Votimit ndaj këtyre fenomeneve, veçanërisht ndaj fotografimit të votës.

Vështirësia apo deri pamundësia në shumë Qendra Votimi, për zgjedhësit me aftësi të kufizuara të ushtrojnë të drejtën e votës mbeti një fenomen i paadresuar edhe në këto zgjedhje. Komisionerët e Qendrave të Votimit nuk i kushtuan rëndësi zbatimit të dispozitave ligjore në lidhje me asistimin e këtyre personave, apo të personave të tjerë që kërkuan asistencë gjatë votimit. Sjellje këto në anashkalim me detyrimin për plotësimin e deklaratës përkatëse nga zgjedhësi që asiston zgjedhësin tjetër, apo duke lejuar që një person të asistonte më shumë se një zgjedhës.

Në ndryshim nga procesi i votimit, numërimi i votave u shoqërua me tensione, zvarritje dhe ndërprerje në një pjesë të konsiderueshme të VNV-ve, veçanërisht gjatë numërimit të votave parapëlqyese për kandidatët. Administrimi i procesit të numërimit nuk u karakterizua nga i njëjti nivel eficence dhe transparence si ai i votimit.

Vullneti zbatues i komisionerëve ndaj ligjit dhe hierarkisë institucionale mbeti dytësor, duke realizuar me vonesë të pajustifikueshme përmbylljen e numërimit dhe nxjerrjen e rezultateve prej KZAZ-ve. Akoma më shqetësues mbeti fakti se numërimi i votave parapëlqyese nuk mori vëmendjen e duhur. Kjo jo vetëm gjatë procesit të numërimit, por si një qëndrim në vijimësi përgjatë ndërtimit dhe zhvillimit të procesit zgjedhor dhe, veçanërisht, përgjatë fushatës zgjedhore.

Problematikë e theksuar, gjatë procesit të numërimit vijoi të mbetet prezenca e personave të paautorizuar qoftë në mjediset rrethuese të VNV-ve, qoftë brenda tyre, si rrjedhim i së cilës nuk munguan situatat e tensionuara, madje edhe incidentet e dhunshme.

I. HYRJE

Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK Albania) ka ndjekur në vazhdimësi, që prej përmbylljes së aksionit të vëzhgimit të Zgjedhjeve Parlamentare 2017 thuajse gjithë proceset institucionale, ligjore e politike që kanë lidhje, drejtpërdrejt ose jo, me integritetin e zgjedhjeve në Shqipëri, përfshirë këtu krizën politike, e cila u përvijua qartas në shkurt të vitit 2019 me dorëheqjen nga mandatet të deputetëve të opozitës, ecurinë përgatitore dhe zhvillimin e Zgjedhjeve për Organet e Qeverisjes Vendore të vitit 2019, së bashku me gjithë proceset e ngërçet institucionale që i shoqëruan dhe i pasuan ato, procesin e reformës zgjedhore që në nisje prej tetorit 2017 e më pas, si konkludim i dakordësuar prej Këshillit Politik, ndryshimet e njëanshme kushtetuese e ligjore të korrikut e tetorit 2020 që e pasuan, si dhe të tjera procese institucionale e politike me rëndësi që i paraprinë Zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të 25 prillit 2021.

Opinionet dhe qëndrimet e KRIIK-ut mbi këto zhvillime janë bërë në vazhdimësi publike nëpërmjet Deklaratave apo Qëndrimeve, Letrave të Hapura, eventeve publike[1], si dhe nëpërmjet opinioneve dhe sugjerimeve, publike ose jo, të dërguara ligjvënësve lidhur me reformën zgjedhore, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve lidhur me aktet nënligjore në plotësimin e kuadrit rregullator për këtë proces zgjedhor, apo edhe nëpërmjet takimeve me aktorë politikë e institucionalë, përfshirë Komisionin e Posaçëm Parlamentar të Reformës Zgjedhore, Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, aktorët politikë kryesorë, aktorët ndërkombëtarë etj.

Përgjatë gjithë këtij aktiviteti të ngjeshur me synim përmirësimin e integritetit të zgjedhjeve në Shqipëri, synimi parësor i KRIIK-ut mbetet fryma kritike dhe konstruktive, evidentimi i pikave të forta dhe i problematikave që kërkojnë përmirësim, si dhe ofrimi i rekomandimeve konkrete afatshkurtra e afatgjata për përmirësimin e mëtejshëm të procesit.

Procesin e Zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të 25 Prillit 2021, KRIIK ka nisur ta monitorojë në tërësi që prej momentit të shpalljes së datës së zgjedhjeve nga Presidenti i Republikës, më 6 shtator të vitit 2020.

Një vëmendje të veçantë, KRIIK i kushtoi monitorimit të përzgjedhjes së anëtarëve të tri organeve drejtuese të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, bazuar në ndryshimet ligjore të korrikut 2020, që erdhën si rrjedhojë e Marrëveshjes politike të 5 Qershorit 2020. Kjo, në veçanti, pas Qëndrimit Publik "30 qershori si dështim i klasës politike dhe kërcënim ndaj demokracisë", të publikuar më 23 gusht 2019 nga KRIIK, pas Zgjedhjeve Lokale të vitit 2019, nëpërmjet së cilës u bë thirrje, mes të tjerash, për shkrirjen e trupës së KQZ-së, pasi procesi i 30 qershorit kishte vendosur një sërë precedentësh absurdë dhe antiligjorë, të cilat mund të eliminoheshin vetëm me një riorganizim drastik të institucionit.

Ky raport monitorimi përmbledh vëzhgimin e këtij procesi zgjedhor, si dhe sjelljen institucionale e ligjore të aktorëve të përfshirë në të, nga data e shpalljes së zgjedhjeve deri në përfundimin e procesit të auditimit pas zgjedhor të kutive të votimit dhe auditimit ligjor të financimit të fushatës zgjedhore. Disa seksione të raportit (të tilla si konteksti politik apo procesi reformues i kuadrit ligjor zgjedhor), u referohen periudhave kohore që i paraprijnë periudhës zgjedhore përmendur më sipër, me nevojën për të qartësuar kontekstin në të cilin ky proces zgjedhor u zhvillua.

Publikimi i këtij raporti final është paraprirë nga publikimi i Raportit të Parë të Ndërmjetëm, i cili mbuloi periudhën nga data e shpalljes së zgjedhjeve deri më datën 25 mars 2021; Raportit të Dytë të Ndërmjetëm, i cili mbuloi periudhën nga 26 marsi deri më 23 prill 2021; Deklaratës së Gjetjeve dhe Konkluzioneve Paraprake, e publikuar më datë 26 prill 2021 pas ditës së zgjedhjeve, si dhe Deklaratës Paraprake mbi Procesin e Numërimit, e publikuar më datën 30 prill 2021 në përfundim të procesit të numërimit.

Përpos sa më sipër, KRIIK ka mbajtur dhe një numër konferencash të tjera për shtyp, veçanërisht gjatë fazës më intensive të procesit zgjedhor, përgjatë ditës së zgjedhjeve dhe procesit të numërimit të votave. Një Konferencë për Shtyp u mbajt më datën 11 mars 2021, në të cilën KRIIK bëri publike shqetësimet e tij lidhur me katër çështje të rëndësishme të procesit zgjedhor[2], të

1 Përmendet realizimi në janar 2021, në vigjilje të zgjedhjeve të përgjithshme, i Konferencës Kombëtare "Kostot e Demokracisë II – Paratë në Politikë dhe Integriteti Zgjedhor", gjatë së cilës u bë publik edhe nisja e Aksionit për Vëzhgimin e Zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të 25 Prillit 2021.

2 Çështjet urgjente që u parashtruan për t'u adresuar ishin mbi: (1) ndikimin që Covid-19 do të kishte mbi organizmin e procesit zgjedhor, veçanërisht në lidhje me të drejtën e grumbullimit dhe të drejtën e votës; (2) integritetin e kandidatëve të propozuar nga subjektet zgjedhore; (3) mundësitë që shqiptarët që jetojnë jashtë vendit të kishin të drejtë të ushtronin të drejtën e votës, si dhe (4) përdorimin e burimeve shtetërore gjatë fushatës zgjedhore.

cilat, në gjykimin e KRIIK nevojiteshin të adresoheshin urgjentisht prej aktorëve përgjegjës në periudhën e mbetur deri në ditën e zgjedhjeve. Ndërsa përgjatë ditës së zgjedhjeve u mbajtën katër konferenca për shtyp[3] nëpërmjet të cilave u informua publiku mbi gjetjet nga vëzhguesit në terren, si dhe u zhvilluan edhe tre konferenca të tjera për shtyp[4] gjatë procesit të numërimit.
Përpos ndjekjes në vazhdimësi të elementeve kontekstuale politike e institucionale, vëzhgimi i elementeve teknike të procesit është fokusuar në sjelljen dhe vendimmarrjen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, si dhe sjelljen dhe ligjzbatueshmërinë e administratës së KQZ-së; përmbushjen e detyrimeve ligjore prej Komisioneve Zonale të Administrimit Zgjedhor, institucioneve dhe aktorëve të tjerë të përfshirë në procesin zgjedhor apo që luajnë një rol në të; fushatën zgjedhore (qoftë atë të parakohshme dhe atë brenda periudhës së parashikuar në ligj); sjelljen e subjekteve zgjedhore dhe institucioneve, si dhe përdorimin e burimeve shtetërore për përfitim elektoral; sjelljen e mediave dhe të AMA-s; ecurinë e ditës së zgjedhjeve dhe procesin e numërimit, si dhe procesin e ankimimeve dhe apelimeve, ndërtimin dhe realizimin për herë të parë të procesit të këqyrjes së fletëve të votimit dhe materialeve zgjedhore (auditimi pas zgjedhor), si dhe procesin e plotë të vetëraportimit financiar të fushatës zgjedhore të kryer nga subjektet zgjedhorë dhe kandidatët, si dhe auditimin ligjor të kryer ndaj financimit të fushatës zgjedhore.
KRIIK angazhoi 22 vëzhgues afatgjatë në të gjithë vendin nga fundi i muajit shkurt deri në fillim të muajit maj, të cilët vëzhguan elementet kyç të procesit. Me afrimin e ditës së zgjedhjeve u angazhuan rreth 900 vëzhgues afatshkurtër për të vëzhguar procesin e votimit si dhe aktivitetin e komisioneve zonale të administrimit zgjedhor në të gjitha KZAZ-të e vendit përpara dhe gjatë ditës së zgjedhjeve, si dhe gjatë numërimit të votave.
KRIIK vëzhgoi procedurat e hapjes së qendrave të votimit, votimit dhe mbylljes së qendrave të votimit në 360 QV të përzgjedhura në mënyrë probabilitare në të gjithë vendin[5]; si dhe situatën përreth qendrave të votimit dhe procesin e votimit në rreth 900 qendra votimi, me ekipe prej dy vëzhguesish të lëvizshëm gjatë ditës së zgjedhjeve[6]. Përpos sa më sipër u ndoq aktiviteti i KZAZ-ve me vëzhgues stacionarë përgjatë gjithë ditës së zgjedhjeve, si dhe u kryen vizita në KZAZ ditën e premte dhe të shtunë, ndërkohë që KZAZ-të përgatitën dhe shpërndanë materialet zgjedhore për komisionet e qendrave të votimit. Procesi i numërimit u ndoq në të gjitha VNV-të e vendit me vëzhgues afatshkurtër.
Raporti final i vëzhgimit, përveçse përshkruan procesin zgjedhor dhe e analizon atë nga pikëpamja e përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga kuadri ligjor shqiptar dhe detyrimet ndërkombëtare të shtetit shqiptar (standardet e njohura ndërkombëtarisht për zgjedhje demokratike), ofron edhe rekomandime në lidhje me përmirësimin e integritetit të procesit zgjedhor, me fokus kryesor në amendimet ligjore, por edhe në lidhje me zbatimin korrekt të kuadrit ligjor ekzistues, si dhe sjelljen e institucioneve e aktorëve të përfshirë në procesin zgjedhor. Është e rëndësishme të theksohet se ky Raport për herë të parë në monitorimin prej KRIIK të një procesi zgjedhor të përgjithshëm parlamentar[7], përmban edhe financimin e subjekteve zgjedhore në mënyrë integrale, si pjesë thelbësore dhe me shumë rëndësi në analizimin dhe vlerësimin për një proces zgjedhor. Sjellim në vëmendje, se graviteti i problematikave që përmban financimi i fushatës zgjedhore, mund të çojë deri në nulifikimin

3 Konferencë për shtyp 1, datë 25 prill 2021, ora 12:00;
Konferencë për shtyp 2, datë 25 prill 2021, ora 15:30;
Konferencë për shtyp 3, datë 25 prill 2021, ora 18:00;
Konferencë për shtyp 4, datë 25 prill 2021, ora 23:30;

4 Konferencë për shtyp 1, datë 26 prill 2021, ora 22:45;
Konferencë për shtyp 2, datë 27 prill 2021,ora 22.00;
Konferencë për shtyp 3, datë 28 prill 2021, ora 22:15.

5 Vëzhgimi i 360 qendrave të votimit të përzgjedhura në mënyrë rastësore garanton përgjithësimin e gjetjeve me një marzh gabimi prej 35%, me një interval besueshmërie prej 95%.

6 Vëzhguesit e lëvizshëm kishin një tjetër metodologji vëzhgimi nga ata stacionarë. Nëse të parët u fokusuan në të gjithë elementet teknike të procesit, përgjatë gjithë ditës së zgjedhjeve në qendrën e votimit ku ishin vendosur, të dytët u fokusuan më tepër në situatën jashtë qendrave të votimit dhe vizituan qendra votimi, të cilat u konsideruan se mund të kishin problematika. Vëzhguesit e lëvizshëm ndoqën edhe procedurat teknike të votimit në qendrat e vizituara, por gjetjet e tyre janë teknikisht të pakrahasueshme me ato të vëzhguesve stacionarë, të cilët e ndoqën procesin përgjatë gjithë ditës. Kjo pasi vëzhguesit e lëvizshëm i ndoqën këto procedura vetëm për periudha të shkurtra kohorë (mesatarisht ata kalonin 30 minuta në një qendër votimi).

7 Aplikimi për herë të parë i kësaj metodologjie nga KRIIK, u bë për Monitorimin e Zgjedhjeve Vendore të 30 qershorit 2019. Për më shumë shih: Raporti i Monitorimit "Sjellja ligjore dhe institucionale e institucioneve dhe aktorëve të përfshirë në procesin zgjedhor të 30 qershorit 2019", *(periudha e monitorimit Nëntor 2018 - Shkurt 2020)*, publikuar nga KRIIK në Qershor 2020.

e rezultatit apo procesit zgjedhor. Për më tepër në realitetin shqiptar, procesi i transparencës dhe kontrollit të financave të partive politike dhe fushatave zgjedhore, asnjëherë nuk është kryer qoftë edhe pjesërisht, duke nxitur shpesh në procesin shtetformues në të cilën ndodhet vendi, paligjshmërinë, pabarazinë përpara ligjit dhe pandëshkueshmërinë e individëve dhe subjekteve me lidhje apo afilime me politikën dhe pushtetin. Nga ana tjetër, situata faktike e korrupsionit galopant dhe prezenca e krimit të organizuar e agravojnë edhe më shumë problematikën, madje rrezikojnë të çojnë drejt kapjes së pushtetit apo edhe të vetë shtetit.
Në zgjedhjet e 25 prillit 2021 votuan 1 662 274 zgjedhës ose 46,33% e zgjedhësve të regjistruar. 44,99% e zgjedhësve që votuan ishin gra. Zona zgjedhore me përqindjen më të lartë të zgjedhësve që votuan ishte Qarku Tiranë me pjesëmarrje 56,13% dhe zona zgjedhore me numrin më ulët të pjesëmarrësve ishte Qarku Vlorë me pjesëmarrje 33,56%. Në 5 198 qendra votimi që u numëruan u gjetën 1 661 176 vota në kuti, 83,059 (5%) prej të cilave u shpallën të pavlefshme gjatë procesit të numërimit. Numri jashtëzakonisht i lartë i fletëve të votimit të pavlefshme në këto zgjedhje, të cilat në praktikë janë të barasvlefshme me rreth shtatë mandate është një problem madhor. Nga auditimi paszgjedhor i bërë prej KQZ-së dhe këqyrja e fletëve të votimit të pavlefshme, sërish mbetet i paqartë se sa është pesha e mosinformimit të qytetarëve dhe sa ajo e tjetërsimit potencial të votave gjatë procesit të numërimit. Shpërndarja e votave të pavlefshme është thuajse e barabartë mes qarqeve të ndryshme. Bashkia me numrin më të ulët të votave të pavlefshme është Himara, me 2,11% të votave të pavlefshme, ndërsa ajo me numrin më të lartë të votave të pavlefshme është Bulqiza e cila arrin në 8,84% të votave.
Nga 17 subjekte zgjedhore garuese në proces (12 parti politike që garuan në gjithë vendin dhe 5 kandidatë të pavarur që garuan në një zonë zgjedhore secili), rezultuan si parti parlamentare katër prej tyre. Partia Socialiste e Shqipërisë mori 48,67% të votave dhe 74 mandate, Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim 39,43% të votave dhe 59 mandate, Lëvizja Socialiste për Integrim 6,81% të votave dhe katër mandate dhe Partia Socialdemokrate 2,21% të votave dhe tri mandate. Asnjë nga subjektet e tjera zgjedhore nuk e kaloi pragun prej 1% të votave në rang vendi.
Aksioni i Vëzhgimit të Zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të 25 Prillit 2021 u realizua në bashkëpunim me 33 organizata partnere, të cilat operojnë në të gjithë vendin: Agjencia Joniane e Mjedisit, Medias, Informacionit – Sarandë; E Shkuara për të Ardhmen - Korçë; Epoka e Re – Fier; Forumi Civil Selenicë – Selenicë; Forumi i Gruas Elbasan - Elbasan; Gruaja Naftëtare në Fokusin e Zhvillimit – Kuçovë; Gruaja në Zhvillim – Korçë; Grupi Lokal i Veprimit Integrimi - Dibër; Lëvizja Rinore për Demokraci Pukë – Pukë; Lëvizja për Zhvillimin e Turizmit - Ksamil; Shoqata Mbrojtja e Mjedisit dhe Zhvillimi i Turizmit – Has; Mbrojtja e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara (MEDPAK) – Librazhd; Nisma e Luleve - Sarandë; Platforma Kombëtare për Gratë – Fier; Porta Rome për Integrim - Krujë; Shoqata Qëndistaret – Korçë; Unë Gruaja - Pogradec; Qendra e Këshillimit të Grave dhe Shërbimeve Sociale – Kukës; Qendra Këshillimore për Njerëzit me Aftësi të Kufizuar - Shkodër; Qendra Sociale në Ndihmë të Njerëzve në Nevojë - Fushë Arrëz; Qendra e Zhvillimit të Shoqërisë Civile - Durrës; *Hand to Hand Against Nation Apathy* – Lezhë; Qendra Rinore e Vlorës – Vlorë; Shoqata Mbrojtja e të Drejtave të Gruas Fshatare dhe Qytetare – Berat; Shoqata Alpin – Tropojë; Shoqata Ekspertët e Rinj Mjedisor – Bulqizë; Shoqata për Gratë dhe Fëmijët – Tiranë; Shoqata Rreze Shprese - Vau Dejës; Sindikata e Pavarur e Tipografëve – Tiranë; *The Youth of Ura Vajgurore* - Ura Vajgurore; *Together for Roma Integration* – Fier; *Youth for Social Changes* – Vorë; si dhe *Consulting and Development Partners* – Shkodër.
KRIIK falënderon të gjitha institucionet, lokale e qendrore, me të cilat ka bashkëpunuar dhe ka marrë informacion; administratën zgjedhore, duke filluar me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si dhe organizma të tjerë e bashkëbisedues, të cilët kanë ndihmuar në mbledhjen e informacionit. KRIIK gjithashtu falënderon mbështetësit financiarë të Projektit të Vëzhgimit të Zgjedhjeve Parlamentare të 25 Prillit 2021, pa mbështetjen e të cilëve nuk do të kishte qenë i mundur një aksion vëzhgimi në një shkallë të tillë.

Projekti i Vëzhgimit të Zgjedhjeve nga KRIIK për Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të 25 Prillit 2021 mbështetet financiarisht nga:

- Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar;
- Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC)
- Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës Federale të Gjermanisë dhe
- Ministria e Punëve të Jashtme e Dukatës së Madhe të Luksemburgut.

Opinionet dhe këndvështrimet e shprehura në këtë Raport dhe në çdo publikim tjetër në kuadër të këtij aksioni vëzhgimi, janë përgjegjësi e KRIIK dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërish pozicionin zyrtar apo opinionin e donatorëve.

II. KONTEKSTI POLITIK DHE INSTITUCIONAL

Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të 25 prillit 2021 u mbajtën në një klimë politike tejet të polarizuar dhe konfliktuale, me një mungesë besimi të theksuar mes palëve politike. Kjo klimë u reflektua në sjelljen e institucioneve publike përgjatë periudhës zgjedhore, përfshi administratën zgjedhore, si edhe institucione të tjera që luajnë një rol në procesin zgjedhor. Për më tepër, për situatën e veçantë në të cilën këto zgjedhje u mbajtën, me opozitën jashtë tërë institucioneve publike, si rrjedhojë e heqjes dorë nga mandatet parlamentare në shkurt 2019 dhe mosmarrjes pjesë në Zgjedhjet Lokale 2019, maxhoranca aktuale hyri në këto zgjedhje me përparësinë e të qenët në kontroll të plotë të institucioneve publike, çka i dha asaj një përparësi në procesin zgjedhor dhe zbehu dukshëm vijën ndarëse mes shtetit dhe partisë përgjatë gjithë procesit.

Klima politike konfliktuale, e cila nisi të përshkallëzohej disa muaj përpara Zgjedhjeve Parlamentare të vitit 2017 dhe vijoi në përshkallëzim të mëtejshëm me heqjen dorë prej mandateve të partive kryesore të opozitës parlamentare në shkurt të 2019-ës dhe bojkotimin prej tyre të Zgjedhjeve Lokale të vitit 2019, duke shpënë në një situatë të paprecedentë në 30 vite të demokracisë shqiptare, ku opozita ishte e papërfaqësuar në sferën vendimmarrëse dhe institucionale në vend.

Tepër shqetësuese në këto zgjedhje ishte se polarizimi i klimës politike nxori në pah, më shumë se në proceset e shkuara zgjedhore, politizimin e fortë të institucioneve publike, në të gjitha nivelet. Në një numër rastesh u vu re një sjellje partizane dhe e anshme nga ana e këtyre institucioneve, përfshi këtu edhe institucionet e pavarura apo organet ligjzbatuese.

Retorikës së ashpër politike dhe akuzave mes subjekteve zgjedhore iu shtua edhe përfshirja e panatyrshme e Presidentit të Republikës në garën elektorale duke mbajtur gjatë gjithë fushatës, veçanërisht ndërsa dita e zgjedhjeve afrohej, një qëndrim të qartë kundër maxhorancës qeverisëse dhe duke e angazhuar institucionin e Presidencës në fushatën zgjedhore, kundër maxhorancës aktuale. Nga ana tjetër, Partia Socialiste, e nxiti dhe vendosi në pah këtë qasje joinstitucionale të Presidentit duke e shënjestruar këtë të fundit si një palë të përfshirë në procesin zgjedhor, duke e unifikuar atë me drejtuesit e opozitës, si dhe përdorur narrativën e mësipërme institucionalisht edhe në funksion të fushatës së vet zgjedhore. Një sjellje e tillë, qoftë nga ana e Presidentit, qoftë nga ana e maxhorancës vlerësohet të ketë ndikuar edhe më tepër në uljen e nivelit të besimit të qytetarëve shqiptarë në institucionet kryesore të shtetit.

Konflikti mes maxhorancës qeverisëse dhe Presidentit të Republikës kulmoi menjëherë pas ditës së zgjedhjeve, ndërkohë që procesi i numërimit vijonte ende, me deklarata të forta politike nga përfaqësues të lartë të maxhorancës vetëm tri ditë pas zgjedhjeve[8], të cilat u pasuan më pas me hapa institucionalë sikurse ishte ngritja e një Komisioni të Posaçëm Parlamentar për hetimin e rolit të Presidentit gjatë fushatës zgjedhore dhe ndërmarrjen e hapave për shkarkimin e tij.

Një veprim i tillë zhvendosi dukshëm vëmendjen nga procesi zgjedhor që ende ishte në zhvillim, e specifikisht nga procesi i ankesave dhe apelimeve, duke vendosur konfliktin politik-institucional në plan të parë, e duke vënë nën presion e lënë në hije procesin shumë të rëndësishëm të drejtësisë zgjedhore, si faza e fundit e procesit zgjedhor.

Komisioni Parlamentar i mbylli hetimet e veta më datë 24 maj dhe, me propozim të tij, më datë 9 qershor Kuvendi vendosi shkarkimin e Presidentit. Ky vendim i Kuvendit të Shqipërisë është marrë tashmë në shqyrtim prej Gjykatës Kushtetuese, e cila pritet të japë shumë shpejt gjykimin e saj mbi këtë vendim.

Zgjedhjet u kryen me një kuadër ligjor të ndryshuar në masë të konsiderueshme. Pjesa më e madhe e amendimeve ligjore erdhën pas dakordësisë politike mes maxhorancës, opozitës jashtëparlamentare, dhe opozitës parlamentare[9]. Pas një serie dështimesh për të kryer një reformë zgjedhore të plotë e gjithëpërfshirëse, prej vitit 2012, në qershor të vitit 2020

8 Ndërkohë, Kryeministri Rama ka deklaruar dy ditë përpara zgjedhjeve, më 23 prill 2021, se nëse Presidenti Meta nuk jepte dorëheqjen pas 25 prillit, ai do të shkarkohej nga Kuvendi ekzistues.

9 E përbërë nga kandidatë për deputetë që ishin në listë pritje në listat e kandidatëve për deputetë të opozitës. Pas vendimmarrjes politike të opozitës për të lënë mandatet në bllok nga të gjithë deputetë dhe kandidatët e tjerë që pasonin në listë pritje, këta kandidatë e refuzuan këtë vendimmarrje politike dhe pranuan mandatet e deputetëve opozitarë të dorëzuara tashmë. Kjo bëri që parlamenti të vijojë prej atëherë të funksionojë me 122 deputetë, nga 140 deputetë që parashikohen të jenë në Kuvendi e Shqipërisë.

maxhoranca dhe opozita u dakordësuan për një paketë amendimesh të thelluara në kuadrin ligjor për zgjedhjet, me anë të një Marrëveshjeje Politike të nënshkruar më 5 Qershor 2020. Mungesa e thellë e besimit mes palëve dhe mosdëshira për të bashkëpunuar u shfaqën qartë përgjatë gjithë procesit të negociatave politike dhe marrëveshja u sigurua vetëm pas një procesi negocimi dhe ndërmjetësimi nga ambasadorët e partnerëve më të rëndësishëm ndërkombëtarë të Shqipërisë. Marrëveshja e 5 Qershorit 2020, pavarësisht se dështoi të sillte një reformim të plotë dhe gjithëpërfshirës të kuadrit ligjor dhe vuajti nga mungesa e transparencës, u vlerësua nga aktorë ndërkombëtarë dhe vendas, përfshi KRIIK, si një hap i parë drejt krijimit të besimit mes palëve politike dhe rivendosjes në shtratin institucional të komunikimit dhe ndërveprimit politik mes tyre.

Por konfliktualiteti dhe mungesa e besimit u rishfaqën vetëm pak ditë pas nënshkrimit të Marrëveshjes së 5 Qershorit, kur maxhoranca dhe opozita parlamentare ndryshuan në mënyrë të njëanshme Kushtetutën e Republikës, për t'u hapur rrugën amendimeve të mëtejshme të kuadrit ligjor zgjedhor, të padakordësuara tashmë me opozitën[10]. Opozita jashtëparlamentare reagoi fort ndaj këtij ndryshimi, i cili, mes të tjerash, eliminonte edhe mundësinë që partitë politike të bashkuara në koalicione parazgjedhore të paraqisnin lista kandidatësh për secilën parti pjesë e koalicionit, duke e konsideruar atë një shkelje të Marrëveshjes së 5 Qershorit.

Ndryshimet kushtetuese u kryen në një kohë shumë të shkurtër, në shkelje të disa ligjeve dhe parimeve[11] dhe pa konsensusin politik të të gjithë aktorëve më të rëndësishëm politikë në vend. Ndryshimet u pasuan nga amendime të tjera të njëanshme të Kodit Zgjedhor, më 5 tetor 2020. Këto amendime u miratuan pa ndryshime, edhe pasi Presidenti i Republikës i ktheu për rishqyrtim në parlament duke i konsideruar ato "në kundërshtim të hapur me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe parimet themelore demokratike të mbrojtura prej saj"[12].

Në këtë kontekst politik dhe institucional gati parashtetëror, të shoqëruar edhe me handikape dhe problematika të hasura edhe nga vështirësitë e ecurisë së Reformës në Drejtësi dhe mungesa e theksuar e besimit mes aktorëve politikë, procesi zgjedhor i 25 prillit 2021, kishte një rëndësi jetike për sheshimin e konfliktit politik dhe ekuilibrimin e pushteteve duke i rilegjitimuar ato, jetën institucionale dhe forcën ligjzbatuese bazuar në vullnetin e shprehur të sovranit në këtë proces, një vullnet i lirë dhe i pacenuar i tij.

Aspirata e Marrëveshjes Politike të 5 Qershorit 2020 pati si test të parë zhvillimin e këtij procesi zgjedhor, i cili, ashtu si edhe proceset e mëparshme, u zhvillua duke u bazuar thelbësisht në sjelljen dhe vullnetin e forcave politike kryesore që kanë edhe rol administrues në proces, dhe që janë sërish tri forcat më të mëdha politike: Partia Socialiste, Partia Demokratike dhe Lëvizja Socialiste për Integrim.

Testi i radhës i Marrëveshjes së 5 Qershorit 2020 do të jetë angazhimi i partive politike, qofshin këto në maxhorancë a opozitë, për reformimin e kuadrit ligjor mbi zgjedhjet, apo edhe të legjislacionit që lidhet ngushtë dhe prek procesin zgjedhor, e në veçanti atë që rregullon partitë politike, financimin politik dhe depolitizimin *de facto* të administratës shtetërore.

Aspiratat e vendosura prej saj në lidhje me forcimin e integritetit të zgjedhjeve mund të përdoren në vazhdim nga partitë politike si një bazë për diskutime dhe ndryshimet teknike të mëtejshme, më të thelluar e më të plota të kuadrit ligjor.

10 Për më tepër mbi natyrën e amendimeve shih seksionin mbi kuadrin ligjor.

11 Për më shumë shih Qëndrimin Publik "Prishja e Marrëveshjes Politike dhe amendimi i njëanshëm i Kushtetutës, precedent tejet i rrezikshëm për të ardhmen demokratike të vendit", të publikuar nga KRIIK më datë 17 korrik 2020.

12 Dekreti nr. 11797 i Presidentit të Republikës, datë 22.10.2020. "Për kthimin e ligjit nr. 118/2020 'për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, 'Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë',i ndryshuar'"

III. KUADRI LIGJOR DHE SISTEMI ZGJEDHOR

III.1. KUADRI LIGJOR

Zgjedhjet rregullohen nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë[13], nga Kodi Zgjedhor[14], i miratuar në vitin 2008 dhe amenduar katër herë në vazhdim, dy amendimet e fundit në vitin 2020; ligje të tjera të cilat rregullojnë aspekte të caktuara të zgjedhjeve apo prekin mbarëvajtjen e tyre[15]; aktet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve; si dhe vendimet e Kolegjit Zgjedhor. Kodi Zgjedhor përshkruan sistemin zgjedhor, rregullon administrimin e zgjedhjeve, regjistrimin e subjekteve zgjedhore dhe kandidatëve, regjistrimin e zgjedhësve, fushatën zgjedhore, mbulimin mediatik të fushatës, financimin e subjekteve zgjedhore, shpalljen e rezultateve, si dhe procesin e ankesave dhe apelimeve.
Gjykata Kushtetuese me një vendimmarrje të saj të datës 7 maj 2013 e ka përjashtuar veten nga shqyrtimi i çështjeve zgjedhore, duke hequr dorë nga detyrimi për sigurimin e procesit të rregullt dhe të drejtave kushtetuese, çka është një veprim i kritikuar nga vëzhguesit vendas (KRIIK/KVV) dhe ata ndërkombëtarë (ODIHR[12]), si dhe për të cilën është rekomanduar kthimi i saj në përmbushje të funksionit që i njeh Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.
Shqipëria ka ratifikuar apo bën pjesë edhe në një numër konventash apo traktatesh ndërkombëtare, të cilat rregullojnë të drejtat civile dhe politike të lidhura me zgjedhjet[16], dhe të cilat shteti shqiptar ka detyrimin t'i zbatojë[17].
Zgjedhjet e 25 prillit 2021 u mbajtën me kuadër ligjor të ndryshuar në shumë elementë të tij. Që prej reformimit të vitit 2012, aktorët politikë ishin zotuar disa herë për të ndërmarrë një proces reformues të thelluar dhe gjithëpërfshirës të kuadrit ligjor zgjedhor. Këto përpjekje dështuan disa herë, madje pa konkluduar në asnjë tekst ligjor ndryshues. Një përjashtim i rrallë ishin amendimet e kuadrit ligjor të vitit 2017, kur në prag të nisjes së fushatës zgjedhore u ndërmorën disa ndryshime legjislative të minutës së fundit, si rrjedhojë e marrëveshjes politike të 18 majit 2017 ndërmjet liderit të Partisë Socialiste dhe atij të Partisë Demokratike.
Reforma zgjedhore, e cila përfundoi në vitin 2020 pikënisi me vendimin e Kuvendit në vitin 2017 për ngritjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore[18]. Këtij Komisioni përgjatë

13 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (Ndryshuar me ligjet: nr. 9675, datë 13.1.2007, nr. 9904, datë 21.4.2008, nr. 88/2012, datë 18.9.2012, nr. 137/2015, datë 17.12.2015, nr. 76/2016, datë 22.7.2016, nr. 115/2020, datë 30.7.2020).

14 Ligji nr. 10 019, datë 29.12.2008, Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, *(ndryshuar me ligjet nr.74/2012, datë 19.07.2012 , nr. 31/2015, datë 02.04.2015, nr. 101/2020).*

15 Ligji Nr. 8580, datë 17.2.2000, Për Partitë Politike, (ndryshuar me ligjet: nr. 9452, datë 2.2.2006, nr. 10 374, datë 10.2.2011, nr.17/2014 dhe nr. 90/2017, datë 22.5.2017, nr. 135/2020, datë 16.11.2020; shfuqizuar një fjali me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 33, datë 9.5.2001; Ligji nr. 238/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", (ndryshuar me ligjin nr. 38/2016, 14.4.2016), i njohur si Ligji i Dekriminalizimit; Ligji Nr.8773, datë 23.4.2001, "Për Tubimet", Ligji nr. 97/2013. "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", ndryshuar me ligjin nr. 22/2016, datë 10.3.2016, vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 56, datë 27.7.2016 dhe ligjin nr. 91/2017, date 22.5.2017); Ligji Nr. 7895, datë 27.1.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", (Ndryshuar me ligjet nr. 8175, datë 23.12.1996; nr. 8204, date 10.4.1997; nr. 8279, datë 15.1.1998; nr. 8733, datë 24.1.2001; nr. 9017, datë 6.3.2003; nr. 9030, datë 13.3.2003; nr. 9086, datë 19.6.2003; nr. 9188, datë 12.2.2004; nr. 9275, date 16.9.2004; nr. 9686, datë 26.2.2007; nr. 9859, datë 21.1.2008; nr. 10 023, datë 27.11.2008; nr. 23/2012, date 1.3.2012; nr. 144, datë 2.5.2013; nr. 98, datë 31.7.2014; nr. 176/2014, datë 18.12.2014; nr. 135/2015, date 5.12.2015; nr. 82/2016, datë 25.7.2016; nr. 36/2017, datë 30.3.2017; nr. 89/2017, datë 22.5.2017; nr. 44/2019, datë 18.7.2019, nr. 35/2020, datë 16.4.2020, nr. 146/2020, datë 17.12.2020; nr. 43/2021, datë 23.3.2021; Vendimet e Gjykatës Kushtetuese: nr. 13, datë 29.5.1997; nr. 46, datë 28.8.1997; nr. 58, datë 5.12.1997; nr. 65, datë 10.12.1999; nr. 11, datë 2.4.2008; nr. 19, datë 1.6.2011; nr. 47, datë 26.7.2012 dhe nr. 9, datë 26.2.2016), në kapitullin "Vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve"; Ligji nr. 44/2015 "Kodi i Procedurës Administrative i Republikës së Shqipërisë", i cili rregullon veprimtarinë administrative të KQZ-së etj.

16 Ndër të tjera, shteti shqiptar ka ratifikuar apo bën pjesë në Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, bërë pjesë në vitin 1991; Konventën Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor, bërë pjesë në vitin 1994; Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, bërë pjesë në vitin 1994; Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, bërë pjesë në vitin 2013, Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ratifikuar në vitin 1996; Konventën Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, bërë pjesë në vitin 1999 etj.

17 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 5.

18 Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Vendimi Nr. 102, 2017, "Për ngritjen e komisionit të posaçëm parlamentar për realizimin e reformës zgjedhore".

rreth tri viteve, iu shty disa herë mandati i veprimtarisë[19] dhe zhvilloi disa seanca[20], por pa konkluduar në ndonjë amendim. Ky *impasse* u thellua me bojkotimin dhe dorëzimin e mandateve në bllok të deputetëve të Partisë Demokratike dhe Lëvizjes Socialiste për Integrim në shkurt të vitit 2019.
Pas disa përpjekjeve për të përfshirë përfaqësuesit e opozitës jashtëparlamentare në Komisionin Parlamentar, në janarin e vitit 2020, aktorët politikë u dakordësuan mbi një modul ekstra-institucional për diskutimin e draft-amendimeve të kuadrit ligjor zgjedhor. Sipas kësaj marrëveshjeje, u ngrit i ashtuquajturi Këshill Politik, i përbërë nga katër anëtarë me përfaqësues të maxhorancës e opozitës parlamentare, si dhe të Partisë Demokratike e Lëvizjes Socialiste për Integrim, si përfaqësuese të opozitës jashtëparlamentare, me objekt përgatitjen dhe dakordësimin mbi draft-amendimet brenda datës 15 mars 2020[21].
Pas tejkalimit të afatit paraprak të funksionimit, pjesërisht edhe si pasojë e pandemisë nga Covid-19, dhe vështirësive jo të pakta për të rënë dakord[22], palët dakordësuan një Dokument Politik më datë 5 Qershor 2020[23]. Një marrëveshje asokohe që u përshëndet si nga partnerët e vendit, përfaqësitë diplomatike[24] ashtu edhe nga aktorë vendas, përfshi KRIIK[25]. Mbi këtë Marrëveshje u hartua më pas teksti i amendimeve ligjore, i cili u miratua nga Kuvendi i Shqipërisë me datë 23 korrik 2020[26].
Ndërhyrjet e korrikut në Kodin Zgjedhor sollën amendimin[27], shtimin[28] apo abrogimin[29] e 80 dispozitave ligjore në total.
Dy ndryshimet thelbësore në kuadrin ligjor vlerësohet të jenë zhbërja e trupës së KQZ-së dhe konstituimi i një trupe të re, por tanimë trilaterale: Komisioneri Shtetëror për Zgjedhjet, Komisioni Rregullator dhe Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve (shih seksionin mbi Komisionin Qendror të Zgjedhjeve) dhe disa ndryshime në financimin e fushatës zgjedhore (shih seksionin mbi financimin e fushatës zgjedhore).
Të tjera ndryshime të rëndësishme përfshinë futjen e përdorimit të teknologjisë në zgjedhje[30]; rregullimin për konkretizimin e së drejtës së votës për shtetasit shqiptarë që janë me vendbanim të përhershëm jashtë vendit; rregullime në lidhje me fushatën zgjedhore[31], përfshi të tilla që synojnë të parandalojnë përdorimin e burimeve publike për përfitim elektoral; mbulimin e fushatës nga mediat[32]; amendime që synojnë përmirësimin e përfaqësimit të grave në politikë (përmirësimin

19 Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Vendimi Nr. 103/2019, datë 12/09/2019, "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 102/2017 "Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për realizimin e reformës zgjedhore", të ndryshuar".

20 Përgjatë gjithë veprimtarisë gati trevjeçare, Komisioni i Posaçëm zhvilloi 18 seanca në datat 10/11/2017, 01/12/2017, 14/02/2018, 09/03/2018, 23/03/2018, 20/04/2018, 20/04/2018, 08/05/2018, 06/06/2018, 07/05/2019, 24/05/2019, 10/10/2019, 24/10/2019, 05/11/2019, 07/11/2019, 18/11/2019, 05/12/2019, 19/12/2019 dhe 06/05/2020.

21 Teksti i Marrëveshjes përcaktonte ndër të tjera se palët e përfshira angazhoheshin të adresonin me konsensus të gjitha çështjet e administrimit të zgjedhjeve që ishin objekt pune i Komisionit të Reformës Zgjedhore, përfshirë këtu edhe rekomandimet e OSBE/ODHIR-it. Për çështjet që nuk do të gjendej dakordësi do të kërkohej mendim dhe ndihmë nga ekspertët ndërkombëtarë.

22 KRIIK Albania, Qëndrim publik, datë 31.05.2020, "Reforma Zgjedhore larg aspiratave dhe pritshmërive për një reformë të vërtetë, të thelluar dhe gjithëpërfshirëse".

23 Teksti i Marrëveshjes përcaktonte 12 pika, ku përfshiheshin dakordësitë për identifikimin biometrik dhe administratën zgjedhore.

24 Ambasada e Shteteve të Bashkuara në Tiranë, Deklaratë për shtyp, datë 05.06.2020.

25 KRIIK Albania, Letër e Hapur, datë 16/06/2020, "Dakordësia e arritur në Marrëveshjen e 5 Qershorit, si një moment i lidershipeve për të tejkaluar përvojën e derisotme".

26 Kuvendi i Shqipërisë, Ligji Nr. 101, datë 23.07.2020, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 019, datë 29.12.2008", "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar".

27 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, nenet nr. 2, 3, 4, 8, 9, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 34, 44, 46, 47, 52, 53, 61, 62, 64, 67, 71, 76, 78, 79, 84, 85, 86, 87, 88, 89, 90, 91, 92, 92/1, 92/2, 92/3, 92/4, 92/5, 92/6, 92/7, 109, 123, 138, 146, 149, 163, 164, 172, 173, 175, 179, 180, 181, 182, 185.

28 Po aty, nenet 123/1, 123/2, 123/3, 124/1, 167/1, 167/2.

29 Po aty, nenet 44, "g". "c", 52 p. 1, 53 p. 3, 85/1, 163 pika 6, 180/1.

30 Identifikimin elektronik të zgjedhësve, votimin dhe numërimin elektronik, i cili u pilotua në një zonë administrimi zgjedhor në Tiranë, si dhe përdorimin e kamerave gjatë procesit të votimit.

31 Ndalimin e subjekteve zgjedhore (përfshi të tretë) të organizojnë evente apo bamirësi gjatë fushatës zgjedhore, detyrimin e subjekteve zgjedhore për të shënuar qartë në materialet propagandistike se kush i ka prodhuar ato, shtrirja e ndalimit për reklamat e institucioneve publike katër muaj para ditës së zgjedhjeve etj.

32 Detyrimi i mediave për të markuar qartë materialin e marrë të gatshëm nga subjektet zgjedhore si të tillë, kalimin e kompetencave të monitorimit të mediave gjatë fushatës zgjedhore tek Autoriteti i Medias Audiovizive (AMA).

e barazisë gjinore); përcaktimi i periudhave kohore brenda të cilave mund të mbahen zgjedhjet; e drejta e qytetarëve për të denoncuar në KQZ shkeljet e legjislacionit zgjedhor; këqyrja e mëpasshme e fletëve të votimit dhe materialit zgjedhor (i ashtuquajturi "audit zgjedhor") etj.
Përveç sa më sipër, amendimet ligjore përfshinë edhe dispozita tranzitore, të cilat lejonin opozitën jashtëparlamentare (deputetët e së cilës hoqën dorë nga mandatet e fituara në Zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2017) që të përfshihej në procesin e përzgjedhjes së anëtarëve të organeve të reja të KQZ-së dhe në emërimin e anëtarëve të niveleve të tjera të administratës zgjedhore (komisionet zonale të administrimit zgjedhor (KZAZ), komisionet e qendrave të votimit (KQV) dhe grupet e numërimit të votave (GNV).
Menjëherë pas dakordësimit dhe nënshkrimit të Marrëveshjes së 5 Qershorit 2020, jashtë tekstit të Marrëveshjes, dhe për sa ishte dakordësuar, Kuvendi ndërmori dhe një tjetër nismë legjislative, amendimin e njëanshëm të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë[33]. Draft-ligji u depozitua në Kuvend nga një grup deputetësh të opozitës parlamentare[34], gjatë kohës që vendi ishte në situatën e gjendjes së fatkeqësisë natyrore për shkak të epidemisë së shkaktuar nga Covid-19, çka ishte jo ligjore. Në reflektim të këtyre ndryshimeve kushtetuese, Kuvendi miratoi më pas një amendim të dytë të Kodit Zgjedhor më datë 5 tetor 2020[35], sërish në mënyrë të njëanshme dhe pa asnjë konsultim publik.
Ndryshimet e Kodit Zgjedhor të tetorit kishin për objekt ndryshimin e mënyrës së votimit për kandidatët, nga votimi për partinë me lista të mbyllura kandidatësh dhe të fiksuar paraprakisht, në votim preferencial të kandidatëve në listë. Këshilli Politik me objekt këto ndryshime në Kodin Zgjedhor rinisi punën më 14 shtator, megjithatë këto ndryshime nuk morën asnjëherë dakordësinë e opozitës jashtëparlamentare, fakt për të cilin, maxhoranca mori kritika si nga aktorë të huaj,[36] ashtu dhe nga ata vendas[37]. Argumenti i opozitës, ndër të tjera, ishte se ndryshimet ishin një tejkalim nga marrëveshja e qershorit 2020 dhe modaliteti i zgjedhur nuk përbënte realisht hapje të listave, pasi ka një prag minimal votash që kandidatët të mund të përfitojnë nga rirenditja në listë si rrjedhim i votave preferenciale (shih seksionin mbi sistemin zgjedhor). Madje ajo kërkoi diskutimin e draftit të maxhorancës në Këshillin Politik duke propozuar hapjen 100% të listave ndaj votimit preferencial dhe mosprekjen e koalicioneve parazgjedhore[38].
Në këtë kundërvënie ndërmjet palëve u përfshi dhe Presidenti i Republikës së Shqipërisë. Ndonëse shprehu kritika të forta për amendimin e Kushtetutës[39], ai e dekretoi aktin. Ndërsa, në rastin e miratimit të amendimit të dytë të Kodit Zgjedhor, Presidenti refuzoi dekretimin e tij[40]. Për këtë arsye, Presidenti paraqiti kërkesën për ndërhyrjen e asistencës së Komisionit të Venecias[41]. Ky i fundit bëri me dije pranimin e kërkesës, por njëkohësisht edhe pamundësinë e shqyrtimit të saj me një procedurë të përshpejtuar.
Bindja Demokratike dhe Lëvizja Demokratike Shqiptare i ankimuan ndryshimet specifike që përcaktojnë rirenditjen e kandidatëve në listë vetëm nëse thyejnë herësin në Gjykatën Kushtetuese, e cila në 30 qershor 2021[42] e rrëzoi pikën 3 të nenit 163 të Kodit Zgjedhor, si të papajtueshëm me Kushtetutën, potencialisht, duke hapur rrugën për lista plotësisht të hapura. Kuvendi i Republikës ndërmori në fund të këtij procesi amendues edhe disa amendime të tjera minore, të dakordësuara si të nevojshme për funksionalizimin e ndryshimeve të reja të Kodit Zgjedhor, e veçanërisht edhe amendimin e Ligjit "Për partitë politike". Ky amendim i ndërmarrë nga një deputet i maxhorancës, u konsiderua si pjesë e Marrëveshjes së 5 Qershorit

33 Ligji Nr. 115/2020, datë 30.07.2020, "Për disa ndryshime në Ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, të ndryshuar".

34 Grup deputetësh, projekt-akt për amendimin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Nr. 1561 Prot., datë 05.06.2020.

35 Ligji Nr. 118, datë 05.10.2020, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, i ndryshuar".

36 Ambasada e Shteteve të Bashkuara në Tiranë, Deklaratë për shtyp, datë 30.07.2020.

37 KRIIK Albania, Qëndrim publik, datë 17.07.2020, "Prishja e Marrëveshjes Politike dhe amendimi i njëanshëm i Kushtetutës, precedent tejet i rrezikshëm për të ardhmen demokratike të vendit".

38 Për më shumë artikullin e *ABC News*: "Opozita dorëzon draftin në Këshillin Politik: Lista 100% të hapura dhe koalicionet siç janë", datë 27 shtator 2020.

39 Presidenti i Republikës, Deklaratë për shtyp, datë 30.07.2020.

40 Dekret për rikthimin për rishqyrtim i Presidentit të Republikës, datë 23.10.2020.

41 Kërkesë drejtuar Komisionit për Demokraci nëpërmjet Ligjit nga Presidenti i Republikës, datë 21.10.2020, "Kërkesë për një Opinion urgjent mbi procesin e ndryshimit të njëanshëm dhe të përshpejtuar të Kushtetutës dhe Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë".

42 Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë Vendimi nr. 28 datë 30.06.2021.

2020 dhe në kuadër të harmonizimit me ndryshimet e para të kryera në Kodin Zgjedhor për financimin e fushatës zgjedhore, por ndërkohë edhe ky amendim ligjor vuajti nga fiktiviteti në procesin konsultues të tij. Gjithashtu, u amendua Kodi Penal[43] si dhe Ligji për Prokurorinë[44], duke përcaktuar detyrimin e Prokurorit të Përgjithshëm dhe Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, sipas juridiksionit përkatës, t'i japin KQZ-së informacion për hetimin e veprave penale në fushën e zgjedhjeve.

Në rezultante të së tërës, procesi reformues rezultoi në ndërhyrje të Kodit Zgjedhor, amendimit të Kushtetutës së Republikës, Ligjit "Për partitë politike", Kodit Penal dhe Ligjit për Prokurorinë. Përpos investimit ndërmjetësues të përfaqësuesve të partnerëve strategjikë të vendit dhe sakrifikimit të shtratit institucional të komunikimit politik, jo të gjitha këto ndërhyrje morën dakordësinë e forcave opozitare. Kjo zhbëri standardin e vendosur dhe të arrirë në proceset e mëparshme amenduese, ku dakordësia në unison e palëve ka qenë mbizotëruese. Kritikë kjo që u evidentua edhe në Opinionin e Komisionit të Venecias mbi ndryshimet kushtetuese.

Amendimet ligjore të vitit të shkuar, pavarësisht se sollën ndryshime të cilat, nëse zbatohen me vullnet të mirë, përmirësojnë kuadrin ligjor për zgjedhjet, dështuan të prekin apo trajtojnë në thellësi problematika të mprehta nga të cilat kanë vuajtur zgjedhjet në vend. Të tilla përmenden dështimi për të garantuar një mekanizëm tërësisht funksional institucional dhe ligjor që garanton transparencën dhe kontrollin mbi financimin e subjekteve zgjedhore[45]; dështimi për të garantuar transparencë të plotë mbi kandidatët[46]; apo dështimin për të rregulluar në mënyrë të plotë votimin e shqiptarëve jashtë vendit dhe ngarkimin me këtë detyrë KQZ-në, çka çoi në dështimin e këtij procesi[47].

Në kuadër të sakrifikimit të shtratit institucional, edhe procesi i konsultimit publik për amendimet e kuadrit ligjor zgjedhor të vitit të shkuar shënoi hapa të tjerë pas. Së pari, tërë veprimtaria e Këshillit Politik ishte një diskutim me dyer të mbyllura dhe më së shumti pa negociatorë të brendshëm ose të huaj. Ky Këshill funksionoi pa transparencë për publikun mbi agjendën e diskutimeve, pa publikimin e procesverbaleve të takimeve dhe kontributeve të sjella për diskutim nga palët. Gjithashtu, ndryshe nga kërkesat paraprake[48], Këshilli nuk përfshiu ekspertizën ndërkombëtare të kërkuar si përshpejtues për gjetjen e dakordësisë. Veçanërisht mbetet i paqartë roli i ekspertizës së asistencës së përfaqësisë së OSBE-së në diskutimet e Këshillit.

Në anën tjetër, edhe institucioni i Kuvendit cedoi në procesin konsultativ për miratimin e akteve amenduese të kuadrit ligjor zgjedhor. Veçanërisht në procesin e amendimit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë[49] dhe Ligjit për Partitë Politike[50], procesi konsultativ vuajti nga shkelja e ligjit dhe fiktiviteti.

Amendimi i Kushtetutës ishte haptazi në kundërshtim me afatin jo më pak se 1 vit nga data e zg-

43 Ligji nr. 146/2020, datë 17.12.2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.

44 Ligji 148/2020, datë 17.12.2020, Kuvendi i Shqipërisë, "Për disa shtesa në ligjin nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë".

45 Për më shumë, shih Letrën e Hapur të KRIIK Albania "Dakordësia e arritur në Marrëveshjen e 5 Qershorit, si një moment i lidershipeve për të tejkaluar përvojën e derisotme", 16 qershor 2020.

46 Po aty.

47 Shih Konferencën për Shtyp të KRIIK Albania, 11 mars 2021: "Aktorët politikë dhe institucionalë të tregojnë gatishmërinë dhe vullnetin për të rritur integritetin e procesit zgjedhor për Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të 25 prillit 2021", .

48 Në një takim me gazetarët me datë 18.10.2019, kryetari i PD-së z. Basha shprehu rëndësinë e përfshirjes së ndërkombëtarëve në procesin e reformës "(...) Mekanizmi të përfshijë tre faktorë, opozitën e bashkuar, ata që kanë çelësat e qeverisjes dhe faktorin ndërkombëtar, jo si drejtues, por me ekspertizën [...] për të dëshmuar vullnetin e palëve për të çuar para procesin".

49 Procesi konsultativ i realizuar vuajti nga pjesëmarrja tejet e ulët e grupeve të interesit, si e aktorëve të shoqërisë civile, ashtu edhe ata të sferës universitare. Veçanërisht për sa i përket këtyre të fundit, në seancën e caktuar për pjesëmarrje u paraqit vetëm një përfaqësues nga bota akademike. Kjo është dëshmia shembullore e fiktivitetit të procesit, i përfunduar pa kurrfarë opinioni nga sfera akademike, pra nga ata që hartojnë doktrinën juridike apo janë gardianët e mendimit politiko-juridik. Gjithashtu, gjendja rëndohet edhe më shumë, kur pesha e mendimit akademik iu besua nga Kuvendi vetëm katër konstitucionalistëve të thirrur. Përpos asnjë dyshimi ndaj ekspertizës dhe vlerave të tyre individuale, nuk mund të mendohet që katër apo sado profesionistë të kontraktuar, të caktuar në mënyrë diskrecionale, të zëvendësojnë institucionet akademike.

50 Procesi, për sa u arrit të merrej informacion dhe të bëhej transparencë, vetëm u deklarua se ishte konsultuar në rreth të mbyllur vetëm me fare pak organizata. Ndërkohë KRIIK megjithëse në ndjekje të vazhdueshme të reformës zgjedhore nuk u vu në dijeni dhe as u ftua për të dhënë opinionin e tij, sikurse është operuar prej Kuvendit në disa procese të tjera të mëparshme.

jedhjeve për kryerjen e ndryshime të rëndësishme ligjore, të parashikuar nga Kodi i Praktikave të Mira për Çështjet Zgjedhore të Komisionit të Venecias, ndërkohë që edhe ekspertiza e përdorur nga konstitucionalistët e thirrur lë vend për dyshime mbi objektivitetin dhe paanshmërinë e trajtimit teorik dhe praktik të bërë prej tyre mbi procesin dhe përmbajtjen e amendimeve[51].

Megjithëse ishte në dispozicion një kohë e mjaftueshme, dhe në kushtet kur ishte më se e qartë se zgjedhjet e 2021 do të organizoheshin në kushtet e një emergjence shëndetësore globale, si pasojë e COVID-19, ligjvënësit dhe as qeveria nuk ndërmorën asnjë nismë specifike për marrjen e masave të domosdoshme për të garantuar një proces zgjedhor sa më normal në kushtet e pandemisë, i cili të siguronte përveç lirive dhe të drejtave kushtetuese, edhe mbrojtjen e shëndetit publik në radhë të parë.

Jo vetëm kaq, por pandemia dhe efektet e saj vlerësohet se u përdorën prej maxhorancës për avantazhim politik, sikurse ishte, ndër të tjera, pengimi i shtetasve shqiptarë që jetojnë në vendet fqinje (veçanërisht në Greqi) të ushtronin të drejtën e votës. Në mbledhjen e datës 19 prill 2021, Komiteti Teknik i Ekspertëve vendosi se të gjithë individët që hynin në Shqipëri nga Greqia apo Maqedonia e Veriut do të duhet të vetëizoloheshin për 14 ditë[52]. Vendimi, sikurse u bë me dije, nuk bazohej në rrezikshmëri të shtuar si pasojë e rritjes së shifrave të infektimeve në këto vende[53], por në rrezikshmërinë që mund të vinte nga personat që do të hynin në vend e që priteshin të ishin në shifra të larta si rrjedhojë e Pashkëve Ortodokse, të cilat festoheshin një javë më vonë pas ditës së zgjedhjeve, më datë 2 maj 2021.

Ky vendim i Komitetit Teknik përbën një cënim të së drejtës së zgjedhësve për të votuar dhe nuk justifikohet me argumentin e dhënë, duke qenë se do të ishte më e arsyeshme që afati i hyrjes në fuqi të vendimit për kufizimin e hyrjeve të mundshme për shkak të Pashkëve të vendosej pas ditës së zgjedhjeve.

Institucionet e shëndetit publik (Ministria e Shëndetësisë dhe Komiteti *Ad Hoc* Teknik i Ekspertëve) u treguan shumë të ngadaltë, të pamotivuar dhe joserioz në adresimin e rregullave që duhet të ndiqeshin lidhur me mbajtjen e zgjedhjeve gjatë pandemisë. Gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, pati dy mbledhje të Komitetit Teknik të Ekspertëve. Në të dyja mbledhjet, kufizimet e lëvizjes së shtetasve në fashat orare 22:00 me 06:00 u lanë në fuqi, ndërkohë që në asnjë prej vendimeve të tyre nuk parashikohej krijimi i lehtësive lidhur me lëvizjen e komisionerëve apo vëzhguesve të angazhuar për mbarëvajtjen e procesit zgjedhor[54].

Gjithashtu, Urdhri i Ministrisë së Shëndetësisë që kufizonte grumbullimet e më tepër se dhjetë personave vijoi të ishte në fuqi si në ditën e zgjedhjeve, ashtu edhe gjatë procesit të numërimit. Urdhri u shkel masivisht gjatë procesit të votimit dhe numërimit, duke qenë se ishte objektivisht i pamundur që ai të zbatohej[55], pasi nuk ishte e mundur që në një qendër votimi, e aq më pak në një vend numërimi të votave të kishte më pak se dhjetë persona.

51 Në gjykimin e KRIIK procesi jo vetëm ishte fiktiv e me shkelje jo të vogla ligjore, por edhe procesi konsultues sikurse u realizua dhe u mbrojt nga katër ekspertët konstitucionalistë, linte vend për dyshime të forta për një trajtim jo të paanshëm të tyre në mbrojtje të linjës së maxhorancës socialiste. Këtë dyshim e përforcon edhe ecuria e mëpasshme e karrierës së këtyre katër ekspertëve konstitucionalistë, të thirrur në cilësinë e ekspertëve të pavarur e të paanshëm. Konkretisht: (1) znj. Elira Kokona, zëvendëssekretare e Përgjithshme e Këshillit të Ministrave; (2) z. Ilir Rusmajli, emërohet në tetor 2020, me mbështetjen e maxhorancës, anëtar i Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve (KAS) në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për një mandat nëntëvjeçar; (3) znj. Adea Pirdeni prej shtatorit 2020 emërohet dhe shërben si Zëvendësministre e Drejtësisë; (4) z. Erind Mërkuri emërohet në nëntor 2020 si Anëtar i Komisionit Disiplinor i Përmbaruesve Gjyqësor Privatë me një mandat katërvjeçar.

52 Komiteti Teknik i Ekspertëve: "Rikthehen në klasa shkollat e mesme, karantinë dyjavore për personat që vijnë nga Maqedonia e Veriut dhe Greqia", 19 prill 2021.

53 Si Greqia, ashtu dhe Maqedonia e Veriut kishin rënie të vazhdueshme të rasteve të reja të infektuara duke nisur nga data 6 prill. Shih: https://ourworldindata.org/coronavirus#coronavirus-country-profiles.

54 Duke qenë se komisionerët apo vëzhguesit duhet të jenë në qendrat e votimit për hapjen e tyre në orën 6:00 dhe, me gjasë, procesi i mbylljes së qendrave të votimit dhe dorëzimi i materialeve zgjedhore nuk ka për të përfunduar në shumë raste përpara orës 22:00, të gjithë individët e angazhuar në administrimin apo vëzhgimin e procesit zgjedhor do të jenë në shkelje të rregullave të vendosura. Mungesa e adresimit publik të çështjes dhe e transparencës nga ana e institucioneve për individët e angazhuar në proces mbetet një problem madhor, së paku si qasje joligjzbatuese.

55 Është e pamundur që në një Qendër Votimi dhe sidomos në një Vend të Numërimit të Votave, të ketë më pak se dhjetë persona të grumbulluar në të njëjtin moment.
Mjafton të sillet në vëmendje se në çdo qendër votimi tetë veta është numri i anëtarëve të Komisionit së bashku me operatorin teknik, ndërkohë që brenda QV-së ishin akredituar për të qenë prezent edhe vëzhguesit politikë të secilit prej subjekteve zgjedhore dhe vëzhguesit e pavarur vendas apo të huaj.
Më e rënduar paraqitet situata në ambientet e mbyllura të Vendeve të Numërimit të Votave ku mesatarisht 28 vetë përbënin vetëm grupin e anëtarëve të Komisionit Zonal të Administrimit Zgjedhor dhe të Grupeve të Numërimit të Votave, pa konsideruar këtu numrin e konsiderueshëm të vëzhguesve, medias etj.

I vetmi akt i prodhuar nga autoritetet shëndetësore në lidhje me mbajtjen e procesit zgjedhor në kushtet e pandemisë ishte një protokoll i miratuar nga Instituti i Shëndetit Publik, i bërë publik në media vetëm rreth datës 20 prill, ndërkohë që ai mban datën 13 prill, si datë të miratimit të tij. Protokolli përmbante disa udhëzime për mbajtjen e procesit zgjedhor, por në vetvete ishte jorealist dhe injoronte fakte bazë të zhvillimit të procesit zgjedhor[56], duke e bërë atë joserioz. Një ditë përpara ditës së zgjedhjeve, Komisioneri nxori një udhëzim minimalist në lidhje me mbrojtjen e shëndetit publik ku i referohej protokollit të miratuar nga ISHP-ja dhe kërkonte vetëdeklarimin mbi shqetësime shëndetësore nga ana e komisionerëve dhe vëzhguesve[57], duke i dhënë legjitimitetin e duhur aktit. Por sërish, në përmbajtje ai mbeti një akt i paplotë, teorik, i vonuar dhe me asnjë efekt në disa rregullime të tij, për më tepër, që edhe ky udhëzim i referohej vetëm ditës së votimit dhe jo procesit të numërimit të votave.

III.2. SISTEMI ZGJEDHOR

Kuvendi i Shqipërisë përbëhet nga 140 deputetë, të cilët zgjidhen nëpërmjet një sistemi proporcional rajonal në 12 zona zgjedhore, kufijtë e të cilave përkojnë me kufijtë administrativë të qarqeve. Mandatet për çdo zonë zgjedhore përcaktohen bazuar në numrin e shtetasve dhe se çdo mandat duhet të përfaqësojë një numër afërsisht të barabartë shtetasish[58].
Komisioni Rregullator përcaktoi ndarjen e mandateve për çdo zonë zgjedhore për Zgjedhjet e 25 prillit 2021 në dhjetor 2020[59], bazuar në numrin e shtetasve rezidentë në qarqet e ndryshme në datë 27 nëntor 2020. Qarqet Dibër dhe Gjirokastër humbën nga një mandat secili krahasuar me zgjedhjet e vitit 2017[60], mandate, të cilat u shtuan në Tiranë. Dy qarqe devijojnë dukshëm nga mesatarja e numrit të shtetasve për mandat në Zgjedhjet e 25 prillit, Gjirokastra dhe Kukësi, respektivisht me 13.7% dhe 13%; megjithatë ky devijim pranohet të jetë në përputhje me praktikat e mira për zgjedhjet[61].
Praktikat e mira, sidoqoftë, pranojnë edhe të tjera mënyra për përcaktimin e mandateve për zonë zgjedhore, si bazuar në numrin e zgjedhësve në listë, të zgjedhësve që aktualisht votojnë[62], apo edhe një kombinim të këtyre metodave. Analiza e numrit të mandateve bazuar në numrin e zgjedhësve në listë disfavorizon dukshëm zgjedhësit e Gjirokastrës nga pikëpamja e përfaqësimit, pasi kjo zonë zgjedhore devijon me 20% nga mesatarja kombëtare (një mandat përfaqëson rreth 31.000 zgjedhës, nga 25 634 zgjedhës / mandat që është mesatarja kombëtare). Akoma më problematike paraqitet situata nëse numri i mandateve përllogaritet bazuar në numrin e zgjedhësve që efektivisht kanë votuar specifikisht në këto zgjedhje. Në atë rast rezultojnë pesë nga 12 zonat zgjedhore që devijojnë me më shumë se 10% nga mesatarja, dy prej të cilave me më shumë se 15%. Ky model sjell një favorizim të fortë të zgjedhësve në Vlorë dhe Shkodër, të cilët janë të mbipërfaqësuar dukshëm, ndërkohë që disfavorizohen Dibra, Kukësi dhe Tirana[63].
Bazuar në sa më sipër rezulton se, pavarësisht se numri i mandateve për zonë zgjedhore është në linjë me praktikat e mira bazuar në numrin e shtetasve, nëse konsiderohet numri i zgjedhësve apo pjesëmarrja efektive në votime, dëmtohet parimi i barazisë së votës, dhe zgjedhësit në zona të ndryshme zgjedhore kanë nivel të ndryshëm përfaqësimi në Kuvend. Kjo përforcohet akoma më shumë duke patur në konsideratë numrin e lartë të shtetasve që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, të cilët përllogariten në numër për shpërndarjen e mandateve, por që *de-facto*

56 P.sh., protokolli vendos disa kërkesa për mjediset në të cilat duhet të vendosen qendrat e votimit, ndërkohë që këto të fundit janë përcaktuar përfundimisht prej datës 15 mars, 40 ditë përpara datës së zgjedhjeve.

57 Udhëzim nr. 11, datë 24 prill 2021, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, "Për zbatimin e masave anti-Covid 19 gjatë ditës së votimeve për Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021".

58 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 75, "Kriteret dhe procedura për caktimin e numrit të mandateve", pika 1.

59 Vendimi nr. 7, datë 11 dhjetor 2020, Komisioni Rregullator, "Për caktimin e numrit të mandateve për çdo zonë zgjedhore të Zgjedhjeve për Kuvend të datës 25 prill 2021".

60 Vendimi nr. 173, datë 3 dhjetor 2016, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, "Për caktimin e numrit të mandateve për çdo zonë zgjedhore të Zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2017".

61 Kodi i Praktikave të Mira në Çështje Zgjedhore, opinioni nr. 190/2002, raport shpjegues, pika 2.2. "Fuqia e barabartë e votës", 15, përcakton se numri i mandateve për zonë zgjedhore rrallë duhet të devijojë më shumë se 10% nga mesatarja dhe në asnjë rast më shumë se 15% nga mesatarja.

62 Po aty.

63 Shih Shtojcën B, Ndarja e mandateve sipas zonave zgjedhore.

nuk arrijnë të votojnë dot, pasi nuk iu sigurohet kjo mundësi në vendet e tyre të vendbanimit.
Vlerësohet se mund të konsiderohet një formulë e cila të jetë më e drejtë në ndarjen e mandateve mes zonave zgjedhore dhe të garantojë barazinë e votës. Një model i bazuar në numrin e shtetasve apo të zgjedhësve, por i korrektuar bazuar në numrin e zgjedhësve që aktualisht kanë votuar në një numër zgjedhjesh të mëparshme do të ishte më i drejtë, veçanërisht duke mbajtur në konsideratë se zona të caktuara të vendit kanë lëvizje demografike të ndryshme, qoftë me drejtim brenda apo jashtë vendit.
Partitë politike që regjistrohen si subjekte zgjedhore duhet të paraqesin lista kandidatësh për të gjitha zonat zgjedhore. Mandatet mes konkurrentëve zgjedhorë alokohen sipas formulës së d'Hondt[64]. Ndryshimet e Kodit Zgjedhor të tetorit të vitit 2021 eliminuan mundësinë e partive politike për të konkurruar në koalicione parazgjedhore[65].
Vetëm subjektet zgjedhore që e tejkalojnë pragun prej 1% të votave të vlefshme të fituara në rang vendi përfitojnë nga shpërndarja e mandateve, çka, siç pritej, ishte një barrierë e pakapërcyeshme për kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, veçanërisht ata që kandidonin në zona zgjedhore me numër më të ulët zgjedhësish[66].
Kodi Zgjedhor duhet të adresojë pragun ligjor për kandidatët e pavarur, me qëllim që të krijohen mundësi reale që të marrin pjesë si konkurrentë elektoralë.
Formula e alokimit të mandateve u jep përparësi partive me më shumë vota ndaj atyre me më pak vota, përveçse nëse këto të fundit janë të përqendruara në pak zona zgjedhore, në rastin kur vendi është i ndarë në disa të tilla. Qartazi kjo ndodhi edhe në zgjedhjet e 25 prillit, ku dy partitë me numër më të ulët votash, Lëvizja Socialiste për Integrim dhe Partia Socialdemokrate, kanë një raport negativ mes votave dhe mandateve. LSI-ja, me 6,8% të votave në rang vendi mori vetëm 2,9% të mandateve në Kuvend[67]. Ndërkohë, Partia Socialdemokrate, e cila ishte subjekti zgjedhor i katërt për numër votash, pati një raport thuajse të përsosur midis votave dhe mandateve (2,1% të mandateve me 2,2% të votave[68]), por sërish një raport negativ. Votat e PSD-së ishin të përqendruara në dy zonat zgjedhore në të cilat mori edhe mandatet (Tiranë dhe Shkodër), me 83,7% të votave të marra vetëm në këto dy qarqe; ndërkohë që LSI-ja kishte një shpërndarje shumë më homogjene midis zonave zgjedhore[69], çka shpjegon diferencën e konsiderueshme ndërmjet këtyre dy partive. Të dyja partitë me më shumë vota (PD dhe PS), në të kundërt, patën një raport pozitiv mes votave dhe mandateve, konkretisht, PS-ja mori 52,9% të mandateve me 48,7% të votave[70], ndërsa PD-ja 42,1% të mandateve me 39,4% të votave[71].
Metoda e d'Hondt-it për alokimin e mandateve dhe pragu ligjor prej 1% sjellin një numër votash që nuk prodhojnë mandate. Në total, në të gjithë vendin 92,1% e votave janë të përfaqësuara (kanë prodhuar mandat) dhe 7,9% të votave nuk kanë prodhuar mandate. Problematike mbetet diferenca ndërmjet zonave zgjedhore (qarqeve) në numrin e votave që nuk kanë prodhuar mandate. Qarqet me përqindjen më të lartë të votave që nuk kanë prodhuar mandat janë Gjirokastra, me 28,2% dhe Dibra me 24,8%. Ndërkohë, Tirana dhe Fieri janë qarqet që e kanë më të ulët numrin e votave që nuk kanë prodhuar mandat (përkatësisht 6,1% dhe 6,2%) (për pasqyrën e plotë të votave të papërfaqësuara sipas zonave zgjedhore dhe subjekteve zgjedhore, shih Shtojcën C).
Ndryshimet e njëanshme kushtetuese të korrikut të vitit 2020, të ndjekura nga amendimet e Kodit Zgjedhor të tetorit të po këtij vitit[72] sollën risinë e mundësisë për zgjedhësit që të zgjedhin, përveç subjektit zgjedhor edhe për një prej kandidatëve të këtij subjekti[73]. Megjithatë, nuk

64 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 162 "Përllogaritja e mandateve të subjekteve zgjedhore".

65 Kjo solli edhe ndryshimin e formulës së ndarjes së mandateve, e cila me Kodin e mëparshëm Zgjedhor përdorte formulën e Sainte-Laguw për ndarjen e mandateve brenda koalicioneve.

66 Kandidati i pavarur që mori përqindjen më të lartë të votave ishte Bojken Abazi (0,19%), i cili kandidonte në Tiranë ku është edhe përqendrimi më i lartë i popullsisë dhe zgjedhësve (rreth 29,5% e zgjedhësve që votuan në këto zgjedhje votuan në Tiranë).

67 Raporti 0.42.

68 Raporti 0.95.

69 Në të tria qarqet ku mori mandate LSI-ja kishte vetëm 46,8% të votave.

70 Raporti 1.09.

71 Raporti 1.07.

72 Ligji Nr. 118, datë 05.10.2020, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, 'Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar'".

73 Sistemi ishte me lista tërësisht të mbyllura dhe të fiksuara.

mund të thuhet se ky ndryshim solli lista të hapura, pavarësisht se zgjedhësve iu njoh e drejta e votës preferenciale. Kjo pasi, në mënyrë që një kandidat të rirenditej në listën e partisë përkatëse sipas votave preferenciale të grumbulluara duhej të merrte një numër votash së paku sa herësi që del nga pjesëtimi i numrit të votave të marra nga subjekti përkatës me numrin e mandateve që kishte fituar subjekti[74]. Vetëm 18 kandidatë arritën ta thyenin këtë herës, 13 nga PS-ja dhe 5 nga PD-AN-ja (shih Shtojcën E).
Kandidatet me numër votash preferenciale më të lartë se herësi zëvendësuan në listë kandidatët me numër më të ulët në renditjen paraprake, përveç rasteve kur kandidati që përfitonte nga rirenditja ishte nga gjinia më shumë e përfaqësuar dhe kandidati që do të zëvendësohej nga gjinia më pak e përfaqësuar, me ç'rast zëvendësohej kandidati që vinte menjëherë sipër tij në listë. Efektet e kësaj metode për rirenditje ishin thuajse nul, vetëm tre kandidatë përfituan nga rirenditja pasi nuk ishin tanimë në listën fituese të partisë përkatëse, dy nga PS-ja dhe një nga PD-AN-ja. Ndërkohë, nëse nuk do të kishte kushte për rirenditjen e kandidatëve dhe listat do të ishin totalisht të hapura, 24 prej të mandatuarve aktualë (17,1%)[75] nuk do të ishin deputetë të Kuvendit të ardhshëm, por do të zëvendësoheshin nga kandidatë me më shumë vota (shih "Shtojcën F", kandidatë që nuk do të ishin mandatuar nëse listat do të ishin totalisht të hapura dhe kush i zëvendësonte (renditja sipas subjekteve zgjedhore).
Pozitivisht, kandidatët në listën jofituese rirenditen sipas numrit të votave parapëlqyese dhe, si rrjedhim, në rast të zëvendësimit të deputetëve që lënë mandatin, kandidati në radhë që merr mandatin është kandidati që ka marrë një numër më të lartë votash parapëlqyese dhe jo kandidati i renditur më lart nga partia përkatëse.
Pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese, pritet që alokimi i mandateve brenda listave të partive të rishikohet nga Kuvendi i ri. Nëse me ndryshimet ligjore të ardhshme do të ruhet votimi preferencial, do të duhet që alokimi i mandateve të pasqyrojë realisht preferencat e votuesve[76], pa barriera fiktive ligjore që dëmtojnë përfaqësimin.

IV. ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE

Administrata zgjedhore përbëhet nga tri nivele, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), i cili është niveli i parë përgjegjës për organizimin, administrimin dhe mbikëqyrjen e procesit; Komisionet Zonale të Administrimit Zgjedhor (KZAZ), të cilat janë komisione që ngrihen dhe funksionojnë tre muaj para ditës së zgjedhjeve deri në përfundim të procesit të numërimit dhe që janë përgjegjëse për organizimin e procesit në nivel zone administrimi zgjedhor; si dhe Komisionet e Qendrave të Votimit (KQV), të cilat administrojnë procesin e votimit në ditën e zgjedhjeve në qendrat e votimit të ngritura. Numërimi i votave është i centralizuar, votat numërohen nga Grupet e Numërimit të Votave (GNV), në Vendet e Numërimit të Votave (VNV), nën mbikëqyrjen e KZAZ-ve. Për zgjedhjet e 25 prillit 2021 u ngritën 92 Zona të Administrimit Zgjedhor (ZAZ) dhe 5 199 Qendra Votimi (QV).
Të gjitha hallkat administrative të organizimit të procesit zgjedhor, kanë në përbërje anëtarë të propozuar prej partive politike, duke pasur gjithmonë në konsideratë baraspeshën e përfaqësimit politik në Kuvendin e Shqipërisë. Përjashtim bën vetëm KQZ-ja, trupat drejtuese të së cilës zgjidhen nëpërmjet një procedure, e cila, të paktën *de jure* nuk është e kushtëzuar drejtpërdrejt nga propozimet e partive politike.
Të gjitha komisionet e sipërpërmendura, pavarësisht mënyrës së formimit dhe kohëzgjatjes së funksionimit të tyre, duhet të përmbushin i përmbushin funksionet e tyre, në përputhje me ligjin, në mënyrë të paanshme dhe transparente[77].

74 Në çdo rast, dispozita përcakton se herësi nuk mund të jetë më shumë se 10 000. Për herësit, sipas zonave zgjedhore dhe subjekteve zgjedhore, shih Shtojcën D.

75 Dymbëdhjetë nga PD-AN-ja, tetë nga PS-ja, dy nga LSI-ja dhe dy nga PSD-ja.

76 Gjatë këtyre zgjedhjeve rezultoi se interesi i zgjedhësve për kandidatët individualë, përveçse për partinë politike, është i lartë (mbi 70%), veçanërisht tek votuesit e partive që kanë fituar mandate në Kuvend. Për më shumë shih Shtojcën G "Përqindja e votave që kanë shprehur një preferencë të vlefshme për kandidatë".

77 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 3, "Parime të përgjithshme", pika 6.

IV.1. KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE (KQZ)

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është institucioni përgjegjës për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve dhe referendumeve, i cili drejton dhe mbikëqyr veprimtarinë e administratës zgjedhore, monitoron veprimtarinë e subjekteve zgjedhore, organeve dhe institucioneve shtetërore dhe të medias në raport me zgjedhjet, si dhe zgjidh në rrugë administrative kërkesat apo ankesat që kanë lidhje me procesin zgjedhor[78].
Pas amendimeve ligjore[79], të cilat reflektuan Marrëveshjen politike të datës 5 Qershor 2020, institucioni i KQZ-së u rimodelua në një institucion me strukturë drejtuese trilaterale: Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve (Komisioneri); Komisioni Rregullator (Rregullatori), i cili përbëhet nga 5 anëtarë dhe Komisioni i Ankesave dhe Sanksioneve (KAS), i përbërë nga pesë anëtarë. Vlen të theksohet qasja e vazhdueshme e vullnetit të dakordësuar e të ngushtë politik prej të dy partive më të mëdha për zhveshjen e KQZ-së nga kompetencat nga një reformë zgjedhore në tjetrën, nga institucioni "organ i përhershëm që përgatit, mbikëqyr, drejton dhe verifikon të gjitha aspektet që kanë të bëjnë me zgjedhjet" sikurse u parashikua në Kushtetutën e miratuar me referendum popullor në vitin 1998, në një "institucion shtetëror i ngarkuar për administrimin e zgjedhjeve, në përputhje me rregullat e përcaktuara në [...] Kod[80]", sikurse parashikohet aktualisht. Madje, me amendimet e njëanshme të ndërmarra nga maxhoranca më 5 Tetor 2020, u hoq edhe togfjalëshi që e përcaktonte si "organi më i lartë shtetëror i përhershëm".
Pavarësisht se riformatimi i KQZ-së duhet të ishte një hap drejt krijimit të një institucioni të pavarur, në reflektim edhe të frymës së marrëveshjes politike të 5 Qershorit 2020, KRIIK vëren se influenca dhe përkatësia politike ishte e pranishme në sjelljen, dhe shpesh edhe në votimin e anëtarësisë së Rregullatorit dhe KAS-it. Anëtarët e Komisionit Rregullator, pavarësisht vendimmarrjes me konsensus për çdo vendim të miratuar përpara ditës së zgjedhjeve, reflektuan edhe sjellje qartazi të afiluara politikisht në diskutimet e tyre përgjatë mbledhjeve publike[81].
Ndërkohë, akoma më mbizotëruese ishte kjo sjellje në KAS, ku gati në të gjitha çështjet e trajtuara, si para[82] ashtu edhe pas ditës së zgjedhjeve në ankimimet e rezultateve zgjedhore dhe në trajtimin e çështjeve të tjera, u vërejt një vendimmarrje e anshme politike, shpesh jo korrekte e ekstraligjore, dhe më një diskrecion haptazi në favor të maxhorancës në pushtet.
Përgjatë funksionimit të vet, tre trupat drejtuese të KQZ-së reflektuan një sjellje që nuk ishte ajo e një institucioni të vetëm, por e tri të tillave, të ndara funksionalisht e thuajse totalisht të pavaruara nga njëra-tjetra.
Përpilimi dhe miratimi i "Planit Orientues të Veprimeve të KQZ-së" në funksion të mirëorganizimit, administrimit dhe kontrollit të procesit zgjedhor, ka qenë një praktikë pozitive e ndërtuar mbi bazën e një akti të miratuar në vazhdimësi përgjatë proceseve të mëparshme zgjedhore duke filluar prej vitit 2005. Miratimi i këtij plani orientues veprimesh përbënte një dokument bazë, veçanërisht për administratën dhe veprimtarinë e KQZ-së, në përputhje me përcaktimet ligjore. Për këtë proces zgjedhor, ky plan nuk u hartua.
Në gjykimin e KRIIK, pavarësisht se në ecurinë e proceseve zgjedhore të mëparshme nuk është konstatuar një zbatim i përpiktë i këtij plani, miratimi i një akti të tillë i vjen në ndihmë organizimit më të mirë të punës në përputhje me detyrimet dhe afatet e parashikuara ligjore. Nga ana tjetër, ajo përbën një bazë më të përmbledhur detyrash ligjore duke nxitur vetë administratën dhe bashkërenduar më mirë hapat me aktorët e tjerë të përfshirë në proces, duke rritur ndër të tjera edhe më tej transparencën mbi veprimtarinë e institucionit dhe tërë procesit zgjedhor.

78 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 12, "Përbërja dhe funksionimi i KQZ-së", pika 1.

79 Ligj nr. 101/2020 datë 23.7.2020 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 019, datë 29.12.2008, i ndryshuar", Fletore Zyrtare Nr. 143, datë 4 gusht 2020.

80 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 2, "Përkufizime" pika 7.

81 Më e fundit ishte mbledhja e fundit e Rregullatorit për miratimin e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve, ku dy prej anëtarëve, përkatësisht ata të propozuar nga opozita, i cilësuan zgjedhjet të shoqëruara me një sërë problematikash të rënda, referuar të cilave vendosën të votonin kundër projekt-aktit. Ndërkohë, tre anëtarët e tjerë të këtij komisioni, përkatësisht ata të propozuar nga maxhoranca, i cilësuan zgjedhjet e 25 prillit 2021 si procesi më i mirë i realizuar ndonjëherë në vend, duke e votuar pro dhe miratuar projektaktin.

82 Konkretisht në çështjet e shqyrtuara mbi përdorimin e burimeve shtetërore dhe të miratimit të fletës së votimit.

IV.1.1. FUNKSIONET E ORGANEVE DREJTUESE TË KQZ-së DHE PËRZGJEDHJA E ANËTARËSISË SË TYRE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve (KSHZ) është organ monokratik që ushtron kompetencat ekzekutive, drejton administratën e KQZ-së dhe përfaqëson KQZ-në në marrëdhëniet me të tretët. Komisioneri ka një mandat shtatëvjeçar, të përtëritshëm.
Nënkomisioneri, i cili është përgjegjës dhe drejton punën për zbatimin e projektit të identifikimit elektronik të votuesve, ka kompetenca të barabarta me Komisionerin për përzgjedhjen, monitorimin dhe zbatimin e teknologjisë për identifikimin elektronik të zgjedhësve, si dhe për përzgjedhjen, rekrutimin dhe trajnimin e zyrtarëve zgjedhorë. Mandati i Nënkomisionerit është katërvjeçar.
Komisioni Rregullator (Rregullatori), funksionon me kohë të pjesshme, përbëhet nga pesë anëtarë, ku njëri prej tyre ushtron detyrën e Kryetarit, dhe është organi kompetent për miratimin e akteve me karakter normativ në fushën e zgjedhjeve dhe vendosjen e rregullave për zgjedhjet. Mandati i anëtarëve të Rregullatorit është pesëvjeçar.
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS), funksionon me kohë të pjesshme, përbëhet nga 5 anëtarë dhe është organi kompetent për shqyrtimin e ankimimeve administrative dhe për vendosjen e sanksioneve për shkelje të ligjit zgjedhor. Mandati i anëtarëve të KAS-it është nëntëvjeçar. Pas katër vitesh nga zgjedhja për herë të parë e trupës, pra në tetor 2024, tre anëtarëve të cilët do të caktohen me short iu mbaron mandati. Anëtarët e rinj zgjidhen me një mandat nëntë vjeçar. Shorti për caktimin e tre anëtarëve do të hidhet jo më vonë se një muaj përpara mbarimit të mandatit katër vjeçar. Anëtarët që lirohen nga detyra kanë të drejtë të rikandidojnë[83].
Komisioneri, Nënkomisioneri, anëtarët e Komisionit Rregullator dhe të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve zgjidhen nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, duke ngritur një Komision të Posaçëm Parlamentar për të realizuar procesin e intervistimit dhe përzgjedhjes paraprake të tyre. Kuvendi e shpalli thirrjen për aplikime për anëtarë të tri organeve drejtuese të KQZ-së[84] më 29 gusht 2020. Në përmbyllje të procesit të aplikimeve[85], pranë Kuvendit u paraqitën 26 kandidatura për pozicionin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve; 15 kandidatura për atë të Nënkomisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve; 47 kandidatura për anëtarë të Komisionit Rregullator dhe 48 kandidatura për anëtarë të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve[86]. Në seancën plenare të datës 17 shtator 2020 Kuvendi i Shqipërisë ngriti[87] Komisionin e Posaçëm Parlamentar, i cili u ngarkua për shqyrtimin, intervistimin dhe vlerësimin e kandidaturave.
Në përbërjen e Komisionit u sigurua pjesëmarrje e shumicës dhe pakicës parlamentare, duke siguruar gjithashtu, në frymën e Marrëveshjes së 5 Qershorit 2020, përfaqësimin e opozitës jashtëparlamentare[88]. Pas zhvillimit të seancave dëgjimore, në mbledhjen e datës 2 tetor 2020 Komisioni mori vendim[89] në lidhje me kandidaturat që iu propozuan Parlamentit për shqyrtim dhe miratim[90]. Procesi i përzgjedhjes nuk ndoqi frymën e parashikuar në Kod për një proces të mirëfilltë përzgjedhjeje e intervistimi, e më pas vlerësimin mbi pikëzimin e bërë ndaj çdo kandidature. Madje, parashikimi ligjor i kritereve dhe limitimi i kandidatëve kryesisht nga individë që vijnë nga radhët

83 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 183, "Formimi kalimtar i organeve drejtuese dhe i administratës zgjedhore", pika 7.

84 Kuvendi i Shqipërisë, datë 29.08.2020, Shpallje për hapjen e procedurës së aplikimit për vende vakante në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

85 Datë 18 shtator 2020.

86 Një pjesë e kandidatëve paraqitën aplikime për më shumë se një pozicion. Në total aplikuan 70 individë.

87 Vendim Nr. 50/2020 "Për krijimin dhe përbërjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për shqyrtimin dhe përzgjedhjen e kandidaturave për organet drejtuese të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve: Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Nënkomisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisionit Rregullator dhe Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve".

88 Sipas përcaktimeve të nenit 183 dhe pikës IV të Vendimit nr.50/2020, datë 17.09.2020 të Kuvendit ..."Përzgjedhja e kandidaturave sipas ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, bëhet në prani të përfaqësuesit të autorizuar, me cilësinë e të dërguarit të posaçëm, të partive parlamentare të dala nga zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2017, që kanë humbur përfaqësimin parlamentar". Sipas këtij përcaktimi në mbledhjet e këtij Komisioni ka qenë i pranishëm si përfaqësues i autorizuar z. Oerd Bylykbashi.

89 Vendim Nr. 2. datë 2.10.2020 "Për përzgjedhjen e kandidaturave për organet drejtuese të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve: Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Nënkomisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisionit Rregullator dhe Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve"

90 Vendim Nr. 56/2020 datë 5.10.2020, Kuvendi zgjodhi Komisioner Shtetëror të Zgjedhjeve z. Ilirjan Celibashi. 57 Procesverbalet e Komisionit të Posaçëm Parlamentar mbi përzgjedhjen e kandidaturave të datës 28 shtator, 29 shtator dhe 30 shtator 2020.

e ish-funksionarëve politikë apo të kabineteve, ish-nëpunësve të nivelit të lartë drejtues, ose të ish-drejtuesve të organizatave jofitimprurëse me veprimtari në fushën e zgjedhjeve dhe të të drejtave të njeriut, dha perceptimin se përzgjedhja do të kryhej mbi preferenca politike.
Në gjykimin e KRIIK, përfshirja e ish-funksionarëve politikë, apo edhe e ish-funksionarëve të kabineteve, në radhën e individëve që lejohen të kandidojnë, nuk është në frymën e aspiratës për një administratë zgjedhore të paanshme dhe të pavarur nga politika dhe lë hapësirë për përzgjedhjen e kandidaturave politike. Pavarësisht se Kodi Zgjedhor ka përfshirë garanci, në dukje, në lidhje me mundësinë e eliminimit të kandidatëve politikë, këto garanci nuk janë të mjaftueshme për sa kohë që nuk ka një procedurë të qartë dhe të detajuar të mekanizmit përzgjedhës, të cilit Komisioni i Posaçëm Parlamentar duhet t'i bindet. Për sa kohë që kjo procedurë të jetë e parregulluar qartë, siç ndodhi në rastin e përzgjedhjes së kandidatëve në tetor të vitit 2020, mbetet e hapur mundësia që vullneti partiak të mbizotërojë mbi frymën e ligjit dhe gërma e ligjit të keqpërdoret, dhe, në analizë të fundit, në dëmtimin e pariparueshëm të aspiratës së pavarësisë dhe paanësisë së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve[91], sikurse u evidentua edhe në këtë proces zgjedhor.

IV.1.2. AKTIVITETI I KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

IV.1.2.1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Komisioneri i administroi zgjedhjet përgjithësisht në mënyrë eficiente dhe transparente.
Vendimmarrja e Komisionerit është realizuar në seanca publike dhe jo publike. Në funksion të zgjedhjeve të datës 25 prill 2021[92] Komisioneri ka miratuar 402 vendime[93] dhe 16 udhëzime[94], në seanca publike dhe jo të tilla. 34 vendime të Komisionerit[95] janë ankimuar në KAS, i cili ka vendosur ndryshimin e plotë apo të pjesshëm për 17 prej tyre[96]. Pavarësisht se marrja e vendimeve prej Komisionerit në seanca jopublike është në përputhje me kuadrin ligjor, KRIIK vlerëson se për një transparencë të rritur të procesit, do të kishte qenë me vend që të gjitha vendimet e Komisionerit të ishin marrë në seanca të hapura publike.
Në tërësi, vendimmarrja e KQZ-së ishte transparente dhe rregullisht e publikuar në faqen e institucionit. Vlerësohet si hap pozitiv në funksion të transparencës publikimi i rregullt dhe në kohë në faqen e internetit edhe i materialeve paraprake të mbledhjeve, një element që ka patur problematika në proceset e shkuara zgjedhore.
Për më tepër, përgjatë gjithë përgatitjes së procesit, Komisioneri ka treguar në vazhdimësi një qasje të hapur dhe bashkëpunuese ndaj aktorëve të përfshirë në proces, medias dhe organizatave të shoqërisë civile[97].

Vlerësohen pozitivisht deklaratat publike të herë pas hershme të Komisionerit, edhe në takimet e hapura me gazetarët, nëpërmjet të cilave bëhej transparencë dhe informohej në tërësi opinioni

91 Aspirata për një administrim zgjedhor të pavarur është diskutuar në vazhdimësi gjatë reformave zgjedhore të viteve të fundit. Sipas formulës së mëparshme të kompozimit të anëtarësisë së Komisionit, kryetari do të duhej të ishte kandidat i pavarur. Kjo aspiratë, e cila asnjëherë nuk arriti të përmbushej plotësisht, u shkatërrua përfundimisht në maj të vitit 2017, kur si rrjedhojë e një marrëveshjeje politike mes liderëve të maxhorancës dhe opozitës, z. Rama dhe z. Basha, kryetari i atëhershëm i KQZ-së, z. Denar Biba, i zgjedhur si i pavarur nga Kuvendi vetëm pak muaj përpara zgjedhjeve të vitit 2017, ndërroi vendin me nënkryetarin z. Klement Zguri, i cili ishte zgjedhur në KQZ i propozuar nga partia e dytë e pakicës parlamentare, Partia Republikane. Kjo rokadë e kryetarit dhe nënkryetarit ishte pranimi, *de jure*, i asaj çka, *de facto* ishte bërë e ditur në atë kohë, që kryetari i KQZ-së ishte një përfaqësues i maxhorancës, nën petkun e kandidatit të pavarur.

92 Përpos aktivitetit në lidhje me Zgjedhjet Parlamentare të 25 prillit, përgjatë periudhës së mbuluar në këtë raport, Komisioneri ka marrë edhe një numër vendimesh në lidhje me ligjin 138/2015 (Ligji i Dekriminalizimit). Në funksion të këtij ligji, Komisioneri ka marrë 90 vendime, nëpërmjet të cilave janë plotësuar vakancat e njoftuara nga Këshillat Bashkiakë dhe Kuvendi i Shqipërisë, apo shqyrtuar rezultatet e verifikimit të përcjella në KQZ nga Prokuroria e Përgjithshme. Vendimet e tjera janë për çështje të ndryshme, si shpërndarja dhe auditimi i fondeve vjetore të partive politike, struktura buxhetore e vitit kalendarik, kërkesa nga OJF-të për nisma të ndryshme etj.

93 Nga të cilat, 15 vendime janë miratuar përgjatë muajve tetor-dhjetor 2020.

94 Nga të cilët, një udhëzim është miratuar përgjatë muajve tetor-dhjetor 2020.

95 Nga të cilat, dhjetë vendime lidhen me ankimimet për rezultatin e zgjedhjeve dhe shtatë vendime me sanksionet ndaj anëtarëve të disa KZAZ-ve, pra janë më të njëjtin objekt ankimimi.

96 Për më shumë shih Shtojcën M "Kërkesat ankimore".

97 Komisioneri ka mbajtur vazhdimisht takime konsultative me aktorët e shoqërisë civile, takime informuese me median, dhe ka treguar gatishmëri për bashkëpunim dhe komunikim me aktorët politikë garues në proces.

publik mbi ecurinë e procesit, dhe veçanërisht lidhur me thirrjet publike ndaj partive politike dhe jo vetëm, në respektim të ligjit dhe detyrave që kanë aktorët në procesin zgjedhor.
Një nga vendimet më të rëndësishme të marra nga Komisioneri ishte miratimi i përmbajtjes së fletës së votimit, pas shpalljes së moskompetencës nga Komisioni Rregullator[98].

Pavarësisht vonesës në miratimin e këtij vendimi, vlerësohet përpjekja dhe konsistenca e sjelljes së Komisionerit për të arritur një konsensus paraprak me partitë politike para miratimit të vendimit, dhe, më pas, vendimmarrja e drejtë[99] prej tij në përputhje të plotë me frymën dhe germën e Kushtetutës dhe të Kodit Zgjedhor.
Përpos aspekteve pozitive dhe të përmirësuara në aspektin e administrimit, jo vetëm nga Komisioneri por edhe administrata e KQZ-së, pati çështje për të cilat Komisioneri, në vlerësimin e KRIIK, duhet të kishte treguar një qëndrim më proaktiv, veçanërisht në lidhje me përmbushjen e funksioneve të veta në disa mekanizma të ndryshuar së fundmi të kuadrit ligjor që synonin adresimin e përdorimit të burimeve shtetërore për qëllime elektorale, sjelljen e mediave gjatë fushatës, apo monitorimin e aktiviteteve të fushatës zgjedhore, me synim forcimin e kontrollit mbi financimin e fushatës zgjedhore.
Lidhur me përdorimin e burimeve shtetërore, u vërejt një qëndrim pasiv i Komisionerit dhe administratës së KQZ-së, për problematikat e vërejtura në procesin e raportimit të aktiviteteve nga institucionet shtetërore në ndërfaqen e krijuar enkas për këtë çështje.

Qysh prej miratimit të vendimit[100] që detyronte këtë raportim, nga KQZ-ja nuk u ndërmor asnjë masë për mosraportimin në kohë, mungesën e raportimit, apo mungesën e detajeve në raportim prej institucioneve.
Raportimi i aktiviteteve të institucioneve shtetërore gjatë fushatës, në analizë të fundit, rezultoi joefikas në adresimin e keqpërdorimit të burimeve shtetërore apo ofiqit publik në fushatë.
Për sa u përket aspekteve të tjera që synonin parandalimin e përdorimit të burimeve shtetërore, si pasojë e denoncimeve të bëra në KQZ, Komisioneri mori vetëm katër[101] masa administrative me gjobë, dy prej të cilave[102] u shfuqizuan nga KAS-i. Gjithashtu, për një çështje tjetër pas konstatimit të shkeljes, Komisioneri vendosi[103] që sanksioni administrativ të vendoset nga KAS, i cili e rrëzoi[104] këtë kërkesë.
Monitorimi i mediave gjatë fushatës zgjedhore u krye nga Autoriteti i Mediave Audiovizive, i cili depozitoi raporte ditore dhe javore në KQZ, në të cilët evidentoheshin disa shkelje, për të cilat KQZ-ja duhet të ndërmerrte sanksione sipas ligjit. Komisioneri, mori në shqyrtim vetëm dy raporte javore të AMA-s gjatë fushatës dhe raportin përfundimtar të saj pas përfundimit të procesit të numërimit. Edhe pas shqyrtimit[105] të raportit përfundimtar, sanksioni[106] ishte për

98 Vendim nr. 12, datë 31.03. 2021, Komisioni Rregullator, "Për shpalljen e moskompetencës së Komisionit Rregullator për shqyrtimin e projektvendimit për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021".

99 Në vendimmarrjen e Komisionerit lidhur me këtë pjesë thelbësisht të rëndësishme të procesit u mor në konsideratë edhe rezultati i një sondazhi të zhvilluar në rrjetet sociale të KQZ-së.

100 Vendimi nr. 9 datë 24.12.2020, Komisioni Rregullator "Rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve".

101 Vendimi nr. 7, datë 14.01.2021, Komisioneri Shtetëror të Zgjedhjeve nëpërmjet të cilit u vendos sanksion administrativ me gjobë ndaj z. Arben Qalliu me detyrë Drejtor i Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Lushnjë.
Vendimi nr. 46, datë 09.02.2021 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nëpërmjet të cilit u vendos sanksion administrativ me gjobë ndaj z. Erion Veliaj me detyrë kryetar i Bashkisë Tiranë.
Vendimi nr. 234, datë 14.04.2021 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nëpërmjet të cilit u vendos sanksioni administrativ me gjobë ndaj z. Gentian Picari, kryetar i Bashkisë Vorë, në shumën 10 000 (dhjetë mijë) lekë.
Vendimi nr. 452 datë 21.09.2021 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nëpërmjet të cilit u vendos sanksion administrativ me gjobë ndaj Drejtorit të Shkollës Shëmri Kukës në shumën 5 000 (pesë mijë) lekë.

102 KAS-i rrëzoi masën administrative ndaj z. Qalliu me vendimin nr. 4, datë 22.01.2020. KAS-i rrëzoi masën administrative ndaj z. Veliaj me vendimin nr. 6, datë 16.02.2021.

103 Vendim nr. 467 datë 11.11.2021, Komisioneri Shtetëror të Zgjedhjeve nëpërmjet të cilit konstatoi shkelje nga administratori i Njësisë Administrative nr. 2 Tiranë, dhe t'i kërkojë KAS, vendosjen e sanksionit administrativ.

104 Vendim nr. 115 datë 21.12.2021 "Për shqyrtimin e kërkesës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 01, datë 17.12.2021 drejtuar Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, për vendosje sanksioni administrativ".

105 Vendimi nr. 370, datë 27.05.2021 Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve "Shqyrtimi i raportit të tabelave përmbledhëse të monitorimit të mbulimit të fushatës zgjedhore nga OSHMA-të për periudhën 26.03.2021 – 23.04.2021, si dhe respektimin e periudhës së heshtjes zgjedhore".

106 Komisioneri vendosi marrjen e masës administrative për RTSH-në, gjobë në vlerën 2 000 000 (dy milionë)

thyerjen e heshtjes zgjedhore, çka anashkaloi çdo shkelje tjetër të konstatuar nga AMA gjatë fushatës zgjedhore.
Reduktimi i rolit të KQZ-së vetëm tek publikimi periodik i raportimeve ditore pas depozitimit të tyre dhe mos shqyrtimi i tyre në një kohë më të shpejtë, e bëri kuadrin rregullator joefikas, duke dështuar të garantonte synimin primar të mekanizmit mbikëqyrës të medias, informimin e publikut në mënyrë të paanshme e objektive gjatë fushatës.

Periudha e shkurtër kohore e fushatës zgjedhore, mosshqyrtimi me shpejtësi dhe frekuencë më të shpeshtë i raporteve, solli mungesën e kompensimit me kohë televizive të subjekteve elektorale të nën përfaqësuara në media, e rrjedhimisht edhe një fushatë mediatike të njëanshme dhe të pabarabartë midis subjekteve zgjedhore garuese.
Publikimi i raporteve të monitorimit të fushatës në faqen e KQZ-së ka qenë thuajse inekzistent në përgjithësi dhe totalisht i munguar gjatë fushatës zgjedhore, çka ka sjellë transparencë të reduktuar, mbi një mekanizëm, i cili ishte joeficient qysh në ngjizjen e vet[107] .
Pas detyrimeve të përcaktuara me ndryshimet e Kodit Zgjedhor në korrik të vitit 2020, realizimi i akteve nënligjore për realizimin e garantimit të së drejtës së votës të emigrantëve iu ngarkua Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Pavarësisht se KQZ-ja tentoi ta realizonte këtë detyrim, duke nisur procesin me ngritjen e Grupit të Punës dhe duke pasur një komunikim të vazhdueshëm me DPGJC-në dhe forcat politike, konkludoi publikisht që ky proces nuk ishte i mundur të realizohej për shkak të mungesës së dakordësisë politike, çka në gjykimin e Komisionerit, ishte domosdoshmëri për realizimin e këtij projekti. Në çdo rast, koha në dispozicion e KQZ-së për realizimin e këtij procesi, duke mbajtur në konsideratë edhe gjithë pjesët e tjera të administrimit, ishte tejet e limituar. Mos përfshirja e votimit nga jashtë vendit në procedurat e zakonshme të votimit gjatë këtyre zgjedhjeve, hoqi mundësinë që në zgjedhjet e ardhshme ky votim të bëhej pjesë përbërëse automatikisht e procedurave të votimit, çka do të thotë se votimit nga jashtë vendit në mënyrë të plotë nuk mund të bëhet në zgjedhjet e ardhshme parlamentare.

IV.1.2.1.1. Shpërndarja e mandateve

Në datë 23 qershor, me Vendimet 406 deri 417[108], Komisioneri Shtetëror për Zgjedhjet vendosi shpërndarjen e mandateve nominale për kandidatët për Kuvendin e Shqipërisë, bazuar në rezultatin e zgjedhjeve.
Shpërndarja e mandateve hasi në problematika, si rrjedhojë e dorëheqjes nga mandati të Kryetarit të Partisë Socialdemokrate, Z. Tom Doshi, menjëherë pasi ditës së zgjedhjeve. Kryetari i PSD kryesonte listën e kandidatëve të këtij subjekti zgjedhor në dy zona zgjedhore të vendit, Tiranë dhe Shkodër. Pavarësisht se kuadri ligjor shqiptar nuk e parashikon dorëheqjen nga kandidimi, madje sanksionon se renditja e kandidatëve në listë nuk mund të ndryshohet më, pas momentit të regjistrimit të listës nga KQZ-ja[109], Komisioneri vendosi që të merrte në konsideratë letrën e dorëheqjes së dorëzuar në KQZ nga Z. Doshi dhe të mos e përfshinte këtë kandidat në shpërndarjen e mandateve[110]. Në arsyetimin për mosdhënien e mandatit Z. Doshi, Komisioneri nuk përmend bazën ligjore shqiptare, por Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat dhe Liritë Civile dhe Politike, dhe gjykoi se sipas kësaj Konvente nuk mund të detyrohet një individ të marrë mandatin.
KRIIK gjykon se arsyetimi i përdorur nga Komisioneri është në kapërcim të normave ligjore vendore dhe se përdorimi i Konventës për të Drejtat dhe Liritë Civile dhe Politike nuk mund të përdoret si argument në këtë rast. Neni 25 i Konventës sanksionon të drejtën e qytetarëve për të marrë pjesë në qeverisjen e vendit të vet, përfshi nëpërmjet të drejtës së kandidimit, Konventa nuk detajon të drejtën për të mos marrë pjesë. Nga ana tjetër, KRIIK vëren se, për shkak të amendimit ligjor të vitit të shkuar që u jep të drejtën kryetarëve të partive për të kandiduar në më shumë se një zonë zgjedhore Komisioneri, *de facto*, ishte në pamundësi për të

lekë, pasi RTSH 2 dhe RTSH Kukësi kishin thyer heshtjen zgjedhore.

107 Deri në datën 23 prill 2021 rezultonin të publikuara në faqen e internetit të KQZ-së 96 raporte monitorimi në total, të cilat mbulonin periudhën nga 1 deri në 20 mars 2021. Nga këto, 63 ishin raportet e para dhe vetëm 33 raporte të dyta të monitorimit.

108 Vendime të Komisionerit Shtetëror për Zgjedhjet, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

109 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 67, Lista e kandidatëve të partive dhe koalicioneve të partive" pika 5.

110 Shih vendimin nr. 409, datë 23.06.2021 "Për shpërndarjen e mandateve midis subjekteve zgjedhore dhe përcaktimin e kandidatëve fitues në zonën zgjedhore qarku Tiranë, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25.04.2021" dhe vendimin nr. 410, datë 23.06.2021 "Për shpërndarjen e mandateve midis subjekteve zgjedhore dhe përcaktimin e kandidatëve fitues në zonën zgjedhore qarku Shkodër, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25.04.2021" të Komsionerit.

shpërndarë mandatet e PSD në Shkodër dhe Tiranë, në mungesë të vullnetit të shprehur prej Z. Doshi se cilin mandat do të mbante.
Megjithatë, shpërndarja e mandateve për PSD në Shkodër dhe Tiranë krijoi standarde të ndryshme në dhënien e mandateve, duke qenë se në rastin e humbjes së mandatit prej një deputeti, deputeti në radhë që e merr mandatin përcaktohet jo nga renditja paraprake e partisë në listën e kandidatëve, si në shpërndarjen fillestare, por në bazë të numrit të votave parapëlqyese të fituara. Ky ishte rasti në dhënien e mandateve për deputetët që hynë në Kuvend pas seancës së parë të tij pas dorëheqjes së katër deputetëve të zgjedhur përpara nisjes së Legjislaturës së re të Kuvendit[111]. Në rast se Z Doshi do të kishte marrë mandatin dhe më pas do të kishte dhënë dorëheqjen, kandidati që do ta zëvendësonte në Kuvend nuk do të përcaktohej nga renditja fillestare në listën e PSD, por nga ri-renditja që kryhet bazuar në numrin e votave parapëlqyese të mara nga kandidatët[112].
Nga ana tjetër, përtej veprimeve të Komisionerit, në gjykimin e KRIIK, tërheqja e Z. Doshi nga mandati i pamarrë në dorëzim është në kundërshtim me përgjegjësinë publike, që një person i cili kërkon të mandatohet nga qytetarët si deputet i Kuvendit, duhet të manifestojë. Kandidati për deputet merr një përgjegjësi publike dhe qytetare, në radhë të parë përpara zgjedhësve të vet dhe më pas përballë legjislacionit. Duke hequr dorë nga mandati pa e marrë përsipër atë, Z. Doshi ka treguar mungesë përgjegjësie publike ndaj zgjedhësve shqiptarë.

IV.1.2.2. Komisioni Rregullator (Rregullatori)

Komisioni Rregullator shqyrton dhe miraton projektaktet me karakter normativ, të përgatitura nga administrata e KQZ-së ose nga anëtarët e tij, si kufijtë e zonave të administrimit zgjedhor, numrin e mandateve për çdo zonë zgjedhore, rregullat për përdorimin e sistemeve apo pajisjeve të teknologjisë së informacionit, udhëzuesit dhe doracakët në shërbim të administratës zgjedhore, rregullat për raportimin financiar të subjekteve zgjedhore, rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, rregullat për metodologjinë e monitorimit të medias etj.[113]
Komisioni Rregullator u mblodh për herë të parë në datën 26 tetor 2020, mbledhje gjatë së cilës u miratua rregullorja për organizimin dhe funksionimin e tij. Në total, në funksion të organizimit të procesit zgjedhor, Komisioni Rregullator zhvilloi 30 mbledhje dhe miratoi 33 vendime dhe 2 udhëzime.
Komisioni Rregullator i merr vendimet me shumicë të cilësuar (4/5) për çështje që kanë të bëjnë me miratimin e projektakteve me karakter normativ, si dhe lidhur me përcaktimin e kufijve të zonave të administrimit zgjedhor, përdorimin e teknologjisë në zgjedhje dhe votimin e shtetasve që banojnë jashtë vendit. Ndërkohë, vendimet lidhur me shpërndarjen e mandateve për zonat zgjedhore dhe me certifikimin e rezultatit final të zgjedhjeve mund të merren me shumicë të thjeshtë (3/5)[114].
Vendimmarrja ka qenë unanime[115], pavarësisht diskutimeve nga anëtarët e këtij komisioni, në disa raste edhe jashtë rendit të ditës, të cilat qartazi reflektonin qëndrime[116] në linjë me qëndrimet politike të subjekteve zgjedhore në garë.

Vërehet se Rregullatori ka mbajtur qëndrim, përgjithësisht, të unifikuar gjatë mbledhjeve publike, ndërkohë që kur vëreheshin mosmarrëveshje apo kishte qëndrime të ndryshme nga ana e anëtarëve merrej pushim për t'i bërë diskutimet përkatëse jo publikisht. Madje, në një rast[117], i gjithë

111 Gramoz Ruçi, i zgjedhur në Fier nga lista e PS-së; Mark Marku, i zgjedhur në Lezhë nga lista e PD-AN; Najada Çomo, e zgjedhur nëTiranë nga lista e PS-së dhe Lefter Koka, i zgjedhur në Durrës nga lista e PS-së.

112 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 163 "Ndarja e mandateve brenda koalicionit", pika 7 dhe neni 164 "Ndërprerja e mandatit dhe zëvendësimi i vakancës", pika 2.

113 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 20 "Kompetencat e Rregullatorit" (ndryshuar me ligjin nr. 101/2020, datë 23.07.2020).

114 Po aty.

115 Përveç vendimit të miratimit të rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve.

116 Dy anëtarët e Komisionit Rregullator znj. Helga Vukaj dhe z. Muharrem Caka, në vazhdimësi kanë ngritur shqetësimin për qëndrimin pasiv të KQZ-së lidhur me përdorimin e burimeve shtetërore, si dhe mosreagimin e KQZ-së për çështjen e publikimit të bazës së të dhënave të shtetasve.

117 Miratimi i manualit të KZAZ-ve dhe GNV-ve (seancat e datave 9 dhe 20 prill 2021), ishte një çështje që u shoqërua me debate gjatë seancës për diskutimin e këtyre projektakteve. Kjo për shkak të propozimit të dy draftakteve nga administrata, ku modeli i dytë, sipas saj, u cilësua si një akt me përmbajtje të njëjtë me të parin, por me vetëm disa ndryshime teknike. Ky ndryshim i akteve u konsiderua si joserioz nga dy anëtarë të Rregullatorit, të cilët kërkuan praninë e Komisionerit për të qartësuar situatën, lidhur me përcaktimin e aktit që duhet të konsiderohej nga Rregullatori.
Komisioneri tërhoqi të dyja projektaktet e propozuara nga administrata duke vijuar me rinisjen e procedurës nga

diskutimi u krye në mbledhje jopublike, dhe vetëm miratimi i aktit u krye në mbledhje publike.

Përveçse në shkelje të Rregullores[118] së Komisionit Rregullator, sipas së cilës mbledhjet e tij janë publike, një qasje e tillë është edhe në kundërshtim me frymën e transparencës ndaj publikut që administrata zgjedhore duhet të manifestojë.

KRIIK vlerëson se çdo diskutim i komisioneve në KQZ duhet të jetë publik, me synimin që të rritet besimi i qytetarëve në administratën zgjedhore dhe vetë procesi zgjedhor.

IV.1.2.2.1. Shpallja e moskompetencës për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit

Një nga rastet ilustruese të ndikimit politik në qëndrimet e anëtarëve të Komisionit Rregullator është shmangia e detyrimit për të miratuar modelin e fletës së votimit prej këtij Komisioni, çështje për të cilën partitë politike kishin qëndrime diametralisht të kundërta, kundërshti, të cilat u zgjidhën në Kolegjin Zgjedhor.

Ligji i njeh kompetencën Komisionit Rregullator për të miratuar elementet e sigurisë së fletëve të votimit, detyrim, i cili u përmbush nga Rregullatori më datë 26 shkurt[119]. Në logjikën e këtij detyrimi ligjor, Komisioneri i paraqiti për shqyrtim dhe miratim Rregullatorit projektaktin[120] për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit. Qëndrimet e përfaqësuesve të partive politike[121] në KQZ në lidhje me kompetencën e Rregullatorit për marrjen e këtij vendimi ishin të ndara, çka dukshëm u reflektua edhe në qëndrimet e anëtarësisë së Rregullatorit gjatë mbledhjes publike. Pavarësisht diskutimeve publike të anëtarëve gjatë mbledhjes, Rregullatori vendosi në përfundim shpalljen e moskompetencës pas diskutimeve jopublike, ku u gjet dakordësia për të votuar unanimisht moskompetencën, pavarësisht qëndrimit të shprehur nga anëtarët lidhur me këtë çështje.

KRIIK gjykon se miratimi i modelit të fletës së votimit është në fakt kompetencë e Rregullatorit, pavarësisht se ligji nuk e përmend në mënyrë eksplicite këtë kompetencë, në analogji të kompetencës së Rregullatorit për të miratuar elementet e sigurisë së fletës së votimit.

Vendimmarrja e Komisionit në këtë rast përbën shmangie të detyrimeve ligjore të këtij organi, shmangie, e cila u diktua nga qëndrimet e ndryshme të partive politike në lidhje me këtë çështje.

IV.1.2.2.2. Miratimi i rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve

Vendimmarrja për rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve ishte akti i fundit i miratuar nga Komisioni Rregullator, në funksion të procesit zgjedhor të datës 25 prill 2021. Ky vendim, mjaft i rëndësishëm për procesin, ishte i vetmi i miratuar me shumicë të thjeshtë votash nga ana e Rregullatorit, çka u parapri nga argumentimi dhe qëndrimi publik[122] gjatë *mbledhjes* i anëtarësisë së tij.

Në këto qëndrime[123], u vërejt sikurse në vazhdimësi, një afilim i gjykimit të anëtarëve me atë të subjekteve politike pjesëmarrëse në proces, me diferenca të mëdha në gjykimin e tyre, nga njëra anë duke e konsideruar si një proces të dështuar zgjedhor dhe nga ana tjetër procesi më i mirë që Shqipëria ka realizuar ndonjëherë. Rregullatori konkludoi në një vendimmarrje "tre me dy", duke pasqyruar qëndrimin e forcave politike.

Duke vlerësuar përpjekjet dhe qëndrimet publike të dy prej anëtarëve[124] të Rregullatorit, edhe gjatë procesit zgjedhor, në funksion të adresimit të çështjeve shumë të rëndësishme me probleme në zbatueshmëri, si mosrespektimi i Vendimit nr. 9 të Rregullatorit apo publikimi

administrata për propozimin dhe miratimin e projektaktit. Në qëndrimet e dy anëtarëve të Rregullatorit u vërejt një nivel i lartë mosbesimi ndaj administratës së KQZ-së.

118 Vendim nr. 1, datë 26.10.2020, Komisioni Rregullator, "Miratimi i rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit Rregullator" Neni 20 "Zhvillimi i mbledhjes së Komisionit Rregullator", pika 5.

119 Vendimi nr. 6, datë 26.02.2021, Komisioni Rregullator, "Për miratimin e specifikimeve teknike të fletës së votimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021".

120 Projektvendim, mars 2021, Komisioni Rregullator, "Për miratimin e përmbajtjes së fletëve të votimit për Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021."

121 Përfaqësuesi i PS-së gjykonte se ky projektvendim nuk ishte kompetencë e Rregullatorit, por e Komisionerit. Përfaqësuesit e forcave të tjera politike gjykonin se ky vendim duhet të merrej nga Komisioni Rregullator.

122 Mbledhja e datës 13.07.2021, pjesa 1, Komisioni Rregullator, Youtube.

123 Mbledhje e Komisionit Rregullator, pjesa 1, datë 13.07.2021. Duke i listuar znj. Helga Vukaj min. 7–16; z. Muharrem Çakaj min. 16–22; z. Dritan Çaka min 2–25; znj. Ilirjana Nano min 26-28.

124 znj. Helga Vukaj dhe z. Muharrem Çakaj.

i bazës së të dhënave personale të shtetasve, duhet të kishte pasur një qasje më proaktive për të shkuar deri në fund marrjes së informacionit të kërkuar publikisht për çështjet e sipërpërmendura. Kjo, do t'i shërbente një qëndrimi edhe më të bazuar institucionalisht në fund të procesit.

IV.1.2.3. Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve

Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve (KAS) është organ i KQZ-së kompetent për shqyrtimin e ankimimeve administrative dhe për vendosjen e sanksioneve për shkelje të ligjit zgjedhor.
KAS-i mund të vendosë për shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve në qendra votimi individuale, zona zgjedhore apo të gjithë vendin, si dhe përsëritjen e zgjedhjeve; shqyrton ankimimet ndaj akteve të Komisionerit apo KZAZ-ve; vlerëson performancën e komisionerëve dhe numëruesve për çështjet që shqyrton dhe vendos masa disiplinore në rastet kur pas kontrollit *a posteriori* të materialit zgjedhor janë konstatuar shkelje ose parregullsi në administrim; si dhe vendos sanksione administrative kundër personave apo subjekteve zgjedhore dhe/ose kandidatëve të tyre, që kryejnë kundërvajtje administrative në lidhje me zgjedhjet, me kërkesë të Komisionerit. Vendimet e KAS-it merren me shumicë të thjeshtë (3/5), me përjashtim të vendimeve që lidhen me rezultatet e zgjedhjeve, ku kërkohet një shumicë e cilësuar (4/5)[125].
Në periudhën që mbulon ky raport, KAS-i shqyrtoi 65 kërkesa ankimore[126] nga 77 kërkesa të paraqitura[127], dhe mori gjithsej 120 vendime,[128] nga të cilat 37 vendime përfundimtare pas shqyrtimit të çështjeve. Për 16 vendime është ushtruar e drejta e ankimimit në Kolegjin Zgjedhor [129], i cili ka vendosur ndryshimin e plotë të vendimit të KAS-it për një çështje,[130] dhe pjesërisht për tri çështje[131].
Në ndjekje të vendimmarrjes së KAS-it, evidentohet se ajo ka qenë në shumicën dërrmuese të saj me shumicë të thjeshtë[132]. Të vetmet raste kur vendimmarrja ka qenë unanime, kanë qenë kërkesa ankimore në të cilat subjektet kryesore politike[133] nuk kanë qenë të përfshira[134], çka është tregues i qartë i një ndikimi politik.

Votimi *en block* në përputhje me qëndrimet e subjekteve politike, për çështje thelbësisht të rëndësishme në proces[135], vendosi në pikëpyetje paanshmërinë e kësaj strukture, në kundërshtim me frymën e Marrëveshjes së 5 Qershorit për një strukturë të paanshme politikisht.
Në funksion të procesit zgjedhor, 35 vendime të Komisionerit janë ankimuar në KAS, i cili ka ndryshuar apo shfuqizuar 18 prej tyre. Më të rëndësishmet konsiderohen vendimet, të cilat rrëzuan masat administrative të vendosura nga Komisioneri, në funksion të shkeljeve të Vendimit nr. 9 të Komisionit Rregullator[136], duke krijuar një precedent negativ për sa i përket zbat-

125 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 21, "Kompetencat e KAS-it" (ndryshuar me ligjin nr. 101/2020, datë 23.7.2020).

126 21 kërkesa u shqyrtuan para ditës së zgjedhjeve, ndërsa 43 pas ditës së zgjedhjeve.

127 Për tetë kërkesa ankimore, KAS-i vendosi moskalimin për shqyrtim për shkak të mangësive në elementet e formës dhe përmbajtjes sipas nenit 130 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë "Objekti i verifikimit paraprak", për dy kërkesa të tjera KAS vendosi moskalimin për shqyrtim për shkak të moskopetëncës mbi objektin e ankimimit, ndërsa për dy të tjera pasi i ktheu për plotësim, çështja u pushua pasi subjektet ankuese nuk plotësuan dokumentacionin përkatës. Ndërkohë një kërkesë ankimore e paraqitur nga PD-ja nuk kishte lidhje me procesin zgjedhor, por me dekriminalizimin.

128 Nga të cilat 83 vendime të ndërmjetme në funksion të çështjeve (p.sh., për bashkim të çështjeve, kthim për plotësimin e kritereve për t'u kaluar në shqyrtim të kërkesave ankimore, moskalim për shqyrtim etj.).

129 Për vendimin nr. 6 datë 16.02.2021 të KAS-it, Kolegji Zgjedhor ka shpallur moskompetencën dhe çështja është gjykuar nga Gjykata Administrative, e cila ka rrëzuar pjesërisht vendimin e KAS-it.

130 Çështja me subjekt ankues Partinë Socialiste dhe objekt "Shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e listave shumemërore të koalicionit Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim (PD-PR-PDIU-PAA-PBDNJ-PDK-LZHK-PLL-FRDBLD-PBKD-PBD-PKD), për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 prill 2021."

131 Për më shumë shih Shtojcën M "Kërkesat Ankimore".

132 Në 34 vendime pas shqyrtimit të ankimimit përkatës, 17 vendime janë miratuar tre me dy, 13 vendime pesë me zero, tre vendime katër me zero, dhe një vendim katër me një.

133 Partia Socialiste, Partia Demokratike dhe Lëvizja Socialiste për Integrim.

134 Pavarësisht se nuk është pranuar me votim katër me një, një prej anëtarëve të KAS-it ka votuar për pranimin e kërkesës ankimore të PDIU-së lidhur me numëruesin e katërt në GNV.

135 Përdorimi i burimeve shtetërore në fushatën zgjedhore, përmbajtja e fletës së votimit, ankimimet e partive opozitare dhe kandidatëve të pavarur lidhur me rezultatin e zgjedhjeve.

136 Vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, Komisioni Rregullator, "Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter

ueshmërisë së një prej risive të vendosura në amendimet e fundit të Kodit Zgjedhor, për parandalimin e përdorimit të burimeve shtetërore për përfitime elektorale.
Në gjykimin e KRIIK, lidhur me këtë çështje, KAS-i tregoi një të lexuar të ngushtë të ligjit, duke anashkaluar frymën e tij, i cili synon parandalimin e përdorimit të burimeve shtetërore në mënyrë që të garantohet barazia në garën elektorale. Përkundër këtij vizioni, KAS është fokusuar në germën e ligjit, duke injoruar qëllimin në funksion të të cilit është hartuar norma.
Edhe pas përfundimit të procesit të votimit dhe numërimit, KAS ndryshoi shtatë vendime të Komisionerit lidhur me sanksionet administrative të vendosura ndaj komisionerëve të disa KZAZ-ve, për shkelje të parashikuara në nenin 122 të Kodit Zgjedhor, të cilat lidhen konkretisht me mosrespektimin e afatit për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultateve[137].
Ishte hera e parë që KQZ-ja ndërmori një hap të tillë në funksion të nxitjes së përgjegjshmërisë së komisionerëve për zbatimin e ligjit, por edhe kjo vendimmarrje u zhbë nga KAS-i. Në gjykimin e KRIIK, kjo vendimmarrje nxit kulturën e pandëshkueshmërisë dhe mosrespektimin e ligjit nga komisionerët zgjedhorë.
KRIIK konstaton se KAS-i është sjellë gjatë gjithë procesit zgjedhor si një trupë e huaj e jashtme e KQZ-së dhe jo si një pjesë integrale e këtij institucioni.

IV.1.3. Përdorimi i teknologjisë në zgjedhje

Një nga ndryshimet e shumëdebatuara gjatë reformës zgjedhore, e cila mori një vëmendje të lartë publike dhe u konsiderua si faktor kyç në përmirësimin e integritetit të zgjedhjeve nga opozita ishte përdorimi i teknologjisë në zgjedhje.
Në funksion të realizimit të identifikimit elektronik të zgjedhësve, Kuvendi emëroi Nënkomisioneren Shtetërore të Zgjedhjeve, një propozim i opozitës jashtëparlamentare, si një garanci për realizimin e aplikimit të teknologjisë në këtë proces zgjedhor.
Sipas Kodit Zgjedhor,[138] detyra kryesore e Nënkomisionerit është drejtimi, monitorimi dhe mbikëqyrja e implementimit të teknologjisë për identifikimin elektronik, si dhe rekrutimi dhe trajnimi i zyrtarëve zgjedhorë. Në zbatim të detyrimeve ligjore[139], KQZ-ja miratoi aktet nënligjore përkatëse në funksion të përdorimit të teknologjisë në zgjedhjet e datës 25 prill 2021. Këto risi përfshinë realizimin e identifikimit elektronik të zgjedhësve në të gjithë vendin dhe votimin dhe numërimin elektronik, si projekt pilot, në vetëm një zonë[140] administrimi zgjedhor.
Risi në këto zgjedhje ishte edhe pajisja e çdo qendre votimi me kamera regjistruese.

IV.1.3.1. Sistemi Elektronik i Identifikimit të Votuesve (SEIV)

Identifikimi elektronik është identifikimi i zgjedhësit nëpërmjet verifikimit të të dhënave personale nga leximi me anë të një Pajisjeje Elektronike të Identifikimit (PEI) të kartës së identitetit apo pasaportës së zgjedhësit, si dhe përqasjen e tyre me bazën elektronike të të dhënave për listën e zgjedhësve. Identifikimi elektronik i zgjedhësve ishte pjesë e rëndësishme në marrëveshjen politike të datës 5 Qershor 2020 dhe një risi madhore në këtë proces zgjedhor.
Individët që menaxhuan dhe përdorën PEI-n gjatë ditës së zgjedhjeve, nuk ishin anëtarë të Komisionit të Qendrës së Votimit përkatëse, por individë të rekrutuar nëpërmjet një thirrjeje të hapur për aplikime dhe trajnuar nga KQZ-ja. Kriteret për të qenë operator i PEI-it dhe rregullat e rekrutimit u miratuan me vendim të Komisionit Rregullator[141].

---

publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve".

137 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 122, pika 1, "Nxjerrja e tabelës përmbledhëse të rezultatit të zgjedhjeve nga KZAZ-ja".

138 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 14 "Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve" (ndryshuar me ligjin nr. 101/2020, datë 23.07.2020).

139 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 22 "Kompetencat e KQZ-së lidhur me teknologjinë në zgjedhje" dhe neni 23 "Procedura për futjen e teknologjisë në zgjedhje dhe vendimmarrja" (ndryshuar me ligjin nr. 101/2020, datë 23.7.2020).

140 Vendim nr. 111, datë 02.03.2021, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, "Për caktimin e zonës së administrimit zgjedhor, nr. 40, në Bashkinë e Tiranës, si njësinë administrative për zbatimin e projektit pilot për procesin e votimit dhe numërimit elektronik të votave".

141 Vendimi nr. 07, datë 02.03.2021, Komisioni Rregullator, "Për caktimin e personelit të kualifikuar për përdorimin e pajisjeve të teknologjisë së informacionit në Qendrën e Votimit".

KQZ-ja realizoi testimin e kësaj mënyre identifikimi të zgjedhësve në tri bashki, përkatësisht në Tiranë, Kukës dhe Fier.
Pajisja e identifikimit elektronik përmbante listën e votuesve të të gjitha QV-ve dhe mund të identifikonte nëse një votues ishte paraqitur në qendrën e votimit të gabuar, si dhe të identifikonte QV-në në të cilën zgjedhësi duhet të votonte. Gjithashtu, pajisja mund të identifikonte nëse një zgjedhës kishte votuar tanimë në atë qendër votimi ku pajisja ishte e vendosur.
Duke qenë se nuk ishte e lidhur në sistem me pajisjet e tjera apo me një bazë të dhënash qendrore, votimi në më shumë se një qendër votimi nuk mund të identifikohej në kohë reale, por vetëm pas përmbylljes së procesit[142]. Pajisja e identifikimit elektronik lejonte edhe kërkimin dhe shtimin manual të zgjedhësit, duke regjistruar edhe faktin që ky zgjedhës është regjistruar manualisht në sistem. Gjatë procesit të identifikimit, zgjedhësi firmoste duke vendosur shenjën e gishtit në pajisjen e identifikimit. Shenja e gishtit nuk shërbente për të identifikuar zgjedhësin (pajisja nuk kryente lidhjen mes të dhënave të dokumentit të identifikimit dhe shenjës së gishtit), por mund të përdoret në vazhdim për të identifikuar nëse e njëjta shenjë gishti ishte përdorur për të firmosur më tepër sesa një herë.
Implementimi i këtij projekti konsiderohet se lehtësoi në mënyrë të konsiderueshme procesin e administrimit të zgjedhjeve, si dhe rriti garancinë e procesit. Lidhja e të gjitha pajisjeve me internet do të kishte garantuar edhe më tepër eliminimin e mundësisë për të votuar në më tepër se një qendër votimi në kohë reale, ndërkohë që nga ana tjetër do të ulte sigurinë e sistemit, duke qenë se rritet mundësia për ndërhyrje nga jashtë në sistem.
KQZ-ja, edhe për shkak të kohës shumë të shkurtër në dispozicion dhe faktit që implementimi i këtij procesi ndodhi për herë të parë, hasi disa vështirësi në procesin e rekrutimit të operatorëve për administrimin dhe përdorimin e PEI-t. Rezultoi se identifikimi i zgjedhësve u realizua tërësisht manualisht në 193 qendra votimi.
Megjithatë, teknologjia nuk funksionoi pa probleme. Disa nga problematikat që lidhen me ditën e votimit lidhen me mosparaqitjen e operatorëve, keqfunksionimin e pajisjeve, çka çoi që në shumë qendra të raportoheshin vonesa të procesit të votimit apo edhe të hapjes së tyre[143]. Të dhënat mbi ecurinë e këtij procesi u përfshinë në raportin mbi gjetjet kyçe të kryqëzimit të të dhënave elektronike dhe biometrike të mbledhura nga pajisjet e identifikimit elektronik, i cili u miratua me vendim[144] nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Problematikat e evidentuara nga raporti konsistojnë në votues të cilët janë identifikuar në 2 qendra votimi të ndryshme[145]; shenja unike gishti të skanuara përkatësisht nga dy herë, pra një shenjë gishti e lidhur me dy numra personalë të ndryshëm[146]; si dhe shenja unike gishti të cilat janë skanuar më shumë se 2 herë, pra një shenjë gishti e lidhur me disa numra personalë të ndryshëm[147]. Lidhur me këto dyshime të nxjerra nga Pajisjet Elektronike të Identifikimit, KQZ kreu kallëzim në Prokurori.

IV.1.3.1.1. Ankimimet që përdorën si provë identifikimin elektronik

Në ankimimet e paraqitura në KAS pas ditës së zgjedhjeve, dhe që kishin për objekt shpalljen e pavlefshme dhe përsëritjen e zgjedhjeve në disa qarqe, një nga arsyet e renditura në funksion të kësaj kërkese ishin probleme të evidentuara nga PEI, si votimi më shumë se një herë, depozitimi i së njëjtës shenjë gishti për votues të ndryshëm.

142 Vendimi nr. 02, datë 31.10.2020, Komisioni Rregullator, "Për llojin dhe karakteristikat teknike që duhet të plotësojnë pajisjet e identifikimit elektronik të zgjedhësve që prokurohen dhe përdoren në zgjedhje në Republikën e Shqipërisë".

143 Për më shumë shih Seksionin "*Procedurat e hapjes së Qendrave të Votimit*"

144 Vendim nr. 469 datë 3.12.2021 "Për miratimin e raportit mbi gjetjet kyçe të procesit të kryqëzimit të të dhenave elektronike dhe biometrike të mbledhura nga pajisjet e identifikimit elektronik në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25.04.2021."

145 20 zgjedhës janë identifikuar nga 2 herë secili në QV të ndryshme, që perbejne 40 raste të dyshimta. Pra i njëjti dokument ose numër personal është skanuar nga Pajisjet Elektronike te Identifikimit në orare të ndryshme në QV të ndryshme, ku në një rast votuesi ka qenë pjesë e listës së votuesve të asaj QV-je dhe në rastin tjetër është paraqitur si administratë zgjedhore.

146 U identifikuan 448 raste të dyshimta, ku 224 shenja gishtash janë depozituar nga 2 here secili për identitete të ndryshme. Pra e njëjta shenjë gishti është skanuar nga Pajisjet Elektronike te Identifikimit në orare të ndryshme për 2 persona të ndryshem.

147 U identifikuan 518 raste te dyshimta, ku 44 shenja gishtash janë depozituar më shumë se 2 herë secili për identitete të ndryshme. Pra e njëjta shenjë gishti është skanuar nga Pajisjet Elektronike te Identifikimit në orare të ndryshme për më shumë se 2 persona të ndryshëm.

Lidhur me këto pretendime, për vetëm një qark,[148] dy anëtarë të KAS-it kërkuan raportim sqarues nga Nënkomisionerja Shtetërore e Zgjedhjeve. Pavarësisht kërkesës zyrtare të KRIIK për kopje të këtij raporti, ai nuk është vënë në dispozicion me arsyetimin se përmban të dhëna sensitive.
Në seancën publike të KAS-it të datës 19.05.2021, për shqyrtimin e kërkesave ankimore që lidhen me Qarkun Gjirokastër, Nënkomisionerja, në përgjigje të pyetjeve të drejtuara, referoi disa nga arsyetimet e pasjes **të së njëjtës shenjë gishti për disa votues apo të identifikimit nga pajisja të personave që janë identifikuar se kanë nënshkruar më shumë se një herë.**
Vlen të theksohet se këto nënshkrime nuk vërtetojnë juridikisht se këta individë kanë ushtruar të drejtën e votës, pra ka siguri që janë identifikuar, por jo që kanë votuar, e për rrjedhim prova në fjalë gjatë gjykimit të KAS-it ngeli e mangët dhe duhet të merret në shqyrtim nga Prokuroria.
Në gjykimin e KRIIK, KAS duhet të ishte treguar më aktiv në kërkesën për shqyrtimin deri në fund të procedurës në fjalë, duke kërkuar edhe këqyrjen e kamerave të sigurisë së QV-ve përkatëse, filmimet e të cilave do të siguronin informacionin nëse personat që kanë tentuar të votojnë më shumë sesa një herë, duke kryer procesin e identifikimit më shumë sesa një herë, kanë votuar apo jo. Duke pasur një qasje evazive, pa i shkuar deri në fund faktimit të pretendimeve në fjalë, KAS relativizoi çdo pretendim të palëve në proces mbi këtë pjesë të tij, për të gjitha qarqet e tjera të shqyrtuara më pas.

IV.1.3.2. Votimi dhe numërimi elektronik

Realizimi i votimit dhe numërimit elektronik u pilotua[149] në zgjedhjet e 25 prillit 2021 në vetëm një zonë zgjedhore, në Bashkinë Tiranë.[150] Duke pasur në konsideratë rëndësinë e realizimit të këtij procesi, si element shumë i rëndësishëm i Marrëveshjes së 5 Qershorit, impaktin që mund të ketë tek besimi mbi procesin zgjedhor, si dhe në vlerësim të konsensusit politik lidhur me çështjen, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve iu drejtua me letër zyrtare tetë partive politike për të parashtruar propozimet e tyre lidhur me zonat zgjedhore, të cilat i gjykonin më të përshtatshme për implementimin e votimit dhe numërimit elektronik. Katër parti politike, Partia Socialiste (PS), Partia Demokratike (PD), Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI) dhe Bindja Demokratike (BD), depozituan[151] propozimet përkatëse.
Pas një procesi të brendshëm diskutimesh ndërmjet KQZ-së dhe partive politike, Komisioneri në mbledhjen e Komisionit Rregullator për këtë çështje deklaroi se KQZ-ja vendosi që ky projekt të realizohet në një prej ZAZ-ve të Tiranës, me jo më shumë se 55 qendra votimi[152]. Referuar kritereve të mësipërme, Komisioneri vendosi caktimin e ZAZ-së nr. 40 (Njësia Administrative nr. 10, në Tiranë) si zonë ku do të zbatohej projekti pilot për procesin e votimit dhe numërimit elektronik të votave në zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 prill 2021. Rregullat lidhur me procedurat për aspektet e veçanta të procesit, të cilat mbulohen nga sistemet apo pajisjet e teknologjisë së informacionit u miratuan[153] nga Komisioni Rregullator, ndërsa rregul-

148 Qarku Gjirokastër.

149 Kjo ishte tentativë e dytë në historikun e proceseve zgjedhore në Shqipëri, pas përpjekjeve të dështuara për ta realizuar në zgjedhjet vitit 2013.

150 Vendim nr. 111 datë 02.03.2021, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, "Për caktimin e ZAZ-së, nr. 40, në bashkinë e Tiranës, si njësinë administrative për zbatimin e projektit pilot për procesin e votimit dhe numërimit elektronik të votave."

151 PD dhe LSI kërkuan që teknologjia e re të implementohet në Fier dhe Korçë, PS-ja kërkoi që teknologjia e re të implementohej në Korçë dhe Tiranë, ndërsa BD-ja kërkoi që teknologjia e re të implementohej në Tiranë.

152 Mbledhja e Komisionit Rregullator datë 12.02.2021, z. Celibashi: "KQZ-ja ka synuar që të implementonte në mënyrë të plotë jo më pak se 10% të qendrave të votimit dhe jo më shumë se 20% të qendrave të votimit, për projektin pilot të votimit dhe numërimit elektronik. Gjatë kësaj periudhe jemi përpjekur në bashkëpunim dhe konsultim me partitë politike që të kishim një dakordësi mbi zonat në të cilat ky projekt do të implementohet. Jemi dakordësuar që për shkak të ngushtësisë së kohës dhe implementimeve të shumta financiare e njerëzore do të ishte e vështirë për KQZ-në që ta shtrinte implementimin në një numër qendrash votimi të barabarta me jo më pak se 10% dhe jo më shumë se 20%. ... Ndaj kemi ceduar të gjithë nga ai angazhim, qoftë ne si institucion KQZ-je, Komisioneri, por edhe interesi i partive politike, dhe jemi dakordësuar që të jetë e mundur të aplikohet në një zonë më të vogël. Pas konsultimeve kemi menduar që implementimi i këtij projekti në një prej ZAZ-ve të Tiranës me numër qendrash votimi jo më shumë se 55, do të na jepte një indicie mbi efektet e këtij projekti. Është menduar që të jetë ose zona që i përket njësisë bashkiake nr. 8 ose njësisë numër 3. Secila prej tyre ka një numër qendrash votimi 52..."

153 Vendimi nr. 17, datë 14.04.2021, Komisioni Rregullator, "Për rregullat procedurale për procesin e votimit dhe numërimit elektronik nëpërmjet pajisjes elektronike të votimit dhe numërimit të Qendrave të Votimit të Zonës së Administrimit Zgjedhor nr. 40 në qarkun Tiranë për zgjedhjet e Kuvendit të datës 25 prill 2021."

lat procedurale teknike për administrimin dhe zhvillimin e procesit të votimit dhe numërimit elektronik në KZAZ nr. 40 u miratuan me vendim[154] të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Në 32 qendrat e votimit ku u aplikua kjo teknologji votuan 12 096 qytetarë. Numri i votave të pavlefshme në këtë zonë zgjedhore ishte 120 (më pak se 1%). Duhet theksuar se, mundësia që të linte pajisja elektronike për të gabuar gjatë procesit të votimit ishte zero, por këto vota ishin të pavlefshme pasi votuesi zgjodhi opsionin "nuk zgjedh asnjë kandidat". Vendosja e këtij opsioni u përcaktua në vendimin[155] e KSHZ-së, por kjo rezulton të jetë bërë pa ndonjë bazë ligjore, pasi kuadri ligjor shqiptar nuk njeh të drejtën e zgjedhësve për të përzgjedhur alternativa "nuk votoj asnjë" apo diçka të ngjashme. Procesi i votimit elektronik u administrua mirë dhe pa probleme, qoftë këto të karakterit teknik, por edhe të aspektit administrativ të procesit. Pavarësisht se mund të ishte bërë më herët, shpallja e rezultatit të zgjedhjeve për këtë zonë zgjedhore u krye në datën 26 prill 2021, për të ezauruar çdo mundësi problematikash që mund të kishte edhe për shkak të implementimit për herë të parë.

IV.2. KOMISIONET ZONALE TË ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR

Zonat e Administrimit Zgjedhor (ZAZ) ngrihen dhe funksionojnë për çdo lloj zgjedhjeje dhe referendumi. Si rregull, një zonë e administrimit zgjedhor përputhet me territorin e një bashkie, sipas ndarjes territoriale-administrative të vendit[156], me përjashtim të bashkive që kanë më shumë se 80.000 zgjedhës, të cilat ndahen në më shumë se një zonë zgjedhore[157].
Zonat e Administrimit Zgjedhor miratohen nga KQZ-ja jo më vonë se 9 muaj para përfundimit të mandatit të Kuvendit, mbi bazën e numrit të shtetasve me të drejtë vote në datën e fundit të periudhës zgjedhore për caktimin e zgjedhjeve, sipas të dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile. KQZ shqyrtoi aplikimin e gjithë kritereve të përcaktuara në ligj, dhe miratoi ndarjen e ZAZ-ve[158] në respektim të afateve ligjore, me vendim të Komisionit Rregullator. Në funksion të administrimit sa më efikas të procesit zgjedhor në nivelin e dytë të tij, si dhe për një proces numërimi më të shpejtë e transparent, Rregullatori vendosi ngritjen e 92 Zonave të Administrimit Zgjedhor, dy më shumë[159] se zgjedhjet e kaluara.
Zgjedhjet në çdo zonë të administrimit zgjedhor administrohen nga Komisionet Zonale të Administrimit Zgjedhor (KZAZ), të cilat përbëjnë nivelin e dytë hierarkik në administratën zgjedhore. KZAZ-të përbëhen[160] nga shtatë anëtarë me të drejtë vote dhe një sekretar, pa të drejtë vote. Anëtarësia e KZAZ-ve reflekton konfigurimin politik të Kuvendit, referuar shumicës dhe pakicës parlamentare. Partitë politike, të cilat duhet të propozonin anëtarë dhe sekretarët e KZAZ-ve u përcaktuan nga KQZ-ja, me vendim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, në datën 23 dhjetor 2020[161]. Nën dritën e lënies së mandateve prej opozitës në janar të vitit 2019, në zgjedhjet për Kuvendin të 25 prillit, Kodi Zgjedhor përfshin një dispozitë tranzitore, e cila diktoi ngritjen e KZAZ-ve në përputhje me konfigurimin e Kuvendit pas Zgjedhjeve të vitit 2017[162] dhe jokonfigurimit të tij në momentin e mbajtjes së zgjedhjeve, me qëllimin për të ga-

154 Vendim nr. 239, datë 15.04.2021, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, "Për miratimin e rregullave procedurale teknike të ZAZ nr.40, për administrimin dhe zhvillimin e procesit zgjedhor të votimit dhe numërimit elektronik për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021".

155 Po aty.

156 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 27, "Zonat e Administrimit Zgjedhor".

157 Në ndarjen e ZAZ-ve aplikohen kriteret e pandashmërisë së territorit administrativ, me përjashtim të ZAZ-ve me mbi 80 000 zgjedhës, vazhdimësia e territorit, mundësi të mira komunikimi brenda territorit, dhe të dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile mbi numrin e shtetasve me të drejtë vote.

158 Vendimi nr. 06, datë 30.11.2020, Komisioni Rregullator, "Për ngritjen e Zonave të Administrimit Zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend, të datës 25 prill 2021".

159 U shtua nga një ZAZ përkatësisht në bashkinë Berat dhe në Bashkinë Fier. Nevoja e shtimit të numrit erdhi si rrjedhojë e rritjes së numrit të votuesve në këto njësi administrative.

160 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 29, "Përbërja e KZAZ-së".

161 Vendimi nr. 40, datë 23.12.2020, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, "Për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarët dhe sekretarët e KZAZ-ve për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021". Partia Socialiste dy anëtarë, Partia Demokratike dy anëtarë, Partia Lëvizja Socialiste për Integrim një anëtar/e dhe Partia Social Demokrate një anëtar/e.
Vendimi nr. 5, datë 07.01.2021, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve miratoi shortin sipas të cilit anëtari/ja i/e shtatë, në KZAZ-të me numër çift do të propozohej nga PS-ja, ndërsa në KZAZ-të me numër tek nga PD-ja.

162 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 183, "Formimi kalimtar i organeve drejtuese dhe i administratës zgjedhore", pika 8.

rantuar pjesëmarrjen e opozitës jashtëparlamentare në administrimin e procesit.
Afati i fundit për depozitimin e listave për anëtarë të KZAZ-ve nga partitë politike ishte data 11 janar 2021, afat, i cili, nuk u respektua plotësisht vetëm nga Partia Socialdemokrate. Kjo parti propozoi anëtarë vetëm për 33 KZAZ duke lënë pa plotësuar me anëtarë të propozuar prej saj 59 të tjera[163].
Sipas përcaktimeve të Kodit Zgjedhor[164], dhe të Rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e KZAZ-së", miratuar nga Komisioni Rregullator[165], e drejta për propozimin e anëtarëve për plotësimin e vendeve vakante i kaloi partisë tjetër brenda të njëjtit grupim parlamentar, konkretisht Partisë Socialiste.
Pas depozitimit të propozimeve prej PS-së për KZAZ-të në të cilat PSD-ja nuk dërgoi propozime, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve emëroi[166] në 59 KZAZ-të e sipërpërmendura anëtarët e PS-së, duke plotësuar vakancat. Mosplotësimi i detyrimeve ligjore nga ana e Partisë Socialdemokrate, prishi balancën e përfaqësisë politike të synuar nga neni 29 i Kodit Zgjedhor, duke qenë se në KZAZ-të me numër çift, konkretisht 30 të tilla, PS-ja kishte katër anëtarë. Për më tepër, ky konfigurim u reflektua edhe në përbërjen e Komisioneve të Qendrave të votimit nën juridiksionin e këtyre KZAZ-ve.
Konstituimi i KZAZ-ve, si dhe emërimi[167] i anëtarëve dhe sekretarëve të tyre u realizua në respektim të afateve ligjore. Mbledhjet e para të KZAZ-ve në të gjithë vendin u realizua në datat 27, 28 dhe 29 janar 2021, të vendosura me vendim nga KQZ-ja, gjatë të cilave u zgjodhën kryetarët/et dhe zëvendëskryetarët/et e tyre.
KQZ-ja njoftoi zhvillimin e trajnimit të anëtarëve të KZAZ-ve në datat 22 dhe 23 mars 2021. Nga raportimet e vëzhguesve afatgjatë të KRIIK-ut, trajnimet u zhvilluan në datat e përcaktuara dhe u raportuan mungesa të pakta[168].
Pavarësisht vendimmarrjes në kohë për konstituimin e KZAZ-ve, trajnimi i tyre u realizua me vonesë. Gjithashtu, ndryshimet ligjore të realizuara në ligjin zgjedhor, miratimi i vonshëm i manualit përkatës të punës së KZAZ-ve, ishin elemente që mund të kenë pasur ndikim në nivelin e performancës së anëtarësisë së disa KZAZ-ve.
Një prej problematikave të vërejtura në punën e KZAZ-ve është mosrespektimi i orarit në një pjesë të tyre. Nga vizitat e kryera nga vëzhguesit afatgjatë të KRIIK janë identifikuar raste kur selitë e KZAZ-ve janë gjetur të mbyllura[169] gjatë orarit zyrtar të punës së KZAZ-së, afishuar në zyrën përkatëse. Ka patur raste kur ky orar nuk ishte i afishuar[170] apo edhe nuk ishin vendosur shenja dalluese në hyrje të ndërtesës[171], elemente, të cilat vështirësonin aksesimin e saj.
Problematika janë vërejtur me selitë/zyrat e përcaktuara nga KQZ-ja si ambiente ku KZAZ-të duhet të zhvillonin aktivitetin e tyre. Janë evidentuar nga vëzhguesit, KZAZ, të cilat në periudhën përpara fillimit të fushatës zgjedhore nuk kishin mjedise të përshtatshme për të zhvilluar punën

163 Për shkak të mosparaqitjes së propozimeve nga Partia Socialdemokrate e Shqipërisë në afatin e përcaktuar, u krijuan vakanca të pozicionit të anëtarit në KZAZ-të: Qarku Shkodër: KZAZ nr. 5, KZAZ nr. 6; Qarku Lezhë: KZAZ nr. 10, KZAZ nr. 14, KZAZ nr. 15; Qarku Dibër: KZAZ nr. 17, KZAZ nr. 18; Qarku Durrës: KZAZ nr. 20, KZAZ nr. 21, KZAZ nr. 22, KZAZ nr. 23, KZAZ nr. 24, KZAZ nr. 25; Qarku Tiranë: KZAZ nr. 39, KZAZ nr. 41, KZAZ nr. 42, KZAZ nr. 43; Qarku Elbasan: KZAZ nr. 44, KZAZ nr. 45, KZAZ nr. 46, KZAZ nr. 47, KZAZ nr. 48, KZAZ nr. 49, KZAZ nr. 50, KZAZ nr. 51, KZAZ nr. 52, KZAZ nr. 53; Qarku Fier KZAZ nr. 54, KZAZ nr. 55, KZAZ nr. 56, KZAZ nr. 57, KZAZ nr. 58, KZAZ nr. 59, KZAZ nr. 60, KZAZ nr. 61, KZAZ nr. 62; Qarku Berat: KZAZ nr. 63, KZAZ nr. 64, KZAZ nr. 65, KZAZ nr. 66, KZAZ nr. 67, KZAZ nr. 68; Qarku Gjirokastër: KZAZ nr. 76, KZAZ nr. 77, KZAZ nr. 78, KZAZ nr. 79, KZAZ nr. 80, KZAZ nr. 81, KZAZ nr. 82; Qarku Vlorë: KZAZ nr. 83, KZAZ nr. 84, KZAZ nr. 85, KZAZ nr. 86, KZAZ nr. 87, KZAZ nr. 88, KZAZ nr. 89; KZAZ nr. 90, KZAZ nr. 91, KZAZ nr. 92.

164 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 29 "Përbërja e KZAZ-së".

165 Vendim nr. 5, datë 20.11.2020, Komisioni Rregullator, "Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor", neni 3 "Përbërja e KZAZ-së" pika 7.

166 Vendim nr. 49, datë 11.02.2021, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, "Për emërimin e anëtarëve të disa KZAZ-ve", lirim dhe emërim të disa anëtarëve në KZAZ nr. 72, Qarku Korçë, KZAZ nr. 77, KZAZ nr. 81, KZAZ nr. 82, Qarku Gjirokastër, dhe të sekretarit të KZAZ-së nr. 82, Qarku Gjirokastër.

167 Vendim nr. 14, datë 25.01.2021, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, "Për emërimin e anëtarëve dhe sekretarëve të Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021".

168 KZAZ nr. 59, Fier mungesë në trajnimin e kryer nga KQZ-ja i nënkryetares dhe i një anëtareje të PS-së. KZAZ nr. 73 mungesë e nënkryetarit dhe të një anëtari, si dhe anëtari i PSD-së në KZAZ-në nr. 74. Mungesë e dy anëtarëve në KZAZ-në nr. 11 Kukës për shkaqe shëndetësore.

169 KZAZ nr. 3 dhe nr. 4 Shkodër, KZAZ nr. 6 Vau i Dejës, KZAZ nr. 11 Kukës, KZAZ nr. 12 dhe nr. 13 Lezhë, KZAZ nr. 14 Mirditë, KZAZ nr. 18 Bulqizë, KZAZ nr. 19 Dibër, KZAZ nr. 25 Shijak, KZAZ nr. 26 Vorë, KZAZ nr. 29, 30, 31, 32, 34, 37 Tiranë, KZAZ nr. 47, 48, 49, 50 Elbasan, KZAZ nr. 53 Përrenjas, KZAZ nr. 60 Patos, KZAZ nr. 61 Roskovec, KZAZ nr. 62 Mallakastër, KZAZ nr. 73 dhe nr. 74 Korçë, KZAZ nr. 76 Përmet, KZAZ nr. 80 Gjirokastër, KZAZ nr. 83, 84, 85, 86 Vlorë, KZAZ nr. 88 Himarë.

170 KZAZ nr. 3 Shkodër, KZAZ nr. 6 Vau i Dejës, KZAZ nr. 11 Kukës, KZAZ nr. 12, 13 Lezhë, KZAZ nr. 14 Mirditë, KZAZ nr. 18, Bulqizë, KZAZ nr. 19 Dibër, KZAZ nr. 31, nr. 32, nr. 34, Tiranë, KZAZ nr. 80 Gjirokastër, KZAZ nr. 52 Librazhd, KZAZ nr. 73 Korçë, KZAZ nr. 88 Himarë.

171 KZAZ nr. 19, Dibër, KZAZ nr. 39 Tiranë dhe KZAZ nr. 90 Sarandë mungesë të shenjave dalluese në objektin, ku supozohet të jetë selia e KZAZ-së, gjë që ka vështirësuar edhe punën e vëzhguesve afatgjatë për sigurimin e informacionit të operimit të Komisioneve Zonale të Administrimit Zgjedhor, duke vështirësuar kontaktin me ta.

dhe veprimtarinë e tyre. Në rastin më të mirë u konkludua me ndryshimin e selisë dhe procedimin në kushte normale të punës nga KZAZ-të përkatëse[172]. Nuk munguan edhe rastet ku për shkak të mungesës së një bashkëpunimi funksional nga Bashkitë përkatëse kërkesat u realizuan me shumë vonesë[173]. Gjithashtu u evidentuan raste ku, edhe pse bashkia mori masa për ndryshimin e selive, funksionaliteti i selive të reja të KZAZ-ve vazhdoi të ishte i cenuar[174]. Ndonëse një pjesë e mirë e KZAZ-ve janë shprehur se kanë pasur në dispozicion të gjitha materialet dhe logjistikën e nevojshme, në një pjesë të tyre, vëzhguesit afatgjatë të KRIIK kanë vëzhguar apo janë informuar nga anëtarët e KZAZ-ve për mungesa serioze të bazës materiale[175].

Pavarësisht problematikave, KZAZ-të i përmbushën detyrat e tyre në mënyrë eficiente për sa i përket procesit të administrimit të zgjedhjeve në ZAZ. Megjithatë, nuk mungon nevoja që në aspekte të veçanta të administrimit zgjedhor, të kryhen përmirësime të mëtejshme në drejtim të zëvendësimeve në momentin e fundit dhe trajnimeve të anëtarëve të rinj. Për sa i përket nivelit të eksperiencës në fushën e administrimit zgjedhor apo njohjes së Kodit Zgjedhor janë vënë re dallime të konsiderueshme edhe midis anëtarëve të KZAZ-ve. Në disa raste, procesi zgjedhor është administruar thuajse tërësisht nga kryetarët dhe nënkryetarët, të cilët kanë mbajtur peshën më të madhe në marrjen e vendimeve, falë përvojës dhe komunikimit të vazhdueshëm me KQZ-në. Megjithatë, vlerësohet fryma e bashkëpunimit midis anëtarëve të KZAZ-ve. Komisionerët u kanë raportuar vëzhguesve të KRIIK se kanë pasur akses të barabartë në informacionin e nevojshëm për kryerjen e punës së tyre.

Në raste sporadike janë vërejtur gjithashtu mosnjohje të kuadrit ligjor dhe mungesë transparence ndaj vëzhguesve. Edhe pse sipas Kodit Zgjedhor[176], mbledhjet e KZAZ-së janë publike, në disa raste[177] vëzhguesve të KRIIK nuk u është lejuar të jenë të pranishëm në to, edhe pse të pajisur me një akreditim të lëshuar nga KQZ-ja. Ky problem ka ardhur duke u rritur sidomos me afrimin e ditës së zgjedhjeve. Elementet e mësipërme e kanë vështirësuar punën e vëzhguesve. Pavarësisht se të qenët i angazhuar në një punë tjetër për anëtarët e KZAZ-ve, nuk është diçka e ndaluar shprehimisht nga ligji. Në gjykimin e KRIIK kjo, në praktikë passjell moseficiencë optimale në punën dhe përmbushjen e çdo detyrimi nga anëtarët e KZAZ-ve. Nga monitorimi i vëzhguesve të KRIIK, rezultoi se më shumë sesa 50% e anëtarësisë së KZAZ-ve ishin të punësuar në administratën publike[178], madje edhe në poste drejtuese[179].

Ligji detyron nëpunësit e administratës publike, të cilët angazhohen në Komisionet Zonale të Admin-

172 KZAZ nr. 74 në Qarkun e Korçës ka ndryshuar vendndodhjen si pasojë e mospërmbushjes së kushteve të selisë së KZAZ-së. Për VNV, ZAZ nr. 87 me propozim të Prefektit të Qarkut Vlorë u propozua zhvendosja nga shkolla e mesme "Hajredin Beqari", Selenicë në Palestrën e shkollës 9-vjeçare "Eqerem Beqiri", Kotë, pasi kjo e fundit ofron kushte më të mira.

173 KZAZ nr. 3 dhe nr. 4, Shkodër ka bërë kërkesë për ndryshim të mjedisit si pasojë e kushteve të papërshtatshme, kjo e fundit paraqet si shqetësim mungesën e energjisë elektrike, mungesën e xhamave, internetit dhe të ambientit me lagështirë. KZAZ nr. 32 hyrja në rrugën "Hasan Tasini" dhe pikërisht në klasën ku ndodhet zyra e KZAZ-së, është tejet e ngushtë për marrjen dhe dorëzimin e dokumentacionit për QV-të. Kjo i është parashtruar verbalisht KQZ-së, por deri në datën 12.03.2021 nuk ka pasur asnjë vendim nga këta të fundit. KZAZ nr. 91, Finiq, gjithashtu i ka drejtuar kërkesë Bashkisë Finiq për ndryshim të selisë si pasojë e hapësirës së kufizuar.

174 KZAZ nr. 18 edhe pse ka ndryshuar seli, ka paraqitur probleme me funksionimin, pasi mungonte energjia elektrike, interneti, printeri, telefoni fiks. E njëjta situatë është paraqitur edhe në KZAZ-në nr. 12 në Lezhë, e cila edhe pse ka ndryshuar vendndodhje, mjediset e saj u vendosën në dushet e palestrës së gjimnazit "Hydajet Lezha" në të cilën kanë munguar pajisje, dezinfektantë, maska etj.

175 KZAZ nr. 5 Shkodër mungesë të lidhjes me internet. KZAZ nr. 17, Klos mungesë e lidhjes me internet dhe e kasafortës. KZAZ nr. 31 Tiranë, mungesë e lidhjes me internet, telefonit fiks dhe faks. KZAZ nr. 57 Fier, mungesë të telefonit fiks, celular dhe faks. KZAZ nr. 58 Fier mungesë të telefonit fiks, celular dhe faks. KZAZ nr. 59 Fier mungesë të telefonit fiks dhe celular. KZAZ nr. 60 Patos dhe nr. 61 Roskovec mungesë të telefonit fiks dhe faks. KZAZ nr. 76 Përmet mungesë të telefonit fiks dhe faks. KZAZ nr. 77, Këlcyrë janë raportuar mungesa të bazës materiale, si telefon fiks e celular e kancelari. KZAZ nr. 72 Devoll, mungesë të lidhjes me internet, faks, telefon fiks. KZAZ nr. 78 Memaliaj, mungesë të telefonit fiks dhe faks. KZAZ nr. 79 Tepelenë mungesë të lidhjes me internet. KZAZ nr. 80, Gjirokastër deri më datën 12.03.2021 ka pasur mungesë të plotë të bazës materiale. KZAZ nr. 87 Selenicë mungesë të lidhjes me internet, telefon fiks dhe faks, fotokopje, kompjuter, printer dhe kancelari. KZAZ nr. 88 Himarë mungesë të telefonit fiks, faks dhe kancelari.

176 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 35 "Mbledhjet dhe vendimet e KZAZ-së", pika 1.

177 KZAZ nr. 36, Tiranë, mossigurimi i kopjeve të vendimeve, pasi kryetari i KZAZ-së e konsideronte si shkelje të ligjit. KZAZ nr. 30, Tiranë, edhe pse vëzhguesi është i pajisur me akreditim nga KQZ-ja, kryetari i KZAZ-së kërkon listën e të akredituarve nga KQZ. KZAZ nr. 5, Shkodër refuzim për pjesëmarrjen në mbledhjen e KZAZ-së përkatëse me motivin që krahas akreditimit, anëtarët në mënyrë unanime kërkojnë edhe listën e vëzhguesve të akredituar nga KQZ-ja.

178 P.sh., KZAZ nr. 1 Malësi e Madhe, sekretari i kësaj KZAZ-je mban postin e drejtorit të hipotekës. KZAZ nr. 2 kryetari i kësaj KZAZ-je është njëkohësisht drejtor i shkollës "Kol Idromeno", Shkodër. KZAZ nr. 4, Shkodër sekretari i kësaj KZAZ-je është punonjës në bashkinë Shkodër. KZAZ nr. 54 Lushnjë pesë nga komisionerët janë të punësuar në sektorin publik. KZAZ nr. 29 Tiranë, nënkryetarja e KZAZ-së ka qenë njëkohësisht e punësuar si mësuese. KZAZ nr. 60 Patos, nr. 61 Roskovec dhe 62 Mallakastër, anëtarë të këtyre KZAZ-ve punojnë njëkohësisht në administratën publike. KZAZ nr. 12 Lezhë, nënkryetarja e kësaj KZAZ-je ka qenë njëherësh dhe punonjëse në Bashki. KZAZ nr. 15, Kurbin, kryetarja e kësaj KZAZ-je mban njëherësh dhe postin e drejtores së Ujësjellës Kanalizimeve. KZAZ nr. 74, kryetari i kësaj KZAZ-je mbante postin e drejtorit të OSHEE-së. KZAZ nr. 73, Korçë, anëtari i kësaj KZAZ-je mbante postin e drejtorit të Shëndetit Publik.

179 Nënkryetarja e bashkisë Fier ka qenë njëkohësisht edhe nënkryetare e KZAZ-së nr. 59.

istrimit Zgjedhor që të marrin autorizim nga eprori direkt në institucionin ku ata janë të punësuar. Nga komunikimi zyrtar i KRIIK me Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, rezulton se 159 nëpunës civilë janë angazhuar nëpër KZAZ, nga 736 anëtarë/sekretarë/kryetarë që ishin gjithsej në 92 KZAZ. Ndryshimi i anëtarësisë së KZAZ-ve vijoi të mbetet problem shqetësues edhe në këto zgjedhje. Përgjatë gjithë procesit evidentohet se janë ndërruar rreth 20% e anëtarësisë së KZAZ-ve[180]. Ka pasur raste kur zëvendësimet kanë prekur shumicën dërrmuese të anëtarëve të KZAZ-së përkatëse, si dhe, të zëvendësimeve të nivelit drejtues të KZAZ-së si kryetar, zëvendëskryetar apo sekretar[181]. Problemi bëhet edhe më shqetësues në rastet e zëvendësimeve të kryera afër ditës së zgjedhjeve, madje edhe një ditë para ditës së zgjedhjeve[182], çka pas-solli pamundësi për t'i trajnuar anëtarët e emëruar rishtas. Për më tepër u evidentuan raste të zëvendësimit të anëtarësisë madje edhe kryetarëve së disa KZAZ-ve edhe gjatë ditës së zgjedhjeve dhe procesit të numërimit[183].
Ndër të tjera, tek vëzhguesit e KRIIK u referuan pretendime për ndryshim të herëpashershëm të tre komisionerëve të nivelit të dytë të një subjekti politik[184] për tërheqje si pasojë e presioneve politike. Nuk munguan edhe rastet e ndërrimeve pas evidentimit të konfliktit të interesit.[185]
Gjithashtu, u evidentua një pjesëmarrje që erdhi me intensitet të rritur me afrimin e ditës së zgjedhjeve, të anëtarësisë së KZAZ-ve në fushatën elektorale të partive politike. Pavarësisht se ligji nuk e ndalon në germën e tij, angazhimi aktiv i zyrtarëve zgjedhorë në fushatë, përpos se cenon kohën në dispozicion të angazhimit si komisioner i KZAZ-së, forcon dhe nxit më tej partizanizmin politik në përmbushjen e detyrave ligjore si anëtar i administratës zgjedhore.

IV.2.1. VENDIMMARRJA E KZAZ-ve

Nga kontaktet e vazhdueshme të vëzhguesve të KRIIK, por edhe nga komunikimi me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, është vërejtur një nivel i ulët transparence dhe përgjegjshmërie në lidhje me vendimmarrjen nga ana e anëtarësisë së KZAZ-ve.

Evidentohet se tre KZAZ ende[186] nuk e kanë përmbushur detyrimin ligjor për të përcjellë vendimmarrjen përkatëse në KQZ. Gjithashtu 57 KZAZ[187] nuk kanë marrë asnjë vendim për akreditim vëzhguesish të subjekteve zgjedhore, ndërkohë që në Qendrat e Votimit në zonën përkatëse, apo në ambientet e VNV-së ka pasur vëzhgues të këtyre subjekteve.
Kuadri ligjor nuk e detyron publikimin e vendimeve të KZAZ-ve në internet, në të njëjtën mënyrë si vendimet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, dhe vëzhguesit e KRIIK kanë hasur vështirësi, në një numër KZAZ-sh për të marrë vendimet e tyre.
Publikimi i vendimeve të kryhet në faqen e internetit të KQZ-së dhe/ose të Njësive të Qeverisjes Vendore në territorin e të cilave këto KZAZ janë vendosur, si p.sh., në faqet ueb të Bashkive, Qarkut apo edhe të Prefekturës.
Vendimmarrja e KZAZ-ve para ditës së zgjedhjeve ka qenë e fokusuar në miratimin e anëtarësisë së KQV-ve, GNV-ve dhe akreditimin e vëzhguesve[188]. Gjithashtu, gjatë procesit të numërimit ka pa-

180 Në qasje krahasimore me zgjedhjet e mëparshme vërehet një ulje e përqindjes së anëtarësisë së ndërruar të KZAZ-ve. Në vitin 2013 dhe 2015 masa e lirim-emërimeve në KZAZ ishte 37%, në vitin 2017 zëvendësimet ishin në masën 24,5%, ndërkohë që në 2019-ën, pavarësisht se anëtarësia nuk ishte përfaqësuese e të gjitha forcave politike, zëvendësimet ishin në masën 19%.

181 Për listën e plotë të lirimeve dhe emërimeve në KZAZ shih Shtojcën N.

182 Po aty.

183 Gjatë ditës së zgjedhjeve u zëvendësuan tre anëtarë në dy KZAZ. Gjatë procesit të numërimit u ndërruan tre kryetarë dhe katër anëtarë në shtatë KZAZ. Për më shumë detaje shih Shtojcën N.

184 KZAZ nr. 77, mendohet se ndërrimi i herëpashershëm i tre anëtarëve të subjektit politik LSI ka ardhur si pasojë e presioneve politike.

185 Një anëtar në KZAZ nr. 34, Tiranë është zëvendësuar në datën 24.04.2021 duke qenë se ka pasur marrëdhënie gjinie me kandidatin e një subjekti politik.

186 KZAZ nr.27, KZAZ nr.30, KZAZ nr.40.

187 KZAZ nr.2; KZAZ nr.4; KZAZ nr.5; KZAZ nr.6; KZAZ nr.8; KZAZ nr.10; KZAZ nr.14; KZAZ nr.16; KZAZ nr.17; KZAZ nr.20; KZAZ nr.24; KZAZ nr.28; KZAZ nr.31; KZAZ nr.32; KZAZ nr.34; KZAZ nr.35; KZAZ nr.37; KZAZ nr.39; KZAZ nr.42; KZAZ nr.43; KZAZ nr.44; KZAZ nr.46; KZAZ nr.50; KZAZ nr.53; KZAZ nr.54; KZAZ nr.55; KZAZ nr.56; KZAZ nr.57; KZAZ nr.58; KZAZ nr.59; KZAZ nr.60; KZAZ nr.62; KZAZ nr.63; KZAZ nr.64; KZAZ nr.65; KZAZ nr.67; KZAZ nr.68; KZAZ nr.69; KZAZ nr.70; KZAZ nr.71; KZAZ nr.72; KZAZ nr.73; KZAZ nr.74; KZAZ nr.75; KZAZ nr.76; KZAZ nr.77; KZAZ nr.78; KZAZ nr.82; KZAZ nr.83; KZAZ nr.84; KZAZ nr.85; KZAZ nr.86; KZAZ nr.87; KZAZ nr.88; KZAZ nr.89; KZAZ nr.90; KZAZ nr.91.

188 Nga KZAZ-të, të cilat kanë marrë vendim për vëzhguesit rezulton të jenë akredituar 381 vëzhgues partiakë për vëzhgimin e KZAZ-ve; 7 521 vëzhgues partiakë për vëzhgim në KQV; 1 206 vëzhgues partiakë për vëzhgim në VNV.

sur KZAZ,[189] të cilat kanë marrë vendim për thirrjen e policisë në ambientet e KZAZ-ve dhe VNV-ve. Ndërkohë pas ditës së zgjedhjeve KZAZ-të kanë miratuar tabelat përmbledhëse të rezultateve. Ecuria e ngritjes së Komisioneve të Qendrave të Votimit, nga KZAZ-të, u realizua në tejkalim të afateve ligjore, problem i ardhur si pasojë e vonesave në propozimet e anëtarësisë së tyre nga partitë politike përkatëse[190]. Problem shqetësues i referuar nga vëzhguesit afatgjatë ishin tentativat e KZAZ-ve për të respektuar parimisht[191] afatet ligjore, si dhe për të shmangur ndryshimet e herëpashershme të kandidatëve të KQV-ve dhe GNV-ve. Nga këqyrja e vendimeve të KZAZ-ve vërehet se 17 KZAZ kanë vendime jashtë afatit ligjor[192] për konstituimin e KQV-ve dhe 11 KZAZ[193] kanë marrë vendim jashtë afatit ligjor për konstituimin e GNV-ve.
Gjatë ditës së zgjedhjeve KZAZ-të operuan, përgjithësisht, në mënyrë eficiente dhe u përgjigjën në kohë problematikave të lidhura gjatë votimit. Ndërkohë, procesi i numërimit vuajti nga tejzgjatja dhe zvarritja, veçanërisht gjatë numërimit të votave preferenciale për kandidatët[194]. Komisioneri vendosi sanksione administrative për anëtarët dhe sekretarët e 17 KZAZ-ve[195], me arsyetimin se pavarësisht detyrimit të përcaktuar në Kodin Zgjedhor[196], kishin numëruar më pak se 50% të QV-ve në juridiksionin e tyre deri në orën 22[00] të datës 26 prill 2021.
Ky vendim i Komisionerit vlerësohet pozitivisht në tentativën për të nxitur komisionerët të respektojnë ligjin, në kushtet kur anëtarësia e këtyre KZAZ-ve jo vetëm që nuk kishte miratuar tabelën përmbledhëse, dhe ishte në shkelje të ligjit, por numri i kutive të numëruara ishte më pak se gjysma. Ajo që mbetet problematike në trajtimin e Komisionerit, është trajtimi në mënyrë jo të barabartë të anëtarësisë së KZAZ-ve, duke qenë se u ndëshkuan vetëm ato që deri në afatin e vendosur nga Kodi Zgjedhor, nuk kishin miratuar tabelat përmbledhëse as për gjysmat e QV-ve në juridiksionin e tyre. Ky nuk është një kufi i përcaktuar në ligj, dhe në të njëjtën situatë mosrespektimi të ligjit ishin edhe anëtarësia e pjesës më të madhe të KZAZ-ve të tjera.
Rezulton se anëtarët e vetëm shtatë KZAZ-ve[197] ankimuan vendimet e komisionerit në KAS,

189 KZAZ nr.1 ka kërkuar ndërhyrjen e policisë për shkak se pati një konflikt mes vëzhguesve para fillimit të numërimit të votave; KZAZ nr.22 ka kërkuar ndërhyrjen e policisë për shkak se në VNV ka patur persona të paautorizuar dhe/ose është rrezikuar rendi dhe zhvillimi i rregullt i procesit të numërimit të votave; KZAZ nr.29 ka kërkuar ndërhyrjen e policisë për shkak se në VNV ka patur persona të paautorizuar dhe/ose është rrezikuar rendi dhe zhvillimi i rregullt i procesit të numërimit të votave; KZAZ nr.47 ka kërkuar ndërhyrjen e policisë për shkak pranë VNV-së ndodheshin persona të paautorizuar që flasnin me tone të larta kundrejt numëruesve duke i intimiduar për të quajtur, ose jo, të vlefshme votat.

190 Për më shumë shih pjesën "Konstituimi i Qendrave të Votimit".

191 KZAZ nr. 56 në Divjakë dhe KZAZ-ja nr. 60 në Patos kanë vendosur me marrëveshje moszbardhjen e vendimeve deri në marrjen e kandidaturave finale prej partive politike. Në KZAZ nr. 58 në bashkinë Fier, vendimit të emërimit të tyre i ishin vendosur data dhe firmat përkatëse, por jo emrat e anëtarëve të KQV-ve për t'i vendosur ato në momentin final të emërimit të tyre. Kjo sjellje në përpjekje për respektimin e ligjit në pikëpamje të afatit, por të shkeljes së tij në pikëpamje të firmosjes së një akti pa përmbajtje.

192 KZAZ nr. 2 vendimet për emërimin e anëtarëve të KQV-ve mbajnë datën 06.04.2021; KZAZ nr.5 vendimet për emërimin e anëtarëve të KQV-ve mbajnë datën 05.04.2021; KZAZ nr.6 vendimet për emërimin e anëtarëve të KQV-ve mbajnë datën 05.04.2021; KZAZ nr.11 vendimet për emërimin e anëtarëve të KQV-ve mbajnë datën 11.04.2021); KZAZ nr.36 vendimet për emërimin e anëtarëve të KQV-ve mbajnë datën 06.04.2021; KZAZ nr.39 vendimet për emërimin e anëtarëve të KQV-ve mbajnë datën 07.04.2021; KZAZ nr. 45 vendimet për emërimin e anëtarëve të KQV-ve mbajnë datën 12.04.2021; KZAZ nr.51 vendimet për emërimin e anëtarëve të KQV-ve mbajnë datën 07.04.2021; KZAZ nr.56 vendimet për emërimin e anëtarëve të KQV-ve mbajnë datën 05.04.2021; KZAZ nr.69 vendimet për emërimin e anëtarëve të KQV-ve mbajnë datën 06.04.2021; KZAZ nr.70 vendimet për emërimin e anëtarëve të KQV-ve mbajnë datën 08.04.2021; KZAZ nr.77 vendimet për emërimin e anëtarëve të KQV-ve mbajnë datën 06.04.2021; KZAZ nr.80 vendimet për emërimin e anëtarëve të KQV-ve mbajnë datën 09.04.2021; KZAZ nr.81 vendimet për emërimin e anëtarëve të KQV-ve mbajnë datën 05.04.2021; KZAZ nr.82 vendimet për emërimin e anëtarëve të KQV-ve mbajnë datën 11.04.2021; KZAZ nr.84 vendimet për emërimin e anëtarëve të KQV-ve mbajnë datën 10.04.2021; KZAZ nr.86 vendimet për emërimin e anëtarëve të KQV-ve mbajnë datën 09.04.2021.

193 KZAZ nr.21 vendimet për emërimin e anëtarëve të GNV-ve fillojnë në datën 26.04.2021; KZAZ nr.24 vendimet për emërimin e anëtarëve të GNV-ve fillojnë në datën 25.04.2021; KZAZ nr.28 vendimet për emërimin e anëtarëve të GNV-ve fillojnë në datën 25.04.2021; KZAZ nr.33 vendimet për emërimin e anëtarëve të GNV-ve fillojnë në datën 25.04.2021; KZAZ nr.39 vendimet për emërimin e anëtarëve të GNV-ve fillojnë në datën 19.04.2021; KZAZ nr.45 vendimet për emërimin e anëtarëve të GNV-ve fillojnë në datën 25.04.2021; KZAZ nr.48 vendimet për emërimin e anëtarëve të GNV-ve fillojnë në datën 25.04.2021; KZAZ nr.60 vendimet për emërimin e anëtarëve të GNV-ve fillojnë në datën 16.04.2021; KZAZ nr.86 vendimet për emërimin e anëtarëve të GNV-ve fillojnë në datën 25.04.2021; KZAZ nr.90 vendimet për emërimin e anëtarëve të GNV-ve fillojnë në datën 24.04.2021; KZAZ nr.91 vendimet për emërimin e anëtarëve të GNV-ve fillojnë në datën 22.04.2021.

194 Për më shumë shih seksionin mbi ditën e zgjedhjeve dhe numërimin e votave.

195 KZAZ nr. 20, KZAZ nr. 66, KZAZ nr. 21, KZAZ nr. 22, KZAZ nr. 24, KZAZ nr. 69, KZAZ nr. 70, KZAZ nr. 2, KZAZ nr. 29, KZAZ nr. 34, KZAZ nr. 35, KZAZ nr. 37, KZAZ nr. 38, KZAZ nr. 39, KZAZ nr. 64, KZAZ nr. 41 dhe KZAZ nr. 42.

196 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 119, pika 5, përcakton se procesi i numërimit vazhdon në mënyrë të pandërprerë deri në numërimin e të gjitha kutive të pranuara të rregullta nga ana e KZAZ-së. Procesi i numërimit ndërpritet me vendim të KZAZ-së, vetëm për shkaqe që nuk varen nga administrata zgjedhore dhe që pengojnë procesin normal të numërimit. Referuar nenit 122, pika 1, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, në të cilin përcaktohet se Tabela përmbledhëse e rezultati të zgjedhjeve për zonën e administrimit zgjedhor nxirret nga KZAZ-ja jo më vonë se ora 22:00 e ditës së nesërme të votimit.

197 KZAZ nr. 20, KZAZ nr. 21, KZAZ nr. 2, KZAZ nr. 38, KZAZ nr. 66, KZAZ nr. 22 dhe KZAZ nr. 35.

i cili pas shqyrtimit bashkarisht të ankimimeve vendosi[198] rrëzimin e vendimit të Komisionerit duke hequr sanksionin administrativ në ngarkim të anëtarëve dhe sekretarëve të KZAZ-ve që bënë ankim, por duke nxitur kulturën e pandëshkueshmërisë tek komisionerët dhe relativizimin e kulturës së zbatimit të ligjit prej tyre.
Nëse puna e KZAZ-ve do të gjykohej vetëm prej rezultatit përfundimtar të administrimit të procesit zgjedhor, atëherë mund të thuhet se performanca e KZAZ-ve ishte e kënaqshme. Por nëse do të shihej më në detaj, ditë pas dite e javë pas jave, do të vihej re se puna e tyre ka çaluar jo vetëm në elementë të veçantë të administrimit zgjedhor, por edhe në tërësi.

IV.3. KOMISIONET E QENDRAVE TË VOTIMIT (KQV)

IV.3.1 QENDRAT E VOTIMIT

Procesi i votimit në zgjedhjet e datës 25 prill 2021 u realizua në 5 199 qendra votimi, nga të cilat 4 792 ishin të vendosura në ambiente publike, 387 në ambiente private[199] dhe 20 ishin QV të posaçme[200].
Kodi Zgjedhor përcakton se qendrat e votimit, me sa të jetë e mundur, duhet të vendosen në mjedise publike[201]. Nga një krahasim i raporteve të mjediseve publike/private të qendrave të votimit në dy zgjedhjet e shkuara, vërehet se pas një uljeje të përqindjes së qendrave të ngritura në mjedise private në vitin 2019, në Zgjedhjet e 25 prillit ky proporcion u rrit sërish, duke shkuar në nivele më të larta se ato të vitit 2017.[202]

Tabela 1 - Raport i numrit të qendrave të votimit në mjedise publike, private, dhe të posaçme me dy zgjedhjet e kaluara.

	ZGJEDHJE PARLAMENTARE 2017	ZGJEDHJE LOKALE 2019	ZGJEDHJE PARLAMENTARE 2021
QV në mjedise publike	4 952 (92,4%)	5 063 (93,5%)	4 792 (92,2%)
QV në mjedise private	389 (7,3%)	334 (6,2%)	387 (7,5%)
QV të posaçme	21 (0,4%)	19 (0,4%)	20 (0,4%)
Total QV	**5 362**	**5 416**	**5 199**

Me ndryshimet e Kodit Zgjedhor në korrik të vitit 2020, u rrit kufiri minimal i numrit të votuesve për çdo qendër votimi, nga 200 në 300 zgjedhës[203]. Si pasojë e këtij ndryshimi ligjor numri total i qendrave të votimit u ul me 217 QV në raport me zgjedhjet pararendëse. KRIIK e konsideron rritjen e pragut minimal të zgjedhësve për hapjen e një qendre votimi si një barrierë që i vendoset ushtrimit të së drejtës së votës nga qytetarët, duke i larguar qendrat e votimit nga vendbanimi i qytetarëve, ndërkohë që benefitet e një veprimi të tillë nuk janë të qarta dhe as nuk janë shpjeguar në asnjë rast[204].

198 Vendimi nr. 55, datë 5.05.2021, Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve, "Për shqyrtimin e kërkesave ankimore nr. 27, nr. 28, nr. 29, nr. 30 dhe nr. 31".

199 Aty kur nuk është i mundur objektivisht caktimi i një qendre votimi në ambient publik, KQZ-ja me vendim mund ta caktojë atë në ambient privat pas propozimit nga kryetarët e bashkive përkatëse.

200 Institucionet e posaçme përbëjnë një zonë të veçantë qendre votimi. Qendra e votimit në këto institucione ngrihet kur në të ndodhen më shumë se 15 zgjedhës.

201 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 93, "Vendndodhja e qendrave të votimit, selive të KZAZ-ve dhe Vendeve të Numërimit të Votave", pika 1.

202 Nga arsyetimet e shumë kryetarëve të bashkive që kanë propozuar vendndodhjet e qendrave të votimit, kjo ka ardhur si pasojë e dëmtimit të godinave publike nga tërmeti i nëntorit 2019.

203 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 62, "Caktimi i zonave dhe vendndodhjes së qendrave të votimit" pika 1 "Zona e qendrës së votimit duhet të jetë brenda një territori kompakt dhe të pashkëputur gjeografik dhe numri i zgjedhësve për çdo qendër votimi nuk duhet të jetë më i vogël se 300 dhe më i madh se 1 000 zgjedhës."

204 Në asnjë prej pikave të dokumentacionit shoqërues të projektligjit, as në relacionin shoqërues dhe as në

Vendndodhja e qendrës së votimit, si rregull, caktohet në të njëjtën adresë me atë të zgjedhjeve të fundit, me përjashtim të rastit kur për arsye objektive, kjo nuk është e mundur dhe nuk mund të ndryshojë në 40 ditët e fundit para datës së zgjedhjeve, pra pas datës 16 mars 2021, përveç rasteve kur, për shkak të forcave madhore, ndryshimi autorizohet nga KQZ-ja. Komisioni Rregullator, me Udhëzimin nr.1, datë 05.12.2020[205], caktoi rregullat dhe kriteret që duhet të ndiqeshin në rastet kur kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore i propozon KQZ-së caktimin e vendndodhjes së QV-së në ndërtesë private.
Pavarësisht përcaktimeve ligjore, KQZ-ja vendosi ndryshimin e adresës për 106 qendra votimi, edhe pas datës 16 mars 2021, pas kërkesave të paraqitura prej kryetarëve të bashkive.
Në arsyetimet e paraqitura prej tyre, vërehet se kërkesat për ndryshimin e adresës së QV-ve ishin kryesisht për shkak të sipërfaqes së vogël të QV-së, dëmtimeve nga tërmeti, mosrealizimit në kohë të rikonstruksionit të objektit, apo amortizimit të ambienteve duke mos plotësuar kriteret e duhura për të shërbyer si një qendër votimi.
Kjo situatë ngre pikëpyetje mbi përmbushjen e detyrimit ligjor të parashikuar, nga ana e kryetarëve të bashkive, të cilët nuk kishin kryer në mënyrën e duhur procesin e verifikimit, kontrollit dhe më pas të propozimit në KQZ të ambienteve të përshtatshme për qendra votimi. Gjithashtu, vëzhguesit e KRIIK raportuan në disa bashki[206] problematikën e ekzistencës së qendrave të votimit që nuk përmbushnin kriteret apo standardet për të qenë të tilla.

IV.3.2. KONSTITUIMI I KOMISIONEVE TË QENDRAVE TË VOTIMIT (KQV)

Përbërja e Komisioneve të Qendrave të Votimit është e njëjtë me atë të KZAZ-ve, dhe anëtarët e tyre propozohen nga partitë politike me të njëjtin rregull të formimit të KZAZ-ve nën juridiksionin e të cilave ato ndodhen. Në kushtet kur Partia Socialdemokrate nuk kishte anëtarë në 56 KZAZ, edhe në qendrat e votimit nën juridiksionin e këtyre KZAZ-ve nuk pati anëtarë. Në të dyja komisionet (KZAZ dhe KQV) këta anëtarë u propozuan nga Partia Socialiste.
Konstituimi i KQV-ve është detyrë e KZAZ-ve, pas propozimeve të emrave përkatës nga partitë politike. Ky proces duhet të përmbyllej deri në datën 5 prill 2021. Praktika negative e mosrespektimit të këtij afati ligjor, propozimeve me vonesë nga partitë politike dhe konstituimit të KQV-ve deri në 24 orë para ditës së zgjedhjeve, vijoi edhe në këtë proces. Vërehet se asnjë subjekt zgjedhor nuk e respektoi afatin e dorëzimit të propozimeve për anëtarë të KQV-ve[207] . Përpos mosrespektimit të afatit prej partive politike edhe ndryshimet shumë të shpeshta të anëtarëve të KQV-ve të propozuara vështirësuan ecurinë përgatitore në këtë nivel të administrimit.
Vëzhguesit afatgjatë të KRIIK konstatuan se katër KZAZ[208] i formuan KQV-të vetëm në datën 23 prill 2021[209], por pas këqyrjes së vendimeve vërehet se datat zyrtare të vendimmarrjes janë të ndryshme,[210] por në përmbushje të afatit ligjor.
Për më tepër, Komisionerët e KZAZ-ve, bazuar në eksperiencën e zgjedhjeve të mëparshme me praktikën e vonesave dhe ndërrimeve nga partitë u përpoqën të gjenin forma jokorrekte për të respektuar formalisht afatin ligjor të parashikuar për ngritjen KQV-ve[211].

raportin e Komisionit Parlamentar për Çështjet Ligjore ndryshimi në këtë nen nuk shpjegohet. Shih dokumentacionin shoqërues të projektligjit.

205 Udhëzimi nr.1, datë 05.12.2020, Komisioni Rregullator, "Përcaktimi i rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjes së hartës së njësisë së vetëqeverisjes vendore për zgjedhjet".

206 Bashkia Përmet, Bashkia Mallakastër, Bashkia Shkodër, Bashkia Kamëz, Bashkia Tiranë.

207 PS nuk ka dërguar brenda afateve të përcaktuara nga Kodi Zgjedhor propozimet për anëtarët e KQV-ve në KZAZ nr. 10 në Has, KZAZ nr. 11 në Kukës, KZAZ nr. 13 në Lezhë, KZAZ nr. 25 në Shijak, KZAZ nr. 61 në Roskovec, KZAZ nr. 65 në Berat, KZAZ nr. 78 në Memaliaj. PD-ja nuk i dërgoi brenda afateve të përcaktuara nga Kodi Zgjedhor propozimet për anëtarë të KQV-ve në KZAZ nr. 21, 24, Durrës, KZAZ nr. 52 Librazhd, KZAZ nr. 33 Tiranë, KZAZ nr. 80 Gjirokastër. LSI-ja në KZAZ-të nr. 21 Durrës, KZAZ 52 Librazhd, KZAZ nr. 33, Tiranë, KZAZ nr. 80 Gjirokastër.

208 KZAZ nr. 21 Durrës, KZAZ nr. 24 Durrës, KZAZ nr. 76 Përmet, KZAZ nr. 78 Memaliaj.

209 Ky informacion është mbledhur nëpërmjet bisedave të vëzhguesve të KRIIK me anëtarët e KZAZ-ve, pasi këta të fundit nuk pranonin të vinin në dispozicion të vëzhguesve kopjet përkatëse të vendimeve të KZAZ-së.

210 KZAZ nr. 21 ka marrë vendim për konstituimin e KQV-ve në datën 31.03.2021, KZAZ nr. 24 ka marrë vendim për konstituimin e KQV-ve në datën 03.04.2021, KZAZ nr. 76 ka marrë vendim për konstituimin e KQV-ve në datën 04.04.2021, KZAZ nr. 78 ka marrë vendim për konstituimin e KQV-ve në datën 29.03.2021.

211 Anëtarët e KZAZ-ve janë të ndërgjegjshëm në lidhje me këtë fenomen, madje në KZAZ nr. 58 në bashkinë

Vëzhguesit e KRIIK, gjatë ditës së zgjedhjeve, e vlerësuan përgjithësisht, pozitivisht performancën e komisioneve të qendrave të votimit.

IV.4. VENDET E NUMËRIMIT TË VOTAVE DHE ANËTARËSIA E GRUPEVE TË NUMËRIMIT TË VOTAVE

Procesi i numërimit të votave u realizua në 92 Vende të Numërimit të Votave (VNV) nga Grupet e Numërimit të Votave (GNV) dhe nën mbikëqyrjen e KZAZ-ve.
Vendet e Numërimit të Votave (VNV) u përcaktuan me vendim të Komisionerit[212], në respektim të afateve ligjore[213], pas propozimeve të Prefektëve për adresat që mund të shërbenin si VNV në bashkitë që mbulon qarku përkatës. Nga kontakti i vëzhguesve të KRIIK-ut me 12 Prefekturat, rezulton që tri[214] prej tyre nuk e respektuan afatin ligjor[215] për dorëzimin e propozimeve të adresave që mund të shërbenin si vende të numërimit të votave.
Pavarësisht miratimit të selive në VNV-ve brenda afateve ligjore, për shkak të propozimeve të reja nga Prefektët u krye ndryshimi i adresës së shtatë VNV-ve. Evidentohet se sikurse në rastin e kryetarëve të bashkive për qendrat e votimit, edhe nga disa prefektë[216] nuk kishin kryer në mënyrën e duhur procesin e verifikimit, kontrollit dhe më pas të propozimit në KQZ të ambienteve të përshtatshme për VNV.
Grupet e numërimit të Votave (GNV) përbëhen nga katër anëtarë të propozuar nga partitë politike dhe emëruar nga KZAZ-të[217]. Partitë politike që kishin të drejtë të propozonin anëtarë për GNV ishin Partia Socialiste, Partia Demokratike dhe Partia Lëvizja Socialiste për Integrim. Referuar Kodit Zgjedhor këto parti u miratuan me vendimin e Komisionerit nr. 193, datë 31 mars 2021[218]. Sipas këtij vendimi, partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet, si parti e koalicionit zgjedhor PD-AN nuk legjitimohej të propozojë anëtarin e katërt të GNV-ve, për arsye se të drejtat e saj si subjekt përmbusheshin nga partia udhëheqëse e koalicionit PD-AN (Partia Demokratike). PDIU-ja e ankimoi këtë vendim në KAS dhe Kolegjin Zgjedhor, të cilat lanë në fuqi vendimin e Komisionerit.
Kriteret teknike për caktimin e numrit të Grupeve të Numërimit të Votave për çdo Vend të Numërimit të Votave, dhe rregullat për ndarjen e detyrave midis anëtarëve të grupit të numërimit u specifikuan dhe përcaktuan me vendim nga Komisioni Rregullator. Gjithashtu, edhe manuali i punës së GNV-ve u miratua në mbledhjen publike të Komisionit Rregullator të datës 20 prill 2021. Edhe pse Kodi Zgjedhor[219] përcakton afatin prej dhjetë ditësh përpara ditës së zgjedhjeve për Ngritjen e Grupeve të Numërimit të Votave (GNV) u vërejt, sikurse edhe në proceset e mëparshme zgjedhore, mosrespektim[220] i këtij afati.

Fier, vendimit të emërimit të tyre i është vendosur data dhe firmat përkatëse, por jo emrat e anëtarëve të KQV-ve për t'i vendosur ato në momentin final të emërimit të tyre. Kjo sjellje në përpjekje për respektimin e ligjit në pikëpamje të afatit, por të shkeljes së tij në pikëpamje të firmosjes së një akti pa përmbajtje. Ndërkohë, KZAZ-ja nr. 56 në Divjakë dhe KZAZ-ja nr. 60 në Patos vendosën me marrëveshje moszbardhjen e vendimeve deri në marrjen e kandidaturave finale prej partive politike.

212 Vendim nr. 148, datë 16.03.2021, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, "Për caktimin e Vendeve të Numërimit të Votave për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021."

213 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 94 "Vendndodhja dhe përgatitja e Vendeve të Numërimit të Votave" pika 1.

214 Propozimi i Prefektit të Qarkut Lezhë depozituar në KQZ me shkresën nr. 171/3 datë 26.02.2021; Propozimi i Prefektit të Qarkut Tiranë depozituar në KQZ me shkresën nr. 268/3 datë 9 mars 2021; Propozimi i Prefektit të Qarkut Korçë depozituar në KQZ me shkresën nr. 296/1 datë 18.03.2021.

215 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 94, "Vendndodhja dhe përgatitja e Vendeve të Numërimit të Votave", pika 1.

216 Prefekti i Qarkut Shkodër, Korçë, Durrës, Vlorë, Kukës.

217 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 95 "Ngritja e Grupeve të Numërimit të Votave".

218 Vendim nr. 193, datë 31.03.2021, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, "Partia politike e shumicës parlamentare, që ka të drejtë të propozojë anëtarin e tretë të Grupeve të Numërimit të Votave për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25.04.2021, është Partia Socialiste e Shqipërisë. Partia politike e opozitës parlamentare, që ka të drejtë të propozojë anëtarin e katërt të Grupeve të Numërimit të Votave, për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25.04.2021, është Partia Lëvizja Socialiste për Integrim".

219 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 95, pika 1 "Për numërimin e votave në rang ZAZ-je, me vendim të KZAZ-së, dhjetë ditë para ditës së votimit, caktohen Grupe Numërimi të Votave".

220 KZAZ nr. 21, nr. 22, nr. 68, nr. 24, nr. 32, nr. 60, nr. 66, nr. 67, nr. 81, nr. 26, nr. 33, nr. 39, nr. 40, nr. 90.

Nga komunikimi i vëzhguesve të KRIIK me KZAZ-të, arsyet e vonesës kanë ardhur si pasojë e partive politike, të cilat i kanë sjellë listat me propozimet e kandidatëve pranë skadimit të afateve ligjore ose kanë kërkuar që anëtarët të zëvendësohen pa arsye të motivuara. Përpos vonesës pati edhe raste të emërimit të anëtarëve të GNV-ve, vetëm para pak fillimit të procesit të numërimit, çka e bëri të pamundur trajnimin paraprak të tyre. Në rastin më të mirë trajnimet e anëtarëve të KQV-ve janë kryer nga përfaqësuesit e partive politike, ku nuk kanë munguar rastet ku informacioni i dhënë në minutë të fundit ka qenë kontradiktor[221] me atë të manualeve të përdorura nga trajnerët e KQZ-së.
Legjislacioni duhet të konsiderojë kufizimin e së drejtës së partive politike për të ndërruar komisionerët e qendrave të votimit dhe anëtarët e grupeve të numërimit të votave në mënyrë të pamotivuar dhe në prag të ditës së zgjedhjeve, pasi kjo gjë pengon trajnimin zyrtar, dhe rrjedhimisht ndikon drejtpërdrejt në efikasitetin e këtyre komisioneve.
Formimi i komisioneve zgjedhore të niveleve më të ulëta jo vetëm që duhet të ndjekë në mënyrë rigoroze afatet ligjore të përcaktuara për krijimin e tyre, por duhet të parashikohen mekanizma, të cilët të zgjidhin problematikat kur respektimi i afateve ligjore nuk zbatohet nga ana e partive politike.

V. REGJISTRIMI I ZGJEDHËSVE

Të drejtën e votës e kanë të gjithë shtetasit që deri në ditën e zgjedhjeve kanë mbushur moshën 18 vjeç, me përjashtim të rasteve kur kjo e drejtë u është hequr me një vendim gjykate, për shkak të ligjit të Dekriminalizimit apo shpalljes së pazotësisë juridike për të vepruar. Regjistrimi i zgjedhësve është pasiv, me përjashtim të shtetasve që kanë mbushur moshën 100 vjeç, të cilët duhet të bëjnë kërkesë për t'u përfshirë në listën e zgjedhësve.
Kufizimi i së drejtës së votës për personat me çrregullime të shëndetit mendor, qoftë edhe nëpërmjet një vendimi gjykate, konsiderohet nga KRIIK të jetë në kundërshtim me detyrimet ndërkombëtare të shtetit shqiptar[222].
Eliminimi *a priori* nga lista e zgjedhësve e shtetasve mbi 100 vjeç konsiderohet gjithashtu si një shkelje e së drejtës së tyre për të zgjedhur dhe diskriminim moshor, pasi këta zgjedhës trajtohen ndryshe nga zgjedhësit e tjerë (u kërkohet regjistrimi aktiv, ndryshe nga shtetasit e tjerë). Pavarësisht se kjo masë lehtëson pastrimin e listës së zgjedhësve nga personat që nuk jetojnë më, KRIIK gjykon se shteti duhet të parashikojë mekanizma të tjerë që arrijnë të njëjtin efekt, duke shmangur diskriminimin e shtetasve bazuar në kritere moshore arbitrare.
Numri total i shtetasve shqiptarë me të drejtë vote për zgjedhjet e datës 25 prill 2021, sipas listës përfundimtare të zgjedhësve ishte 3 588 869, nga të cilët 1 812 442 (50,5%) meshkuj dhe 1 776 427 (49,5%) femra.
Ligji nr. 138/2015[223], apo i ashtuquajturi Ligji i Dekriminalizimit, dhe Udhëzimi i Ministrit të Brendshëm[224], parashikojnë që DPGJC-ja në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, duhet të evidentojnë dhe heqin nga lista e zgjedhësve shtetasit, të cilët janë duke vuajtur dënimin për vepra penale të referuara në këtë ligj. Numri i shtetasve, të cilët nuk u përfshinë në lista për këto zgjedhje, në referim të këtij ligji, ishte 1 098 shtetas.

V.1. HARTIMI I LISTAVE TË ZGJEDHËSVE

Hartimi dhe publikimi i ekstrakteve të përbërësve zgjedhorë, realizohet nëpërmjet një procesi në të cilin përfshihen Ministri i Brendshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (DPGJC), bashkitë, si dhe Zyrat e Gjendjes Civile (ZGJC) në çdo bashki. Ministria e Brendshme nëpërmjet

221 Në trajnimin e grupeve të numërimit në KZAZ nr. 89 Delvinë nga numërues të një subjekti politik u tha se fletët e pavlefshme nuk duhet të tregohen në monitor, gjë që u kundërshtua më pas nga trajnuesja.

222 Neni 29 i Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara ngarkon shtetet anëtare me detyrimin për t'u garantuar personave me aftësi të kufizuara të drejtat politike dhe mundësinë për t'i gëzuar ato njësoj me të tjerët.

223 Ligji nr. 138, datë 17.12.2015, Kuvendi i Shqipërisë, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

224 Udhëzimi Nr. 225, datë 11.05.2016, Ministri i Brendshëm "Për procedurat e pezullimit nga lista e zgjedhësve për shtetasit që vuajnë dënimin e parashikuar nga Ligji" Nr.138/2015 "Për garantimin e personave që zgjidhen, emërohen dhe ushtrojnë funksione publike".

Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile është institucioni përgjegjës për hartimin dhe publikimin e listave të zgjedhësve, sipas të dhënave të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGJC), që është baza e të dhënave ku ruhen, administrohen dhe përpunohen përbërësit zgjedhorë të shtetasve shqiptarë.
Konform detyrimeve të parashikuara nga Kodi Zgjedhor, katër ditë pas dekretimit të datës së zgjedhjeve prej Presidentit të Republikës, më datë 10 shtator 2020, Ministri i Brendshëm nxori Udhëzimin "Për procedurat e hartimit të listave të zgjedhësve për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë"[225]. Në bazë të këtij udhëzimi dhe përcaktimeve të parashikuara në Kodin Zgjedhor[226] u organizua dhe realizua procesi i publikimit ciklik të listave të zgjedhësve dhe, për aq sa u realizua, procesi i njoftimit me shkrim të shtetasve për qendrën e votimit.
Gjatë procesit të hartimit dhe publikimit të ekstrakteve të listave të zgjedhësve, pati një ecuri të ndryshimit të zgjedhësve në lista[227] që konsiderohet normale për periudhën kohore që përfshin publikimi i gjashtë ekstrakteve.
Në dhjetor të vitit 2018, DPGJC-ja nisi procesin e përditësimit apo migrimit të adresave të shtetasve në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile. Ky proces u realizua pa ndonjë bazë ligjore të bërë publike nga Ministria e Brendshme apo DPGJC-ja, pavarësisht se nga komunikimet zyrtare me institucionin, verbalisht u njoftua se ka një urdhër të Ministrit të Brendshëm, i cili bazohet në një VKM, por pa qartësuar numrin e VKM-së apo referuar ndonjë bazë tjetër ligjore, edhe pse janë bërë disa herë kërkesa zyrare.
Gjithashtu, nga komunikimi me Ministrinë e Brendshme, referohet se projekti "Popullimi", i cili u realizua në vitet 2016-2017 dhe që kishte synim identifikimin e adresës reale të shtetasve, u realizua nga Operatori për Shpërndarjen e Energjisë Elektrike (OSHEE) në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme. Të dhënat e mbledhura nga ky projekt i shumëdiskutuar publikisht për mungesën e transparencës dhe një sërë elementësh të tjerë, u migruan në RKGJC për të bërë saktësimin e adresës së banimit të shtetasve. Por, pavarësisht migrimit të të dhënave në sistem, qendra e votimit të shtetasve (lista e zgjedhësve me qendrat përkatëse të votimit), sipas MB nuk ndryshoi, çka përbën një situatë absurde, pasi qendra e votimit lidhet drejtpërdrejt me adresën e banimit të shtetasit.
Nga gjithë sa më sipër, por edhe referuar komunikimit verbal me zyrtarë të DPGJC-së, rezultoi se ky institucion mund të konsiderohet se punoi me "dy baza të dhënash" të RKGJC-së paralelisht, në kuptimin e gjenerimit automatik të listës së zgjedhësve. "Një databazë" e cila gjeneron Listën e mëparshme të Zgjedhësve, ku shtetasi figuron votues në QV-në ku kishte votuar në zgjedhjet pararendëse dhe "një databazë" nga e cila po të gjenerosh dokumentat e gjendjes civile të shtetasit, me gjasë ai figuron në një adresë banimi të ndryshme, nga ajo e Listës së Zgjedhësve, adresë e cila është migruar aty nga projekti i "Popullimit".

Ndërkohë, Kodi Zgjedhor përcakton qartë se lista e zgjedhësve[228] gjenerohet automatikisht nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile, i cili është vetëm një, në kuptim të ligjit, pra vetëm më një adresë kryesore banimi. Tërë sa më sipër, konsiderohet një qasje e nxituar prej zyrtarëve të MB dhe DPGJC për të zgjidhur problemin e adresave të shtetasve, një problem madhor ky në vite, por duke ndërmarrë një proces pa një bazë të saktë, të qartë dhe të rregullt ligjore.
Numri i shtetasve me të drejtë vote, të cilët referuar "dy bazave të të dhënave të mësipërme" kanë adresë të qendrës së votimit, jo në territorin e vendbanimit[229] të tyre ishte 39 243[230] zgjedhës[231].
Gjatë muajit tetor 2020 u transmetuan në media[232] disa denoncime nga qytetarë për ndry-

225 Udhëzim nr. 298 datë 10.09.2020, Ministri i Brendshëm "Për procedurat e hartimit të listave të zgjedhësve për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë".

226 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Pjesa III, "Zgjedhësit dhe përgatitja e listës së zgjedhësve".

227 Për më shumë mbi ecurinë e të dhënave statistikore në publikimin e ekstrakteve të përbërësve zgjedhorë shih Shtojcën K "Ecuria e të dhënave statistikore të Listës së Zgjedhësve".

228 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 47 "Përputhshmëria me RKGjC".

229 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 46 "Lista e zgjedhësve", pika 1.

230 Pavarësisht se burimi i të dhënave është DPGJC-ja, ky numër nuk përputhet me atë të deklaruar nga auditi teknicien, i cili në raportin e tij referon 46 666 zgjedhës të tillë.

231 Ky numër zgjedhësish u referohet të dhënave të DPGJC-së, dhe në këtë kategori përfshihen *votues në QV të veçanta, familjarët e tyre, pasi nëse një nga familjarët e ka kodin ndryshe nga të tjerët, numërohet e gjithë familja, si dhe shtetasit me kode QV-sh 777, 888 dhe 999 dhe anëtarët e familjeve të tyre.*

232 BOOM zbulon skandalin me listat e votuesve: Qeveria po zhvendos votuesit e opozitës nga QV pa dijeninë e tyre – 28 shtator 2020.

shime të paautorizuara prej tyre të adresës së vendbanimit. Lidhur me këtë problematikë pati prononcime publike nga ish-Ministri i Brendshëm z. Sandër Lleshaj[233], Drejtori i Përgjithshëm i Gjendjes Civile z. Bledar Doracaj[234] dhe zyrtarë të tjerë, si dhe njoftimet përkatëse në faqen zyrtare të internetit të Ministrisë së Brendshme[235].

KRIIK nëpërmjet një deklarate publike[236] i bëri thirrje institucionit të Ministrisë së Brendshme për të bërë transparencë lidhur me procesin e migrimit të shtetasve, dhe gjithë procedurat e ndjekura në funksion të hartimit dhe publikimit të ekstrakteve zgjedhore. Në Deklaratë u sollën edhe elemente të tjerë të procesit të hartimit të listës së zgjedhësve, me synim adresimin e disa problematikave të evidentuara në vazhdimësi në proceset zgjedhore të mëparshme.
Një element që, sikurse edhe në proceset e mëparshme zgjedhore, vijoi të mbetet problem është zëvendësimi i kodeve të banimit 000, 888, 999 në listën e zgjedhësve me adresa banimi. Ky ka qenë një numër që në vijimësi ka ardhur duke u ulur, por i konsideruar si i realizuar jo konform kuadrit ligjor, sipas auditëve teknicienë të emëruar nga KQZ-ja. Madje, prej tyre janë sjellë shembuj se këto adresa me kode të panjohura janë zëvendësuar dhe vendosur nëpër adresa fiktive, si lulishte, objekte shtetërore të ndryshme, etj, në kuadër të saktësimit të përbërësve zgjedhorë për Zgjedhjet Lokale të 30 qershorit 2019, kur u shënua një reduktim drastik i numrit të këtyre adresave me kod të panjohur, nga rreth 280 mijë në rreth një mijë adresa[237].

Kjo problematikë është evidentuar edhe prej njërit prej auditëve teknicienë[238] të kontraktuar nga KQZ-ja edhe për këto zgjedhje. Sipas tij, vijoi të ishte e pranishme problematika e vënies së kodeve fiktive të vendbanimit tek shtetasit që kishin adresë me kod banimi të panjohur. Lidhur me ecurinë e të dhënave mbi këtë çështje, auditi teknicien ka kërkuar informacion nga DPGJC-ja në lidhje me emrin e përdoruesit të ZGJC-së që ka kryer veprimin e ndryshimit të adresës në sistem, por, sipas auditit, përgjigjet nga DPGJC-ja kanë qenë jo të sakta dhe evazive, çka nuk ka lejuar investigim të plotë[239] të çështjes.

V.2. NJOFTIMI I ZGJEDHËSVE MBI PRANINË NË LISTË DHE QENDRËN PËRKATËSE TË VOTIMIT

Zgjedhësit mund të informohen mbi qendrën përkatëse të votimit në disa mënyra, përfshi publikimin ciklik të listave të zgjedhësve fizikisht në mjedise me hyrje të lirë për publikun (që realizohet nga bashkitë sipas listave të përkohshme të publikuara nga zyrat e gjendjes civile në çdo bashki); njoftimin me shkrim të zgjedhësve në vendbanimin e tyre (i cili realizohet nga bashkitë me fonde të alokuara nga Ministria e Brendshme), si dhe nëpërmjet kontrollit të listës elektronike të zgjedhësve, e cila publikohet në internet. Gjatë këtij procesi 6 mujor mund të bëhet korrigjimi i përbërësve zgjedhorë apo i pasaktësive që mund të figurojnë në listën e zgjedhësve mbi të dhënat e

BOOM – Thellohet skandali i zhvendosjeve, Njësia 4 në Tiranë 'ndan' çiftin, burri shkon në Korçë dhe gruaja te Njësia 7, 29 shtator 2020.
BOOM sjell të tjera dëshmi: Familja me banim në Tiranë zhvendoset në Dibër - 01 tetor 2020.

233 Intervistë e Ministrit të Brendshëm z. Sandër Lleshaj, datë 02.10.2020 për emisionin "Real Story" në RTV "News24", . Real Story/ E "kërcënuan" me padi, Lleshaj sfidon PD-në: Qesharake! Le të shkojnë në Prokurori...

234 Gabimi me adresat, Doracaj: S'ka ndryshim vendbanimesh, s'do ketë probleme për zgjedhjet. Intervistë e z. Bledar Doracaj për emisionin *Ilva Noë* në TV *EuroNews Albania*, datë 29.09.2020.

235 Deklaratë e ministrit Lleshaj, datë 29.09.2020: Në Shqipëri po zbatohet projekti për sistemin funksional të adresave, nuk ka asnjë lloj ndryshimi të qendrave të votimit për qytetarët. Reagim i ministrit të Brendshëm Sandër Lleshaj, pas deklaratave të opozitës "Asnjë ndryshim nuk po ndodh, nuk do të ndodhë dhe nuk mund të ndodhë me qendrat e votimit – Të gjithë kanë nevojë të kenë një adresë".

236 KRIIK Albania, Qëndrim Publik, tetor 2020 "Ministria e Brendshme të bëjë transparencë të plotë, në mënyrë periodike, mbi tërë procesin e hartimit dhe saktësimit të listës së zgjedhësve."

237 Shih Kapitullin "VIII. Listat e Zgjedhëve" fq. 83-91; Seksionin "VI.2. Ministria e Brendshme" fq. 64-64; si dhe Seksionin "VI.4. Bashkitë" fq. 66-67; tek Raporti i Monitorimit "Sjellja ligjore dhe institucionale e institucioneve dhe aktorëve të përfshirë në procesin zgjedhor të 30 qershorit 2019", (periudha e monitorimit Nëntor 2018 - Shkurt 2020), publikuar nga KRIIK në Qershor 2020.

238 "Raport përfundimtar i audituesit mbi verifikimin e veprimeve në bazën e të dhënave të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile, Roland Kërçuku, f. 12. i audituesit mbi verifikimin e veprimeve në bazën e të dhënave të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile, Roland Kërçuku, f. 12.

239 Raporti i audituesit Roland Kërçuku mbi verifikimin e veprimeve në bazën e të dhënave të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile, dt. 24.02.2021, f. 10.

shtetasve, duke shkuar pranë zyrave të gjendjes civile të zonës së banimit të tyre.
Pas publikimit të Listës Përfundimtare të Zgjedhësve, në rast evidentimi të pasaktësive apo nevoje për ndryshim të përbërësve zgjedhorë, zgjedhësit mund t'i drejtohen gjykatës për saktësimet/ndryshimet përkatëse, në mënyrë që të ushtrojnë të drejtën e votës[240].
KRIIK ka pasur komunikim zyrtar me 22 gjykatat e rrethit gjyqësor në Shqipëri, 11 prej të cilave[241] kanë konfirmuar 271 kërkesa të paraqitura nga zgjedhësit për ndryshime në përbërësit e ekstrakteve zgjedhore, nga të cilat së paku 93 janë kryer nga persona që janë duke vuajtur dënime në IEVP.

I.2.1. PUBLIKIMI CIKLIK I LISTAVE TË ZGJEDHËSVE

Sipas Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm[242], gjashtë ekstrakte të listës së zgjedhësve duhet të ishin hartuar dhe publikuar, duke filluar me publikimin e ekstraktit të parë në datën 6 tetor 2020, dhe duke konkluduar me publikimin e listës përfundimtare të zgjedhësve në datën 5 mars 2021[243]. Publikimi duhet të kryhej në mjediset e zyrave të gjendjes civile ose në mjediset pranë tyre me akses të lirë për publikun, në mënyrë që të mund të konsultoheshin dhe kontrolloheshin nga vetë shtetasit, pa asnjë kufizim.

Nga vëzhgimi josistematik i aktivistëve të KRIIK përgjatë periudhës tetor, nëntor, dhjetor, disa bashki[244] patën probleme me publikimin e ekstrakteve në këta muaj. Këto probleme konsistonin në publikimin me vonesë[245] të ekstrakteve të përbërësve zgjedhorë apo edhe mospublikim[246] të tyre në vende të përshtatshme dhe që përmbushin kriteret ligjore, në disa raste.
Lista përfundimtare e zgjedhësve u gjenerua nga DPGJC-ja në datën 15 mars 2021, konform afateve kohore të vendosura në ligj. Por, edhe në ditët e fundit të muajit mars disa bashki[247] referuan tek vëzhguesit afatgjatë të KRIIK, që listat ende nuk ishin printuar e publikuar.

V.2.2. NJOFTIMI ME SHKRIM I ZGJEDHËSVE

Ligji parashikon edhe njoftimin me shkrim të zgjedhësve në vendbanimin e tij, në lidhje me qendrën e votimit në të cilin ata duhet të votojnë; një proces mjaft i rëndësishëm për saktësimin e të dhënave të qytetarëve në listat e zgjedhësve, i cili duhet të kryhet brenda 60 ditëve[248] nga shpallja e ditës së zgjedhjeve[249].
Edhe më tepër rëndësi merrte ky proces në këto zgjedhje, duke qenë se 54 242 zgjedhësve iu ndryshua adresa e qendrës së votimit si rrjedhojë e shkrirjes së 400 QV-ve për shkak të numrit më të ulët të zgjedhësve se kufiri minimal prej 300 zgjedhës për QV.
Ky proces realizohet nga Bashkia, nëpërmjet një fondi të veçantë, i cili alokohet nga Ministria e

240 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 57. "Vendimet gjyqësore pas hartimit të listës së zgjedhësve" (Ndryshuar me ligjin nr.74/2012, datë 19.07.2012).

241 Gjykata e Rrethit Gjyqësor: Berat, Fier, Korçë, Krujë, Lezhë, Pukë, Sarandë, Shkodër, Tiranë, Tropojë, Vlorë.

242 Udhëzim nr. 298, datë 10.09.2020, Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, "Për procedurat e hartimit të listave të zgjedhësve për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë".

243 Gjithsej gjashtë ekstrakte: 6 tetor 2020, 5 nëntor 2020, 5 dhjetor 2020, 4 janar 2021, 3 shkurt 2021, dhe 5 mars 2021 (lista finale).

244 Bashkia Gjirokastër, Bashkia Elbasan, Bashkia Peqin, Bashkia Shkodër, Bashkia Berat, Bashkia Këlcyrë, Bashkia Durrës etj.

245 Në bashkinë Gjirokastër nga vizita e kryer më datë 12.03.2021 u konstatua se afishimi i listave me përbërësit zgjedhorë mban datën 31.01.2021. Gjatë vizitës së datës 15.03.2021 afishimi i listave mbante datën 31.01.2021 në zyrën e Gjendjes Civile, Fier.

246 Bashkia Durrës, Bashkia Fier, Bashkia Vlorë dhe Bashkia Tiranë.

247 Në ditët e fundit të muajit mars, bashkitë Dropull, Libohovë dhe Gjirokastër nuk kanë dalë ende listat përfundimtare. Në Bashkitë Bulqizë, Dibër, Mat dhe Klos, listat janë printuar, por nuk janë dorëzuar ende në KZAZ pasi nuk ka përfunduar procesi i firmosjes nga kryetarët.
Në KZAZ nr. 5 Bashkia Shkodër është konstatuar problem me dorëzimin e listave përfundimtare të zgjedhësve në KZAZ, pasi bashkia ka dorëzuar vetëm dy kopje nga tri që parashikon ligji. Kjo ka sjellë mospranim të listave nga KZAZ-ja dhe zvarritje të këtij procesi.

248 Njoftimi përfshin periudhën nga data 6 tetorit deri më 5 dhjetor 2020 për këto zgjedhje.

249 Njoftimi përmban "qendrën e votimit, vendndodhjen dhe adresën e saj, si dhe numrin rendor të zgjedhësit në listën e zgjedhësve të qendrës së tij të votimit".

Brendshme. Kjo e fundit gjeneron edhe modelin e formës që duhet të përdoret për njoftimin. Fondi prej 14 435 000 lekë iu alokua bashkive në datën 22 tetor 2020. Ky fond u lëvrua nëpër bashki duke filluar nga data 22 tetor 2020.

Nga komunikimi zyrtar i KRIIK me 61 bashkitë në vend, disa[250] prej tyre në përgjigje zyrtare në muajt dhjetor dhe janar, konfirmuan se fondi nuk ishte lëvruar ende, ndërsa disa të tjera referuan shifra të ndryshme nga Ministria e Brendshme[251] në lidhje me shumën e alokuar[252].

Lidhur me ecurinë e procesit të njoftimit me shkrim të zgjedhësve, Ministria nuk bëri asnjë njoftim, qëndrim apo deklaratë publike.

Edhe përgjatë këtyre zgjedhjeve, njoftimi me shkrim i zgjedhësve vuajti nga të njëjtat problematika që e kanë shoqëruar në procese të mëparshme zgjedhore. Problematika që nisin nga mënyra se si modeli i njoftimit u hartua, progresi i tij në terren, mungesa e informacionit të besueshëm në lidhje me realizimin e procesit dhe informacionet kontradiktore të mbledhura nga vëzhguesit e KRIIK dhe nga Bashkitë në drejtim të Ministrisë apo Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Duke nisur nga dokumentacioni i përdorur, u vërejt se modeli i njoftimit me shkrim të miratuar[253] nuk përmbante hapësirë të dedikuar për t'u firmosur nga qytetari që njoftohet në mënyrë që ai të konfirmojë (duke nënshkruar) marrjen e njoftimit me shkrim, sikundër kërkohet nga Kodi Zgjedhor[254].

Gjithashtu, udhëzimi nuk parashikonte në përmbajtje të tij asnjë mekanizëm për llogaridhënie të kryetarëve të bashkive mbi procesin e njoftimit me shkrim[255] të zgjedhësve në bashkitë përkatëse.

Udhëzimi i Ministrit të Brendshëm nuk përmbante asnjë orientim lidhur me mënyrën e menaxhimit të fondit[256] dhe kohën e lëvrimit të tij ndaj bashkive për kryerjen e procesit të njoftimit me shkrim të zgjedhësve.

Sipas komunikimit të KRIIK me Ministrinë e Brendshme[257], gjenerimi i modelit për njoftimin me shkrim është kryer më datën 30 nëntor, çka nuk lejonte kohë të mjaftueshme që bashkitë ta kryenin këtë proces brenda afatit të përcaktuar në ligj. Procesi i njoftimit me shkrim të zgjedhësve duhet të kishte përfunduar brenda datës 6 dhjetor 2020.

KRIIK i është drejtuar me kërkesë zyrtare 61 bashkive në vend, në muajin nëntor 2020, duke kërkuar informacion në lidhje me ecurinë e procesit.

Përpos problematikës të moskthimit të përgjigjes nga ana e disa bashkive[258], në disa raste

250 Bashkia Gramsh, në përgjigjen zyrtare ndaj KRIIK me nr. 4598/1 prot. datë 02.12.2020 referon: "Nuk është alokuar akoma fondi" prej Ministrisë së Brendshme.
Bashkia Dropull, në përgjigjen zyrtare ndaj KRIIK me nr. 151 prot. datë 26.01.2020 referon: "Fondi nga Ministria e Punëve të Brendshme nuk është realizuar".
Bashkia Memaliaj, në përgjigjen zyrtare ndaj KRIIK me nr. 1884/1 prot. datë 22.01.2021 referon se "nuk u realizua lëvrimi i fondit për shkak të pandemisë, pasi punonjësit përgjegjës kanë qenë të infektuar me Covid 19".
Bashkia Kukës, në përgjigjen zyrtare ndaj KRIIK me nr. 5959/1 prot. datë 02.12.2020 referon se "...deri tani nuk është kryer procesi i lajmërimit të zgjedhësve për arsye të akordimit të fondit nga Ministria e linjës që mbulon shërbimin e gjendjes civile."

251 Shkresa nr. 592/1 prot. datë 02.02.2021, me objekt "Kthim përgjigjeje" ndaj kërkesës së KRIIK drejtuar Ministrisë së Brendshme me nr. 2012/80M datë 28.12.2020 me objekt "Kërkesë për informacion".

252 Bashkia Dibër, Ministria e Brendshme referon se shpërblimi ndaj kësaj bashkie është 230 000 lekë, ndërkohë që vetë bashkia në përgjigjen zyrtare ndaj KRIIK me nr. 4504/1 prot. datë 15.12.2020 referon se shuma e akorduar nga Ministria e Brendshme është 1 205 000 lekë.
Bashkia Tepelenë, Ministria e Brendshme referon se shpërblimi ndaj kësaj bashkie është 51 000 lekë, ndërkohë që vetë bashkia në përgjigjen zyrtare ndaj KRIIK nëpërmjet e-mail në datën 24 dhjetor 2020 referon se shuma e akorduar nga Ministria e Brendshme është 156 000 lekë.
Bashkia Kamëz, Ministria e Brendshme referon se shpërblimi ndaj kësaj bashkie është 414 000 lek, ndërkohë që vetë bashkia në përgjigjen zyrtare ndaj KRIIK me nr. 9647/1 prot. datë 15.01.2021 referon se shuma e akorduar nga Ministria e Brendshme është 423 529 lekë.

253 Shih Udhëzimin nr. 298 të Ministrit të Brendshëm (cit.).

254 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 52 "Njoftimi me shkrim i zgjedhësve", pika 4 "Personat e ngarkuar me njoftimin e zgjedhësve i dorëzojnë njoftimin zgjedhësit personalisht ose, në mungesë të zgjedhësit, një anëtari madhor të familjes së tij, që gjendet në banesën e zgjedhësit, i cili firmos për marrjen e njoftimit. ..."

255 Po aty, pika 4 "... Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore raporton për përmbushjen e këtij detyrimi, sipas udhëzimit të ministrit që mbulon shërbimin e gjendjes civile".

256 Po aty.

257 Komunikim verbal me Drejtuesin e Drejtorisë së Sistemeve Informatike në Ministrinë e Brendshme.

258 Bashkia Cërrik, Bashkia Fier, Bashkia Kavajë, Bashkia Këlcyrë, Bashkia Klos, Bashkia Maliq, Bashkia Vorë, nuk

vërehet edhe mosnjohje e kuadrit ligjor, për rrjedhojë edhe e detyrimeve ligjore të institucionit.

Nga përgjigjet zyrtare të kthyera, konfirmohej se ky proces kishte filluar të realizohej vetëm në dymbëdhjetë bashki[259] në muajin nëntor, në 27 bashki[260] në muajin dhjetor dhe janar, ndërkohë që 12 bashki[261] referuan se nuk e kishin filluar ende këtë proces, pavarësisht se data e kthimit të përgjigjes ishte muaji dhjetor 2020 apo janar 2021.

Vëzhguesit afatgjatë të KRIIK raportuan gjithashtu problematika në lidhje me realizimin e këtij procesi[262]. Disa bashki referuan vështirësi për të realizuar njoftimin si pasojë e gabimeve në adresat[263] e vendbanimit të qytetarëve, për shkak të distancave të largëta që mund të mbulojnë bashki të caktuara ose për shkak të mungesave të njëpasnjëshme të punonjësve si shkak i infektimit me Covid-19.

Në lidhje me realizimin e këtij detyrimi ligjor, kryetarët e bashkive, duhet të raportojnë pranë Ministrisë së Brendshme[264] dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve[265].

Nga komunikimi zyrtar i KRIIK me Ministrinë e Brendshme, deri në datën 2 shkurt 2021 në këtë ministri nuk ka pasur raportim prej kryetarëve të bashkive. Ndërkohë nga komunikimi verbal, sipas të dhënave që disponon kjo ministri, vetëm 23 bashki e përdorën fondin për njoftimin me shkrim të zgjedhësve, 16 bashki nuk e përdorën, ndërsa për 22 bashki MB-ja nuk ka asnjë informacion. Gjithashtu, MB-ja pohon se raportimi i kryetarëve të bashkive mbi këtë proces në MB ka qenë thuajse inekzistent.

Sa i përket raportimit në KQZ, kjo e fundit nëpërmjet komunikimit zyrtar me KRIIK konfirmoi se raportuan pranë saj vetëm nëntë bashki[266] .

V.3. ZGJATJA E AFATIT TË VLEFSHMËRISË SË DOKUMENTEVE TË IDENTIFIKIMIT

Pasja e një dokumenti të vlefshëm identifikimi biometrik përbën domosdoshmëri për të ushtruar të drejtën e votës[267]. U evidentua në vazhdimësi nga institucionet vendase që numri i shtetasve shqiptarë me të drejtë vote, të cilët nuk kishin një dokument identifikimi brenda afatit të vlefshmërisë ishte shumë i lartë[268]. Në funksion të situatës së krijuar, gjatë muajve janar-mars 2021, Ministria e Brendshme nëpërmjet Drejtorit të Përgjithshëm të DPGJC-së ndërmori një fushatë informimi dhe ndërgjegjësimi në disa bashki të vendit, për t'u bërë thirrje të gjithë qytetarëve, të cilët zotëronin një dokument identifikimi të pavlefshëm, të aplikonin për rinovimin e tij. Pavarësisht se ky numër erdhi në ulje, sërish vazhdoi të mbetej i lartë.

Ky shqetësim u ngrit edhe nga dy anëtarë të Komisionit Rregullator, gjatë dy mbledhjeve të

kanë kthyer ende përgjigje edhe pas disa kontakteve me KRIIK në funksion të kthimit të përgjigjes.

259 Bashkia Mallakastër, Bashkia Libohovë, Bashkia Konispol, Bashkia Kolonjë, Bashkia Memaliaj, Bashkia Tropojë, Bashkia Vlorë, Bashkia Vau Dejës, Bashkia Bulqizë, Bashkia Divjakë, Bashkia Gjirokastër, Bashkia Mat.

260 Bashkia Pukë, Bashkia Korçë, Bashkia Delvinë, Bashkia Pustec, Bashkia Elbasan, Bashkia Durrës, Bashkia Dropull, Bashkia Gramsh, Bashkia Devoll, Bashkia Kuçovë, Bashkia Tiranë, Bashkia Himarë, Bashkia Ura Vajgurore, Bashkia Shijak, Bashkia Krujë, Bashkia Roskovec, Bashkia Fushë-Arrës, Bashkia Finiq, Bashkia Shkodër, Bashkia Poliçan, Bashkia Librazhd, Bashkia Patos, Bashkia Përmet, Bashkia Malësi e Madhe, Bashkia Kamëz, Bashkia Sarandë, Bashkia Përrenjas.

261 Bashkia Selenicë, Bashkia Lezhë, Bashkia Belsh, Bashkia Mirditë, Bashkia Skrapar, Bashkia Lushnje, Bashkia Durrës, Bashkia Kukës, Bashkia Peqin, Bashkia Dibër, Bashkia Pogradec, Bashkia Kurbin.

262 Bashkia Lezhë deri më datë 21 mars 2021 i ka raportuar vëzhguesit afatgjatë të KRIIK se njoftimi me shkrim i zgjedhësve vazhdon ende, si dhe bashkia nuk ka ende një numër të saktë të zgjedhësve të njoftuar deri më këtë datë.

263 Bashkia Shkodër, Bashkia Malësi e Madhe, Bashkia Lezhë referuan vështirësi në njoftimin me shkrim të zgjedhësve për shkak të gabimeve në adresa. Në Bashkinë Tepelenë procesi i njoftimit me shkrim deri më datën 18 mars 2021 nuk ishte kryer me arsyetimin se banorët njihen me njëri-tjetrin. E njëjta gjë u raportua edhe për Bashkinë e Memaliaj në të cilën përpos këtij fakti u raportuan edhe raste të gabimeve në adresa si pasojë e problemeve në sistemin kompjuterik.

264 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 52 "Njoftimi me shkrim i zgjedhësve", pika 4.

265 Po aty, pika 6.

266 Bashkia Fier, Bashkia Malësi e Madhe, Bashkia Krujë, Bashkia Ura Vajgurore, Bashkia Kukës, Bashkia Berat, Bashkia Bulqizë, Bashkia Pukë, Bashkia Poliçan.

267 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 105 "Paraqitja e zgjedhësit në qendrën e votimit", pika 1(a).

268 Numri i shtetasve, të cilët në ditën e zgjedhjeve nuk kishin një ID të vlefshme ishte rreth 650 000 qytetarë.

kësaj trupe. Pas kërkesës publike dhe eksplicite të tyre, KQZ-ja iu drejtua me kërkesë zyrtare Ministrisë së Brendshme ku kërkoi ndërmarrjen e hapave nga kjo Ministri për të mundësuar ushtrimin e së drejtës së votës për këta shtetas, nëpërmjet konsiderimit edhe të shtyrjes së afatit të vlefshmërisë së dokumentit biometrik të identifikimit.
Nëpërmjet një akti normativ[269], Këshilli i Ministrave me propozim të Ministrit të Brendshëm, vendosi shtyrjen e afatit të vlefshmërisë së letërnjoftimeve elektronike jashtë afatit të vlefshmërisë, deri më datën 30 prill 2021, çka i dha mundësinë për të votuar çdo shtetasi me të drejtë vote pavarësisht datës së vlefshmërisë së dokumentit biometrik të identifikimit.

V.4. AUDITËT TEKNICIENË

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nëpërmjet propozimeve të Komisionerit dhe Nënkomisionerit, emëroi dy auditë teknicienë[270] për mbikëqyrjen e procesit të hartimit të listave të zgjedhësve. Nëpërmjet kontraktimit të këtyre auditive teknicienë, të cilët gjatë punës së tyre kanë të njëjtin akses si Drejtori i DPGJC-së në bazën e të dhënave të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile, KQZ-ja mbikëqyr procesin e hartimit të listave të zgjedhësve. Auditët duhet të raportojnë çdo muaj pranë KQZ-së[271].
Përpos raporteve të përfundimtare këta auditë përpiluan dhe dorëzuan në KQZ dy raporte të ndërmjetme, pavarësisht se, referuar datës së emërimit të tyre, auditët teknicienë janë kontraktuar nga KQZ-ja dhe kanë punuar për një periudhe pesëmujore, gjatë së cilës do të duhet të hartonin dhe paraqisnin në KQZ raport për çdo muaj[272]. Ky detyrim rezulton të jetë i papërmbushur prej të dy auditëve.
Edhe në këto zgjedhje, u vërejt një ndryshim drastik në përmbajtjen e raporteve të prodhuara prej auditëve teknicienë, për sa iu përket problematikave të paraqitura. Auditi që emërohet nga komisioneri (apo kryetari i KQZ-së në zgjedhjet pararendëse) ka një raport pa evidentime të problematikave, madje duke vlerësuar ecuri tejet pozitive të procesit të hartimit dhe publikimit të listave të zgjedhësve. E kundërta ndodh me auditin që u emërua nga nënkomisionerja (apo nënkryetari i KQZ-së në zgjedhjet pararendëse), ku prezantohet një raport, i cili evidenton shkelje dhe ngre pikëpyetje serioze mbi mënyrën e operimit dhe të sigurisë së bazës së të dhënave prej punonjësve të DPGJC-së.
Sipas njërit prej auditëve teknicienë, shprehet shqetësimi se në shumë raste, DPGJC-ja vazhdon të kthejë përgjigje me vonesë dhe janë shumë sipërfaqësorë[273] në përgjigjet e tyre ndaj pikëpyetjeve apo problematikave të ngritura.
Nga komunikimi i KRIIK me KQZ-në, na është bërë me dije se raportet e auditëve teknicienë u janë përcjellë DPGJC-së, por pa iu kërkuar shpjegime për to sikurse parashikon neni 61 i Kodit Zgjedhor[274].

269 Aktnormativ nr. 11, datë 25.03.2021, "Për një ndryshim në ligjin nr.8952, datë 10.10.2002, "Për letërnjoftimin elektronik të shtetasve shqiptarë", të ndryshuar", botuar në Fletoren Zyrtare 26.03.2021.

270 Vendimi nr. 1, datë 19.10.2020, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, "Për emërimin e auditit teknicien për mbikëqyrjen e procesit të hartimit të listave të zgjedhësve, për zgjedhjet për Kuvendin, të datës 25 prill 2021", dhe vendimi nr. 13, datë 28.10.2020 "Për emërimin e auditit teknicien për mbikëqyrjen e procesit të hartimit të listave të zgjedhësve, për zgjedhjet për Kuvendin, të datës 25 prill 2021".

271 Udhëzim nr. 2, datë 28.12.2012, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve "Për miratimin e rregullave të veçanta për kushtet e kontratës dhe kryerjen e auditimit nga auditët teknicienë për verifikimin e veprimeve në bazën e të dhënave RKGJC dhe në Sistemin Elektronik të Verifikimit SEV".

272 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 61, pika 7. "Mbikëqyrja e hartimit të listave të zgjedhësve nga KQZ-ja" (Ndryshuar me ligjin nr.74/2012, datë 19.07.2012, ndryshuar fjalia e dytë e pikës 2, shtuar një fjali pas fjalisë së parë në pikën 3, ndryshuar pikat 5 dhe 8 me ligjin nr. 101/2020, datë 23.7.2020).

273 "Raport i audituesit mbi verifikimin e veprimeve në bazën e të dhënave të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile", Roland Kërçuku, dt. 24.02.2021, f. 6.

274 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 61 pika 8. "Mbikëqyrja e hartimit të listave të zgjedhësve nga KQZ-ja" (Ndryshuar me ligjin nr.74/2012, datë 19.07.2012, ndryshuar fjalia e dytë e pikës 2, shtuar një fjali pas fjalisë së parë në pikën 3, ndryshuar pikat 5 dhe 8 me ligjin nr. 101/2020, datë 23.7.2020).

V.5. REGJISTRIMI I VOTUESVE ME BANIM JASHTË VENDIT

Shtetasit shqiptarë që jetojnë jashtë vendit gëzojnë liritë dhe të drejtat politike, të parashikuara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe legjislacioni shqiptar[275] në fuqi, duke pasur të drejtë të marrin pjesë aktive në jetën politike të vendit. Ushtrimi i së drejtës së votës, është e drejtë e këtyre qytetarëve që duhet të garantohet nga autoritetet shtetërore shqiptarë duke respektuar detyrimin kushtetues.

Premtimet dhe angazhimet publike të partive qeverisëse për garantimin e të drejtës së votës së emigrantëve janë diskutuar në vazhdimësi, por hapi i parë konkret lidhur me përgatitjen e bazës ligjore për realizimin e këtij procesit nisi me Urdhrin e Kryeministrit nr. 124 datë 18.09.2019[276], sipas së cilit u ngrit Grupi i Punës, i kryesuar nga Ministri i Shtetit për Diasporën, i cili hartoi paketën ligjore për t'u përfshirë në Kodin Zgjedhor dhe Strategjinë Kombëtare të Diasporës 2018-2024[277].

Pas ndryshimeve[278] të miratuara me ligjin nr. 101/2020, datë 23.7.2020, Kodi Zgjedhor[279], garanton të drejtën e zgjedhësve shqiptarë që kanë vendbanimin e përhershëm jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të votojnë në zgjedhjet për Kuvendin, duke regjistruar paraprakisht në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, adresën e vendbanimit të përhershëm jashtë vendit. Këto aplikime mund të kryheshin nëpërmjet portalit *e-Albania*, referuar procedurave të përcaktuara në VKM-në[280] e datës 4 nëntor 2020.

Kodi Zgjedhor[281] ngarkon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për realizimin e të gjitha akteve nënligjore, përgatitjen e kushteve dhe zbatimin e masave që mundësojnë votimin nga jashtë vendit në zgjedhjet për Kuvendin, për zgjedhësit që kanë vendbanimin e përhershëm jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Sa i përket ecurisë së punës, KQZ-ja nëpërmjet Urdhrit nr. 91 datë 31 tetor 2020, ngriti grupin e punës lidhur me mundësinë e votimit nga jashtë vendit, për zgjedhjet e datës 25 prill 2021.

Pavarësisht raportit të hartuar[282] prej këtij grupi, KQZ-ja nuk ndërmori asnjë hap tjetër publik për shtrimin e bazës ligjore për realizimin e procesit të votimit të emigrantëve.

Mos marrja e një vendimi për për përfshirjen për herë të parë të votimit nga jashtë vendit në procedurat e zakonshme të votimit në këto zgjedhje, sipas parashikimeve të nenit 24 pika 3 të Kodit Zgjedhor, shtyn përfshirjen automatikisht si pjesë përbërëse të procedurave të votimit, votimin nga jashtë vendit jo më parë se zgjedhjet e viti 2029.

Numri i shtetasve shqiptarë që janë me banim të përhershëm jashtë vendit është relativisht i lartë. Duke qenë se regjistrimi i tyre nuk është bërë asnjëherë, nga llogaritje të përafërta, nisur nga të dhënat e INSTAT dhe KQZ, janë rreth 1 600 000 shtetas nga të cilët 1 300 000 zgjedhës. Aktualisht numri i shtetasve shqiptarë me adresë të deklaruar vendbanimi jashtë territorit të Shqipërisë dhe me procedurë të mbyllur për përfundimin e regjistrimit nga Ministria e Brendshme është 1 475[283].

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve evidentoi në vazhdimësi rëndësinë e dakordësisë politike për realizimin e këtij procesi, si dhe kohën tejet të kufizuar në dispozicion të Komisionit Qen-

275 Ligj Nr.9668, datë 18.12.2006, Kuvendi i Shqipërisë, "Për emigrimin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi", Neni 6.

276 Urdhri Nr. 124, datë 18.09.2019, Këshilli i Ministrave, "Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për hartimin e paketës ligjore për garantimin e së drejtës së votës për shtetasit shqiptarë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë".

277 Strategjia Kombëtare e Diasporës 2018-2024 dhe Plani i Veprimit, Miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 259, datë 09.05.2018.

278 Deri më vitin 2020 sipas legjislacionit në fuqi, shtetasit shqiptarë me banim jashtë vendit mund të votonin vetëm duke ardhur fizikisht në Shqipëri.

279 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 46 "Lista e zgjedhësve", pika 3.

280 Vendim i Këshillit të Ministrave, nr. 915, datë 04.11.2020, Fletore Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, numër 208, datë 27.11.2020.

281 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 24 "Kompetencat e KQZ-së lidhur me votimin nga jashtë vendit".

282 Raporti në përmbajtje përfshin një ecuri ligjore të këtij procesi, si dhe shembuj konkretë se si ky proces realizohet në pesë shtete të ndryshme.

283 Nga komunikimi i KRIIK me DPGJC-në nga muaji dhjetor 2020 deri në mars 2021 në *e-Albania* ka pasur 4 550 aplikime për regjistrim të vendbanimit jashtë territorit të Shqipërisë, ndërkohë që vetëm 1 475 prej tyre janë procesuar nga Ministria e Brendshme përgjatë së njëjtës periudhë.

dror të Zgjedhjeve për ngritjen e gjithë infrastrukturës së nevojshme, ligjore dhe jo vetëm, për realizimin e këtij procesi[284].
Mosrealizimi i votimit të emigrantëve rezultoi një rast i humbur si dhe një shkelje e angazhimeve politike të palëve, sipas marrëveshjes së 5 Qershorit 2020.
KRIIK ka nënvizuar në vazhdimësi rëndësinë dhe nevojën për t'u garantuar zgjedhësve me banim jashtë vendit të drejtën e votës, jo vetëm si një detyrim i institucioneve ndaj këtyre shtetasve, por edhe si një mënyrë për të zbehur sistemin e patronazhit politik dhe drejtimit të votës, të ngritur brenda vendit.
Rregullimi ligjor i bërë me amendimet e korrikut 2020 konsiderohet nga KRIIK si totalisht i pamjaftueshëm për të arritur zbatimin efektiv të këtij procesi, duke e ngarkuar KQZ me detyra të cilat, efektivisht, ishin të parealizueshme në mungesë të një konsensusi politik dhe rregullimi ligjor të detajuar. U evidentua se, përtej vullnetit të shprehur verbalisht prej partive politike, mungoi një vullnet i pastër i tyre për realizimin e këtij procesi.

V.6. E DREJTA E VOTËS PËR PERSONAT NË VETËIZOLIM (TË INFEKTUAR ME VIRUSIN SARS-COV-2 DHE FAMILJARËT E TYRE)

Pavarësisht se ishte lehtësisht e parashikueshme që zgjedhjet e 25 prillit do të zhvilloheshin në situatë pandemie, partitë politike nuk e bënë këtë çështje në asnjë moment pjesë të diskutimit në Këshillin Politik, për aq sa dihet dhe është bërë publike.

KRIIK e ka ngritur këtë çështje me një Letër të Hapur në qershor të vitit të shkuar[285] dhe u ka bërë thirrje institucioneve dhe partive politike të marrin në konsideratë këtë mundësi dhe të përgatisin skenarë të mundshëm të administrimit të procesit zgjedhor në situatë pandemie, thirrje e cila është përsëritur në vazhdimësi disa herë.
Partitë politike dhe institucionet nuk patën asnjë reagim në lidhje me këtë çështje për muaj me radhë. Reagimi i parë erdhi nga Kryeministri Rama, në një Konferencë për Shtyp[286], ku në përgjigje të pyetjes së një prej gazetarëve deklaroi se "Do të bëjmë të njëjtën gjë që kanë

284 Në një konferencën për shtyp Celibashi ka deklaruar se "sa i përket votimit të emigrantëve për fat të keq procesi vazhdon të jetë pa rezultat konkret. Kemi përgatitur sipas kërkesës së disa partive një listë të akteve të kërkuara nga partitë për të pasur një qartësi për procedurat që KQZ-ja do të ndjekë. Me shumë mundësi javën tjetër do t'i kalojë KRR draftin për procedurat e votimit nga jashtë. Teorikisht ka shans që të realizohet".
https://www.facebook.com/Ilirjan.Celibashi/videos/928718701201612
https://www.facebook.com/KQZShqiperi/videos/244749337277289
Nuk kam qenë asnjëherë optimist, por dëshirëplotë për këtë projekt, sepse koha në dispozicion ka qenë jo ajo që duhet të ishte. Por, kemi menduar që ky proces mund të bëhej. Unë vazhdoj të shpresoj akoma në realizimin e këtij procesi, vetëm për faktin që numri i atyre që janë regjistruar në RGJC është i vogël. Si pasojë, ekziston mundësia që edhe si test mundet ta provojmë edhe për këto zgjedhje. Mbetet për t'u parë. Teorikisht vazhdoj të mendoj që edhe për këto zgjedhje ky projekt mund të realizohet. Vërtet KQZ-ja ka detyrimin të përgatisë aktet dhe infrastrukturën për votimin e emigrantëve, por ka shumë rëndësi koha. Në kaq kohë sa iu la në dispozicion KQZ-ja, për këdo vend tjetër që e ka aplikuar këtë proces në mënyrë korrekte, do të ishte e parealizueshme. Është e pamundur, në mënyrë reale, që të realizohet gjithë infrastruktura ligjore dhe të tjera për vetëm gjashtë muaj. Është një proces delikat. Argumenti që dikush përdor se KQZ-ja kishte për detyrë të hartonte aktet deri më 20 shkurt 2021, KZ ka një dispozitë në kod ku thuhet se komisioni rregullator merr një vendim kur do t'i përfshijë për herë të parë votuesit jashtë territorit të vendit në zgjedhje. Pra, ka një moment të parë kur vetë ligjvënësi ia ka lënë në dorë Rregullatorit për ta marrë këtë vendim. Ky i fundit është në të drejtën e vet kur do t'i përfshijë. Ne jemi duke bërë rregullat nga e para. Është shumë e rëndësishme që ky proces të ketë dakordësinë e partive politike. KQZ-ja është investuar plotësisht për aq kohë sa ka në dispozicion t'ia dali, nëse nuk do t'ia dalë është zero përgjegjësia e KQZ-së.
https://youtu.be/llfLZG0xPFA *"Ne kemi një qasje për të kërkuar konsensus të gjithë partive politike, jo për t'i kthyer resto për ringritjen e KQZ-së. Ne deri këtu shkojmë. Por duam që të shkojmë në një proces zgjedhor me një konsensus të plotë me rregullat që KQZ-ja po përpiqet të përshtasë, pa cënuar aspak interesin e votuesit shqiptar. Në këtë kuadër edhe qasja e KQZ-së në lidhje me projektin e votës së emigrantëve, për të pasur konsensusin e të gjitha palëve është në këtë pikë. Nuk është se Kodi Zgjedhor ka zgjidhur ndonjë gjë në lidhje me këtë çështje, u ka garantuar të drejtën që tashmë ka qenë e garantuar në kushtetutë. Është një gjë tejet e komplikuar nga pikëpamja e kohës. Ne zyrtarisht sot kemi jo më shumë 854 shqiptarë me vendbanim të përhershëm jashtë Shqipërisë. KQZ-ja duhet të hartojë votimin për këta emigrantë. Për ligjin shqiptar qytetarë që kanë vendbanim jashtë territorit të Shqipërisë në mënyrë të përhershme janë vetëm 854 vetë. Pra, KQZ-ja do të duhet të përgatisë procesin vetëm për këta 900 shqiptarë. As për këta nuk është e garantuar seti se si do të votojnë."*

285 KRIIK Albania, Letër e Hapur, datë 16.06.2020, "Dakordësia e arritur në Marrëveshjen e 5 Qershorit, si një moment i lidershipeve për të tejkaluar përvojën e derisotme".

286 Konferencë me gazetarët, datë 2 mars 2021, Kryeministri Edi Rama: "*Do të bëjmë të njëjtën gjë që kanë bërë vendet e tjera, që për ata, të cilët janë të testuar pozitivë, e nuk janë negativizuar, nuk bëhet fjalë fare, duhet të qëndrojnë në shtëpi, ata duhet të vetëkarantinohen etj.*"

bërë vendet e tjera. Për ata të cilët janë të testuar pozitivë dhe nuk janë negativizuar duhet të qëndrojnë në shtëpi".
Mungesa e reagimit dhe marrjes nw konsideratw se zgjedhjet do të organizoheshin në periudhë pandemie, tregon së paku mungesë të respektit për të drejtën e votës, si një e drejtë thelbësore e qytetarit dhe, nga ana tjetër, edhe konsiderimin e procesit zgjedhor thjesht si një proces mekanik votimi për mandatimin e një pushteti politik.
Shteti shqiptar dështoi haptas në plotësimin e detyrimit për t'iu garantuar të gjithë shtetasve të vet të drejtën e votës, një të drejtë të pamohueshme dhe të pacënueshme që Kushtetuta dhe Konventat Ndërkombëtare[287] të ratifikuara nga shteti shqiptar ua njohin shtetasve.
Nga ana tjetër, një qasje e tillë është shkelje edhe e dispozitave të Kodit Zgjedhor, pasi ai përcakton ngritjen e Qendrave te Posaçme të Votimit në ambientet e spitaleve apo qendrave shëndetësore ku janë hospitalizuar jo më pak se 15 pacientë dhe për një periudhë jo më pak se tri ditë.

VI. REGJISTRIMI I SUBJEKTEVE ZGJEDHORE DHE KANDIDATËVE

E drejta e kandidimit rregullohet nga Kushtetuta e Shqipërisë, Kodi Zgjedhor[288], dhe Ligji i Dekriminalizimit[289].
Subjekt zgjedhor quhet çdo parti politike apo koalicion partish, të cilat paraqesin lista kandidatësh në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si dhe çdo shtetas shqiptar, i cili propozohet si kandidat për deputet nga një grup zgjedhësish sipas përcaktimeve të Kodit Zgjedhor. Çdo shtetas që ka mbushur 18 vjeç ka të drejtën të kandidojë, me përjashtim të atyre që e kanë humbur këtë të drejtë për kryerjen e disa kategorive të veprave penale (të përcaktuara në Ligjin e Dekriminalizimit), si dhe disa kategorive personash që ushtrojnë detyra të caktuara publike[290] .
Pjesa IV e Kodit Zgjedhor, e cila ka të bëjë me regjistrimin e subjekteve zgjedhore, ishte pjesë e ndryshimeve të Kodit Zgjedhor të miratuara me ligjin nr. 101/2020, datë 23.7.2020, si dhe me ligjin nr. 118/2020, datë 5.10.2020[291].
Ndryshimet e tetorit 2020, të kryera pa konsensusin e opozitës jashtëparlamentare, në kundërshtim me frymën e Marrëveshjes së 5 Qershorit 2020, u paraprinë nga ndryshime kushtetuese të kryera në korrik të vitit 2020, sërish të kryera në mënyrë të njëanshme, jo të ligjshme, në mungesë të konsensusit me opozitën jashtëparlamentare dhe me një proces konsultimi fiktiv. Ndryshimet përfshijnë eliminimin e mundësisë së partive politike të bashkohen në koalicione parazgjedhore duke paraqitur lista individuale (për çdo parti) kandidatësh, dhe, si rrjedhim, detyrimin që çdo koalicion të paraqesë listë unike kandidatësh.
Kryerja e ndryshimeve ligjore në një element kaq të rëndësishëm të procesit zgjedhor, siç është regjistrimi i subjekteve zgjedhore, në mungesë të një procesi gjithëpërfshirës konsultimi dhe konsensusi politik, u vlerësua nga KRIIK si një aspekt negativ dhe që rrezikoi seriozisht të minojë besimin në procesin zgjedhor.

287 Paragrafi 25 i Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat dhe Liritë Politike. Shih edhe Paragrafët 11 dhe 12 të Komentit të Përgjithshëm nr. 25, të Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut

288 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Nenet 45 "Përbërësit zgjedhore" dhe 69 "Kandidatët e propozuar nga zgjedhësit për zgjedhjet në Kuvend", dhe Ligji nr. 138/2015, datë 17.12.2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen apo ushtrojnë funksione publike", Fletore Zyrtare, publikuar më 22.12.2015.

289 Ligji nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen apo ushtrojnë funksione publike", Fletore Zyrtare, publikuar më 22.12.2015, Neni 2, "Ndalimi për kandidim dhe për t'u zgjedhur në një funksion të lartë publik".

290 Gjyqtarët, prokurorët; ushtarakët e shërbimit aktiv; punonjësit e policisë dhe të sigurimit kombëtar; përfaqësuesit diplomatikë; kryetarët e bashkive për zgjedhjet në Kuvend; deputetët, kur konkurrojnë për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore; prefektët në vendet ku kryejnë detyrat e tyre për zgjedhjet në Kuvend dhe për organet e qeverisjes vendore; kryetarët dhe anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve; Presidentin e Republikës; dhe zyrtarët e lartë të administratës shtetërore të përcaktuar me ligj. Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, Neni 63, "Subjektet zgjedhore dhe kandidatët", pika 4 e.

291 Në funksion të këtyre ndryshimeve, për të detajuar rregullat e kandidimit, KQZ-ja miratoi një udhëzim nr. 1 datë 23.12.2021, "Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit".

Partitë politike që nuk zotërojnë një mandat në Kuvend apo kandidatët e paraqitur nga zgjedhësit kanë detyrimin për të paraqitur firma mbështetëse të zgjedhësve për t'u regjistruar si kandidatë[292]. Numri i firmave mbështetëse që duhet të paraqiten janë në përputhje me praktikat e mira për zgjedhjet[293].
Pavarësisht kësaj, mbledhja e firmave mbështetëse u tregua të ishte një barrierë për kandidimin e kandidatëve të pavarur. Nga tetë komisione nismëtare të regjistruara në KQZ, vetëm pesë arritën të mblidhnin firmat e kërkuara.
Tre nga këta kandidatë të pavarur u mbështetën nga Qendra Vetëvendosje, e cila në Shqipëri është e regjistruar si organizatë jofitimprurëse[294], sipas ligjit shqiptar, pra patën mundësinë të përdornin burimet e një strukture organizative ekzistuese. Jo vetëm kaq, por kandidatët nga kjo lëvizje përfituan edhe nga mbështetja publike e Kryeministrit të Kosovës (kryeministër në hije në atë moment) dhe drejtuesit të Lëvizjes VetëVendosje, z. Albin Kurti gjatë fazës së mbledhjes së firmave mbështetëse, gjatë vizitës së këtij të fundit në Shqipëri në datë 3 mars 2021[295]. Pavarësisht se është e vështirë të matet në mënyrë të besueshme, mbështetja e z. Kurti, veçanërisht menjëherë pas zgjedhjeve të 14 shkurtit 2021 në Kosovë, në të cilat partia e drejtuar prej tij pati një rezultat shumë të lartë, ka gjasa që angazhimi i drejtpërdrejt i tij të ketë ndikuar ndjeshëm në mbledhjen e firmave.
Për zgjedhjet e datës 25 prill 2021, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve regjistroi 46 parti politike[296], 2 koalicione[297] dhe 5 kandidatë të pavarur[298].
Në rezultante, pas grupimit në koalicione zgjedhore dhe paraqitjes së listave të kandidatëve, ishin 12 subjekte zgjedhore në çdo qark, dhe 13 në 5 qarqe[299] ku pati kandidatë të pavarur. Numri total i kandidatëve për deputetë ishte 1 841[300].

VI.1. REGJISTRIMI I PARTIVE POLITIKE

Rregullat për regjistrimin e partive politike në proceset zgjedhore përcaktohen në ligjin për partitë politike dhe Kodin Zgjedhor[301]. Në detajim të këtyre ligjeve KQZ miratoi udhëzimin[302] për rregullat e regjistrimit të subjekteve zgjedhore.
Afati ligjor, sipas Kodit Zgjedhor, për regjistrimin e partive politike ishte data 15 shkurt 2021,

292 5 000 firma mbështetëse në rastin e partive politike, 7 000 në rastin e koalicioneve dhe 1% të numrit të zgjedhësve në zonën zgjedhore përkatëse, por në çdo rast jo më shumë se 3 000 firma në rastin e kandidatëve të pavarur.

293 Kodi i Praktikave të Mira në Çështje Zgjedhore i Komisionit të Venecias, (I.1.3..i) sugjeron që numri i firmave mbështetëse të mos i kalojë 1% të zgjedhësve të regjistruar.

294 Ndërkohë që aktivistët e saj e konsiderojnë veten pjesë të së njëjtës lëvizje mbarëkombëtare me partinë politike Lëvizja VetëVendosje! Në Kosovë dhe përfshihen në aktivitete të përbashkëta. Shih: https://shqiperi.vetevendosje.org/pyetje-te-shpeshta/. Drejtuesi i Lëvizjes VetëVendosje në Kosovë dhe kryeministër aktual i Kosovës, Albin Kurti, vizitoi Shqipërinë dhe mori pjesë në aktivitete të organizuara për të prezantuar kandidatët e mbështetur nga Qendra VetëVendosje në Shqipëri në mars të këtij viti.

295 Albin Kurti: "Pas Kosovës edhe Shqipëria ka nevojë për ndryshime" https://www.youtube.com/watch?v=nz8sncgiui4

296 Njëmbëdhjetë parti politike dhe tri komitete nismëtare, pavarësisht se u regjistruan si subjekte zgjedhore, nuk paraqitën lista shumemërore kandidatësh apo firmat mbështetëse për kandidatët e pavarur, çka konkludoi në tërheqjen e tyre faktike nga gara elektorale.

297 Koalicioni "Partia Demokratike – Aleanca për ndryshim" dhe Koalicioni "ABEOK".

298 Z. Plarent Aleksi, kandidat për deputet i propozuar nga zgjedhësit në qarkun Berat; z. Boiken Abazi, kandidat për deputet i propozuar nga zgjedhësit në qarkun Tirane; z. Iljaz Shehu, kandidat për deputet i propozuar nga zgjedhësit në qarkun Lezhë; z. Kreshnik Merxhani, kandidat për deputet i propozuar nga zgjedhësit në qarkun Gjirokastër; z. Pal Shkambi, kandidat për deputet i propozuar nga zgjedhësit në qarkun Shkodër.

299 Qarku Tiranë, Qarku Gjirokastër, Qarku Lezhë, Qarku Shkodër dhe Qarku Berat.

300 1836 kandidatë nga partitë politike dhe koalicionit dhe pesë kandidatë të pavarur.

301 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 64 "Regjistrimi i partive politike në zgjedhje" pika 1.

302 Udhëzimi nr. 1, datë 23.12.2020, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, "Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit".

ndërsa për koalicionet zgjedhore data 25 shkurt 2021[303]. Ndërkohë sipas Udhëzimit[304] për rregullat e regjistrimit të subjekteve zgjedhore, KQZ duhet të verifikojë dokumentacionin e dorëzuar nga partitë politike brenda dy ditëve nga depozitimi i tij.
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vendosi, në mbledhjen publike të datës 22 shkurt 2021, regjistrimin e nëntë partive politike ndërsa katër parti që kishin mangësi në dokumentacionin e paraqitur, nuk u regjistruan[305]. Nga shqyrtimi i relacioneve të projektvendimeve përkatëse për regjistrimin e këtyre partive, rezulton se kërkesat, përfshirë plotësimin e dokumentacionit, ishin depozituar në KQZ brenda afatit ligjor, por vendimmarrja faktike ishte në tejkalim të tij.
Procesi i regjistrimit të partive politike në KQZ u realizua konform përcaktimeve ligjore të detajuara edhe në aktet nënligjore nga KQZ, e cila qëndroi në komunikim të vazhdueshëm me partitë në funksion të plotësimit sa më të shpejtë dhe efikas të dokumentacionit.
Vlerësohet si hap pozitiv respektimi i çdo kërkese të udhëzimit, sidomos atij të hapjes dhe publikimit të një numri të posaçëm llogarie bankare nga ana e çdo partie politike që paraqet kërkesën për t'u regjistruar në zgjedhje.

VI.1.1. MANDATI I KRYETARIT TË PARTISË SIPAS STATUTIT TË PARTISË

Kuadri ligjor përcakton listën e dokumenteve që partitë politike duhet të dorëzojnë për t'u regjistruar si subjekt zgjedhor. Dokumentacioni është përgjithësisht formal dhe nuk përfshin asnjë mekanizëm që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të verifikojë nëse një parti politike operon në përputhje me parimet kushtetuese dhe ligjore të demokracisë së brendshme[306].
Një nga këto parime, që qartas nuk është respektuar nga një pjesë e partive politike të regjistruara si subjekte zgjedhore për zgjedhjet e 25 prillit, është vlefshmëria e mandatit të kryetarit të partisë (referuar statutit të vetë partive përkatëse), mungesa e një mandati të kufizuar në kohë të kryetarit në statut, apo mos kryerja e zgjedhjeve periodike për zgjedhjen e forumeve drejtuese sipas statutit të partisë.
Nëse Komisioni Qendror i Zgjedhjeve do të kishte tagrat ligjorë të ndalonte kandidimin e partive si subjekte zgjedhore, bazuar vetëm në këtë element, 22 parti nuk duhet të ishin regjistruar.
Konkretisht nga vëzhgimi i akteve të regjistrimit të partive politike në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për 46 partitë e regjistruara në KQZ për zgjedhjet e datës 25 prill 2021, rezulton se:

i. 20 parti[307] i kanë kryetarët brenda afatit të vlefshëm ligjor të ushtrimit të mandatit,

303 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 64, "Regjistrimi i partive politike në zgjedhje" pika 1.

304 Udhëzimi nr. 1 datë 23.12.2020, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, Neni 1 "Regjistrimi i partive politike" pika 3.

305 Partia e Punës e Shqipërisë, Partia Centriste e Mirëqenies Popullore Shqiptare dhe Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve nuk kanë depozituar në KQZ numrin e llogarisë së posaçme bankare të hapur nga partia; ndërsa për Partinë Emigracioni Shqiptar kërkesa ishte realizuar dhe firmosur nga një anëtar i partisë dhe jo kryetari i saj apo një person i autorizuar prej tij. Ndërkohë, kjo parti ishte regjistruar më herët si subjekt zgjedhor nëpërmjet kryetarit të saj.

306 Neni 9, pika 1 e Kushtetutës përcakton se "Organizimi [I partive politike] duhet të përputhet me parimet demokratike". Neni 7, pika a. e Ligjit për Partitë Politike, e shpie këtë një hap më tej duke specifikuar se nuk lejohet regjistrimi i një partie politike kur "organizimi i [...] brendshëm është në kundërshtim me parimet demokratike dhe, veçanërisht, me parimet vijuese: ndërtimi nga poshtë lart i partisë, zgjedhjet e brendshme demokratike për forumet e partisë..."

307 - Partia Lëvizja për Ndryshim, Kryetarja aktuale zgjedhur pas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të datës 23.11.2020; - Partia Lëvizja Demokratike Shqiptare, Kryetari aktual zgjedhur pas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të datës 19.10.2020; - Partia Ora e Shqipërisë, kryetari aktual rizyrtarizuar pas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të datës 23.11.2017; - Partia Bindja Demokratike, kryetari aktual zyrtarizuar pas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të datës 25.04.2019; - Partia Lëvizja e Legalitetit, kryetari aktual rizyrtarizuar pas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të datës 23.12.2017; - Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet, kryetari aktual rizyrtarizuar pas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të datës 28.02.2017; - Partia e Reformave Demokratike Shqiptare, Kryetari aktual zyrtarizuar pas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të datës 15.03.2019; - Partia Demokristiane e Shqipërisë, kryetari aktual zyrtarizuar pas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të datës 10.05.2017; - Partia Agrare Ambientaliste, kryetari aktual zyrtarizuar pas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të datës 21.07.2016; - Partia Kristian Demokrate e Shqipërisë, Kryetari aktual rizyrtarizuar pas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të datës 14.01.2016; - Partia Aleanca Demokracia e Re, Kryetari aktual zgjedhur pas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të datës 12.01.2021; - Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, Kryetarja aktuale rizyrtarizuar pas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të datës 15.01.2021; - Partia Socialdemokrate, kryetari aktual zgjedhur pas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të datës 04.02.2021; - Partia Lëvizja e Re, kryetari aktual zyrtarizuar

sipas përcaktimeve në statutin përkatës;

ii. 4 parti[308] konsiderohet se i kanë kryetarët brenda afatit të vlefshëm të mandatit të tyre të përfaqësimit, megjithëse nuk rezulton një mandat i kufizuar në vite, i përcaktuar shprehimisht në statutin përkatës (në këtë rast është përllogaritur si afat i vlefshëm mandati shtatëvjeçar si afati më i gjatë kohor i evidentuar në tërë listën e paraqitur të partive);

iii. 6 parti[309] i kanë kryetarët jashtë afatit të vlefshëm ligjor të ushtrimit të mandatit, sipas përcaktimeve në statutin përkatës;

iv. 16 parti[310] konsiderohet se i kanë kryetarët jashtë afatit të vlefshëm të mandatit të tyre të përfaqësimit, megjithëse nuk rezulton një mandat i kufizuar në vite, i përcaktuar në statut.

Në mënyrë që operimi i partive politike të jetë në përputhje me normat demokratike të sanksionuara nga Kushtetuta duhet që në ligjin për partitë politike të përcaktohet qartë se mandati i kryetarit të partisë dhe organeve drejtuese të saj duhet të ketë një kohëzgjatje të caktuar (një kohëzgjatje tavan mund të parashikohet në ligj) dhe se partia duhet të kryejë zgjedhje brenda afatit të caktuar në ligj.

pas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të datës 28.12.2020; - Partia Lëvizja Punëtore Shqiptare, kryetari aktual zyrtarizuar pas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të datës 27.04.2015; - Partia Nisma Thurje, kryetari aktual zgjedhur pas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të datës 15.01.2021; - Partia Kombëtare Konservatore Albania, Kryetari aktual zyrtarizuar pas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të datës 20.02.2017; - Partia Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane, Kryetari aktual zyrtarizuar pas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të datës 20.09.2017; - Partia Qytetare Shqiptare, Kryetari aktual zgjedhur pas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të datës 01.10.2020; - Partia Aleanca Kuq e Zi, Kryetarja aktuale zyrtarizuar pas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të datës 19.12.2017.

308 - Partia Aleanca Demokratike, Kryetari zyrtarizuar pas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë më 22.05.2014; - Partia Demokratike depozitimi i fundit në Gjykatë më 2013. Sipas statutit të PD-së, mandati i kryetarit të partisë është katërvjeçar. Kryetari aktual i PD-së është zgjedhur nga anëtarësia e partisë më 22.07.2017, por këto ndryshime nuk figurojnë që të jenë pasqyruar pranë Gjykatës; - Partia Socialiste e Shqipërisë, depozitimi i fundit në Gjykatë më 2013-ën. Sipas statutit të PS-së, i publikuar në faqen zyrtare të internetit, ndryshuar më 2016-ën, mandati i kryetarit të partisë konsiderohet i rinovuar në momentin që ai/ajo zgjidhet kryeministër. Por këto ndryshime nuk figurojnë që të jenë pasqyruar pranë Gjykatës. Për më shumë shih Statutin e Partisë Socialiste të Shqipërisë, datë 19.03.2016, Neni 40, "Zgjedhja e Kryetarit të Partisë", pika 5; - Partia Fryma e Re Demokratike, Kryetari zyrtarizuar pas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë më 20.04.2015.

309 - Partia Balli Kombëtar, kryetari aktual zyrtarizuar pas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të datës 16.02.2004, pavarësisht se në statutin e partisë përcaktohet shprehimisht se mandati i kryetarit të partisë është katër vjet; - Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë, kryetari aktual zyrtarizuar pas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të datës 07.12.2010, pavarësisht se në statutin e partisë përcaktohet shprehimisht se mandati i presidentit të partisë është tre vjet; - Partia Bashkimi Popullor i Pensionistëve Shqiptar, kryetari aktual zyrtarizuar pas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të datës 24.04.2009, pavarësisht se në statutin e partisë përcaktohet shprehimisht se mandati i kryetarit të partisë është katër vjet; - Partia Aleanca Kombëtare, kryetari aktual zyrtarizuar pas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të datës 01.06.2007, pavarësisht se në statutin e partisë përcaktohet shprehimisht se mandati i kryetarit të partisë është katër vjet; - Partia Ligj dhe Drejtësi, kryetari aktual zyrtarizuar pas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të datës 17.02.2009, pavarësisht se në statutin e partisë përcaktohet shprehimisht se mandati i kryetarit të partisë është katër vjet; - Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve, kryetari aktual zyrtarizuar pas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të datës 18.02.2002, i cili është edhe vendimi i regjistrimit të kësaj partie në Gjykatë, pavarësisht se në statutin e partisë përcaktohet shprehimisht se mandati i kryetarit të partisë është katër vjet.

310 - Partia Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet, kryetari aktual zyrtarizuar pas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të datës 03.03.2009, i cili është edhe vendimi i regjistrimit të kësaj partie në Gjykatë; - Partia e Çështjeve Shqiptare, kryetari aktual zyrtarizuar pas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të datës 09.11.2004, i cili është edhe vendimi i regjistrimit të kësaj partie; - Partia e Unitetit Kombëtar, Kryetari aktual zyrtarizuar pas Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë të datës 15.03.1991, i cili është edhe vendimi i regjistrimit të kësaj partie; - Partia e Balli Kombëtar Demokrat, Kryetari aktual zyrtarizuar pas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të datës 28.05.2005; - Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar, kryetari aktual zyrtarizuar pas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të datës 18.05.2005; - Partia Republikane Shqiptare, kryetari aktual zyrtarizuar pas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të datës 22.05.2005; - Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar, kryetari aktual zyrtarizuar pas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të datës 16.06.2008; - Partia Komuniste e Shqipërisë, kryetari zyrtarizuar pas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë më 17.12.2012; - Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut, kryetari aktual zyrtarizuar pas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të datës 11.03.2002; - Partia Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen, Kryetari aktual zyrtarizuar pas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të datës 10.06.2002, i cili është edhe vendimi i regjistrimit të kësaj partie; - Partia Bashkimi Liberal Demokrat, kryetari aktual rizyrtarizuar pas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të datës 13.04.2005; - Partia Demokracia Sociale, kryetari aktual zyrtarizuar pas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të datës 07.05.2003, i cili është edhe vendimi i regjistrimit të kësaj partie në Gjykatë; - Partia Shqiptare Atdheu, kryetari aktual zyrtarizuar pas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të datës 09.04.2013, i cili është edhe vendimi i regjistrimit të kësaj partie; - Partia Emigracioni Shqiptar, kryetari aktual zyrtarizuar pas Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë të datës 16.07.1998, i cili është edhe vendimi i regjistrimit të kësaj partie; - Partia e Pajtimit Kombëtar, kryetari aktual zyrtarizuar pas Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë të datës 24.12.1997, i cili është edhe vendimi i regjistrimit të kësaj partie; - Partia Aleanca Popullore, kryetari aktual zyrtarizuar pas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të datës 11.04.2013.

Përveç sa më sipër, kuadri ligjor duhet të përcaktojë mekanizmat e verifikimit dhe sanksionet ndaj partisë politike që nuk përmbush këtë normë ligjore. Mund të konsiderohet që një nga tagrat e KQZ-së të jetë edhe verifikimi i kritereve minimale të demokracisë së brendshme të partisë, si kusht për regjistrimin si subjekt zgjedhor.

VI.2. REGJISTRIMI I KOALICIONEVE ZGJEDHORE

Dy ose më shumë parti politike të regjistruara si subjekte zgjedhore në KQZ, mund të regjistrohen si koalicion zgjedhor, jo më vonë se 60 ditë përpara datës së zgjedhjeve[311]. Në momentin e regjistrimit, koalicioni duhet të deklarojë partinë politike udhëheqëse të koalicionit, e cila është përgjegjëse për përmbushjen e të gjitha detyrave që rrjedhin prej Kodit Zgjedhor. Partitë politike pjesëtare të një koalicioni duhet të nënshkruajnë marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet tyre, për të përcaktuar të drejtat dhe detyrat e ndërsjella. Kjo marrëveshje depozitohet në komisionin Qendror të Zgjedhjeve.
Për zgjedhjet e datës 25 prill 2021, KQZ regjistroi tre koalicione zgjedhore: Koalicioni "Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim" në përbërjen e të cilit ishin 13 parti politike[312]; Koalicioni "Aleanca" në përbërjen e të cilit ishin 7 parti politike[313] dhe Koalicioni "Aleanca Bashkimi Popullor – Emigracioni – Ora e Shpresës dhe Konservatorët" në përbërjen e të cilit ishin katër parti politike[314]. Pas përfundimit të procesit të regjistrimit të kandidatëve rezultoi se vetëm dy koalicione arritën të plotësonin[315] dokumentacionin e nevojshëm për të figuruar si subjekte zgjedhore në fletën e votimit[316].
Për shkak të ndryshimeve ligjore, të cilat detyrojnë koalicionet parazgjedhore të paraqiten me listë unike kandidatësh, Partia Demokratike dhe Lëvizja Socialiste për Integrim nënshkruan një marrëveshje me anë të së cilës u angazhuan publikisht për një koalicion paszgjedhor[317].

VI.3. REGJISTRIMI I KANDIDATËVE

Partia politike ose koalicioni duhet të depozitojë në KQZ listën shumemërore të kandidatëve për çdo zonë zgjedhore jo më vonë se 50 ditë[318] para datës së zgjedhjeve.
Një kandidat mund të përfshihet vetëm në listën e një zone zgjedhore (qarku) dhe vetëm të

311 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 64 "Regjistrimi i koalicioneve zgjedhore".

312 Partia Lëvizja e Legalitetit, Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet, Partia Demokristiane e Shqipërisë, Partia Balli Kombëtar Demokrat, Partia Agrare Ambientaliste, Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar, Partia Kristiandemokrate, Partia Demokratike, Partia Republikane Shqiptare, Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut, Partia Bashkimi Liberal Demokrat, Partia Fryma e Re Demokratike, Lëvizja për Zhvillim Kombëtar.

313 Partia Aleanca Demokratike Shqiptare, Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet, Partia Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane, Partia e Reformave Demokratike Shqiptare, Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve, Partia Lëvizja Punëtore Shqiptare, Partia Qytetare Shqiptare.

314 Partia Ora e Shqipërisë, Partia Kombëtare Konservatore Albania, Partia Bashkimi Popullor i Pensionistëve Shqiptar, Partia Emigracioni Shqiptar.

315 Koalicionit Aleanca iu refuzua kërkesa për regjistrimin e listave shumemërore, pasi dorëzoi vërtetim nga Kuvendi për zotërimin e mandateve në Kuvend në numër më të ulët se numri i partive pjesë e Koalicionit. Edhe pas ankimimit në KAS dhe Kolegjin Zgjedhor, vendimi nr. 165, datë 18.03.2021 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve "Për shqyrtimin e kërkesës për miratimin e listave shumemërore të koalicionit Aleanca (AL), për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021" nuk ndryshoi.

316 Koalicioni Aleanca, në përbërjen e të cilit ishin shtatë parti politike, paraqiti në KQZ kërkesën për regjistrimin e listave shumemërore, bashkëshoqëruar me vërtetim nga Kuvendi i Shqipërisë për zotërimin të një mandati në Kuvend. Edhe pas përfundimit të procedurës së plotësimit të dokumentacionit, për shkak të mungesës së vërtetimit për zotërimin e numrit të nevojshëm të mandateve, i cili në rastin konkret duhet të ishte shtatë, kjo listë nuk u regjistrua. Përfaqësuesi i këtij koalicioni në KQZ, ngriti pretendimin se numri i partive anëtare të koalicionit, për efekt regjistrimi nga KQZ-ja, ka ndryshuar nga shtatë në dy. Duke evidentuar faktin që koalicioni tashmë ishte regjistruar në KQZ e për rrjedhim edhe partitë përbërëse të tij janë të vendosura, KSHZ-ja vendosi me vendimin nr. 165 datë 18.03.2021 "refuzimin e listave shumemërore të Koalicionit Aleanca". Vendimi i Komisionerit u ankimua në KAS, i cili me vendimin nr. 6 datë 24.03.2021, me unanimitet votash la në fuqi vendimmarrjen e Komisionerit për mosregjistrimin e listës së kandidatëve të koalicionit Aleanca. Edhe Kolegji Zgjedhor pas shqyrtimit të kësaj çështje me vendimin nr. 4, datë 31.03.2021 la në fuqi vendimmarrjen e Komisionerit.

317 PD dhe LSI konkurruan në zgjedhje me dy lista (PD-AN + LSI), për të realizuar një përfaqësim të plotë dhe sa më gjithëpërfshirës politiko-elektoral, sipas deklarimeve publike të bëra prej tyre. Përfaqësimi në të gjitha nivelet e qeverisjes së ardhshme do të realizohej proporcionalisht mbi bazën e rezultatit zgjedhor.

318 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 67 "Lista e kandidatëve të partive dhe koalicioneve të partive", pika 1.

një partie të caktuar[319]. Përjashtim nga ky rregull përbëjnë kryetarët e partive politike, të cilët, sipas amendimeve të njëanshme të 5 tetorit të vitit 2020 në Kodin Zgjedhor[320], mund të kandidojnë deri në katër qarqe, me të drejtën për të zgjedhur mandatin që do të mbajnë nëse fitojnë në më shumë se një zonë.
Kryetarët e disa partive e ushtruan këtë të drejtë, përfshi kryetarin e PS-së, LSI-së dhe PSD-së[321]. KRIIK vlerëson se kjo dispozitë ligjore shkel parimin e barazisë të kandidatëve në garë.
Procesi i regjistrimit të listës shumemërore të kandidatëve për partitë politike të cilat zotërojnë mandat në Kuvendin e Shqipërisë, konsiston vetëm në plotësimin e dokumentacionit administrativ. Ndërkohë, regjistrimi i kandidatëve të propozuar nga partitë politike të cilat nuk zotërojnë asnjë mandat në Kuvend duhet të mbështeten nga jo më pak se 5 000 zgjedhës ose në rastin e koalicioneve nga jo më pak se 7 000 zgjedhës në shkallë kombëtare[322]. Bën përjashtim nga ky rregull koalicioni, ku partitë pjesëtare zotërojnë bashkërisht në Kuvend një numër mandatesh jo më të vogël se numri i partive pjesëtare të koalicionit.
11 parti politike[323] dhe tri koalicione[324] paraqitën lista shumemërore në KQZ, deri në datën 8 mars 2021. Listat e kandidatëve të depozituara prej 13 subjekteve[325] u kthyen për korrigjim nga KQZ[326], për shkak të mangësive në dokumentacion, që lidheshin kryesisht me numrin e kandidatëve në listë[327], mosrespektim të kriterit gjinor[328], mangësi të dokumentacionit shoqërues si dokumenti i identifikimit, formularët e vetëdeklarimit etj.[329] Pas përfundimit të procesit të korrigjimit, listat e dy subjekteve zgjedhore[330] nuk u miratuan nga Komisioneri.
Partia Lëvizja Socialiste për Integrim dhe Partia Demokratike, për shkak të vendimit për tërheqjen e deputetëve nga parlamenti në janar të vitit 2019, ishin parti jo parlamentare në prag të këtyre zgjedhjeve. Kjo nënkuptonte që mënyra e vetme e regjistrimit të listave të kandidatëve për këto zgjedhje, do të ishte mbledhja e nënshkrimeve[331].
Nga shqyrtimi i dokumentacionit mbështetës, rezulton se LSI-ja është regjistruar nëpërmjet paraqitjes së një vërtetimi nga Kuvendi i Shqipërisë[332] për zotërimin e një mandati deputeti.
Ndërsa, Koalicioni PD-AN i regjistroi listat shumemërore në KQZ nëpërmjet paraqitjes së firmave mbështetëse. Konkretisht PD paraqiti 14 750 firma mbështetëse.
Udhëzimi[333] i miratuar nga Komisioneri Shtetëror për Zgjedhjet, përcaktoi si detyrim për kandidatët dorëzimin dhe publikimin në faqen zyrtare të internetit të jetëshkrimit të kandidatëve.

319 Po aty, pika 3.

320 Po aty.

321 Kryetari i Partisë Socialiste kandidoi në dy zona zgjedhore; Kryetarja e Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim kandidoi në 3 zona zgjedhore; Kryetari i Partisë Socialdemokrate kandidoi në 2 zona zgjedhore; Kryetari i Partisë Nisma Thurje kandidoi në 4 zona zgjedhore; Kryetarja e Partisë Lëvizja për Ndryshim kandidoi në 4 zona zgjedhore; Kryetari i Partisë Balli Kombëtar kandidoi në 4 zona zgjedhore dhe Kryetari i Partisë Lëvizja Demokratike Shqiptare kandidoi në 4 zona zgjedhore.

322 Po aty, Neni 68 "Listat mbështetëse të partive politike dhe koalicioneve" pika 1.

323 Lëvizja Socialiste për Integrim, Partia Lëvizja e Re, Partia Lëvizja për Ndryshim, Partia Aleanca Demokracia e Re, Partia Lëvizja Demokratike Shqiptare, Partia Nisma Thurje, Partia Balli Kombëtar, Partia Bindja Demokratike, Partia Socialdemokrate dhe Partia Socialiste e Shqipërisë.

324 Koalicioni "Aleanca për Ndryshim – Partia Demokratike", Koalicioni "Aleanca", Koalicioni "Aleanca Bashkimi Popullor – Emigracioni – Ora e Shpresës dhe Konservatorët".

325 Të gjitha subjektet kishin mangësi në dokumentacion, përveç partisë Lëvizja Socialiste për Integrim.

326 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 73 "Verifikimi i dokumentacionit", pika 1.

327 Po aty, Neni 67 "Lista e kandidatëve të partive dhe koalicioneve të partive" pika 4.

328 Po aty, Neni 67 "Lista e kandidatëve të partive dhe koalicioneve të partive" pika 6.

329 Po aty, Neni 72, "Dokumentet e kandidimit".

330 Lista shumemërore e kandidateve të propozuar nga koalicioni "Aleanca" dhe lista shumemërore e kandidatëve të propozuar nga partia Aleanca Kombëtare.

331 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 68 "Listat mbështetëse të partive politike dhe koalicioneve" pika 1.

332 Vërtetim i Kuvendit të Shqipërisë, nr. 499/1 datë 16.02.2021, me anë të të cilit vërtetohet se në bazë të deklarimit të paraqitur në Kuvend, deputeti Gjetan Gjetani ka deklaruar përkatësinë në partinë politike Lëvizja Socialiste për Integrim.

333 Udhëzim nr. 01, datë 23.12.2020 Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve "Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit".

Formati përkatës i miratuar ishte shumë i thjeshtë dhe i tillë që u lë mundësi kandidatëve të shmangen nga detyrimi për të ofruar transparencë të plotë mbi edukimin, formimin, angazhimin dhe të shkuarën e tyre. Lidhur me nevojën për paraqitjen në mënyrë të plotë të jetëshkrimit dhe angazhimeve të kandidatit, referuar edhe përvojës së zgjedhjeve të mëparshme, KRIIK i dërgoi KQZ-së, përpara miratimit të këtij udhëzimi, sugjerime[334] për përmirësimin e formatit të jetëshkrimit.
Nga shqyrtimi i jetëshkrimeve të kandidatëve, u vu re se rreth 50% e kandidatëve kishin të publikuar një jetëshkrim që nuk përmbante thuajse asnjë të dhënë ose të dhënat ishin shumë të përgjithshme, ku mungonte informacioni i nevojshëm, minimal për efekt të të cilit është gjykuar i rëndësishëm publikimi i CV-së.

VI.3.1. NUMRI I KANDIDATËVE NË LISTËN E PD-AN

Kodi Zgjedhor[335] i cili parashikon numrin e kandidatëve për çdo zonë zgjedhore, u ndryshua me reformën zgjedhore të ndrmarrë në vitin vitit 2020[336]. Sipas përllogaritjeve të këtij neni, numri i kandidatëve që duhet të depozitonte çdo subjekt zgjedhor është 153 kandidatë.
Disa subjekte paraqitën listat me më shumë kandidatë se numri i nevojshëm. Kjo ishte shkak ose një nga shkaqet e kthimit të listave për plotësim për këto subjekte nga ana e Komisionerit. Subjekti që nuk reflektoi ndryshime në listë edhe pas kthimit për plotësim ishte Partia Demokratike, e cila nuk e ndryshoi listën e depozituar në KQZ me 222 kandidatë. Në vazhdim të procesit dhe në koherencë me vendimmarrjen e mëparshme, Komisioneri vendosi të regjistronte listën e PD duke "fshirë" kandidatët e gjendur në tejkalim të numrit të nevojshëm në listë.
Pavarësisht një qëndrimi koherent nga ana e Komisionerit mbi interpretimin e normës përsa i përket numrit të kandidatëve, KAS nuk reflektoi të njëjtën qëndrim në vendimmarrjen[337] e tij për këtë çështje, duke evidentuar KQZ-në në këtë rast jo si një institucion i vetëm.
Çështja vijoi me ankimim në Kolegjin Zgjedhor, i cili me votim katër me një vendosi[338] të linte në fuqi vendimin e Komisionerit, dhe koalicioni PD-AN të përfaqësohej në listën e kandidatëve me 153 deputetë.
Ky proces, passolli vështirësi dhe vonesa në ndjekjen në kohë të procedurave jo vetëm për formën finale të fletës së votimit, çka ishte e nevojshme për një fushatë efektive edukimi dhe sensibilizimi të zgjedhësve, por edhe, në procedurat e prokurimit me kompaninë për prodhimin e fletës së votimit.
Përpos kësaj, evidentohet si problematik moskonkludimi në një listë më kompakte brenda numrit të kërkuar sipas ligjit, bashkëshoqëruar kjo me mungesën e përzgjedhjes e të konsultimit paraprak brenda forumeve të subjektit politik. Situatë kjo, që e shndërron përzgjedhjen dhe të qënit kandidat në një plotësim dëshirash apo 'detyrimesh' të ndërsjella interesash të ngushta politike.

VI.4. PROCESI I DEKRIMINALIZIMIT

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka një rol kyç në mbrojtjen dhe garantimin e mirëfunksionimit demokratik të Kuvendit nga ndikimi apo pjesëmarrja në politikëbërje dhe/ose vendimmarrje i personave ndaj të cilëve ligji ka vendosur ndalime në mbajtjen e ushtrimin e një pozicioni publik[339].

334 KRIIK, Opinion, dhjetor 2020, Mbi projekt-udhëzimin "Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit".

335 Kodi Zgjedhor, Neni 67, "Lista e kandidatëve të partive dhe koalicioneve të partive", pika 4.

336 Ligj nr. 118/2020 datë 5.10.2020. Kuvendi i Shqipërisë, Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

337 Vendim nr. 9, datë 23.03.2021, Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve "Për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr.05, datë 19.03.2021 të koalicionit Partia Demokratike Aleanca për Ndryshim ndaj vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr.156, datë 17.03.2021."

338 Vendimi nr. 3 datë 29.03.2021, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, Vendimi "Për shqyrtimin e kërkesës ankimore Nr. 05 Datë 19.03.2021, Të Koalicionit Partia Demokratike – Aleanca Për Ndryshim (PD-AN) me objekt "Kundërshtimin e Vendimit Nr. 156, datë 17.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve".

339 Persona që janë dënuar apo ndaj të cilëve janë marrë masa sigurie, ose janë dënuar me vendim jopërfundimtar për kryerjen e krimeve, sipas parashikimeve të Ligjit nr. 138/2015, datë 17.12.2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen apo ushtrojnë funksione publike" (i ashtuquajturi ligji i dekriminalizimit), si dhe të Vendimit nr. 17, datë 04.03.2016, Kuvendi i Shqipërisë, botuar në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë 10.03.2016.

Në funksion të procesit të regjistrimit të kandidatëve për deputetë në zgjedhjet e datës 25 prill 2021, KQZ administroi formularët e vetëdeklarimit, dhe përpara vendimmarrjes për regjistrimin e listave përkatëse të subjekteve, realizoi procesin e verifikimit të tyre, duke kërkuar zyrtarisht, sikurse e parashikon ligji, informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.
Për shkak të afateve të ngushta kohore, që diktojnë realizimin e verifikimit për përfshirje në sferën e ndalimit të ligjit të dekriminalizimit, për çdo element që mund të tejkalohet përgjatë kësaj faze, KQZ disponon të drejtën t'i drejtojë në çdo moment Prokurorisë së Përgjithshme raste për verifikime apo hetime të thelluara[340].
Formularët e vetëdeklarimit për çdo kandidat, depozitohen në KQZ[341] nga subjekti politik përkatës. Referuar kuadrit ligjor[342], këto formularë duhet të jenë të plotësuar me kompjuter në mënyrë të qartë, të firmosen në çdo fletë dhe të dorëzohen në KQZ në format elektronik dhe të printuar. Pas përfundimit të regjistrimit, KQZ-ja bëri publikimin e formularëve në faqen zyrtare të internetit. Vërehet se ka nëntë kandidatë për të cilët ky formular jo vetëm nuk u publikua në kohë, por vijon ende të jetë i papublikuar[343].

Nga këqyrja e formularëve të publikuar të vetëdeklarimit, vërehet problematika e plotësimit me shkrim dore në 972 kandidatë (53%)[344], përfaqësues të 11 subjekteve[345] zgjedhore, si dhe për dy kandidatë të pavarur[346]. Plotësimi në mënyrë korrekte i Formularit të Vetëdeklarimit është shumë i rëndësishëm jo vetëm në kuptim të respektimit të ligjit, por për të evituar çdo mundësi ngatërresash apo keqleximesh në deklarimet e kandidatëve.
Për veprat penale të ndodhura brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, dhe/ose ndryshimet e gjeneraliteteve apo çdo masë shtrënguese të vendosur më parë ndaj secilit kandidat, dhe/ose të deklaruar prej tyre, KQZ kreu verifikimin *prima facie* të formularëve të vetëdeklarimit të kandidatëve për deputet nëse përfshiheshin në fushën e veprimit të nenit 2 të ligjit nr. 138/2015.
Në funksion të këtij verifikimi KQZ i dërgoi kërkesë me shkrim Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile (DPGJC) dhe Drejtorisë së Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore (DPGJGJ). Nga këqyrja e vendimeve të Komisionerit, konstatohet se DPGJC nuk ka kthyer përgjigje për asnjë prej listave të përcjella për shqyrtim[347], ndërsa DPGJGJ ka kthyer përgjigje vetëm për listat e 9 subjekteve nga 12 të tilla[348].

340 Po aty.

341 Udhëzimi nr.2, datë 29.01.2013, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, "Për caktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit dhe afatet për publikimin e listave të kandidatëve", ndryshuar me Vendimin nr. 44 datë 17.02.2017 "Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 2, datë 29.01.2013 "Për caktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit dhe afatet për publikimin e listave të kandidatëve" dhe Vendimin nr. 22 datë 01.02.2019 "Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 2, datë 29.01.2013 "Për caktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit dhe afatet për publikimin e listave të kandidatëve" Vendimi nr. 17/2016, datë 04.03.2016 i Kuvendit të Shqipërisë, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

342 Po aty.

343 Znj. Entela Muça dhe z. Ermal Muçaj, kandidatë të listës shumemërore të Partisë Socialdemokrate në Qarkun Elbasan dhe z. Sejdi Babaliu kandidat në Qarkun Berat. z. Flamur Alimadhi, kandidat i listës shumemërore të Partisë Balli Kombëtar, Qarku Durrës dhe z. Gëzim Hysenllari, kandidat i qarkut Tiranë. z. Flogert Muça kandidat i listës shumemërore të Partisë Nisma Thurje Qarku Vlorë dhe Marsel Rupi kandidati i listës shumemërore të Qarkut Durrës. Znj. Drita Duka kandidate e listës shumemërore të Koalicionit Aleanca Bashkimi Popullor – Emigracioni - Ora e Shpresës dhe Konservatorët, Qarku Vlorë. Znj. Anxhela Zavalani kandidate e listës shumemërore të Partisë Bindja Demokratike, Qarku Tiranë.

344 Nga totali prej 153 kandidatë në listën shumemërore të çdo subjekti garues formulari i vetëdeklarimit është plotësuar me shkrim dore nga: 123 kandidatë të koalicionit ABEO, 74 kandidatë të Koalicionit Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim, 142 kandidatë të Partisë Aleanca Demokracia e Re, 151 kandidatë të Partisë Balli Kombetar, 84 kandidatë të Partisë Bindja Demokratike, 3 kandidatë të Partisë Lëvizja Demokratike Shqiptare, 63 kandidatë të Partisë Lëvizja e Re, 101 kandidatë të Partisë Lëvizja për Ndryshim, 144 kandidatë të Partisë Nisma Thurje, 59 kandidatë të Partisë Socialdemokrate, 28 kandidatë të Partisë Socialiste e Shqipërisë.

345 Kjo praktikë është aplikuar nga të gjitha subjektet, përveç partisë Lëvizjes Socialiste për Integrim.

346 Z. Plarent Aleksi, kandidat i pavarur, në Qarkun e Beratit. Pal Shkambi, kandidat i pavarur, në Qarkun e Shkodrës.

347 Me përjashtim të kërkesës për kandidatin e pavarur z. Pal Shkambi. Duke iu referuar të dhënave të deklaruara në formularin e vetëdeklarimit të këtij subjekti evidentohet ndryshimi i datës së lindjes.

348 DPGJGJ-ja nuk ka kthyer përgjigje për subjektet: Koalicioni Aleanca Bashkimi Popullor - Emigracioni - Ora E Shpresës dhe Konservatorët (ABEOK), Partia Socialdemokrate (PSD) dhe Koalicioni Partia Demokratike "Aleanca për Ndryshim" (PD-AN).

Kjo mungesë bashkëpunimi nga institucionet shtetërorë në përmbushje të një detyrimi ligjor ndaj Komisionit Qendror të Zgjedhjeve gjatë një procesi zgjedhor, veçanërisht në lidhje me një proces kaq kyç sa ai i dekriminalizimit, tregon, më së paku, neglizhencë në përmbushjen e detyrimeve ligjore të këtyre institucioneve.

Rregullat për plotësimin e formularit të vetëdeklarimit janë të përfshira në vendimin e Kuvendit të Shqipërisë [349] sipas të cilit pasqyrimi i të dhënave të pavërteta, të paplota, dhe të pasakta në formularin e vetëdeklarimit passjell përjashtimin e menjëhershëm dhe në çdo kohë nga kandidimi/zgjedhja/emërimi apo nga funksioni publik, si dhe përbën vepër penale[350].

Referuar formularëve të vetëdeklarimit të kandidatëve dhe përgjigjeve të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve është konstatuar një kandidat, i cili në formular nuk ka deklaruar[351] të dhëna mbi gjendjen gjyqësore, por që nga përgjigja zyrtare e DPGJGJ ndaj KQZ-së rezultonte të kishte qenë i dënuar. Pavarësisht kësaj situate kandidati është lejuar të kandidojë.

Në vendimmarrjen e Komisionerit për regjistrimin final të listave të kandidatëve të secilit subjekt përfshihen të dhënat e deklaruara në formular për secilin kandidat të atij subjekti, edhe kur ai/ajo nuk është në kushtet e ndalimit të kandidimit sipas ligjit 138/2015. Sipas këtyre vendimeve 42 kandidatë nga të gjitha subjektet zgjedhore kanë deklaruar dënime të cilat nuk përfshihen në sferën e ndalimit, por nga këqyrja e formularëve rezulton të jenë 63 kandidatë me të dhëna të tilla të përfshira në formularin e vetëdeklarimit.

Ndërkohë nga këqyrja e çdo formulari rezulton se janë 54 kandidatë[352] që kanë deklaruar ndryshime të gjeneraliteteve, emrit, mbiemrit, datëlindjes apo edhe ndryshim të emrit dhe mbiemrit në të njëjtën kohë, si dhe, 42 kandidatë nga 1.841 të tillë kanë deklaruar në formular të dhëna që korrespondojnë me dënime të formës së prerë nga gjykatat[353]. Kandidatët janë pjesë e listave shumemërore të 11 subjekteve[354].

Tetë[355] kandidatë rezultojnë të kenë deklaruar në formularin e dekriminalizimit 13 dënime

349 Vendimit nr. 17/2016, datë 04.03.2016, Kuvendi i Shqipërisë, Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" Kreu III, Përmbajtja, efektet dhe modeli i formularit të vetëdeklarimit.

350 Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, Neni 190, "Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve" (Ndryshuar me ligjin nr.9188, datë 12.2.2004, neni 6; shtuar me ligjin nr. 9275, datë 16.9.2004, neni 15; shfuqizuar me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 47, datë 26.7.2012, pjesa që parashikon dënimin me gjobë si dënim kryesor).

351 Nga monitorimi i formularit të vetëdeklarimit evidentohet se kandidati për deputet i subjektit politik "Nisma Thurje" z. Napolon Laska nuk ka raportuar të dhëna mbi gjendjen gjyqësore në formularin e vetëdeklarimit e dorëzuar në KQZ. Ndërkohë që në bazë të vërtetimit të gjendjes gjyqësore nr. 17 prot., datë 09.03.2021, me vendimin nr. 219 datë 22.05.2018, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier e ka deklaruar fajtor për veprën penale të "Pengim i qarkullimit të mjeteve të transportit rrugor", parashikuar nga neni 293, 55 i Kodi Penal dhe nenit 406 K.Pr.P, i cili është dënuar me 3 (tre) muaj burgim. Në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal urdhërohet pezullim i ekzekutimit të dënimit për 6 (gjashtë) muaj me kusht. Rehabilituar në bazë të nenit 69 të Kodit Penal.

352 - Njëzeteshtatë kandidatë kanë ndryshuar emrin, nga të cilët tetë janë pjesë e listës shumemërore të Koalicionit ABEOK, gjashtë kandidatë janë pjesë e listës shumemërore të Partisë Socialiste, tre kandidatë janë pjesë e listës shumemërore të Lëvizjes Socialiste për Integrim, dy kandidatë janë pjesë e listës shumemërore të Koalicionit PD-AN, një kandidat i përket Partisë Bindja Demokratike, një kandidat i përket Aleanca Demokracia e Re, katër kandidatë i përkasin listës shumemërore të Partisë Lëvizja e Re dhe dy kandidatë Partisë Lëvizja për Ndryshim.

- Tetëmbëdhjetë kandidatë kanë ndryshuar mbiemrin, nga të cilët dy kandidatë i përkasin subjektit politik Partisë Socialiste, dy kandidatë i përkasin Partisë Socialdemokrate, tre kandidatë i përkasin Lëvizjes Socialiste për Integrim, një kandidat i përket Koalicionit ABEOK, gjashtë kandidatë i përkasin Koalicionit PD-AN, një kandidat i përket Partisë Aleanca Demokracia e Re, një kandidat i përket Partisë Lëvizja e Re dhe dy kandidatë u përkasin Partisë Nisma Thurje.

- Gjashtë kandidatë kanë ndryshuar datëlindjen, nga të cilët, dy i përkasin Partisë Socialiste, një kandidat i përket Partisë Demokratike, një kandidat i përket Lëvizjes Socialiste për Integrim dhe një kandidat i Pavarur.

- Tre kandidatë kanë ndryshuar edhe emrin, edhe mbiemrin, nga të cilët dy kandidatë i përkasin Partisë Lëvizja e Re dhe një kandidat i përket Koalicioni Partia Demokratike Aleanca për Ndryshim.

353 Nga këta, 34 kanë deklaruar dënime me masë administrative me gjobë ose alternative, të tilla si shërbim prove, punë në interes publik, dënim me gjobë, detyrim paraqitjeje etj.

354 Tre kandidatë të Koalicionit ABEOK, një Kandidat i Pavarur, tre kandidatë të Partisë Socialiste të Shqipërisë, një kandidat i Partisë Lëvizja për Ndryshim, katër kandidatë të Partisë Socialdemokrate, një kandidat i Partisë Nisma Thurje, tetë kandidatë të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, katër kandidatë të Partisë Bindja Demokratike, tre kandidatë të Partisë Lëvizja e Re, një kandidat i Partisë Aleanca Demokracia e Re, dy kandidatë të Partisë Lëvizja Demokratike Shqiptare, një kandidat i Partisë Demokratike.

355 Z. Ardian Nikulaj kandidat i listës shumemërore të Partisë Socialdemokrate, Qarku Lezhë. Gjykata e Lezhës me vendimin nr. 124 datë 24.11.2003, e ka dënuar për veprën penale parashikuar nga neni 278, për të cilën është dënuar me 4 (katër) muaj. Gjykata e Triestes, Itali në periudhën 1997-1999 është dënuar me 21 muaj burg për veprën penale "Rrahje". Gjykata Vlorë në periudhën 1986-1991 e ka dënuar me dy vite burg për arsye "Politike".

me burg, tre prej të cilëve kanë deklaruar me shumë sesa një vendim gjyqësor me burg, me shtrirje kohore nga dhjetë ditë deri në gjashtë vjet.

VI.4.1. REFERIMI PËR VERIFIKIM TË THELLUAR NË PROKURORINË E PËRGJITHSHME

Dy subjektet zgjedhore Partia Socialiste dhe Partia Demokratike bënë akuza të ndërsjella për përfshirje në listat e kandidatëve të individëve të cilët preken nga ligji i dekriminalizimit. Këto akuza u bënë nëpërmjet deklaratave publike në media, dhe shërbyen edhe si indicie për KQZ-në, për të referuar këto raste në Prokurorinë e Përgjithshme për një hetim më të thelluar.
KQZ, referoi për verifikim të thelluar në Prokurorinë e Përgjithshme 30 kandidatë, nga të cilët 28 ishin përfaqësues të nëntë subjekteve zgjedhore dhe dy ishin kandidatë të pavarur[356]. Verifikimi i thelluar nga Prokuroria është kërkuar edhe për kandidatë, të cilët në formularin e dekriminalizimit nuk kanë deklaruar[357] asnjë të dhënë të dyshimtë.
Gjithashtu, përpos KQZ-së, edhe Partia Demokratike e Shqipërisë ka përcjellë për verifikim të thelluar në Prokurorinë e Përgjithshme një kandidat[358]. Ky përbën rastin e parë kur një subjekt zgjedhor kërkon verifikim nga Prokuroria për një kandidat, të cilin e ka vendosur vetë në listat e kandidatëve. Kjo është një praktikë, që në gjykimin e KRIIK, duhet të aplikohet nga partitë përpara depozitimit të emrave të kandidatëve në KQZ, si një etapë që do ta ndihmonte edhe KQZ-në në procesin e verifikimit e për rrjedhim edhe qytetarët në funksion të evitimit të përzgjedhjes së kandidatëve me probleme të pastërtisë së figurës.
Nga komunikimi zyrtar i KRIIK me Prokurorinë e Përgjithshme, sipas kësaj të fundit procesi i verifikimit ka përfunduar për vetëm 10 kandidatë[359] dhe është në proces për pjesën tjetër. Nga

Z. Ido Pashaj, kandidat i listës shumemërore të Partisë Koalicioni Aleanca Bashkimi Popullor Emigracioni - Ora e Shpresës dhe Konservatorët Qarku Fier është dënuar nga Gjykata Rajonale Vlorë, për veprën penale "Agjitacion, Propagandë", sipas nenit 55 të Kushtetutës, masa e dënimit me burg gjashtë vite.
Z. Tom Doshi kandidat i listës shumemërore të Partisë Socialdemokrate Qarku Shkodër është dënuar nga Kolegji Ushtarak i Gjykatës së rrethit Durrës me një vit heqje lirie më datë 25.05.1990 për sjellje të padenjë në shoqëri sipas nenit 121 dhe 31/a të Kodit Penal.
Z. Ferdinand Aligjoni kandidat i listës shumemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim Qarku Vlorë. Me vendimin nr. 276 datë 06.12.1989, Gjykata e Rrethit Vlorë e deklaron fajtor për veprën penale të "Vjedhjes së Pasurisë Qytetare", parashikuar nga neni 101/1 Kodi Penal dhe e dënon me 6 (gjashtë) muaj heqje lirie.
Z. Gjergji Thanasi kandidat i listës shumemërore të Koalicioni Aleanca Bashkimi Popullor Emigracioni - Ora e Shpresës dhe Konservatorët Qarku Durrës ka deklaruar se me vendimin nr. 119 datë në 31.07.1990, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës e ka dënuar për dy vepra penale, respektivisht me 6 (gjashtë) muaj burgim dhe një dënim tjetër me 45 ditë burgim, por kandidati nuk ka specifikuar të dhënat për veprën penale.
Z. Pal Shkambi kandidat i Pavarur në Qarkun Shkodër, në vitin 1982 është dënuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, akuzuar për veprën penale, Përvetësim të Pasurisë Socialiste, për motive politike, vepër penale për të cilën është dënuar me 2 (dy) vite burgim;
Në vitin 1983, është dënuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, akuzuar për veprën penale, Përvetësim të Pasurisë Socialiste, për motive politike, vepër penale për të cilën është dënuar me 20 (njëzetë) muaj burgim;
Z. Edi Paloka, kandidat i listës shumemërore të Koalicioni Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim, Qarku Durrës, është caktuar masë e sigurisë arrest me burg, masë e cila është revokuar, nga Gjykata Shkallës së Parë Tiranë, për veprën penale "Miting i paligjshëm për kundërshtim me forcë të policisë", më datë 30.01.2000, për të cilën është vendosur vendim përfundimtar arrest me burg për një afat 10 (dhjetë) ditor.
Z. Bahri Shabani kandidat i listës shumemërore të Partisë Bindja Demokratike, Qarku Shkodër, Gjykata Darmstad, Gjermani, e ka dënuar me burg për rreth një muaj për veprën penale Emigrim i Paligjsh
ëm, ndryshim i identitetit, duke u paraqitur si shtetas kosovar.

356 - *Koalicioni ABEOK*: z. Altin Gjeloshaj, znj. Elsa Voka, z. Daniel Prroj, z. Ervis Beu, z. Ido Pashaj; - *Partia Lëvizja Socialiste për Integrim*: z. Arbër Arifaj, z. Ashim Tafilaku, z. Elton Ismaili, Ferdinant Aligjoni, z. Ilir Hysi, z. Artur Baku; - Partia Demokratike: z. Agron Kapllanaj, z. Gentjan Muca; z. Rezart Tusha; z. Zef Hila; - *Partia Socialdemokrate*: z. Kleo Murataj, z. Tom Doshi, z. Serdar Hoxhaj; - *Partia Socialiste*: z. Artan Bitri; z. Halim Dauti; z. Leonard Beqiri; - *Partia Bindja Demokratike*: z. Arsen Belaj, z. Bahri Shabani; - *Partia Nisma Thurje*: z. Boris Shakaj, z. Napolon Laska; - *Partia Lëvizja për Ndryshim*: z. Dashamir Tahiri, z. Adrian Gjoka; - *Partia Lëvizja e Re*: z. Ilmi Kuka: kandidatë të Pavarur Pal Shkambi dhe Boiken Abazi.

357 Z. Zef Hila, kandidat i subjektit Partia Demokratike, në formularin e vetëdeklarimit nuk evidentohen të dhëna të dyshimta mbi gjendjen gjyqësore. Z. Serdar Hoxhaj, kandidat i Partisë Socialdemokrate, në formularin e vetëdeklarimit nuk evidentohen të dhëna të dyshimta mbi gjendjen gjyqësore. Z. Napolon Laska, kandidat i Partisë Nisma Thurje, nuk ka raportuar të dhëna të dyshimta mbi gjendjen gjyqësore, edhe pse duke iu referuar përgjigjes së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve konstatohet të ketë konsumuar veprën penale "Pengim i qarkullimit të mjeteve të transportit rrugor".

358 Z. Rezart Tusha, kandidat i Partisë Demokratike në Qarkun Durrës.

359 Z. Zef Hila, z. Artur Baku, z. Napolon Laska, z. Vullnet Gjoka dhe z. Boiken Abazi, z. Arsen Belaj, Z. Ido Pashaj, Z. Tom Doshi, Z. Daniel Prroj dhe Z. Ervis Beu.

e gjithë lista e dërguar për t'u verifikuar, vetëm një kandidat[360] morri mandatin e deputetit, por dha dorëheqjen më pas. *De facto* verifikimi i Prokurorisë do të mbetet një procedurë që duhet përfunduar, por që pavarësisht rezultatit të verifikimit nuk do të ketë ndikim, duke qenë se ka humbur objekti dhe qëllimi i verifikimit të thelluar.
KRIIK rekomandon që verifikimi i kandidatëve të jetë një proces që duhet të përfundojë mundësisht përpara ditës së zgjedhjeve. Edhe nëse rezulton objektivisht i pamundur për shkak të kohës së nevojshme në rastet e verifikimeve jashtë vendit, së paku duhet të bëhen përpjekje ndërinstitucionale dhe ndërveprimi më të mira që të bëhet i mundur publikimi i rezultateve të verifikimit së paku brenda territorit të Shqipërisë.

VII. FUSHATA ZGJEDHORE

VII.1. MJEDISI I FUSHATËS

Fushata zgjedhore u dominua nga drejtuesit e partive politike dhe u vu re se i mungoi debati racional, i bazuar në programe e oferta qeverisëse konkrete. Liria e shprehjes dhe e grumbullimit u respektua përgjatë fushatës pavarësisht kufizimeve të vendosura për mbrojtjen e shëndetit publik, si rezultat i pandemisë së shkaktuar nga Covid-19.
Kuadri ligjor parashikon se fushata zgjedhore, periudhë në të cilën subjektet zgjedhore kanë detyrimin të veprojnë sipas rregullave të përcaktuara nga Kodi Zgjedhor[361], fillon 30 ditë përpara ditës së zgjedhjeve. Mungesa e një përkufizimi të qartë të fushatës në ligj, krijon mundësinë që subjektet zgjedhore t'a anashkalojnë dispozitën ligjore dhe t'a nisin fushatën më herët[362].
Partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhje, shpalosën programet politike dhe zhvilluan takime me karakter elektoral me qytetarët disa muaj përpara nisjes zyrtare të fushatës[363]. Tubimet e hapjes zyrtarisht të fushatës, u mbajtën gjithashtu një ditë përpara datës së parashikuar nga Kodi Zgjedhor[364]. Media raportoi në mënyrë aktive aktivitetet e partive politike, përgjatë periudhës së fushatës së parakohshme zgjedhore.
Si aktivitetet e fushatës së parakohshme zgjedhore, ashtu edhe organizimi i aktivitetit hapës dhe mbyllës së fushatës në fushatë zyrtare nuk respektuan, kufizimet e vendosura nga Ministria e Shëndetësisë sipas Urdhrit që ndaloi grumbullimet e me më shumë se dhjetë personave[365].
Partia Socialiste, u përqendrua tek takimet *online* përgjatë fushatës së parakohshme, ku takimet me qytetarët apo grupet e interesit zhvilloheshin nëpërmjet takimeve në platformat digjitale. Përgjatë fushatës, PS ndryshoi strategji, duke zhvilluar takime që në parim ruanin distancat fizike për mbrojtjen nga COVID-19, por që shkelnin urdhrin e ndalimit të grumbullimeve. Ndërsa Partia Demokratike dhe partitë e tjera opozitare u përqendruan si para fushatës zgjedhore, ashtu edhe përgjatë asaj zyrtare, jo vetëm në takime shëtitëse derë më derë me qytetarët, por edhe në mitingje masive në sheshet e qyteteve.
Organizimet e tubimeve, përveçse nuk respektonin udhëzimet e Urdhrit të Ministrisë së Shëndetësisë, u kthyen në një nga temat e debatit mes maxhorancës dhe opozitës[366].

360 Z. Tom Doshi, Partia Socialdemokrate dhe z. Zef Hila, Partia Demokratike.

361 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 77, "Periudha e fushatës dhe e heshtjes zgjedhore".

362 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 2 "Përkufizimet".

363 Partia Demokratike shpalli e programin ekonomik më 28 janar 2021. Lëvizja Socialiste për Integrim e shpalli programin ekonomik më 25 janar 2021. Partia Socialiste e shpalli programin e saj për drejtësinë "Drejtësia që duam" më 3 mars 2021.

364 PS-ja dhe PD-ja hapën zyrtarisht fushatën në Tiranë në dy sheshet kryesore më datën 25 mars, një ditë më parë se data 26 mars e parashikuar në bazë të Kodit Zgjedhor.

365 Urdhër i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Nr.633 datë 17.11.2020, "Ndalimi i grumbullimeve në vende të mbyllura apo të hapura".

366 Takimet e kreut të PD-së nëpër rrethe do të fillonin gjithnjë me tubimin që organizohej nga simpatizantë të kësaj partie në qendër të qyteteve, të cilat thyenin rregullat e vendosura nga Komiteti Ekspertëve për ndalimin e tubimeve masive. (*shih*: Mitingu elektoral në Durrës dhe Malësi të Madhe! Basha pritet me entuziazëm nga qytetarët)

Pavarësisht retorikës politike, kjo çështje nxori në pah një problematikë edhe më të rëndësishme, siç ishte fryma e pandëshkueshmërisë, apo ndëshkimi selektiv, për të njëjtën shkelje. Media raportoi se përgjatë fushatës parazgjedhore, përfaqësues të disa partive politike u dënuan me gjobë nga Policia e Shtetit, për shkelje të kufizimeve kundër përhapjes së COVID-19[367]. Përgjatë fushatës zyrtare, instancat shtetërore përkatëse nuk mbajtën asnjë qëndrim për shkeljet e partive të mëdha. Ndërkohë, një sjellje totalisht e ndryshme u konstatua ndaj dy kandidatëve të pavarur, të cilët u gjobitën për shkelje të Urdhrit të Ministrisë për tubimet[368], duke shkelur parimin e barazisë në garë për konkurrentët zgjedhorë.
Edhe më shqetësues mbetet fakti se vetë Kryeministri Rama nëpërmjet deklaratave publike nxiti parimin e pandëshkueshmërisë dhe njëanshmërisë[369]. Frymën e pandëshkueshmërisë dhe shkeljes së rregullave anti-covid, kreu u qeverisë, e artikuloi edhe pas vendimit të Ministrisë së Shëndetësisë, në të cilin vendosi karantinën e detyruar 14-ditor, për qytetarët shqiptarë, të cilët do të hynin në Shqipëri, nga shtetet fqinje, si Greqia dhe Maqedonia e Veriut, duke hequr në këtë mënyrë të drejtën e tyre për të votuar[370].
Çështja e menaxhimit të pandemisë, zuri një hapësirë shumë të gjerë ne retorikën politike, sidomos përpara fillimit të fushatës zyrtare, por edhe përgjatë saj.
Fushata e vaksinimit, kundër Covid-19 u përdor gjerësisht nga maxhoranca socialiste për përfitim kreditesh gjatë fushatës, ku nuk munguan as spotet apo posterat në rrjete sociale ku bëhej thirrje për vaksinimin e popullsisë me logon dhe ngjyrat e Partisë Socialiste. Pavarësisht se kjo fushatë është një detyrim i institucioneve përkatëse, figura të larta të Partisë Socialiste, e konsideruan menaxhimin e saj tërësisht si një meritë të qeverisë dhe kryeministrit Rama.
Për t'a theksuar rëndësinë e këtij procesi, në qeverisjen e tij Kreu Socialist, njëkohësisht Kryeministër i vendit, artikuloi deklarata intimiduese në media ndaj popullsisë, duke deklaruar se garantimi i vaksinave dhe vijimi i këtij procesi lidhej drejtpërdrejt me vijimin e mandatit qeverisës të Partisë Socialiste[371].
Përqasje të tilla, në situata të cilat nuk kanë të bëjnë thjesht me fushatën elektorale në vetvete, por me detyrimin e shtetit shqiptar për të mbrojtur shëndetin e popullatës, si dhe për të ofruar garanci e siguri për të ardhmen e jetës dhe shëndetit të qytetarëve, janë situata flagrante dhe të papranueshme.

Në disa raste, kryeministri Rama e akuzoi liderin e PD-së, Lulzim Basha si të papërgjegjshëm për veprime, të cilat mund të kishin pasoja deri në humbje jete për shkak të virusit.
Reagimi i Kryeministrit Rama ne *Twitter,* 30 mars 2020:
"O lula unë jam i frikësuar për njerëzit tuaj që i bëni mish për top me grumbullimet e turpshme të papërgjegjshmërisë suaj, duke mbledhur njerëz të verbër me makina e me bori, që virusi të bëjë dasmë teksa dhëndri juaj premton ta bëjë ditën natë! Premtim i mbajtur fatkeqësisht!"
Në mënyrë të përsëritur, Kryeministri do të bënte krahasime nëpërmjet fotomontazheve të organizimeve të Partisë Socialiste dhe asaj Demokratike, duke e nxjerrë në pah sipas tij, diferencën e madhe që ekzistojnë mes këtyre forcave, kur bëhet fjalë në menaxhimin e pandemisë.

367 Disa nga njoftimet e Policisë së Shtetit, mbi gjobat e vëna për kundërshtimin e Aktit Normativ Nr. 3, datë 15.03.2020, pika 2, neni 3, si dhe pika 1 e Urdhrit nr. 633, datë 17.11.2020 të MSHMS-së "Për ndalimin e grumbullimeve në vende të mbyllura apo të hapura".
Njoftim i Policisë së Shtetit, datë 12.02.2021, mbi gjobitjen e përfaqësuesve politikë të PD-së Agim Cani dhe Fatmir Muça.
Njoftim i Policisë së Shtetit, datë 11.02.2021 për gjobitjen e përfaqësuesit politik të LSI-së Endrit Brahimllari.
Njoftim i Policisë së Shtetit, datë 12.02.2021 për gjobitjen e përfaqësuesit politik të PS-së Blendi Klosi.
Njoftim i Policisë së Shtetit, datë 18.02.2021 për gjobitjen e përfaqësuesit politik të PD-së Edmond Spaho.

368 Në datë 12 Prill 2021, Komisioni i Shqyrtimit të Kundërvajtjes Administrative, vendosi të ndëshkojë Iljaz Shehun, kandidatin në këtë qark i Lëvizjes Vetëvendosjes me shumën 5 milionë lekë për shkeljen e urdhrit të Ministrisë për grumbullimin e më shumë se 10 personave në ambientet e hapura.
Në datë 26.03.2021 Komisioni i Shqyrtimit të Kundërvajtjes Administrative, vendosi të ndëshkojë Elton Debreshin, kandidatin e pavarur në qarkun e Dibrës me shumën 5 milionë lekë për shkeljen e urdhrit të Ministrisë për grumbullimin e më shumë se 10 personave në ambientet e hapura.

369 Kryeministri Rama, gjatë një interviste në Opinion Tv Klan, më 25 prill 2021, duke komentuar aktivitetin e hapjes së fushatës së PD-së: "Unë nuk e di ç'do bëjë policia në këtë rast, pasi unë nuk i kam thënë gjobit apo mos gjobit... por unë shpresoj që në këtë rast policia mos bëjë gjë, pasi ata janë artistë të bëjnë viktimën. Sepse më pas policia do të hajë të gjithë baltën që prodhohet në klubet mediatike të natës".

370 Kryeministri Edi Rama gjatë një intervistë për emisionin Real Story më 21 prill 2021, deklaroi në lidhje me qytetarët që vijnë nga këto dy shtete dhe të drejtën e tyre të votimit, duke sugjeruar shkeljen e vendimit: "Kush e ka vërtetë më zemër dhe kush vërtet vjen si patriot, meqë paska deklaruar LSI, vjen dhe voton... Pra teoria që ne na pengoi karantina dhe u vu karantina për ne është një marrëzi".

371 Edi Rama në një takim me banorët e Shkodrës, 31 mars 2021 "... Po të vijnë këta (PD) do të vazhdojë vaksinimi? Harrojeni! Këta nuk dinë. Më tregoni një qendër shëndetësore? Nuk dinë. Është mbledhur paaftësia dhe indiferenca. Ata dinë vetëm dy gishta dhe Rama ik..."

Përveç menaxhimit të pandemisë, temat në të cilat u përqendrua debati politik përgjatë fushatës zgjedhore, ishin çështjet ekonomike, reforma në drejtësi, investimet e huaja në vend, largimi masiv i të rinjve nga Shqipëria dhe procesi i rindërtimi pas tërmetit të 26 nëntorit të vitit 2020. Opozita i konsideroi këto si dështimet më të mëdha të qeverisë, por munguan analizat e thelluara dhe planet konkrete për zgjidhjen e këtyre çështjeve, në diskursin e tyre publik.
Fushata elektorale ishte e varfër në ballafaqim platformash, liderët e partive politike ishin në qendër të saj dhe kandidatët individualë u spostuan në plan të dytë. Një pjesë e retorikës së fushatës u bazua në diskutimin e karakteristikave individuale të liderëve të partive, madje në disa raste kjo u përshkallëzua në fushata denigruese personale.
Qeveria socialiste nuk i ofroi qytetarëve një bilanc të tetë viteve qeverisje, por shpalosi planet për investimet që do të kryheshin në vend në katër vitet e ardhshme[372]. Ajo e quajti atë si një plan veprimi, vazhdim i punëve të nisura tashmë, dhe nuk publikoi një program të mirëfilltë elektoral[373].
Partia Demokratike publikoi në faqen zyrtare te saj *shqipëriafiton.al*, shtyllat kryesore të programit të saj[374]. Partia Lëvizja Socialiste për Integrim artikuloi në daljet e saj publike, shpalosjen e një programi të kësaj partie, i cili në faqen zyrtare të saj, u emërtua si "Prioritetet Zgjedhore"[375].
Ndërkohë, që në faqet e tyre zyrtare u publikuan edhe programet e partive Lëvizja për Ndryshim, Bindja Demokratike dhe Nisma Thurje[376].
Analizimi i këtyre programeve në hapësirat mediatike, nga vetë partitë dhe ekspertë të fushave përkatëse, ishte i munguar . Qytetari nuk u njoh në mënyrë shteruese për specifikat e programeve apo planeve të veprimit, duke shkuar drejt ditës së votimit jo plotësisht i informuar mbi një ndër elementet kryesorë që formëson votën.
E drejta për një votë të lirë është një ndër të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutën e Shqipërisë[377]. Ndaj si e tillë është shumë e rëndësishme që klima politike dhe retorika e përdorur të jenë garantë që ky proces të zhvillohet pa ndërhyrje që mund të drejtojnë në mënyrë të paligjshme apo intimiduese votën e qytetarit.
Intimidimi i votuesve, në të gjitha format, ishte një çështje serioze, e cila u konstatua përgjatë gjithë fushatës zgjedhore, sidomos kur ato vinin edhe nga sjellja apo deklarimet e kreut të qeverisë[378].
Mungesa e programeve dhe analizave elektorale, u zëvendësua me debate pa përmbajtje me një gjuhë të ashpër, tiparet e së cilës u panë edhe para fillimit zyrtar të fushatës dhe u intensifikua më tej në fushatën zyrtare me përcaktime denigruese kundrejt kundërshtarit[379].

372 Edi Rama në takim me banorët në Bylis, 3 prill 2021 "...Ne kërkojmë mandatin e tretë, por nuk vijmë nga dy mandate. Vijmë nga një mandat dhe një luftë që nuk ka përfunduar. Kjo luftë do të kishte gjunjëzuar shumëkënd, por jo qeverinë tonë. Një tërmet shkatërrimtar dhe një tjetër tërmet trondités për të gjithë botën..."

373 Edi Rama i ftuar në emisionin Open në Top Channel, 2.04.2021 "...Ne nuk kemi një program.... Ne kemi plan-veprimi 2021-2025... Dhe është i qartë, për shembull, ne nuk themi do ulim taksën se e kemi bërë zero dhe ajo që themi është se këto do rrinë zero. Plani i veprimit është program për kudo në të gjithë sektorët".

374 Në faqen *online shqipëriafiton.al*, Partia Demokratike publikoi "Prezantimet Programi Shqipëria Fiton", në të cilat paraqiten shtyllat kryesore, me hapat që do të ndërmerren në sektorë të ndryshëm të shoqërisë për zhvillimin ekonomik dhe social të vendit, nëse zgjidhet si koalicion fitues në zgjedhjet e përgjithshme.

375 Lëvizja Socialiste për Integrim ka të publikuar në faqen e saj zyrtare në një kopje elektronike dhe nëpërmjet disa videove ilustruese programin e saj të quajtur "Prioritet zgjedhore 2021"

376 Nisma Thurje: 33 Projektligjet - Platforma 'Lësho Tepsinë' ; Bindja Demokratike: "Plani ynë për një Shqipëri normale"; Lëvizja për Ndryshim: Programi .

377 Kushtetua e Shqipërisë: Liritë dhe të drejtat politike, Neni 45, pika 1 dhe 4.

378 Kërcënimet për një votë drejtuar Kryeministri Rama i shprehu edhe në deklaratën e tij për infermieret dhe mësuesit, gjatë një komunikimi *live* në faqen e tij zyrtare në *Facebook*. Kryeministri Edi Rama në një komunikim live me përfaqësues të Partisë Socialiste, në lidhje me punësimet në administratë deklaroi më 6 prill 2021 "Tani mësuesit dhe infermierët kanë hyrë me meritë, por duhet ta mbrojnë se me votën në drejtim të paditur ikën në drejtim të paditur".

379 Edi Rama, 8.03.2021 Takim *online* me kandidatët e listave shumemërore: "Dash Shehi, që ka 100 vjet që i jep së djathtës frymën liberale të rakisë...Agron Duka...ministër Bujqësie, meqë gjeli i Agrares përfaqëson aq shumë pula zogj e vezë sa për kotec i shkon vetëm ministria e Ushqimit....Tym Idrizi i doganave, i cili nga ana e tij e ka televizorin për luftë gjakatare me grekun ndërsa deputetllëkun e ka për të shitur vende pëllumbash në zyrat e shtetit.."
Edi Rama, hapja e fushatës së PS-së, 25.03.2021: "... Luli është Saliu, Luli është Iliri, Monika. Është kukull. Si ato kukullat, po nuk i tunde, flenë, kur tunden hapin sytë, dhe nxjerrin këngën në formë ninulle për të vënë bebet në gjumë..."
Mesila Doda, postim në Facebook, 10.03.2021 "...Përroi psikik rrodhi edhe sot... o kungull, kryeministri që ka 8 vite në pushtet del në fushatë me bilanc, jo duke sharë gratë e burrat që ka përballë."
Petrit Vasili, deklaratë për mediat, 10 mars 2021: "Ju për fat të keq jeni të detyruar, për shkak se kryeministri juaj nuk ka asnjë punë tjetër, përveç një karagjoz mejhanesh, që të shikoni e të dëgjoni idiotësi pa fund të këtij kryeministri, i cili shpërdoron karrigen dhe nuk bën detyrën e tij."

Opozita e akuzoi në mënyrë të vazhdueshme maxhorancën për një përfshirje në krime elektorale si vjedhje, apo blerje të votës, të cilat , sipas tyre, do të prishnin procesin zgjedhor[380].
Në këtë debat, u përfshi edhe Presidenti i vendit Ilir Meta, e cili mori një rol shumë aktiv përgjatë periudhës zgjedhore në vend. Daljet e tij publike u shoqëruan me një gjuhë të ashpër, duke u kthyer kështu në një palë të përfshirë, kryesisht me akuza personale ndaj Kryeministrit Rama[381].
Gjithashtu në faqen zyrtare të institucionit të Presidencës, u vendos një hapësirë ku çdo qytetar apo subjekt mund të denonconte shkelje të vërejtura në procesin zgjedhor, ndërkohë që vetë Presidenti artikuloi disa here deklarata me një gjuhë shumë të ashpër një lidhje më këtë çështje[382].
Drejtimi i vëmendjes mediatike dhe qytetare tek një gjuhë e tillë, nuk e ndihmoi aspak klimën e qetë në të cilën duhet të zhvillohej një fushatë elektorale.
Partitë politike, krerët e tyre dhe gjithashtu institucionet që qëndrojnë mbi palët, nuk u bënë garantë që qytetari të çlirohej nga nxitja e vendimmarrjeve emocionale e cila vjen me ashpërsimin e gjuhës. Krijimi i klimës së pasigurisë, u shoqërua disa herë në disa raste me përplasje fizike, apo incidente në të cilat ishin të përfshirë përfaqësues të një force politike.
KRIIK theksoi që në fillimet të fushatës së parakohshme zgjedhore, se nevojitej një distancim nga tensionet politike dhe gjuha e ashpër, nga palët e përfshira, pasi kjo mund të ishte një nxitëse për përshkallëzimin e incidenteve me karakter elektoral.
Media raportoi incidente të cilat kishin të përshirë përfaqësues të subjekteve zgjedhore në disa rrethe të vendit, përgjatë fushatës zgjedhore[383].
Gjuha konfliktuale që pasoi këto incidente do të përshkallëzohej edhe më tej në konfliktin e armatosur i cili shkaktoi një viktimë dhe disa të plagosur në Elbasan. Kjo ngjarje shënjoi negativisht fushatën elektorale, në prag të përfundimit të saj, por edhe diskutimet post-zgjedhore. Vullneti i munguar për të ulur tonet dhe mosdistancimi i subjekteve zgjedhore prej akteve të dhunshme që prej incidenteve të mëparshme në këtë qytet, e në vijim në të gjithë vendin, kulmoi me këtë ngjarje, e cila në tërë kontekstin e ndodhjes së saj ishte e influencuar dhe motivuar politikisht[384].

Erion Veliaj, intervistë në media 15.03.2021 deklaroi "...Me këtë politikën e Metës dhe Berishës "KCK", dua t'i them Ilir Metës dhe kujtdo te kjo minorancë se 'koha jua mbaroi, nuk keni shans, do ta lironi pronën publike'. Burrat e dhunshëm, ata të alkoolizuar, jemi gati t'u ofrojmë programe falas për rehabilitim, secili duhet të ketë një shans të dytë dhe ne jemi të gatshëm t'ua japim...".

380 Kandidati për deputet i LSI-së, Vangjel Tavo deklaroi në një dalje publike se në qarkun e Gjirokastrës, partia në pushtet, po kërkonte vota në këmbim të parave.
Alfred Rushaj, kandidat për deputet PD, postim në Facebook, 10.03.2021: "Ervin Bushati, nga dëshpërimi, shpërndan lëmoshë për socialistët në nevojë, të cilët ndihmën ekonomike duhet ta marrin nga njësitë administrative dhe jo nga zyrat e PS-së."

381 Edi Rama, takim me banorët e Fierit, datë 4.04.2021 "... Në fakt me Lulin nuk duhet të merreshim fare se është thjesht një kukull, është Gjino që shërben për të krijuar një dasmë dhe ka një dhëndër të ri, ndërsa trimi që gjuan me gurë atje dihet që është Iliri..."
Presidenti Ilir Meta në një deklaratë për mediat në Vlorë 10 prill 2021 "... Kryeministri në detyrë ka një kartelë të psikiatrisë, që nga koha e komunizmit, të cilën ua kam thënë para disa a ditësh dhe do ua them në Vlorë, më 25 prill në Vlorë, ku shqiptarët të tregojnë ai do të tregojë kartelën...".

382 Presidenti Ilir Meta, deklaratë për mediat, 23.10.2021 pohoi se do të ndërmerrte masa për këdo që do të cënonte votën e lirë. Ai përdori një gjuhë të ashpër duke deklaruar "Kush prek një votë do t'i pritet një dorë".

383 Në datë 18 prill 2021, u dogj makina e kryetarit të grupseksionit të Partisë Demokratike në Shelqet, të Bashkisë Vau i Dejës, Ariston Drini (Raportim i A2 CNN 18.04.2021) .
Në datë 21 prill 2021, në Poliçan u raportua se një anëtar i LSI-së, Luan Tare Pitikoja, u godit me sende te forta, duke pretenduar se sulmi ishte politik. (Raportim i A2 21.04.2021).
Ngjarja e ndodhur në Kavajë, që rezultoi me plagosjen e sekretarit të PD në zyrat elektorale të këtij qytetari, iu atashua menjëherë qëllimeve politikë. Deklarata e Policisë së Shtetit, 20 prill 2021 "Sot rreth orës 19:00, në lagjen nr. 4, në Kavajë, shtetasi N. J., dyshohet se si pasojë e një konflikti për motive të dobëta, ka hyrë në ambientet e brendshme të një zyre elektorale të një subjekti politik dhe ka plagosur me armë zjarri pistoletë në këmbë shtetasin B.O., 27 vjeç, i cili ndodhet në spitalin e Durrësit, nën kujdesin e mjekëve".
Reagimi i ashpër i kreut të PD-së Lulzim Basha dhe shkuarja e tij në vendin e ngjarjes, i dha kësaj ngjarjeje ngjyrime politike, ndërsa vetë kryeopozitari e konsideroi këtë si atentat kundër PD-së. Lulzim Basha në një deklarim për mediat fill pas ngjarjes në Kavajë: "Sonte Kavaja është përballur me një ngjarje të rëndë, një atentat kundër PD-së, kundër Aleancës për Ndryshim nga një kryeministër që e di se të dielën ai humb, Kavaja fiton dhe Shqipëria fiton... . Kërkojnë të frikësojnë PD-në, kërkojnë të na mbyllin gojën, nuk kemi frikë, do të marrin përgjigjen e merituar me votë të dielën në Kavajë dhe në të gjithë Shqipërinë".
Kryeministri Rama, nëpërmjet një postimi në mediave sociale e dënoi aktin dhe bëri thirrje për mos politizimin e situatës. Edi Rama në një postim në Twitter "Plagosja e Kavajës e patoleruesshme! Autori duhet çuar në pranga sa më shpejt! Politizimi i kësaj ngjarjeje është po aq i keq sa vetë ngjarja! LB duhet të bashkohet me mua për të mbështetur drejtësinë pa nxitur tensionin, ndërsa IM duhet ta ndalë fushatën idioteske të tensionimit!"

384 Në ngjarjen e Elbasanit, mbeti i vrarë një ish-zyrtar, i cili ishte i përfshirë në incidentin e mëparshëm në këtë qytet para fillimit të fushatës zgjedhore, më datë 14 mars kur simpatizantë të PD-së dhe PS-së u konfliktuan fizikisht mes njëri-tjetrit gjatë festimeve zyrtare të Ditës së Verës. Ngjarje, që shkaktoi viktimën ndodhi në datë 21 prill 2021 në afërsi të zyrave elektorale të PD-së dhe grupet e përfshira njiheshin si simpatizantë të dy partive

Problematikat e rënda që nxori në pah kjo ngjarje ishin përpjekjet për blerje vote, dhe ruajtjen e saj edhe nëpërmjet strukturave të ngritura nga partitë[385].
Përfshirja e partive politike në ngjarje të tilla nuk kontribuojnë aspak në një proces zgjedhor të shëndetshëm, bazuar në parimet demokratike dhe institucionale në vend, që ngjall besim. Në të njëjtën kohë të tilla ngjarje kompromotojnë dhe ulin besueshmërinë e qytetarit ndaj institucioneve të pavarura nga politika, sikurse janë policia dhe prokuroria, të cilat nuk u ecidentuan në përmbushje të misionit të vet ligjor r kushtetues për të zbardhur dhe parandaluar ngjarjet e rënda që u shënuan.
Megjithëse pati deklarata të ashpra kërcënuese dhe tension në rritje pak ditë përpara zgjedhjeve[386], në ditën e votimit partitë politike dhe përfaqësuesit e tyre u shfaqën dhe mbajtën tone të qetë në deklaratat publike të komunikuara.

VII.2. PUBLIKIMI I BAZËS SË TË DHËNAVE TË QYTETARËVE TË TIRANËS

Dy javë përpara ditës së zgjedhjeve, në 11 prill 2021, në portalin *lapsi.al* u publikua një shkrim ekskluziv[387], në të cilin pretendohej se kjo media kishte siguruar një bazë të dhënash të votuesve të Tiranës të rrjedhur nga zyrat e Partisë Socialiste. Në bazën e të dhënave përfshiheshinn të dhëna personale (numri personal i identifikimit, ditëlindja, numri i telefonit etj.) dhe sensitive (si preferenca politike). Publikimi i bazës së të dhënave shkaktoi një debat të gjerë në opinionin publik dhe vuri në qendër të diskutimit publik një fenomen të njohur e përmendur prej kohësh, por asnjëherë në këtë masë, atë të patronazhimit politik nga ana e partive politike dhe tentativave për të kontrolluar dhe drejtuar votën e qytetarëve[388].
Pavarësisht qendrimit publik të portalit publikues, që kjo databazë ishte marrë nga zyrat e Partisë Socialiste, eksponentë të saj patën qëndrime publike fillimisht kontradiktore lidhur me këtë fakt, por në vazhdim termi "patronazhist" u bë pjesë e retorikës së saj politike dhe batutave të fjalimeve të Kryeministrit, duke mbrojtur publikisht patronazhistët madje duke i trajtuar ata si pjesë e rëndësishme e strukturave të Partisë Socialiste[389]. Për më tepër, në disa

politike. Deklarata e Policisë së Shtetit, datë 22 prill 2021 për vrasjen e një personi, në qytetin e Elbasanit dhe plagosjen e katër të tjerëve, për shkak të përplasjeve mes përfaqësuesve të strukturave për mbrojtjen e votës dhe përfaqësuesve kriminale, të akuzuar nga PD-ja, si të lidhur me Partine Socialiste.
Drejtuesi politik i PD-së në Elbasan, Gazment Bardhi në një deklaratë për median 21 prill 2021 "... Konflikti politik i nxitur nga Partia Socialiste që prodhon tension çdo moment, në përpjekjen për të mbajtur pushtetin me çdo kusht, dhe për të mos lënë qytetarët të votojnë të lirë... . Ajo që ka ndodhur sot është drejtpërdrejtë përgjegjësi e Taulant Ballës. Angazhimi i eksponentëve të krimit të organizuar në zgjedhje dhe nxitja për të kryer krime elektorale është përgjegjësi e tij".
Edi Rama në një postim në *Twitter* më 21 prill "Dëshpërimi i humbësve nuk duhet e nuk do të na bëjë të humbasim as qetësinë, as durimin, as besimin se 25 prilli do të sjellë bashkimin e shqiptarëve për ta ngjitur Shqipërinë në majën e merituar dhe ndëshkimin kuptimplotë të forcave që duan të ribëhen gjarpër rreth këmbëve tona!"

385 PD ngriti një organ të quajtur "struktura për mbrojtjen e votës", e cila përbëhej nga mbështetës së kësaj partie, të cilët kishin si funksionin identifikimin dhe ruajtjen votës në raste se do të identifikoheshin vjedhje apo tjetërsim të saj. Kandidatja për deputete e PD-së Albana Vokshi, përgjatë një interviste televizive në A2news, 22.04.2021, deklaroi: "...Në mungesë totale të institucioneve shtetërore, të shtetit për të mbrojtur votën, atëherë pranë PD-së janë krijuar struktura të posaçme të përbëra nga profesionistë të fushës, të cilët vullnetarisht po punojnë në mënyrë të organizuar në shtabe për të marrë informacione, për të siguruar dhe denoncuar atë që quhet krim elektoral. Nuk janë të armatosur. Ata që kanë leje në mënyrë të ligjshme mund ta mbajnë armën. Unë në shtabin tim nuk kam njerëz të armatosur. Zoti Bardhi tha që ai që kishte armë e kishte me leje. Janë persona të organizuar në Strukturat e Mbrojtjes së Votës. Ata bëjnë atë që shteti nën urdhrat e Ramës nuk po e bën..."

386 Drejtuesi politik i PD-së, njëkohësisht edhe kandidat për deputet në qarkun e Dibrës Xhelal Mziu gjatë një takimi me qytetarët artikuloi deklarata kërcënuese në lidhje me përpjekjet për blerje vote nga kundërshtarët politikë. "Kemi ngritur grupet e gatshme nga sot dhe në vazhdim dhe çdo person i dyshimtë që lëviz në lagjet tuaja, mjafton një telefonatë dhe do ta pësojë njëlloj si ai i Elbasanit".
Kandidati për deputet kërkoi ndjesë për deklarimet e tij, ndërsa Policia e rrethit Dibër nisi një procedim penal për veprën penale "Thirrjet për armatosje ose marrje të padrejtë të komandës" (Njoftim i Policisë së Shtetit në datë 23 prill 2021).

387 Ekskluzive, lapsi.al: "Si na monitoron Rilindja nr. e telefonit, nr. ID, vendet e punës, të dhënat konfidenciale për 910 mijë votues të Tiranës".

388 Sipas *lapsi.al*, kjo databazë e cila nuk përmban vetëm të dhënat ë qytetarëve të Tiranës por të gjithë Shqipërisë, burimi i së cilës u mbajt i fshehtë, menaxhohej nga të ashtuquajturit "patronazhistë" në Partinë Socialiste, persona të cilët ishin të ngarkuar të survejonin preferencat politike të qytetarëve të Tiranës. Patronazhistët, ishin në posedim edhe të informacioneve personale mbi qytetarët, të cilat përdoreshin për të intimiduar qytetarët në funksion të drejtimit të votës së tyre.

389 Edi Rama në një takim me të rinjtë në Tiranë më 18 prill 2021: "Le të thonë ç'të duan ata se atë punë kanë,

dalje publike, përfshi edhe intervista në media të huaja, Kryeministri tentoi ta relativizojë faktin që Partia Socialiste përpunon të dhënat personale të qytetarëve, duke ngritur si pretendim se numri i kartës së identitetit nuk është e dhënë personale. Ndërkohë që përmbajtja e databazës së publikuar kishte jo vetëm të dhëna personale, por edhe të dhëna sensitive, të dhëna këto që gëzojnë një mbrojtje të posaçme si liri dhe të drejta kushtetuese, si dhe komente të cilat përveç preferencës së votës shkonin deri tek përkatësitë racore të qytetarëve, apo edhe aftësisë e tyre fizike e gjendjen shëndetësore.
Partia Socialiste u akuzua gjerësisht në media apo edhe në mediat sociale prej qytetarëve, se këto të dhëna i kishte marrë nga platforma digjitale *e-Albania*, e cila menaxhohet nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI). Kjo pasi, ndër të tjera, pati pretendime se në databazë ekzistonin të dhëna të përditësuara së fundi nga qytetarët në e-albania, të dhëna të cilat nuk ishin regjistruar, sipas, tyre askund tjetër.
Por, AKSHI, i cili është institucioni që kryen përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale duke respektuar dhe garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe, në veçanti, të drejtën e ruajtjes së jetës private e mbrojtjen e këtyre të dhënave sipas ligjit[390], nëpërmjet një deklarate publike i mohoi akuzat se të dhënat kishin dalë nga platforma digjitale *e-Albania*[391].
Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDP) nisi një hetim administrativ për përhapjen e paligjshme të të dhënave personale të shtetasve, subjekt i së cilës ishin portali *lapsi.al*, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit dhe Partia Socialiste. Në përfundim të hetimit Komisioneri[392] konkludoi se rezultonte e pamundur të vërtetohej lidhje midis kontrolluesve të hetuar (përveç Lapsi.al) dhe bazës së të dhënave të publikuar.
Ajo që vërehet, në gjykimin e KRIIK, është se, përpos mangësive që mbart dhe mosthellimit në mënyrën e duhur përgjatë prcoesit të hetimit administrativ të kryer, sërish gjetjet e këtij hetimi ishin alarmante. Kjo përsa i përket të kuptuarit të mangët të legjislacionit dhe detyrimeve që mbart ai prej punonjësve të institucioneve, nivelit të sigurisë dhe të sistemeve të poseduara e të ndërtuara për të truajtur dhe siguruar të dhënat personale në institucionet shtetërore, si dhe lidhur me praktikat jokorrekte që përdor Partia Socialiste për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave personale të shtetasve.
Lidhur me institucionet dhe subjektet e përfshira në këtë hetim, Komisioneri disponoi me rekomandim[393] për Partinë Socialiste, DPGJC dhe AKSHI; për portalin Lapsi.al nuk zhvilloi verifikime për shkak se ky subjekt është në hetim nga SPAK; si dhe, vendosi[394] sanksion administrativ gjobë për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.
Hetimi administrativ i zhvilluar prej Komisionerit, u krye edhe në funksion të 78 ankimimeve[395] që u paraqitën pranë këtij institucioni, kryesisht qytetarë, të shqetësuar nga publikimi i të dhënave personale në të njëjtën databazë.

patronazhimi është klasa e parë e shkollës së madhe politike, kush ka ambicien për të shkuar në klasa më të larta e fillon nga patronazhimi. Mesazhi im për ata që merren me patronazhistët, duke filluar nga Ilir Meta, ku është kamera? Patronazhistëve t'ju merrni të keqen! Mos harroni: Patronazhistët ju njohin kush jeni, as mos ta çoni nëpër mend se patronazhistët tanë ja fshihni mendimet tuaja. Ne ju njohim kush jeni dhe në 25 prill do ta shikoni sa mirë ju njohim ne juve".

390 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Ligji Nr.9887 datë 10.03.2008 'Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale' dhe Ligji Nr. 9918 datë 19.05.2008 'Për Komunikimet Elektronike dhe Postare', si dhe aktet e tjera nënligjore në plotësim.

391 Deklaratë e Drejtoreshës së Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), Linda Karçanaj, datë 20.04.2021: "Të dhënat e qytetarëve shqiptarë që marrin shërbime *online* përmes portalit unik qeveritar *e-Albania* nuk ruhen dhe as nuk janë ruajtur ndonjëherë, as nga AKSHI e as nga *e-Albania*. Përveç ndalimit nga legjislacioni në fuqi, nuk ekziston asnjë mundësi teknike që këto të dhënat të përdoren e keqpërdoren, kur as nuk ruhen dot."

392 Relacion hetimi administrativ për përhapjen e paligjshme të të dhënave personale të shtetasve, Komisioneri për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale, Nr. 1399 prot., datë 19.08.2021.

393 Rekomandim Nr. 42, datë 19.08.2021, Drejtoria e Përgjithshme Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Për kontrolluesin "Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile".
Rekomandim Nr. 43, datë 19.08.2021, ***Drejtoria e Përgjithshme Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Për kontrolluesin "Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit".***
Rekomandim Nr. 44, datë 19.08.2021, ***Drejtoria e Përgjithshme Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Për kontrolluesin "Partia Socialiste e Shqipërisë".***

394 Vendim nr. 41, datë 23.08.2021, Drejtoria e Përgjithshme Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, *Për kontrolluesin "Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve"*.

395 Pranë KDIMDP u paraqitën ankesa për "Lapsi.al"; 4 ankesa për DPGJC; 31 ankesa për AKSHI; 1 ankesë për DPT; dhe 40 ankesa për PS.

Përveç debateve politike që e përdorën këtë çështje për qëllime elektorale, ajo që përbën shqetësim madhor është fakti se nuk u ndërmor asnjë hap institucional nga institucionet shtetërore për të ndalur dhunimin e mëtejshëm dhe mbrojtur të dhënat e qytetarëve.
Të vetmet përpjekje, të shumëfishta dhe në vazhdimësi të cilat u bënë publike, ishin deklarimet e zyrtarëve të lartë dhe të zgjedhurve të partisë socialiste, pjesë apo drejtues të institucioneve shtetërore kryesore, deklarime këto të një natyre aspak zyrtare, por të një natyre tërësisht politike partiake që tentonin në vazhdimësi të relativizonin ligjin, gravitetin e situatës, si dhe të merrnin haptas në mbrojtje patronazhistët dhe sistemin e patronazhimit, duke fyer dhe thyer rëndë besimin e qytetarëve shqiptarë tek institucionet shtetërore dhe tek zyrtarët publikë në raport me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tyre kushtetuese.

VII.3. PËRDORIMI I BURIMEVE SHTETËRORE PËR PËRFITIM ELEKTORAL

Përdorimi i burimeve publike për përfitim elektoral ka qenë dhe vijon të mbetet një element problematik në zgjedhjet në Shqipëri. Avantazhi elektoral që përfiton partia/partitë në pushtet në një moment të caktuar mund të mbërrijë deri në ekstremin ku partia në pushtet dhe institucioni shtetëror nuk dallohen më, duke zbehur vijën ndarëse mes partisë dhe shtetit dhe shkaktuar një disavantazh të theksuar për opozitën gjatë procesit zgjedhor.
Disa nga ndryshimet më të rëndësishme të Kodit Zgjedhor në korrik të vitit 2020 synojnë të kufizojnë përdorimin e burimeve publike për përfitim elektoral. Kjo mori dakordësi si nga maxhoranca, ashtu dhe nga opozita në Marrëveshjen e 5 Qershorit. Ndryshimet u pasqyruan në nenet 91 dhe 92 të Kodit Zgjedhor. Adresimi i keqpërdorimit të burimeve publike dhe, veçanërisht, atyre njerëzore të administratës për përfitim elektoral merr një rëndësi të veçantë nën dritën e aspiratës për një administrim të zgjedhjeve totalisht jopolitik.
Ky amendim passolli një rregullim të ri për sa i përket përdorimit të institucioneve publike për efekt elektoral. Më konkretisht, në thelbin e tyre ndryshimet adresonin largimin e veprimtarisë institucionale publike[396] dhe të vendimmarrjes ekzekutive me funksion elektoral. Këto ndryshime ligjore nuk ishin pjesë e një konsultimi publik, si i tërë procesi i reformës zgjedhore, por mbartën dakordësinë e aktorëve politikë të përfaqësuar në Këshillin Politik.
Amendimet ligjore të korrikut përcaktojnë ndalimin e disa llojeve të veprimtarive publike të institucioneve në periudhën katër mujore që pararend ditën e zgjedhjeve, që mund të kenë funksion elektoral[397].Gjithashtu, për periudhën katër mujore pararendëse të zgjedhjeve rregullimi i ri ndalon veprime si "*propozimi, miratimi ose nxjerrja e akteve ligjore ose nënligjore, të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë*"[398]. Këtu përmendet që dispozita e Kodit Zgjedhor vuan për nga teknika legjislative, duke passjellë kësisoj *impasse* të panevojshme në funksionimin e administratës. Ndonëse dispozita kryen një përcaktim gjeneralist dhe të vagullt fillimisht, kryen edhe një listim të veprimtarive të ndaluara dhe mbyllet me frazën e "të tjera".
Në këtë kontekst ligjor, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve miratoi vendimin për raportimin dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë publike të institucioneve në periudhën zgjedhore[399]. Ky vendim ndër të tjera, në thelbin e tij përcaktonte rregullimin e raportimit të institucioneve për veprimtaritë publike në periudhën katër mujore që pararend zgjedhjet. Gjithashtu listonte në mënyrë pjesërisht shteruese kategorinë e "veprimtarive të ndaluara për promovim" dhe "veprimtaritë e ndaluara".
Akti i miratuar nga Komisioni Rregullator, u përcoll për konsultim paraprak jo vetëm tek par-

396 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 92, "Veprimtaritë e institucioneve publike në fushatë".

397 Kodi Zgjedhor, përpara ndryshimeve të korrikut 2020, parashikonte në nenin 88 një tërësi ndalimesh të keqpërdorimit të burimeve të administratës publike. Praktikisht, neni 92, pas ndryshimeve, është një risjellje e këtij neni duke shtuar rregullimin për sa i përket vendimmarrjes së ekzekutivit në periudhën katërmujore pararendëse, në pikën 4.

398 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, Ligji Nr. 10019, datë 28.12.2008, Neni 91, Ndalimi i përdorimit të burimeve publike në mbështetje të subjekteve zgjedhore.

399 Vendimi Nr. 9, datë 24.12.2020, Komisioni Rregullator, "Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve".

titë politike, por edhe organizatat e shoqërisë civile. KRIIK[400] dërgoi në KQZ opinionin dhe sugjerimet e tij lidhur me projekt-aktin. Përpos elementeve teknike, u theksua rëndësia madhore e përpilimit të një projekt-akti i cili adreson problemet e një fenomeni mjaft shqetësues për demokracinë në Shqipëri, si dhe, rëndësinë e trajtimit në mënyrën e duhur dhe të bashkëveprimit pro-aktiv me institucione të tjera nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
Partitë politike u konsultuan dhe dakordësuan paraprakisht lidhur me këtë akt, i cili u miratua me konsensus nga Komisioni Rregullator.
Me gjithë aspiratën që një akt i tillë ligjor do të rregullonte një problem të vazhdueshëm të zgjedhjeve në Shqipëri, zbatimi i tij në praktikë ishte ineficent. Gjatë fushatës elektorale, në periudhën zyrtare dhe sidomos atë jo të tillë, përfaqësuesit më të lartë politikë të institucioneve shtetërore e shkrinë gjithë veprimtarinë institucionale me atë të fushatës elektorale.
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, nuk reflektoi një qëndrim proaktiv në funksion të sanksionimit të zyrtarëve shtetërorë, sidomos pas vendimmarrjes së KAS që shfuqizoi sanksionet ndaj kryetarit të Bashkisë Tiranë.
Një tjetër hallkë shumë e rëndësishme e këtij rregullimi ligjor, raportimet nga institucionet në ndërfaqen e KQZ, u shndërruan në një proces mekanik dhe burokratik, pa asnjë kontroll, qoftë për formën, qoftë për përmbajtjen e tyre.
Gjithashtu, pjesëmarrja e administratës publike aktivisht në evente të fushatës elektorale ishin të pranishëm edhe në këto zgjedhje, madje u evidentua një aktivizim i shtuar i punonjësve të administratës, në shumë raste edhe pas përdorimit të mekanizmave intimiduese.

VII.3.1. SJELLJA E INSTITUCIONEVE DHE E ADMINISTRATËS PUBLIKE

Për mbikëqyrjen e sjelljes së administratës shtetërore në proceset zgjedhore, në praktikën e zgjedhjeve të mëparshme, është ngritur një *task force* nën mbikëqyrjen e zëvendëskryeministrit. Nëpërmjet këtij mekanizmi *ad hoc* realizohej kontrolli i sjelljes së administratës publike gjatë proceseve zgjedhore.
Përgjatë procesit zgjedhor të datës 25 prill 2021, ky mekanizëm ndryshoi për shkak të ndryshimeve ligjore në Kodin Zgjedhor të Korrikut 2020, të cilat u përvijuan edhe me vendimmarrjen e Komisionit Rregullator.
Sipas ligjit "Për nëpunësin civil"[401] dhe Kodit Zgjedhor[402], nëpunësit e administratës publike, në nivel qendror apo lokal, e kanë të ndaluar të marrin pjesë në aktivitete elektorale gjatë orarit zyrtar të punës, si dhe, në rast pjesëmarrjeje jashtë këtij orari, nuk duhet të kryejnë veprime të cilat manifestojnë haptazi përkrahjen për ndonjë forcë politike. Përpos pjesëmarrjes fizike, me interpretim të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, u përcaktua edhe kufizimi për të mos shprehur publikisht preferencat apo bindjet politike nga nëpunësit publikë në rrjetet sociale[403].
Në takimet elektorale të zhvilluara nga forcat politike dhe kandidatët për deputetë, u vërejt një prani e konsiderueshme e zyrtarëve të lartë të administratës publike, të cilët kanë qenë të shoqëruar edhe nga zyrtarë të lartë lokalë[404].
Përveç faktit që kanë qenë të pranishëm në këto aktivitete elektorale përgjatë orarit zyrtar të

400 KRIIK, Opinion, dhjetor 2020: Mbi Projekt-vendimin "Për rregullat pe r raportimin e veprimtarive me karakter publik te institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive te ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve".

401 Ligji nr. 152/2013 (i ndryshuar), Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, "Për nëpunësin civil", Neni 37 "Të drejtat politike".

402 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 91 "Ndalimi i përdorimit të burimeve publike në mbështetje të subjekte zgjedhore".

403 Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në shkresën nr. 458, datë 05.04.2021, drejtuar grupeve të monitorimit të burimeve njerëzore të institucioneve pjesë e shërbimit civil, interpretoi më tej këto kufizime duke e shtrirë fushën e tyre të veprimit edhe në mediat sociale. Sipas përcaktimit të Komisionerit: "... ndarja apo pëlqimi i materialeve elektorale të subjekteve politike në mediat sociale (*Facebook*, *Twitter*, *Instagram*) në llogaritë personale të punonjësve civilë përbën shkelje të detyrimit për të mos shprehur publikisht bindjet apo preferencat e tyre politike".

404 Zyrtarë të lartë lokalë, të cilët kanë qenë të pranishëm në takime elektorale janë evidentuar në Bashkinë Kamëz, Bashkinë Tiranë, Bashkinë Vau i Dejës, Bashkia Fushë-Arrëz, Krujë, Bashkia Durrës, Bashkia Fier, Bashkia Korçë, Bashkia Elbasan, Bashkia Kukës, Bashkia Vorë, Bashkia Lushnjë, Bashkia Vlorë, Kurbin, etj.

punës[405], një pjesë e tyre kanë qenë të angazhuar në evente edhe si folës dhe protagonistë, çka përbën shkelje të kuadrit ligjor zgjedhor[406] apo edhe të statusit të nëpunësit publik.
Pranë vëzhguesve të KRIIK, prej punonjësve të administratës publike në nivel lokal, u paraqitën pretendime për presione të ushtruara për t'u angazhuar në fushatë, në formën e pjesëmarrjes aktive apo edhe për të siguruar votues për forcën politike qeverisëse. Pretendime të tilla përfshinin edhe shantazhe apo intimidim për pushim nga puna apo mospërfitim të shërbimeve sociale.
Gjithashtu, në rrjetet sociale, u vërejt në një shkallë të lartë përfshirja e administratës publike në fushatën zgjedhore, duke postuar apo ripostuar, publikime të kandidatëve të ndryshëm për deputetë, ministrave dhe kryeministrit.

VII.3.1.1. Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil (KMSHC), është institucion i krijuar me ligj i cili ka në kompetencë të tij mbikëqyrjen, kryesisht ose me kërkesë të institucioneve, të zbatimit të ligjit në administrimin e shërbimit civil në të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civilë, referuar dispozitave të ligjit "Për nëpunësin civil"[407].
Procesi i monitorimit të administratës publike përgjatë fushatës elektorale, nisi me miratimin e Urdhrit[408] të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, sipas të cilit urdhërohej ngritja e grupeve të monitorimit në institucionet publike, me qëllim sigurimin e zbatimit të ligjit për nëpunësin civil dhe vijueshmërinë normale të punës së trupës së nëpunësve civilë, të pa ndikuar nga procesi zgjedhor. Ky akt nënligjor u plotësua me udhëzimin[409] dhe rregulloren e brendshme[410] të grupit të punës.
KMSHC-ja ka depozituar në Kuvend një Raport të posaçëm për mbikëqyrjen e administrimit të shërbimit civil dhe monitorimin e sjelljes së nëpunësve civilë gjatë fushatës zgjedhore.
Në këtë raport, Komisioneri ka konstatuar një sjellje në përgjithësi të përgjegjshme dhe korrekte nga ana e nëpunësve civilë dhe institucioneve publike, por thekson se janë evidentuar raste të veçuara[411] të veprimeve të nëpunësve publikë në kundërshtim me ligjin, si dhe emërime në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil pa kryer procedurën ligjore të emërimit në detyrë të tyre[412]. Vlen të theksohet së këto janë shkelje të konstatuara nga monitorimi i vetëm 200 institucioneve[413] dhe i 12 896 nëpunësve civilë, nga rreth 16 000 që është numri total i nëpunësve civilë në të gjithë sistemin e shërbimit civil.

VI.3.1.2. Angazhimi i nëpunësve civilë si kandidatë apo në administratën zgjedhore

Referuar vendimit nr. 9 të Komisionit Rregullator u sanksionua[414] detyrimi i nëpunësve të administratës publike të kërkonin pezullim nga detyra publike në funksion të kandidimit si deputet në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë.

405 Zyrtarë të lartë lokalë në Bashkitë Vorë, Krujë, Tiranë, Vlorë, Bulqizë.

406 Vendimi nr. 9 datë 24.12.2020, Komisioni Rregullator, "Rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve".

407 Ligji nr. 152/2013, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, Neni 14 "Kompetencat e Komisionerit" dhe 15 "Mbikëqyrja".

408 Urdhër nr. 13 datë 11.02.2021, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, "Për ngritjen e Grupit të Punës për monitorimin e sjelljes së nëpunësve civilë gjatë procesit zgjedhor."

409 Udhëzim në lidhje me unifikimin e zbatimit të ligjit në drejtim të pjesëmarrjes së nëpunësve civilë në institucionet e administrimit të procesit zgjedhor dhe respektimit të të drejtave të tyre politike.

410 Rregullore e Brendshme e Grupit të Monitorimit, në lidhje me mbikëqyrjen e sjelljes së nëpunësit civil gjatë periudhës së fushatës elektorale për zgjedhjet në Kuvendin e Shqipërisë.

411 Shih pjesën denoncime në ndërfaqen e KMSHC-së.

412 KMSHC-ja ka evidentuar 14 emërime në detyrë në kundërshtim me ligjin për nëpunësin civil. Një rast në një institucion të varësisë së Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe 13 raste në institucionet e vetëqeverisjes vendore, konkretisht në Bashkitë Kurbin, Devoll, Pogradec, Libohovë, Gjirokastër, Kukës, Fier, Divjakë, Mallakastër dhe Malësi e Madhe.

413 Kryeministria, 11 ministri, 90 institucione varësie, 12 prefektura, 12 këshilla qarku, 61 bashki dhe 13 institucione të pavarura.

414 Vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, Komisioni Rregullator, Neni 6, "Të drejtat dhe detyrimet e punonjësit të administratës shtetërore" pika 2.

Sipas të dhënave të Komisionerit për Mbikëqyrjen Shërbimit Civil ishin 15 nëpunës civilë të regjistruar si kandidatë për deputetë të cilët u pezulluan nga detyra.
Gjithashtu për t'u angazhuar në administratën zgjedhore (si komisionerë në KZAZ, KQV, GNV apo si operatorë të PEI-t) nëpunësit publikë duhet të pajisen me autorizim nga eprori direkt.
Sipas KMSHC-së 680 nëpunës të administratës publike janë angazhuar në administratën zgjedhore.

VI.3.1.3. Denoncimet në ndërfaqen e KMSHC-së

Me qëllim që qytetarët të mund të denonconin rastet e shkeljeve të vërejtura nga nëpunës të administratës publike, KMSHC-ja hapi në faqen zyrtare të internetit një rubrikë[415] ku mund të denoncoheshin përfshirje të nëpunësve civilë në veprimtari politike apo në mbështetje të një subjekti zgjedhor apo kandidati në zgjedhje.
Sipas raportit të KMSHC në këtë rubrikë u administruan tri denoncime[416].
Ajo që mbetet shqetësuese në sjelljen dhe interpretimin e KMSHC-së është mos kuptimi drejt, në mënyrë të qëllimshme i konceptit dhe fenomenit të mos përdorimit të burimeve shtetërore. Interpretimi i KMSHC-së, i cili nuk e kategorizon shkelje punësimin e 6 personave shtesë në Institucionin e Autoritetit të Aviacionit Civil, pasi kemi të bëjmë me shtim të strukturës çka, sipas tyre, nuk cënon të drejtat e punonjësve që janë tashmë në institucion, jo vetëm bie ndesh me parashikimet e kodit zgjedhor dhe vendimit nr. 9 të KQZ-së, por është një keqinterpretim i rrezikshëm, i cili hap rrugë krijimit të precedentëve negativë në të ardhmen, si dhe çon drejt kompromentimit dhe zhbërjes së qëndrimit kritik publik ndaj fenomeneve dhe rasteve të tilla.

VII.3.2. RAPORTIMI I AKTIVITETEVE NË KQZ

Përpos elementeve të tjera, Vendimi nr. 9 i Komisionit Rregullator, parashikon edhe raportimin e detyruar nga ana e institucioneve publike të veprimtarive të tyre përgjatë periudhës që nis katër muaj para ditës së zgjedhjeve (25 dhjetor 2020). Sipas parashikimeve të këtij akti, institucionet publike, qendrore/vendore e të varësisë[417] duhet të raportonin në ndërfaqen e dedikuar në faqen zyrtare të internetit të KQZ aktivitetet e planifikuara. Aktivitetet u publikuan nga KQZ në një seksion të dedikuar të faqes së tyre në internet[418]. Raportimi duhet të kryhet së paku pesë ditë përpara aktivitetit të planifikuar[419].
Procesi i raportimit në këtë ndërfaqe filloi në datën 27 dhjetor 2021. Nga monitorimi i raportimeve në faqen e KQZ, përgjatë gjithë periudhës katër muaj para ditës së zgjedhjeve, u vërejt se mekanizmi për raportimin e aktiviteteve të institucioneve nuk ishte efektiv në realizimin e qëllimit të tij, madje nuk reflektoi aspak qëllimin e ngritjes së mekanizmit, dhe u kthye thjesht në një procedurë burokratike formale.
Problematikat e vërejtura në lidhje me raportimin e aktiviteteve nisnin nga mungesa e raportimit, raportimi me vonesë, apo raportimi jo mjaftueshëm i detajuar (në shumë raste pa asnjë detaj).
Totali i institucioneve të evidentuara në Vendimin nr. 9 të Komisionit Rregullator që mbartin

415 http://www.kmshc.al/?page_id=3823&preview=true

416 Grupi i Monitorimit në Bashkinë Cërrik ka njoftuar KMSHC-në se janë evidentuar veprime të nëpunësve civilë në këtë bashki në kundërshtim me nenin 37 të ligjit "Për nëpunësin Civil".
E njëjta shkelje është konstatuar edhe nga një punonjës i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier-Vlorë-Gjirokastër; Institucioni i Autoritetit të Aviacionit Civil nisi ristrukturimin e administratës së institucionit gjatë fushatës zgjedhore, duke punësuar gjashtë nëpunës të rinj, veprim në kundërshtim me vendimin nr. 9 të Komisionit Rregullator pavarësisht se referuar Urdhrit nr. 359, datë 18.12.2020 të Kryeministrit. KMSHC-ja me interpretim nuk e kategorizon shkelje këtë rast pasi kemi të bëjmë me shtim të strukturës, çka nuk cënon të drejtat e punonjësve që janë tashmë në institucion. KMSHC-ja e konsideron si rast "të përligjur". Arsyetim në kundërshtim me vendimin nr. 9 të Komisionit Rregullator neni 3 pika 1.3 shkronja d.

417 Kryeministri, administrata e tij, Zëvendëskryeministri, ministri dhe zëvendësministri, administrata e tyre, kryetari i bashkisë zëvendësit dhe administrata e tij, Prefekti dhe administrata e tij, drejtori i përgjithshëm i agjencive apo institucioneve në varësi të Kryeministrit, Këshillit të Ministrave ose Ministrit, drejtori i përgjithshëm, drejtorët e departamenteve, drejtorët e drejtorive dhe administratat përkatëse, drejtuesit dhe anëtaret e organeve kolegjiale, enteve, bordeve, çdo drejtues i shoqërive tregtare në administrim nga shteti si edhe në çdo ent ku shteti zotëron aksione e kapitale/kuota apo emëron shumicën e organit mbikëqyrës ose të organit administrues, titullari dhe zëvendësit e tij për ndërmarrjet shtetërore (Neni 3, pika 2 e Vendimit nr. 9 të Komisionit Rregullator.

418 https://aktivitete.kqz.gov.al/category/aktivitetet-e-raportuara/.

419 Vendimi nr. 9 datë 24.12.2020, Komisioni Rregullator, Neni 4, "Ndërfaqja e raportimeve, procedura dhe afatet e raportimit", pika 4.

detyrimin për të raportuar ishte 344 institucione. Por nga këto, vetëm 51 raportuan të kishin kryer aktivitete gjatë periudhës katër mujore (në total 1.254 aktivitete). Institucioni me numrin më të lartë të aktiviteteve të raportuara ishte Kryeministria me 431, ndjekur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë me 152 dhe Bashkia Tiranë me 94.
Pavarësisht se kuadri rregullator kërkonte që aktivitetet të raportoheshin së paku pesë ditë përpara kryerjes së tyre, rreth 72% të aktiviteteve të raportuara (906/1254) janë raportuar më pak se pesë ditë përpara. Një pjesë e konsiderueshme (8%) janë raportuar ditën në të cilën aktiviteti do të zhvillohej, madje ka të tilla të raportuara pasi aktiviteti kishte ndodhur (39 aktivitete).
Institucionet më të rëndësishme dhe me nivelin më të lartë të aktiviteteve konsiderohen Kryeministria, Ministritë, Bashkitë dhe Prefekturat, 89 institucione gjithsej, nga të cilat kanë raportuar vetëm 25.
Kanë raportuar vetëm 12 ministri nga 16 të tilla, 11 Bashki nga 61 të tilla dhe vetëm 1 nga 12 Prefektura.
Vërehet se ka një numër të konsiderueshëm institucionesh, tre ministri, 48 Bashki dhe 11 Prefektura, të cilat nuk kanë raportuar asnjë[420] aktivitet në ndërfaqen e KQZ-së pavarësisht se monitorimi i bërë evidentohet se kanë pasur disa të tilla.
Gjithashtu, disa prej institucioneve që kanë raportuar[421] vërehet se kanë kryer një raportim të pjesshëm, vetëm disa nga aktivitetet e zhvilluara prej tyre.
Një problem tjetër i vërejtur në raportime ishte se njoftimet në shumë raste nuk respektonin formatin e kërkuar. Sipas Vendimit të Komisionit Rregullator, njoftimi duhet të përmbante: institucionin që organizonte veprimtarinë, datën dhe orën e veprimtarisë, tematikën e veprimtarisë, nivelin më të lartë të pjesëmarrjes, të ftuarit e nderit, folësit e planifikuar dhe mediatizimin e veprimtarisë.

Nga tërë këto elementë, mediatizimi i veprimtarisë nuk përmendet në thuajse asnjë prej aktiviteteve të raportuara. Vendi i zhvillimit ishte në pjesën më të madhe të aktiviteteve i papërcaktuar (p.sh. Qarku Tiranë, apo edhe thjesht Tiranë), ndërkohë që folësit dhe pjesëmarrësit përgjithësisht nuk specifikoheshin.
KQZ-ja nuk mori asnjë masë ndaj asnjë institucioni për mosraportim, raportim pas afatit, apo të pjesshëm, pavarësisht se këtë tagër ia njeh kuadri rregullator.
Neglizhenca e institucioneve publike në raportim, e kombinuar me mungesën e sanksioneve e bënë mekanizmin një formalitet, duke ia humbur thelbin dhe qëllimin për të cilin ishte ngritur e duke vënë në pikëpyetje aplikimin e mëtjshëm të tij në formë ineficente apo zhbërjen fare të tij.

VII.3.2.1. Denoncimet

Në total në ndërfaqen e KQZ u dërguan 136 denoncime. Rezulton që një denoncim është ende në proces hetimi administrativ nga KQZ, ndërsa pjesa tjetër janë konkluduar me vendimmarrje. Në funksion të këtyre denoncimeve janë marrë 104 vendime nga Komisioneri, nga të cilat nëntë janë ankimuar në KAS. Ky i fundit ka rrëzuar apo ndryshuar[422] vendimet e Komisionerit për gjashtë denoncime.

420 Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Shtetit për Diasporën dhe Ministria e Shtetit për Sipërmarrjen, edhe pse kanë patur një sërë aktivitetesh përgjatë periudhës 25 dhjetor - 24 prill nuk kanë raportuar asnjë prej tyre në ndërfaqen e KQZ.
Bashkia Belsh, Bashkia Bulqizë, Bashkia Cërrik, Bashkia Delvinë, Bashkia Devoll, Bashkia Dibër, Bashkia Dropull, Bashkia Fier, Bashkia Finiq, Bashkia Fushë-Arrëz, Bashkia Gjirokastër, Bashkia Gramsh, Bashkia Has, Bashkia Himarë, Bashkia Kamëz, Bashkia Kolonjë, Bashkia Konispol, Bashkia Korçë, Bashkia Krujë, Bashkia Kukës, Bashkia Lezhë, Bashkia Libohovë, Bashkia Librazhd, Bashkia Maliq, Bashkia Lushnjë, Bashkia Malësi e Madhe, Bashkia Mallakastër, Bashkia Mat, Bashkia Memaliaj, Bashkia Mirditë, Bashkia Patos, Bashkia Peqin, Bashkia Pogradec, Bashkia Poliçan, Bashkia Përrenjas, Bashkia Pukë, Bashkia Pustec, Bashkia Rrogozhinë, Bashkia Sarandë, Bashkia Selenicë, Bashkia Shijak, Bashkia Skrapar, Bashkia Tepelenë, Bashkia Tropojë, Bashkia Vau i Dejës dhe Bashkia Vlorë nuk kanë raportuar asnjë aktivitet publik në ndërfaqen e KQZ-së.
Sa iu përket prefekturave, ka raportuar vetëm Prefektura Elbasan.

421 Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, Ministria e Shtetit për Rindërtimin. Bashkia Përmet, Bashkia Roskovec.

422 Vendim nr. 06, datë 16.02.2021, Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve "Për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr.03, datë 11.02.2021, të z. Erion Veliaj ndaj vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr.46, datë 09.02.201".
Vendim nr. 04, datë 22.01.2020, Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve, "Për kërkesat ankimore nr. 1 të z. Arben Qalliu dhe nr. 2 të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim ndaj vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr.7, datë 14.01.2021".
Vendimi nr. 103 datë 14.07.2021, Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve, "Për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 59, të paraqitur në KQZ në datën 12.07.2021".
Vendim nr. 107 datë 26.07.2021, Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve, "Për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 60, të paraqitur në KQZ në datën 22.07.2021".
Vendim nr. 108 datë 26.07.2021 Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve, "Për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 61, të paraqitur në KQZ në datën 22.07.2021".
Vendim nr. 113 datw 08.11.2021 "Për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 74, të paraqitur në KQZ në datën 28.10.2021".

Komisioneri ka vendosur për 86 denoncime për mosfillim shqyrtimi administrativ apo përfundim shqyrtimi administrativ pa shkelje të konstatuar, për 15 denoncime ka vendosur sanksion administrativ[423] dhe për 17 çështje ka shpallur moskompetencën. Gjithashtu, për 11 çështje është urdhëruar nga Komisioneri marrja e masave të menjëhershme nga ana e institucioneve të denoncuara dhe 2 çështje i janë përcjellë për kompetencë institucioneve të tjera. Tri denoncime janë trajtuar me shkresë nga Komisioneri dhe jo vendimmarrje të mirëfilltë.
Lidhur me subjektet denoncuese vërehet se rreth 70% e denoncimeve janë bërë nga institucioni i Presidentit të Republikës dhe subjektet politike LSI dhe PD[424].
Sipas KMSHC-së, KQZ-ja ka trajtuar dhjetë denoncime për punonjës të administratës publike nga të cilat vetëm tri raste kanë qenë nëpunës civil. Për të tria rastet është konkluduar nga Komisioneri[425] se nuk ishin konstatuar shkelje të vendimit nr. 9 të Komisionit Rregullator.
Në funksion të rritjes së transparencës, sugjerohet që denoncimet e paraqitura në KQZ nga aktorë të ndryshëm duhet të shqyrtohen në seanca publike dhe me prezencën e palëve në proces.

VII.3.3. PUBLIKIMI I KONTAKTEVE

Vendimi nr. 9 datë 24.12.2020 i Komisionit Rregullator parashikon detyrimin e publikimit të të dhënave zyrtare të kontaktit të drejtuesve[426] të institucioneve publike qendrore e vendore. Nga monitorimi i faqeve zyrtare të internetit të të gjitha bashkive, prefekturave dhe ministrive e kryeministrisë, rezulton se ky detyrim ligjor u përmbush pjesërisht nga institucionet e sipërpërmendura. Konkretisht publikuan kontaktet sipas kërkesave të ligjit vetëm tetë bashki[427] dhe dy prefektura[428].

VII.3.4. AKTE NORMATIVE QË LIDHEN ME PËRDORIMIN E BURIMEVE SHTETËRORE

Kodi Zgjedhor[429], përpos aktiviteteve të kategorizuara si të ndaluara, katër muaj para ditës së zgjedhjeve ndalonte edhe propozimin, miratimin apo nxjerrjen e akteve ligjore ose nënligjore, të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë[430]. Në përmbushjen e këtij detyrimi përfshihen të gjitha institucionet publike.

423 Vendimi nr. 46, datë 09.02.2021, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, Vendimi nr. 7, datë 14.01.2021, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, Vendimi nr. 234 datë 14.04.2021, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, Vendimi nr. 452 datë 21.09.2021, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

424 Konkretisht janë kryer 34 denoncime nga LSI-ja, 32 denoncime nga PD-ja, 28 denoncime nga institucioni i Presidentit të Republikës, 15 denoncime nga sinjalizues të ndryshëm që janë individë, 22 denoncime nga organizata jofitimprurëse dhe nga një denoncim përkatësisht nga subjektet Bindja Demokratike, Bashkia Roskovec, Asambleja e Partisë Socialiste Tropojë dhe Qendra Muzeore Durrës.

425 Vendimi nr. 351, datë 05.05.2021 Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, Për shqyrtimin administrativ të denoncimit për shkelje të parashikuar në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ndaj z. Françesko Muçaj, Drejtor në Zyrën Vendore të Shërbimit të Provës Vlorë.
Vendimi nr. 350, datë 05.05.2021, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, Për shqyrtimin administrativ të denoncimit për shkelje të parashikuar në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ndaj zj. Anjeza Shiko, me funksion Drejtor në Drejtorinë Rajonale Tatimore Vlorë.
Vendimi nr. 233, datë 14.04.2021, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, Për shqyrtimin administrativ të denoncimit për shkelje të parashikuar në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ndaj zj. Donika Hysenaj.

426 Vendimi nr.9 datë 24.12.2020, Komisioni Rregullator, "Rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni public, e me capital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administrates shtetërore para zgjedhjeve", Neni 7, pika 1: "Sekretarët e përgjithshëm të institucioneve publike qendrore e vendore, të pavarura e të varësisë, kryetarët e bashkive, prefektët, drejtuesit e njësive administrative dhe drejtuesit e institucioneve të varësisë:" germa c "publikojnë të dhënat e tyre të kontaktit në faqen zyrtare përkatëse të internetit, me qëllim administrimin e çdo rasti të përfshirjes, nxitjes, urdhërimit, shantazhimit apo kërkesës për përfshirjen e punonjësve të atij institucioni në veprimtari politike apo në mbështetje të një subjekti zgjedhor apo të një kandidati në zgjedhje."

427 Bashkia Vau i Dejës, Bashkia Tropojë, Bashkia Shijak, Bashkia Pukë, Bashkia Dropull, Bashkia Konispol, Bashkia Lezhë, Bashkia Peqin.

428 Prefektura e Qarkut Durrës dhe Prefektura e Qarkut Berat.

429 Kodi Zgjedhor, Neni 91 "Ndalimi i përdorimit të burimeve publike në mbështetje të subjekteve zgjedhore" pika 4.

430 Konkretisht përfshihen aktet që parashikojnë rritjen e pagave, pensioneve, mbështetjes ekonomike apo sociale, uljen ose heqjen e taksave, vendosjen e amnistive fiskale, privatizimin apo dhënien e pasurive a të shpërblimeve etj., përveçse kur nisma kushtëzohet nga gjendje të fatkeqësisë natyrore.

Nga monitorimi i vendimmarrjes së Këshillit të Ministrave dhe Këshillave Bashkiakë, rezultojnë akte nënligjore[431] të cilat janë miratuar në kundërshtim me këtë dispozitë të Kodit Zgjedhor, dhe të vendimit nr. 9 të Komisionit Rregullator.

VII.3.5. ZYRAT ZGJEDHORE DHE MATERIALET PROPAGANDISTIKE

VII.3.5.1. Zyrat Zgjedhore

Në përvojën e fushatave zgjedhore në vend, për herë të parë në zgjedhjet e vitit 2017, subjekteve zgjedhore iu ngarkua detyrimi[432] për regjistrimin e zyrave zgjedhore pranë njësive të qeverisjes vendore ku ishte vendosur zyra. Plotësimi ligjor lidhur me termin se çfarë përbën një zyre

431 Vendimi Këshillit të Ministrave nr. 100, datë 17.02.2021 "Për përcaktimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë si autoritet kontraktor për zhvillimin e mundshëm të procedurës së koncesionit / Partneritet Publik Privat, për Portin e Triport, Vlorë. Nëpërmjet kësaj VKM-je Këshilli i Ministrave ka iniciuar nëpërmjet caktimit të Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë procedurën e një koncesioni/ Partneritet Publik Privat. Ky vendim është në kundërshtim me parashikimet e Vendimit nr.9 të Komisionit Rregullator, neni 3 pika 4.
Vendim nr. 1076, datë 24.12.2020, "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 555, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve me arsim të lartë dhe të punonjësve të infermieristikës në sistemin e ministrisë së shëndetësisë dhe njësinë mjekësore ushtarake pranë Spitalit Universitar të Traumës, si dhe për trajtimin e personelit mjekësor në strukturat e forcave të armatosura", të ndryshuar. Ky vendim është në kundërshtim me parashikimet e vendimit nr.9 të Komisionit Rregullator, neni 3 pika 3.
Vendim nr. 1149, datë 24.12.2020 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 175, datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë, në arsimin parauniversitar", të ndryshuar. Ky vendim është në kundërshtim me parashikimet e vendimit nr.9 të Komisionit Rregullator, neni 3 pika 3.
Vendim nr. 244 datë 23.04.2021 "Për përcaktimin e masës së financimit, në buxhetin e vitit 2021, për bashkësitë fetare, që kanë nënshkruar marrëveshje me këshillin e ministrave".
Vendim nr. 1151, datë 24.12.2020 "Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2021, në njësitë e qeverisjes qendrore"
Vendim i Këshillit Bashkiak Berat nr.21, datë 29.03.2021 "Për miratimin e kërkesës së Bashkisë Berat së bashku me dokumentacionin tekniko-ligjor për akordimin e ndihmës financiare për familjet banesat e të cilëve janë dëmtuar nga zjarri si dhe nga tërmeti i vitit 2019 nga buxheti i Bashkisë vitit 2020 "Programi Emergjencat Civile".
Vendimi i Këshillit Bashkiak Vlorë nr. 19, datë 25.02.2021 "Për disa ndryshime në Vendimin e Këshillit të Bashkisë nr. 109, datë 18.10.2018 për miratimin dhe zbatimin e programit të banesave me kosto të ulët, nëpërmjet kredive me kushte lehtësuese nga Buxheti i Bashkisë Vlorë".
Vendim i Këshillit Bashkiak Berat nr. 27, datë 16.04.2021 "Mbi përdorimin e fondeve të mbështetjes sociale, mbështetje financiare për përballimin në raste të veçanta për z. Panajot Myftari". Ky vendim është në kundërshtim me parashikimet e vendimit nr.9 të Komisionit Rregullator, neni 3 pika 1.1 shkronja b.
Vendim i Këshillit Bashkiak Berat nr. 28, datë 16.04.2021 "Mbi përdorimin e fondeve të mbështetjes sociale, mbështetje financiare për përballimin në raste të veçanta përz. Rakip Zhuri". Ky vendim është në kundërshtim me parashikimet e vendimit nr.9 të Komisionit Rregullator, neni 3 pika 1.1 shkronja b.
Vendim i Këshillit Bashkiak Cërrik nr. 13 datë 26.02.2021, "Për shpërndarjen e fondit për rritjen e pagave ne arsimin parashkollor për vitin 2021". Ky vendim është në kundërshtim me parashikimet e vendimit nr.9 të Komisionit Rregullator, neni 3 pika 3.
Vendim i Këshillit Bashkiak Shkodër nr. 17, datë 25.03.2021 "Për një shtesë në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.63, date 28.12.2020 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2021 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2021-2023 të Bashkisë Shkodër." Ky vendim është në kundërshtim me parashikimet e vendimit nr.9 të Komisionit Rregullator, neni 3 pika 3.
Vendim i Këshillit Bashkiak Skrapar nr. 17 datë 25.03.2021 "Për një ndryshime në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.68, datë 24.12.2020 "për miratimin e buxhetit vjetor 2021 dhe të projekt-buxhetit afatmesëm 2021-2023 të bashkisë Skrapar dhe institucioneve në varësi të saj." Ky vendim është në kundërshtim me parashikimet e vendimit nr.9 të Komisionit Rregullator, neni 3 pika 1.3 shkronja d.
Vendim i Këshillit Bashkiak Përmet nr. 13 datë 03.03.2021 "Për një shtesë në Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.99 date 30.12.2020"Per miratimin e buxhetit te bashkisë për vitin 2021 . Ky vendim është në kundërshtim me parashikimet e vendimit nr.9 të Komisionit Rregullator, neni 3 pika 3.
Vendim i Këshillit Bashkiak Përmet nr. 17, datë 03.03.2021 "Për miratimin e pagesës dyfish nga fondi 6% për muajin Janar 2021". Ky vendim është në kundërshtim me parashikimet e vendimit nr.9 të Komisionit Rregullator, neni 3 pika 3.
Vendim i Këshillit Bashkiak Krujë nr.110, datë 28.12.2021 "Falje masash administrative gjate periudhës se pandemisë". Ky vendim është në kundërshtim me parashikimet e vendimit nr.9 të Komisionit Rregullator, neni 3 pika 3.
Vendim i Këshillit Bashkiak Korçe nr. 31, datë 25.03.2021 "Për miratimin e fondit te rritjes se pagave për funksionin e arsimit parashkollor". Ky vendim është në kundërshtim me parashikimet e vendimit nr. 9 të Komisionit Rregullator, neni 3 pika 3.
Vendimi Këshillit Bashkiak Gjirokastër nr.19, datë 05.03.2021 "Për një shtesë në buxhetin 2021 si rrjedhim i rritjes së pagave për funksionimin e arsimit parashkollor". Ky vendim është në kundërshtim me parashikimet e vendimit nr. 9 të Komisionit Rregullator, neni 3 pika 3.
Vendimi i Këshillit Bashkiak Lezhë nr. 30, datë 24.02.02021 "Për një shtese ne buxhetin e Bashkisë Lezhe për vitin 2021". Ky vendim është në kundërshtim me parashikimet e vendimit nr.9 të Komisionit Rregullator, neni 3 pika 3.
Vendim i Këshillit Bashkiak Mallakastër nr. 14, datë 24.02.2021 "Për miratimin e dyfishimit te ndihmës ekonomike për familjet ne nevoje qe do trajtohen me ndihmë ekonomike me fondin deri ne 6%" nga buxheti i bashkisë." Ky vendim është në kundërshtim me parashikimet e vendimit nr. 9 të Komisionit Rregullator, neni 3 pika 3.
Vendim i Këshillit Bashkiak Tiranë nr. 12, datë 01.03.2021; "Për trajtimin me subvencionin e qirasë së disa familjeve në nevojë që nuk mund të përballojnë qiranë e tregut të lirë." Ky vendim është në kundërshtim me parashikimet e vendimit nr.9 të Komisionit Rregullator, neni 3 pika 3.
Vendim i Këshillit Bashkiak Tiranë nr. 50, datë 06.04.2021; "Për krijimin e lehtësirave fiskale ndaj biznesit në kuadër të masave për përballimin e pasojave të infeksionit Covid-19." Ky vendim është në kundërshtim me parashikimet e vendimit nr.9 të Komisionit Rregullator, neni 3 pika 3.
Vendim i Këshillit Bashkiak Tiranë nr. 56, datë 06.04.2021; "Për trajtimin me subvencionin e qirasë së disa familjeve në nevojë që nuk mund të përballojnë qiranë e tregut të lirë". Ky vendim është në kundërshtim me parashikimet e vendimit nr.9 të Komisionit Rregullator, neni 3 pika 3.
Vendim i Këshillit Bashkiak Tiranë nr. 57, datë 06.04.2021; "Për trajtimin me subvencionin e qirasë së disa familjeve në nevojë që nuk mund të përballojnë qiranë e tregut të lirë". Ky vendim është në kundërshtim me parashikimet e vendimit nr.9 të Komisionit Rregullator, neni 3 pika 3.
Vendim i Këshillit Bashkiak Tiranë nr. 68, datë 19.04.2021 "Për trajtimin me subvencionin e qirasë të disa familjeve në nevojë që nuk mund të përballojnë qiranë e tregut të lirë." Ky vendim është në kundërshtim me parashikimet e vendimit nr.9 të Komisionit Rregullator, neni 3 pika 3.

432 Udhëzimi nr. 1, datë 31.05.2017 "Për përdorimin e materialeve propagandistike dhe vendet për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore". Neni 2, pika 3 "Subjekti zgjedhor është i detyruar që brenda pesë ditëve nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi të njoftojë me shkrim Kryetarin e Bashkisë përkatëse, adresat e sakta të zyrave elektorale".

zgjedhore u përcaktua nga Udhëzimi[433] i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, sipas të cilit "Zyra zgjedhore" janë mjediset/zyrat që përdoren nga subjektet zgjedhore apo kandidatët e tyre për qëllime të fushatës zgjedhore. Udhëzimi ngarkon gjithashtu edhe detyrimin[434] e subjekteve për njoftimin e Kryetarit të Bashkisë në territorin e të cilës do të hapet zyra zgjedhore, dhe vendet ku ndalohet hapja e tyre.
Procesi i hapjes së një zyre zgjedhore, implikon përpos elementeve të tjera, edhe detyrimin e njoftimin zyrtar të Bashkisë në zonën e të cilës do të hapet zyra.
Nga komunikimi i vëzhguesve të KRIIK në të gjitha bashkitë e vendit, rezultoi se vetëm tri subjekte[435], nga dhjetë të evidentuara që kishin hapur zyra zgjedhore, njoftuan në vetëm nëntë bashki[436] për hapjen e këtyre zyrave.
Vëzhguesit e angazhuar nga KRIIK, të fokusuar ndër të tjera edhe në monitorimin e zyrave zgjedhore, identifikuan 676 zyra zgjedhore, të vendosura në 53 bashki[437], dhe që i përkasin 16 partive/subjekteve zgjedhore[438].
Në renditje subjekti me numrin më të lartë të zyrave zgjedhore të identifikuara ishte Partia Socialiste, me 275 të tilla, duke u ndjekur nga Partia Demokratike me 254 dhe Lëvizja Socialiste për Integrim me 81.

VII.3.5.2. Materialet propagandistike

Materialet propagandistike gjatë fushatës zgjedhore, sipas Kodit Zgjedhor[439], mund të afishoheshin vetëm në vendet e përcaktuara me vendim nga kryetari i njësisë së qeverisjes vendore përkatëse.
Gjithashtu referuar udhëzimit[440] të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, kryetarët e bashkive duhet të marrin masa për të mos lejuar apo të heqin menjëherë çdo material statik, përfshirë posterat dhe flamujt nga çdo vendndodhje e cila nuk është e përcaktuar me vendim nga kryetari i bashkisë.
KRIIK iu drejtua me kërkesë zyrtare 61 bashkive në vend, komunikim zyrtar nga i cili rezultoi se 2[441] prej tyre nuk e morën vendimin për vendin e afishimit të materialeve propagandistike gjatë fushatës zgjedhore. 4[442] bashki nuk kanë kthyer një përgjigje të qartë, nëse e kanë marrë këtë vendim, duke anashkaluar dhënien e këtij informacioni, ndërsa 55 bashkitë[443] e tjera kanë marrë një vendim lidhur me vendet e afishimit të materialeve propagandistike gjatë fushatës zgjedhore.

433 Udhëzimi nr.6, datë 23.03.2021, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve "Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore".

434 Po aty, neni 5 "Zyrat Zgjedhore", pika 2 "Subjekti zgjedhor njofton me shkrim Kryetarin e Bashkisë përkatëse dhe vë në dijeni KQZ-në për hapjen e zyrave zgjedhore dhe për adresat e sakta të tyre, jo më vonë se 35 ditë para datës së zgjedhjeve."

435 Partia Socialiste, Partia Demokratike dhe Partia Lëvizja Socialiste për Integrim.

436 Bashkia Delvinë, Bashkia Dropull, Bashkia Elbasan, Bashkia Krujë, Bashkia Libohovë, Bashkia Mat, Bashkia Kashar, Bashkia Peqin dhe Bashkia Përrenjas.

437 Numri i zyrave zgjedhore sipas bashkive: Tiranë, 135; Durrës, 60; Vlorë, 57; Fier, 55; Shkodër, 37; Korçë, 30; Lezhë, 24; Elbasan, 22; Lushnjë, 15; Sarandë, 14; Berat, 13; Patos, 13; Gjirokastër, 12; Shijak, 11; Bulqizë, 10; Kamëz, 10; Kavajë, 10; Krujë, 9; Kukës, 8; Roskovec, 8; Dibër, 7; Divjakë, 7; Kurbin, 7; Tepelenë, 7; Vorë, 7; Devoll, 6; Konispol, 6; Rrogozhinë, 6; Kolonjë, 5; Kuçovë, 5; Vau i Dejës, 5; Gramsh, 4; Librazhd, 4; Peqin, 4; Përmet, 4; Pogradec, 4; Selenicë, 4; Klos, 3; Mallakastër, 3; Poliçan, 3; Pukë, 3; Belsh, 2; Cërrik, 2; Mat, 2; Memaliaj, 2; Mirditë, 2; Skrapar, 2; Tropojë, 2; Finiq, 1; Has, 1; Himarë, 1; Këlcyrë, 1; Përrenjas, 1.

438 Numri i zyrave zgjedhore sipas subjekteve elektorale: Partia Socialiste, 275; Partia Demokratike, 254; Lëvizja Socialiste për Integrim, 81; Partia Socialdemokrate, 19; Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet, 16; Partia Lëvizja e Re, 8; Nisma Thurje, 5; Bindja Demokratike, 5; Kandidat i Pavarur, 2; Partia Agrare Ambientaliste, 2; Aleanca Demokracia e Re, 2; Fryma e Re Demokratike, 2; Lëvizja për Ndryshim, 2; Partia Demokristiane e Shqipërisë, 1; Partia Kristiandemokrate, 1; Partia Republikane, 1.

439 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 79 "Afishimi i materialeve propagandistike".

440 Udhëzimi nr. 6 datë 23.03.2021 "Për përdorimin e materialeve propagandistike edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore", neni 3.

441 Bashkia Maliq dhe Bashkia Fushë-Arrëz.

442 Bashkia Gjirokastër, Bashkia Kamëz, Bashkia Kuçovë, Bashkia Skrapar.

443 Bashkia Belsh, Bashkia Berat, Bashkia Cërrik, Bashkia Dibër, Bashkia Bulqizë, Bashkia Elbasan, Bashkia Devoll, Bashkia Malësi E Madhe, Bashkia Mallakastër, Bashkia Memaliaj, Bashkia Përmet, Bashkia Divjakë, Bashkia Dropull, Bashkia Fier, Bashkia Pukë, Bashkia Pustec, Bashkia Gramsh, Bashkia Has, Bashkia Selenicë, Bashkia Shijak, Bashkia Himarë, Bashkia Klos, Bashkia Kolonjë, Bashkia Vorë, Bashkia Korçë, Bashkia Delvinë, Bashkia Kurbin, Bashkia Lushnjë, Bashkia Durrës, Bashkia Pogradec, Bashkia Finiq, Bashkia Poliçan, Bashkia Prrenjas, Bashkia Roskovec, Bashkia Kavajë, Bashkia Këlcyrë, Bashkia Rrogozhinë, Bashkia Sarandë, Bashkia Konispol, Bashkia Krujë, Bashkia Kukës, Bashkia Shkodër, Bashkia Lezhë, Bashkia Libohovë, Bashkia Librazhd, Bashkia Tropojë, Bashkia Mat, Bashkia Mirditë, Bashkia Patos, Bashkia Peqin, Bashkia Ura Vajgurore, Bashkia Tepelenë, Bashkia Vau–Dejës, Bashkia Vlorë, Bashkia Tiranë.

Por, pavarësisht përmbushjes së detyrimit të diktuar nga Kodi Zgjedhor prej Bashkive, rezultoi një detyrë e realizuar në mënyrë jo të plotë nga disa prej tyre. Konkretisht 15[444] bashki nuk e publikuan në faqen e tyre zyrtare të internetit këtë vendim, ndërsa 7 vendime[445] nuk kanë respektuar afatet ligjore të përcaktuara nga Kodi Zgjedhor.
Me gjithë ndalimet e sipërpërmendura ligjore, u evidentuan raste të afishimit të materialeve propagandistike në disa bashki[446], të cila u hoqën edhe pas ndërhyrjes së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

VIII. FINANCIMI I FUSHATËS ZGJEDHORE

VIII.1. KUADRI LIGJOR

Financimi i partive politike dhe subjekteve zgjedhore rregullohet nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë[447], Ligji "Për partitë politike[448]", Kodi Zgjedhor[449], aktet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, si dhe nga legjislacioni fiskal në fuqi[450]. Legjislacioni që rregullon financimin e partive dhe subjekteve zgjedhore ka qenë subjekt ndryshimesh në vazhdimësi. Rregullimi ligjor mbi veprimtarinë financiare të partive politike dhe subjekteve zgjedhore është hartuar sipas proceseve legjislative të ndryshme të shtrira në kohë, në mungesë të një vizioni fillestar të të tërë mekanizmit ligjor-institucional përkatës. Për këtë shkak, ky kuadër ligjor në tërësinë e tij është i fragmentarizuar dhe përmbajtësisht jo integral. Ndryshime të qenësishme janë kryer në vitin 2017, në Ligjin për Partitë Politike[451] dhe në vitin 2020, në Kodin Zgjedhor[452].
Ndryshimet e korrikut të vitit 2020 në Kodin Zgjedhor[453] përfshinë edhe amendime të 19 dispozitave që adresojnë rregullimin e veprimtarisë financiare të subjekteve zgjedhore[454].
Ndryshimet adresojnë tagrat e kontrollorit, ndalimet dhe penalitetet, si dhe synojnë të rrisin transparencën financiare të subjekteve zgjedhore.
Risitë kryesore të sjella nga këto amendime vlerësohet të jenë:

- Monitorimi i veprimtarive elektorale të subjekteve zgjedhore kryhet i pjesshëm455;
- Subjekteve zgjedhore u kërkohet të ruajnë dokumentacionin e plotë financiar për një afat kohor të përcaktuar456;
- Pohimi i qartë i lejimit të të tretëve të denoncimit të fakteve rreth veprimeve të jashtëligjshme të kryera nga subjektet zgjedhore457;
- Rëndimi i penaliteteve për subjektet zgjedhore në rast mosbashkëpunimi me auditin kontabël të caktuar nga KQZ-ja;

444 Bashkia Tepelenë, Bashkia Delvinë, Bashkia Këlcyrë, Bashkia Mallakastër, Bashkia Mat, Bashkia Pustec, Bashkia Kurbin, Bashkia Peqin, Bashkia Fushë-Arrëz, Bashkia Maliq, Bashkia Skrapar, Bashkia Gjirokastër, Bashkia Kamëz, Bashkia Kuçovë, Bashkia Tiranë.

445 Bashkia Berat, Bashkia Bulqizë, Bashkia Himarë, Bashkia Prrenjas, Bashkia Rrogozhinë, Bashkia Shkodër, Bashkia Vlorë.

446 Bashkia Gjirokastër, Bashkia Durrës, Bashkia Librazhd, Bashkia Elbasan, Bashkia Kamëz.

447 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë .

448 Ligji nr. 8580, datë 17.2.2000, "Për partitë politike", i ndryshuar.

449 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë.

450 Ligji Nr. 92/2014, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë".

451 Ligji nr. Nr. 90/2017 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8580, datë 17.2.2000, "Për partitë politike", të ndryshuar".

452 Ligji nr. 101/2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 019, Datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar

453 Disa nga këto amendime nuk ishin të reja në legjislacion, pasi ishin përfshirë qysh në vitin 2017 në Ligjin "Për Partitë Politike" dhe u përfshinë në Kodin Zgjedhor në vitin 2020. Ligji "Për Partitë Politike" u amendua në nëntor të vitit 2020, duke eliminuar nenet që rregullonin veprimtarinë e subjekteve zgjedhore, një pjesë e të cilave ishin përfshirë tanimë në Kodin Zgjedhor.

454 Nenet 3, 20, 78, 86, 87, 88, 89, 90, 91, 92, 92/1, 92/1, 92/3, 92/4, 92/5, 92/6, 92/7, 173, 180.

455 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 92/4, "Monitorimi i fushatës zgjedhore".

456 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 92/3, "Deklarimi dhe publikimi".

457 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 123/3, "Pjesëmarrja e publikut në denoncimin e fakteve".

- Ulja e kufirit maksimal të shpenzimeve të subjekteve zgjedhore458;
- Përfshirja në raportim dhe në kontrollin e veprimtarisë financiare të subjekteve zgjedhore edhe e kandidatëve të listave shumëemërore;
- Detyrimi i kandidatëve në listat shumëemërore për hapjen e llogarive bankare për marrjen e donacioneve mbi 50 mijë lekë459;
- Ulja e pragut për donacionet që duhet të kryhen nëpërmjet llogarisë bankare460;
- Pavarësisht se, në përgjithësi, këto amendime konsiderohen të jenë pozitive, ato dështojnë të adresojnë problematika të rëndësishme, ndërkohë që nuk sjellin mekanizma të reja transparence, në tërësi apo përgjatë fushatës zgjedhore.

Disa nga çështjet madhore që lidhen me financimin e partive politike dhe subjekteve zgjedhore dhe të cilat mbeten për t'u adresuar në legjislacion vlerësohet të jenë:

- Lejimi i veprimtarisë financiare dhe i veprimtarive të kryera nga të tretët në favor të subjekteve zgjedhore apo e ashtuquajtura *fushatë hije;*
- Shpenzimet me qëllim elektoral të kryera para apo pas periudhës zgjedhore vazhdojnë të kenë një regjim kontrolli të ndryshëm;
- Nuk kërkohet deklarimi i shpenzimeve të subjekteve zgjedhore përgjatë fushatës zgjedhore;
- Mungesa e kontrollit dhe verifikimit ndaj kuotizacioneve të mbledhura nga subjektet zgjedhore;
- Mungesa e ndërveprimit të KQZ-së me autoritetet tatimore për kontrollin e veprimtarisë financiare të subjekteve zgjedhore.

VIII.2. TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET

VIII.2.1. TË ARDHURAT

Kuadri ligjor përcakton si burime të ligjshme të financimit për fushatën zgjedhore fondet e dhëna paradhënie nga Buxheti i Shtetit për partitë politike të regjistruara si subjekte zgjedhore; të ardhurat e vetë subjektit zgjedhor; dhuratat për subjektin zgjedhor dhe kandidatët e tij, në vlerë monetare, natyrë ose shërbime, si dhe huatë ose kreditë e marra nga partitë politike ose kandidatët.
Shuma totale e të ardhurave për 32 subjektet zgjedhore që garuan në zgjedhjet vitit 2021 (27 parti dhe 5 kandidatë të pavarur) duke përfshirë kandidatët përkatës është 291.457.174 lekë, nga të cilat rreth 43% (125.816.694 lekë) janë nga buxheti i shtetit, pra financim publik[461] dhe 57% (165.640.480 lekë) janë financime private[462].
Partia Socialiste ka përfituar pjesën më të madhe të ardhurave, më shumë se të gjithë subjektet e tjerë zgjedhorë të marrë së bashku, e ndjekur nga Partia Demokratike dhe Lëvizja Socialiste për Integrim[463].

VIII.2.1.1 Fondet nga buxheti i shtetit

Amendimet e korrikut 2020 në Kodin Zgjedhor ndryshuan mënyrën e shpërndarjes të fondeve publike për subjektet zgjedhore, qoftë përsa i përket mënyrës së alokimit të fondeve, qoftë përsa i përket mbështetjes që një subjekt zgjedhor duhet të gëzojë që të përfitojë fonde publike.

458 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 173, "Sanksionet në lidhje me financimin e fushatës".

459 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 92/2, "Regjistrimi i fondeve jopublike" pika 2, i ndryshuar.

460 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 92/2, "Regjistrimi i fondeve jopublike", pika 3.

461 Në Zgjedhjet Lokale të vitit 2019 financimi publik zinte rreth 60% të të ardhurave totale të fushatës; në Zgjedhjet Parlamentare të vitit 2017 financimi publik zinte rreth 85% të të ardhurave totale të fushatës; në Zgjedhjet Lokale të vitit 2015 financimi publik zinte 23% të të ardhurave totale të fushatës dhe në Zgjedhjet Parlamentare të vitit 2013 financimi publik zinte rreth 43% të të ardhurave totale të fushatës.

462 Nga shuma totale e të ardhurave nga financimet private rezulton se: 4.124.978 lekë janë dhurime ndaj subjekteve zgjedhorë në para; 7.861.950 lekë janë dhurime ndaj subjekteve zgjedhorë në natyrë; 37.922.713 lekë janë të ardhura nga kuotat e anëtarësisë së subjekteve zgjedhorë; 65.537.732 lekë janë të ardhura të krijuara nga vetë subjektet zgjedhorë dhe 50.193.107 lekë janë të ardhura të deklaruara nga kandidatët e listave shumëemërore.

463 PS ka 61% të të ardhurave totale, PD 16.5%, LSI 15% dhe 17.5 % është pjesa e totalit të të ardhurave të përfituara dhe shpenzuara nga subjektet e tjerë zgjedhorë.

Sipas sistemit të aplikuar në zgjedhjet e mëparshme, të gjitha partitë që regjistroheshin për të marrë pjesë në zgjedhje përfitonin fonde publike paradhënie, pavarësisht nëse kishin marrë pjesë në zgjedhjet pararendëse ose jo[464]. Ndërkohë, sipas sistemit aktual, subjektet zgjedhore që kanë marrë mbi 1% të votave në shkallë vendi në zgjedhjet pararendëse të të njëjtit lloj përfitojnë fonde paradhënie, në proporcion me numrin e votave të marra në ato zgjedhje.
Kjo mënyrë e shpërndarjes së fondeve diskrimon dhe redukton hapësirën për alternativa të reja në spektrin e partive politike, pasi partitë politike që nuk kanë marrë pjesë në zgjedhje të mëparshme të të njëjtit lloj nuk mund të përfitojnë fonde publike, pavarësisht se, potencialisht, mund të kenë mbështetje.
Ndryshimi i dytë ka të bëjë me rritjen e pragut të votave që një subjekt zgjedhor duhet të marrë për të përfituar fonde publike, nga 0.5% në 1%, *de facto* duke unifikuar pragun zgjedhor me pragun për të përfituar fonde.
Edhe ky ndryshim konsiderohet të jetë restriktiv, duke qenë se ul mundësinë për të përfituar fonde për partitë e vogla dhe avantazhon partitë e mëdha. Së paku dy parti politike pjesëmarrëse në zgjedhjet e vitit 2021 do të kishin përfituar fonde publike për fushatën[465] nëse pragu do të ishte 0.5%.
Në një zhvillim pozitiv shihet ndryshimi se subjektet zgjedhore që kanë përfituar fonde paradhënie dhe nuk arrijnë dot pragun prej 1% nuk duhet t'i rikthejnë ato, përveçse në rastin kur nuk kanë mundur t'i shpenzojnë totalisht ato fonde. Në këtë rast ato kthejnë vetëm diferencën e fondeve të pashpenzuara[466], ndryshe nga zgjedhjet e mëparshme, kur nëse nuk arrihej pragu 1% fondet e marra paradhënie duhet të ktheheshin.
Fondi i vënë në dispozicion nga buxheti i shtetit për zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2021, referuar Kodit Zgjedhor[467], ishte dy herë më i madh se fondi i alokuar për zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2017[468], çka sipas përllogaritjeve konkludoi në shumën 130.000.000 lekë. Sipas vendimmarrjes së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve (KSHZ), vetëm dhjetë parti politike[469], nga 27 të tilla[470], të cilat garuan si pjesë e koalicioneve apo më vete, përfituan fonde nga buxheti i shtetit[471]. Në përfundim rezultoi se 86% e fondit total u shpërnda në vetëm tri parti politike[472], ndërsa 14% e tij në shtatë partitë e tjera.
Partia politike që përfiton fonde nga Buxheti i Shtetit, para shpërndarjes së fondit, nënshkruan aktmarrëveshje me KQZ-në, në të cilën përcaktohej se partia politike pranonte fondin e dhënë, se do ta përdorte atë në zbatim të të gjitha kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në ligj, pranonte monitorimin e shpenzimeve të kryera prej subjektit dhe kandidatëve, si dhe angazhohej të respektonte të gjitha ndalimet që përcaktohen me ligj. Modalitetet e aktmarrëveshjes së bashkëpunimit, ndërmjet KQZ dhe partisë politike që përfiton fonde nga Buxheti i Shtetit u përcaktuan nga KQZ-ja me udhëzim[473]. Kjo marrëveshje u realizua me çdo subjekt zgjedhor që përfitoi fonde nga buxheti i shtetit për fushatën zgjedhore.
KRIIK vlerëson këtë aspekt si një hap pozitiv, pasi pavarësisht se është formal, u imponon

464 Fondi paraprak ripërllogaritej në përfundim të zgjedhjeve, bazuar në votat e marra prej secilës parti politike dhe partia mund të përfitonte financim shtesë, apo të kthente pjesërisht apo plotësisht fondet e marra paradhënie. Ripërllogaritja bëhej pas shpalljes së reultatit final të zgjedhjeve. Moskthimi i fondeve penalizonte partinë politike me mosmarrje pjesë në zgjedhjet e rradhës.

465 Partitë Bindja Demokratike dhe Nisma Thurrje.

466 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 88, pika 7.

467 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 180 "Dispozitë tranzitore për financimin nga buxheti", pika 4.

468 Fondi i alokuar nga buxheti i shtetit për zgjedhjet e vitit 2017 ishte 65.000.000 lekë.

469 Partia Socialiste e Shqipërisë 55.826.750 lekë, Partia Demokratike 33.318.149 lekë, Partia Republikane 3.926.232 lekë, Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar 1.434.012 lekë, Partia Lëvizja Socialiste për Integrim 18.975.182 lekë, Partia për Drejtësi, Integrim dhe Unitet 5.552.885 lekë, Partia Fryma e Re Demokratike 2.188.832 lekë, Partia Demokristiane 1.479.742 lekë, Partia Socialdemokrate 1.629.360 lekë, Partia Bindja Demokratike 1.485.550 lekë.

470 Partitë e tjera janë parti, të cilat kanë marrë pjesë në zgjedhjet 2015-2017-2019, por në vitin 2015 dhe 2017 nuk kanë plotësuar kriterin e marrjes së 1% të votave në rang vendi.

471 Referuar rezultateve të zgjedhjeve pararendëse nëse do të ishin të garuese në këto zgjedhjeve, do të kishin përfituar fonde edhe Partia Demokracia Sociale, Partia Socialiste e Vërtetë dhe Partia Lista e Barabartë (LIBRA).

472 Partia Socialiste 44%, Partia Demokratike 26% dhe Lëvizja Socialiste për Integrim afërsisht 16%.

473 Udhëzimi nr. 3, datë 16.02.2021, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, "Për miratimin e aktmarrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe partisë politike që përfiton fondet nga buxheti i shtetit dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve".

subjekteve të deklarohen zyrtarisht paraprakisht mbi njohjet e detyrimeve ligjore, bën të ditur publikisht angazhimin e tyre në raport me zbatimin e ligjit, si dhe lehtëson e bën të mundur edhe marrjen e mundshme të masave respektive në rast shkelje të detyrimeve ligjore.
Fondet nga buxheti i shtetit iu shpërndahen partive politike jo më vonë se pesë ditë nga regjistrimi i listave të kandidatëve[474]. U vërejt se si vendimi[475] për shpërndarjen e këtyre fondeve, edhe lëvrimi i tyre nga thesari, është realizuar në tejkalim të këtij afati ligjor[476]. Megjithatë, në një zhvillim pozitiv nga procese të mëparshme zgjedhore, fondet u lëvruan përpara ditës së zgjedhjeve.
Koalicioni ABEOK ankimoi në KAS vendimin e Komisionerit për shpërndarjen e fondeve publike. Ankimimi kërkonte rishpërndarje të fondeve, duke përfshirë në të partitë anëtare të këtij koalicioni duke qenë parti që kishin mandate në Kuvendin e Shqipërisë. Ankimimi përdorte bazë ligjore të gabuar pasi ishte mbështetur në nenin 19 të "Ligjit për partitë politike", i cili i referohet shpërndarjes së fondeve vjetore për partitë dhe jo fondeve të fushatës zgjedhore.
KRIIK gjykon se ky ankimim tregon nga njëra anë vazhdimin e kulturës së ulët ligjore të partive poltike e mosnjohjen prej tyre të legjislacionit respektiv, por, nga ana tjetër, vë në dukje edhe çoroditjen e krijuar nga fragmentimi i legjislacionit për financimin politik në dy ligje të ndryshme.
Pas rrëzimit të kërkesës ankimore nga KAS[477] vendimi u ankimua edhe në Kolegjin Zgjedhor, i cili la në fuqi vendimin e KAS[478].

VIII.2.1.1.1 Ri-shpërndarja e fondeve pas shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve

Brenda dhjetë ditëve[479] nga nxjerrja e rezultatit përfundimtar në shkallë vendi, KQZ-ja përcakton me vendim vlerën në para të një vote të vlefshme, duke pjesëtuar fondin e përgjithshëm të miratuar, me numrin e përgjithshëm të votave të vlefshme të grumbulluara nga partitë politike që kanë marrë jo më pak se 1% të votave të vlefshme në shkallë vendi.
Në zgjedhjet e 25 prillit vetëm katër subjekte zgjedhore[480] e kaluan këtë prag. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve e përcaktoi vlerën e një vote të vlefshme 85 lekë[481]. Asnjë parti politike që nuk kishte përfituar fonde paradhënie nuk arriti pragun prej 1%, si rrjedhim asnjë parti që nuk kishte përfituar fonde paradhënie nuk përfitoi as nga ri-shpërndarja e fondeve pas zgjedhjeve[482].

VIII.2.1.2. Fondet jo-publike

VIII.2.1.2.1. Donacionet

Subjektet zgjedhore dhe kandidatët mund të pranojnë dhurime private vetëm nga persona fizikë dhe juridikë vendas. Kufizimet në lidhje me dhurimet private përfshijnë ndalimin e pranimit të dhurimeve nga një subjekt juridik apo çdo aksioner i tij, i cili ka përfituar fonde publike, kontrata publike apo koncesione në tri vitet e fundit me vlerë mbi dhjetë milionë lekë; ushtron veprimtari në fushën e medias; ka qenë partner me fonde publike në projekte të ndryshme; apo ka detyrime monetare ndaj Buxhetit të Shtetit ose ndaj çdo institucioni publik. Kufizimet në lidhje me dhurimin nga individë apo subjekte që kanë përfituar para publike

474 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 88 "Fondet nga Buxheti i Shtetit për financimin e partive pjesëmarrëse në zgjedhje" (ndryshuar me ligjin nr. 101/2020, datë 23.7.2020, shtuar fjali në fund të pikës 3 me ligjin nr. 118/2020, datë 5.10.2020), pika 6.

475 Vendimi nr. 172 datë 23.03.2021, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, "Për përcaktimin e sasisë së fondit nga buxheti i shtetit që do t'u shpërndahet si paradhënie partive politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021".

476 Lëvrimi i fondeve të partive politike pjesëmarrëse në zgjedhjet është realizuar në datat 9-22 prill 2021.

477 Vendimi nr. 13, datë 30.03.2021, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve "Për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr.07, datë 25.03.2021 të koalicionit Bashkimi Popullor – Emigracioni – Ora e Shpresës dhe Konservatorët ndaj vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr.172, datë 23.03.2021".

478 Vendimi Nr. 6, datë 08.04.2021, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor.

479 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 88 "Fondet nga Buxheti i Shtetit për financimin e partive pjesëmarrëse në zgjedhje" (ndryshuar me ligjin nr. 101/2020, datë 23.7.2020, shtuar fjali në fund të pikës 3 me ligjin nr. 118/2020, datë 5.10.2020), pika 2.

480 Partia Socialiste, Koalicioni Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim, Lëvizja Socialiste për Integrim dhe Partia Socialdemokrate.

481 Vendimi nr. 428 datë 22.07.2021, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, "Për përcaktimin e vlerës në para të një vote të vlefshme për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021."

482 Vendimi nr. 428, datë 22.07.2021, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve "Për përcaktimin e vlerës në para të një vote të vlefshme për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021."

shtrihen edhe pas zgjedhjeve duke parashikuar se personat fizikë ose personat juridikë, të cilët i kanë bërë dhurime një subjekti zgjedhor apo kandidatëve të tij në zgjedhje, nuk mund të përfitojnë për periudhën deri tre vjet pas datës së zgjedhjeve kontrata publike, kontrata të partneritetit publik privat ose në çdo mënyrë tjetër fonde me vlerën totale që tejkalon shumën prej dhjetë milionë lekësh.

Kodi Zgjedhor përcakton detyrimin e subjekteve zgjedhore për të bërë publike dhe të sigurojë akses të plotë e të pandërprerë të të tretëve në bazën e të dhënave, ku subjekti zgjedhor regjistron dhurimet, huatë ose kreditë e përfituara nga vetë subjekti dhe kandidatët e tij për shumat mbi 50.000 lekë[483], por specifikimet se si konkretisht ky akses bëhet i mundur dhe si konfigurohet baza e të dhënave mungojnë.

Ndërkohë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nuk e adresoi rregullimin e detajuar të kësaj dispozite në aktet e veta rregullatore, çka e bën atë praktikisht të pazbatueshme në praktikë.

Kodi Zgjedhor[484] dhe udhëzimi[485] i KQZ-së kanë të përcaktuar ndër kriteret e tjera të nevojshme për regjistrimin e subjekteve zgjedhorë, edhe detyrimin e hapjes së një numri të posaçëm llogarie bankare.

KQZ-ja publikoi në faqen e saj numrat e llogarive për të gjitha subjektet zgjedhore[486]. Megjithatë, raportet e auditimit për disa subjekte zgjedhore[487] pohojnë se subjekti zgjedhor nuk kishte hapur llogari të posaçme bankare për fushatë.

Nuk është e qartë nëse KQZ-ja ka publikuar llogaritë e partive politike përkatëse, dhe jo llogaritë e posaçme në këto raste, apo nëse është një pasaktësi nga ana e auditëve.

Këto të dhëna, duhet të plotësoheshin edhe nga kandidatët të cilët planifikonin të pranonin dhurime mbi 50.000 lekë[488].

Rezultoi se vetëm 38 kandidatë[489] përfaqësues të tri subjekteve zgjedhore dhe tre kandidatë të pavarur, dorëzuan të dhënat e llogarive të tyre bankare në KQZ.

Shuma e dhuruar nga individë apo subjekte të ndryshme ndaj partive politike për zgjedhjet e datës 25 prill 2021 ishte 49.909.641 lekë, nga të cilat 4.124.978 lekë ishin dhurime monetare, 7.861.950 lekë dhurime në natyrë dhe 37.922.713 lekë kuota anëtarësie.

Dhurimet në natyrë të deklaruara rezultojnë se janë kryesisht zyra elektorale, dhe më pak karburant, printim materialesh promocionale, pagesa për media sociale, etj.

Sa i përket donacioneve në vlera monetare[490], vërehet një numër shumë më i ulët donatorësh si dhe i vlerës monetare të dhuruar ndaj partive politike për efekt të fushatës zgjedhore, në krahasim me zgjedhjet e mëparshme[491]. Shuma totale e dhuruar në para për zgjedhjet e 25 prillit 2021 ishte 4.124.978 lekë e dhuruar për 11 subjekte[492].

483 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 92/1, "Financimi i subjekteve zgjedhore nga fondet jopublike", pika 5.

484 Po aty, Neni 92/2, "Regjistrimi i fondeve jopublike", pika 2

485 Udhëzim nr. 01, datë 23.12.2020, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve "Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit".

486 Të dhënat e llogarive bankare të subjekteve zgjedhore.

487 Bindja Demokratike, Partia Socialdemokrate, Partia Demokristiane, Partia Fryma e Re Demokratike, Partia Nisma Thurje, Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar, kandidati i pavarur Pal Shkambi, kandidatët e Partisë Agrare Ambjentaliste dhe të Partisë Lëvizja e Re, subjekte këto që kanë përfituar të ardhura dhe kryer shpenzime gjatë fushatës elektorale. Përpos tyre edhe kishte edhe subjekte të tjera të cilat nuk hapën llogari të posaçme bankare, por këto të fundit nuk patën asnjë aktivitet financiar në funksion të fushatës. Këto parti ishin: PBDSH, PKD, PLL, PBLD, POSH, PBPPSH, PESH, ADRE, PBK.

488 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 92/2 "Regjistrimi i fondeve jopublike", pika 3.

489 Gjashtë kandidatë të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, dy kandidatë të Partisë Socialdemokrate, 27 kandidatë të Partisë Lëvizja e Re dhe tre kandidatë të pavarur.

490 Dhurime monetare ndaj partive politike: - Partia Bindja Demokratike ka 8 donatorë me 100.000 lekë secili; - Partia Socialiste ka 20 donatorë me 50.000 lekë secili; - Partia Lëvizja Socialiste për Integrim ka 1 donator me 50.000 lekë; - PBDNJ ka një donator me 150.000 lekë (që është vetë kryetari i partisë); - Partia Lëvizja për Ndryshim ka 15 donatorë që kanë dhuruar shuma të ndryshme me një vlerë totale 748.720 lekë;
Dhurime monetare ndaj kandidatëve të pavarur: - Z. Kreshnik Merxhani ka 4 donatorë me vlera të ndryshme me shumë totale 234.950 lekë; - Z. Pal Shkambi ka 1 dhurues me 102.250 lekë; - Z. Iljaz Shehu ka 4 donatorë me vlera të ndryshme me shumë totale 210.150 lekë; - Z. Boiken Abazi ka 6 donatorë me vlera të ndryshme me shumë totale 271.850 lekë dhe Z. Elton Debreshi ka 48 donatorë me vlera të ndryshme me shumë totale 439.047 lekë.

491 Në Zgjedhjet e mëparshme rezultojnë të deklaruar këto dhurime monetare: - Shuma totale e dhuruar në Zgjedhjet Parlamentare të vitit 2013 ishte 84.882.620 lekë nga 125 donatorë për 9 subjekte zgjedhore; - në Zgjedhjet Lokale të vitit 2015 ishte 20.081.000 lekë nga 70 donatorë për 2 subjekte zgjedhore; - në Zgjedhjet Parlamentare të vitit 2017 ishte 10.224.985 lekë nga 73 donatorë për 4 subjekte zgjedhore dhe në Zgjedhjet Lokale të vitit 2019 ishte 1.921.425 lekë nga 15 donatorë për 3 subjekte zgjedhore.

492 Konkretisht rezultojnë 108 donatorë, 45 donatorë për 6 parti politike dhe 63 për kandidatët e pavarur.

VIII.2.1.2.2. Të ardhura të krijuara nga vetë subjektet

Të ardhurat e gjeneruara nga vetë subjektet zgjedhore sipas ligjit mund të jenë kuotat e anëtarësisë, huatë dhe kreditë.
Asnjë subjekt nuk ka deklaruar të ketë marrë hua apo kredi për zgjedhjet e vitit 2021, pavarësisht se deklaron se ka raste të detyrimeve ende të papaguara[493].
Evidentohet se janë vetëm 3 partitë kryesore politike (PS, PD dhe LSI) të cilat kanë deklaruar të ardhura nga kuotat e anëtarësisë[494] afërsisht 38.000.000 lekë, dhe të ardhura të gjeneruara nga llogaritë e tjera, respektivisht të secilit subjekt, që shkon në një shumë rreth 65.000.000 lekë. Duhet theksuar se në raportet përkatëse të vetëdeklarimit nuk ka specifikime të mëtejshme se nga cila llogari janë gjeneruar konkretisht të ardhurat apo se si janë krijuar ato[495].

Partia	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021
PS	8.909.000	5.223.200	38.460.250	11.767.849	38,146,158	6.804.560	2.976.735		25.839.161
PD	1.500.000	0	0	0	181.045	2.014.303	1.302.950	5.377.825	10.258.792
LSI	0	0	17.184.732	32.617.860	14.203.270	5.306.260	4.254.990	2.913.700	1.824.760

Tabela e kuotave të anëtarësisë sipas vetëdeklarimeve të partive politike

Nga analiza paraprake që mund t'i bëhet tabelës së mësipërme mbi kuotat e anëtarëssisë së partive politike të vetëdeklaruara prej tyre prej vitit 2013 e deri më sot, vlerësohet se të ardhurat e siguruara për partitë politike nga kuotizacionet e anëtarësisë përkatëse, nuk kanë patur një ecuri që mund të konsiderohet normale, duke qenë se nga viti në vit ndryshimet e shifrave të deklaruara janë shumë të mëdha, ndërkohë që sipas deklarimeve publike të këtyre partive, në vazhdimësi është theksuar fakti i rritjes së anëtarësisë së tyre.
Situata bëhet edhe më problematike nëse sillet në vëmendje fakti se anëtarësia e partive politike dhe numri i saj, nuk është detyrim ligjor për t'u bërë publik, apo njoftuar pranë ndonjë institucioni të tretë, jashtë partive politike. I vetmi detyrim ligjor dhe statutor është parashikimi që secili prej anëtarëve duhet të paguajë rregullisht kuotën e anëtarësisë, pasi në të kundërt mund të humbasë edhe anëtarësinë.
Diferenca e madhe e shifrave të vetëdeklaruara apo deklarimi edhe me zero i kuotave vjetore të anëtarësisë, evidenton problematikën e mosfunksionimit të rregullt të organizimit të brendshëm të partive politike, si dhe ngre dyshime të forta për sinqeritetin dhe vërtetësinë e këtyre deklarimeve, e rrjedhimisht edhe mbi burimet e financimit të këtyre partive.
Vlerësohet se ky aspekt është një çështje ku edhe auditët ligjorë e kanë mjaft të vështirë apo gati të pamundur të kontrollojnë vërtetësinë e informacionit të servirur nga vetë partitë.
Kjo situatë meriton një rregullim të detajuar dhe të plotë ligjor, për më tepër kur fakti i të qenit anëtar ose jo i një partie politike, përbën kusht për kualifikimin ose jo të kandidatëve për një sërë pozicionesh zyrtare, veçanërisht në institucionet e pavarura dhe në ato të drejtësisë.

VIII.2.1.2.3. Të ardhurat e kandidatëve

Burimet e financimit të fushatës zgjedhore për kandidatët janë financimet private, burime vetjake të vetë kandidatit, huatë apo kreditë dhe mbështetja financiare nga partia politike.
Të ardhurat e kandidatëve i nënshtrohen të njëjtave rregulla[496] e kufizime sikurse partitë politike. Gjithashtu, edhe vetëfinancimi i kandidatit i nënshtrohet të njëjtave rregulla sikurse dhurimi nga të tretët.

493 Sipas raporteve të vetëdeklarimit, Partia Bindja Demokratike në raport ka 522.113 lekë shërbime (spot publicitar në media) të deklaruara të palikujduara; Partia Demokratike në raport ka 90.000 lekë shërbime (qera ambjenti për zyrë elektorale) të deklaruara të palikujduara; Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet në raport ka 112.648 lekë shërbime (foni për mitingje dhe karrige për mitingje) të deklaruara të palikujduara.

494 PS ka deklaruar 25.839.161 lekë të ardhura nga kuotat e anëtarësisë, PD ka deklaruar 10.258.792 lekë të ardhura nga kuotat e anëtarësisë dhe LSI ka deklaruar 1.824.760 lekë të ardhura nga kuotat e anëtarësisë.

495 Nisur nga shqyrtimi në vazhdimësi që iu është bërë raporteve financiare të partive politike, një pjesë e këtyre të ardhurave mund të jetë nga financimi vjetor i buxhetit të shtetit për këto parti, si dhe të ardhura të gjeneruara nga anëtarësia, kuotat, kartat e anëtarësisë, etj. Mungesa e bilancit të aseteve dhe detyrimeve për periudhën 06.09.2020-25.04.2021, e bën të vështirë gjykimin mbi këto burime. Mbetet detyrë e audituesit ligjor për të verifikuar dhe rakorduar këto deklarime edhe në kuadër të auditimit të raporteve financiare vjetore të këtyre partive.

496 Kodi Zgjedhor Neni 92/1 dhe neni 92/2.

Sa i përket financimit në natyrë apo në para nga partia politike nën siglën e së cilës kandidon, kandidati nuk mbart detyrimin e raportimit. Këtë detyrim e ka partia politike përkatëse.
Nga raportet e vetëdeklarimit vërehet se asnjë prej kandidatëve nuk ka deklaruar të ketë marrë hua apo kredi në funksion të fushatës përkatëse zgjedhore.

Ndërkohë rezulton se 50% e të ardhurave janë financime nga vetë kandidatët për fushatën e tyre, ndërsa pjesa tjetër janë: dhurime në natyrë në masën prej 9% dhe dhurime në para nga persona të tretë në masën prej 41% të të ardhurave.
Duke qenë se financimi i fushatës së kandidatëve i nënshtrohet të njëjtave rregulla sikurse partitë politike, në zbatim të parashikimeve të Kodit Zgjedhor, çdo dhurim monetar mbi 50.000 lekë duhet të derdhet në një llogari të posaçme bankare të hapur nga kandidati për këtë qëllim[497].

Nga shqyrtimi i raporteve vërehet se një numër i konsiderueshëm kandidatësh[498] kanë marrë dhurime në para *cash* më të mëdha se vlera e lejuar nga ligji. Ndërsa përsa i përket dhurimeve të kryera nëpërmjet transfertave bankare, mbetet detyrë e auditit për të verifikuar nëse ato janë kryer ose jo nëpërmjet një llogarie të posaçme bankare.
Gjithashtu, është vërejtur se në disa raste është kryer dhurim me një shumë më të madhe se 50.000 lekë, por Kandidatët përfitues[499] nuk e kanë specifikuar në seksionin përkatës në raportin financiar mënyrën e realizimit të dhurimit, sikurse parashikon detyrimi ligjor.
Përpos mënyrës së realizimit të dhurimit, pjesë integrale e formatit të raportit janë edhe detaje të tjera që duhet të plotësohen, sikurse edhe në formatet e raportimit të partive politike.
Nga shqyrtimi i raporteve, u vërejt se 19 kandidatë[500] kanë deklaruar marrjen e financimit prej burimeve të tyre personale për mbulimin e shpenzimeve të fushatës elektorale, pas përfundimit të kësaj të fundit, madje deri edhe në dy muaj pas ditës së zgjedhjeve.
Pavarësisht se bëhet fjalë për burime personale të ardhurash, kjo situatë tregon së paku nivel të ulët informimi mbi detyrimet ligjore dhe neglizhencë ndaj zbatimit të tyre.

VIII.2.2. SHPENZIMET PËR FUSHATËN ZGJEDHORE

Kodi zgjedhor parashikon se shpenzim për fushatë zgjedhore konsiderohet çdo shpenzim që bëhet për qëllime të fushatës, nëse është bërë nga partia, kandidatët apo degët e saj.
Shuma totale e shpenzimeve të realizuara në funksion të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e

497 Kodi Zgjedhor Neni 92/2 pika 2.

498 Kanë tejkaluar kufirin ligjor të lejuar të marrjes së dhurimeve në *cash* kandidatët e mëposhtëm të:
- Partisë Socialiste: Pranvera Resulaj 200.000 lekë, Vullnet Sinaj 322.110 lekë, Anila Denaj 285.202 lekë, Damian Gjiknuri 78.809 lekë, Ermonela Felaj 210.000 lekë, Xhemal Qefalija, Edmond Rushi 158.000 lekë, Ornaldo Rakipi 191.000 lekë, Kledina Skendo 151.000 lekë, Benet Beci 630.000 lekë, Lela Berdica 400.000 lekë, Eduard Ndreca 345.100 lekë, Laert Duraj 137.865 lekë, Erion Brace 201.560 lekë, Arber Arapi 81.000 lekë, Florenc Spaho 98.553 lekë, Fadil Nasufi 258.000 lekë, Nasip Naco 100.000 lekë, Briseida Gjoza 69.800 lekë.
- Lëvizjes Socialiste për Integrim: Luljeta Skura 70.000 lekë, Bahri Shaqiri 70.812 lekë, Shemsi Prençi 70.000 lekë, Ramazan Topuzi 72.979 lekë, Endrit Brahimllari 90.000 lekë, Gentian Cala 109.650 lekë, Floida Kerpaçi 60.000 lekë, Faik Basha 123.120 lekë, Klodjan Doka 153.020 lekë, Luan Rama 144.200 lekë, Griselda Myslymi 116.100 lekë, Liri Dema 81.120 lekë, Anxhela Shenaj 61.000 lekë, Joana Ruçi 61.000 lekë, Blenard Monaj 51.200 lekë, Anxhela Kalivaçi 95.505 lekë, Dikens Bushaj 52.600 lekë, Merita Hoxha 70.000 lekë, Ramazan Topuzi 72.979 lekë (e ndarë kjo shumë në disa këste), Arben Rroko 86.200 lekë (e ndarë kjo shumë në 2 këste).
- PAA: Agron Duka 140.000 lekë.
- LRE: Asllan Hoxha 74.200 lekë (e ndarë kjo shumë në dy këste), Fitimtar Lala 236.000 lekë (e ndarë kjo shumë në disa këste), Bledar Lleshi 74.100 lekë (e ndarë kjo shumë në disa këste).

499 Kandidatët e PS: Niko Kurri 105.000 lekë, Eduart Shalsi 278.000 lekë, Pandeli Majko 270.080 lekë, Alfred Muharemi 247.000 lekë, Halim Dauti 267.197 lekë.
Kandidatët e Lëvizjes Socialiste për Integrim: Agron Çela 430.000 lekë, Edmond Ndou 290.000 lekë, Lindita Reçi 260.000 lekë, Ilir Hyseni 230.000 lekë, Somela Radohima 150.000 lekë.

500 - Kandidatë të PS: Eduart Shalsi dhuruar vetes 175.000 lek në datën 30.06.2021; Eduard Ndreca dhuruar vetes 345.100 lekë në datat 30 prill, 31 maj dhe 2 qershor.
- Kandidatë të LSI: Endrit Brahimllari dhuruar vetes 90.000 lek cash në datën 22.05.2021; Griselda Myslymi dhuruar vetes 86.100 lekë në disa këste midis datave 10 maj – 18 maj; Lindita Reçi dhuruar vetes 260.000 lekë në datën 19.05.2021; Dikens Bushaj dhuruar vetes 52.600 lekë në datën 19.05.2021; Ilir Hyseni dhuruar vetes 230.000 lekë në datën 19.05.2021; Klajda Gjosha dhuruar vetes 125.000 në dy këste nëpërmjet transfertës bankare në datën 11.05.2021 dhe 18.05.2021; Arben Çuko dhuruar vetes 30.000 lekë cash në datën 04.05.2021; Liri Dema dhuruar vetes 81.120 lekë cash në datën 05.05.2021 dhe 10.05.2021; Floida Kerpaçi dhuruar vetes 60.000 lekë cash në datën 31.05.2021; Somela Radohima dhuruar vetes 150.000 lekë cash në datën 19.05.2021; Anxhela Shenaj dhuruar vetes 61.000 lekë cash në data të ndryshme në muajin maj; Kristian Kina dhuruar vetes 10.000 lek cash në datën 24.05.2021; Joana Ruçi dhuruar vetes 61.000 lekë cash në datën 04.06.2021; Ramazan Topuzi dhuruar vetes 20.004 lekë në datën 24.05.2021; Silva Caka dhuruar vetes 15.000 lekë në datën 08.06.2021; Besnik Jakaj dhuruar vetes 25.500 lekë në datën 25.05.2021; Everton Shehu dhuruar vetes 47.000 lekë në datën 25.05.2021; Vojo Bregu dhuruar vetes 200.000 lekë në datën 16.07.2021 nëpërmjet transfertës bankare; Arben Rroko dhuruar vetes 86.200 lekë cash në datat 05.05.2021 dhe 12.05.2021.

datës 25 prill 2021 është 295.928.351 lekë e shpenzuar nga 20 subjekte zgjedhore[501], përfshirë kandidatët e tyre[502].

Zërat për të cilët subjektet kanë shpenzuar më shumë janë mediat që zënë 39% të shpenzimeve[503], aktivitetet elektorale me 18% të shpenzimeve, prodhimi i materialeve promocionale që zë 15% të shpenzimeve, konsulenca me 10% të shpenzimeve[504], shpenzimet administrative me 10%, zyrat zgjedhore 3% si dhe transporti e shpenzimet e tjera 6%.

Kodi Zgjedhor[505] vendos nivelin maksimal të shpenzimeve që mund të kryejë një parti politike duke përfshirë kandidatët e saj, në funksion të fushatës elektorale, i cili nuk duhet të jetë më shumë se 3-fishi i vlerës më të madhe të marrë nga një subjekt zgjedhor nga fondet publike në funksion të fushatës. Për këto zgjedhje kjo vlerë përllogaritet 167.480.250 lekë[506].

Vërehet se Partia Socialiste, përfshirë kandidatët e saj, e ka tejkaluar limitin e shpenzimeve me rreth 4.5 milionë lekë (ka shpenzuar 172.046.612 lekë). Vendimi nr. 18 i Komisionit Rregullator[507] parashikon sanksion administrativ për këtë shkelje.

Jo vetëm deklarimi i plotë dhe i vërtetë, por edhe dokumentimi i duhur i shpenzimeve sipas legjislacionit tatimor në fuqi, është pjesë shumë e rëndësishme e raporteve financiare të subjekteve zgjedhore në funksion të transparencës dhe zbatimit të ligjit. Përputhshmëria dhe rregullsia e faturave tatimore është objekt i punës së auditëve ligjorë, të emëruar nga KQZ, të cilët realizuan auditimin e fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike gjatë fushatës zgjedhore.

Shpenzimet e kryera nga subjektet zgjedhore duhet të udhëhiqen jo vetëm nga parimi i vërtetësisë, por edhe i përgjegjshmërisë.

Sipas ligjit, shpenzim i fushatës konsiderohet çdo shpenzim i kryer nga partia apo kandidatët e saj për qëllime të fushatës zgjedhore pavarësisht kohës kur është kryer ai. Në këtë kuptim, partitë duhet të kenë një qasje që reflekton përgjegjshmëri maksimale të tyre, qoftë në nivel parimor e politik, qoftë edhe në zbatimin katërcipërisht të rregullave dhe procedurave ligjore të parashikuara.

Nuk është asesi në frymën dhe gërmën e ligjit që mbështetja financiare e dhënë ndaj partive politike nga buxheti i shtetit për zhvillimin e fushatës elektorale, të përdoret për likujdime të faturave të mbartura nga periudha të mëparshme e të papaguara ende, apo për shpenzime ushqimore në supermarket, sikurse disa parti kanë deklaruar në raportet e tyre.

Fondet për fushatën zgjedhore jepen me qëllimin madhor që zgjedhësit të mund të informohen sa më mirë për ofertën elektorale të secilës prej partive garuese. Përdorimi i fondeve përtej këtij qëllimi është së paku keqpërdorim i mbështetjes me para publike nga qytetarët shqiptarë.

Në këtë këndvështrim, në funksion të transparencës së shpenzimeve të fondeve të përfituara nga buxheti i shtetit dhe mirëmenaxhimit të tyre, vlerësohet të sillet në vëmendje dhe të konsiderohet propozimi i disa auditëve ligjorë në vitet paraardhëse mbi aplikimin e ligjit të prokurimit publik në procesin e shpenzimit të tyre.

Nga ana tjetër , nevojitet gjithashtu të bëhet rregullimi ligjor i nevojshëm dhe i detajuar, i cili të parashikojë që fondet publike të pashpenzuara sipas rregullave fiskale e tatimore, apo të shpenzuara për qëllime joelektorale, të kthehen në buxhetin e shtetit nga partitë përkatëse.

Në gjykimin e KRIIK, pamundësia apo paaftësia e çdo subjekti zgjedhor për t'u sjellë me përgjegjshmëri dhe menaxhuar fondet publike me vërtetësi dhe në respekt të plotë të parashikimeve ligjore, është së paku pamundësi dhe paaftësi për të ushtruar përgjegjësitë publike në ushtrimin e detyrës si i zgjedhur i popullit.

VIII.2.2.1. Shpenzimet për aktivitete elektorale dhe mitingje

Shuma e shpenzuar në total për zhvillimin e aktiviteteve elektorale, sipas përllogaritjeve të zërit mitingje, tubime dhe aktivitete në fushatë është 44.160.147 lekë, e shpenzuar nga 5

501 15 parti politike dhe 5 kandidatë të pavaruar.

502 Shuma e shpenzuar nga partitë është 249.971.004 lekë dhe shuma e shpenzuar nga kandidatët e tyre është 45.957.347 lekë.

503 Nga të cilat 31% për media tradicionale, kryesisht televizione dhe 8% për media sociale.

504 Shpenzime për konsulencë kanë deklaruar vetëm PS dhe PD.

505 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 92/2, "Regjistrimi i fondeve jopublike", pika 4.

506 Trefishi i shumës më të lartë, e cila është përfituar nga Partia Socialiste në vlerën 55.826.750 lekë.

507 Vendim nr. 18 datë 14.04.2021, "...Shkelja e kufirit maksimal të shpenzimeve nga një subjekt zgjedhor dënohet me një gjobë prej 5 000 000 lekësh ose me një gjobë të barabartë me shumën që ka kaluar kufirin, cilado që është më e lartë."

subjekte zgjedhore[508].
Raportet e vetë-deklarimit duhet të përfshijnë të dhënat e çdo shpenzimi të kryer, qoftë edhe indirekt, për çdo miting të realizuar prej subjekteve zgjedhore. Reflektimi i plotë i të dhënave në seksionin e posaçëm të parashikuar në formatet e raportimit do të jepte një panoramë sistematike të mitingjeve të realizuara, përfshirë evidentimin më të plotë dhe të qartë të shpenzimeve. Kjo pjesë e formatit të raportimit kërkon që subjekti zgjedhor të japë informacion financiar rreth mitingjeve të fushatës, sipas vlerës së shpenzuar për çdo event, çka jep mundësinë dhe siguron një pasqyrë të mjaftueshme të shpenzimeve për të konkluduar se sa mund të kushtojë një aktivitet i tillë.
Nga shqyrtimi i bërë i të gjithë raporteve, rezulton se asnjë prej tyre nuk e ka të plotësuar plotësisht këtë seksion të raportit.

Edhe tek ato parti që e kanë të plotësuar pjesërisht[509] atë, është i pamundur krijimi i një panorame të qartë të aktiviteteve të kryera dhe kostimi respektiv i secilit prej tyre.
Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet është e vetmja parti tek e cila raportimet në seksionin e shpenzimeve dhe seksionin specifik të mitingjeve janë në të njëjtën vlerë[510].
Partia Socialiste dhe Lëvizja Socialiste për Integrim deklarojnë vlera të ndryshme[511] në seksionin e shpenzimeve, në zërin e mitingjeve e tubimeve, dhe në seksionin e shpenzime për mitingje në raport.
Partia Demokratike nuk ka asgjë të plotësuar në seksionin e shpenzimeve për mitingje. Ndërkohë në seksionin e shpenzimeve deklaron shumën 147.732 lekë të shpenzuar për mitingje.

Vlerësohet se duke patur në konsideratë gjithë aktivitetet e zhvilluara prej kësaj partie gjatë fushatës elektorale, e cila ka kryer aktivitete elektorale në çdo bashki, si dhe mitingjet e hapjes dhe mbylljes së fushatës elektorale, ky deklarim nuk është i vërtetë dhe nuk reflekton kostot reale.

VIII.2.2.2. Shpenzimet për zyra elektorale

Evidentimi i numrit të zyrave zgjedhore, referuar detyrimeve ligjore që iu lindin subjekteve zgjedhore në momentin e hapjes së një zyre, do të duhej të ishte një proces i thjeshtë përllogaritje matematikore.
Nga konsultimi i raporteve të subjekteve zgjedhore vërehet se ka një mospërputhje në shifrat e deklaruara me informacionin e ardhur nga raportet e monitoruesve të emërëuar nga KQZ, si dhe nga monitorimi i kryer nga vëzhguesit e KRIIK në terren.

Konkretisht monitoruesit kanë evidentuar në terren 660 zyra zgjedhore, vëzhguesit e KRIIK kanë evidentuar 651 zyra zgjedhore, ndërsa nga raportet e vetëdeklarimit, duke i konsideruar ato të plota e të sakta[512], figuron se subjektet zgjedhore kanë deklaruar në total 426 zyra zgjedhore[513] në të gjithë vendin.

508 Nga të cilat 4 janë parti politike dhe 1 kandidat i pavarur.

509 Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, Partia Socialiste dhe Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet.

510 Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet ka pasqyruar 484.648 lekë të shpenzuara për mitingje në Fier dhe Vlorë.

511 Konkretisht, PS sipas seksionit përkatës të shpenzimeve në raport, në zërin mitingje/tubime dhe aktivitete, deklaron 40.246.286 lekë të shpenzuara, ndërsa në seksionin e shpenzimeve për mitingjet e fushatës ka pasqyruar 9.260.000 lekë të shpenzuara për mitingje. LSI sipas seksionit të shpenzimeve në raport në zërin mitingje/tubime dhe aktivitete deklaron 3.267.891 lekë të shpenzuara, ndërsa në seksionin e shpenzimeve për mitingjet e fushatës ka pasqyruar 1.970.000 lekë të shpenzuara.

512 Përllogaritja e numrit është bërë duke llogaritur: tek PD, të gjitha deklarimet tek dhurimet në natyrë si zyra zgjedhore, si dhe tek LSI çdo përshkrim të deklaruar tek shpenzimet si qera zyre.
Vlerësimi në raportin e LSI-së është bërë duke marrë për të saktë dhe të mirëqenë gjithë çfarë është deklaruar aty, ndërkohë që KRIIK ka vërejtur se disa deklarime janë bërë gabim, pasi ka ripërsëritje të zërave / deklarimeve të dhurimeve në natyrë si dhe të shpenzimeve

513 Nga krahasimi i gjetjeve konstatohet se:
- *Partia Socialiste:* sipas vëzhguesve të KRIIK 266 zyra, sipas raporteve të monitoruesve 252, sipas raportit të vetëdeklarimit 230;
- *Partia Demokratike*: sipas vëzhguesve të KRIIK 240 zyra, sipas raporteve të monitoruesve 262, sipas raportit të vetëdeklarimit 41;
- *Lëvizja Socialiste për Integrim*: sipas vëzhguesve të KRIIK 80 zyra, sipas raporteve të monitoruesve 75, sipas raportit të vetëdeklarimit 71;
- *Partia Socialdemokrate*: sipas vëzhguesve të KRIIK 18 zyra, sipas raporteve të monitoruesve 13, sipas raportit të vetëdeklarimit 0;
- *Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet*: sipas vëzhguesve të KRIIK 16 zyra, sipas raporteve të monitoruesve 15, sipas raportit të vetëdeklarimit 22;
- *Partia Lëvizja e Re*: sipas vëzhguesve të KRIIK 8 zyra, sipas raporteve të monitoruesve 1, sipas raportit të vetëdeklarimit 0;

Përveç zyrave të raportuara nga subjektet zgjedhore, Partia Socialiste dhe Lëvizja Socialiste për Integrim kanë raportuar edhe zyra zgjedhore të ngritura nga kandidatët, respektivisht 24 dhe 29 zyra. Nuk është e qartë nëse këto zyra zgjedhore janë të përfshira në raportin e dorëzuar nga Partia apo nëse janë shtesë.
Ndërkohë, vëzhguesit e KRIIK kanë identifikuar në total 133 zyra zgjedhore të cilat ishin branduar nga kandidatë të veçantë, por rezulton se ato nuk janë raportuar nga vetë kandidatët[514].

Gjithashtu, rezulton se së paku 68 kandidatë të cilët kanë branduar një zyrë zgjedhore, të identifikuar nga vëzhguesit e KRIIK, nuk kanë deklaruar shpenzime për zyra zgjedhore. Sërish, edhe në këtë rast është e paqartë nëse këto zyra zgjedhore janë paguar nga partitë dhe janë të përfshira në raportet financiare të tyre, apo janë të paraportuara.
Ajo çka vërehet nga raportimi në lidhje me zyrat zgjedhore është se, në disa raste çmimet e deklaruara në raportet e vetëdeklarimit nuk përfaqësojnë vlerën reale të tregut në zonën përkatëse të vendndodhjes dhe as çmimin e referencës për atë zonë.

Vëzhguesit e KRIIK kryen një vlerësim të përafërt të sipërfaqes së zyrave zgjedhore të identifikuara, si dhe raportuan vendndodhjen gjeografike të tyre.
Bazuar në këto të dhëna, dhe referuar çmimeve të referencës, sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave të vitit 2019[515], totali i shpenzuar për zyrat zgjedhore të identifikuara nga KRIIK është rreth 7.5 milionë lekë në muaj[516]. Duke përllogaritur që zyrat zgjedhore janë marrë me qira për së paku dy muaj nga një pjesë e konsiderueshme e subjekteve zgjedhore, dhe në shumë raste për më tepër se kjo periudhë, kjo shifër, minimalisht dyfishohet.
Nga ana tjetër, vlen të merret në konsideratë se çmimi i referencës nuk është çmimi real i tregut, por shumë më i ulët se ai. KRIIK mblodhi informacion në lidhje me çmimin e tregut nga kompani pasurish të paluajtshme për Bashkinë Tiranë, dhe rezulton se çmimi real e tejkalon atë të referencës me së paku dyfish.
Pra, në rezultante, shuma totale e përllogaritur nga çmimet e referencës mund të katërfishohet (një vlerësim konservator), duke e shpënë në rreth 30 milionë lekë. Ndërkohë, në total, subjektet zgjedhore kanë raportuar rreth 10.452.101 lekë si shpenzime për zyra zgjedhore, nga të cilat 3.645.763 lekë janë deklaruar nga kandidatët, 6.656.588 lekë nga partitë politike dhe 149.750 lekë nga kandidatët e pavarur.
Sërish, mbetet e paqartë nëse shpenzimet e deklaruara nga subjektet zgjedhore (partitë politike) përfshijnë edhe deklarimet e kandidatëve, duke e rënduar edhe më krahasimin e

- *Nisma Thurje*: sipas vëzhguesve të KRIIK 5 zyra, sipas raporteve të monitoruesve 2, sipas raportit të vetë deklarimit 0;
- *Bindja Demokratike*: sipas vëzhguesve të KRIIK 5 zyra, sipas raporteve të monitoruesve 5, sipas raportit të vetëdeklarimit 0;
- Kandidat i Pavarur Elton Debreshi sipas vëzhguesve të KRIIK 1, sipas raporteve të monitoruesve 0, sipas raportit të vetëdeklarimit 0;
- Kandidat i Pavarur Iljaz Shehu sipas vëzhguesve të KRIIK 1, sipas raporteve të monitoruesve 0, sipas raportit të vetëdeklarimit 1.
- *Partia Agrare Ambientaliste*: sipas vëzhguesve të KRIIK 2 zyra, sipas raporteve të monitoruesve 0, sipas raportit të vetëdeklarimit 0;
- *Aleanca Demokracia e Re*: sipas vëzhguesve të KRIIK 2 zyra, sipas raporteve të monitoruesve 0, sipas raportit të vetëdeklarimit 0;
- *Fryma e Re Demokratike*: sipas vëzhguesve të KRIIK 2 zyra, sipas raporteve të monitoruesve 0, sipas raportit të vetëdeklarimit 0;
- *Lëvizja për Ndryshim*: sipas vëzhguesve të KRIIK 2 zyra, sipas raporteve të monitoruesve 0, sipas raportit të vetëdeklarimit 2;
- *Partia Demokristiane e Shqipërisë*: sipas vëzhguesve të KRIIK 1 zyrë, sipas raporteve të monitoruesve 0, sipas raportit të vetëdeklarimit 0;
- *Partia Kristiandemokrate*: sipas vëzhguesve të KRIIK 1 zyrë, sipas raporteve të monitoruesve 0, sipas raportit të vetëdeklarimit 0;
- *Partia Republikane*: sipas vëzhguesve të KRIIK 1 zyrë, sipas raporteve të monitoruesve 0, sipas raportit të vetëdeklarimit 0;

514 Numri i kandidatëve që kishin posterat e tyre në pjesën e jashtme të zyrave zgjedhore, sipas subjekteve zgjedhore: 64 nga Partia Socialiste, 32 nga Partia Demokratike, 19 nga Lëvizja Socialiste për Integrim, 5 nga Bindja Demokratike, 3 nga Partia Lëvizja e Re, 3 nga Partia Socialdemokrate, 2 nga Nisma Thurje, 2 nga Partia Aleanca Demokracia e Re, 2 nga Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet dhe 1 nga Partia Kristiandemokrate.

515 Vendim nr. 168, dt. 27.03.2019 i Këshillit të Ministrave "Për disa ndryshime në Vendimin nr. 132, datë 7.3.2018, të Këshillit të Ministrave "Për metodologjinë dhe përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "Ndërtesa", e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe kritereve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës".

516 Përllogaritja është kryer duke i konsideruar mjediset e përdorura për zyra zgjedhore si mjedise shërbimesh (dyqane), duke qenë se ato janë në kate të para apo të dyta të ndërtesave, me hyrje nga rruga, qartas mjedise që përmbushin kriteret për mjedise shërbimesh.

shifrave, apo nëse këto shpenzime janë të deklaruara veçmas.
Në çdo rast, sipas gjykimit të KRIIK, vlerësohet se shpenzimet e deklaruara për zyrat zgjedhore duket të jenë larg vlerave reale, duke marrë në konsideratë, minimalisht, vetëm dy faktorët e sipërpërmendur, çmimin e tregut dhe kohëzgjatjen e mbajtjes së ambientit si zyrë zgjedhore.

VIII.2.2.3. Shpenzimet për media

Shpenzimet e drejtuara për median zënë vendin më të madh në totalin e shpenzimeve të realizuara nga subjektet zgjedhore.
Pavarësisht se Kodi Zgjedhor përcakton[517] një limit kohor prej 90 minutash për reklamë politike për secilën parti, gjysma e së cilës duhet të ofrohet falas nga media përkatëse, nga monitorimi i AMA-s ky limit është tejkaluar nga shumë televizione dhe subjekte zgjedhore.
Kodi Zgjedhor parashikon se çdo media duhet të depozitojë në KQZ, përpara fillimit të fushatës zgjedhore, tarifat që ajo aplikon lidhur me reklamën politike përgjatë fushatës zgjedhore. Ky detyrim ligjor u plotësua vetëm nga 17 media[518].
Një element mjaft i rëndësishëm lidhur me ofrimin e reklamës falas, siç është detyrimi eksplicit që Kodi Zgjedhor[519] i ngarkon KQZ-së dhe Ministrisë së Financave, për hartimin e udhëzimit të përbashkët mbi procedurat e faturimit nga mediat ndaj partive politike lidhur me reklamën politike që ato kryejnë në këto media gjatë fushatës elektorale, nuk u realizua.
Nga shqyrtimi i raporteve vërehet se shpenzime të realizuara në zërin media kanë deklaruar vetëm 7 parti politike, 1 kandidat i pavarur dhe 13 kandidatë për deputetë, në një shumë totale prej 78.350.572 lekë[520].
Sipas monitorimit të kryer nga AMA, në mediat shqiptare janë transmetuar gjatë 30 ditëve të fushatës zgjedhore 9.260 minuta reklamë nga 15 subjekte[521] në 33 televizione të monitoruara.
Referuar gjithë sa më sipër, duke u bazuar në minutat e reklamës për secilin subjekt në secilin prej televizioneve të monitoruara nga AMA, si dhe në tarifat e mediave për reklamë politike të depozituar në KQZ, pas një kryerjes së një përllogaritjeje të përafërt[522] vërehet një diferencë shumë e lartë midis shifrës së raportuar nga subjektet dhe asaj të përllogaritur. Diferenca rezulton të jetë së paku 690.000.000 lekë, pra rreth 9-fish më e lartë[523].
Lidhur me këtë mospërputhje edhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve iu dërgoi shtatë partive[524] politike një letër kërkesë për sqarime të mëtejshme lidhur me mospërputhjet në deklarimet e tyre, dy prej të cilave[525] nuk i kanë kthyer ende një përgjigje zyrtare KQZ-së.
Përpos kësaj, edhe partitë që kanë reaguar ndaj kërkesës së KQZ, me përgjigjet[526] e tyre e bëjnë

517 Kodi Zgjedhor, Neni 84 pika 5.

518 Tarifat e medias. Mediat që depozituan në KQZ tarifat për reklama gjatë fushatës zgjedhore ishin: Top Channel, Top News, A2 CNN, News 24, TV Klan, Tv Klan plus, ABC News, Ora News, Ora TV, Vizion Plus, Fax News, Euronews, Report TV, Media Mapo, MCN TV, Balkanweb.com, Channel One.

519 Kodi Zgjedhor, Neni 84 pika 6 "... Ngarkohen KQZ-ja, Enti rregullator për mediat audiovizive dhe Ministria e Financave të nxjerrin udhëzimet përkatëse."

520 Nga të cilat 76.503.757 lekë janë deklaruar nga partitë dhe 1.846.815 lekë nga kandidatët.

521 Nga të cilat 14 parti politike dhe 1 kandidat i pavarur.

522 Duke qenë se disa media nuk kanë të publikuara tarifat që kanë aplikuar, si dhe, çmimet e reklamës variojnë sipas orarit dhe mënyrës së transmetimit, KRIIK ka përllogaritur një mesatare të përafërt të kostos për çdo sekondë reklamë në secilën nga mediat që kanë publikuar tarifat zyrtare.

523 Për më shumë shih Shtojcën T "Të dhëna mbi deklarimin dhe shpenzimet e subjekteve zgjedhore në media".

524 Partisë Socialdemokrate, Partisë Socialiste, Partisë Demokratike, Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, Partisë Bindja Demokratike, Partisë Nisma Thurje dhe Partisë Lëvizja për Ndryshim.

525 Partia Demokratike dhe Partia Lëvizja për Ndryshim.

526 Pjesë nga përgjigjet që i janë kthyer KQZ-së nga:
- Partia Socialiste: "... PS ka raportuar të gjitha shpenzimet e shërbimit mediatik në raportin financiar të depozituar pranë KQZ. Çdo shpenzimi i është bashkëlidhur kontrata midis nesh dhe kompanisë mediatike ...".
- PSD: "...Çdo shpenzim i bërë pranë mediave vizive, por që nuk bashkëshoqërohet me shkresë me siglen e PSD dhe firmën e drejtuesve të saj, ne e konsiderojmë të pa rregullt dhe nuk mbajmë përgjegjësi. ..."
- Bindja Demokratike: "... Sikurse kemi raportuar BD ka patur kontratë për transmetim spotesh publicitare vetëm me 3 televizione. Këto TV kanë transmetuar spotet elektorale të BD kundrejt shumave të përcaktuara në kontratë. Televizionet janë shoqëri tregtare dhe si të tilla kanë diskrecionin të lidhin kontrata të ndryshme me çmime të ndryshme. Çmimi i vetëm që duhet të merret në konsideratë nga KQZ është vetëm çmimi i kontratës. ..."
- Nisma Thurje: "... Nëse këto shpenzime do të ishin kryer ato do të ishin subjekt i deklarimit me faturë tatimore në organet tatimore. Ju ftojmë të verifikoni pohimet tona me raportimet financiare të bëra nga mediat audiovizive

situatën edhe më absurde duke e deleguar përgjegjësinë tek media, e cila formalisht është shoqëri tregtare që mund të japë shërbime vetëm bazuar në kontratat e lidhura paraprakisht, si dhe duke i shoqëruar ato me faturën përkatëse.

Nga përgjigjet e kthyera ka raste kur nga subjekti zgjedhor pretendohet se media mund të ketë transmetuar reklamë pa dijeninë e tij, çka sipas tyre nuk ngarkon fare me përgjegjësi deklarimi subjektin zgjedhor. Pretendim ky që nuk qëndron, pasi edhe nëse do të ishte i vërtetë rasti, evidentohen së paku tre shkelje të ligjit, mos deklarimi si dhurim, tejkalimi i limitit të përcaktuar për reklamë politike, si dhe ndalim i dhurimit nga aksionerë, pronarë dhe shoqëri mediatike.

Në vazhdim të kësaj situate, sipas informacionit zyrtar të marrë prej KQZ-së, vetëm subjekti LSI i është drejtuar me e-mail zyrtar[527] disa mediave duke iu kërkuar nëse ka patur kontratë midis tij dhe mediave në fjalë.

Një kërkesë e tillë, ku kërkohet kopje e një kontrate ku një nga palët është vetë subjekti nën pretendimin e mosqënies në dijeni është joserioze dhe ngre hije dyshimi mbi informacionin që kërkon të përcillet nëpërmjet këtij komunikimi.

Nga ana e mediave, të cilat konfirmojnë mosekzistencën e një kontrate, deklarohet[528] në një rast se është kërkuar nga AMA që mediat të ishin korrekte në minutazh për fushatën zgjedhore ndaj të gjitha partive, dhe për këtë arsye televizioni ka transmetuar spote pa marrëdhënie kontraktuale gjatë asaj periudhe.

Ky deklarim, përveçse evidenton mosnjohje të ligjit, përbën edhe një shkelje ligjore.

Ligji përcakton[529] detyrimin për minutazh të balancuar dhe me kohëzgjatje sipas parashikimeve të Kodit Zgjedhor në transmetimin e edicionit të lajmeve mbi subjektet zgjedhore dhe jo për reklamën politike, e cila ka një rregullim krejt tjetër.

Për më tepër, sipas ligjit[530], çdo subjekt që ushtron veprimtari në fushën e medias, dhe asnjë aksioner i tij, nuk mund të bëjë dhurime për ndonjë subjekt zgjedhor.

Përpos situatës së mësipërme, vërehet se ka parti të cilat kanë deklaruar shpenzime dhe pagesa të kryera ndaj disa televizioneve, ndërkohë që nga monitorimi i këtyre të fundit prej AMA-s, rezulton se nga këto media nuk kanë transmetuar asnjë reklamë politike për subjektet në fjalë[531]. Ky fakt ngre dyshime për llojin e shërbimit të marrë nga partitë politike nga këto media për të cilat është kryer pagesa, çka sjell në vëmendje një aspekt tjetër, potencialisht shumë problematik, *i cili duhet të investigohet prej KQZ-së dhe që duhet të rregullohet qartazi dhe specifikisht në kuadrin ligjor.*

VIII.2.2.4. Shpenzimet për reklama politike në Facebook

Falë mekanizmit të transparencës të ndërtuar nga rrjeti social *Facebook*, shpenzimet për reklamat politike në rrjetet sociale *Facebook* dhe *Instagram* janë transparente dhe të lexueshme nga gjithësecili[532].

---

në organet tatimore. ...”
- LSI: “... Ju lutem na vini në dispozicion dokumentacionin mbështetës lidhur me konstatimet për mospërputhje.”

527 E-mail zyrtar drejtuar Report TV dhe Fax News: “... KQZ ka dërguar pranë subjektit LSI kërkesën për kopje të kontratës me institucionin tuaj. Ndërkohë që ne nuk disponojmë asnjë kontratë të tillë në protokollin tonë, për shkak se kjo marrëdhënie nuk ka ekzistuar, lutemi na konfirmoni nëse ekziston apo ka ekzistuar një marrëdhënie kontraktuale ndërmjet nesh. ...”

528 Fax Media News: “Nuk ekziston një marrëdhënie kontraktuale midis nesh. Gjatë periudhës zgjedhore të 25 prillit u kërkua nga AMA që mediat të ishin korrekte në minutazh për fushatën zgjedhore të të gjitha partive dhe të ishin sa më “fair”. Për këtë arsye televizioni ka trasmetuar edhe spotet pa marrëdhënie kontraktuale gjatë kësaj periudhe.”

529 Kodi Zgjedhor, Neni 84.

530 Kodi Zgjedhor, Neni 92/1 pika 3 “Ndalohet dhënia e fondeve nga një person juridik apo çdo aksionar i tij nëse ndodhet në një nga kushtet e mëposhtme: b) ushtron veprimtari në fushën e medias”

531 - *PDIU* raporton të ketë paguar për TV Gold faturën me vlerë 60.000 lekë, për TV Abc News faturën me vlerë 300.000 lekë dhe për TV News 24 faturën me vlerë 369.420 lekë. Ndërkohë nga monitorimi i AMA-s, rezulton se ky subjekt nuk ka realizuar asnjë minutë reklamë politike në këto media.
- *Partia Republikane* raporton të ketë paguar për TV Klan faturën me vlerë 1.495.000 lekë dhe për TV Top Channel faturën me vlerë 1.060.000 lekë, ndërkohë që nga monitorimi i AMA-s rezulton se ky subjekt nuk ka realizuar asnjë sekondë reklamë politike në këto media.
- *Partia Lëvizja për Ndryshim* raporton të ketë paguar për TV Klan faturën me vlerë 515.425 lekë, ndërkohë që nga monitorimi i AMA-s rezulton se ky subjekt nuk ka realizuar asnjë sekondë reklamë politike në këtë media.

532 Shih librarinë e reklamave politike të Facebook për Shqipërinë.

VIII.2.2.4.1. Reklamat nga partitë politike dhe kandidatët e pavarur

Gjatë periudhës kalendarike që përkon me fushatën zgjedhore, në total janë shpenzuar rreth 33.2 milionë lekë për reklama politike në *Facebook dhe Instagram*[533].

Ndërkohë në total nga subjektet zgjedhore janë deklaruar rreth 28.4 milionë lekë shpenzime për reklama politike në mediat sociale.

Shuma e padeklaruar gjykohet të jetë më e madhe se diferenca e shumave të mësipërme (prej 4.8 milionë lekësh), duke qenë se deklarimi prej subjekteve zgjedhore përfshin "mediat sociale", pra jo vetëm *Facebook dhe Instagram*. Ndërkohë theksohet se në shumën e llogaritur si të shpenzuar janë llogaritur vetëm *Facebook dhe Instagram*[534].

Nga shpenzimet e kryera 12.6 milionë lekë janë paguar nga kandidatët, 16.8 milionë lekë janë paguar nga partitë politike [535]dhe 3.8 milionë lekë janë shpenzime të kryera nga palë të treta për llogari të Partisë Socialiste.

Nga këto, 56.2% (rreth 18.6 milionë lekë) janë shpenzuar për reklama për llogari të Partisë Socialiste, 27.2% (rreth 9 milionë lekë) për llogari të Partisë Demokratike dhe 5.6% (rreth 1.8 milionë lekë) për llogari të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim. Të gjitha subjektet e tjera zgjedhore kanë shpenzuar shuma me vlerë shumë herë më të vogël[536].

Reklamat janë gjeneruar nga faqet zyrtare të kandidatëve, faqet zyrtare të partisë, faqet e degëve të partisë në rrethe si dhe nga palë të treta.

Ajo çka përbën një shqetësim madhor është gjenerimi i reklamave nga palë të treta, sikurse janë disa faqe në *Facebook*, të cilat nuk janë të afiluara në mënyrë të drejtpërdrejtë me ndonjë nga partitë politike, ndërkohë që as nuk figurojnë si të raportuara në vetëraportimin financiar të asnjë prej subjekteve zgjedhore.

Fushata hije vazhdon të jetë një fenomen shumë shqetësues dhe një nga mënyrat për të fshehur shpenzimet e fushatës zgjedhore. Të dhënat e gjeneruara nga Facebook janë një ilustrim i këtij fenomeni për të cilin KRIIK ka ngritur në vazhdimësi shqetësimin e tij.

Në këto zgjedhje u evidentuan gjashtë faqe në Facebook, të cilat kanë gjeneruar reklama me pagesë, pavarësisht se nuk janë të afiluara drejtpërdrejt me asnjë forcë politike.

Nga këto faqe, pesë prej tyre kanë gjeneruar reklama për Partinë Socialiste[537] dhe një faqe për Bindjen Demokratike[538].

Pesë faqet që kanë gjeneruar reklama për Partinë Socialiste, me përjashtim të njërës, janë krijuar rishtas gjatë periudhës zgjedhore. Të gjitha këto faqe e ndaluan totalisht aktivitetin e tyre vetëm pak ditë përpara apo menjëherë pas ditës së zgjedhjeve. Theksohet se numri i telefonit dhe vendndodhja e administratorëve të këtyre faqeve janë të njëjtë për pothuajse të gjitha faqet, ndërkohë që edhe numri i kontaktit dhe adresa e llogarisë nga e cila është kryer pagesa për reklamat janë sërish të njëjtë për të gjitha këto faqe.

Gjithë sa më sipër janë indikacione të qarta se këto faqe kanë qenë të koordinuara dhe janë

533 Në përllogaritjen e bërë reklamuesit, të cilët kanë shpenzuar më pak se 100 dollarë amerikanë për reklama përgjatë periudhës së përmendur, janë përllogaritur me një vlerë shpenzimi minimal prej 10 USD. Kjo pasi shpenzimet e bëra nën vlerën 100 USD nuk përcaktohen me saktësi, por me rang, duke e bërë të pamundur evidentimin e vlerës së saktë të shpenzuar.

534 Për më shumë shih Shtojcën R – Tabela R4 "Kandidatë që kanë deklaruar shpenzime për media sociale, por sipas librarisë së reklamave në Facebook dhe Instagram nuk kanë kryer shpenzime".

535 Për më shumë shih Shtojcat O, P dhe R6.

536 Të gjithë subjektet e tjerë kanë shpenzuar 10% të shumës totale të shpenzuar për Facebook dhe Instagram nga tërë subjektet zgjedhorë.

537 - Untold Stories of Albania, faqe e krijuar në janar të vitit 2019 që nuk ka pasur karakter politik nga janari deri në maj të vitit 2019. Ka shpenzuar rreth 16.005 USD. Prej majit 2019 faqja ka qenë joaktive dhe është riaktivizuar në mes të dhjetorit 2020 duke nisur të postojë reklama denigruese ndaj opozitës. Kjo faqe nuk ka postuar më pas datës 23 prill 2021 dhe është fshirë rreth shtatorit të vitit 2021.
- Punë Punë, faqe e krijuar në shtator të vitit 2020. Ka shpenzuar rreth 6.555 USD. Kjo faqe nuk ka postuar më pas datës 20 prill 2021.
- Ligj dhe Rend, faqe e krijuar në nëntor të vitit 2020. Ka shpenzuar rreth 4.132 USD. Kjo faqe nuk ka postuar më pas datës 21 prill 2021.
- Te jesh grua, faqe e krijuar në nëntor 2020. Ka shpenzuar rreth 5.352 USD. Kjo faqe nuk ka postuar më pas datës 20 prill 2021.
- Pakëz drite, faqe e krijuar në shtator të vitit 2020. Ka shpenzuar rreth 4.768 USD. Kjo faqe nuk ka postuar më pas datës 29 prill 2021.

538 Egnatia News, faqe e krijuar në nëntor të vitit 2020. Kjo faqe është një faqe e një medie *online* (egnatianews.com), portal, i cili është krijuar në nëntor të vitit 2020.

përdorur me qëllim të qartë elektoral.
Shuma e shpenzuar nga të pesë këto faqe rezulton shumë e lartë, 36.810 USD (rreth 3.8 milionë lekë), çka përbën 38% të shumës së shpenzuar nga llogaritë zyrtare në Facebook të Partisë Socialiste për reklama në këtë rrjet social.

VIII.2.2.4.2. Reklamat e kandidatëve të subjekteve zgjedhore

Të ardhurat dhe shpenzimet e kandidatëve përfshihen si vlerë totale në raportin e partisë politike nën siglën e së cilës ata kandidojnë, por detajimi në zëra i vlerës totale të shpenzuar bëhet në raportin personal të çdo kandidati.
Sikurse është përmendur edhe më sipër, numri i kandidatëve të cilët nuk kanë dorëzuar raport vetëdeklarimi në KQZ është mjaft i lartë, pra 1.166 kandidatë nga 1.820 në total.
Situata bëhet edhe më problematike, kur konstatohet se disa nga këta kandidatë kanë kryer në fakt shpenzime për reklama në *Facebook/Instagram*. Kjo provohet falë mundësisë së ofruar nga facebook, ku shpenzimet e kryera mund të kontrollohen nga aktorë të tretë të jashtëm. Ky fakt vlen edhe për rastet kur shpenzimi nuk është paguar nga vetë kandidati, por nga një donator i tij. Në një rast të tillë pagesa në funksion të faqes së kandidatit, ashtu sikurse edhe për zyrën zgjedhore të tij të paguar nga palë të treta, duhet të ishte deklaruar prej kandidatit si dhurim në natyrë.
Nga totali prej 1.820 kandidatësh, bazuar në librarinë e reklamave të *Facebook*[539] rezultojnë se 167 prej tyre kanë kryer pagesa në funksion të reklamimit në *Facebook* apo *Instagram*[540], por vetëm 81 prej tyre kanë deklaruar shpenzime për media sociale në raportet e vetëdeklarimit të dorëzuara në KQZ[541].
Pjesa tjetër e kandidatëve ose nuk ka dorëzuar raport vetëdeklarimi, ose ka dorëzuar një raport me 0 të ardhura dhe shpenzime apo në pasqyrën përkatëse financiare nuk ka deklaruar shpenzime për mediat sociale.
Shuma totale e shpenzuar për kandidatët për qëllime të fushatës elektorale rezulton të jetë rreth 17.4 milionë lekë, nga të cilat rreth 4.8 milionë lekë janë paguar nga partitë politike për faqet e kandidatëve përkatës dhe 12.6 milionë lekë janë paguar nga vetë kandidatët ose persona të tjerë.
Ndërkohë shuma totale e deklaruar prej kandidatëve nga raportet e vetëdeklarimit është 8.216.760 lekë, shumë kjo e cila përfshinë edhe ato reklamime të paguara nga partitë politike përkatëse. Për rrjedhojë, rezulton se rreth 4.5 milionë lekë nuk janë deklaruar prej kandidatëve.
Nga shqyrtimi dhe përpunimi i të dhënave të mbledhura rezulton se 63 kandidatë kanë kryer pagesa për reklama politike në faqet e tyre përkatëse[542] në *Facebook* dhe *Instagram,* por nuk kanë dorëzuar fare raport vetëdeklarimi, sikurse detyrimi ligjor parashikon.
Nga këta kandidatë, 42 prej tyre i kanë kryer personalisht pagesat përkatëse, të cilat arrijnë një shumë prej afro 4.4 milionë lekë.
69 kandidatë të tjerë, nga ata që kanë dorëzuar raport vetdeklarimi, deklarojnë zero të ardhura dhe shpenzime në total në raportet e tyre, apo zero shpenzime për media sociale, ndërkohë që figuron se ata kanë kryer shpenzime për reklama politike në faqet përkatëse të tyre në *Facebook* dhe *Instagram*[543], në një shumë prej afro 3.6 milionë lekë.
Kandidati me vlerën më të madhe të shpenzuar për fushatë elektorale është Agron Shehaj me rreth 16.5 milionë lekë të shpenzuara për *Facebook* dhe *Instagram*.
Pas tij, kandidati për faqen e të cilit është paguar më shumë, është Lulzim Basha me vlerën 1.970.000 lekë, por pagesat për këtë janë kryer nga Partia Demokratike. Gjithë pjesa tjetër e kandidatëve kanë kryer shpenzime me vlerë më të vogël se 700.000 lekë.

539 Shih Librarinë e Reklamave të Facebook

540 Në total figurojnë 194 kandidatë, për faqet e të cilëve janë kryer pagesa për reklama politike, por për 27 prej tyre pagesa është kryer tërësisht apo pjesërisht nga partia politike e cila i ka kandiduar.

541 Për më shumë shih Shtojcën R – Tabela R1 "Kandidatë të cilët kanë deklaruar shpenzime për media sociale dhe shuma e shpenzuar sipas librarisë së reklamave në Facebook dhe Instagram".

542 Për më shumë shih Shtojcën R – Tabela R3 "Kandidatë që nuk kanë dorëzuar raport, por sipas librarisë së reklamave të facebook dhe Instagram kanë shpenzime në këto platforma".

543 Për më shumë shih Shtojcën R – Tabela R2 "Kandidatë që kanë deklaruar 0 të ardhura dhe shpenzime, por sipas librarisë së reklamave në Facebook dhe Instagram janë kryer pagesa për faqet e tyre, nga vetë kandidati/ja apo nga persona të tretë".

Konstatohet si mjaft problematike mungesa e një informimi të plotë mbi kuadrin ligjor të raportimit financiar nga kandidatët.
Përpos rasteve të mosdeklarimit të shpenzimeve të kryera, evidentohen edhe raste kur shpenzimet janë paguar nga partia politike, ndërkohë që kandidatët i deklarojnë ato si shpenzim të tyre, çka është në kundërshtim me udhëzimet e miratuara prej KQZ-së.
Në vazhdën e analizës dhe përpunimit të të dhënave edhe me qasje në raportet vjetore, janë parë shpenzimet e bëra në facebook edhe pas datës së zgjedhjeve e deri përfundim të vitit financiar. Rezulton se 24 kandidatë për deputetë kanë kryer shpenzime edhe pas përfundimit të fushatës zgjedhore, ndërkohë që midis tyre figurojnë nga ata që nuk kanë dorëzuar fare raport apo e kanë deklaruar atë me zero[544].

VIII.3. TRANSPARENCA

VIII.3.1. VETËDEKLARIMI I SUBJEKTEVE ZGJEDHORE

Kuadri ligjor nuk i detyron subjektet zgjedhore që të bëjnë publike të ardhurat dhe shpenzimet përpara ditës së zgjedhjeve dhe, nga ana tjetër, asnjë prej subjekteve zgjedhore nuk ofroi një transparencë të tillë vullnetarisht[545], megjithëse nuk munguan thirrjet publike lidhur me këtë.
Ligji parashikon se subjektet zgjedhore duhet t'a dorëzojnë raportin e vetëdeklarimit financiar në KQZ brenda 60 ditëve nga shpallja e rezultatit të zgjedhjeve.
Bazuar në analizën e kryer mbi raportet e vetëdeklarimit, evidentohen një numër problematikash në procesin e transparencës së bërë nga vetë subjektet zgjedhore në lidhje me të ardhurat dhe shpenzimet.
Pavarësisht miratimit dhe vendosjes në dispozicion të subjekteve zgjedhore të formateve të gatshme e të thjeshta të raportimit, apo edhe trajnimeve të zhvilluara me partitë politike në vazhdimësi nga KQZ-ja apo të tjerë aktorë, situata e raportimit financiar edhe në zgjedhjet e 25 prillit 2021 mbeti në nivele bazike dhe formale, duke mos garantuar transparencë të plotë të fondeve të përftuara dhe shpenzuara gjatë fushatës.
Përpos nivelit të ulët të përgjegjshmërisë së vetë subjekteve zgjedhore, edhe *formatet e miratuara mbartin problematika të cilat nevojitet të reflektohen e të përmirësohen.*

Kështu, në formatin e raportit të vetëdeklarimit, subjekti zgjedhor nuk përfshin në tabelën përmbledhëse të të ardhurave dhe shpenzimeve, shpenzimet e kryera nga kandidatët, por i paraqet vetëm si përmbledhje vlerash totale të agreguara me bazë qarku.
Gjithashtu, shpjegimi i nevojshëm i kërkuar sipas udhëzimeve në çdo pjesë të raportit, qoftë për detajimin dhe të kuptuarin mirë të të ardhurave, qoftë të shpenzimeve, nuk plotësohet siç duhet nga subjektet. Po ashtu, konstatohet se pjesa më e madhe e raporteve të kandidatëve mungojnë.
Gjithë sa më sipër, e bën shumë të vështirë transparencën, të kuptuarin dhe për rrjedhim edhe kontrollin apo auditimin, edhe në kushtet kur hipotetikisht çdo lëvizje financiare do të ishte deklaruar në mënyrë të plotë prej subjekteve.
Përpos përfshirjes të cunguar të kandidatëve në raportet e vetdeklarimit të subjekteve zgjedhorë, një problem tjetër madhor mbetet plotësimi sipërfaqësor i tyre prej vetë subjekteve.

Pjesët sqaruese të shpenzimeve dhe dhurimeve, qofshin këto në para apo në natyrë, thuajse nuk plotësohen, duke lënë mundësi për interpretime të ndryshme apo aludime.
Kjo vështirëson të kuptuarin e situatës dhe analizën e të dhënave të raportuara.
Në vetëdeklarimet e subjekteve zgjedhorë për zgjedhjet e 25 prillit 2021, nuk kuptohet se kush ka paguar për zyra të ndryshme zgjedhore, në të cilat kanë qenë të vendosura foto të kandidatëve specifikë, partia apo kandidati.

Gjithashtu, nëse partia deklaron shpenzime për media sociale të kryera nga vetë ajo, mbetet e paqartë nëse tek shuma e deklaruar ka të përfshirë edhe pagesat e kryera, nga vetë partia politike, për faqet e kandidatëve.
Ky element, mbetet i paqartë pas vëzhgimit të raporteve të vetëdeklarimit të kandidatëve, ku

544 Për më shumë shih Shtojcën R – Tabela R5 "Kandidatë të cilët kanë kryer shpenzime në Facebook dhe Instagram edhe pas ditës së zgjedhjeve".

545 KRIIK iu bëri thirrje subjekteve zgjedhore që, në frymën e transparencës të bënin publike të ardhurat dhe shpenzimet e tyre përpara ditës së zgjedhjeve në mënyrë vullnetare, në një Konferencë për Shtyp të datës 11 mars 2021.

pavarësisht se sipas *Facebook* një reklamim është paguar nga partia për kandidatin, ky i fundit në disa raste e deklaron si shpenzim të vetin dhe në raste të tjera nuk e deklaron.
Gjithë kjo situatë lë mundësi për abuzime dhe vështirëson verifikimin, sidomos duke patur si autoritet kontrollues një institucion, i cili në praktikën e tij të derisotme ka treguar pasivitet përsa i përket kontrollit të financave të partive politike.
Kodi Zgjedhor parashikon se subjektet zgjedhore e dorëzojnë raportin e vetëdeklarimit financiar në KQZ brenda 60 ditëve[546] nga shpallja e rezultatit të zgjedhjeve. Rregullat, afatet dhe formatet e raportimit u miratuan me vendim të Komisionit Rregullator. Risi për vetëraportimin financiar në këto zgjedhje ishte detyrimi për të raportuar edhe i kandidatëve të pavarur[547].
Në deklarimet e çdo subjekti zgjedhor, duhet të përfshihet çdo e dhënë financiare, e ardhur dhe shpenzim, të kryera jo vetëm gjatë fushatës zgjedhore, por deri në gjashtë muaj përpara fushatës zgjedhore, si dhe, çdo shpenzim tjetër i kryer në funksion të fushatës zgjedhore[548], pavarësisht kohës së kryer të tij.
Përpos raportit të vetëdeklarimit, formati i të cilit është i miratuar nga KQZ, partitë politike duhet të depozitojnë në KQZ edhe bilancin e aseteve dhe detyrimeve të tyre për periudhën nga dekretimi i datës së zgjedhjeve deri në datën e zgjedhjeve[549], pra nga data 6 shtator 2020 deri në datën 25 prill 2021.
Në zgjedhjet e datës 25 prill 2021 morën pjesë 27 parti politike dhe 5 kandidatë të pavarur, të cilët mbartin edhe detyrimin për të dorëzuar raport vetëdeklarimi financiar në KQZ, sipas përcaktimeve përkatëse ligjore.
Për shkak të situatës së krijuar nga pandemia Covid 19, KQZ shtyu afatin e dorëzimit të këtyre raporteve me 10 ditë, duke vendosur datën 23 shtator 2021 si afatin përfundimtar.
Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar dhe Partia Nisma Thurje nuk e kanë dorëzuar raportin në afatet e përcaktuara ligjore. Sa i përket LZHK-së raporti është dorëzuar në datën 11 tetor 2021, ndërkohë që raporti i Partisë Nisma Thurje është publikuar në faqen e KQZ-së **në fund të muajit nëntor, por mban datë 12 shtator**[550].
Mungesa e raportit, edhe për shkak të pasivitetit të Partisë NTH nga njëra anë dhe administratës së KQZ nga ana tjetër, ka sjellë referimin zyrtarisht nga KQZ-ja se Partia NTH nuk kishte dorëzuar raport vetëdeklarimi. Edhe në situatën e dorëzimit të tij më vonë, sërish jemi në kushtet e dorëzimit jashtë afatit ligjor, për të cilën parashikohen shprehimisht sanksione administrative[551].
Administrata e KQZ-së kryen kontrollin paraprak (*prima facie*) të raportit financiar për fushatën zgjedhore dhe sipas rastit njofton subjektet për korrigjimin e parregullsive të vërejtura.

Në përmbushje të këtij detyrimi vërehet se publikimi në faqen zyrtare të KQZ-së[552] ka qenë në afatet e përcaktuara kohore.
Formatet e raporteve financiare të subjekteve zgjedhore, të miratuara nga Komisioni Rregullator me vendimin e sipërpërmendur, vërehet se kanë ndryshime minimaliste krahasuar me formatet e miratuara nga KQZ-ja **në vitin 2017**.

Në këto kushte, duke patur në konsideratë edhe trajnimet e herëpashershme të zhvilluara nga KQZ lidhur me raportimet financiare, ndërgjegjësimi i subjekteve zgjedhore mbi mekanizmin dhe informimi i detajuar i tyre mbi përpilimin e raportit sipas formës dhe përmbajtjes së kërkuar ligjore, nuk duhet të shfaqte problematika.
Objekti i kontrollit paraprak të raportit financiar për fushatën zgjedhore është vetëm verifikimi i elementeve të formës juridike nëse janë sipas modelit të miratuar nga KQZ-ja.

546 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 92/3 pika 1.

547 Vendimi nr. 13, datë 06.04.2021, Komisioni Rregullator "Për përcaktimin e rregullave për raportimin financiar të subjekteve zgjedhore, kontrollin dhe verifikimin e financimeve dhe shpenzimeve të tyre gjatë fushatës zgjedhore", Neni 3 pika 1.

548 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 92/3 pika 2.

549 Po aty.

550 Sipas komunikimit me KQZ, pas dorëzimit të parë NTH i është kthyer raporti për plotësim, dhe partia nuk ka ridorëzuar raport të plotësuar. Ndërkohë që pas auditimit është konstatuar që partia e ka dërguar raportin nëpërmjet e-mail, i cili nuk është marrë nga administrata e KQZ.

551 Vendimi nr. 18 datë 14.04.2021 "...Mosparaqitja e një raporti financiar për fushatën brenda afatit ligjor dënohet me një gjobë prej 2 000 000 lekësh."

552 Vendimi nr. 13, datë 06.04.2021, Komisioni Rregullator, Neni 4 pika 4.

Vërehet se 4 parti politike[553] kanë dorëzuar raporte që nuk janë në formatin e miratuar nga KQZ, shkelje për të cilin kuadri ligjor[554] parashikon sanksion administrativ.

Gjithashtu, pavarësisht se formati i publikuar i raporteve në faqen e KQZ[555] është në pdf, subjekteve zgjedhore iu është dhënë dhe kanë patur detyrimin ligjor për t'a dorëzuar të plotësuar raportin në formatin excel, përpos se në formë shkresore me firmë e vulë.

Konstatohet se Raportet janë dorëzuar vetëm në formatin *pdf* dhe shpesh foto, duke shfaqur refuzim të përmbushjes së detyrimit ligjor. Nga ana tjetër, kjo mënyrë raportimi në format të pa-edituesshëm vështirëson tej mase leximin, kuptimin dhe përpunimin e të dhënave të deklaruara, duke penguar zhvillimin në mënyrë normale e të thjeshtuar të procesit të verifikimit dhe kontrollit. Pavarësisht kësaj KQZ i ka pranuar dhe publikuar këto raporte në faqen e internetit të saj.

KRIIK gjykon se në funksion të rritjes së transparencës, përgjegjshmërisë së subjekteve zgjedhore, si dhe hapjes së të dhënave që përfshihen në raportet financiare, këto raporte duhet të publikohen në formate lehtësisht të lexueshme dhe përpunueshme.

Gjithashtu formatet duhet të programohen në mënyrë të tillë që çdo fushë apo qelizë detajuese të jetë e detyrueshme për t'u plotësuar, duke nxitur paraprakisht përgjegjshmërinë e partive politike ndaj detyrimit ligjor për të detajuar në mënyrë korrekte të ardhurat dhe shpenzimet e kryera prej tyre.

Nga totali prej 32 subjekte zgjedhore që kanë dorëzuar një raport financiar, vërehet se 11[556] prej tyre kanë dorëzuar një raport financiar ose dokument të thjeshtë ku deklarohen zero të ardhura dhe shpenzime.

Ndërkohë që ligji parashikon se në raportet financiare duhet të përfshihet çdo e ardhur, qoftë kjo edhe në natyrë[557], si dhe çdo shpenzim i realizuar, direkt apo indirekt, prej partive apo kandidatëve, përfshirë shpenzimet personale kur janë në funksion të fushatës zgjedhore, deklarimi prej subjekteve zgjedhore garuese se kanë zero aktivitet financiar, ngre pikëpyetje serioze mbi vërtetësinë e këtyre deklarimeve apo edhe të qëllimit dhe futjes në garë zgjedhore.

Një parti politike së bashku me kandidatët e saj që futet në garën zgjedhore dhe nuk kryen asnjë asnjë aktivitet elektoral, vë në pikëpyetje mënyrën se si ajo dhe kandidadët për deputet të saj e kanë prezantuar ofertën elektorale dhe kanë marrë angazhime politike përballë qytetarëve prej të cilëve priten që të votohen. Një situatë e tillë, në thelb, cënon qëllimin e ekzistencës së një partie politike dhe të marrjes pjesë së saj në një garë elektorale.

VIII.3.1.1. Bilancet e aseteve dhe detyrimeve

Kodi zgjedhor[558], parashikon detyrimin ndaj subjekteve zgjedhore, që përpos dorëzimit të raportit të vetëdeklarimit financiar sipas formatit të miratuar nga KQZ, të depozitojë edhe bilancin e aseteve dhe detyrimeve të tyre për periudhën nga dekretimi i datës së zgjedhjeve deri në datën e zgjedhjeve, pra për periudhën 06.09.2020 – 25.04.2021.

Ky parashikim i Kodit Zgjedhor bën të mundur qartësimin e situatës financiare të partisë politike më datë 6 shtator 2020, pra asetet, gjendjen financiare faktike si dhe detyrimet, në nisje të periudhës kur partia do të raportojë në KQZ nëpërmjet raportit të vetëdeklarimit, si dhe situatën financiare të partisë politike më datë 25 prill 2021, pra sërish asetet, gjendjen financiare faktike si dhe detyrimet, në fund të periudhës për të cilën raportohet.

Përmbushja e këtyre detyrimeve ligjore të parashikuara, si dhe një raportim i saktë e konform standardeve të kontabilitetit, bën të mundur të sigurohet një panoramë më e qartë mbi aktivitetin financiar të subjektit zgjedhor, duke siguruar transparencë më të plotë dhe bërë

553 Partia Kombëtare Konservatore Albania, Partia Balli Kombëtar, Partia Balli Kombëtar Demokrat dhe Partia Bashkimi Popullor i Pensionistëve Shqiptarë.

554 Vendimi nr. 18 datë 14.04.2021 " ... Paraqitja e raporteve në shkelje të rregullave dhe formateve të standardizuara të miratuara nga KQZ-ja dënohet me gjobë nga 500 000 deri 1 000 000 lekë."

555 Raportet e subjekteve zgjedhore për fushatën zgjedhore 2021.

556 Kanë deklaruar zero të ardhura dhe shpenzime: Partia Kombëtare Konservatore Albania, Partia Balli Kombëtar, Partia Balli Kombëtar Demokrat, Partia Bashkimi Popullor i Pensionistëve Shqiptarë, Partia Ora e Shqipërisë, Partia Bashkimi Liberal Demokrat, Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar, Partia Emigracioni Shqiptar, Partia Kristian Demokrate, Partia Lëvizja e Legalitetit, Partia Lëvizja Demokratike Shqiptare.

557 Kur subjektet marrin një shërbim apo të mirë materiale si dhuratë në funksion të fushatës së tyre elektorale pa e paguar atë.

558 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 92/3 pika 2.

funksional mekanizmin e kontrollit nëpërmjet verifikimit të KQZ-së dhe auditëve ligjorë.
Nga komunikimi zyrtar i KRIIK me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, konfirmohet se janë vetëm 10 parti politike[559], nga 27 pjesëmarrëse në zgjedhje, që kanë dorëzuar këtë bilanc, përsa ai mund të quhet i tillë, në KQZ dhe ato pas afatit ligjor të parashikuar.
Dokumentet e dorëzuara për përmbushjen e detyrimit të mësipërm ligjor, janë dorëzuar në KQZ në muajin nëntor 2021. Pavarësisht se në ligj nuk përcaktohen afate eksplicite lidhur me këtë detyrim, bilanci i aseteve dhe detyrimeve në kuptim të funksionit që duhet të kryejë përmbajtja e tij duhet të ishte dorëzuar në KQZ së bashku me raportin e vetëdeklarimit të fushatës zgjedhore.
Gjithashtu, raporti në fjalë do të duhej të ishte pjesë e punës së auditëve ligjorë, për të patur një panoramë të plotë të gjendjes dhe pasqyrave financiare të subjekteve zgjedhore, në fillim dhe në fund të periudhës së raportimit, çka në fakt nuk u bë dot e mundur, pasi ato u dorëzuan me vonesë prej partive politike.
Nga ana tjetër, përmbajtja e të ashtuquajturave bilance të aseteve dhe detyrimeve, të dorëzuara prej partive politike nuk përmbushin kriteret e nevojshme ligjore që duhet të ketë një bilanc i tillë. Ato janë më së shumti shkresa që diku referojnë disa asete apo pajisje që ka partia, diku çfarë asetesh janë shtuar gjatë 6 muajve, e diku është një deklaratë ku sqarohet se partia i ka përmbushur detyrimet e dorëzimit të raportit të vetëdeklarimit në KQZ.
Referuar gjithë sa më sipër, ky detyrim i partive politike rezultoi të mbetej jo vetëm i paplotësuar prej tyre, por, çka është më shqetësuese nga leximi i dokumentave të dorëzuara, krijoi një praktikë anashkalimi dhe ridikulizimi ndaj normës detyruese të Kodit Zgjedhor.
Tërë kjo sjellje, në gjykimin e KRIIK, është një qasje totalisht joserioze dhe e papërgjegjshme e tyre në raport me këtë sfidë madhore, veçanërisht prej partive kryesore të cilat ishin promotore, mbështetëse dhe aprovuese të ndryshimeve ligjore të fundit në përgjigje të kërkesave dhe presionit ndërkombëtarë dhe vendas për të siguruar transparencë dhe kontroll ndaj financave të fushatave zgjedhore dhe partive politike.

VIII.3.1.2. Problematika që lidhen me përmbajtjen e raporteve të vetëdeklarimit

VIII.3.1.2.1. Financieri i partisë ka qenë njëkohësisht edhe kandidat për deputet

Vendimi i Komisionit Rregullator[560] **përcakton se financieri i partisë nuk duhet të jetë kandidat për t'u zgjedhur.**
Pavarësisht këtij detyrimi vërehet se financieri i disa subjekteve zgjedhore ka qenë njëkohësisht edhe kandidat[561] i atij subjekti zgjedhor.
Pavarësisht se vendimi i sipërpërmendur i detyron partitë të kryejnë zëvendësimin e financierit në rast përfshirje të saj/tij në listën shumëemërore të kandidatëve, duke e cilësuar këtë angazhim si të papajtueshëm me detyrën e financierit, asnjë prej këtyre partive politike nuk kreu zëvendësimin e tyre, madje raportet e vetëdeklarimit të depozituara në KQZ janë firmosur sërish prej tyre.

VIII.3.1.2.2. Publikimi në web-in e partisë

Vendimi i Komisionit Rregullator përcakton[562] detyrimin e subjekteve zgjedhore për të publikuar në faqen zyrtare të internetit një kopje të raportit të vetëdeklarimit për fushatën zgjedhore.
Një pjesë e partive nuk kanë një faqe interneti zyrtare. Ndërkohë nga partitë e tjera që e kanë një faqe të tillë, Partia Socialiste[563] ka publikuar vetëm tabelën përmbledhëse të të ardhurave

559 Kanë dorëzuar bilancin e aseteve dhe detyrimeve në KQZ: Partia Socialiste, Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet, Partia Lëvizja e Re, Partia Fryma e Re Demokratike, Partia Republikane, Partia Bashkimi Demokrat, Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut, Partia Lëvizja e Legalitetit, Partia Demokristiane, Partia Socialdemokrate.

560 Vendimi nr. 13, datë 06.04.2021, Komisioni Rregullator, Neni 7 pika 2.

561 - *Partia Bindja Demokratike*, financieri z. Elon Ciko është edhe kandidat me numër rendor 24 në Qarkun Tiranë; - *Partia Emigracioni Shqiptar*, financierja znj. Enkeleda Latifi është edhe kandidate e Koalicionit ABEOK ku kjo parti bën pjesë, me numrin rendor 2 në Qarkun Elbasan; - *Partia Emigracioni Shqiptar*, financieri z. Rozher Prifti është edhe kandidat i Koalicionit ABEOK ku kjo parti bën pjesë, me numër rendor 4 në Qarkun Korçë; - *Partia Lëvizja Demokratike Shqiptare*, financierja znj. Marcela Lala është edhe kandidate me numër rendor 2 në Qarkun Fier; - *Partia Lëvizja e Re*, financieri z. Arsen Lazri është edhe kandidat me numër rendor 5 në Qarkun Durrës; - *Partia Nisma Thurje*, financier z. Panajot Soko është edhe kandidat me numër rendor 1 në Qarkun Tiranë.

562 Vendimi nr. 13, datë 06.04.2021, Komisioni Rregullator, Neni 3 pika 4.

563 Partia Socialiste ka publikuar në faqen zyrtare të internetit vetëm përmbledhjen financiare të totalit të të

e shpenzimeve, por jo Raportitin e Plotë sikurse kërkohet nga ligji, ndërkohë që të gjithë subjektet e tjerë zgjedhorë nuk e kanë përmbushur këtë detyrim ligjor.
Ky parashikim përbën një risi në kuadrin rregullues në funksion të rritjes së transparencës prej partive politike. Në këtë kuadër KQZ, duhet të aplikojnë mekanizma detyrues, qoftë edhe nëpërmjet sanksioneve, që të detyrojë subjektet t'i publikojnë raportet përkatëse financiare, pavarësisht vonesës dhe sanksionit administrative që mund të aplikohet ndaj tyre.

VIII.3.1.2.3. Raporte të paplotësuara

Raportet financiare të subjekteve zgjedhore duhet të plotësohen me kompjuter, si dhe të plotësohen në çdo fushë të përmbajtjes së tyre me të dhënat e nevojshme, në mënyrë që të krijohet një tablo sa më e qartë për të gjithë situatën financiare të subjektit zgjedhor gjatë fushatës.
Thuajse në asnjë raport vetëdeklarimi plotësimi nuk është bërë në të gjitha pjesët e tij, të parashikuara për t'u plotësuar sipas formatit përkatës.
Partia Socialdemokrate ka depozituar një raport në përmbajtje të të cilit është referuar vetëm shuma e marrë prej kësaj partie nga buxheti i shtetit, dhe asnjë e dhënë tjetër.
Madje edhe kjo pjesë është plotësuar me shkrim dore.
Edhe raporti i Partisë Ora e Shqipërisë është plotësuar me shkrim dore.
Partia Demokratike, Partia Fryma e Re Demokratike dhe kandidati i pavarur Iljaz Shehu në raportin e tyre nuk kanë specifikuar përshkrimin e dhurimit në natyrë.
Në disa raporte mungojnë të dhëna të ndryshme në fusha të ndryshme raporteve, që janë në seksionin e të ardhurave, por edhe të shpenzimeve[564].

VIII.3.1.2.4. Dhurime më shumë se 50 mijë lekë të kryera cash

Kodi Zgjedhor[565] **përcakton se dhurimi i fondeve jo publike me vlerë më të madhe se 50 mijë lekë duhet të kryhet vetëm nëpërmjet transfertës bankare në llogarinë e posaçme të hapur nga subjekti apo kandidati.**
Disa subjekte[566] kanë deklaruar në raportet e tyre dhurime të vlerave monetare më të mëdha se 50 mijë lekë të kryera cash.
Sipas Vendimit të Komisionit Rregullator[567] ky veprim jo vetëm sanksionohet me gjobë sa shuma e dhuruar, por edhe fondet e marra nga subjekti duhet të kalojnë për llogari të KQZ-së.

VIII.3.1.2.5. Raporte ku nuk përputhet kategoria e shpenzimit me përshkrimin e tij

Kategorizimi i shpenzimeve në raportet e vetëdeklarimit, bëhet sipas zërave në kategorinë e të cilëve futet secili shpenzim, i cili duhet të përshkruhet në kolonën përkatëse.
Vërehet se Partia Demokratike për pjesën dërrmuese të shpenzimeve të kryera nuk ka vendosur përshkrim, por vetëm zërin e shpenzimit.

---

ardhurave dhe shpenzimeve nga gjithë Raporti i vetëdeklarimit financiar për fushatën zgjedhore.

564 - Në raportin e *Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim* mungojnë numrat e identifikimit të disa individëve që kanë bërë dhurim në natyrë. - Në raportin e *Partisë Socialiste* mungon data kur janë depozituar ne llogarinë bankare të fushatës të ardhurat nga kuotat e anëtarësisë dhe transferta nga llogari të tjera të subjektit; tek seksioni i financimeve jo publike në para mungon data e dhurimit, dhe adresa e dhuruesit. - Në raportin e *Partisë Demokratike* në disa raste mungon numri i identifikimit të individëve dhurues tek seksioni i dhurimeve në natyrë; mungon data kur janë depozituar ne llogarinë bankare të fushatës të ardhurat nga kuotat e anëtarësisë dhe transferta nga llogari të tjera të subjektit; shpenzimet për Facebook janë përmbledhur në një deklarim të vetëm, jo të ndara sipas secilës faturë dhe datë të kryerjes së shpenzimi. - Në raportin e *Partisë Republikane* mungon shpjegimi i shpenzimeve. - Në raportin e *Partisë Lëvizja për Ndryshim* mungon metoda e kryerjes së pagesës për faturat në seksionin e shpenzimeve. - Në raportin e *Partisë Bindja Demokratike* seksioni i shpenzimeve është i padetajuar; tek seksioni i të ardhurave mungon data e dhurimit dhe adresa e dhuruesit.

565 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 92/2 pika 2.

566 - Partia Bindja Demokratike ka deklaruar 8 dhurues me shuma përkatësisht nga 100.000 lekë secili të kryera *cash*. - Partia Lëvizja për Ndryshim ka deklaruar 4 dhurues me shuma përkatësisht nga 75.000 lekë secili të vetëm, *cash*. -Z. Agron Duka kandidat i PD-AN në raportin e tij si kandidat i Partisë Agrare Ambjentaliste i ka dhuruar vetes cash 100,000 lekë *cash*. - Kandidati i propozuar nga zgjedhësit z. Pal Shkambi, ka marrë dhurim në para nëpërmjet kompanive të transfertave ndërkombëtare të parave shumën 102.000 lekë.

567 Vendim nr. 18 datë 14.04.2021 "... Pranimi i fondeve private me vlerë më të madhe se 50 mijë lekë, përmes formave të tjera, të ndryshme nga ajo e kalimit në llogarinë bankare, dënohet më gjobë të barabartë me shumën e dhuruar dhe në kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së".

Ndërkohë Partia Socialiste[568] dhe Lëvizja Socialiste për Integrim[569] kanë disa mospërputhje midis zërit të shpenzimit dhe përshkrimit të tij.
Përpos rasteve kur mospërputhja është e dukshme, janë prezentë edhe raste kur lidhja mes zërit dhe përshkrimit mbetet e diskutueshme.
Për të minimizuar subjektivitetin në kategorizimin e shpenzimeve, duhet që në formatet e raportimit, në funksion të secilit zë që është i paracaktuar dhe mund të përzgjidhet prej subjektit, të krijohet listë e mbyllur përzgjedhje për përshkrimin përkatës.

VIII.3.1.2.6. Deklarimi i shpenzimeve

Seksioni i shpenzimeve të formularit tip përbëhet nga dy pjesë. Pjesa e parë, parashikon raportimin e shpenzimeve në bazë të faturës, çka ofron një pasqyrë të detajuar të të gjitha shpenzimeve të fushatës të kryera nga subjekti zgjedhor.
Gjithashtu, duhet që përveç detajimit të tyre në kuptim të llojit, kostos dhe të dhënave të faturave përkatëse, çdo subjekt të bëjë plotësim të kolonave me përshkrimeve më të detajuara në rastin e shpenzimeve për mitingje, për media apo për promocione të ndryshme.
Përveç PDIU, asnjë subjekt tjetër nuk e ka plotësuar këtë pjesë, duke e lenë bosh apo edhe duke e hequr (fshirë) nga seksioni i shpenzimeve.

VIII.3.1.2.7. Pagesa më shumë se 150.000 lekë të kryera cash

Legjislacioni tatimor[570] në Republikën e Shqipërisë përcakton se pagesat kundrejt shërbimeve mund të realizohen me para në dorë nëse ato janë deri në vlerën 150,000 Lekë. Për vlera më të mëdha pagesat duhet të kryhen nëpërmjet bankës.
Vërehet se Partia Socialiste ka kryer pagesa cash të faturave në shuma jashtë këtij kufiri ligjor[571].
Gjithashtu një parti ka deklaruar[572] pagimin e një fature me vlerë më të madhe se kufiri i lejuar pa e specifikuar metodën e pagesës.

VIII.3.1.2.8. Shpenzimet e kryera pas përfundimit të fushatës elektorale

Në seksionin e shpenzimeve të fushatës, përfshihet çdo shpenzim që kryhet për qëllime të fushatës pavarësisht datës se kur është bërë, por gjithmonë përpara datës së zgjedhjeve. Ndërsa likuidimi i faturës ose i kësteve përfundimtare mund të bëhen edhe pas datës së zgjedhjeve.
Në raportet e gjashtë partive[573] janë deklaruar shpenzime me datë të faturës në muajt maj, qershor apo korrik 2021, pra jashtë periudhës së fushatës zgjedhore.
Përpos faktit që kemi të bëjmë me shpenzime të cilat janë kryer jashtë periudhës së fushatës zgjedhore, evidentohet moskorrektësi edhe nga ana e subjekteve që i kanë lëshuar këto fatura, pasi ato deklarojnë kryerje të shpenzimeve në funksion të një aktiviteti elektoral, pas datës së zgjedhjeve. Kjo është në kundërshtim me legjislacionin tatimor në fuqi[574], sipas të cilit fatura përpilohet dhe nxirret nga subjekti ofrues apo shitës në momentin e kryerjes së shërbimit, pavarësisht momentit kur kryhet likuidimi i saj.

568 Në zërin mitingje dhe tubime janë përfshirë shpenzime për "qera zyre elektorale", në zërin shpenzime zyrë elektorale janë përfshirë shpenzime për transport apo edhe karburant, etj.

569 Në zërin shpenzime për zyrë elektorale janë përfshirë shpenzime për "komisione", për mirëmbajtje makine, në zërin shpenzime për mitingje dhe aktivitetet janë future shpenzime për "veshje zyrë elektorale", etj.

570 Udhëzimi Nr.24 datë 02.09.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i Ministrit të Financave, ndryshuar me Udhëzimin Nr. 4, datë 25.01.2014, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 6 datë 30 janar 2014, pika 59.1.1 "Ne zbatim të pikës 1 të nenit 59 të Ligjit, personat e tatueshëm nuk mund të kryejnë midis tyre transaksione shitjeje dhe blerjeje me lekë në dore, kur vlera e çdo transaksioni është më e madhe se 150 mijë lekë. Kryerja me lekë në dorë dhe jo nëpërmjet kalimit nga llogaria likuiduese e blerësit në llogarinë likuiduese të shitësit e transaksioneve të shitblerjes që e kalojnë vlerën 150 mijë lekë, përbën shkelje si për shitësin ashtu dhe për blerësin dhe dënohet, sipas nenit 120 te Ligjit me një gjobe sa 10 për qind e vlerës se çdo transaksioni te kryer me lekë në dorë."

571 PS ka paguar cash një fature 311.654 lekë si dhe një faturë 150.000 lek..

572 Partia Lëvizja për Ndryshim, fatura me vlerë 515.425 lekë.

573 Partia Socialiste, Partia Demokratike, Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut, Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet, Partia Fryma e Re Demokratike.

574 Udhëzimi Nr.24 datë 02.09.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i Ministrit të Financave, ndryshuar me Udhëzimin Nr. 4, datë 25.01.2014, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 6 datë 30 janar 2014, pika 51.1 "Shitësi lëshon faturë tatimore dhe blerësi duhet ta kërkojë atë në kohën e realizimit të shitjes apo të kryerjes së punimit ose shërbimit".

VIII.3.2. VETËRAPORTIMI I KANDIDATËVE

Kandidatët e pavarur apo të propozuar nga partitë politike apo koalicionet mbartin të njëjtat detyrime apo kufizime në aspektin e financimit sikurse vetë subjektet zgjedhore që i propozojnë ato.

Aktiviteti financiar i kandidatëve duhet të jetë nën mbikëqyrjen e financierit të partisë. Të ardhurat dhe shpenzimet e kandidatëve llogariten si të ardhura dhe shpenzime nga partia përkatëse, dhe duhet të përfshihen në raportin financiar të fushatës zgjedhore të partisë.

Kandidatët e përfshirë në listat shumëemërore të partive politike kanë detyrimin të regjistrojnë, dokumentojnë dhe raportojnë të ardhurat dhe shpenzimet e fushatës së tyre duke përdorur një formular tip raportimi të miratuar nga Komisioni Rregullator në KQZ.

Bashkë me raportin financiar të partisë politike duhet të bashkëngjiten edhe kopjet e raporteve të kandidatëve.

Vetëm 8 parti[575] kanë depozituar në KQZ, së bashku me raportin e partisë, edhe raportet e kandidatëve të tyre.

Një parti[576] ka përfshirë në raportin e saj vetëm shumën totale të përfituar dhe shpenzuar nga kandidatët si një total i agreguar sipas secilit qark.

Partia Demokratike, ka përfshirë shumën e agreguar sipas qarkut për kandidatët e vetëm 5 qarqeve, duke deklaruar 0 të ardhura dhe shpenzime nga kandidatët e 7 qarqeve[577] të tjera.

Duke patur në konsideratë aktivitetin elektoral të kandidatëve të kësaj force politike në qarqet në fjalë, ngrihen pikëpyetje dhe dyshime të forta mbi vërtetësinë e këtij deklarimi.

Vendimi i Komisionit Rregullator parashikon që kandidatët duhet të mbajnë kontakt të vazhdueshëm me financierin e partisë lidhur me aktivitetin financiar të fushatës së tyre. Kjo do të thotë se financieri i partisë është në dijeni të tërë aktivitetit financiar të çdo kandidati, ndër të tjera, për të patuar kujdes edhe mostejkalimin e limitit të shpenzimeve sipas parashikimeve të Kodit Zgjedhor.

Nga totali prej 1.825 kandidatësh[578] 659[579] kanë dorëzuar raport vetëdeklarimi pranë KQZ nëpërmjet subjektit politik në logon e të cilit kandidonin, apo si kandidatë të propozuar nga zgjedhësit, ndërsa pjesa tjetër prej 1 166 kandidatësh nuk e ka përmbushur këtë detyrim ligjor[580].

Rezulton se 483 kandidatë, nga 654 që i kanë dorëzuar raportet e tyre në KQZ, bashkëlidhur raportit të partisë përkatëse, deklarojnë zero të ardhura dhe shpenzime[581] përgjatë gjithë aktivitetit të electoral të zhvilluar prej tyre.

Sipas deklarimeve të partive politike, shuma totale e përfituar prej kandidatëve është 50.193.107 lekë dhe ajo e shpenzuar 45.957.347 lekë.

Shuma totale e të ardhurave të kandidatëve, sipas raporteve të vetëdeklarimit të vetë kandidatëve të cilët kanë dorëzuar raport është 49.306.723 lek ndërsa ajo e shpenzuar 44.237.559 lek.

Sa i përket shpenzimeve, vërehet se ato janë kryesisht: për prodhimin e materialeve promocionale 28%, media sociale 19%, shpenzime për transport 18%, zyra zgjedhore 8%, shpenzime për mitingje 8%, shpenzime administrative 7%, media 4% dhe pjesa e mbetur për shpenzime të tjera si sondazhe, reklamime në natyrë, botime, etj.

VIII.3.2.1. Shpenzimet e kandidatëve

Sikurse partitë politike, edhe kandidatët duhet të konsiderojnë si shpenzim të fushatës çdo shpenzim që lidhet me fushatën, pavarësisht kohës se kur është bërë.

Shpenzimet ndahen në kategori të veçanta. Seksioni i shpenzimeve në raportin e vetëdeklarimit parashikon ndarjen e shpenzimeve sipas faturave përkatëse, dhe detajimin e

575 Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, Partia Republikane, Partia Agrare Ambjentaliste, Partia Lëvizja për Ndryshim, Partia Lëvizja e Re, Partia Demokristiane, Partia Demokratike, Partia Socialiste.

576 Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet.

577 Qarku Berat, Qarku Dibër, Qarku Durrës, Qarku Fier, Qarku Kukës, Qarku Lezhë, Qarku Vlorë.

578 Numri total i kandidatëve në zgjedhjet e 25 prillit ishte 1841, por duke qenë se kryetarët e disa partive aplikuan të drejtën e kandidimit në më shumë se një qark, numri i individëve kandidatë që duhet të dorëzojnë raport vetëdeklarimi është 1825, nga të cilët 5 kandidatë të pavarur. (Për më shumë lidhur me numrin e kandidatëve shih pjesën "Regjistrimi i kandidatëve")

579 Nga të cilët 654 kandidatë të partive politike apo koalicioneve zgjedhore dhe 5 kandidatë të pavarur.

580 Për më shumë shih Shtojcën S "Kandidatë të cilët nuk kanë dorëzuar raport vetëdeklarimi".

581 Për më shumë shih Shtojcën Q "Kandidatë të cilët kanë dorëzuar raport vetëdeklarimi me 0 të ardhura dhe shpenzime".

secilës faturë sipas fushave dhe përshkrimeve përkatëse. Plotësimi i plotë i secilës fushë ofron një pasqyrë të qartë shpenzimeve të kryera nga kandidati në funksion të fushatës elektorale.

Shpenzimet duhet të justifikohen me dokumentacionin e nevojshëm tatimor, sipas legjislacionit në fuqi.

Vërehet se edhe në raportet e kandidatëve paraqiten thuajse të njëjtat problematika sikurse partitë politike.

Kështu, pavarësisht përcaktimit ligjor për lëshimin e faturës tatimore në momentin e kryerjes së një shërbimi të caktuar, janë 35 kandidatë[582] të cilët deklarojnë në raportet përkatëse fatura të muajve maj, qershor apo korrik, pas përfundimit të fushatës elektorale.

Referuar legjislacionit tatimor, edhe kandidatët nuk mund të paguajnë shuma më të mëdha se 150.000 lekë *cash*, por vetëm nëpërmjet transfertës bankare.

Nga raportimi i kandidatëve vërehet se 6 kandidatë[583] të Partisë Socialiste kanë kryer pagesa të tilla *cash*.

VIII.3.2.2. Raporte të paplotë dhe me mangësi

Raportimi i kandidatëve do të duhej të ishte në bashkëpunim dhe koordinim të ngushtë me financierin e partisë politike. Në këto kushte raportet e kandidatëve do të duhej të kalonin edhe filtrin e kontrollit nga partia politike përpos atij në KQZ.

Vërehet se ka një plotësim dhe publikim të cunguar të raporteve të kandidatëve. Kështu kandidatët e Partisë Socialiste të cilët kanë dorëzuar një raport me 0 të ardhura dhe shpenzime, nuk kanë të publikuar një raport të plotë, por vetëm faqen e parë të tij.

Edhe në raste kur kandidatët kanë aktivitet financiar, plotësimi i të dhënave të nevojshme të formatit të raportit është i cunguar[584].

582 * *Partia Socialiste*
- *Ogerta Manastirliu*, paguar faturë të datës 01.07.2021 me vlerë 150.000 lekë; - *Pranvera Resulaj*, paguar faturë të datës 12.05.2021 me vlerë 68.860 lekë, dhe me faturat e datave 26.06.2021 dhe 29.06.2021 përkatësisht me shumat 2.100 lekë, 14.630 lekë, 39.360 lekë dhe 18.900 lekë; - *Etilda Gjonaj*, paguar faturë të datës 24.05.2021 me vlerë 266.800 lekë; - *Eduart Shalsi*, paguar faturë të datës 20.06.2021 me vlerë 445.000 lekë; - *Plarent Ndreca*, paguar faturë të datës 24.05.2021 me vlerë 340.000 lekë; - *Eduard Ndreca*, dhurimet që ia ka bërë vetvetes janë në datat 30.04.2021, 31.05.2021 dhe 02.06.2021, paguar fatura të datave 30.04.2021 me vlerë 74.100 lekë, 31.05.2021 me vlerë 120.000 lekë dhe 02.06.2021 me vlerë 58.000 lekë; - *Bledi Como*, paguar dy fatura të datës 29.05.2021 përkatësisht me vlerat 14.000 lekë dhe 101.591 lekë; - *Bledar Çuçi*, paguar faturë të datës 14.05.2021 me vlerë 1.310.160 lekë dhe 17.05.2021 me vlerë 292.850 lekë; - *Taulant Balla*, paguar faturë të datës 12.05.2021 me vlerë 258.000 lekë.
* *Partia Agrare Ambjentaliste*
- *Agron Duka*, fatura e dhurimit në natyrë me vlerën 50,000 lekë është lëshuar në datën 30.07.2021.
* *Lëvizja Socialiste për Integrim*
- *Luljeta Skura*, paguar fatura të datës 05.05.2021 me vlerë 70.000 lekë, 08.05.2021 me vlerë 15.000 lekë; - *Merita Hoxha*, paguar dy fatura të datës 05.05.2021 me vlerë 35.000 lekë dhe 35.000 lekë; - *Monika Kryemadhi*, paguar fatura të datës 01.05.2021 me vlerë 100.000 lekë dhe 10.05.2021 me vlerë 19.928 lekë; - *Arben Cuco*, paguar fatura të datës 04.05.2021 me vlerë 30.000 lekë; - *Kristian Kina*, paguar faturë të datës 13.05.2021 me vlerë 10.000 lekë; - *Endrit Braimllari*, paguar fatura të datës 22.05.2021 me vlerë 90.000 lekë; - *Agron Cela*, paguar tre fatura të datës 19.05.2021 përkatësisht me vlerë 150.000 lekë dhe dy të tjerat me vlerë 140.000 lekë; - *Bledar Monaj*, paguar një faturë të datës 02.06.2021 me vlerë 51.200 lekë; - *Liri Dema*, ka paguar dy fatura të datës 05.05.2021 me vlerë 32.500 lekë dhe 27.600 lekë, dhe një faturë të datës 10.05.2021 me vlerë 10.000 lekë; - *Anxhela Shenaj*, paguar dy fatura të datës 05.05.2021 me vlerë që të dyja 6.500 lekë, dhe një faturë të datës 17.05.2021 me vlerë 24.000 lekë dhe një faturë të datës 18.05.2021 me vlerë 24.000 lekë; - *Dikens Bushaj*, paguar dy fatura të datës 19.05.2021 me vlerë 25.000 lekë dhe me vlerë 27.600 lekë; - *Griselda Myslymi*, paguar një faturë të datës 10.05.2021 me vlerë 10.000 lekë dhe tre fatura të datës 18.05.2021 përkatësisht me vlerat 15.600 lekë, 50.000 lekë dhe 10.500 lekë; - *Silvana Caka*, paguar një faturë të datës 08.06.2021 me vlerë 15.000 lekë; - *Besnik Jakaj*, paguar një faturë datës 25.05.2021 me vlerë 25.500 lekë; - *Vojo Bregu*, paguar një faturë të datës 25.05.2021 me vlerë 200.000 lekë; - *Arben Rroko*, paguar një faturë të datës 05.05.2021 me vlerë 43.200 lekë dhe një faturë të datës 12.05.2021 me vlerë 43.000 lekë; - *Floida Kerpaci*, paguar një faturë të datës 31.05.2021 me vlerë 60.000 lekë; - *Edmond Ndou*, paguar dy fatura të datës 20.05.2021 përkatësisht me vlerë 150.000 lekë dhe 140.000 lekë; - *Linda Reçi*, paguar dy fatura të datës 19.05.2021 përkatësisht me vlerë 140.000 lekë dhe 120.000 lekë; - *Ilir Hyseni*, paguar dy fatura të datës 19.05.2021 përkatësisht me vlerë 110.000 lekë dhe 120.000 lekë; - *Somela Radohima*, paguar një faturë të datës 19.05.2021 me vlerë 150.000 lekë; - *Klajda Gjosha*, ka një faturë të datës 06.05.2021 me vlerë 35.000 lekë dhe një faturë të datës 12.05.2021 me vlerë 90.000 lekë; - *Joana Ruçi*, paguar një faturë të datës 04.06.2021 me vlerë 60.000 lekë; - *Everton Shehu*, paguar një faturë të datës 25.05.2021 me vlerë 47.000 lekë; - *Arben Rroko*, paguar një faturë të datës 05.05.2021 me vlerë 43.200 lekë dhe një faturë të datës 12.05.2021 me vlerë 43.000 lekë.

583 - *Lavdim Krasniqi*, paguar cash faturën me vlerë 390.000 lekë; - *Xhemal Qefalija*, paguar cash faturë 198.500 lekë; - *Ylli Shehu*, paguar cash dy fatura me vlerën 202.000 lekë dhe 468.000 lekë; - *Halim Dauti*, paguar cash faturë 267.917 lekë; - *Bledar Çuçi*, paguar cash faturë 292.850 lekë; - *Antoneta Dhima*, paguar cash faturë 170.000 lekë.

584 * *Partia Socialiste*
- *Pranvera Resulaj* nuk ka plotësuar seksionin e dhurimeve në natyrë me emrat përkatës; - *Teuta Ramaj* ka vendosur me shkrim dore në raport vetëm shumën e marrë prej saj si financim jo publik, por nuk ka ka plotësuar detajet e tjera të seksionit të financimit jo publik; - *Etilda Gjonaj* nuk ka plotësuar seksionin e financimit jo publik në raport, por vetëm shumën përkatëse të marrë; - *Ermonela Felaj* në seksionin e shpenzimeve ka vendosur vetëm shumat pa specifikuar

VIII.4. KONTROLLI

Kuadri ligjor përcakton dy mekanizma bazë me anë të të cilave kontrollohen financat e subjekteve zgjedhore: monitorimin përgjatë fushatës zgjedhore dhe auditimin ligjor, i cili kryhet nga auditues ligjorë të kontraktuar nga KQZ.

Monitoruesit përgjatë fushatës zgjedhore, në një hap prapa nga zgjedhjet e mëparshme, nuk parashikohet të kryejnë kostim të veprimtarive së partive politike në fushatë, por monitorimin e pajtueshmërisë së veprimtarive me detyrimet sipas Kodit Zgjedhor dhe/ose akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

Përditësimi i rregullave, referuar ndryshimeve ligjore të vitit 2020, për plotësimin, depozitimin, kontrollin dhe verifikimin e raporteve financiare që dorëzojnë subjektet zgjedhore në KQZ, modeli i raportit të auditimit të fondeve të përfituara nga subjektet zgjedhore nga audituesit e caktuar nga KQZ, afatet e publikimit të këtyre raporteve, roli dhe përgjegjësitë e financierëve të partive politike, u krye nëpërmjet Vendimit[585] nr. 13 të miratuar nga Komisioni Rregullator.

VIII.4.1. MONITORIMI I FUSHATËS ZGJEDHORE

Monitorimi kryhet në emër dhe për llogari të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe synon vlerësimin për shkallën e përputhshmërisë së veprimtarisë së partive politike, subjekteve zgjedhore dhe kandidatëve të tyre me kushtet dhe kërkesat e Kodit Zgjedhor dhe akteve të tjera nënligjore. Në ndryshim nga viti 2017 dhe viti 2019, monitoruesit e aktiviteteve të fushatës nuk ishin më auditët financiarë dhe nuk kishin për qëllim të nxirrnin kosto të pavarura të fushatës, por vetëm të monitoronin aktivitetet, përfshirë aktivitetet e institucioneve shtetërore.

Ky mekanizëm kontrolli është i rëndësishëm gjatë periudhës parazgjedhore, me qëllim rritjen e transparencës për zgjedhësit, ndërkohë që gjetjet e monitoruesve do të shërbejnë edhe si informacion shtesë për evidentimin e saktësisë së raportimit të shpenzimeve të fushatës nga vetë subjektet zgjedhore.

KQZ miratoi udhëzimin[586] për kriteret e përzgjedhjes, procedurën dhe emërimin e monitoruesve, objektin e monitorimit, periudhën e monitorimit, përcaktimin e subjektit/ve të monitorimit, zonën gjeografike ku shtrihet monitorimi, si dhe raportimin e monitorimit në mënyrë të pavarur, të paanshme dhe transparente.

Çdo monitorues nënshkroi formularin e miratuar[587] nga Komisioneri, për mungesën e konfliktit të interesit si dhe të vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore.

KQZ emëroi 64 ekspertë monitorues[588] në 12 qarqe të vendit.

Monitoruesit duhet të dorëzonin në KQZ raporte të ndërmjetme çdo dhjetë ditë[589], si dhe të

---

asgjë tjetër të nevojshme në tabelën përkatëse të seksionit; - *Dallandyshe Bici* nuk ka plotësuar seksionin e dhurimeve në natyrë me përshkrimin e këtij dhurimi; - *Klodeta Dibra* në seksionin e shpenzimeve ka mangësi në numra e data faturash; - *Ornaldo Rakipi,* tabela e shpenzimeve ka vetëm disa shuma nën zërin shpenzime administrative pa asnjë shpegim; - *Edona Bilali* në raportin përkatës ka specifikuar vetëm shumën e të ardhurave dhe shpenzimeve në faqen e parë, por pa plotësuar seksionet e tjera të tij; - *Eduard Ndreca* në seksionin e shpenzimeve nuk ka specifikuar kategorinë e shpenzimit; - *Bledi Como* ka dorëzuar një raport të plotësuar me shkrim dore; - *Bardhyl Kollcaku* ka përfshirë në raport vetëm të ardhurat, por jo shpenzimet e kryera prej tij; - *Fadil Nasufi* shuma 50.000 lekë e pasqyruar në faqen e parë si shpenzim indirekt nuk është në seksionin përkatës të dhurimeve në natyrë në raport; - *Dionis Imeraj* ka disa pasaktësi në plotësimin e seksioneve të shpenzimeve dhe dhurimeve në natyrë duke patur një pasqyrim të dubluar të shifrave në faqen e parë të raportit; - *Kabir Fishta* citon në faqen e parë të raportit të tij 50.000 lekë të ardhura nga persona juridikë, por nuk ka plotësuar seksionet e tjera të raportit.

* *Partia Demokratike*

- *Edmond Spaho*, në seksionin e dhurimeve në para dhe në natyrë mungon çdo e dhënë identifikuese e dhuruesve. Gjithashtu ka emra të dhuruesve në natyrë dhe përshkrimin përkatës, por pa kundërvleftën e dhurimit në para; - *Entela Shehaj*, në raportin e saj nuk ka plotësuar seksionin e të ardhurave, por ka bashkëlidhur vetëm deklaratë për dhurim të kryer prej saj.

* *Partia Republikane*

Në raportin e kandidatit *Fatmir Mediu* janë vetëm shpenzimet e kryera, por seksioni i të ardhurave është i pa plotësuar.

585 Vendimi nr. 13, datë 06.04.2021, Komisioni Rregullator "Për përcaktimin e rregullave për raportimin financiar të subjekteve zgjedhore, kontrollin dhe verifikimin e financimeve dhe shpenzimeve të tyre gjatë fushatës zgjedhore."

586 Udhëzim nr. 1 datë 2.02.2021, "Për caktimin e kritereve për përzgjedhjen e monitoruesve, procedurën, emërimin dhe objektin e monitorimit".

587 Urdhër nr. 89, datë 05.02.2021, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, "Për miratimin e formularëve tip të vetëdeklarimit për monitoruesit".

588 Lista e monitoruesve të përzgjedhur për 12 qarqe, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

589 Çdo monitorues referuar periudhës së angazhimit duhet të dorëzonte në total pesë raporte të ndërmjetme

raportonin në mënyrë të menjëhershme parregullsitë e vërejtura.
KQZ ka detyrimin të publikojë raportet e monitoruesve në faqen e vet të internetit, brenda dy ditëve pune nga depozitimi i tyre në KQZ[590].
Ky detyrim nuk u realizua plotësisht nga KQZ-ja. Deri në ditën e zgjedhjeve rezultonin të publikuara në faqen e internetit të KQZ-së vetëm 63 raporte monitorimi, të cilat në tërësi përfshinin periudhën nga data 1 deri në 15 mars 2021.
Nga këqyrja e raporteve të ndërmjetme, para ditës së zgjedhjeve, evidentohej se 6 bashki[591] dhe 5 subjekte zgjedhore[592] nuk ishin monitoruar për atë periudhë, pasi nuk ishin të përfshirë në asnjë prej raporteve të monitorimit.
Gjithashtu, në tërësinë e gjithë raporteve të ndërmjetme të publikuara monitoruesit evidentonin dy probleme që përbëjnë shkelje të ligjit[593].
Aktualisht, në faqen e internetit të KQZ janë publikuar në total 303 raporte të ndërmjetme[594] nga 64 monitorues.
Sa i përket raporteve përfundimtare të monitorimit rezultojnë tre bashki[595] të papërfshira në asnjë prej raporteve.

Gjithashtu, vërehet se vetëm tri subjektet kryesore PS, PD dhe LSI janë monitoruar në çdo qark ndërsa të tjerat në shumë pak prej tyre[596].
Në faqen zyrtare të KQZ janë publikuar 59 raporte përfundimtare të monitorimit[597], ndërkohë mungojnë raportet përfundimtare të tre monitoruesve[598].
Duhet theksuar se edhe në këtë proces pati raste të dorëzimit të raporteve me probleme nga ana e monitoruesve financiarë.

Evidentohen nga këqyrja e raporteve të monitorimit raste të raporteve, të cilat janë të paplota, me plotësimin e fushave përkatëse vetëm nëpërmjet togfjalëshit "nuk ka"[599], raporte tek të cilat evidentohet një numër total i zyrave zgjedhore prej monitoruesit, por pa specifikuar se cilit subjekt i përkasin[600], apo edhe raporte të plotësuara me shkrim dore[601].
Në një gjykim të përgjithshëm vërehet përgatitje dhe angazhim i ulët nga ana e monitoruesve,

dhe një raport përfundimtar.

590 Vendimi nr. 13, datë 16.04.2021, Komisioni Rregullator, "Për përcaktimin e rregullave për raportimin financiar të subjekteve zgjedhore, kontrollin dhe verifikimin e financimeve dhe shpenzimeve të tyre gjatë fushatës zgjedhore", Neni 2 "Raportet e monitorimit" pika 2.

591 Bashkia Përmet, Bashkia Sarandë, Bashkia Selenicë, Bashkia Shijak, Bashkia Himarë, Bashkia Librazhd, Bashkia Fushë-Arrëz.

592 Partia Lëvizja për Ndryshim, Partia Lëvizja Demokratike Shqiptare, Partia Bindja Demokratike, Partia Aleanca Demokracia e Re, Partia Balli Kombëtar.

593 Raporti i monitorueses A.S.: Në Bashkinë Durrës, Partia Demokratike dhe Partia Lëvizja Socialiste për Integrim kanë hapur më shumë se një zyrë zgjedhore për lagje.
Raporti i monitoruesit N.D.: Partia Lëvizja Socialiste për Integrim nuk ka përfshirë në materialet propagandistike të fushatës shprehjen "prodhuar nën përgjegjësinë ligjore të....."

594 Mungojnë: - raporti i tretë i ndërmjetëm i monitoruesit I.E; - Raporti i katërt i ndërmjetëm i monitoruesit G.N; - Raporti i katërt dhe i pestë i ndërmjetëm i monitoruesit A.S; - Raporti i parë, i dytë, i tretë dhe i katërt i ndërmjetëm i monitoruesit S.GJ; - Raporti i tretë dhe i katërt i ndërmjetëm i monitoruesit I.B; - Raporti i katërt i ndërmjetëm i monitoruesit B.G; - Raporti i dytë dhe i tretë i ndërmjetëm i monitoruesit A.N; - Raporti i parë, i dytë, i tretë dhe i pestë i ndërmjetëm i monitoruesit I.S. .

595 Bashkia Librazhd, Bashkia Prrenjas dhe Bashkia Himarë.

596 Qarku Berat janë monitoruar tri subjekte zgjedhore (PD, PS, LSI); Qarku Dibër janë monitoruar tri subjekte zgjedhore (PD, PS, LSI); Qarku Durrës janë monitoruar tri subjekte zgjedhore (PD, PS, LSI); Qarku Elbasan janë monitoruar pesë subjekte zgjedhore (PD, PS, LSI, BD, NTH); Qarku Fier janë monitoruar pesë subjekte zgjedhore (PD, PS, LSI, BD, PDIU); Qarku Gjirokastër janë monitoruar gjashtë subjekte zgjedhore (LSI, PS, PD, NTH, VV, PSD); Qarku Korçë janë monitoruar pesë subjekte zgjedhore (PS, PD, LSI, PSD, PDIU); Qarku Kukës janë monitoruar pesë subjekte zgjedhore (PD, PS, LSI, PR, BD); Qarku Lezhë janë monitoruar tri subjekte zgjedhore (PD, PS, LSI); Qarku Shkodër janë monitoruar gjashtë subjekte zgjedhore (PS, PD, LSI, PSD, NTH, LN, BD); Qarku Vlorë janë monitoruar gjashtë subjekte zgjedhore (PS, PD, LSI, BD, LRE, PSD, PDIU); Qarku Tiranë janë monitoruar gjashtë subjekte zgjedhore (PS, PD, LSI, PSD, ADR, PDIU).

597 Në pamje të parë janë 61 raporte, por në linkun ku duhet të ishte Raporti përfundimtar i monitorimit të monitoruesit N.D. , ndodhet Raporti përfundimtar i monitorimit të monitoruesit I.LL.; si dhe në linkun ku duhet të ishte Raporti përfundimtar i monitorimit A.P. , ndodhet Raporti përfundimtar i monitorimit të G.A..

598 Mungon Raporti final i monitoruesit I.S; Raporti final i monitoruesit R.H; Raporti final i monitoruesit J.L.

599 Raporti përfundimtar i monitorimit të Monitoruesit R.O.; Raporti përfundimtar i monitorimit të Monitoruesi G.A..

600 Raporti përfundimtar i monitorimit të Monitoruesi SH.C.; Raporti përfundimtar i monitorimit të Monitoruesi G.K.; Raporti përfundimtar i monitorimit të Monitoruesit B.K..

601 Raporti përfundimtar i monitorimit të Monitoruesit SH.C.; Raporti përfundimtar i monitorimit të Monitorues E.P., raporti përfundimtar i monitorimit të Monitoruesi S.Gj., raporti përfundimtar i monitorimit të Monitoruesi O.Ç., raporti përfundimtar i monitorimit të Monitoruesi G.K..

me paraqitje të raporteve pa të dhëna esenciale, pa përshkrimet e nevojshme të shkeljeve[602], në formate shumë të vështira për tu lexuar e përpunuar, si dhe me gabime të mëdha gramatikore të cilat vështirësojnë të kuptuarin e çështjeve të trajtuara.

Kjo situatë, në rastin më të mirë tregon mungesën e përgjegjshmërisë nga ana e monitoruesve dhe nga ana tjetër mungesën e kontrollit nga KQZ mbi këto raporte.

Monitoruesit kanë evidentuar disa problematika që lidhen me aktivitetin e subjekteve zgjedhore.

Konkretisht, janë evidentuar raste të zhvillimit të aktiviteteve elektorale në shkolla[603] apo institucione publike dhe përfshirje të administratës publike në fushatën elektorale në orarin e punës[604] në shkelje të parashikimeve të neneve 91 dhe 92 të Kodit Zgjedhor.

Janë raportuar nga monitoruesit raste të hapjes së më shumë se një zyre zgjedhore për lagje[605] apo zyra zgjedhore të ngritura në një distancë më të vogël se 300 metra nga qendra e votimit, KZAZ-ja apo VNV-ja[606] në shkelje të Udhëzimit nr. 6 datë 23.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Gjithashtu, janë monitoruar afishime të materialeve propagandistike në fasada apo hapësira publike të papërcaktuara në vendimin e kryetarit të bashkisë[607]; afishim të materialeve propagandistike në distancë më shumë se 5 metra nga zyra zgjedhore[608]; si dhe prezenca e materialeve propagandistike pa brandimin [609] apo përcaktimin e shprehjes *"prodhuar nën përgjegjësinë ligjore të....."*, në shkelje të nenit 79 të Kodit Zgjedhor.

602 Monitoruesi A.M. përmend në raport raste ku subjektet zgjedhore apo kandidatët japin para, të mira materiale, përfitime të tjera, për të përfituar mbështetjen e tyre në zgjedhje, por nuk bën asnjë sqarim të mëtejshëm lidhur me këtë fakt. Monitoruesi R.G. ka evidentuar në raport raste të aktiviteteve elektorale në institucione publike, por ka cituar vetëm datat pa bërë plotësime për rastin konkret.

603 Monitoruesi G.SH. dhe Monitoruesi R.G. në raportet e monitorimit evidentojnë këtë problematikë, por janë të paqartë në përshkrimet përkatëse.

604 Monitoruesi R.G., Bashkia Gjirokastër, deklaron për subjektin PS: "…. Gjatë takimit të Kryeministrit Edi Rama në pikën turistike të Parkut të Viroit ditën e enjte ora 15.00, shihet qartë që pjesa më e madhe e të ftuarve në atë takim janë të administratës publike në orarin zyrtar të punës. Gjatë takimit të Kryeministrit Edi Rama në stadium datë 17.04.2021, ora 15.00, shihet qartë që pjesa më e madhe e të ftuarve në atë takim janë të administratës publike dhe veçanërisht arsimtarë të të gjitha cikleve".
Monitoruesi R.N., Bashkia Tropojë, për subjektin PS: "….Në datën 30.03.2021 kryetari i Bashkisë Tropojë z. Rexhë Byberi, Zv. Kryetari Abedin Kerrnaja, dhe Kujtim Rexha, nëpunësi civil Agron Cakraj, Drejtori i Spitalit Tropojë Kongres Imeraj, Nënprefekti Muj Gusturani, Përgjegjesi i AZHBR Tropojë Altin Berbati, Punonjësi i Hidrocentralit Fierzë Kujtim Hajdarmataj, si dhe punonjësi i postës Mehmet Cakrraj kanë marrë pjesë ne fushatën zgjedhore të PS-së z. Petrit Malaj. Ky konstatim u konstatua edhe në 2 takimet e radhës së datës 30.03.2021 të organizuara në Njësinë Administrative Bytyc, fshatrat Berishë, Pac, Visoc dhe Radogosh, si dhe Njësinë Administrative Llugaj, fshati Cerrnic kjo e vërejtur nga monitorimi i rrjeteve sociale *Facebook* të kandidatit për deputet Petrit Malaj. Pjesëmarrja e personave të sipërcituar përbën shkelje për shkak të pozicioneve të punës që përmban gjithsecili brenda orarit të punës për qëllime zgjedhore. Përveç sa më sipër vërehet edhe pjesëmarrja e personave të mitur në takime".

605 Raporti përfundimtar i monitorimit të monitoruesit A.N. Bashkia Shijak, Subjekti PS; Raporti përfundimtar i monitorimit të monitoruesit A.Z. Bashkia Durrës, subjekti PS, PD, LSI.

606 Raporti përfundimtar i monitorimit të monitoruesit S.B., Bashkia Durrës (Shkozet) tri zyra zgjedhore të tri subjekteve PS, PD, LSI; Raporti përfundimtar i monitorimit të Monitoruesit M.H., Bashkia Peqin, Belsh tri zyra zgjedhore të tri subjekteve PS, PD, LSI; Raporti përfundimtar i monitorimit të Monitoruesit G.B., Bashkia Cërrik, dy zyra zgjedhore të subjektit LSI; Raporti përfundimtar i monitorimit të Monitoruesit A.T., Bashkia Roskovec, subjekti PS; Raporti përfundimtar i monitorimit të Monitoruesi R.G., Bashkia Gjirokastër, subjektet NTH dhe PS; Raporti përfundimtar i monitorimit të Monitoruesi D.D., Bashkia Korçë, dy zyra zgjedhore të subjektit PS dhe tri zyra zgjedhore PD; Raporti përfundimtar i monitorimit të Monitoruesi A.S., Bashkia Maliq dhe Pustec, subjektet LSI, PS, PD, PSD; Raporti përfundimtar i monitorimit të Monitoruesit A.M., Bashkia Tiranë (Njësia nr.1) subjektet PDIU dhe PD; Raporti përfundimtar i monitorimit të Monitoruesit L.B., Bashkia Tiranë (Baldushk, Kashar, Ndroq, Petrelë, Pezë, Vaqar) subjekti PD; Raporti përfundimtar i monitorimit të Monitoruesit E.X., Bashkia Tiranë (njësia nr.2) katër zyra zgjedhore subjektit PD dhe një zyrë zgjedhore subjekti PDIU; Raporti përfundimtar i monitorimit të Monitoruesit I.B., Bashkia Tiranë (Njësia nr.6), një zyrë zgjedhore për subjektin PSD, një zyrë për subjektin LSI, katër zyra zgjedhore për subjektin PD, tri zyra zgjedhore PS.

607 Raporti përfundimtar i monitorimit të Monitoruesit R.K. Bashkia Berat (Çorovodë, Skrapar) Subjekti PD; Raporti përfundimtar i monitorimit të Monitoruesit R.G. Bashkia Gjirokastër, subjekti PS; Raporti përfundimtar i monitorimit të Monitoruesit O.K. Bashkia Pogradec, subjektet PS, PD, LSI dhe PAA; Raporti përfundimtar i monitorimit të Monitoruesit L.B. Bashkia Tiranë (Baldushk, Kashar, Ndroq, Petrelë, Pezë, Vaqarr) Subjekti PD; Raporti përfundimtar i monitorimit të Monitoruesit J.D. Bashkia Tiranë (Njësia nr.5) subjektet PS dhe PD; Raporti përfundimtar i monitorimit të Monitoruesit I.B. Bashkia Tiranë (Njësia nr.6), subjekti PD.

608 Raporti përfundimtar i monitorimit të Monitoruesit B.T. Bashkia Elbasan subjekti PS; Raporti përfundimtar i monitorimit të Monitoruesit A.T. Bashkia Roskovec subjekti PD; Raporti përfundimtar i monitorimit të Monitoruesit G.SH. Bashkia Tepelenë, Memaliaj subjekti PS; Raporti përfundimtar i monitorimit të Monitoruesit R.G. Bashkia Gjirokastër subjektet PD dhe PS; Raporti përfundimtar i monitorimit të Monitoruesit J.D. Bashkia Tiranë (Njësia nr.5) subjektet PS dhe PD; Raporti përfundimtar i monitorimit të Monitoruesit I.B., Bashkia Tiranë (Njësia nr.6), subjekti PD.

609 Raporti përfundimtar i monitorimit të Monitoruesit R.M. Bashkia Durrës (Lagjja 13), subjektet PS, PD, LSI; Raporti përfundimtar i monitorimit të Monitoruesit B.T. Bashkia Elbasan, subjektet BD dhe NTH; Raporti përfundimtar i monitorimit të Monitoruesit A.P. Bashkia Mallakastër, subjekti LSI; Raporti përfundimtar i monitorimit të Monitoruesit R.G. Bashkia Gjirokastër, subjektet LSI dhe PS; Raporti përfundimtar i monitorimit të Monitoruesit D.D. Bashkia Korçë, subjektet PS, PD dhe LSI.

VIII.4.2. AUDITIMI I SHPENZIMEVE

Kriteret e procedurat e përzgjedhjes, metodologjia së detajuar e punës së auditëve ligjorë, për auditimin e fondeve të përfituara nga partitë politike për vitin kalendarik dhe fushatën zgjedhore, u miratuan me udhëzimin[610] nr. 14 nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.
Emërimi i auditëve të fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike gjatë fushatës zgjedhore u krye me vendimin nr. 426 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve[611] pas shortit të hedhur në datën 12 korrik 2021[612]. 19 ekspertë kontabël të licencuar, apo audituesit ligjorë, audituan fondet e përfituara dhe shpenzuara nga 32 subjekte zgjedhore, ku përfshihen 27 parti politike dhe pesë kandidatë të pavarur[613].
Auditimi kërkohet dhe duhet të kryhet në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të), duke mbajtur skepticizëm profesional gjatë punës dhe më pas duke dhënë gjykim profesional në përfundim të saj.

Pavarësisht kësaj ekziston një rrezik i pashmangshëm që disa nga anomalitë materiale të mbeten të pazbuluara, edhe pse auditimi kryhet në përputhje me SNA-të.

Puna e ekspertëve kontabël, të kontraktuar si audites ligjorë zgjedhorë prej KQZ, konkludon në dorëzimin e raportit të auditimit, i cili ka pjesën analitike dhe në përfundim opinion e auditit.

Pjesa analitike përmban të dhëna sasiore dhe cilësore mbi auditimin e kryer në subjektin përkatës, ndërsa opinioni është përmbledhja e gjykimit me specifikim vetëm të problematikës përkatëse të evidentuar gjatë auditimit.
Nga gjykimi final i auditëve mbi veprimtarinë financiare të lidhur me fushatën zgjedhore, për 14 subjekte[614] është konkluduar në opinion me rezervë[615], për 17 subjekte auditi ka konkluduar në opinion pa rezervë[616], ndërsa në një subjekt[617] auditi nuk ka mundur të japë gjykim për shkak se nuk ka realizuar procesin e auditimit.
Formati i raportit[618] kërkon pyetje, orientime dhe specifikime, përgjigja tërësore e të cilave jep një panoramë të plotë dhe të qartë mbi auditimin e kryer dhe problematikat eventuale.
Konstatohet shqetësuese që në thuajse asnjë raport, plotësimi i duhur nuk është në 100% të tij, duke lënë mangësi.
Në një gjykim të përgjithshëm vërehet se auditimi i realizuar nga ekspertët ligjorë është sipërfaqësor, pa u thelluar në disa elemente të rëndësishëm të veprimtarisë financiare të partive.
Evidentohen raste të paraqitjes së raporteve të paplotësuara tërësisht sipas formatit të miratuar nga KQZ në vitin 2021[619] apo raporte me gabime materiale[620].

Gjithashtu ka raste, ku auditët përdorin si bazë ligjore dispozitat e Kodit Zgjedhor i cili ishte në

610 Udhëzimi nr. 14 datë 09.06.2021 "Për "për caktimin e kritereve, procedurat për përzgjedhjen dhe emërimin e ekspertëve kontabël të licensuar (audituesve ligjor) dhe kushtet kontraktuale për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike gjatë vitit kalendarik dhe subjektet zgjedhore dhe kandidatët e tyre në fushatën zgjedhore".

611 Vendimi nr. 426 datë 12.07.2021 "Për shpalljen e rezultatit të shortit për emërimin e ekspertëve kontabël të licensuar (audituesit ligjor), të cilët do të kryejnë auditimin e fondeve të përftuara dhe të shpenzuara nga subjektet zgjedhor për fushatën zgjedhore, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021".

612 Shorti për përzgjedhjen e ekspertëve kontabël të licensuar, dt. 12.07.2021.

613 13 ekspertë kontabël të licensuar do të auditojnë nga dy subjekte zgjedhore dhe gjashtë ekspertë kontabël të licensuar do auditojnë nga 1 subjekt zgjedhor.

614 Partia Lëvizja e Legalitetit, Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet, Partia Demokristiane e Shqipërisë, Partia Balli Kombëtar Demokrat, Partia Demokratike, Partia Fryma e Re Demokratike, Partia Bashkimi Popullor i Pensionistëve Shqiptar, Partia Bindja Demokratike, Partia Socialdemokrate, Partia Socialiste, Lëvizja për Zhvillim Kombëtar dhe kandidatët e pavarur Iljaz Shehu, Pal Shkambi, Elton Debreshi.

615 Opinioni me rezervë, është konkluzion i auditit kur veprimtaria financiare e subjektit zgjedhor ka patur një apo më shumë probleme apo shkelje ligjore nga ana e subjektit.

616 Opinioni pa rezervë, është konkluzion i auditit kur veprimtaria financiare e subjektit zgjedhor ka qenë në përputhje me Standartet Kombërate të Kontabilitetit, pra është zhvilluar dhe dokumentuar konform gjithë kuadrit ligjor zgjedhor dhe financiar në fuqi.

617 Raporti i auditimit Partia Kombëtare Konservatore Albania.

618 Formati i auditimit të fushatës zgjedhore

619 Raporti i auditimit Partia Lëvizja e Legalitetit; Raporti i auditimit Partia Socialdemokrate; Raporti i auditimit Fryma e Re Demokratike; Raporti i auditimit Lëvizja për Zhvillim Kombëtar.

620 Raporti i auditimit Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet, auditi ka ngatërruar detajimin e zërave të shpenzimeve; Raporti i auditimit Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë, auditi ka pasaktësi në detajimin e listës së donatorëve dhe detajimin e zërave dhe shpenzimeve përkatëse; Raporti i auditimit Partia Balli Kombëtar ka dorëzuar një raport që nuk është në formatin e miratuar nga KQZ, por auditit nuk e evidenton si problem këtë duke dhënë opinion pa rezervë për partinë.

fuqi përpara ndryshimeve të vitit 2020, e për rrjedhim kontrolli kryhet referuar atyre rregullave[621].

Rastet e pranimit të dhurimeve me vlerë më të madhe se 50.000 lek të kryera *cash*, apo pagesat e faturave me vlerë më të madhe se 150.000 lekë *cash* në disa subjekte zgjedhore, faturat me data përtej muajit prill, nuk janë cilësuar si shkelje të ligjit nga auditët[622].

Pjesa dërrmuese e auditëve nuk përmendin në raportin përkatës auditimin e veprimtarisë financiare të kandidatëve të subjektit përkatës.

Vetëm 2 auditë[623] referojnë probleme lidhur me raportimin e kandidatëve.

Ndonëse një element shumë i rëndësishëm është kryqëzimi i të dhënave të gjetura nga auditi me ato të pasqyruara në raportet e monitorimit nga monitoruesit e fushatës zgjedhore, asnjë audit nuk ka paraqitur në raportin përkatës një krahasim mbi përputhshmërinë e të dhënave të gjetura, duke e evituar si pyetje në shumicën dërrmuese të raporteve, por edhe duke specifikuar se kryqëzimi i të dhënave është i pa mundur[624] apo për subjektin e audituar nuk ka patur raport monitorimi[625].

Sikurse KRIIK është shprehur edhe më herët, procesi i monitorimit në këto zgjedhje dështoi të përmbushte funksionin për të cilin u ngarkua në kuadrin ligjor, konstatim i cili evidentohet edhe nga auditët ligjorë.

Nga shqyrtimi tërësor i raporteve të auditëve ligjorë, konstatohen probleme të evidentura nga auditët lidhur me veprimtarinë financiare të subjekteve zgjedhore dhe konkretisht:

- Partia Socialiste ka tejkaluar kufirin ligjor të shpenzimeve që mund të kryente një subjekt zgjedhor për efekt të fushatës elektorale.
- Për Partinë Kombëtare Konservatore Albania, auditi nuk ka mundur të kryejë auditimin për shkak të mungesës së bashkëpunimit nga ana e këtij subjekti.
- Audituesit të Partisë Demokratike nuk i janë vënë në dispozicion raportet e vetëdeklarimit të kandidatëve të këtij subjekti.
- Balli Kombëtar Demokrat nuk i ka dhënë auditit informacion lidhur me hapjen e llogarisë së posaçme bankare.
- Konstatimi i deklarimeve jo të vërteta lidhur me numrin e zyrave zgjedhore të Partisë Demokratike.
- Mosdeklarim i dhurimit të kohës televizive si dhurim në natyrë tek FRD.
- Për tre subjekte zgjedhore, 2 parti politike dhe një kandidat i pavarur është konstatuar mungesa e dokumentacionit të rregullt tatimor[626].
- Vlera e përllogaritur e dhurimit në natyrë ishte më e ulët se vlera reale e shërbimeve të përfituara prej Partisë Socialiste, konkretisht kontratat e qerasë për zyrat zgjedhore janë lidhur me çmim më të ulët se çmimi i referencës në zonën përkatëse.
- Paraqitje e raporteve me probleme, si mos përfshirje e çdo të ardhure në të duke dorëzuar një raport me deficit[627], mos përfshirje e evidencave të të gjithë donatorëve duke bërë të pamundur verifikimin e identitetit dhe plotësimin e deklaratës mbi konfliktin e interesit[628], apo paraqitja e një raporti jo në formatin e standartizuar duke mos siguruar një pamje të vërtetë të aktivitetit financiar[629].
- Subjekte që nuk kanë hapur llogari të posaçme bankare për kryerjen e aktivitetit financiar në funksion të fushatës zgjedhore[630], apo pavarësisht ekzistencës së kësaj llogarie ka patur shpenzime që nuk janë kryer nëpërmjet saj, por nga llogari të tjera të partisë[631].

621 Raporti i auditimit Partia Lëvizja e Re, Raporti i auditimit Bindja Demokratike, Raporti i auditimit Lëvizja për Ndryshim.

622 Raporti i auditimit Partia Socialiste, Raporti i auditimit Partia Lëvizja e Re, Raporti i auditimit Bindja Demokratike, Raporti i auditimit Lëvizja për Ndryshim, etj.

623 Raporti i auditimit Partia Demokratike e Shqipërisë, Raporti i auditimit Partia Bindja Demokratike.

624 Raporti i auditimit Partia Demokratike.

625 Raporti i auditimit partia Balli Kombëtar Demokrat.

626 Partia Socialiste ka patur raste kur shpenzimet nuk ishin me faturë tatimore, por vetëm me kupon tatimor ose anasjelltas ishte lëshuar faturë tatimore, por mungonte kuponi tatimor. Për subjektin Partia Demokristiane dhe kandidatin Pal Shkambi, u konstatuan shpenzime të kryera pa dokumentacionin përkatës tatimor.

627 Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet nuk ka përfshirë në raportin e saj të ardhurat e gjeneruara nga llogaria tjetër e partisë; Kandidati i pavarur Pal Shkambi nuk ka deklaruar të gjitha të ardhurat në raportin e tij.

628 Kandidati i pavarur Iljaz Shehu.

629 Partia Balli Kombëtar Demokrat.

630 Bindja Demokratike, Partia Socialdemokrate, Partia Demokristiane, Partia Fryma e Re Demokratike, Partia Nisma Thurje, Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar, kandidati i pavarur Pal Shkambi dhe kandidatët e Partisë Agrare Ambjentaliste dhe Partisë Lëvizja e Re, subjekte këto që kanë përfituar të ardhura dhe kryer shpenzime gjatë fushatës elektorale. Përpos tyre edhe subjekte të tjera nuk hapën llogari të posaçme bankare, por nuk kishin asnjë aktivitet financiar në funksion të fushatës: PBDSH, PKD, PLL, PBLD, POSH, PBPPSH, PESH, ADRE, PBK.

631 Partia Demokratike, Partia Socialiste, Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet.

VIII.5. FONDET VJETORE PËR PARTITË POLITIKE

Për vitin 2021 fondi total vjetor i shpërndarë për 6 parti politike sipas përcaktimeve të Ligjit "Për partitë politike"[632] ishte 140.000.000 lekë. Ky fond u shpërnda me vendimin nr. 24 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve[633].

Edhe aktiviteti financiar vjetor i partive politike është subjekt auditimi nga ekspertë kontabël të licencuar, auditët ligjorë, të emëruar dhe kontraktuar nga KQZ. Emërimi i auditëve për fondet vjetore të vitit 2020, u krye nga KQZ me vendimin[634] e datës 12 korrik, pas shtyrjes së këtij procesi në muajin prill 2020.

Sa i përket aktivitetit financiar vjetor partitë politike kanë detyrimin ligjor[635] të dorëzojnë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve raport vetëdeklarimi financiar vjetor. Për vitin 2020 vetëm 25 parti[636] nga 131 të tilla dorëzuan këtë raport në KQZ nga të cilat katër[637] jashtë afatit ligjor[638]. Kjo është një situatë, e cila ka qenë gjithmonë prezente, dhe pavarësisht kësaj sjelljeje të partive politike, KQZ-ja nuk ka ndërmarrë asnjë hap për aplikimin e masave ligjore të parashikuara ndaj partive politike që janë në shkelje të kuadrit të sipërpërmendur ligjor.

Për vetëdeklarimin financiar vjetor të vitit 2020 të padorëzuar në KQZ apo të dorëzuar përtej afateve ligjore, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, vendosi[639] sanksione administrative gjobë për 110 parti politike, 11 prej të cilave ishin pjesëmarrëse në zgjedhjet e datës 25 prill 2021.

KRIIK vlerësoi si një hap pozitiv këtë vendimmarrje në funksion të vendosjes së kulturës së zbatimit të ligjit dhe barazisë përballë tij, me synim ndërgjegjësimin e tyre për përgjegjshmëri më të lartë në raport me ligjin dhe në funksion të transparencës dhe kontrollit financiar.

Kjo vendimmarrje e Komisionerit u ankimua në KAS nga 19 parti politike[640], nëpërmjet 12 kërkesave ankimore.

KAS me vendim të ndërmjetëm[641] përpos pranimit të kërkesës ankimore të partisë Aleanca Demokristiane e Shqipërisë për kundërshtimin e këtij vendimi të Komisionerit, pezulloi shqyrtimin e çdo kërkese tjetër që do të paraqitej me arsyetimin se duke qenë se nga vendimi i Komisionerit cënohen interesat e 110 partive politike, duhet të pritej deri në përfundim të afatit 30-ditor të ankimimit për t'i shqyrtuar bashkërisht të gjitha kërkesat, për shkak se kishin të njëjtin objekt[642].

Pavarësisht se afati përfundimtar i ankimimeve për këtë vendim ishte data 23 gusht 2021, seanca e shqyrtimit të 12 kërkesave ankimore të paraqitura u krye nga KAS në datën 9 shtator 2021.

632 Ligji "Për partitë politike" neni 24.

633 Vendimi nr. 24 datë 02.02.2021 "Për shpërndarjen e fondeve vjetore partive politike në formën e ndihmës financiare vjetore për vitin 2021".

634 Vendim nr. 425 datë 12.07.2021 "Për shpalljen e rezultatit të shortit për emërimin e ekspertëve kontabël të licensuar (audituesit ligjor), të cilët do të kryejnë auditimin e fondeve të përftuara dhe të shpenzuara nga partitë politike për vitin kalendarik 2020".

635 Ligji "Për partitë politike" neni 23.

636 Partia Lëvizja Socialiste për Integrim; Partia Kristian Demokrate; Partia Demokratike e Shqipërisë; Partia Lëvizja Punëtore Shqiptare; Partia SocialDemokrate; Partia Socialiste e Shqipërisë; Partia Bashkimi Liberal Demokrat; Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet; Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut; Partia Lista e Barabartë; Partia Demokracia Sociale; Partia Demokristiane e Shqipërisë; Partia Aleanca Demokratike Shqiptare; Partia Fryma e Re Demokratike; Partia Republikane Shqiptare; Partia Socialiste e Moderuar; Partia Aleanca Popullore; Partia Demokrate për Integrim e Prosperitet; Partia Lëvizja e Re; Partia Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane; Partia Lëvizja për Ndryshim; Partia Lëvizja e Legalitetit; Partia Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen; Partia Zgjidhja; Partia e Gjelbër.

637 Partia Lëvizja e Legalitetit e dorëzoi raportin më datë 18.06.2021; Partia Minoriteti Etnik Grek e dorëzoi raportin më datë 02.04.2021; Partia Zgjidhja e dorëzoi raportin më datë 12.04.2021; Partia e Gjelbër e dorëzoi raportin më datë 31.05.2021.

638 Data 31 mars e çdo viti kalendarik.

639 Vendimi nr. 430 datë 22.07.2021 "Për dorëzimin e raporteve vjetore financiare të partive politike për vitin kalendarik 2020 si dhe sanksionet për mosdorëzimin e tyre".

640 Partia Aleanca Demokristiane, Partia Lëvizja e Legalitetit, Partia Balli Kombëtar, Partia Ora e Shqipërisë, Partia Bashkimi Demokrat, Partia Balli Kombëtar Demokrat, Partia Kombëtare Konservatore Albania, Partia Bashkimi Popullor i Pensionistëve Shqiptar, Partia Demokracia e Re Europiane, Partia Emigracioni Shqiptar, Partia Lëvizja Demokratike e Shqipërisë, Partia Aleanca Maqedonasve për Integrim Europian, Partia Lëvizja Demokratike për Ndryshim, Partia Demokratike e Bashkimit Mysliman Shqiptar, Partia e Gjelbër, Partia e Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen, Partia për Zhvillim Kombëtar, Partia Popullore Kristiandemokrate e Shqipërisë dhe Partia Uniteti Kombëtar.

641 Vendimi nr. 62 datë 26.07.2021 "Për pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 62, paraqitur në KQZ në datën 23.07.2021 plotësuar me nr.62/1, datë 26.07.2021."

642 Vendimi nr.03 datë 06.11.2020 "Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve", Neni 19 pika 1 "KAS përpara ose gjatë shqyrtimit të një ankimi administrativ, vendos shqyrtimin bashkërisht të tij me një ose më shumë ankime të tjera, të paraqitura nga subjekte të ndryshme kundër të njëjtit vendim. ....".

Arsyetimet kryesore të partive politike, lidhur me mos dorëzimin e bilanceve vjetore konsistonin në konfuzionin dhe pamundësitë e krijuara për shkak të pandemisë Covid-19, por edhe në një paqartësi të krijuar lidhur me afatin ligjor për dorëzimin e këtij raporti.
Duke qenë se ligji "Për partitë politike" përcakton vetëm detyrimin e dorëzimit të bilancit dhe jo afatin për dorëzimin e tij, KQZ i referohet një vendimi të vitit 2012[643] dhe analogjisë me legjislacionin tatimor, për përcaktimin si afat përfundimtar të datës 31 mars të çdo viti kalendarik.
KAS, me vendimmarrjen[644] e tij e ndryshoi vendimin e Komisionerit duke zhbërë nisjen për herë të parë të një procesi që fut jo vetëm partitë politike, por edhe vetë KQZ-në në binarët e respektimit të ligjit sa i përket kësaj çështje.

Konkretisht, KAS shfuqizoi sanksionin administrativ për dy parti[645] politike, nuk ndryshoi asgjë për dy parti[646] dhe uli masën e gjobës për 15 subjektet e tjera. Masa e gjobës u ul në nivelin minimal ligjor për 3 subjekte[647], të cilat e dorëzuan raportin financiar pas vendosjes së sanksionit dhe u ul më pak për pjesën tjetër[648].
Masat e sanksionit administrativ të vendosur nga Komisioneri u reduktuan ndjeshëm nga KAS, në më shumë se 90% të vlerës, me arsyetimin se KQZ është hera e parë që ndërmerr një hap ndëshkues për këtë shkelje dhe në parimin që ligji ka funksion edukues e jo ndëshkues.
Në gjykimin e KRIIK kjo vendimmarrje reflekton pabarazi në trajtimin e partive politike, të cilat ishin subjekt sanksionimi nga Komisioneri për të njëjtën shkelje.
Në rast të një qasje parimore prej KAS, për evidentimin e qëllimit edukues të ligjit, edhe për shkak të aplikimit për herë të parë të sanksioneve për këto shkelje sikurse ai arsyeton, do të duhej që ai ta kishte parë e gjykuar çështjen duke patur në konsideratë të gjitha partitë subjekt i vendimmarrjes së Komisionerit.

IX. MEDIA

IX.1. MJEDISI MEDIATIK

Liria e shprehjes parashikohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë si një e drejtë themelore, në përputhje me standardet ndërkombëtare[649]. Kodi Zgjedhor përcakton detyrimet ligjore të mediave audio-vizive përgjatë fushatës zgjedhore, të cilat kanë detyrimin për një pasqyrim të balancuar të aktiviteteve të subjekteve zgjedhore dhe kandidatëve pjesëmarrës në zgjedhje[650]. Detyrimet e mediave audiovizive përfshihen në të njëjtin seksion me fushatën

643 Vendim nr.14, datë 23.11.2012 "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 3, datë 18.01.2012 "Për miratimin e rregullave për formatet e standardizuara për raportimet financiare të partive politike, subjekteve zgjedhore dhe raportimet e kontrollit financiar nga ekspertët kontabël".

644 Vendim nr. 111 datë 09.09.2021 "Për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 62, 63, 64, 65, 66, 67, 68, 69, 70, 71, 72, 73 të partive politike të depozituar në KQZ".

645 Partia Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen e cila faktoi dërgimin me postë brenda afatit ligjor, dhe Partia Lëvizja Demokratike e Shqipërisë e cila ishte themeluar në muajin nëntor 2020 .

646 Partia Lëvizja Legalitetit dhe Partia e Gjelbër, të cilat ishin gjobitur për shkak të dorëzimit të raportit jashtë afatit ligjor.

647 Partia Kombëtare Konservatore Albania, Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar dhe Partia Ora e Shqipërisë, masa e gjobës u reduktua nga 1.000.000 në 50.000 lekë.

648 Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë, Partia Balli Kombëtar, Partia Balli Kombëtar Demokrat, Partia Bashkimi Popullor i Pensionistëve, Partia Demokracia e Re Europiane, Partia Emigracioni Shqiptar, Partia Aleanca Maqedonasve për Integrimin Europian, Partia Lëvizja Demokratike për Ndryshim, Partia Demokratike e Bashkimit Mysliman Shqiptar, Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar, Partia Bindja Demokratike, Partia Popullore Kristian Demokrate e Shqipërisë dhe Partia e Unitetit Kombëtar masa e gjobës u reduktua nga 1.000.000 në 65.000 lekë.

649 Kushtetuta e Shqipërisë, Nenet 22 dhe 23.

650 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 80 "Fushata zgjedhore e subjekteve zgjedhore në radiotelevizionin publik (ndryshuar me ligjin nr.74/2012, datë 19.7.2012), Neni 81 "Edicionet informative të radiotelevizionit publik" (ndryshuar me ligjin nr.74/2012, datë 19.07.2012), Neni 82 "Minutazh falas për KQZ-në", Neni 83 "Orari i transmetimeve", Neni 84 "Fushata zgjedhore në radiot dhe televizionet private" (ndryshuar me ligjin nr.74/2012, datë 19.07.2012, shtuar shkronja "d" e pikës 2, ndryshuar akronimi dhe ndryshuar afati në pikën 10 me ligjin nr. 101/2020, datë 23.7.2020), Neni 84/1 "Mbulimi i fushatës zgjedhore në zgjedhjet vendore" (shtuar me ligjin nr.74/2012, datë 19.07.2012), Neni 85 "Monitorimi i fushatës zgjedhore në media" (ndryshuar fjalia e

zgjedhore[651] dhe disa nga nenet kanë një përbërje të miksuar dhe kundërintuitive[652]. Mediat e tjera, si ato të shkruara dhe online, nuk kanë të përcaktuara detyrime ligjore gjatë fushatës zgjedhore (referuar Kodit Zgjedhor), megjithatë si çdo media përmbajtja e tyre duhet të jetë në përputhje me parimet kushtetuese të lirisë së shprehjes dhe Kodin e Etikës të Gazetarisë[653]. *Kodi Zgjedhor duhet të përfshijë një seksion të dedikuar sjelljes së mediave gjatë periudhës zgjedhore (jo vetëm përgjatë fushatës zgjedhore) duke e shkëputur seksionin e fushatës nga ai i sjelljes së mediave. Kodi duhet të përfshijë detyrimin e të gjitha mediave që operojnë në Republikën e Shqipërisë për të përmbushur parimet e paanësisë dhe informimit objektiv të qytetarëve, dhe jo të kufizohet vetëm tek detyrimet e mediave audiovizive.*

Mjedisi mediatik shqiptar, karakterizohet nga një larmishmëri e mediave tradicionale dhe atyre online. Mediat, si ato tradicionale dhe ato *online* ishin të angazhuara gjerësisht në pasqyrimin e fushatës së parakohshme zgjedhore, asaj zyrtare dhe deri në zyrtarizmin e rezultatit në këto zgjedhje. Por vijoi të mbetej shqetësuese, si një problematike e evidentuar edhe në të shkuarën, mungesa e një qasjeje kritike të shëndetshme e medias ndaj informacionit që transmetohej në publik.

Media audiovizive mbeti sërish pre e transmetimeve të materialeve të gatshme filmike të aktiviteteve elektorale të përgatitura nga partitë politike. Transmetimi i kronikave të gatshme propagandistike zbehu mjaft rolin e medias, si një platformë e raportimit kritik, si dhe funksionin e saj të raportimit të pandikuar.

Në mediat audiovizive munguan debatet në studio mes kandidatëve, pavarësisht numrit të lartë të emisioneve televizivë me karakter politik. Publiku nuk pati mundësinë që të shihte të ballafaquar platformat elektorale nëpërmjet kandidatëve. Edhe pse mungesa e debateve u duk sikur erdhi nga vendimet politike të vetë partive[654], në disa media pati përpjekje pozitive për të shpalosur krah njëra-tjetrës kronika me qëndrimet e kandidatëve për deputetë të subjekteve të ndryshme zgjedhorë.

Aktorët politikë preferuan platformat sociale si mjete më të shpejta dhe të drejtpërdrejta të komunikimit me qytetarët, duke shmangur kërkesën e llogarisë me të cilën do të përballeshin në debatet publike.

Në mediat e shkruara, edhe pse të lira nga detyrimet ligjore, mbetet ende problem pozicionimi dhe paanësia e tyre, mungesa e analizave të thelluara dhe mungesa e ballafaqimit të qëndrimeve të ndryshme për një temë të caktuar.

Për sa iu përket mediave online, roli i të cilave u rrit ndjeshëm përgjatë kësaj periudhe zgjedhore, mbeten ende shqetësuese burimet e tyre të informacionit.

Problematikat me të cilat përballet media dhe gazetari përgjatë punës së përditshme, ndikojnë drejtpërdrejtë në qëndrimin e mbajtur ndaj raportimit politik në vend[655]. Mungesa e një pavarësie financiare, si dhe mos rregullimi me ligj i profesionit të gazetarit, problemet e brendshme të tyre, vënë në rrezik raportin delikat që ka media me politikën dhe lidhjen mes tyre, e cila bëhet edhe më e dukshme përgjatë fushatave elektorale. Baza e brishtë në të cilën ngrihet media shqiptare, në një demokraci ende në tranzicion, bën që aktorët politikë t'a akuzojnë atë si palë të përfshirë, që përdoret në shërbim të partive politike[656].

Sulmet nga drejtuesit e lartë të shtetit ndaj medias janë dhe mbeten një problem shqetë-

parë e pikës 1 dhe shfuqizuar pika 5, me ligjin nr.74/2012, datë 19.07.2012, ndryshuar me ligjin nr. 101/2020, datë 23.7.2020).

651 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Pjesa VI, "Fushata Zgjedhore dhe Media".

652 P.sh., detyrimi për të publikuar së bashku me sondazhet parazgjedhore marxhin e gabimit dhe të tjera detaje teknike, detyrim i cili përfshihet tek detyrimet e subjekteve zgjedhore dhe nuk paraqitet si një detyrim eksplicit edhe për operatorët mediatikë (neni 78, pika 5 i Kodit Zgjedhor).

653 Kodi më i fundit i etikës është hartuar në 2018 nga Instituti Shqiptar i Medias (ISHM) me mbështetjen e Projektit për Riforcimin e Ekspertizës Juridike në Lirinë e Shprehjes dhe të Medias në Evropën Juglindore (JUFREX) – një iniciativë e përbashkët e udhëhequr nga Bashkimi Evropian dhe Këshilli i Evropës (shih Kodi i Etikës së Gazetarit).

654 Drejtuesi politik për Partinë Socialiste për Vlorën, Damian Gjiknuri, në emisionin Breaking në Top Channel (datë 14 prill 2021), diskutoi ftesën që Presidenti Meta i bëri për një debat publik *"Unë jam këtu për popullin. Nëse Presidenti deklarohet se ai është lideri i qarkut të opozitës, unë madje do të shkel edhe rregullin e vendosur nga partia dhe përballem, sepse ne kemi prioritet të takohemi me njerëzit".*

655 Raporti i Parlamentit Europian për vitin 2019-2020 nënvizonte mungesën e progresit në aspektin e lirisë së medias, ndërhyrjet e jashtme, sidomos ato politike, në punën e gazetarit, veçanërisht në gazetarinë investigative, si dhe forcimin e pozitave të gazetarëve në këtë mjedis.

656 Konference për shtyp 10 mars 2021 Presidenti Ilir Meta "*...pronarët e mediave janë nën presion për t'ju nënshtruar regjimit...*".

sues. Kryeministri Edi Rama ka sulmuar në vazhdimësi median duke e cilësuar atë, ndër vitet e qeverisjes së tij, si "kazan mediatik" që mbron interesat personale të pronarëve të tyre[657]. Përveçse kjo mund të ndikojë e t'a detyrojë median që të pozicionohet politikisht *apriori*, krijon edhe një klimë paqartësie e mosbesimi tek qytetarët, duke i perceptuar apo pozicionuar ato si media të pushtetit apo opozitare. Edhe Kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj, u përfshi në debate të herëpashershme me RTV Ora Neës, për shkak të qëndrimit kritik ndaj Bashkisë së Tiranës dhe këtij të fundit në kronikat e transmetuara në këtë media. Kreu i Bashkisë ngriti akuza të forta, ndaj pronarit të këtij subjekti mediatik[658], ndërkohë që nuk munguan as incidentet ndaj gazetarëve të këtij televizioni dhe vetë kreut të bashkisë, të cilat u shënuan edhe përgjatë zgjedhjeve[659].

Kodi Zgjedhor lejon që media të përdorë materiale të gatshme, në rast të një pamundësie për ndjekje me mjetet e saj të aktiviteteve elektorale[660]. Ky nen nuk ndalon në asnjë rast median të jetë prezente në aktivitetet elektorale të çfarëdo lloji, në rast se media kërkon t'a ndjekë dhe mbulojë vetë atë.

Në një pjesë të madhe të aktiviteteve elektorale të zhvilluara, në veçanti nga mazhoranca në pushtet, nuk u lejua një raportim i pavaruar nga mediat. Transmetimi i kronikave ishte ose i servirur gatshëm nga shtabet elektorale të partive, ose nga regjia qendrore e ofruar nga vetë subjekti zgjedhor.

Për të përmbushur misionin e saj për të marrë dhe transmetuar informacion në mënyrë të pavarur, media duhet të ketë sigurinë, të theksuar edhe në Kodin Zgjedhor, që të jetë e lirë të mbulojë çdo aktivitet elektoral në bazë të kapaciteteve të saj dhe sipas interesave dhe lirisë editoriale të saj.

Pavarësisht konflikteve të mundshme mes pronarëve të mediave dhe zyrtarëve të lartë, akuzave të tyre të ndërsjella, apo mospëlqimit prej këtyre zyrtarëve të linjave editoriale kritike të ndjekura nga media të ndryshme, është dhe mbetet i papranueshëm cënimi i integritetit të plotë të gazetarit në vetvete.

Veçanërisht i papranueshëm dhe mjaft i rëndë mbetet cënimi në aspektin e prekjes apo konfrontimit fizik, apo i presionit psikologjik të drejtëpërdrejtë të ushtruar nga zyrtarë të lartë apo përfaqësues të organeve shtetërore, ndërkohë që gazetari është duke përmbushur detyrën dhe misionin e tij për të informuar, sikurse është qëndrimi i përsëritur i Kryetarit të Bashkisë Veliaj apo i Kryeministrit Rama me gazetaren e faxneës[661].

Në këtë linjë ishte dhe vendimi i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar Tiranë, i cili detyronte portalin e lajmeve "Lapsi.al" të dorëzonte serverët e redaksisë për hetime të mëtejshme pas publikimit të lajmit investigativ mbi *databazën* që përmbante të dhënat personale të 910 mijë qytetarëve të Tiranës. Ky vendim cënonte rëndë të drejtën e medias për mbrojtën e burimeve, sidomos kur ato janë të një interesi të lartë publik[662]. Çështja e mbrojtjes së burimit të informacionit, dhe lirisë së shprehjes së medias, ishin

657 Në një postim në Twiter Kryeministri Rama deklaroi: "*Imagjinoni për një moment sikur fëmijëve t'u mësonim se shpifjet, sharjet, hiletë e gënjeshtrat, janë mjete jo vetëm të lejueshme, po edhe të nevojshme për të mundur një kundërshtar! Sot këto mjete po u tregtohen përditë shqiptarëve nga humbësit politikë dhe kazanët mediatikë*". Konferencë për shtyp 2 Mars 2021 Kryeministri Edi Rama: "*E filluam me një shpifje e mbaruam me një shpifje…Kush ka veshë të të dëgjojë, kush ka sy të shikojë, dhe pastaj kush nuk do le të shikojë Syrin, Faxin, Shijakun…shyqyr që ju kemi se i jepni lezet gjithë kësaj telekomedie lajmesh të rreme*".

658 Gjatë një interviste televizive në Tv News 24 Erion Veliaj deklaroi: "…Është shumë shqetësuese, trafikantë droge që janë pronarë televizionesh që kanë ndërruar emra. Kjo është me provë, jo me të dëgjuar…".

659 Mbështetës të Kryetarit të Bashkisë Erion Veliaj, nuk lejuan gazetarin e TV Ora News t'i drejtonte disa pyetje gjatë një takimi të tij me banorët e Kavajës, duke e larguar atë me forcë dhe dhunuar grupin e xhirimit. (Raportim i TV Ora News 14 Prill 2021 "E paprecedentë/ Kavajë mbështetësit e Veliajt dhunojnë gazetarin dhe grupin e xhirimit të Ora"). Pamjet e publikuara në media, treguan shqetësimin e përhershëm të medias, që ka të bëjë me moslejimin e tyre në aktivitete elektorale.

660 Neni 84, i Kodit Zgjedhor Fushata Zgjedhore në televizionet private, pika d "Media audiovizive përgatit lajmet në liri të plotë editoriale. Kur për shkaqe objektive media nuk është në gjendje të ndjekë veprimtari të veçanta zgjedhore, ajo lejohet të shfrytëzojë dhe përzgjedhë pamje filmike nga regjistrimet e plota të servirura nga subjektet zgjedhore, me kushtin që ta shoqërojë lajmin me shënimin "materiali filmik servirur nga subjekti.. ."

661 Gjatë një prononcimi për median në lidhje me vijimin e procesit të vaksinimit më 13 Mars 2021, Kryeministri Rama, i kërkoi gazetares së Fax News, e cila nuk kishte të vendosur maskën mbrojtëse, që të largohej dhe të vendoste një tillë. Kërkesën e tij, në formë urdhërore, Kryeministri Rama e shoqëroi edhe me kontakt fizik, duke e prekur gazetaren dhe shtyrë dorën e saj në shenjë largimi.

662 Drejtuesit e këtij portali e quajtën këtë kërkesë për bllokim si një vendim të drejtuar nga strukturat qeveritare. Raportim i Lapsi.al nga gazetari Armand Shkullaku "*Ne nuk mund të punojmë në redaksinë tonë. Ne përsëri*

dy parimet themelore që i dhanë të drejtë portalit "Lapsi.al", në Gjykatën e Strasburgut për të mos dorëzuar serverët ku ruhen materialet e portalit informativ[663].
Është e rëndësishme që të para*shikohet në legjislacion siguria dhe paprekshmëria e profesionit të gazetarit dhe e të drejtave të tij, për të përmbushur misionin e tij informues në mënyrë të pandikuar nga presionet e jashtme apo edhe të brendshme censuruese të vendosura nga pronarët apo bordet drejtuese.*

IX.2. MEDIA AUDIOVIZIVE

Kodi zgjedhor përcakton detyrimin ligjor për mbulimin e fushatës zgjedhore për mediat audio dhe audiovizive[664]. Autoriteti i Mediave Audiovizive, është institucioni i pavarur kompetent, që mbikëqyr ketë media, në bazë të ligjit për mediat audiovizive, i cili parashikon parimet themelore që përbëjnë bazën e zhvillimit të veprimtarisë audiovizive, përgjatë fushatave elektorale[665].
Me shfuqizimin e grupit *ad hoc* të Bordit të Monitorimit të Medias, që ngrihej nga KQZ-ja për monitorimin e mediave audiovizive gjatë fushatës elektorale, kjo kompetencë i kaloi AMA-s. Ky institucion, që prej vitit 2019 funksionoi me mungesa në bordin e saj, ndërsa fushata zgjedhore gjeti me mandat të përfunduar kryetarin e AMA-s, ndërsa bordi përbëhej vetëm prej katër anëtarësh, nga shtatë që parashikon ligji[666].
AMA ngriti një komision *ad hoc* që do të mbikëqyrte procesin e monitorimit dhe përpunimit të të dhënave përgjatë fushatës zgjedhore. Procesi i monitorimit, u bazua sipas metodologjisë së miratuar nga KQZ-ja, tre muaj përpara nisjes zyrtare të fushatës[667].
Pas shqyrtimit të metodologjisë, të cilat parashikonin matje sasiore dhe cilësore, bordi i AMA, njoftoi se disa nga parashikimet në këtë metodologji nuk mund të përmbusheshin[668]. Monitorimi i AMA-s u bazua thuajse totalisht në të dhëna sasiore (kryesisht numri i minutave të dedikuara një subjekti zgjedhor të caktuar) dhe i munguan elementë cilësorë që do të mundësonin të kuptuarin më të qartë të nivelit të paanshmërisë së mediave dhe cilësisë së

refuzuam oficerëve të policisë gjyqësore të hyjnë në zyrat tona. U thamë: nëse duan të hyjnë në zyrat tona, të shkojnë e t'i shpërthejnë. Ne vet nuk dorëzojmë materiale, sepse e quajmë këtë një dhunim të lirisë së shprehjes. I kërkuam dy ditë kohë të konsultohemi edhe ne me avokatët tanë. Vendimi i gjyqtares na duket i tepruar, sepse duket më tepër i motivuar nga urdhër nga lart se sa nga një hetim i vërtetë nga poshtë. Besojmë që në këtë rast prokuroria nuk po përdoret për qëllimin për të cilin është krijuar, po ashtu edhe Gjykata Speciale" .

663 Njoftimi i Gjykatës së Strasburgut: "Autoritetet duhet të ndalojnë zbatimin e vendimit të ndërmjetëm të Gjykatës së Shkallës së Parë të Specializuar Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar nr. 131 të 18 prillit 2021 dhe të ndalojnë sekuestrimin e çdo pajisjeje për ruajtjen e të dhënave dhe të dhënave kompjuterike / elektronike që u përkasin gazetarëve" (shih, raportim i Lapsi.al *" Gjykata e Strasburgut mbron Lapsi.al. SPAK nuk ka të drejtë ta sekuestrojë*").

664 Neni 85 i Kodit Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë

665 Ligj Nr. 97/2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë". Ndryshuar me Ligjin nr. 22/2016 datë 10.3.2016 Ndryshuar me Vendimin nr. 56 datë 27.07.2016 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë dhe me ligjin nr. 91/2017.

666 Kryetari i AMA-s, dhe një prej anëtarëve vijoi punën me një mandat të përfunduar që prej tetorit të vitit 2019. Ndërkohë ky institucion vinte me një mungesë edhe më herët prej shkarkimit të një prej anëtarëve, ndërsa anëtari i katërt dha dorëheqjen për shkak të kandidimit si deputet në zgjedhjet e 25 Prillit 2021. Zëvendësimi i këtyre vendeve vakante, dhe përzgjedhja e kandidaturave të reja u shty për një kohë të gjatë nga Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik për shkak të mosplotësimit të numrit apo kushteve të parashikuara në nenin 10 të Ligjit Nr. 97/2013 "Për Mediat Audiovizive Në Republikën E Shqipërisë" *(i ndryshuar).* Procedurat për zgjedhjen e kryetarit të AMA-s rinisën pas përfundimit të zgjedhjeve, kur Komisioni Për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, me një Vendim Nr.13/2021, rishpalli vakancën për Kryetar të AMA-s, proces nga i cili u Komisioni përzgjodhi dy kandidatura të cilat u dërguan në Kuvend për miratim. Në seancën e fundit të legjislaturës së këtij parlamenti u miratua edhe kandidatura e kryetarit të AMA-s në datë 7 korrik 2021.

667 Vendim nr. 02, datë 30.01.2021 "Për miratimin e Metodologjisë së Monitorimit të Medias Audio dhe Vizive". Sipas metodologjisë së monitorimit, AMA do të monitoronte çdo ditë OSHMA, të dhënat e të cilave do të përmblidheshin në raporte javore, që kërkonin miratimin nga Bordi Drejtues i AMA-s dhe që shoqëroheshin me sugjerimet përkatesë për marrjen e masave në rast shkeljesh. Këto raporte ditore u dorëzuan në KQZ, duke u publikuar në faqen zyrtare të saj. Raportet javore u shqyrtuan nga Komisioneri i KQZ së bashku me sugjerimet përkatëse në rast shkeljeje nga OSHMA-të gjatë monitorimit.

668 Vendime të Bordit të AMA-s datë 02.02.2021, AMA në këtë mbledhje shqyrtoi vendimin e KQZ "Për Miratimin e Metodologjisë së Monitorimit të medias audio dhe audiovizive" dhe ra dakord të njoftohet KQZ mbi pamundësinë e zbatimit të disa parashikimeve të këtij akti".

informacionit ofruar qytetarëve (si p.sh. konteksti i mbulimit mediatik)[669].
AMA duhet të marrë masa që në të ardhmen mbulimi mediatik të monitorohet si në elementë sasiorë ashtu edhe në elementë cilësorë, të tilla si konteksti apo toni i përdorur nga mediat në mbulimin e fushatës zgjedhore, e të tjerë elementë.
AMA monitoroi në total 53 Ofrues Shërbimi Mediatik Audiovizivë (OSHMA), të cilat u ndanë në dy grupe të veçanta, duke përdorur si kriter përzgjedhje elementin e mbulimit gjeografik dhe duke i kategorizuar ato në OSHMA me mbulim të përhershëm, dhe ato me materiale të regjistruara[670]. Qëllimi i kësaj i ndarje ishte që të gjitha OSHMA të ishin pjesë e monitorimit të mbulimit të fushatës.
AMA, publikoi për çdo javë listën e OSHMA-ve që parashikohen në nenin 6 të metodologjisë[671]. Në këto raporte, u monitoruan koha e transmetimit të secilit subjekt zgjedhor dhe aktor politik, në edicionet informative, transmetimet *live*, emisionet me përmbajtje politike, radha e vendosjes së kandidatëve, si dhe raporti gjinor i mbulimit mediatik të kandidatëve. Raportet ditore të përpiluara nga AMA, u dërguan në KQZ dhe më pas publikoheshin në faqen zyrtare të internetit të këtij të fundit.
Raporteve javore të miratuara nga AMA, u dërguan për t'u shqyrtuar në KQZ me sugjerime për masat administrative përkatëse, në rastet e shkeljeve të konstatuara sipas AMA-s.
Në bazë të gjetjeve në raportet javore, KQZ ishte institucioni i cili mund të merrte masa administrative, në rast shkelje të detyrimeve nga OSHMA-të. Megjithatë Komisioneri shqyrtoi vetëm dy raporte javore brenda periudhës së fushatës zgjedhore[672].
Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, parashikon se në minutazhin politik të edicioneve informative, radiotelevizioni publik është i detyruar të zbatojë raporte kohore të barabarta për të gjitha partitë parlamentare, që në zgjedhjet e fundit për Kuvendin kanë marrë deri në 20 për qind të vendeve në Kuvend. Partitë që kanë marrë më shumë se 20 për qind të vendeve në Kuvend, përfitojnë kohë transmetimi të shpërndarë në mënyrë të barabartë midis tyre. Secila nga këto parti përfiton kohë sa dyfishi i kohës që përfiton një parti që ka marrë deri në 20 për qind të vendeve në Kuvend, ndërsa ky detyrim vlen edhe për subjektet audiovizive dhe audio private.
Në raportin e analizuar nga KRIIK, në lidhje me tabelën përmbledhëse të monitorimit në 30 ditët e fushatës zgjedhore, vuri re se asnjë nga OSHMA-të nuk zbatoi me përpikëri balancat e pasqyrimit të subjekteve zgjedhore[673].
Në raportet javore që AMA i dërgoi KQZ, i tërhoqi vëmendje në mënyrë të përsëritur OSH-

669 Sipas Metodologjisë, Neni 9 "Përmbajtja e raportit të Monitorimit", Pika 2: Raporti i AMA-s brenda kapaciteteve organizative dhe logjistike të saj mund të përmbajë të dhënat cilësore në vijim: a) Numrin e herëve që përdoret një fjalë e caktuar për të përshkruar një politikan të caktuar, b) Numrin e grave kandidate të përmendura në media dhe c) Numri i herëve që përmendet secili aktor politik (si p.sh., një kandidat apo një politikan tjetër)

670 Grupi i monitorimit çdo jave monitoroi 34 OSHMA, nga të cilat 27 kanale (23 TV dhe katër radio) me monitorim te përhershëm nga AMA, ndërsa 26 kanale me mbulim lokal me regjistrim të programacionit të dorëzuar nga këto OSHMA në Autoritetin e Medias Audiovizive. OSHMA të cilat mbulonin mbi 48% të popullsisë në shtrirjen gjeografike, do të ishin në mbulim të përhershëm nga AMA, ndërsa OSHMA mbulonin nën 48% të popullsisë, do të duhet të dërgonin në AMA, materialet e tyre te regjistruara të çdo dite për monitorim.

671 Nenet 6, shkronja "a" dhe 8, të vendimit nr. 2, datë 30.01.2021, të Komisionit Rregullator, "Për miratimin e metodologjisë së monitorimit të medias audio/audiovizive", parashikojnë se OSHMA-të private me shtirje rajonale që mbulojnë më pak se 48 për qind të popullsisë bëhen me përzgjedhje në bazë të mbulimit gjeografik, audiencës, orareve të transmetimit, formatit të përmbajtjes së transmetuar nga OSHMA-të, lloji i medias, audienca e synuar nga kjo lloj media në publik/subjektet politik si dhe OSHMA-të vendore që nuk mbulohet nga mjetet monitoruese janë të detyruara të depozitojnë pranë AMA-s, përmbajtjen e transmetuar në fillim të çdo dite pasardhëse monitoruese.
Vendim Nr.46 i AMA datë 26.03.2021 për Përcaktimin e listës së subjekteve zgjedhore që do të monitorohen për mbulimin e fushatës zgjedhore në datat 26 Mars2021- 03 Prill 2021.
Vendim Nr.52 i AMA datë 06.04.2021 për Përcaktimin e listës së subjekteve zgjedhore që do të monitorohen për mbulimin e fushatës zgjedhore në datat 4 prill 2021- 10 prill 2021.
Vendim Nr.57 i AMA datë 14.042021 për Përcaktimin e listës së subjekteve zgjedhore që do të monitorohen për mbulimin e fushatës zgjedhore në datat 12 Prill 2021- 20 Prill 2021.
Vendim Nr.60 i AMA datë 22.04.2021 për Përcaktimin e listës së subjekteve zgjedhore që do të monitorohen për mbulimin e fushatës zgjedhore në datat 20 Prill 2021- 24 Prill 2021.

672 Vendim nr. 257, datë 21.04.2021 "Për shqyrtimin e raportit të Autoritetit të Medias Audiovizive të pasqyrimit të fushatës zgjedhore nga OSHMA-të për periudhën 04.04.2021 – 11.04.2021".
Vendim nr. 224, datë 13.04.2021 "Për shqyrtimin e raportit të Autoriteti të Medias Audiovizive të pasqyrimit të fushatës zgjedhore nga OSHMA-të për periudhën 26.3.2021 – 3.4.2021".

673 Sipas këtij vëzhgimi vetëm rreth 5% e OSHMA-ve ishin përpjekur të respektonin deri diku balancën e pasqyrimit, mes partive me mbi 20% të vendeve në Kuvend dhe atyre me më pak se 20%. Vëzhgimi evidentoi se këto OSHMA, kanë respektuar me përafërsi minutazhin për dy partitë e mëdha, dhe e kanë respektuar minutazhin për vetëm një parti që ka nën 20% të vendeve në Kuvend të fituara nga zgjedhjet e kaluara.

MA-ve për të kompensuar balancat e pasqyrimit në edicionet informative.
Megjithatë, OSHMA-të e evidentuara, përveçse nuk zbatuan kërkesën e AMA-s, u vu re se diferenca e kompensimit të minutazhit u rrit deri në përfundim të fushatës.

Partia Socialiste, mori një mbulim të konsiderueshëm në minutazh krahasuar me Partinë Demokratike, në rreth 50% të OSHMA-ve. Megjithatë kjo shifër është edhe më lartë, nëse do të llogaritej edhe minutazhi i përcaktuar në tabelat monitoruese si Qeveria. Kjo edhe për faktin, se përgjatë fushatës zgjedhore, KRIIK vuri re se ishte shumë e vështirë të diferencoje një kronike të zyrtarëve të lartë qeveritarë që nuk kishte karakter elektoral[674].
Si në Kodin Zgjedhor, sugjerimet e dërguara nga AMA, por edhe vendimet e KQZ, në asnjë rast nuk përcaktohet një afat kohor per televizionet private, në lidhje me kompensimin e kohës së munguar për një subjekt zgjedhor, në edicionet informative[675].
Pavarësisht, se Kodi parashikon gjoba deri në ndalim transmetimi të sinjalit për mosrespektim të balancave të hapësirës, KQZ nuk ndërmori asnjë hap për OSHMA-të cilat e ripërsëritën këto shkelje[676].
Legjislacioni duhet të përcaktojë qartë afatet e kompensimit të hapësirës së munguar mediatike për një subjekt zgjedhor. Këto afate duhet të kenë efekt të menjëhershme përgjatë periudhës së monitorimit, që të mund të sigurojnë një paanshmëri të mbulimin e aktiviteteve zgjedhore.
Radio Televizioni Publik Shqiptar, i cili ka një detyrim ligjor për të qenë i balancuar, nuk e ruajti balancën e pasqyrimit në edicionet informative[677]. Ndryshe nga OSHMA-të private, për televizionin publik, Kodi përcakton qartë afatet kur duhen kompensuar, në rast mungese, minutazhi mediatik në edicionet informative për subjektet zgjedhore.
Por në asnjë moment përgjatë shqyrtimeve të raporteve javore apo dhe atij final, KQZ nuk mori asnjë masë për shkeljen e ripërsëritur të televizionit publik[678].
Partia Socialiste, e dominoi hapësirën mediatike në edicionet e lajmeve si në OSHMA-të publike, dhe ato kombëtare, sinjali televiziv i të cilave shtrihet në pjesën më të madhe të territorit. Në këtë mënyrë kur pjesa më e madhe e qytetarëve të vendit kanë akses në këto televizione rrjedhimisht u ekspozuan ndaj një informacioni të njëanshëm[679].
Për sa u përket partive që kanë më pak se 20% të vendeve në Kuvend, atyre jo parlamentare dhe kandidatëve të pavarur, shifrat e pasqyrimit nuk ishin në përputhje me zbatimin e Kodit Zgjedhor. Aktivitetet e tyre zunë një hapësirë shumë të vogël në edicionet informative apo emisionet politike, sidomos në televizionet kombëtare. KQZ, në shqyrtimin që i bëri raportit përfundimtar të monitorimit të fushatës zgjedhore, nuk mori asnjë masë administrative ndaj OSHMA-ve në lidhje me këtë shkelje.
Problematika u shfaqën edhe në monitorimin e mediave lokale, të cilat mbulojnë më pak se 48% të popullsisë në vend. Shqyrtimet e raporteve javoreve konstatuan se në mënyrë të përsëritur një pjesë e mediave lokale nuk dorëzuan, sipas detyrimeve, materialet e regjistruara në AMA për monitorim, për disa prej të cilave KQZ mori masa administrative[680].

674 Kryeministri Edi Rama dhe anëtarë të tjerë të kabinetit qeveritare, u shfaqën me shenja identifikuese të fushatës elektorale (si maska apo kapele që mbanin numrin 12) edhe përgjatë evenimenteve të cilat nuk duhet të kishin karakter elektorale.

675 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 84 "Fushata zgjedhore në radiot dhe televizionet private", pika a.

676 Neni 84 në Kodin Zgjedhor në rast të shkeljes së raporteve të pasqyrimit në favor të një partie, KQZ-ja, kryesisht ose me propozimin e KZAZ-ve, e gjobit operatorin radioteleviziv vendor me 1 500 000 lekë dhe operatorin radioteleviziv kombëtar me 3 000 000 lekë.

677 RTSH 1 i kushtoi PS 288,4 minuta, PD, 262,6 minuta, LSI 44,35 minuta dhe PSD 15,07 minuta
RTSH 24 i kushtoi PS 208,45 minuta, PD 128,28 minuta, LSI 18,9 minuta dhe PSD 17,18 minuta
RTSH 2 i kushtoi PS 74,55 minuta, PD 89,92 minuta, LSI 8,98 PSD 7,33 minuta

678 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 81, pika 2 Në rast të shkeljes së raporteve të pasqyrimit në favor të një partie ose të një koalicioni, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve urdhëron reduktimin në të njëjtën masë të kohës në dispozicion të partisë ose koalicionit politik ose kompensimin e partive apo koalicioneve të tjera politike me minutazh shtesë brenda 48 orëve.

679 KRIIK vuri re se tendencat për një pasqyrim të njëanshëm, në favor të aktiviteteve të partisë dhe qeverisë në pushtet, ishin të dukshme edhe përpara fillimit të fushatës zgjedhore, në TV publik dhe ato kombëtarë. KRIIK konstatoi se që prej shtatorit të vitit 2020 deri në mars të 2021, përpara fillimit të fushatës zyrtare, në tabelat e publikuara nga AMA shihet se këto OSHMA, i dhanë më shumë hapësirë mediatike dy partive më të mëdha dhe veçanërisht mazhorancës, ndërsa ishte shumë herë më ulët hapësira mediatike kushtuar partive të tjera parlamentare. (shih tabelat "Monitorimi i përmbajtjeve" Shtator 2022- Shkurt 2021)

680 Ne vendimin Nr.257 më 21 Prill 2021, KQZ vendosi marrjen e masës administrative, me vlerën 5000 (pesë mijë) lekë, pasi nuk kanë depozituar regjistrime për periudhën 4.4.2021 – 11.4.2021, për ofruesit e shërbimit mediatik audioviziv (OSHMA-të): - TV Channel 1, - TV Kopliku, - TV Antena Nord, - TV Klaudiana, - TV Skampa, - TV Jug, - TV Gold, - TV Glob, - TV Puka, - Tv Adria Med.

KRIIK vuri re se kjo shkelje ishte e përsëritur edhe pas marrjes së këtyre masave. Megjithatë KQZ nuk mori asnjë masë ekuivalente, apo përshkallëzim të kësaj mase në rast ripërsëritje të kësaj shkelje. Kjo mangësi nuk tregoi sjelljen reale të këtyre OSHMA-ve ndaj balancës së pasqyrimit të subjekteve, duke qenë se pati mungesa të theksuara në materialet e monitorimit, duke mos dhënë një tablo të qartë me respektimin apo jo të detyrimeve ligjore.
Një fakt i shtuar i cili nuk paraqit sjelljen reale të mediave lokale por edhe paanshmërinë e tyre në përçimin e informacionit, është dhe lidhja mes pronësisë së dhe politikës[681]. E pamundur për të kuptuar kontekstin e raportimit të informacionit në kanalet lokale për shkak të mungesës së monitorimeve cilësore nga AMA, KRIIK nëpërmjet vëzhguesve të saj afatgjatë konstatoi se në publikun lokal në rrethet ku këto kanale operojnë, ka një perceptim të publikut në lidhje me anësinë politike të kanaleve.
KRIIK, sheh si të rëndësishme, përkufizimin dhe detajimin mbi balancën e hapësirës mediatike, duke përfshirë marzhin brenda të cilit minutazhi maksimal në favor të një subjekti politik është i pranueshëm, si dhe një rishikim të masave administrative për OSHMA-të që shkelin këto balanca bazuar mbi diferencat e munguara.
Favorizimi i Partisë Socialiste, u pa gjithashtu edhe në hapësirën që iu dha në reklamat politike. Koha e përgjithshme e transmetimit të reklamave politike gjatë gjithë fushatës zgjedhore nga secila radio dhe televizion privat nuk mund të jetë më shumë se 90 minuta për secilën parti të regjistruar për zgjedhje[682]. Megjithatë, Kodi Zgjedhor përcakton se minutazhi për reklamat politike për partitë joparlamentare dhe kandidatët e pavarur nuk duhet ta tejkalojë kohën prej dhjetë minutash përgjatë gjithë fushatës zgjedhore, si në televizionin private. Ndërsa për televizionin publik, KQZ-ja përcakton minutazh falas për partitë parlamentare prej 30 minutash, ndërsa për ato joparlamentare dhe kandidatë të pavarur jo më shumë se dhjetë minuta[683].
KRIIK e konsideron të rëndësishme mundësinë e barabartë që duhet t'iu jepet subjekteve zgjedhore, apo kandidatëve të pavarur, në hapësirën e reklamave politike në televizionin publik. Më të njëjtin parim, Kodi Zgjedhor duhet t'u japë të gjitha subjekteve zgjedhore, si dhe kandidatëve të pavarur, mundësi të barabarta për të promovuar platformat e tyre në mediat private, duke rritur transparencën e tarifimeve të reklamave politike në këto media.
Vetëm 13 kompani mediatike dorëzuan tarifat e reklamave politike përgjatë fushatës elektorale në KQZ, pavarësisht detyrimit ligjor që ka çdo media audio dhe audiovizive[684]. Nga raportet e AMA-s për reklamat politike rezultojnë se kanë qene 33 OSHMA, të cilat kanë transmetuar reklama politike[685].
Rreth 65% e mediave nuk e zbatuan detyrimin ligjor për të mos kaluar minutazhin maksimal të reklamave përgjatë 30 ditëve të fushatës[686].
Partia Socialiste duket të ketë shpenzuar më shumë në reklamat televizive, pasi në total mbi 50% e mediave i kushtuan më shumë hapësirë Partisë Socialiste, duke përfshirë këtu edhe të tre televizionet kombëtare.
Mbi 50% e mediave private, duke përfshirë edhe tre kombëtarë private, transmetuan më shumë reklama politike në favor të Partisë Socialiste, duke e bërë këtë të fundit të dominojë hapësirën mediatike në këtë aspekt.
Ndërsa rreth 45% e televizioneve i kushtuan hapësirë më të madhe Partisë Demokratike, e cila korrespondon me të njëjtat televizione që i kushtuan kohën më të madhe kësaj partie edhe në edicione informative. Në dy televizione lokale u vu re se dy parti jo parlamentare kishin shpenzuar më shumë në reklama politike, minutazhi i të cilave ishte shumë herë më i lartë se i parashikuar në Kodin Zgjedhor[687].

681 Pronar i TV Bulqiza, Edmond Isaku. ishte në të njëjtën kohë edhe kandidati i Partisë Demokratike. Në raportin e përmbledhës së AMA-s, Tv Bulqiza i ka kushtuar më shumë kohë pasqyrimi në edicionet informative, Partisë Demokratike, edhe pse sipas AMA-s kjo OSHMA në mënyrë të përsëritur ka shkelur ligjin duke transmetuar edicionet informative të një OSHMA-je tjetër.

682 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 84 "Fushata zgjedhore në radiot dhe televizionet private", pika 5.

683 Po aty, Neni 80 "Fushata zgjedhore e subjekteve zgjedhore në radiotelevizionin publik", pika 1.

684 Në këto 13 kompani mediatike përfshihen 15 OSHMA dhe katër media *online*.

685 14 Në KQZ nuk rezultojnë të publikuara tarifat për reklama politike të 14 OSHMA-ve. Të cilat janë televizione lokale që operojnë në vend.

686 REAL TV, 6+1 Vlora, Klan TV, Klan Plus, Klan News, One tv Vlora, Top Channel, Report Tv, News 24, Abc news, Euronews Albania, RTV Ora, Vizion Plus, Syri Tv, Fax News, Top News, Tv Best, Shijak Tv, A2 CNN, Kanali 7, Antena Nord.

687 OSHMA lokale RE.AL transmetoi 702.3 minuta reklamë politike për Partinë Bindja Demokratike.
OSHMA lokale 6+1 Vlora, transmetoi 206.05 minuta reklamë politike për Lëvizja për Ndryshim

KQZ-ja, në mënyrë të përsëritur u tërhoqi vëmendje disa prej OSHMA, përgjatë shqyrtimeve të raporteve javore, për transmetim në orare jo të përcaktuara nga Kodi Zgjedhor të reklamave politike. Gjithashtu disa prej reklamave nuk i plotësonin standardet e kërkuara për identifikimin e tyre dhe përmbajtja e tyre kishte elementë të ç'orientimit për ata që e ndjekin, apo ishin transmetuar jashtë intervaleve kohore të përcaktuara në Kodin Zgjedhor[688]. Megjithatë KQZ nuk mori asnjë masë administrative në lidhje me shkelje te ripërsëritura të gjetjeve të monitorimit të AMA-s.
Mungesa e transparencës financiare të mediave, ngre shqetësimin e financimit të tyre, sidomos në periudha zgjedhore nëpërmjet reklamave politike. KRIIK nëpërmjet vëzhgimeve sporadike vuri re se disa prodhime televizive (emisione, show televiziv) kishin tipare të reklamave politike[689].
Përdorimi i logove, sloganeve apo dhe numrave rendor në fletën e votimit të partive apo kandidatëve për deputetë që marrin pjesë në zgjedhje janë në mënyrë direkte promovim. Mungesa e një përkufizimi të reklamës politike në legjislacion lë hapësirë për abuzim nga ana e medias, por edhe e subjekteve zgjedhore apo aktorëve politikë.
Është e rëndësishme që Kodi Zgjedhor të përcaktojë qartë përkufizimin e reklamave politike, në bazë të cilit AMA të kryejë monitorimet dhe rrisë transparencën nga ana e mediave, sidomos atyre kombëtare.
Përsa i përket heshtjes zgjedhore, mediat e ruajtën parimin e saj një ditë para ditë së votimit. E vetmja masë administrative që KQZ, vendosi gjatë shqyrtimit të raportit përfundimtar të monitorimit ishte shkelja e heshtjes zgjedhore nga OSHMA publike RTSH 2 dhe RTSH Kukës, duke transmetuar kronika mbi aktivitetin e subjekteve politike në fushatë elektorale [690].
Fakti që fushata ishte e centralizuar në konceptin e saj duke u përqendruar vetëm tek liderët e partive politike, u përkthye në shifra edhe në raportet e monitorimit. Në tabelat përmbledhëse minutazhin më të lartë e zë kreu i qeverisë Edi Rama dhe pas tij vjen kreu i PD-së Lulzim Basha[691]. Përqendrimi i hapësirës mediatike vetëm te këto dy figura, i dha shumë pak hapësirë promovimit të kandidatëve dhe platformave të reja, pjesëmarrëse në zgjedhje.
AMA, në monitorimin e minutazhit të e deklarimeve të drejtpërdrejta, raportoi shifra edhe për Presidentin e vendit Ilir Meta. Pavarësisht se metodologjia e miratuar nga KQZ, nuk e përfshin kreun e shtetit në monitorim[692], Presidenti Meta, ishte i treti në radhë për nga minutazhi që mediat i dhanë deklaratave të tij publike[693], duke nxjerrë në pah përfshirjen e tij aktive në këtë proces[694].
Ruajta e raporteve gjinore, ishte gjithashtu një problematikë në pasqyrimin mediatik. Në raportet e AMA, jo të gjithë OSHMA-të zbatuan detyrimin për t'i dhënë hapësirën e nevojshme grave përgjatë fushatës zgjedhore.
Në edicionet informative vetëm 13% minutazhit total të sinkroneve të drejtpërdrejta të kandi-

688 Klan News përgjatë 30 ditëve të fushatës ka transmetuar reklama politike përgjatë edicioneve informative. Top Channel dhe Report TV në datë 23 prill 2021 kanë transmetuar reklama me tipare ç'orientuese për mënyrën e votimit.

689 KRIIK vuri re se në disa prodhime televizive, aktorë politikë do të ishin të ftuar në programe të cilët si qëllim nuk kanë promovim të kandidatëve për deputetë, por argëtimin e publikut. Megjithatë në këto raste, kandidatët do të shfaqeshin në studiot televizive me numrin rendor që subjekti zgjedhor garonte në fletën e votimit (Rasti i Kryeministrit Rama i ftuar në emisionin satirik "Klanifornia", i cili mbante të veshur një kapele me numrin 12) .
Në Top Channel, u transmetua përpara fillimit të fushatës zgjedhore, por edhe përgjatë saj emisioni "Kandidati" i cili sipas prezantimit që vete media i bënte këtij prodhimi televiziv ishte *"Një program që sjell për publikun një profil gjithëpërfshirës të kandidatëve për deputetë për zgjedhjet parlamentare 2021. Do të jemi në të gjithë Shqipërinë, me çdo kandidat që synon të jetë deputet".* Cikli i këtij emisioni politik filloi me promovimin e kandidatit të parë në 4 shkurt 2021 edhe pse listat për deputet u dorëzuan nga partitë politike në 9 mars 2021, ndërsa fushata zgjedhore filloi zyrtarisht në 26 mars 2021. Ndërsa ishte paqartë se si u bë përzgjedhja e kandidatëve që do të promovoheshin, pas fillimit të fushatës zyrtare, aty nuk u ruajtën balancat e përfaqësimit, siç e parashikon Kodi Zgjedhor. Përgjatë serive të këtij emisioni, për disa kandidatë dhe në të njëtën mënyrë, u shfaqën numrat rendorë në të cilët kandidatët ishin të pozicionuar në fletën e votimit.

690 Vendimi i KQZ për "Shqyrtimin e raportit të tabelave përmbledhëse të monitorimit të mbulimit të fushatës zgjedhore nga OSHMA-të për periudhën 26.03.2021 – 23.04.2021, si dhe respektimin e periudhës së heshtjes zgjedhore" vendosi: Marrjen e masës administrative për RTSH, gjobë në vlerën 2 000 000 (dy milion) lekë. RTSH në këtë rast shpjegoi se transmetimi i kronikave në lidhje me aktivitetet elektorale kishte ardhur vetëm si një pakujdesi e ritransmetimit të një materiali të një dite më parë.

691 Kryeministri Edi RAMA 3545,77 minuta, Kreu i Partisë Demokratike Lulzim Basha 2986,17 minuta

692 Metologjia e Monitorimit të Mediave Audiovizive, Neni 6, 7 dhe Neni 9.

693 Presidenti Ilir Meta 1153,04 minuta.

694 Kushtetuta e Shqipërisë në Nenin 86, pika 1 e përkufizon Presidentin e Republikës si "Kryetar i Shtetit që përfaqëson unitetin e popullit", ndaj i si tillë, ai nuk mund të konsiderohet si një aktor politik, në kuptimin e subjektit elektoral.

datëve iu dha kandidateve gra, duke evidentuar kështu shqetësimin se plotësimi i numrave në lista apo vendeve në Kuvend nuk korrespondon me barazinë që u jepet kandidateve gra në hapësirën mediatike.
Shkeljet e përsëritura, edhe pas vendimmarrjes së KQZ, mospërcaktimi i një afati të qartë të kompensimit të minutazhit, ndaj subjekteve zgjedhore, brenda afatit zyrtar të përfundimit të fushatës elektorale, dhe bartja e këtyre shifrave pas mbarimit të saj, tregojnë për një ngërç në funksionimin e mekanizmit të mbikëqyrjes së sjelljes së mediave.
Vendimmarrja për shkeljet e detyrimeve nuk i ka efektet e menjëhershme. Qëllimi i monitorimit është sigurimi i balancave të transmetimeve televizive për subjektet zgjedhore dhe kandidatët në to, vetëm për 30 ditë të fushatës elektorale. Si e tillë edhe vendimmarrja dhe korrigjimi i çdo shkelje nga OSHMA-të duhet të korrespondojë me këtë periudhë, në të cilën qytetari duhet të informohet në mënyrë të balancuar, garant për të cilën janë organet kompetente, AMA dhe KQZ.
Publikut në mënyrë të vazhdueshme iu ofrua e njëjta përmbajtje, për shkak të transmetimit të "kasetave të gatshme", pavarësisht OSHMA-ve të ndjekura. Mungesa e të dhënave cilësore nuk dha një pamje të plotë të sjelljes mediatike ndaj subjekteve dhe kandidatëve në zgjedhje. Tërheqjet e vëmendjes nga AMA, në raportet e saj dhe mungesa e marrjes së masave administrative nga KQZ, nuk e vuri median në presion real për zbatimin e detyrimeve që parashikohen në ligj. Metodologjia e hartuar për monitorimin e mediave, aplikohet vetëm përgjatë fushatës zyrtare, ndërsa raportimet me karakter elektoral kanë qenë të pranishme në media shumë më herët se fillimi i kësaj fushate.
Për të patur një monitorim, i cili të tregojë sjelljen reale të mediave në Shqipëri përgjatë periudhës zgjedhore, është me rëndësi që ai të kryhet në mënyrë të detajuar, të shtrihet më gjatë në kohë, dhe të përfshihen në të elementë të monitorimit cilësor.
*Mekanizmi i monitorimit dhe sanksionimit të sjelljes së mediave duhet të rishikohet në mënyrë që të garantojë që qytetarët të marrin informacion të paanshëm dhe objektiv përgjatë fushatës zgjedhore. KQZ duhet të shqyrtojë raportet e AMA-s me një frekuenc*ë shumë më të shpeshtë dhe të vendosë afate të qarta për kompensimin e minutazhit të munguar.

IX.3. MEDIA E SHKRUAR

Aktualisht, në Shqipëri botohen 11 gazeta me format gjeneralist[695], të cilat pavarësisht rënies së tirazhit mbeten ende një burim i rëndësishëm informacioni. Ndikimi i tyre mbetet ende domethënës, duke shtuar faktin se faqet e para të tyre, lexohen çdo ditë në emisionet e mëngjesit në televizionet shqiptare, por theksohetz gjithashtu se këto gazeta kanë edhe portalin përkatës *online*. Sjellja e medias së shkruar gjatë fushatës zgjedhore nuk rregullohet në Kodin Zgjedhor, megjithatë raportimi i saj duhet t'i përmbahet së pari parimeve të Kushtetutës dhe Kodit të Etikës së Gazetarisë.
KRIIK monitoroi në mënyrë jo-sistematike dhjetë gazeta gjeneraliste përgjatë periudhës Mars-Maj 2021[696]. Monitorimi konsistonte në përcaktimin me përafërsi në përqindje të hapësirës që mbulonin në faqet e gazetave, të emërtuara nga redaksia si "Politikë", të partive politike dhe përfaqësuesve të tyre.[697] Gjithashtu, u krye edhe numërimi i titujve të faqes së parë të çdo gazete, dhe sa prej tyre u kushtoheshin raportimeve mbi zgjedhjet. Në këtë hapësirë u morën për matje vetëm lajmet që i kushtoheshin pasqyrimeve të aktiviteteve me karakter elektoral, apo intervistave të përfaqësuesve politikë në të cilat flitej vetëm për zgjedhjet. Qëllimi i këtij monitorimi ishte për të kuptuar klimën që mbizotëronte në shtypin e shkruar dhe sa prezente ishte fushata parazgjedhore dhe ajo zyrtare në faqen e parë të këtyre gazetave.
Në periudhën përpara fushatës elektorale, nga data 1 Mars - 26 Mars, u vu re se rreth 30% e këtyre gazetave balancoi hapësirën në pasqyrimin për raportimet mbi zgjedhjet të dy forcave

695 1.Panorama 2. Gazeta Shqiptare 3.Mapo 4.Koha Jonë 5.Sot 6.Standard 7.Telegraf 8.Dita 9.Tema 10. Fjala 11.Liberale

696 1.Panorama 2.Fjala (Gazetë e përditshme e pavarur) 3.Dita (E përditshme info-analitike) 4.Koha Jonë (E përditshme e pavarur. *Kjo gazete ndaloi botimin e saj ne versionin print në 1 Korrik 2021*) 5.Gazeta Shqiptare 6.Gazeta Mapo (E përditshme e pavarur) 7.Sot 8.Tema (Gazeta e përditshme) 9. Telegraf (E përditshme e pavarur) 10.Standard (Gazetë e përditshme)

697 Në gazetën Tema dhe Mapo, në mungesë të emërtimit të faqes "Politike", u monitoruan faqet e emërtuara si "Aktualitet". Në gazetën Fjala u përfshinë edhe faqet të emërtuara "Kryesore"

më të mëdha politike PS-PD. Ndërsa rreth 40% e gazetave të mbetura kishin një diferencë me më shumë se 10%, në pasqyrimin e njërës apo tjetrës palë. Rreth 30% e totalit të gazetave të monitoruara, i kushtoi LSI-së hapësirë si pjesë e pasqyrimit të raportimeve zgjedhore, më shumë ose të barabartë krahasuar me dy partitë kryesore.
Ndërkohë rreth 20% e gazetave i kushtuan një hapësirë më të madhe pasqyrimit mbi raportimet të lajmeve me karakter elektoral të Presidentit Ilir Meta. Ndërkohë në total rreth 60% e tyre i kushtuan kreut të shtetit pothuajse të njëjtën hapësirë me partitë kryesore në vend.
Partitë e vogla, pjesëmarrëse në zgjedhje, në total, nuk e kalojnë më shumë se 5% të hapësirës së pasqyrimit të raportimeve me karakter zgjedhor, në faqet e përzgjedhura, ndërsa rreth 30% e totalit të gazetave i kanë kushtuar këtyre partive 0-1.5%.
Rreth 60% e gazetave, i kanë kushtuar më pak se 50% të pasqyrimit mbi raportime të institucioneve të tjera, apo shkrime të brendshme të redaksisë, përfaqësuesve së shoqërisë civile, apo ekspertëve në brendësi të faqeve të emërtuara "Politikë".
Ndërsa përgjatë fushatës elektorale nga 26 Mars - 25 Prill, 40% e gazetave kishin një diferencë me 20% në hapësirën që zë njëra nga dy partitë kryesore në vend[698]. Partia e tretë kryesore në vend LSI, zuri pjesën më të madhe, ose të barabartë të hapësirës në faqet politike, krahasuar me PD dhe PS, në 30% të gazetave[699]. Ndërsa në 70% të tyre ajo zë një hapësirë më pak se 5% të faqeve të politikës.
Për sa i përket partive të tjera opozitare, pjesëmarrëse në zgjedhje, ato ishin shumë pak të përfaqësuara në faqet e politikës së medias së shkruar. Në total partitë e vogla, nuk zunë në asnjë prej gazetave më shumë se 5% të hapësirës së pasqyrimit të aktiviteteve elektorale. Madje në 40% të tyre, hapësira që zë pasqyrimi i aktivitetit apo deklarimeve të Presidentit Meta në lidhje me zgjedhjet, është më i madh ose i barabartë me partitë e vogla.
Faqja e parë e këtyre gazetave, si treguesi kryesor i linjës së tyre editoriale, mori gjithashtu një rëndësi të veçantë përgjatë kësaj periudhe, duke qenë se leximit të tyre i dedikohet kohë në emisionet e mëngjesit në televizione, duke e rritur potencialisht numrin e lexuesve vetëm të faqes së parë të këtyre gazetave.
Përgjatë periudhës përpara nisjes së fushatës zjedhore u konstatua se një pjesë e mirë e titujve të pasqyruar në faqen e parë të këtyre gazetave kishin një karakter të mirëfilltë elektoral.
Gjatë këtij vëzhgimi u konstatua, se 50% gazetave kishin në kryetitull të pasqyruar një subjekt politik apo aktor përfaqësues të tyre. Ndërkohë, 10% e këtyre gazetave, pasqyronin në kryetitull vetëm një forcë politike[700]. U vu re se 30% e këtyre gazetave nuk ishin të balancuara në pasqyrimin e titujve në faqen e parë. Gjithashtu rreth 40%, në kryetitull kishin në një pjesë të konsiderueshme nota negative në pasqyrim[701].
Përgjatë vëzhgimit gjatë fushatës zyrtare, u vërejt se balanca në përzgjedhjen e titujve që kishin të bënin me fushatën elektorale, jo domosdoshmërisht përkonte me balancën në brendësi të faqeve politike të gazetës.
50% e gazetave kishin një vendosje tituj të balancuar në faqen e parë për sa i përket forcave kryesore politike, por në 20% e tyre nuk korresponduan me përmbajtje të balancuar, në brendësi të faqeve politike.
Përgjatë këtij monitorimi u vu re se në faqet e para të gazetës, titujt kryesorë në 60% të gazetave, kishin të bënin drejtpërdrejtë me fushatën elektorale. Në 50% të gazetave të monitoruara, kryetitujt ishin në mbështetje të një force politike, ose kishin nota negative ndaj forcës politike kundërshtare.
Ndërkohë që periudha pas-zgjedhore, me procesin e numërimit dhe atë të ankimimive, u pasqyrua gjerësisht në mediat e shkruara. Qëndrimet e tyre për rezultatin zgjedhor, korrespondoi me qëndrimin e tyre përgjatë periudhës zgjedhore. Rreth 60% e tyre pasqyruan gjerësisht, problematikat dhe denoncimet që ndoqën periudhën pas ditës së zgjedhjeve.
Përgjatë këtij monitorimi KRIIK konstatoi se media e shkruar vijon të mbetet e ndikuar nga lidhjet e ngushta që kanë pronarët e tyre me politikën[702].

698 Gazetat me këtë diferencë ishin: "Dita", "Koha Jonë", "Mapo", "Standard".

699 LSI-ja ishte më e përfaqësuar në këto gazeta: "Koha Jonë", "Standard", "Telegraf".

700 Përgjatë fushatës zyrtare elektorale u vu re se "Gazeta Shqiptare", kishte gjithmonë si kryeartikull një shkrim mbi apo për Partinë Demokratike.

701 "Koha Jonë", "Mapo", "Telegraf" dhe "Standard" në një pjesë së konsiderueshme të titujve që lidheshin me qeverinë kishin tone negative.

702 "Koha Jonë", në pronësi të gazetarit Nikoll Lesi, kaloi vetëm në versionin online në datë 1 korrik, pak pas

Mediat duhet të evitojnë ndikimin e linjës editoriale në paanësinë dhe objektivitetin e informacionit të përçuar, sidomos përgjatë një fushatë elektorale, ku ndjeshmëria e publikut është edhe më e madhe. Media e shkruar, njësoj edhe si media audiovizive duhet të ruajë parimet pasqyrimit të të gjitha palëve.

IX.4. MEDIAT ONLINE

IX.4.1. PORTALET

Autoritet i Komunikimeve Elektronike dhe Postare ose AKEP është autoriteti përgjegjës rregullator për komunikimet elektronike, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9918 datë 19.5.2008 *"Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë"*[703]. AKEP administron *domain*-et që regjistrohen në siglën *.al* dhe nën *domain*-et e tij, ndaj kjo e bën edhe më të vështirë monitorimin e këtyre portaleve, sidomos ato gazetareske, të cilat nuk regjistrohen në këto *domain*-e.
AMA garanton që i autorizuari i mediave elektronike të jetë përgjegjës në lidhje me interesat dhe ndjeshmërinë publike, të respektojë mirëkuptimin dhe bashkekzistencën shoqërore të të gjithë individëve në Republikën e Shqipërisë.
Megjithëse nuk ka ligj të posaçëm për median *online* në vend, parimet kushtetuese të lirisë së shprehjes dhe lirisë së shtypit shtrihen me të drejtat dhe kufizimet edhe tek mediat *online,* sikurse edhe zbatimi i Kodit të Etikës së Gazetarisë.
Ndikimi në rritje e kësaj media të re, rezultoi në përpjekje të njëanshme të qeverisë për të kontrolluar përmbajtjen e saj përmes paketës "*anti-shpifje*"[704]. Sasia e informacionit të publikuar nga mediat *online* në kohë reale e rrit vështirësinë në ndjekjen e burimit të informacionit, por kalimi i këtij ligji dhe shtimi i kompetencës të Këshillit të Ankesave të Autoriteti të Medias Audiovizive për të vlerësuar përmbajtjen e publikimeve të mediave *online* dhe gjobitjen e tyre, duke anashkaluar kështu gjykatat, do të cënonte lirinë e shprehjes dhe gjithashtu do të krijonte edhe klimën e auto censurës tek to.
Objektiviteti, i informacioneve të publikuara në këto portale, përveç se u bë pjesë e debateve politike[705], u konkretizua edhe me kërkesën e autoritetit përgjegjës AKEP, në mbylljen e një prej portaleve më të ndjekura në vend[706].
Përgjatë një vëzhgimi KRIIK vuri re se disa portale lajmesh, sponsorizuan në faqet e tyre të *Facebook*, postime në të cilat promovohej vetëm një kandidat i një partie të caktuar dhe la-

---

përfundimit të zgjedhjeve. Në një editorial të shkuar nga Nikoll Lesi, e cili më pas u ripublikua i ndryshuar, ai shkroi edhe për lidhje dhe marrëveshje të bërë mes politikës dhe publikimit të lajmeve në këtë gazetë. Përgjatë shkrimit të tij Nikoll Lesi foli për raportin mes Presidentit Meta dhe gazetës, ndërsa mbylli shkrimin me fjalinë "Nëse as këta nuk të bindin, të paktën ish-kryeredaktorin e fundit të 30 vjetorit të "Koha Jonë", Qamil Xhani që ta vuri edhe gazetën në dispozicion të LSI gjatë fushatës, natyrisht me lejen time". Kjo fjali më pas do të fshihej nga shkrimi duke e ripublikuar atë të ndryshuar.

703 Ligj Nr.9918, datë 19.5.2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë" ndryshuar me ligjin nr. 102/2012, datë 24.10.2012, nr. 107/2018, datë 20.12.2018, ndryshuar me ligjin nr. 92/2019 datë 18.12.201

704 Qeveria Socialiste ka bërë disa përpjekje për ta rregulluar atë, qoftë përmes ndryshimeve të ligjit "Për tregtinë elektronike", qoftë përmes përpjekjes së fundit për të zgjeruar fushën e veprimtarisë së Autoritetit të Medias Audiovizive mbi mediat *online* nën "paketën "anti-shpifje".
Kjo paketë u kontestua gjerësisht si nga përfaqësues të medias ashtu edhe nga përfaqësia e OSBE, të cilat i kërkuan kryeministrit rishikimin e tij. Parlamenti shqiptar e tërhoqi për rishikim ligjin, edhe pas rikthimit që iu bë atij nga Presidenti në janar të 2020, duke pritur opinionin e Venecias, kërkesë e cila iu dërgua nga Këshilli i Evropës.
Mirëpo edhe pas publikimit të draftraportit nga Komisioni i Venecias se "ligji karakterizohet nga paqartësi dhe mund të ketë një efekt frenues të fjalës së lirë, Kryeministri Rama në një deklaratë në tetor të 2020-ës deklaroi se ky ligj do të kalonte, sepse ishte i konsultuar përreth një vit me OSBE, dhe se në të do të përfshiheshin edhe rekomandimet e Komisionit te Venecias.

705 25 shkurt 2020 Edi Rama në *Twiter* "Fatkeqësisht ky vend në çdo vështirësi a fatkeqësi natyrore ose emergjencë shëndetësore që shfaqet, duhet të përballet dhe me fatkeqësinë e tij të madhe të kanaleve e portaleve ku lulëzon injoranca, ligësia, dembelizmi e grykësia e maskarallëkut që në këto raste bëhet çnjerëzor".
17 shtator 2020 Taulant Balla "Jam i bindur që portali i Shkëlzen Berishës, Syri.Net apo i dhëndrit të Sali Berishës, Jeta është pa qejf, do të kenë shumë arsye për të prodhuar lajme sot dhe se u prek çështja e medias këtu. Shqipëria e ka të domosdoshëm transparencën e pronësisë së medias. Duhet të ketë të publikuar zyrtarisht se kush është pronari. Kush janë gazetarët që shkruajnë lajme *fake*".

706 Drejtoria e Përgjithshme e Policisë i kërkoi AKEP mbylljen e *domain*-eve *"joq.al", "jetaoshqef.al"* dhe *"joqalbania.com"*, me pretendimin se ato kishin shkelur kërkesat e Ligjit nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile", për publikim të lajmeve të rreme në lidhje me tërmetin e 26 nëntorit 2019.

jmet në faqen e tyre përmbanin të njëjtën linjë[707].
Është e rëndësishme që tek portalet, njësoj si mediat audio dhe audiovizive, duhet të monitorohen reklamat politike. *KRIIK e konsiderohen të nevojshëm këtë rregullim për të përmirësuar transparencën e financave të subjekteve zgjedhore, si dhe* për të kuptuar përfitimet monetare që kanë këto media.
Njohja dhe përfshirja e konceptit "media *online*", transparenca në financimet e tyre, vetë ndërgjegjësimi i individëve që janë të punësuar në këto portale, mbi kodet e etikës gazetareske, janë aspekte që do të përmirësonin funksionimin dhe përmbajtjen e informacionit në këto portale.
Konkurrenca e këtyre portaleve për numrin e klikimeve, por edhe paqartësitë në financimet e tyre, duke hedhur shpesh dyshime për lidhje me subjekte politike, bëjnë që informacioni në to të jetë shpesh një burim kontroversial.

IX.4.2. Fushata në platformat e medias sociale.

Mediat sociale, pavarësisht se nuk konsiderohen si media të mirëfillta, kanë marrë një rol shumë të rëndësishëm në zhvillimet politike. Shifrat e larta të përdorimit të *Facebook* në Shqipëri, e bëjnë atë një aset të mirë, për përdorimin e kësaj platforme për qëllime elektorale[708].
Të gjitha subjektet politike dhe kryetarët apo anëtarësia e tyre, ishin aktivë në *Facebook* me postime të cilat morën karakter kryekëput elektoral përpara dhe gjatë fushatës elektorale. Liderët e partive kryesore, por jo vetëm kanë një numër të madh ndjekësish[709] dhe numri i postimeve të tyre, nëpërmjet videove, fotove dhe statuseve të ndryshëm u rrit ndjeshëm që prej dekretimit të datës së zgjedhjeve, e sidomos pas shpalosjes së programeve.
Komunikimi i drejtpërdrejtë me qytetarin, bëri që aktorët politikë të anashkalonin, filtrin e medias tradicionale, duke e zhvilluar këtë komunikim nëpërmjet opsionit "*live*" që ofrojnë këto platforma, të cilat transmetohen direkt më pas edhe nga mediat elektronike, sidomos në event me karakter informativ. Nga ana tjetër kjo formë komunikimi rriti potencialisht mundësitë për dezinformim. Ndjekësve iu ofrua vetëm ajo çka serviret nga aktorët politikë duke mos lejuar një këndvështrim tjetër kritik.
Gjatë para-fushatës elektorale, por edhe asaj zyrtare, partitë politike përdorën në këto platforma, një ndër elementët e saj më të rëndësishëm siç janë *memet*. Postimet me karakter satirik apo denigrues të figurës së kundërshtarit nëpërmjet përpunimit të fotografive dhe videove, ishin disa nga format e përdorimit të fuqisë së imazhit.
Një hap i rëndësishëm që u ndërmor nga *Facebook,* në këtë periudhë zgjedhore ishte dhe formalizimi i reklamave politike, duke ndihmuar në të njëjtën kohë edhe në përllogaritjen e kostove reale që subjektet zgjedhore dhe aktorët politikë shpenzojnë për këto platforma përgjatë fushatave elektorale[710]. Në fillimet e kësaj nisme nga *Facebook*, një sërë reklamash elektorale nuk e kishin të identifikuar burimin e të ardhurave. Për këtë arsye, platforma e këtij rrjeti social, i kufizoi shpërndarjen duke i hequr ato nga *Facebook*.
Si problematike, me përdorimin e këtyre platformave ishte dhe fushata nga palë të treta, nëpërmjet faqeve jo të lidhura drejtpërdrejt me ndonjë parti, së paku në përshkrimin e tyre. Këto faqe postuan vazhdimisht përmbajtje të ngjashme apo të njëjtë me të partive të cilën mbështesnin.

Shqetësim për këto postime, ishin fakti se ato ishin të sponsorizuara, çka përbën një provë të qartë të fushatës nga palë të treta[711]. Faqe të tilla u krijuan pak para fillimit të fushatës ose

707 *Egnatia News* shpenzoi në *Facebook* $423 për promovimin e lajmeve mbi kandidatin e partisë Bindja Demokratike. Albeu.com- shpenzoi ne *Facebook* $641 për promovim vetëm të lajmeve me kontekst negativ ndaj qeverisë. Berati.net, ka shpenzuar në *Facebook* rreth $100, duke promovuar kandidatin e partisë Lëvizja Socialiste për integrim Ardit Cela.

708 Statistikat e statista.com kanë përllogaritur se gjatë fushatës zgjedhore kishte përafërsisht 1.606.000 përdorues të *Facebook* në Shqipëri.

709 Numri i ndjekësve në faqet zyrtare të krerëve të tri partive kryesore në vend deri më 23 mars 2021: Edi Rama 1 505 147 ndjekës, Lulzim Basha 620 023 ndjekës, Monika Kryemadhi 86 412 ndjekës.

710 Subjektet zgjedhore dhe aktorët pjesëmarrës në zgjedhje, apo dhe faqet e tjera të *Facebook*-ut që janë mbështetëse të këtyre subjekteve, dhe që publikojnë reklama elektorale, pra që kanë për qëllim kryerjen e fushatës zgjedhore, që prej 11 Marsit 2021, iu nënshtruan rregullores që *Facebook* implementoi edhe në Shqipëri për reklamat politike. Të gjitha reklamat elektorale dhe politike në Shqipëri duhet të vijnë nga reklamues të autorizuar, duke përfshirë njoftimin "Paguar nga" (*Paid for by*). Çdo reklamues që do të krijojë reklama në lidhje me zgjedhjet ose politikën dhe synon njerëzit në Shqipëri duhet të jetë i autorizuar në vendin ku targeton me këto reklama, si dhe pagesa për këto reklama duhet të vijë nga përdorues i vendosur në Shqipëri. Në rast se *Facebook,* identifikon një reklamë me mesazhe elektorale apo politike dhe shoqërore, e cila nuk ka të identifikuar burimin, atëherë ajo të hiqet nga platforma.

711 Për më shumë shih seksionin e Financave të Fushatës Zgjedhore.

ndryshuan karakterin e tyre të përmbajtjes së mëparshme, me synime të qarta elektorale, duke ngritur pikëpyetje në lidhje me financimin e tyre. Faqet e identifikuara nga KRIIK si fushatë nga palë të treta kanë ndaluar postimet e tyre pak përpara ose menjëhere pas ditës së zgjedhjeve, çka e bën të dukshme qartas se ishin faqe të krijuara me qëllim elektoral.
Rrjetet sociale edhe pse të konsideruara si personale, u përdorën për qëllime publike, jo vetëm nga liderët e partive, por edhe nga çdo kandidat për deputet në këto zgjedhje. Promovimi i veprave infrastrukturore, postimi i fotove në të cilat shfaqen fëmijët pranë kandidatëve për deputetë ishin disa nga shkeljet që u vunë re në këtë fushatë.
E njëjta praktikë publikimi intensiv u ndoq edhe në periudhën e heshtjes zgjedhore, e cila nuk u respektua aspak në platformat sociale.
Thuajse të gjithë subjektet zgjedhorë patën reklama me pagesë në Facebook, të cilat ishin aktive gjatë ditës së shtunë përpara ditës së zgjedhjeve, si dhe në vetë ditën e zgjedhjeve. Moskonsiderimi i këtyre platformave si një media e mirëfilltë dhe mospërfshirja e tyre në detyrimet ligjore, bëri që kandidatët ta përdornin për propagandë politike përgjatë gjithë periudhës zgjedhore.
Përhapja dhe përdorimi i shtuar i këtyre platformave, për qëllime politike, lind nevojën për një diskutim të gjerë e të thelluar për përfshirjen dhe rregullimin e tyre në një kuadër rregullator të të posaçëm përgjatë fushatës zgjedhore.

X. ANKESAT DHE APELIMET

Ankimimet dhe apelimet mbi çështjet zgjedhore ndjekin rrugën administrative ose atë gjyqësore[712]. Pjesët e Kodit Zgjedhor që rregullojnë procesin e ankimimit patën amendime relativisht të konsiderueshme përgjatë procesit reformues të vitit 2020. Ndër ndryshimet kryesore përmendet njohja në mënyrë eksplicite e së drejtës së ankimimit nga të tretë në procesin zgjedhor[713].
Vendimet e Komisionerit dhe të Komisioneve të nivelit të dytë ankimohen në Komisionin e Ankimimeve dhe të Sanksioneve (KAS). Vendimmarrja e KAS, apo mosmarrja vendim brenda afateve ligjore nga ana e tij ankimohet në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit të Tiranë apo pranë Gjykatës Administrative.
Të drejtën e ankimimit e kanë subjektet zgjedhore, partitë politike apo kandidatët, të cilëve iu është refuzuar regjistrimi si subjekte zgjedhore, si dhe subjektet të cilat kanë të drejtën të akreditojnë vëzhgues, për mosakreditimin e tyre.
Ngushtimi i subjekteve që mund të ankimojnë vendimet e trupës së administrimit zgjedhor vetëm në ato subjekte që janë regjistruar si subjekte zgjedhore, apo që iu është refuzuar regjistrimi ngushton efektivitetin e drejtësisë zgjedhore. Ngushtimi i së drejtës justifikohet me ekzistencën e interesit të ligjshëm të ankimuesit. Ndërkohë, për vetë rëndësinë që procesi zgjedhor ka për shoqërinë, si e tërë, çdo individ ka një interes të ligjshëm në këtë proces.
Në periudhën që mbulon ky raport 34 vendime të Komisionerit janë ankimuar në KAS i cili ka vendosur[714] ndryshimin apo shfuqizimin për 17 prej tyre[715].
Ndërkohë, në total KAS shqyrtoi 64 kërkesa ankimore[716] nga 74 kërkesa të paraqitura[717], dhe mori gjithsej 113 vendime,[718] nga të cilat 34 vendime përfundimtare pas shqyrtimit të çështjeve.

712 Shqyrtimi administrativ i ankesave mbi çështjet zgjedhore gjen rregullim në Pjesën 10 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë. Ndërsa përsa i përket shqyrtimit gjyqësor, rregullimi procedural kryhet në Pjesën e 11 të Kodit Zgjedhor.

713 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 124/1, "Ankimi administrativ i palëve të treta".

714 Nga të cilat nëntë vendime lidhen me ankimimet për rezultatin e zgjedhjeve ,shtatë vendime me sanksionet ndaj anëtarëve të disa KZAZ-ve, pra janë më të njëjtin objekt ankimimi.

715 Për më shumë shih Shtojcën M "Kërkesat Ankimore".

716 21 kërkesa janë paraqitur dhe shqyrtuar para ditës së zgjedhjeve dhe 43 pas ditës së zgjedhjeve.

717 Për tetë kërkesa ankimore KAS vendosi moskalimin për shqyrtim për shkak të mangësive në elementet e formës dhe përmbajtjes sipas neni 130 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, ndërsa për dy të tjera pasi i ktheu për plotësim çështja u pushua pasi subjektet ankuese nuk plotësuan dokumentacionin përkatës.

718 Nga të cilat 79 vendime të ndërmjetme në funksion të çështjeve (p.sh., për bashkim të çështjeve, për plotësimin e kritereve për t'u kaluar në shqyrtim të kërkesave ankimore etj.).

Për 17 vendime[719] është ushtruar e drejta e ankimimit në Kolegjin Zgjedhor [720], i cili ka vendosur ndryshimin e plotë të vendimit të KAS për një çështje,[721] dhe pjesërisht për tri çështje.
Vlen të theksohet se anëtarët e trupit gjykues të Kolegjit Zgjedhor në 17 nga 19 çështjet[722] e shqyrtuara kanë votuar në unanimitet. Gjithashtu një vendim u ankimua dhe shqyrtua në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, e cila vendosi ndryshimin e pjesshëm të vendimmarrjes së KAS[723].
Referuar kuadrit ligjor[724], për shkak të tipologjisë së njëjtë të objektit të ankimit apo të ankimit nga subjekte të ndryshme i të njëjtit vendim, KAS mund të bëjë shqyrtimin bashkërisht të këtyre ankimimeve. Këtë procedurë KAS e ka aplikuar në 30 kërkesa ankimore në total[725], për të cilat është konkluduar me 13 vendime përfundimtare shqyrtimi.

X.1. ANKESA DHE APELIME PARA DITËS SË ZGJEDHJEVE

X.1.1 ANKIMIMET E SHQYRTUARA NGA KAS

KAS zhvilloi seancën e parë në datën 18 janar 2021, dhe shqyrtoi 24 ankimime të paraqitura përpara datës së zgjedhjeve, nga të cilat tri nuk u pranuan[726] për shqyrtim.
Ndër çështjet më të rëndësishme të shqyrtuara nga KAS përpara ditës së zgjedhjeve lidheshin me ankimime të vendimeve të Komisionerit për shkelje të parashikuara në Vendimin nr. 9 të Komisionit Rregullator për përdorimin e burimeve shtetërore[727], për numrin e kandidatëve në listën shumëemërore të Koalicionit PD-AN[728], për përmbajtjen e fletës së votimit[729], për shpërndarjen e fondeve publike subjekteve zgjedhore[730], për caktimin e subjektit zgjedhor që do të propozonte anëtarin e katërt të GNV-ve[731], për regjistrimin e listave shumëemërore të Koalicionit Aleanca[732], etj.[733] si dhe vendimmarrja e disa KZAZ-ve për mos akreditimin e vëzhguesve të disa subjekteve zgjedhore[734].

719 Një prej të cilave vendim për "Mospranim për shqyrtim", Vendimi nr. 97, datë 29.06.2021 "Për mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 56, paraqitur në KQZ në datën 28.06.2021".

720 Për vendimin nr. 6 datë 16.02.2021 të KAS Kolegji Zgjedhor ka shpallur moskopetencën dhe çështja është gjykuar nga Gjykata Administrative e cila ka rrëzuar pjesërisht vendimin e KAS.

721 Çështja me subjekt ankues Partinë Socialiste dhe objekt "Shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e listave shumemërore te koalicionit Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim (PD-PR-PDIU-PAA-PBDNJ-PDK-LZHK-PLL-FRD-BLD-PBKD-PBD-PKD), për zgjedhjet për kuvendin të datës 25 prill 2021."

722 Në vendimin nr. 3 datë 29.03.2021 dhe vendimin nr. 8 datë 19.04.2021 votimi ishte katër me një.

723 Për më shumë shih Shtojcën M "Kërkesat Ankimore".

724 Vendim nr. 03 datë 06.11.2020, Komisioni Rregullator, "Për miratimin e rregullores "Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve", Neni 19 pika 1.

725 18 kërkesat ankimore (nr. 33 – nr. 53) që lidheshin me rezultatin zgjedhor për të cilat është konkluduar në nëntë vendime; në shtatë kërkesat ankimore (nr. 25 – nr. 31) të paraqitura nga anëtarët e disa KZAZ për sanksionet e vendosura ndaj tyre nga Komisioneri për të cilat është konkluduar në 2 vendim, në 2 kërkesa ankimore (nr. 1 dhe nr. 2) lidhur me vendimin e Komisionerit nr. 7 datë 14.01.2021 për të cilat është konkluduar në një vendim; në tri kërkesat ankimore (nr. 8, nr. 9 dhe nr. 10) për formën dhe përmbajtjen e fletës së votimit për të cilat është konkluduar në një vendim.

726 Kërkesa ankimore nr. 4 me ankimues znj. Leonora Hyso, Kërkesa ankimore nr. 13 me ankimues Aleanca për Teatrin dhe Kërkesa ankimore nr. 17 me ankimues z. Kastriot Gurra.

727 Kërkesat ankimore nr. 1, ankues z. Arben Qalliu; Kërkesa ankimore nr. 2, ankues partia Lëvizja Socialiste për Integrim; Kërkesa ankimore nr. 3, ankues z. Erjon Veliaj; Kërkesa ankimore nr. 14, ankues Gentian Picari.

728 Kërkesa Ankimore nr. 5 me ankues Koalicionin PD-AN, kishte për objekt vendimmarrjen e Komisionerit për numrin e kandidatëve në listën shumemërore të këtij subjekti zgjedhor, Vendimi 156, datë 18.03.2021.

729 Kërkesat Ankimore Nr. 8 me ankimues Partinë Socialiste, nr. 9 me ankimues partinë Bindja Demokratike dhe nr. 10 me ankimues Koalicionin PD-AN, kishin për objekt miratimin e formatit dhe përmbajtjes së fletës së votimit. Këto tre ankimime të bashkuara në shqyrtim, kishin më konkretisht për objekt identifikimin e kandidatëve në fletë, orientimin e fletës së votimit dhe logon e një subjekti zgjedhor.

730 Kërkesa Ankimore Nr. 7, ankimues Koalicioni ABEOK, kishte për objekt vendimmarrjen e Komisionerit për përcaktimin e fondit publik për subjektet zgjedhore, Vendimi Nr. 13, datë 30.03.2021.

731 Kërkesa Ankimore nr. 11 me ankues partinë PDIU, me objekt caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të grupeve të numërimit të votave, Vendimi nr. 193 datë 31.03.2021.

732 Kërkesa Ankimore nr. 6, ankimues Koalicioni Aleanca me objekt vendimmarrjen e Komisionorit për mosregjistrimin e listës shumemërore të këtij koalicioni, Vendimi nr. 165, datë 18.03.2021.

733 Kërkesa ankimore nr. 58 me ankimues Partinë Demokratike, e cila nuk lidhej me procesin zgjedhor, por me dekriminalizimin.

734 Kërkesa ankimore nr. 15, nr. 16 dhe nr. 24 me ankues Partinë Bindja Demokratike, Kërkesa ankimore nr.18, nr. 19, nr. 20, nr. 21, nr. 22, dhe nr. 23 me ankues partinë Aleanca Demokracia e Re.

Disa nga vendimmarrjet e mësipërme, zhbënë vendimet e Komisionerit, në disa raste duke krijuar precedentë negative, sidomos sa i përket zbatueshmërisë së një prej risive të vendosura në amendimet e fundit të Kodit Zgjedhor, për parandalimin e përdorimit të burimeve shtetërore në fushatë elektorale, por edhe për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit duke konkluduar në një të tillë me numra dhe jo emra në përmbajtje.
Gjithashtu në një panoramë më të gjerë, përtej një vendimmarrje që lidhet me një proces të caktuar zgjedhor, këto vendime të KAS vendosin precedentë për vendimmarrjen e tij në vazhdimësi, jo vetëm në këtë proces zgjedhor por edhe në të ardhmen. Kjo qasje e distancoi KAS nga të qenit pjesë e organeve drejtuese të KQZ-së, e cila ka për detyrim dhe kompetencë të dhënë nga Kodi Zgjedhor vendosjen e sanksioneve për shkelje të ligjit zgjedhor, gjë të cilën KAS nuk e ka marrë fare në konsideratë gjatë tërë shqyrtimeve dhe trajtimeve të kryera.
Përpos kësaj, këto vendime vendosin në pikëpyetje edhe paanshmërinë e kësaj strukture, në frymën e Marrëveshjes së 5 Qershorit për një strukturë të paanshme politikisht. Vendimmarrja në lidhje me këto çështje ka qenë shumicë të thjeshtë (3-2), dhe duket se anësia politike e anëtarëve të KAS ka ndikuar në gjykimin dhe vendimmarrjen e tyre.
Lidhur me kërkesat ankimore për vendimmarrjen e Komisionerit për shpërndarjen e fondit publik subjekte zgjedhore, apo për regjistrimin e listës shumemërore të Koalicionit Aleanca, KAS reflektoi një vendimmarrje në lexim të drejtë të kuadrit ligjor.
Përsa i përket hedhjes poshtë të vendimeve të KZAZ-ve për regjistrimin e vëzhguesve të partive politike, konstatohet se në këtë rast KAS ka ushtruar diskrecionin e vet për të mos ta parë ngushtë parashikimin ligjor dhe afatin e përcaktuar për regjistrimin e vëzhguesve vendas.
Në gjykimin e KRIIK, në përgjithësi KAS tregoi një të lexuar të ngushtë të ligjit, duke anashkaluar frymën e tij. Përkundër këtij vizioni, KAS është fokusuar në germën e ligjit, duke injoruar qëllimin për të cilin normat ekzistojnë.

X.1.2. ANKIMIMET E SHQYRTUARA NGA KOLEGJI ZGJEDHOR

Në Kolegjin Zgjedhor, përpara ditës së zgjedhjeve u ankimuan tetë vendime të KAS. Për një prej tyre Kolegji shpalli moskopetencën dhe ia kaloi çështjen për gjykim Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë[735].
Në 7 vendime të Kolegjit Zgjedhor, për tri padi u vendos rrëzimi i tyre, për tri të tjera pranimi i pjesshëm i padisë dhe vetëm për 1 rast Kolegji vendosi pranimin e plotë të padisë, e për rrjedhim ndryshimin e vendimmarrjes së KAS.

X.2. ANKESA DHE APELIME PAS DITËS SË ZGJEDHJEVE

X.2.1. ANKIMIMET E SHQYRTUARA NGA KAS

Pas përfundimit të procesit të votimit dhe numërimit në KAS u paraqitën 53 kërkesa ankimore por që mund të grupohen në pesë tipologji për shkak të të njëjtit objekt ankimimi. Për shtatë kërkesa u vendos moskalimi për shqyrtim[736].
Konkretisht, ishin ankimimet e anëtarëve të disa KZAZ-ve të cilët ishin gjobitur nga Komisioneri

735 Me vendimin nr. 2 datë 04.03.2021 Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vendosi pushimin e gjykimit të çështjes me nr. 2 Regj. Them., datë regjistrimi 22.02.2021, me palë paditëse Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, palë të paditur Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe person të tretë kryetarin e Bashkisë Tiranë, me objekt: "Ndryshimi i vendimit të datës 16.02.2021 të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve. Në dispozitivin e arsyetimit specifikohet vendimi i shpallur për mungesë kompetence lëndore të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor.

736 Kërkesa ankimore nr. 32 me ankimues z. Tasim Mehmeti; Kërkesa ankimore nr. 45 me ankimues Koalicionin ABEOK; Kërkesa ankimore nr. 47 me ankimues znj. Lediana Fratari; Kërkesa ankimore nr. 50 me ankimues z. Kostaq Papa; Kërkesa ankimore nr. 55 me ankimues Partia Bashkimi Popullor i Pensionistëve Shqiptarë; Kërkesa ankimore nr. 56 me ankimues Koalicionin ABEOK. Për kërkesat ankimore nr. 32 dhe nr. 50 fillimisht u vendos kthimi për plotësim dokumentacioni, por duke mos u realizuar kjo hallkë ankimimet u pushuan pa u shqyrtuar.

gjatë procesit të numërimit[737], ankimimet për kundërshtimin e rezultatit zgjedhor[738], ankimimet[739] për vendimmarrjen e Komisionerit lidhur me denoncimet e bëra prej ankuesve për shkelje që lidhen me vendimin nr. 9 të Komisionit Rregullator, ankimimet[740] për sanksionet administrative të vendosura nga Komisioneri për 110 parti politike lidhur me mospërmbushjen e detyrimit ligjor për dorëzimin e raporteve financiare vjetore për vitin 2020, si dhe ankimimet[741] lidhur me vendimmarrjen mbi rezultatin e procesit të auditimit pas zgjedhor, etj[742].

X.2.1.1. Vendimmarrja për gjobat e anëtarëve të disa KZAZ-ve

Të nesërmen e ditës së zgjedhjeve, Komisioneri vendosi sanksione administrative për anëtarët dhe sekretarët e 17 KZAZ-ve[743], me arsyetimin se pavarësisht detyrimit të përcaktuar në Kodin Zgjedhor[744], kishin numëruar më pak se 50% të QV-ve në juridiksionin e tyre deri në orën 22^{00} të datës 26 prill 2021.
Anëtarët e shtatë prej këtyre KZAZ-ve[745] i ankimuan vendimet e Komisionerit në KAS, i cili pas shqyrtimit bashkërisht të ankimimeve vendosi[746] rrëzimin e vendimit të Komisionerit duke hequr sanksionin administrativ në ngarkim të anëtarëve dhe sekretarëve të KZAZ-ve që bënë ankim, por duke nxitur kulturën e pandëshkueshmërisë tek komisionerët dhe relativizim e kulturës së zbatimit të ligjit prej tyre.

X.2.1.2. Vendimmarrja për kundërshtimin e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve

Proceduralisht, pas miratimit të tabelës përmbledhëse të rezultateve për një zonë zgjedhore me vendim të Komisionerit, kjo vendimmarrje mund të ankimohet në KAS për të kundërshtuar rezultatin përkatës në atë zonë zgjedhore.
Në këtë procedurë, për të kundërshtuar rezultatin e zgjedhjeve u paraqitën në KAS 18 kërkesa ankimore nga 5 subjekte zgjedhore[747] për kundërshtimin e rezultatit të zgjedhjeve në dhjetë zona zgjedhore[748]. Duke bërë bashkimin e disa kërkesave ankimore, për shkak të të njëjtit

737 Kërkesa ankimore nr. 25 me ankimues anëtërët e KZAZ nr. 35, Kërkesa ankimore nr. 26 me ankimues anëtërët e KZAZ nr. 22 , Kërkesa ankimore nr. 27 me ankimues anëtërët e KZAZ nr.66 , Kërkesa ankimore nr. 28 me ankimues anëtërët e KZAZ nr. 38, Kërkesa ankimore nr. 29 me ankimues anëtërët e KZAZ nr. 2 , Kërkesa ankimore nr. 30 me ankimues anëtërët e KZAZ nr. 20, si dhe Kërkesa ankimore nr. 31 me ankimues anëtarët e KZAZ nr. 21.

738 Kërkesat ankimore nr. 33, nr. 34, nr. 35, nr. 46, nr. 48, nr. 49 me ankimues Partinë Lëvizja Socialiste për Integrim; Kërkesat ankimore nr. 36, nr. 37, nr. 38, nr. 39, nr. 40, nr. 41, nr. 42, nr. 43, nr. 44 me ankimues Partinë Demokratike dhe Kërkesat ankimore nr. 51 me ankimues z. Boiken Abazi, nr. 52 me ankues z. Kreshnik Merxhani dhe nr. 53 me ankimues z. Iljaz Shehu.

739 Kërkesat ankimore nr. 59, nr. 60 dhe nr. 61 të paraqitura në KAS nga organizata "Qëndresa Qytetare", Kërkesa Ankimore nr. 74 paraqitur në KAS nga organizata "Instituti Shqiptar i Shkencave" dhe Kërkesa Ankimore nr. 57 me ankimues z. Andi Derhemi.

740 Kërkesat ankimore nr. 62 deri 73 të paraqitura në KAS nga 19 parti politike.

741 Kërkesat ankimore nr. 75, nr. 76, dhe kërkesa ankimore nr. 1 e vitit 2022 për kundërshtimin e vendimit nr. 470 datë 03.12.2021 të komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

742 Kërkesa ankimore nr. 58 me ankimues Partinë Demokratike dhe object Kundërshtimi i vendimit nr. 422, datë 02.07.2021 të KSHZ-së "Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme për kryetarin e Bashkisë Mallakastër".

743 KZAZ nr. 20, KZAZ nr. 66, KZAZ nr. 21, KZAZ nr. 22, KZAZ nr. 24, KZAZ nr. 69, KZAZ nr. 70, KZAZ nr. 2, KZAZ nr. 29, KZAZ nr. 34, KZAZ nr. 35, KZAZ nr. 37, KZAZ nr. 38, KZAZ nr. 39, KZAZ nr. 64, KZAZ nr. 41 dhe KZAZ nr. 42.

744 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 119, pika 5, përcakton se procesi i numërimit vazhdon në mënyrë të pandërprerë deri në numërimin e të gjitha kutive të pranuara të rregullta nga ana e KZAZ-së. Procesi i numërimit ndërpritet me vendim të KZAZ-së, vetëm për shkaqe që nuk varen nga administrata zgjedhore dhe që pengojnë procesin normal të numërimit. Referuar nenit 122, pika 1, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, në të cilin përcaktohet se Tabela përmbledhëse e rezultati të zgjedhjeve për zonën e administrimit zgjedhor nxirret nga KZAZ-ja jo më vonë se ora 22:00 e ditës së nesërme të votimit.

745 KZAZ nr. 20, KZAZ nr. 21, KZAZ nr. 2, KZAZ nr. 38, KZAZ nr. 66, KZAZ nr. 22 dhe KZAZ nr. 35.

746 Vendimi nr. 55 datë 5.05.2021, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve "Për shqyrtimin e kërkesave ankimore nr. 27, nr. 28, nr. 29, nr. 30 dhe nr. 31".

747 Partia Demokratike ankimoi rezultatin e zgjedhjeve për nëntë zona zgjedhore, partia Lëvizja Socialiste për Integrim për gjashtë zona zgjedhore, dhe kandidatët e pavarur z. Boiken Abazi, z. Kreshnik Merxhani dhe z. Iljaz Shehu të cilët ankimuan rezultatin për nga një zonë zgjedhore respektivisht aty ku garuan.

748 Në përfundim u shqyrtuan nga KAS vetëm nëntë zona zgjedhore, pasi kandidati i pavarur z. Iljaz Shehu u tërhoq nga ankimimi i tij për kundërshtimin e rezultatit të zgjedhjeve në Qarkun Lezhë.

objekt, KAS mori 9 vendime përfundimtare, të cilat i referoheshin 9 zonave zgjedhore.
Duke patur jo vetëm të njëjtin objekt, por edhe të njëjtat pretendime nga ankuesit për secilën zonë vendimmarrja ishte e njëjtë, me përjashtime shumë të vogla, sidomos për zonat zgjedhore Qarku Berat dhe Qarku Durrës ku ishte kërkuar edhe ri numërim.
Në rezultante u vërejt se KAS pati një qasje të njëanshme në tërësinë e trajtimit të çështjeve, duke mos mbështetur hetimin e fakteve dhe rrethanave plotësuese të cilat do të qartësonin pretendimet e paraqitura. Veçanërisht sjellja e anëtarëve të mbështetur e propozuar nga mazhoranca në KAS ishte në bllok në pothuaj të gjitha çështjet e trajtuara me tendencën për t'i rrëzuar pretendimet e paraqitura, por në disa raste edhe për t'i ridikulizuar ato apo relativizuar përmbajtjen e tyre.

X.2.1.3. Ankimimet në lidhje me Vendimin nr. 9 të Komisionit Rregullator

Sa i përket katër kërkesave ankimore, në objekt të të cilave kundërshtoheshin katër vendime të Komisionerit që lidheshin me zbatueshmërinë e Vendimit nr. 9 të Komisionit Rregullator, KAS rrëzoi vetëm një prej tyre.
Për tre kërkesat e tjera vendimmarrja e Komisionerit ju kthye për ri shqyrtim këtij të fundit, pasi, sipas gjykimit të KAS, kishte nevojë për një hetim më të thelluar. Të treja çështjet vijojnë të jënë në shqyrtim nga Komisioneri dhe nuk ka ende një vendim përfundimtar.

X.2.1.4. Vendimmarrja lidhur me sanksionet ndaj partive politike

KQZ-ja nëpërmjet vendimmarrjes së Komisionerit[749] për herë të parë sanksionoi 110 parti politike, të cilat nuk kishin përmbushur detyrimin ligjor të dorëzimit të pasqyrave financiare vjetore pranë KQZ-së, duke përfshirë edhe partitë, të cilat e kishin kryer këtë detyrim jashtë afatit ligjor[750]. Vlen të theksohet, se kjo vendimmarrje ishte një hap pozitiv për ndërgjegjësimin e partive politike mbi detyrimet e tyre nëpërmjet dhënies fund të kulturës së pandëshkueshmërisë në rastet e mosrespektimit të ligjit.
Edhe në këtë vendimmarrje, pas shqyrtimit të ankimimeve nga disa prej partive të gjobitura, KAS-i zhbëri këtë hap të Komisionerit, duke ndryshuar vendimin e këtij të fundit.

X.2.2. ANKIMIMET E SHQYRTUARA NGA KOLEGJI ZGJEDHOR

Pas vendimmarrjes së KAS lidhur me ankimimet për rezultatin e zgjedhjeve për 9 zona zgjedhore, të gjitha këto vendime u ankimuan në Kolegjin Zgjedhor, i cili nëpërmjet votimit unanim në ccdo rast, rrëzoi paditë dhe la në fuqi vendimmarrjen e KAS.
Përgjithësisht evidentohet një trajtim dhe qëndrim i ngjashëm i trupës së kolegjit me atë të KAS, duke treguar në disa raste anësi dhe diskrecion në funksion të përmbylljes dhe kaparosjes së shqetësimeve dhe problematikave të pretenduara, apo të hasuara.

XI. INSTITUCIONE TË TJERA QË KANË ROL NË PROCESIN ZGJEDHOR

XI.1. MINISTRIA E BRENDSHME

Ministria e Brendshme është një nga institucionet që ka një rol shumë të rëndësishëm në procesin zgjedhor, jo vetëm në kuadër të garantimit të sigurisë publike dhe mbarëvajtjes në tërësi të procesit, por edhe në procesin e hartimit dhe saktësimit të listave të zgjedhësve.
Katër ditë pas dekretimit të datës së zgjedhjeve prej Presidentit të Republikës, në datë 10 shtator 2020, Ministri i Brendshëm nxori Udhëzimin përkatës për hartimin e listave të zgjed-

749 Vendim nr. 430 datë 22.07.2021 "Për dorëzimin e raporteve vjetore financiare të partive politike për vitin kalendarik 2020, si edhe sanksionet për mosdorëzimin e tyre".

750 Për më shumë shih pjesën VIII "Financimi i partive politike"

hësve"[751]. Bazuar në këtë Udhëzim, Zyrat e Gjendjes Civile (ZGJC) në bashkëpunim me bashkitë ndërmorën procesin e verifikimit, saktësimit dhe publikimit ciklik të listave të zgjedhësve, deri në publikimin e ekstraktit përfundimtar në datën 16 mars 2021.
Përpos këtij procesi, Ministria e Brendshme, nëpërmjet Drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile (DPGJC) ndërmori një aktivitet të shtuar për sensibilizimin e qytetarëve për të aplikuar për rinovimin e dokumenteve të identifikimit, ndikuar kjo nga numri i lartë i qytetarëve të cilëve iu kishte skaduar ky dokument.
Një moment shumë i rëndësishëm në tërë procesin zgjedhor është njoftimi me shkrim i qytetarëve për adresën e qendrës përkatëse të votimit.
Për realizimin e këtij procesi, kuadri ligjor ngarkon bashkitë nëpërmjet fondit të shpërndarë nga Ministria e Brendshme. Sikurse edhe në proceset e mëparshme, edhe në këtë proces rezultoi se Ministri i Brendshëm nuk përmbushi plotësisht kërkesat e Kodit Zgjedhor. Konkretisht, ky Udhëzim nuk parashikon një mekanizëm raportimi nga ana e kryetarëve të bashkive lidhur me ecurinë e njoftimit me shkrim të zgjedhësve nga ana e tyre. Gjithashtu modeli i njoftimit me shkrim të miratuar nuk përmbante hapësirë të dedikuar për t'u firmosur nga qytetari që njoftohet sikundër kërkohet nga Kodi Zgjedhor. Fondi për bashkitë, për realizimin e këtij procesi u shpërnda me vonesë dhe nuk pati asnjë mekanizëm kontrolli për shpenzimin e tij. Edhe pas përfundimit të procesit rezulton se Ministria e Brendshme nuk ka një informacion zyrtar lidhur me realizimin e procesit të njoftimit me shkrim të zgjedhësve.
DPGJC-ja, në dhjetor 2019 nisi procesin e përditësimit apo migrimit të adresave të shtetasve në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGJC). Baza ligjore për realizimin e tij nuk është bërë asnjëherë publike nga DPGJC edhe pas kërkesave zyrtare të vazhdueshme nga KRIIK. Në përgjigje të këtyre kërkesave është pohuar vetëm verbalisht prej zyrtarëve të kësaj drejtorie se ka një urdhër të Ministrit të Brendshëm në bazë të të cilit realizohet procesi por pa saktësuar konkretisht bazën ligjore mbi të cilin është marrë ky urdhër dhe pa e vënë në dispozicion atë. Gjithashtu është pohuar se projekti "Popullimi" i realizuar në vitet 2016-2017, është realizua nga Operatori për Shpërndarjen e Energjisë Elektrike (OSHEE) në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme dhe kishte synim identifikimin e adresës reale të shtetasve, proces ky i shumëdiskutuar publikisht për mungesën e transparencës dhe një sërë elementësh të tjerë. Janë këto të dhëna që janë përdorur për saktësimin e adresës së shtetasve duke bërë lëvizjet përkatëse në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, për administrimin dhe përgjegjësinë e në cilësinë e administratorit, ngrihen pikëpyetje nga ana formale e përgjegjësisë dhe kompetencës.
Pavarësisht situatës së sipërpërmendur, qytetarët që nuk ishin paraqitur pranë Zyrave të Gjendjes Civile për të konfirmuar ndryshimin e adresës, pas ndryshimeve të bëra në adresën e tyre sipas të dhënave të projektit "Popullimi" të reflektuara tashmë në RKGJC, mund të votonin në qendrat e votimit ku kishin votuar në zgjedhjet pararendëse.
Gjithë sa më sipër, por edhe referuar komunikimit verbal me zyrtarë të DPGJC, rezultoi se një situatë e paqartë lidhur me ecurinë e gjenerimit dhe hartimit të listës së zgjedhësve dhe saktësimit të adresave, duke iu referuar e punuar paralelisht dy bazave të të dhënave të ndryshme të RKGJC-së për vendbanimin e shtetasve, çka bie në kundërshtim me kuadrin ligjor[752] parashikimeve të tij për gjenerim automatik të listës së zgjedhësve prej RKGJC-së.

XI.2. PREFEKTURAT

Në zbatim të kuadrit ligjor[753] dhe në përmbushje të detyrave të ngarkuara lidhur me procesin zgjedhor, prefektët propozojnë objektet në nivel qarku, të cilat do të shërbejnë si Vende të Numërimit të Votave (VNV).
Nga kontakti i vëzhguesve të KRIIK me 12 Prefekturat, rezultoi që tri[754] prej tyre nuk e respektuan afatin ligjor[755] për dorëzimin e propozimeve të adresave që mund të shërbenin si vende të numërimit të votave.

751 Udhëzim nr. 298 datë 10.09.2020, "Për procedurat e hartimit të listave të zgjedhësve për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë".

752 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 47, "Përputhshmëria me RKGjC-në".

753 Ligji nr. 107/2016, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, "Për Prefektin e Qarkut".

754 Propozimi i Prefektit të Qarkut Lezhë depozituar në KQZ me shkresën nr. 171/3 datë 26.02.2021; Propozimi i Prefektit të Qarkut Tiranë depozituar në KQZ me shkresën nr. 268/3 datë 9 mars 2021; Propozimi i Prefektit të Qarkut Korçë depozituar në KQZ me shkresën nr. 296/1 datë 18.03.2021.

755 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 94, "Vendndodhja dhe përgatitja e Vendeve të Numërimit të Votave", pika 1.

XI.3. NJËSITË E QEVERISJES VENDORE

Bashkitë, si Njësi të Qeverisjes Vendore, përfshihen në procesin zgjedhor nëpërmjet përcaktimit të qendrave të votimit në ambiente të përshtatshme sipas kritereve ligjore brenda territorit përkatës, publikimit të listave të zgjedhësve, njoftimit me shkrim të zgjedhësve, si dhe vendimmarrjes për vendet e lejuara për afishimin e materialeve propagandistike gjatë fushatës elektorale.
Sa i përket përcaktimit të adresave të qendrave të votimit, ishte një proces që, në ndryshim nga zgjedhjet pararendëse, u kushtëzua edhe nga ndryshimet e Kodit Zgjedhor për shkrirjen e QV-ve me më pak se 300 zgjedhës, procesi i cili u realizua përgjatë gjithë kohës së publikimit të ekstrakteve zgjedhorë dhe përfundoi me publikimin e listës përfundimtare të zgjedhësve.
Publikimi i ekstrakteve të përbërësve zgjedhorë, apo listave të zgjedhësve në mënyrë ciklike çdo 30 ditë, duke filluar nga data 6 tetor 2020, pati problematika të publikimit me vonesë apo edhe të mosafishimit fare në ambiente publike të ndonjë prej ekstrakteve[756], sikurse parashikon kuadri ligjor.
Njoftimi me shkrim i zgjedhësve rezultoi të ishte sërish një proces i realizuar në mënyrë të pjesshme nga bashkitë, madje edhe në ato Bashki dhe elementë ku u realizua ishte në tejkalim të afateve ligjore[757].
Raportimi në KQZ dhe Ministrinë e Brendshme lidhur me ecurinë e këtij procesi rezultoi sërish një proces thuajse i parealizuar[758].
Lidhur me vendimin për afishimin e materialeve propagandistike, edhe ky rezultoi të ishte një detyrim i përmbushur në mënyrë të pjesshme nga disa bashki[759].
Evidentohet shqetësues angazhimi i të gjithë Kryetarëve të Bashkive në vend në fushatën zgjedhore, në shumë si drejtues politik të Partisë Socialiste në qarqet përkatëse, si dhe i administratës lokale në varësi të këtyre bashkive.
Situata e mësipërme duhet t'i nënshtrohet një diskutimi të gjithëanshëm, të thelluar si dhe ka nevojë për një rregullim të detajuar e të plotë ligjor. Kjo për të siguruar paanësinë e funnksionimit të institucionit shtetëror, si dhe sjelljen ligjore e institucionale të duhur të institucioneve të qeverisjes lokale në vazhdimësi e veçanërisht përgjatë fushatave zgjedhore. Kryetarët e Bashkive pavarësisht se janë të propozuar nga një parti politike, pas zgjedhjes së tyre si Qytetarë të Parë të Komunitetit të asaj Bashkie, nuk mund të sillen si militantë politikë as me prezencën e tyre publike, e jo më në ushtrim të funksioneve dhe përgjegjsive publike të marra përsipër.

XI.4. POLICIA

Policia e Shtetit i ushtron detyrat e veta në shërbim të zgjedhjeve në përputhje me parashikimet e Kodit Zgjedhor, në paanshmëri të plotë ndaj subjekteve zgjedhore, dhe në përputhje me Ligjin 108/2014[760] "Për Policinë e Shtetit".
Policia e Shtetit kryen detyra të rëndësisë së veçantë gjatë fushatës zgjedhore, ditën e zgjedhjeve, gjatë numërimit të votave dhe nxjerrjes së rezultatit të zgjedhjeve, duke garantuar organizimin dhe administrimin e qetë të procesit zgjedhor, rendin dhe zhvillimin e qetë të votimit ditën e zgjedhjeve dhe gjatë numërimit të votave.
Ndryshimet e Kodit Zgjedhor me Ligjin 101/2020, shtuan detyrat dhe përgjegjësitë për Policinë e Shtetit gjatë veprimtarisë në shërbim të zgjedhjeve. Përpos detyrimeve të ruajtjes së ambienteve ku ishin të vendosura komisionet zgjedhore, policia ishte e ngarkuar edhe me zbatimin e përcaktimeve të nenit 79 të Kodit Zgjedhor për përdorimin dhe afishimin e materialeve propagandistike nga subjektet zgjedhore. Periudha e angazhimit të policisë në zgjedhje fillon më së paku katër muaj para ditës së zgjedhjeve.
Në funksion të caktimit të rregullave organizative të funksionimit të Policisë dhe koordinimit të

756 Për më shumë shih pjesën "Regjistrimi i zgjedhësve" / "Publikimi ciklik i listave të zgjedhësve".
757 Për më shumë shih pjesën "Regjistrimi i zgjedhësve" / "Njoftimi me shkrim i zgjedhësve".
758 Në KQZ raportuan vetëm gjashtë bashki, ndërsa në Ministrinë e Brendshme asnjë prej tyre.
759 Për më shumë shih pjesën "Fushata zgjedhore" / "Materialet propagandistike".
760 Ligji nr. 108/2014, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë "Për Policinë e Shtetit".

saj me KQZ, Komisioni Rregullator miratoi Vendimin nr. 12, datë 30.12.2020[761].
Punonjësit e Policisë së Shtetit, në të gjitha Drejtoritë Vendore të Policisë u trajnuan lidhur me rolin dhe detyrat e Policisë së Shtetit në zgjedhjet e datës 25 prill 2021, gjatë muajve shkurt dhe mars 2021.
Në shkallë vendi nga strukturat e Policisë së Shtetit janë evidentuar dhe referuar në prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, ose sipas kompetencës, në Prokuroritë pranë Gjykatave të Rrethit 57 vepra penale[762] që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve sipas parashikimeve të Kodit Penal[763]. 52 nga këto referime janë bërë nga 12 nga strukturat vendore të policive në nivel qarku[764] ndërsa 5 nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit. Vlen të theksohet se qarku me numrin më të lartë të veprave penale të referuara në Prokurori është Durrësi ndërsa ai me numrin më të vogël Korça.
Përpos sa më sipër, Policia e Shtetit ka qenë në vazhdimësi e angazhuar edhe për kontrollet në funksion të zbatimit të masave anti-covid, sipas urdhrave të ndryshëm të nxjerrë nga Ministria e Shëndetësisë. Një prej tyre[765], më i rëndësishmi në kohën e fushatës elektorale, ishte ndalimi për grumbullime të më shumë se dhjetë personave. Pavarësisht këtij urdhri partitë politike i mblodhën mbështetësit dhe simpatizantët e tyre në evente apo tubime, dhe takimet në shkelje të këtyre masave ishin dukshëm prezentë, jo vetëm nga evidentimet në terren, por edhe nga të gjitha raportimet mediatike apo publikimet në rrjetet sociale.
Qëndrimi i Policisë së Shtetit në funksion të vendosjes së sanksioneve për mos respektimin e këtyre rregullave ishte evaziv dhe jo i njëjtë për të gjithë kandidatët apo përfaqësuesit e forcave politike që organizuan takime në shkelje të këtyre masave shtrënguese.
U ndëshkuan me sanksion administrativ gjobë 7 kandidatë[766] për deputetë, një kandidat i Partisë Socialiste, tre kandidatë të Partisë Demokratike, një kandidat i partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, një kandidat i partisë Lëvizja e Re dhe një kandidat i pavarur.

XI.5. PROKURORIA

Veprat penale që lidhen me procesin zgjedhor parashikohen në Kreun X të Kodit Penal[767], pjesë e cila u ndryshua me ndryshimet e miratuara në dhjetor të vitit 2020[768]. Gjithashtu ligji nr. 148/2020[769] përcaktoi detyrimin e Prokurorit të Përgjithshëm dhe Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, sipas juridiksionit përkatës, t'i japin KQZ-së informacion për hetimin e veprave penale në fushën e zgjedhjeve, që nuk cënon ruajtjen e sekretit hetimor sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Penale.
Në proceset e mëparshme zgjedhore, në funksion të koordinimit dhe bashkëpunimit, nënshkrimi i një marrëveshje paraprake ndërmjet Prokurorisë së Përgjithshme dhe Komisionit

761 Vendim nr. 12, datë 30.12.2020, Komisioni Rregullator "Për miratimin e rregullave të veprimtarisë së Policisë së Shtetit në shërbim të zgjedhjeve".

762 Konkretisht, referimet janë bërë për vepra penale që parashikohen në nenet: Neni 325 "Pengimi i subjekteve zgjedhore", Neni 326 "Falsifikimi i materialit zgjedhor dhe rezultateve të zgjedhjeve", Neni 327 "Shkelja e fshehtësisë së votimit", Neni 328 "Korrupsioni aktiv në zgjedhje", Neni 328/a "Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore", Neni 328/b "Korrupsioni pasiv në zgjedhje", Neni 329 "Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje", Neni 330 "Pengimi i zgjedhësit", Neni 331/a "Marrja ose përdormi i paligjshëm i dokumenteve të identifikimit", Neni 248 "Shpërdorimi i detyrës", Neni 261 "Pengimi në ushtrimin e të drejtës për t'u shprehur, grumbulluar apo manifestuar, Neni 262 "Organizimi dhe pjesëmarrja në grumbullime e manifestime të paligjshme".

763 Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë Kreu X, "Vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve".

764 Qarku Berat, pesë vepra penale; Qarku Dibër, dy vepra penale; Qarku Durrës, shtatë vepra penale; Qarku Elbasan, gjashtë vepra penale; Qarku Fier, tri vepra penale; Qarku Gjirokastër, katër vepra penale; Qarku Korçë, një vepër penale; Qarku Kukës, pesë vepra penale; Qarku Lezhë, pesë vepra penale; Qarku Shkodër, katër vepra penale; Qarku Vlorë, katër vepra penale dhe Qarku Tiranë gjashtë vepra penale.

765 Urdhri nr. 633, datë 17.11.2020 të MSHMS "Për ndalimin e grumbullimeve në vende të mbyllura apo të hapura".

766 Z. Blendi Klosi (PS) ndëshkuar me sanksion administrativ gjobë nga Drejtoria Vendore e Policisë Berat; z. Arjan Galdini (LRE) ndëshkuar me sanksion administrativ gjobë nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë; z. Endrit Brahimllari (LSI) ndëshkuar me sanksion administrativ gjobë nga Drejtoria Vendore e Policisë Berat; z. Elton Debreshi (kandidat i pavarur) ndëshkuar me sanksion administrativ gjobë nga Drejtoria Vendore e Policisë Dibër; z. Edmond Spaho (PD) ndëshkuar me sanksion administrativ gjobë nga Drejtoria Vendore e Policisë Korçë; z. Belind Këlliçi (PD) ndëshkuar me sanksion administrativ gjobë nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë; znj. Soela Myrtollari (PD) ndëshkuar me sanksion administrativ gjobë nga Drejtoria Vendore e Policisë Korçë.

767 Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë nenet 325 deri 332/a dhe neni 248.

768 Ligji nr. 146/2020, datë 17.12.2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.

769 Ligji 148/2020, datë 17.12.2020, "Për disa shtesa në ligjin nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë".

Qendror të Zgjedhjeve ka qenë një praktikë pozitive, pavarësisht limitimeve përmbajtësore. Në këtë proces, edhe për shkak të ndryshimeve ligjore të sipërpërmendura nuk pati një marrëveshje të tillë.
Në përmbushje të detyrimeve kushtetuese e ligjore për mbarëvajtjen e proceseve zgjedhore, Prokurori i Përgjithshëm nxori një udhëzim të ri[770] duke përfshirë edhe ndryshimet ligjore në ligjin për Prokurorinë lidhur me marrëdhënien e këtij institucioni me KQZ, i cili ju shpërnda të gjitha prokurorive të rretheve.
Veprat penale që lidhen me korrupsionin aktiv dhe pasiv në zgjedhje[771] tashmë janë objekt hetimi nga Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, SPAK.
Në Prokurorinë e Përgjithshme, janë regjistruar 158 njoftime[772] për vepra penale në fushën e zgjedhjeve, dhe ajo ka regjistruar procedim penal për 82 njoftime[773] me 10 persona të proceduar penalisht, dy në masën e sigurisë arrest në burg. Më shume së gjysma e njoftimeve, 73 të tilla, janë kryer përpara ditës së zgjedhjeve dhe pjesa tjeter gjatë ditës së zgjedhjeve, fillimit të procesit të numërimit e më pas. Sa i përket objektit të këtyre procedimeve penale, përveç atyre që janë kompetencë e SPAK, vërehet se numri më i lartë i kallëzimeve është për vepra penale "Përdorimi i funksionit publik", "Shpërdorim detyre ne lidhje me aktet ligjore për zgjedhjet", "Pengimi i zgjedhësit", etj.
Në SPAK lidhur me procesin zgjedhor të datës 25 prill 2021 janë paraqitur 147 materiale[774] (kallëzime, referime apo informacione të ndryshme), dhe janë regjistruar 57 procedime penale[775], nga të cilat aktualisht në SPAK janë në hetim 38 procedime penale[776].
Pjesë shumë e rëndësishme në punën e prokurorisë lidhur me proceset zgjedhore mbetet verifikimi i kandidatëve të përcjellë nga KQZ. Nga 30 të tillë, Prokuroria ka përfunduar verifikimin vetëm për nëntë kandidatë. Ky proces në funksion të realizimit të objektit të ligjit të dekriminalizimit duhet të konsiderohet prioritar në punën e Prokurorisë, për të bërë të mundur në një kohë sa më të shkurtër pengimin e ofrimit tek zgjedhësit të kandidatëve me probleme të pastërtisë së figures, apo edhe të ushtrimit të detyrës së tyre nëse zgjidhen.

XI.6. GJYKATAT

XI.6.1. GJYKATA KUSHTETUESE

XI.6.1.1. Ankimimi i Partisë Republikane në Gjykatën Kushtetuese mbi Urdhrin e Ministres së Shëndetësisë

Situata e krijuar nga pandemia dhe Vendimi i Komitetit Teknik nr. 4856 i 16 nëntorit 2020[777] dhe Urdhri i Ministres së Shëndetësisë që pasoi për moslejimin e grumbullimeve të më shumë se dhjetë personave dhe ndalimin e tubimeve apo takimeve partiake[778] kufizonin të drejtën e tubimit.

770 Udhëzimi nr. 2 datë 31.03. 2021 "Për disa ndryshime e shtesa në udhëzimin e përgjithshëm Nr.3, dt. 21.06.2019 "Mbi masat administrative dhe procedurale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm në periudhën para dhe pas zgjedhore".

771 Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë neni 328, Neni 328/a dhe neni 328/b.

772 Nga të cilat 91 njoftime janë kryer drejtpërdrejt në Prokurori (70 njoftime nga subjekte politike e kandidatë, 18 njoftime nga institucione shtetërore dhe 3 njoftime nga shtetas) 31 njoftime janë referuar nga policia gjyqësore dhe 36 njoftime janë referuar nga SPAK.

773 Lidhur me pjesën tjetër 23 njoftime janë përcjellë në SPAK, për 23 është vendosur mosfillimi i procedimit,dhe pjesa tjetër janë në process verifikimi paraprak.

774 Jane paraqitur 89 kallëzime nga subjektet politike (konkretisht 80 kallëzime PD, shtatë kallëzime LSI, 1 kallëzim PS dhe 1 kallëzim FRD); 23 referime nga Policia Gjyqësore; tetë materiale nga Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore; 20 infomacione nga Presidenti i Republikës; 6 kallëzime nga shtetasit dhe një rast i regjistruar kryesisht.

775 Lidhur me pjesën tjetër të materialeve është vendosur mosfillimi i procedimit penal për 14 kallëzime, i janë dërguar për kopetencë prokurorive të rretheve gjyqësore 49 raste, i janë dërguar policisë së shtetit për verifikime të mëtejshme 19 raste dhe tetë raste janë ende në process vlerësimi nga prokurorët.

776 Për 15 procedime penale SPAK ka shpallur moskopetencën dhe ua ka dërguar Prokurorive të Rretheve Gjyqësore dhe për katër procedime të tjera është vendosur bashkimi për shkak të të njëjtit objekt.

777 Urdhër nr 633, datë 17.11.2020, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale "Ndalimi i grumbullimeve në vende të mbyllura apo të hapura".

778 Po aty.

Urdhri i Ministres u ankimua në Gjykatën Kushtetuese nga Partia Republikane, dhe Gjykata Kushtetuese vendosi në datë 9 mars se ai duhet të kishte një datë brenda së cilës të rishihej, pasi nuk mund të lihej me afat të papërcaktuar (deri në një urdhër të dytë si në formulimin origjinal të tij)[779].
Ankimimi i Partisë Republikane bazohej në argumentin se Urdhri i Ministres ishte në kundërshtim me Kushtetutën e Shqipërisë, që garanton lirinë e tubimit dhe të shprehjes, dhe krijonte disavantazh të partive opozitare ndaj maxhorancës qeverisëse, e cila gëzon vizibilitet më të lartë.
Gjykata Kushtetuese gjykoi se urdhri në fakt ndalonte tubimet partiake më shumë se dhjetë persona, dhe jo të gjitha tubimet partiake (siç pretendonte ankimuesi – Partia Republikane). Në thelb, Gjykata Kushtetuese e bazoi vendimin e vet vetëm në faktin se Urdhri i Ministres nuk kishte një afat brenda të cilit duhet të rishihej duke mos trajtuar, në vendimin final, kushtetueshmërinë e ndalimit të tubimeve, si të tillë[780].
Në zbatim të vendimit të Gjykatës Kushtetuese, Ministria e Shëndetësisë nxori një urdhër në datë 11 mars me anë të të cilit i shtrinte efektet e Urdhrit nr. 633 deri në 25 mars[781]. Ndërkohë, në datë 24 mars, në mbledhjen e radhës, Komiteti Teknik vendosi që masat kufizuese të mbeteshin në fuqi edhe për dy javë të tjera (deri në datë 7 prill 2021)[782].

XI.6.1.2. Ankimimi i Partisë Bindja Demokratike dhe Lëvizja Demokratike Shqiptare mbi pikën 3 të nenit 163 të Kodit Zgjedhor

Bindja Demokratike dhe Lëvizja Demokratike Shqiptare ankimuan ndryshimet specifike
që përcaktojnë rirenditjen e kandidatëve në listë vetëm nëse thyejnë herësin në Gjykatën Kushtetuese, e cila në 30 qershor 2021[783] e rrëzoi pikën 3 të nenit 163 të Kodit Zgjedhor, si të papajtueshëm me Kushtetutën.
Sipas Gjykatës, në përcaktimin e herësit nuk duhet të vendosen kufizime në një masë më të madhe se sa është e nevojshme për të arritur objektivat, në respektim të së drejtës për të zgjedhur dhe parimit të barazisë së votës. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se parashikimi i herësit, lidhur me vlerën e tij numerike, i përcaktuar në pikën 3 të nenit 163 të Kodit Zgjedhor, si një ndër kriteret që ndikon në shpërndarjen e mandateve, cenon të drejtën për të zgjedhur, pasi nuk përmbush kriterin e proporcionalitetit. Për këtë arsye Gjykata vendosi pranimin pjesërisht të kërkesës dhe shfuqizimin e pikës 3 të nenit 163 të Kodit Zgjedhor, si të papajtueshëm me Kushtetutën.

XI.6.1.3. Ankimimi i Shoqatës së Bashkive mbi antikushtetueshmerinë e procesit zgjedhor të 30 qershorit 2019

Më datën 4 nëntor 2021, Gjykata Kushtetuse rrëzoi kërkesën e Shoqatës së Bashkive, e cila kishte kërkuar "Konstatimi antikushtetues të zgjedhshmërisë/procesit zgjedhor të zhvilluar më 30 qershor 2019 për zgjedhjen e organeve të qeverisjes vendore, të kryetarëve të bashkive dhe anëtarëve të këshillave bashkiakë dhe, si rrjedhojë, konstatimi antikushtetues i zgjedhjes së anëtarëve të këtyre organeve, si dhe verifikimin i kushtetutshmërisë së veprimtarisë së partisë "Bindja Demokratike" në lidhje me regjistrimin e saj në gjykatë dhe zgjedhjet e datës 30 qershor 2019.
Gjykata e rrëzoi kërkesën pasi vlerësoi se në lidhje me kërkimin e parë të kërkesës në shqyrtim çështja nuk bën pjesë në juridiksionin kushtetues, kurse në lidhje me kërkimin e dytë kërkuesja nuk legjitimohet për të vënë në lëvizje gjykimin kushtetues.

779 Vendim nr. 11, datë 09.3.2021, Gjykata Kushtetuese "Në emër të Republikës së Shqipërisë".

780 Është me vend të theksohet këtu se më 31 mars të vitit 2020, në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin prej ratifikimit të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, Shteti Shqiptar ka njoftuar me një notë verbale Sekretariatin e Përgjithshëm të Këshillit të Evropës për një përjashtim të përkohshëm nga ana e Shqipërisë të përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga nenet 8 dhe 11 të Konventës (e drejta e privatësisë dhe e drejta e tubimit). Përjashtimi nga përmbushja e këtyre detyrimeve ka qenë në fuqi deri më 23 qershor 2020, datë në të cilën Shteti Shqiptar ka njoftuar Sekretariatin se tërhiqet nga përjashtimi dhe se këto dy të drejta do të respektohen plotësisht në vazhdim. Nuk ka një njoftim të dytë të Shtetit Shqiptar për mospërmbushjen e detyrimeve të nenit 11, çka sjell që Urdhri i Ministres së Shëndetësisë të mos jetë në koherencë me qëndrimin e përfaqësisë shqiptare në Këshillin e Evropës.

781 Vendim nr. 158, datë 11.3.2021 i Ministrit të Shëndetësisë.

782 Është me vlerë të theksohet se në ndryshimin që iu bë të njëjtit urdhër më datë 20 maj 2021 (Urdhri Nr. 183/4, datë 20 maj 2021) togfjalëshi që përcaktonte datën e saktë se deri kur urdhri ishte në fuqi u zëvendësua sërish me togfjalëshin "deri në një urdhër të dytë" (pika 1 e Urdhrit). Ministria e Shëndetësisë ka nxjerrë pra një Urdhër, i cili qartas është në kundërshtim me një Vendim të Gjykatës Kushtetuese.

783 Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë Vendimi nr. 28 datë 30.06.2021.

XI.6.2. GJYKATA ADMINISTRATIVE

Në Gjykatën Administrative të Shkallës së parë Tiranë u gjykuan dy çështje lidhur me procesin zgjedhor të datës 25 prill 2021. Të dyja çështjet kishin ankimues Partinë Lëvizja Socialiste për Integrim, ndërkohë që njëra prej tyre u dërgua në këtë gjykatë prej Kolegjit Zgjedhor.
Vlen të theksohet se Gjykata Administrative e Shkallës së parë Tiranë i ka gjykuar çështjet në një kohë të shpejtë dhe vendimet e saj mbetën të pandryshuara, edhe pse njëri prej tyre u ankimua në shkallën e dytë të gjykimit administrativ.
Një çështje e gjykuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ishte ankimimi i Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim[784] ndaj vendimit të KAS[785] për heqjen e sanksionit administrativ të vendosur nga Komisioneri ndaj kryetarit të Bashkisë Tiranë[786]. Ky vendim u përcoll nga Kolegji Zgjedhor i cili shpalli[787] moskompetencë lëndore për gjykimin e kësaj çështje dhe vendosi dërgimin e akteve për kompetencë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
Me vendimin e datës 7 korrik 2021 kjo Gjykata Administrative vendosi pranimin e pjesshëm të padisë duke ndryshuar pjesërisht vendimin e KAS[788].

Sipas këtij vendimi të formës së prerë[789], ndaj kryetarit të Bashkisë Tiranë u vendos sanksioni administrativ gjobë për mosraportim të aktivitetit publik të institucionit.

Në gjykimin e saj, sipas KRIIK, kjo gjykatë ka reflektuar një lexim të ngushtë të ligjit duke pranuar vetëm që veprimtaria e zhvilluar ishte publike dhe duhet të ishte raportuar në ndërfaqen e KQZ, por duke i konsideruar dokumentet e shpërndara (lejet e shtëpive) si dokumente të thjeshta dhe jo jo akte me vlerë juridike.
Në datën 21 prill 2021 Lëvizja Socialiste për Integrim kërkoi në Gjykatën Administrative marrjen e masës së sigurimit të padisë, duke pezulluar zbatimin e Urdhrit nr.219, datë 19.04.2021 të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale "Për karantinimin e personave që vijnë në Republikën e Shqipërisë nga Republika e Maqedonisë së Veriut dhe Greqia". Në gjykimin e datës 23 prill 2021 Gjykata Administrative shpalli moskompetencën funksionale dhe vendosi dërgimin e akteve Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, si gjykatë kompetente nga pikëpamja funksionale për gjykimin e çështjes. Kjo e fundit vendosi në datën 24 prill mospranimin e kërkesës së LSI-së duke e konsideruar ankimimin në fjalë jashtë juridiksionit të saj gjyqësor por në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese, duke patur parasysh karakterin normativ të aktit të ankimuar dhe natyrën kushtetuese të pretendimeve për të drejtat e cënuara nga ky akt.
Në gjykimin e KRIIK, subjekti zgjedhor duhet të kishte ushtruar të drejtën e ankimimit në Gjykatën Kushtetuese, pavarësisht se koha në dispozicion për çdo lloj vendimmarrje nga Gjykata Kushtetuese nuk do të sillte pezullim të Urdhrit e për rrjedhim mundësinë për të votuar të shtetasve që mund të vinin për të ushtruar këtë të drejtë nga Greqia dhe Maqedonia e Veriut.
Marrja në shqyrtim prej Gjykatës Kushtetuese do t'i shërbente qartësimit të pretendimeve të disa subjekteve zgjedhore, si dhe, përdorimit eventual të kësajvendimmarrje në ankimimet pas zgjedhore. Përpos të tjerash, si një gjykatë ligji, Gjykata Kushtetuese do të vendoste precedentët dhe interpretimin e nevojshëm mbi cënimin dhe kufizimin e të drejtave, veçanërisht të së drejtës së votës, në kushtet të ngjashme, apo në tërësi në kushtet e një pandemie.

XI.6.3. GJYKATAT E RRETHIT GJYQËSOR

Roli i gjykatave të rrethit në proceset zgjedhore për zgjedhjet për Kuvendin, në ndryshim nga zgjedhjet vendore, lidhet vetëm me vendimmarrje për ndryshime në ekstraktin e përbërësve zgjedhorë me kërkesë të votuesve pas publikimit të listën përfundimtare të zgjedhësve, dhe

784 Objekti i padisë "Ndryshimi i vendimit të datës 16.02.2021 të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS) në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve."

785 Vendim nr. 06, datë 16.02.2021, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve, "Për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr.03, datë 11.02.2021, të z. Erion Veliaj ndaj vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr.46, datë 09.02.201".

786 Për më shumë shih pjesën "Përdorimi i burimeve shtetërore".

787 Vendimi nr. 2, datë 04.03.2021, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor "Në emër të Republikës".

788 Gjykata ndryshoi vetëm pikën 1 të vendimit të KAS "Për pikën 1 të vendimit të KSHZ nr. 46/2021, shfuqizimin e sanksionit administrativ me gjobë ndaj z. Erion Veliaj, Kryetar i Bashkisë Tiranë, në shumën 35 000 (tridhjetë e pesë mijë) lekë për shkelje të nenit 92 pikat 1, 2 e 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar për mosraportim të aktiviteteve publike".

789 Ligji nr. 49, 03.05.2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" Fletore Zyrtare 16.05.2012, Neni 45.

gjykimin e kërkesë/padive të referuara nga qytetarët apo nga Prokuroria.
Në 22 gjykatat e rretheve gjyqësore lidhur me procesin zgjedhor të datës 25 prill 2021 janë gjykuar apo janë në gjykim tri çështje penale[790] që lidhen me vepra penale të parashikuara në kreun X të Kodit Penal.
Gjithashtu gjykatat kanë marrë në shqyrtim kërkesat e 271 shtetasve për ndryshime apo korrigjime në listën e zgjedhësve[791].

XII. VËZHGUESIT

Ligji parashikon[792] të drejtën e subjekteve zgjedhore dhe organizatave vendase apo të huaja për të caktuar vëzhgues të procesit zgjedhor. Vëzhguesit kanë të drejtë të vëzhgojnë pa pengesë të gjitha aspektet e përgatitjes dhe zhvillimit të zgjedhjeve dhe të gjitha fazat e procesit zgjedhor, të paraqesin vërejtje me shkrim para komisioneve të zgjedhjeve për çdo lloj parregullsie që vërejnë, si dhe të shohin ose të këqyrin dokumentacionin ose materialet e procesit zgjedhor.
KQZ miratoi një Udhëzim[793] të ri lidhur me procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit nga vëzhguesit. Për Zgjedhjet për Kuvendin të 25 prillit 2021, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka akredituar një numër të lartë vëzhguesish jo politikë nga aktorë shqiptarë dhe të huaj. KQZ akreditoi gjithsej 2 274 vëzhgues jo politikë, prej të cilëve 248 vëzhgues afatgjatë[794], 2 026 vëzhgues afatshkurtër[795] dhe 1 199 përfaqësues të medias. Përveç organizatave vendase, ky proces zgjedhor u vëzhgua edhe nga dy misione ndërkombëtare vëzhgimi OSBE/ODHIR[796] dhe ENEMO[797].
Përgjithësisht, vëzhguesit e KRIIK nuk kanë hasur pengesa serioze në aksesimin e informacionit të nevojshëm nga KZAZ-të, pavarësisht se vërehen raste sporadike të mosnjohjes së kuadrit ligjor nga anëtarët e komisioneve zgjedhore lidhur me të drejtat e vëzhguesve dhe detyrimet e tyre në raport me ta.
Kodi Zgjedhor parashikon se vëzhguesit e partive politike apo të kandidatëve të mbështetur nga zgjedhësit regjistrohen/akreditohen nga KZAZ-të, në afatin ligjor të përcaktuar nga ligji[798]. Për shkak të mosrespektimit të afateve ligjore 19 KZAZ[799] nuk regjistruan vëzhguesit e tri subjekteve politike[800] të cilat bënë ankim në KAS. Ky i fundit vendosi rrëzimin e vendimit të KZAZ-ve dhe për rrjedhim regjistrimin e vëzhguesve të këtyre subjekteve zgjedhore pavarësisht mosrespektimit të afatit ligjor prej tyre.

790 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë ka marrë vendim për çështjen penale me objekt "Korrupsioni Aktiv në Zgjedhje" parashikuar nga neni 328 i Kodit Penal, procedim penal i iniciuar nga Prokuroria. Kjo gjykatë ka shpallur moskompetencë lëndore dhe çështja është ankimuar në Gjykatën e Apelit Shkodër.
Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, ka të regjistruar një çështje penale me objekt "Votimi më shumë se një herë" parashikuar nga neni 327/a/2 i Kodit Penal. Çështja është ende në gjykim.
Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër, ka regjistruar dhe vendosur masën e sigurimit arrest në burg për tre persona për 1 çështje penale me objekt "Korrupsioni aktiv në zgjedhje" dhe "Përdorimi i funksionit publik për veprime politike ose zgjedhore". Pas këtij vendimi materialet e çështjes i kaluan Gjykatës së Posaçme të Shkallës ë Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

791 Për më shumë shih pjesën "Regjistrimi i Zgjedhësve".

792 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 6, "E drejta për të caktuar vëzhgues".

793 Udhëzim nr. 02, datë 02.02.2021, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, "Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, mediave dhe subjekteve zgjedhore".

794 Nga të cilët 202 ishin përfaqësues të organizatave shqiptare dhe 46 të misioneve ndërkombëtare.

795 Nga të cilët 215 vëzhgues të organizmave ndërkombëtarë, si ambasada dhe organizata ndërkombëtare dhe 1 811 përfaqësues të organizatave shqiptare.

796 ODIHR open elections observation mission to Albania.

797 ENEMO International Election Observation Mission, Parliamentary Elections in Albania 2021.

798 Udhëzim nr. 02, datë 02.02.2021, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, neni 9 "Kohëzgjatja e mandatit të vëzhguesve", pika 3.

799 KZAZ nr. 17 Klos, KZAZ nr. 21, 22, 24 Durrës, KZAZ nr. 25 Shijak, KZAZ nr. 33, 34 Tiranë, KZAZ nr. 52 Librazhd, KZAZ nr. 60 Patos, KZAZ nr. 62 Mallakastër, KZAZ nr. 65 dhe 68 Berat, KZAZ nr. 73, 74 Korçë, KZAZ nr. 75 Kolonjë, KZAZ nr. 76 Përmet, KZAZ nr. 78 Memaliaj, KZAZ nr. 81 Libohovë, KZAZ nr. 87 Selenicë.

800 Partia Aleanca Demokracia e Re, Partia Bindja Demokratike, Partia Lëvizja për Ndryshim.

Nga shqyrtimi i vendimeve të KZAZ-ve rezulton se janë rreth 9 108 vëzhgues politikë të akredituar[801] dhe përveç tyre kanë qenë prezent gjatë procesit të numërimit edhe përfaqësues të forcave të ndryshme politike.
Gjatë procesit të numërimit, sikurse KRIIK ka evidentuar në deklaratat publike përkatëse, ka pasur një prezencë të shtuar të vëzhguesve politikë në ambientet e numërimit të votave. Në disa raste nuk munguan edhe konfliktet fizike ndërmjet simpatizantëve të forcave të ndryshme politike[802]. Kjo u bë shkak që Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në deklaratë publike dhe me vendimin nr. 322 datë 26.04.2021[803] të vendoste shfuqizimin e të gjitha vendimeve të KZAZ nr. 30 në Bashkinë Tiranë, nëpërmjet të cilave ishin akredituar vëzhguesit e subjekteve politike. Kjo shërbeu për normalizimin e situatës në këtë KZAZ, por në të gjitha KZAZ-të e tjera vijoi një prezencë e shtuar e vëzhguesve politikë.
Përpos të tjerave, vlen të theksohet se gjithë situata e mësipërme në vendet e numërimit të votave dhe të qendrave të votimit ishte në shkelje flagrante të rregullave të vendosura për shkak të situatës së pandemisë Covid-19 duke ekspozuar dhe vënë në rrezik shëndetin e të gjithë individëve prezentë në to.
Situata e krijuar dhe mbipopullimi ishte drejtpërdrejt përgjegjësi e përfaqësuesve të policisë së shtetit, të cilët lejuan futjen në ambientet e numërimit edhe të personave të cilët nuk kishin një akreditim të rregullt nga komisionet zgjedhore përkatëse.

XIII. PJESËMARJA E GRAVE

Pjesëmarrja e drejtpërdrejtë dhe aktive e grave në jetën politike dhe publike përbën instrument themelor në konsolidimin e sistemit demokratik. Për të nxitur barazinë gjinore në Kodin Zgjedhor[804] janë vendosur kuotat gjinore për të përmirësuar pjesëmarrjen e grave në përbërjen e Kuvendit, qeverisjen vendore dhe në administratës zgjedhore.
Kuadri ligjor përcakton se të paktën një në çdo tre kandidatë duhet të jetë nga gjinia e nënpërfaqësuar, duke vendosur kështu një limit të minimumit të numrit të grave, por jo një limit maksimal të përfaqësimit të tyre, duke lënë të hapur mundësinë e dorëzimit të listave me vetëm gra në përbërjen e tyre.

XIII.1. PJESËMARRJA E GRAVE NË LISTAT E KANDIDATËVE

Si rrjedhojë e amendimeve ligjore në Kodin Zgjedhor të realizuara në muajin korrik të 2020-ës[805], pati një garantim të numrit të grave kandidate në listat shumemërore të subjekteve zgjedhore. Nga totali i 1.841 kandidatëve për deputetë (5 prej tyre kandidatë të pavarur) të regjistruar nga KQZ 732 ishin gra e vajza (39,8%)[806]. Ndërkohë, në zgjedhjet pararendëse kjo shifër ka qenë respektivisht 40,8% në vitin 2017 dhe 38,5% në vitin 2013. Një tendencë lehtësisht rritëse vërehet tek listat e Partisë Socialiste dhe Partisë Demokratike, në krahasim

801 Duhet theksuar që ky numër i referohet vendimeve vetëm nga 31 KZAZ, pasi të tjerat ose nuk kanë marrë vendim ose nuk e kanë bërë atë publik apo depozituar në KQZ.

802 Për më shumë shih pjesën "Ecuria e procesit të numërimit".

803 Vendim nr. 322 datë 26.04.2021, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve "Për shfuqizimin e të gjithë vendimeve për akreditim të vëzhguesve në vendin e numërimit të votave në KZAZ nr.30, qarku Tiranë".

804 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 29 "Përbërja e KZAZ-së" dhe Neni 67 "Lista e kandidatëve të partive dhe koalicioneve të partive".

805 Ligji nr. 101/2020, datë 23.07.2020.

806 Nga totali prej 153 kandidatësh për secilin subjekt, kishte konkretisht gra:
Partia Socialiste 60 kandidate gra, 39,22%; Partia Lëvizja Socialiste për Integrim 61 kandidate gra, 39,87%; Koalicioni Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim 51 kandidate gra, 33,33%; Partia Lëvizja e Re 75 kandidate gra, 49,02%; Partia Nisma Thurje 67 kandidate gra, 43,79%; Partia Lëvizja për Ndryshim 68 kandidate gra, 44,44%; Partia Socialdemokrate 63 kandidate gra, 41,18%; Partia Lëvizja Demokratike Shqiptare 61 kandidate gra, 39,87%; Partia Bindja Demokratike 58 kandidate gra, 37,91%; Koalicioni ABEOK 59 kandidate gra, 38,56%; Partia Balli Kombëtar 55 kandidate gra, 35,95%; Partia Aleanca Demokracia e Re 56 kandidate gra, 36,60%.

me dy zgjedhjet e shkuara parlamentare[807].
Në Kuvendin e dalë prej zgjedhjeve të datës 25 prill 2021, ka 46 gra, ose 32,8% e tij. Ky përfaqësim ishte 27,9% në Kuvendin e dalë nga zgjedhjet e vitit 2017 dhe 17,9% në atë të dalë nga zgjedhjet e vitit 2013. Vetëm 2 nga 17 partitë politike garuese kanë kryetare grua.
Mbetet shqetësues fakti që pavarësisht përcaktimit ligjor që i detyron partitë politike të respektojnë kuotën gjinore[808] duke i sanksionuar ato me refuzim të listës shumemërore në rast të mosplotësimit të saj, për disa subjekte lista u kthye për plotësim nga KQZ[809] edhe për shkak të mospërmbushjes së këtij detyrimi.

XIII.2. PJESËMARRJA E GRAVE NË ADMINISTRATËN ZGJEDHORE

Sa i përket trupave kryesore institucionale dhe gjyqësorë të lidhura me procesin zgjedhor, vërehet se në Kolegjin Zgjedhor pesë nga tetë, anëtarë janë gra, ndërsa në Komisionet e KQZ, janë vetëm dy gra anëtare të Komisionit Rregullator dhe asnjë në KAS.
Përsa i përket administratës zgjedhore të nivelit të dytë dhe të tretë gratë ishin më shumë të përfaqësuara në nivelin e dytë (Komisionet Zonale të Administrimit Zgjedhor), sesa në nivelin e tretë (Komisionet e Qendrave të Votimit). Ligji përcakton[810] detyrim për përmbushjen e kuotës gjinore vetëm nga dy partitë kryesore, PS dhe PD në Komisionet Zonale të Administrimit të Zgjedhjeve në masën 30%.
Pavarësisht se në totalin e anëtarësisë së KZAZ-ve, ishin 31,4% gra[811], ky numër nuk u respektua nga të gjitha partitë politike që kishin të drejtë të propozonin anëtarë në KZAZ[812]. Edhe ky përfaqësim në nivelet minimale të kërkesave ligjore, rezultoi të ishte shumë pak në nivele drejtuese. Vetëm 33% e grave në KZAZ ishin kryetare, Zv/ kryetare apo sekretare[813].

XIII.3. ÇËSHTJET GJINORE NË FUSHATË

Është e vështirë të klasifikosh rëndësinë që i kanë dhënë përfaqësimit gjinor në programet e partive politike dhe për rrjedhim rëndësinë që i japin ato kësaj çështje në projeksionin e tyre qeverisës, duke qenë që nuk pati programe të mirëfillta elektorale të publikuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhje. Përpos kësaj, gjykohet një domosdoshmëri angazhimi për rritjen e përfaqësimit të gruas si një çështje e cila duhet të fillojë në strukturat e partive politike.
Në komunikimin publik, partitë politike[814] pjesëmarrëse në zgjedhje shprehën mbështetjen ndaj grave me premtime verbale për rritjen e punësimit dhe përfaqësimit të tyre në çdo sektor; megjithatë çështjet gjinore mbetën një diskutim marxhinal në fushatë nga të gjitha partitë pjesëmarrëse në zgjedhje.
Gjatë fushatës elektorale, nuk munguan as incidentet ndaj grave në diskutimin public. Kryetari

807 PS në 2013 kishte 24,9% të kandidatëve gra, në 2017 kishte 35,4%, ndërsa në 2021 kjo shifër ishte 39%. PD në 2013 kishte 29,3% të kandidatëve gra, në 2017 kishte 20,1%, ndërsa në 2021 kjo shifër ishte 33%. LSI në 2013 kishte 34,2% të kandidatëve gra, në 2017 kishte 42,5%, ndërsa në 2021 kjo shifër ishte 39,9%.

808 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 175 "Sanksioni për mosrespektim të kuotës gjinore".

809 Partia Socialiste, Partia Balli Kombëtar, Partia Bindja Demokratike, Partia Socialdemokrate, Koalicioni Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim.

810 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 29, pika 1, gërma ç "30 për qind e anëtarëve të propozuar përkatësisht nga partia më e madhe e shumicës dhe partia më e madhe e opozitës, në shkallë vendi, duhet të jenë nga secila gjini."

811 231 gra nga 736 anëtarë të trupës së 92 KZAZ-ve.

812 Partia Socialiste kishte 130 gra nga 335 anëtarë gjithsej (38,8%); Partia Demokratike kishte 76 gra nga 276 anëtarë gjithsej (27,5%); Lëvizja Socialiste për Integrim kishte 13 gra nga 92 anëtarë gjithsej (14,1%); Partia Socialdemokrate kishte 12 gra nga 33 anëtarë gjithsej (36,4%).

813 Në vetëm 15 KZAZ nga 92 të tilla kishte një grua kryetare; në 28 KZAZ kishte një grua nënkryetare dhe në 34 KZAZ kishte një grua sekretare.

814 Partia Lëvizja Socialiste për Integrim në publikimin e disa përmbledhjeve të programit të saj elektoral përfshin gruan si pjesë integrale të planit të saj të veprimit; Partia Socialiste dhe Partia Demokratike kanë patur vetëm artikulime verbale për rritjen e përfaqësimit të gruas pa e trajtuar thelbësisht çështjen, të cilat janë bërë kryesisht në takimet e drejtuesve të këtyre partive me gra.

i Partisë Socialiste dhe Kryeministri i vendit, në një takim/komunikim publik për prezantimin e kandidatëve të Partisë Socialiste në datën 10 mars 2020, përdori gjuhë intimiduese[815] ndaj një kandidateje grua të Partisë Demokratike.
Kandidatët gra gjetën mbulim shumë të pakët në edicionet informative duke nxjerrë në pah problemet e vazhdueshme në lidhje me pjesëmarrjen e grave në jetën politike.

XIV. PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë sanksionon të drejtën për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur të të gjithë shtetasve shqiptarë, duke përfshirë shtetasit me aftësi të kufizuara, me përjashtim të rasteve kur kjo e drejtë iu është hequr[816] me një vendim gjyqësor të formës së prerë. Ky ndalim bie në kundërshtim me Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara[817].
Shqipëria ka nënshkruar Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDPAK)[818] në vitin 2009 dhe ratifikuar atë në vitin 2013, por jo Protokollin Opsional të saj[819]. Pavarësisht kësaj, edhe disa përmirësimeve në Kodin Zgjedhor për garantimin e të drejtës për të votuar të shtetasve më aftësi të kufizuara, pak është bërë në terma konkretë për të garantuar që këta persona të jenë plotësisht të integruar, përfshi garantimin e të drejtave dhe lirive të tyre politike. Kodi Zgjedhor parashikon të të drejtën e tyre për të votuar edhe nëpërmjet asistentit[820].
Duke qenë se subjektet zgjedhore garuese në 25 prill nuk patën programe të mirëfillta dhe të publikuara, është e vështirë të përcaktohet vendi që zënë në agjendën e tyre qeverisëse çështjet e personave me aftësi të kufizuar.
Gjatë fushatës zgjedhore problemet e Personave me Aftësi të Kufizuara (PAK) u prekën vetëm nëpër diskutime në mënyrë periferike. Vetëm subjekti Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim zhvilloi një takim[821] me përfaqësues të organizatave që punojnë me personat me aftësi të kufizuara, pas të cilit u deklarua se u firmos një marrëveshje bashkëpunimi, e cila nuk ishte publike. Në shumicën e rasteve këta individë konsiderohen në politikëbërje si pjesë e të gjitha grupeve të tjera vulnerabël.
Vlerësohet pozitivisht publikimi i spoteve[822] edukuese nga KQZ edhe me gjuhën e shenjave për personat që nuk dëgjojnë.
Në Shqipëri nuk ka të dhëna zyrtare të sakta sa i përket numrit të personave me aftësi të kufizuara. Sipas të dhënave të Shërbimit Social Shtetëror, deri në muajin prill 2021 numri i personave që janë njohur zyrtarisht të kenë një aftësi të kufizuar është rreth 71 443 persona, të ndarë në aftësi të kufizuara të shikimit 12 064 persona, 6 299 para - tetraplegjik dhe 53 080 me aftësi të kufizuara fizike e mendore[823].
Nga komunikimi zyrtar i KRIIK me 61 Bashkitë në vend, gjatë muajve nëntor – dhjetor 2020 referohet se janë 8 887 persona të verbër në 48 bashki dhe 47 052 persona me aftësi të kufizuar. Nga raportimi i 45 bashkive[824] pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve rezultojnë 42 331 zgjedhës

815 https://www.facebook.com/watch/live/?v=135019718451028&ref=watch_permalink minuta 26.

816 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Kreu III "Liritë dhe të Drejtat Politike", Neni 45, pika 2.

817 Komunikata 1, Nr. 4/2011 të vitit 2013 të Komitetit të KDPAK-së, pika 9.4. *"Neni 29 nuk parashikon ndonjë kufizim ose përjashtim të arsyeshëm për ndonjë grup personash me aftësi të kufizuara. Prandaj, një përjashtim i së drejtës për të votuar në bazë të një paaftësie psikosociale ose intelektuale të perceptuar ose aktuale, duke përfshirë një kufizim në bazë të një vlerësimi të individualizuar, përbën diskriminim në bazë të aftësisë së kufizuar, brenda kuptimit të nenit 2 të Konventës".*

818 Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.

819 Protokoll Opsional i Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.

820 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 108 "Zgjedhësit që nuk mund të votojnë vetë".

821 Basha nënshkruan marrëveshjen e bashkëpunimit me shoqatat e Personave me Aftësi të Kufizuar.

822 http://kqz.gov.al/spote/

823 Përfituesit e PAK Mars-Prill 2021

824 Nuk kanë përmbushur detyrimin për të raportuar lidhur me numrin e personave me aftësi të kufizuara në KQZ

me aftësi të kufizuar, 35 995 persona me aftësi të kufizuar fizike ose mendore dhe 6 336 të verbër. Procesi i evidentimit të numrit të Personave më Aftësi të Kufizuara do ´të duhet të ishte një koordinimin i thjeshtë ndërmjet bashkive dhe KQZ-së, duke qenë se të dhënat figurojnë pranë çdo bashkie. Por vërehet një neglizhim i bashkive[825] për dërgimin e këtyre të dhënave në KQZ, duke sjellë një situatë jo të qartë lidhur me garantimin e kushteve të nevojshme për të votuar për personat me aftësi të kufizuar.

Nevojitet një koordinimin më i mirë i institucioneve për të siguruar paraprakisht një informacion të plotë dhe më pas edhe sigurimin e kushteve të nevojshme pranë çdo qendre votimi, në territorin e së cilës janë të regjistruar shtetas me aftësi të kufizuara, në mënyrë që të lehtësohet votimi prej tyre.

Komisioni Rregullator me Udhëzimin[826] e caktimit të rregullave për ngritjen e qendrave të votimit, përcaktoi se ambientet e tyre duhet të ishin në katet e para të ndërtesave, çka nuk u realizua plotësisht në praktikë, pasi një numër të konsiderueshëm qendrash votimi ishin në katet e dyta të ndërtesave.

Gjithashtu bashkitë ishin përgjegjëse për krijimin e kushteve të nevojshme të QV-ve ku do të votonin personat me aftësi të kufizuara, por nga vëzhgimi i KRIIK rezultoi se vetëm 33% e QV-ve ishin të aksesueshme për këtë grup individësh, ndërkohë që pjesa tjetër ishin të paaksesueshme apo pjesërisht të aksesueshme.

Pavarësisht hapave pozitivë përsa i përket rritjes së pjesëmarrjes së shtetasve me aftësi të kufizuara në proceset zgjedhore, nevojiten më shumë ndryshime ligjore dhe përmirësime të tjera, për të garantimin e të drejtave të këtij grupimi individësh jo vetëm sa i përket garantimit të të drejtës së tyre për të votuar, por edhe të të drejtave të tjera.

Vlerësohet si nevojë imediate, hartimi paraprak i një databaze të Personave me Aftësi të kufizuara, për të lehtësuar procesin e përshtatjes së qendrave të votimit me rampa dhe shabllonin brail.

Nevojitet rishikimi i ligjit që iu heq të drejtën për të zgjedhur personave me aftësi të kufizuara intelektuale, si një element që bie në kundërshtim me Konventën për të Drejtën e Personave me Aftësi të Kufizuara.

XV. PAKICAT KOMBËTARE

Pakicat kombëtare në Shqipëri gëzojnë ushtrimin e lirive dhe të të drejtave specifike të tyre nëpërmjet një ligji të posaçëm[827]. Sipas kuptimit të këtij ligji, pakicat kombëtare në Republikën e Shqipërisë janë pakicat greke, maqedonase, arumune, rome, egjiptiane, malazeze, boshnjake, serbe dhe bullgare[828].

Për njësitë administrative ku pakicat kombëtare përbëjnë më shumë se 20% të popullsisë, këta qytetarë kanë të drejtën të marrin informacionin në lidhje me procesin e votimit në gjuhën e tyre. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në kuadër të informimit të pakicave që jetojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe që gëzojnë të drejtën e votimit, përgatiti spote informuese[829] dhe fletëpalosje[830] në lidhje me mënyrën e votimit dhe aktet që përbëjnë krim zgjedhor.

Një parti politike që garoi në këto zgjedhje si pjesë e koalicionit Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim, është përfaqësuese e pakicave kombëtare, PBDNJ.

Pavarësisht kësaj në programet e partive politike, për aq sa u bënë publike dhe mund të konsiderohen të tilla, nuk pati pjesë të dedikuara për pjesën e pakicave kombëtare.

16 bashki: Bashkia Shkodër, Bashkia Malësi e Madhe, Bashkia Vau i Dejës, Bashkia Tropojë, Bashkia Has, Bashkia Vorë, Bashkia Kavajë, Bashkia Cërrik, Bashkia Divjakë, Bashkia Maliq, Bashkia Kolonjë, Bashkia Përmet, Bashkia Memaliaj, Bashkia Vlorë, Bashkia Delvinë, Bashkia Sarandë.

825 Po aty.

826 Udhëzim nr. 1 date 5.12.2021 "Përcaktimi i rregullave për ngritjen caktimin, dhe njoftimin e vendndoshjes së qendrave të votimit dhe përgatitjen e hartës së njësisë së qeverisjes vendore për zgjedhjet".

827 Ligji 96/2017 "Për pakicat Kombëtare", miratuar më datë 13.10 2017 dhe publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 196 datë 09.11.2017.

828 Po aty, Neni 3 "Përkufizime", pika 2.

829 http://kqz.gov.al/spote/

830 http://kqz.gov.al/galeria-e-posterave-dhe-fletepalosjeve/

XVI. DITA E ZGJEDHJEVE DHE NUMËRIMI I VOTAVE

KRIIK angazhoi 360 vëzhgues stacionarë, të cilët ndoqën procesin e hapjes, votimit dhe mbylljes së qendrave të votimit në 360 qendra votimi të përzgjedhura në mënyrë probabilitare në të gjithë vendin. Vëzhgimi i 360 qendrave të votimit të përzgjedhura në mënyrë rastësore garanton përgjithësimin e gjetjeve me një marzh gabimi prej 35%, me një interval besueshmërie prej 95%. Gjithashtu, me anë të ekpieve të vëzhguesve të lëvizshëm u vëzhgua situata përreth qendrave të votimit dhe procesi i votimit në rreth 900 QV. Vëzhguesit e lëvizshëm kishin një tjetër metodologji vëzhgimi nga ata stacionarë. Nëse të parët u fokusuan në të gjithë elementet teknikë të procesit, përgjatë gjithë ditës së zgjedhjeve në qendrën e votimit ku ishin të vendosur, të dytët u fokusuan më tepër në situatën jashtë qendrave të votimit dhe vizituan qendra votimi, të cilat u konsideruan se mund të kishin problematika [831].
Përpos sa më sipër, në çdo KZAZ u vendos një vëzhgues stacionar, i cili ndoqi aktivitetin e KZAZ-ve përgjatë gjithë ditës së zgjedhjeve. Këta vëzhgues kryen edhe vizita monitorimi në KZAZ gjatë ditës së premte dhe të shtunë, ndërkohë që KZAZ-të përgatitën dhe shpërndanë materialet zgjedhore për komisionet e qendrave të votimit.
Procesi i numërimit në të gjitha VNV-të e vendit u ndoq në mënyrë të vazhduar me vëzhgues stacionarë, deri në përfundimin e tij.

XVI.1. AKTIVITETI I KZAZ-SË PËRPARA DITËS SË ZGJEDHJEVE

Shumica e KZAZ-ve qëndruan të mbledhura gati gjatë gjithë ditës së premte, me përjashtim të KZAZ-së nr. 2. Në katër KZAZ u verifikuan mungesa në anëtarësi gjatë ditës së premte.
Thuajse të gjitha KZAZ-të raportuan se i kishin marrë në dorëzim materialet zgjedhore nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve deri ditën e premte, me përjashtim të KZAZ-së nr. 28 e cila i mori ditën e shtunë. Pesë KZAZ raportuan se kishin mungesa në materialet e dërguara nga KQZ ditën e premte.
Pesë KZAZ raportuan se deri ditën e premte ende nuk i kishin konstituuar grupet e numërimit të votave[832], në shkelje të parashikimeve ligjore.
Gjatë ditës së shtunë, të gjitha KZAZ-të kanë qenë të mbledhura dhe kanë dorëzuar materialet zgjedhore tek qendrat e votimit përkatëse. Shpërndarja e materialeve zgjedhore nga Komisionet Zonale të Administrimit Zgjedhor drejt qendrave të votimit vuajti nga vonesat përtej parashikimit ligjor në një numër të konsiderueshëm të KZAZ-ve (rreth 40% e tyre). Një nga faktorët shkaktarë për vonesat ishte mungesa e operatorëve teknikë për përdorimin e pajisjes PEI apo të kamerës në QV. Një tjetër faktor i përmendur shpesh si vonesë në shpërndarjen e materialeve zgjedhore ishte vonesa e punonjësve të policisë së shtetit, pa të cilët nuk mund të fillonin procedurat e dorëzimit të materialeve zgjedhore[833]. Në përgjithësi, procesi i dorëzimit të materialeve zgjedhore tek komisionet e qendrave të votimit ka shkuar pa probleme[834].

XVI.2. PROCESI I VOTIMIT

Retorika e ashpër politike dhe konfliktualiteti që shoqëruan fushatën zgjedhore nuk u shtrinë në ditën e zgjedhjeve, e cila u zhvillua pa incidente apo problematika serioze. Procesi i votimit ishte i qetë dhe proceduralisht u administrua mirë, me përjashtim të problematikave me Pajisjen Elektronike të Identifikimit në një numër qendrash votimi. Shkeljet procedurale të vëzhguara gjykohet se nuk e ndikuan negativisht dhe në mënyrë domethënëse procesin.

831 Vëzhguesit e lëvizshëm ndoqën edhe procedurat teknike të votimit në qendrat e votimit të vizituara, por gjetjet e tyre janë teknikisht të pakrahasueshme me ato të vëzhguesve stacionarë, të cilët e ndoqën procesin përgjatë gjithë ditës. Kjo pasi vëzhguesit e lëvizshëm i ndoqën këto procedura vetëm për periudha të shkurtra kohore (mesatarisht ata kalonin rreth 30 minuta në një qendër votimi).

832 KZAZ nr. 16, 35, 83, 84 dhe 85.

833 KZAZ 26, Bashkia Vorë iu drejtua me shkresë zyrtare KQZ-së dhe policisë së shtetit në lidhje me vonesën e mbërritjes së punonjësve të policisë, por nuk pati një përgjigje zyrtare.

834 Në KZAZ-të me numër 27, 37, 41, 42, 50, 60 dhe 83 vëzhguesit kanë raportuare për radhë të gjata dhe rrëmujë gjatë procesit të dorëzimit të materialeve zgjedhore.

Një shqetësim madhor mbetet ndikimi i paligjshëm dhe i paduhur i zgjedhësve në afërsi të qendrave të votimit, në linjë me indikacionet gjatë fushatës zgjedhore për struktura të organizuara të drejtimit të votës.
Votimi familjar dhe fotografimi i votës ishin fenomene të cilët u vërejtën në një numër relativisht të lartë të Qendrave të Votimit. Ajo që ishte më shqetësuese ishte toleranca e komisionerëve të Qendrave të Votimit ndaj këtyre fenomeneve, veçanërisht ndaj fotografimit të votës. Në lidhje me këtë të fundit, në një numër rastesh të vërejtura komisionerët nuk njoftuan Policinë e Shtetit, edhe pse i identifikuan zgjedhësit që fotografuan votën, por u mjaftuan me shënimin e fletës së votimit si të pavlefshme.
Vështirësia apo deri pamundësia në shumë Qendra Votimi, për zgjedhësit me aftësi të kufizuara të ushtrojnë të drejtën e votës mbeti një fenomen i paadresuar edhe në këto zgjedhje. Komisionerët e Qendrave të Votimit nuk i kushtuan rëndësi zbatimit të dispozitave ligjore në lidhje me asistimin e këtyre personave, apo të personave të tjerë që kërkuan asistencë gjatë votimit. Sjellje kjo, në anashkalim me detyrimin për plotësimin e deklaratës përkatëse nga zgjedhësi që asiston zgjedhësin tjetër, apo duke lejuar që një person të asistonte më shumë se një zgjedhës.
Këto fenomene theksojnë nevojën për një trajnim më profesional të komisionerëve të qendrave të votimit, fushata ndërgjegjësimi dhe edukimi të zgjedhësve më proaktive dhe të targetuara specifikisht për fasha të ndryshme demografike.
Masa më proaktive duhen marrë gjithashtu në lidhje me garantimin e një situate të qetë dhe pa ndikim mbi zgjedhësit gjatë ditës së votimit, jo vetëm në brendësi të qendrave të votimit por edhe në afërsi të tyre, masa të cilat duhet të kombinohen me masat për parandalimin e drejtimit dhe kontrollit të votës përgjatë periudhës përpara ditës së zgjedhjeve.

XVI.2.1. PROCEDURAT E HAPJES SË QENDRAVE TË VOTIMIT

Vëzhguesit e KRIIK vëzhguan procedurat e hapjes së qendrave të votimit në 354 qendra votimi nga 360 që ishte kampioni. Për arsye të ndryshme[835]; gjashtë vëzhgues nuk arritën të ishin në kohë per të vëzhguar procedurat e hapjes.
Procesi i hapjes së qendrave të votimit vuajti nga vonesat e hapjes përtej afatit ligjor, në një numër rastesh si pasojë e vështirësive me aktivizimin e pajisjeve elektronike të identifikimit (PEI). Në 4.8% të qendrave të votimit pati problematika, të llojit të ndryshëm[836], me funksionimin e PEI-t gjatë procedurave të hapjes.
Vetëm në 66.67% të qendrave të votimit procesi i votimit nisi në orar (7:00). Shumica e qendrave të votimit që u hapën me vonesë patën një vonesë prej më pak se gjysmë ore (24.58% e totalit u hapën mes orës 7:00 dhe 7:30) dhe 8.76% u hapën me vonesa mbi gjysmë ore. Në më shumë se gjysmën e qendrave të votimit që u hapën me vonesë (50.89%) kishte zgjedhës që prisnin në radhë për të votuar në momentin e hapjes së QV-së.

GRAFIKU 1 – *Orari i hapjes së qendrës së votimit*



Prania e komisionerëve të qendrës së votimit në orën e hapjes ishte e plotë (shtatë komisionerë) në pjesën më të madhe të QV-ve (80.23%). 10.45% u hapën me gjashtë anëtarë të pranishëm, dhe pjesa tjetër me pesë ose katër anëtarë të pranishëm. Asnjë prej qendrave të votimit nuk i realizoi procedurat e hapjes pa numrin minimal të komisionerëve të parashikuar në ligj (katër anëtarë).

835 Përgjithësisht, vështirësi për të gjetur qendrën e votimit.

836 Operatorët qe nuk ishin paraqitur, vështirësi me aktivizimin e pajisjes, etj.

GRAFIKU 2 – *Prania e anëtarëve të komisionit të qendrës së votimit gjatë procedurave të hapjes*

Në thuajse të gjitha qendrat e votimit, vëzhguesit vlerësuan se organizimi i qendrës së votimit garantonte fshehtësinë e votës, me përjashtim të katër QV-ve.
Kutitë e votimit u mbyllën në prezencë të të gjithë anëtarëve të pranishëm në QV dhe vëzhguesve në të gjithë qendrat e votimit. Një nga problematikat madhore gjatë procesit të hapjes në një numër të konsiderueshëm QV-sh kanë qenë vështirësitë me vendosjen në punë të Pajisjes Elektronike të Identifikimit. Në 4.8% të qendrave të votimit PEI nuk u aktivizua dhe, si rrjedhim, nuk u printua raporti i hapjes së QV-së gjatë kryerjes së procedurave të hapjes. Kjo solli edhe vonesa në një numër të konsiderueshëm të QV-ve.

GRAFIKU 3 – *A u aktivizua PEI në prani të të gjithë anëtarëve të komisionit të qendrës së votimit dhe vëzhguesve?*



Thuajse të gjitha qendrat e votimit ishin të pajisura me materialet e nevojshme për nisjen e votimit, vetëm në 1.13% u vërejtën mungesa të bazës materiale në momentin e hapjes[837] KZAZ-të përkatëse i pajisën KQV-të me materialet e munguara, duke mundësuar vijimin e procesit.
Procedurat standarde gjatë procesit të hapjes së Qendrave të Votimit (QV) u zbatuan me përpikëri në thuajse të gjitha qendrat e votimi. Procedurat e hapjes u vlerësuan nga vëzhguesit, si "shumë të mira" në 66.1% të QV-ve, si "të mira" në 28.25% të tyre dhe si "me probleme" në 5.65%. në asnjë QV procedurat e hapjes nuk u vlerësuan si "shumë problematike".

GRAFIKU 4 – *Vlerësimi i procedurave të hapjes së qendrës së votimit nga vëzhguesit*



837 Boja për timbrosje në një QV, Procesverbalet në dy QV dhe zarfet për dokumentacionin zgjedhor në një QV.

VI.2.2. PROCEDURAT E VOTIMIT

Përgjatë procesit të votimit, njësoj si në momentin e hapjes së QV-së, duhet të jenë të pranishëm shumica e komisionerëve që procesi të vijojë. U vërejt se në krahasim me momentin e hapjes së QV-ve, në vazhdim të votimit, numri i QV-ve që operuan me numrin e plotë të komisionerëve u rrit me thuajse 9 pikë përqindje. Në rezultante të tërë ecurisë, në 89.44% të Qendrave të Votimit, komisionet operuan me shtatë anëtarë[838].
Rezultoi se edhe në këtë proces zgjedhor përfshirja e grave në nivelin e tretë të administrimit zgjedhor ishte problematike. Në 22.22% të komisioneve nuk pati asnjë anëtare grua në përbërje, në 25.56% pati vetëm një anëtare grua, në 22.22% pati dy anëtare gra dhe në 17.5% të tyre pati tri anëtare gra. Ndërsa në 12.5% të Komisioneve të nivelit të tretë, maxhoranca e anëtarëve ishte gra. Në rezultante të së tërës, u vërejt se rreth 26.16% e komisionerëve të qendrave të votimit ishin gra. Këto shifra tregojnë përmirësim në krahasim me Zgjedhjet për Kuvend të vitit 2017[839], megjithatë janë ende shumë larg aspiratës së barazisë gjinore.

GRAFIKU 5 – *Komisionere gra në qendrat e votimit*



Prania e personave të paautorizuar brenda qendrave të votimit vazhdoi të ishte një fenomen i vërejtur në një numër relativisht të lartë të QV-ve. Numri i Qendrave të Votimit në të cilat u vërejtën persona të paautorizuar së paku në një moment, ishte në masën 5%[840].
Vëzhguesit e KRIIK vlerësuan se në 5.83% të QV-ve, pozicionimi i dhomës së fshehtë nuk lejoi që të gjithë komisionerët dhe vëzhguesit të kishin një pamje të qartë të veprimeve që kryente zgjedhësi prapa saj[841]. Ndërsa në 1.67% të QV-ve, vëzhguesit vlerësuan se pozicionimi i dhomës së fshehtë nuk garantoi fshehtësinë e votës.
Një tjetër shqetësim i lidhur me infrastrukturën dhe organizimin e qendrës së votimit ishte mos afishimi i listës së posterave me numrat e kandidatëve, posterave që shpjegonin procedurat e votimit dhe listës së zgjedhësve në 4.72% të qendrave të votimit. Veçanërisht shqetësues është mosafishimi i posterave me numrat e kandidatëve. Duke marrë në konsideratë kompozimin e fletës së votimit me numra dhe jo me emra, kjo nuk i dha mundësinë e informimit të saktë zgjedhësve në këto qendra votimi që mund të dëshironin të bënin një zgjedhje të minutës së fundit në lidhje me kandidatin e preferuar.

838 Në 20 qendra votimi u operua me gjashtë anëtarë, në 16 me 5 anëtarë dhe vetëm në dy qendra votimi me katër anëtarë. Në asnjë qendër votimi nuk u operua me numër anëtarësh nën minimumin ligjor (katër anëtarë).

839 Ku vetëm 22,7% e anëtarëve të komisioneve të qendrave të votimit ishin gra.

840 Në 14 nga rastet e vërejtura, personat e paautorizuar brenda QV-së u identifikuan si përfaqësues të forcave politike dhe në katër raste vëzhguesit nuk mundën të identifikonin se çfarë përfaqësonin.

841 Ekrani mbrojtës pas të cilit zgjedhësit votojnë, dhoma e fshehtë, duhet të vendoset në një pozicion të tillë që të mund të shihet nga të gjithë anëtarët e komisionit dhe vëzhguesit, në mënyrë që të mund të shihet se çfarë veprimesh po kryen zgjedhësi pas tij. Kjo është e rëndësishme për të evituar fotografimin e votës apo të tjera mënyra manipulimi të rezultatit zgjedhor.

GRAFIKU 6 – *Afishimi i posterave me numrat e kandidatëve në qendrat e votimit*



Procedurat formale të procesit të votimit u respektuan në shumicën e qendrave të votimit me përpikmëri, me devijime në një numër të vogël të QV-ve[842].
Shkelje të vërejtura në një numër të konsiderueshëm të qendrave të votimit kishin të bënin me përdorimin e telefonit celular brenda QV-së, që u vërejt në 5% të QV-ve, apo mbajtja e telefonit celular në dorë në dhomën e fshehtë, e vërejtur në 3.89% të tyre.
Të tjera shkelje procedurale të vërejtura kishin të bënin me respektimin e procedurave për zgjedhësit të cilët kërkuan asistencë gjatë procesit të votimit[843]. Një shkelje e vërejtur në një numër relativisht të lartë rastesh ishte mosplotësimi i deklaratës përkatëse nga personat që asistojnë zgjedhës që kanë nevojë për asistencë, i vërejtur në 4.72% të QV-ve, ndërsa në 2.22% të QV-ve u vërejtën persona që ndihmuan më tepër se një zgjedhës për të votuar. Të ndihmuarit e zgjedhësve me aftësi të kufizuara nga komisionerët e qendrës së votimit pati një rënie drastike, krahasuar me zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2017; vetëm në 0.83% të qendrave të votimit u vërejtën komisionerë që ndihmuan.
Fenomen shqetësues vazhdoi të ishte votimi familjar ose në grup, pavarësisht se edhe ky fenomen shënoi një rënie të konsiderueshme, krahasuar me zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2017. Tentativa për votim familjar ose në grup janë vënë re në 11.67% të qendrave të votimit[844].

GRAFIKU 7 – *Votimi familjar*



Shqetësues mbetet fotografimi i votës prej zgjedhësve[845], i vërejtur në 1.94% të qendrave të votimit (së paku një rast). Në 5 prej qendrave të votimi ku kjo u vërejt, anëtarët e komisionit mbajtën shënim gjeneralitetet e zgjedhësve dhe në dy prej tyre u mjaftuan me shpalljen e votës së pavlefshme.

842 Si p.sh..: lejim i zgjedhësve që të votojnë pa u kontrolluar nëse ishin timbrosur më parë (1.11% e QV-ve) apo pa paraqitur një dokument të vlefshëm identifikimi (0.28% e QV-ve); mostimbrosje e zgjedhësve me bojën e posaçme përpara se të votojnë (2.22% e QV-ve) apo tentativa të zgjedhësve për të votuar jashtë dhomës së fshehtë (0.56% e qendrave të votimit).

843 Kjo është një e drejtë që u njihet zgjedhësve, por e kushtëzuar me tre rrethana. Personi që i asiston duhet të jetë një zgjedhës i asaj qendre votimi, një person mund të asistojë vetëm një zgjedhës dhe në momentin kur kërkohet asistenca, si zgjedhësi që asistohet ashtu edhe ai që asiston plotësojnë një deklaratë dhe gjeneralitetet e të dyve mbahen shënim. Anëtarët e komisionit të qendrës së votimit, në çdo rast, e kanë të ndaluar të asistojnë zgjedhës për të votuar.

844 Në Zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2017 kjo u vërejt në thuajse 22% të qendrave të votimit.

845 Nëse anëtarët e Komisionit të Qendrës së Votimit vënë re se zgjedhësi fotografon votën, duhet t'a ndalojnë zgjedhësin të hedhë votën në kuti, të mbajnë shënim gjeneralitetet e zgjedhësit dhe të njoftojnë Policinë për faktin.

Gjatë Ditës së Zgjedhjeve u vërejtën raste të ndërhyrjes apo të ushtrimit të presionit ndaj zgjedhësve apo ndaj komisionerëve të qendrave të votimit, si dhe tentativa për të ndikuar vullnetin e zgjedhësve apo kryer propagandë elektorale, në afërsi apo brenda Qendrave të Votimit.
Në 1.11% të Qendrave të Votimit u vërejt së paku një rast i personave që ndërhynë në punën e komisionit të qendrës së votimit. Në të gjithë rastet e vërejtura, personat që ndërhynë në punën e komisionit ishin përfaqësues të forcave politike, dhe në pak raste ishin nëpunës shtetërorë.
Raste të propagandimit elektoral apo tentativa për të ndikuar vullnetin e zgjedhësve u vërejtën brenda Qendrës së Votimit në masën 0.83% dhe në afërsi të tyre në masën 1.94%.
Një problem, i vërejtur vetëm në një qendër votimit, por që vlen të përmendet ishte tejkalimi i kompetencave nga komisionerët e QV. Në qendrën e votimit nr. 4327 (Bashkia Dropull), komisionerët pretenduan se një votues kishte hyrë në Shqipëri ditët e fundit nga Greqia dhe si rrjedhim nuk kishte të drejtë të votonte, pasi kishte thyer karantinën. Komisioni bllokoi qendrën e votimit për rreth 45 minuta dhe në përfundim vendosën të mos e lejonin zgjedhësin të votonte. Ky është një tejkalim i qartë i kompetencave të anëtarëve të KQV-së dhe abuzim flagrant me të drejtën e shtetasve për të votuar.
Vëzhguesit vlerësuan mungesën e elementëve infrastrukturorë, të cilët vështirësuan mundësinë e personave me aftësi të kufizuara të ushtronin të drejtën e votës. Infrastruktura e Qendrave të Votimit e bënte të pamundur aksesimin e tyre dhe të votuarin në mënyrë të pavarur të personave me aftësi të kufizuara të lëvizjes në 28.98% të qendrave të votimit dhe të vështirë në 38% të qendrave të votimit. Vetëm 33.01% e qendrave të votimit u vlerësuan nga vëzhguesit si të aksesueshme nga personat me aftësi të kufizuara fizike.



GRAFIKU 8 – *Aksesueshmëria e qendrave të votimit për personat me aftësi të kufizuara në lëvizje*

Zgjedhësit e verbër që u paraqitën në qendrat e votimit përdorën asistencën e zgjedhësve të tjerë për të votuar në thuajse të gjitha rastet e vëzhguara. Vetëm në tri raste (nga 100 të vëzhguara), zgjedhësit votuan në mënyrë totalisht të pavarur, duke përdorur shabllonin me alfabetin *Braille*.
Vëzhguesit e vlerësuan në total procesin e votimit në përfundim të vëzhgimit në referencë me katër dimensione, secili prej të cilëve u vlerësua në një shkallë me katër alternativa, nga shumë e mirë në shumë problematike. Atmosfera e përgjithshme e votimit u vlerësua si "shumë e mirë" nga 69.17% e vëzhguesve dhe si "e mirë" nga 30.56% e tyre. Vetëm në një QV atmosfera e përgjithshme u vlerësua si problematike dhe në asnjë si shumë problematike.
Zbatimi i procedurave të votimit prej komisionerëve u vlerësua si "shumë e mirë" nga 69,17% e vëzhguesve dhe si "e mirë" nga 28,89% e vëzhguesve[846]. Njohja e rregullave të votimit prej zgjedhësve u vlerësuar si "shumë e mirë" nga 33,15% e vëzhguesve dhe si "e mirë" nga 57,1% e tyre[847]. Ndërsa kualifikimi i komisionerëve të Qendrave të Votimit u vlerësua si "shumë i mirë" nga 55,56% e vëzhguesve dhe si "i mirë" nga 41,39% e tyre[848].

846 Në 1.94% të qendrave të votimit zbatimi i procedurave nga komisionerët është vlerësuar si "problematike" dhe në asnjë QV nuk është vlerësuar si "shumë problematike".

847 Në 9.75% të qendrave të votimit njohja e rregullave të votimit prej zgjedhësve është vlerësuar si "problematike" dhe vetëm në një si "shumë problematike".

848 Në 3,06% të qendrave të votimi kualifikimi i komisionerëve është vlerësuar si "problematik" dhe në asnjë si "shumë problematik".

GRAFIKU 9 – *Vlerësimi i përgjithshëm i votimit*



XVI.2.3. MBYLLJA E QENDRAVE TË VOTIMIT

82,5% e qendrave të votimit u mbyllën sipas orarit ligjor (19:00), 11,94% e tyre u mbyllën mes orës 19:00 dhe 19:30, dhe 1,67% u mbyllën pas orës 19:30[849]. Në vetëm 1,94% të qendrave të votimit kishte zgjedhës që prisnin në radhë për të votuar pas orës 19:00.

GRAFIKU 10 – *Koha e mbyllje së qendrës së votimit*



Përgjithësisht, procedurat e mbyllje së qendrave të votimit dhe administrimit të materialeve zgjedhore janë respektuar me përpikëri, përveçse në një numër shumë të vogël QV-sh. Përgjithësisht shkeljet procedurale kanë pasur të bëjnë me neglizhencën në numërimin e fletëve të votimit të papërdorura (3,3% e QV-ve) apo të dëmtuara (2 qendra votimi). Në 2,5% të qendrave të votimit numri i zgjedhësve që kanë votuar nuk është nxjerrë nga PEI, sipas procedurave.
Në të gjitha qendrat e votimit të gjithë komisionerët ishin dakord me rezultatin e numërimit dhe rezultatet dhe vendimet e marra nga komisioni i qendrës së votimit u pasqyruan në procesverbalin e mbyllje së qendrës së votimit.
Nisja e materialeve zgjedhore drejt vendit të numërimit të votave është zbatuar me përpikmëri në të gjitha qendrat e votimit, por në disa prej QV-ve ka pasur vonesa të vogla të makinës që do të transportonte materialet.
Në fund të procesit të vëzhgimit, vëzhguesit vlerësuan mbarëvajtjen e procesit në përgjithësi. Në 71,94% të qendrave të votimit vëzhguesit i vlerësuan procedurat e mbyllje së qendrave të votimit si "shumë të mira", në 26,94% si "të mira" dhe në 1,11% si "problematike". Në asnjë qendër votimi, procedurat e mbyllje së votimit nuk u vlerësuan "shumë problematike".

849 3,89% e qendrave të votimit u mbyllën përpara orës 19:00.

GRAFIKU 11 – *Vlerësimi i procedurave të mbylljes*



XVI.3. NUMËRIMI I VOTAVE

XVI.3.1. MARRJA NË DORËZIM E MATERIALEVE ZGJEDHORE

Në të gjitha Vendet e Numërimit të Votave u përmbush detyrimi ligjor për balancimin politik të grupeve të formuara nga KZAZ-ja për marrjen në dorëzim të materialeve zgjedhore. Marrja në dorëzim e materialeve zgjedhore pati një procedim relativisht të shpejtë dhe pa problematika për t'u shënuar. Megjithatë, u vërejt se në 41,3% të KZAZ-ve (38) u krijuan radhë të gjata pritjeje gjatë këtij procesi.

XVI.3.2. PROCESI I NUMËRIMIT

Në ndryshim nga procesi i votimit, numërimi i votave u shoqërua me tensione, zvarritje dhe ndërprerje në një pjesë të konsiderueshme të VNV-ve, veçanërisht gjatë numërimit të votave parapëlqyese për kandidatët. Administrimi i procesit të numërimit nuk u karakterizua nga i njëjti nivel efiçence dhe transparence si ai i votimit.
KRIIK vërejti me shqetësim se, pavarësisht qëndrimeve të prera të Komisionerit Shtetëror për Zgjedhjet, vendimmarrjeve prej tij dhe thirrjeve të vazhdueshme për vijim të pandërprerë të procesit nga ana e tij, por edhe nga organizatat vëzhguese të zgjedhjeve si KRIIK, sërish edhe në këto zgjedhje vullneti zbatues i komisionerëve ndaj ligjit dhe hierarkisë institucionale mbeti dytësor, duke realizuar me vonesë të pajustifikueshme përmbylljen e numërimit dhe nxjerrjen e rezultateve prej KZAZ-ve.
Akoma më shqetësues mbeti fakti se numërimi i votave parapëlqyese nuk mori vëmendjen e duhur. Kjo jo vetëm gjatë procesit të numërimit, por si një qëndrim në vijimësi përgjatë ndërtimit dhe zhvillimit të procesit zgjedhor dhe, veçanërisht, përgjatë fushatës zgjedhore.
Problematikë e theksuar, gjatë procesit të numërimit vijoi të mbetet prezenca e personave të paautorizuar qoftë në mjediset rrethuese të VNV-ve, qoftë brenda tyre. Mosmbajtja e kartonëve identifikues në qafë prej shumicës së personave të pranishëm në vendet e numërimit të votave e bënte të vështirë identifikimin se çfarë përfaqësonin ata. Vëzhguesit e KRIIK kanë vërejtur në disa VNV vëzhgues që mbanin kartona identifikues të plotësuar me shkrim dore, pa vulën

e KZAZ-së, çka ngre dyshime mbi fiktivitetin e këtyre dokumenteve. Në 38% të KZAZ-ve janë thirrur së paku njëherë forcat e rendit për të rivendosur rregullin brenda VNV-së gjatë procesit të numërimit, në shumë prej tyre ato janë thirrur në më shumë se një rast[850].
Një tjetër fenomen i vërejtur në një numër KZAZ-sh ishte ndërhyrja e vëzhguesve në punën e grupeve të numërimit të votave duke shprehur ankesa me zë të lartë ndaj numëruesve. Qartas, pjesa më e madhe e vëzhguesve të partive politike nuk kishin dijeni në lidhje me procedurat që duhet të ndiqnin në rast se kishin pretendime apo ankimime në lidhje me punën e numëruesve. Si rrjedhim i prezencës së rritur të personave të paautorizuar në VNV dhe situatës së tensionuar, nuk munguan edhe incidentet e dhunshme, si në rastin e KZAZ-së nr. 30, në Tiranë, ku pati një konflikt dhe konfrontim fizik mes vëzhguesve dhe numëruesve në datë 26 prill në mbrëmje; apo në afërsi të KZAZ-së nr. 38, po në Tiranë. Policia e shtetit ka ndërhyrë për zgjidhjen e konflikteve në të gjitha këto raste.
Vëzhguesit vërejtën probleme gjatë procesit të numërimit që ulnin transparencën e procesit. Një nga këto probleme, i vërejtur edhe në procese të mëparshme, është kalimi shumë i shpejtë i fletëve të votimit përpara kamerës. Ky fakt krijonte vështirësi në dallimin e qartë të shenjës që kishte bërë votuesi në fletën e votimit, çka është veçanërisht problematike në rastin e votave parapëlqyese. Problematike konsiderohet edhe mungesa e njërit subjekt zgjedhor (kandidatit të pavarur për Qarkun e Tiranës, Abazi) në procesverbalin e numërimit të KZAZ-së nr. 38.
Numri jashtëzakonisht i lartë i fletëve të votimit të pavlefshme në këto zgjedhje, të cilat në praktikë janë të barasvlefshme me rreth shtatë mandate është një problem madhor. Referuar Raportit të këqyrjes paszgjedhore të KQZ-së[851], rreth 66% e votave të pavlefshme ishin shpallur të tilla pasi në fletën e votimit ishte votuar për dy subjekte zgjedhore, apo për një subjekt zgjedhor dhe kandidatin e një tjetër subjekti. Ndërsa parregullsia e parë, deri në njëfarë mase ishte e pranishme edhe në zgjedhje të mëparshme, në këto zgjedhje mori përmasa madhore. Arsyet për këtë mund të jenë keqkuptimi i qytetarëve si pasojë e fushatës individuale të kandidatëve (vendosja e dy numrave, atij të subjektit zgjedhor dhe atij të kandidatit në listë në materiale promocionale), por edhe një tjetërsim i mundshëm i votës gjatë procesit të numërimit nga ana e numëruesve. Një rast i tillë u bë me dije gjerësisht dhe në media, gjatë numërimit. Mbetet e paqartë se sa kjo i faturohet mosinformimit të qytetarëve dhe sa tjetërsimit potencial të votave gjatë procesit të numërimit. Ndërkohë, parregullsia e dytë është totalisht rrjedhojë e sistemit të ri zgjedhor, dhe veçanërisht e kompozimit të fletës së votimit. Nëse zbriten nga totali i votave të pavlefshme dy kategoritë e mësipërme (rreth 5450 vota të pavlefshme nga totali prej 8252 vota të pavlefshme në 519 qendrat e votimit ku u këqyrën materialet zgjedhore nga KQZ), përqindja e votave të pavlefshme zbret në më pak se 1.7%, shumë më pranë normës normale të votave të pavlefshme në zgjedhje të mëparshme, por sërish rreth 70% më e lartë sesa në zgjedhjet e fundit parlamentare.
Nëse në rang qarku, shpërndarja e votave të pavlefshme është thuajse e barabartë mes qarqeve të ndryshme, në nivel bashkie ka diferenca të theksuara[852]. Bashkia me numrin më të ulët të votave të pavlefshme është Himara, me 2,11% të votave të pavlefshme (sërish një numër konsiderueshëm më i lartë se mesatarja e zgjedhjeve të mëparshme, që është përafërsisht 1%). Ndërkohë bashkia me numrin më të lartë të votave të pavlefshme është Bulqiza ku arrin në 8,84%, një shifër jashtëzakonisht e lartë, edhe nëse e krahasojmë me mesataren kombëtare për këto zgjedhje.
Në një vlerësim të përgjithshëm rezulton se niveli i zbatimit të Kodit Zgjedhor dhe Udhëzimeve të KQZ-së nga KZAZ-ja gjatë procesit të numërimit të votave u vlerësua si shumë i mirë nga vëzhguesit në 66,7% të KZAZ-ve, si i mirë në 32,1% të tyre, dhe me probleme në 1,2% të tyre. Arsye për vlerësimin problematik janë cituar mungesa e njohurive të komisionerëve mbi kërkesat e legjislacionit, konsultimi i tyre mbi procedurat me persona të paautorizuar, kaosi në VNV dhe mungesa e transparencës gjatë numërimit dhe vendimmarrjes së KZAZ-ve.
Niveli i kualifikimit të anëtarëve të KZAZ-së u vlerësua si shumë i mirë në 61,5% të KZAZ-ve dhe i mirë në 35,9% të tyre. Në 2.6% të KZAZ-ve, niveli i kualifikimit u vlerësua me probleme.
Ndërkohë, niveli i kualifikimit të anëtarëve të grupeve të numërimit të votave u vlerësua si shumë i mirë në 55,1% të KZAZ-ve, si i mirë në 41% dhe me probleme në 3,9% të tyre.

850 Në KZAZ nr. 9 Bashkia Bajram Curri, KZAZ nr. 75 Bashkia Këlcyrë dhe KZAZ nr. 86 Bashkia Himarë .

851 Raport mbi gjetjet kyçe të procesit të këqyrjes të materialeve zgjedhore të përdorura nga komisiont zgjedhore në zgjedhjet për Kuvend të datës 25.04.2021.

852 Shih Shtojcën L për shpërndarjen e votave të pavlefshme sipas bashkive dhe devijimin e numrit të tyre nga numri mesatar në rang vendi.

XVII. AUDITIMI POST ZGJEDHOR

XVII.1. KUADRI LIGJOR

Pas ndryshimeve ligjore në Kodin Zgjedhor[853] në korrik 2020, për herë të parë në proceset zgjedhore në Shqipëri u implementua procesi i këqyrjes së mëpasshme të fletëve të votimit dhe materialit zgjedhor.
Auditimi pas zgjedhor konsistoi në këqyrjen e fletëve të votimit, materialit zgjedhor në kutitë përkatëse, si dhe pajisjeve të teknologjisë së informacionit të përdorura në zgjedhje, për 10% të qendrave të votimit të çdo Zone të Administrimit Zgjedhor (ZAZ).
Qendrat e Votimit për auditim u përzgjodhën në mënyrë rastësore, pasi procesi kishte përfunduar dhe ishte shpallur rezultati përfundimtar i zgjedhjeve.
Nëpërmjet këtij procesi synohet kontrolli i zbatueshmërisë së ligjit nga ana e Komisionerëve në nivelin e dytë dhe të tretë të administrimit zgjedhor, duke verifikuar rregullsinë dhe saktësinë e veprimtarisë së tyre në numërimin e votave dhe administrimin e procesit, duke nxjerrë në pah problematikat që mund të kenë karakterizuar procesin jo vetëm në nivel sasior, por edhe në nivel cilësor. Gjithashtu kontrolli shërben për të verifikuar saktësinë e sistemeve apo pajisjeve të teknologjisë së informacionit, që u përdorën për identifikimin elektronik të zgjedhësve.

Nga ana tjetër, përzgjedhja rastësore e qendrave të votimit në të cilat kryhet verifikimi, mundëson përgjithësimin e gjetjeve, pra lejon që të gjykohet në lidhje me masën në të cilën parregullsitë potenciale të identifikuara gjatë procesit janë të pranishme në të gjithë vendin.
Pavarësisht këtij konstatimi të mundshëm problematikash, është e rëndësishme të theksohet se gjetjet nuk shërbejnë dhe nuk kanë asnjë efekt në rezultatin përfundimtar, tashmë të shpallur të zgjedhjeve.
Çdo gjetje nga procesi i auditimit paszgjedhor reflektohet më pas në një ndërmarrje gjykimi administrativ apo referimi në organe të tjera kompetente, ndaj komisionerëve përgjegjës që mund të kenë kryer shkeljen. Pra, në thelb, qëllimi i procesit të auditimit paszgjedhor është verifikimi i saktësisë së kryerjes së detyrave prej komisionerëve zgjedhorë me qëllim nxitjen e përgjegjshmërisë së tyre, si dhe eliminimin e kulturës së pandëshkueshmërisë ndaj çdo shkelësi të ligjit, pjesë e administratës së zgjedhjeve, pavarësisht përkatësisë partiake apo lidhjeve politike që mund të ketë. I gjithë procesi i verifikimi regjistrohet në video dhe mund të monitorohet nga vëzhgues të pavarur, media si dhe përfaqësues të çdo subjekti politik të interesuar.
Në funksion të realizimit të auditimit paszgjedhor për Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të 25 prillit 2021, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve miratoi Udhëzimin[854] përkatës dhe përzgjodhi nëpërmjet përzgjedhjes rastësore[855] në seancë publike 519 Qendra Votimi[856], të cilat iu nënshtruan verifikimit nga administrata e KQZ-së.
Përzgjedhja rastësore e qendrave të votimit për auditim është një element shumë i rëndësishëm, pasi, së pari eliminon diskrecionin e mundshëm nga KQZ-ja në përzgjedhjen e qendrave të votimit, çka do t'i bënte gjetjet të paragjykuara dhe jo realiste.

Nga ana tjetër, përzgjedhja rastësore garanton që gjetjet mund të përgjithësohen për të gjithë vendin, me një marzh të njohur gabimi[857]. Në këtë kuptim, duke shtuar edhe 32 QV të KZAZ nr. 40 në Tiranë, të cilat iu nënshtruan të gjitha procesit të verifikimit, totali i QV-ve të audituara shkon në 551.

853 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 167/2.

854 Udhëzimi nr. 15 datë 07.10.2021 "Për përcaktimin e procedurave të këqyrjes pas zgjedhore të fletëve të votimit dhe materialeve zgjedhore"

855 Udhëzimi nr. 15 datë 07.10.2021, Kreu 2, Pika 9.

856 Në listën e QV-ve që iu nënshtruan shortit për t'u përzgjedhur nuk duhet të përfshiheshin Qendrat e Votimit të cilat ishin hapur më parë nga KAS në kuadër të kërkesave ankimore, QV-të e KZAZ nr. 7 Bashkia Pukë të cilat ishin të sekuestruara nga Prokuroria dhe as QV-të e KZAZ Nr. 40 ku u implementua votimi e numërimi elektronik, të cilat iu nënshtruan të gjitha procesit të verifikimit në kuadër të verifikimit të teknologjisë.

857 Konkretisht, këqyrja e 519 qendrash votimi, nga 5199 të tilla që u ngritën për Zgjedhjet për Kuvend të 25 prillit 2021 garanton që gjetjet mund të përgjithësohen për të gjithë vendin, me një marzh gabimi prej 4% (niveli i konfidencës 95%). E thënë ndryshe, në rast se një parregullsi e caktuar vërehet në 7% të qendrave të votimit, do të thotë se jemi 95% konfidentë që ajo parregullsi gjendet në 3% deri 11% të qendrave të votimit.

Procesi i këqyrjes u realizua nëpërmjet 8 grupeve të numërimit nga data 14 tetor deri më 2 nëntor 2021 dhe u monitorua plotësisht nga vëzhgues të KRIIK të alokuar në ambientin ku u krye verifikimi.

Përpos monitorimit të procesit në sallë, KRIIK mori nga KQZ-ja të gjithë procesverbalet e plotësuar nga grupet e verifikuesve, i hodhi të dhënat në një bazë të dhënash elektronike dhe i përpunoi në mënyrë të pavarur ato.

Të dhënat dhe informacioni kontrollohej dhe administrohej nga grupet e numërimit në KQZ në dy procesverbale, i pari që përmblidhte të dhëna mbi numrin e votave për çdo subjekt e kandidat, dhe i dyti që përmblidhte të dhëna mbi zbatimin e ligjit dhe të procedurave administrative prej komisionerëve dhe/ose numëruesit e votave gjatë procesit.

Rinumërimi i fletëve të votimit për kontrollin e numrit të votave që kishte fituar çdo subjekt zgjedhor dhe kandidat, shoqërohej më pas me krahasimin me shifrat përmbledhëse të tabelës së miratuar të rezultateve të qendrës së votimit përkatëse. Ky verifikim dhe krahasim të dhënash sasiore, u pasqyrua menjëherë në faqen e internetit të KQZ-së.

Ndërkohë, të dhënat e dala nga kontrolli i kutisë së materialeve zgjedhore, i përputhshmërisë së plotësimit të dokumentacionit e procedurave të ndjekura me kuadrin ligjor, plotësoheshin në një formular/procesverbal të dytë.

Gjetjet nga procesi i auditimit pas zgjedhor, u përmblodhën në raportin përfundimtar të hartuar nga administrata e KQZ-së dhe u miratuan[858] nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Raporti përmban jo vetëm gjetjet nga procesi, por edhe rekomandime lidhur me çështje të ndryshme në të.

Në konkluzion, referuar këtyre gjetjeve, Komisioneri i kërkoi KAS-it sanksionimin e 31 sekretarëve të 31 qendrave të votimit për problematika të hasura me Librin e Protokollit të Mbledhjeve, si dhe referoi në Prokurori 67 anëtarë të 18 Grupeve të Numërimit të Votave (GNV), pasi nga gjetjet u konkludua se kishte indicie të besueshme për veprën penale të falsifikimit të materialeve zgjedhore dhe rezultatit të zgjedhjeve.

KAS shqyrtoi kërkesën për sanksionimin e sekretarëve të QV-ve dhe vendosi[859] sanksion administrativ ndaj tyre.

Në KAS u paraqitën edhe 2 kërkesa ankimore nga anëtarë të 2 GNV-ve. Vetëm në një rast[860] KAS morri në shqyrtim pjesërisht kërkesën dhe vendosi shfuqizimin e pikës së raportit që kishte lidhje me të dhënat e numërimit të dala nga QV 3305/2.

XVII.2. PROBLEMATIKAT QË SHOQËRUAN PROCESIN E KËQYRJES PAS ZGJEDHORE

Pavarësisht se realizimi i një procesi të tillë ndërmerrej për herë të parë nga KQZ, u vëzhguan disa problematika të cilat në rezultante e bënë atë jo eficient.

Në vazhdimësi të standardit të vendosur gjatë procesit zgjedhor të datës 25 prill 2021, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve e ndau paraprakisht për sugjerime edhe draft-udhëzimin në lidhje me këtë proces, me partitë politike dhe organizatat vëzhguese të zgjedhjeve.

Udhëzimi i miratuar nga KQZ-ja parashikon se qendrat e votimit të cilat ishin hapur njëherë për efekt të kërkesave apo çështjeve të ndryshme të shqyrtuara tashmë nga KAS, do të përjashtoheshin nga shorti, përcaktim ky i cili nuk reflekton në mënyrën e duhur parashikimin e Kodit Zgjedhor[861].

Në gjykimin e KRIIK, gërma e Kodit bën konsiderimin veçmas të fletëve të votimit nga kutia

858 Vendim nr. 470 datë 03.12.2021 "Për miratimin e raporteve mbi gjetjet kyçe të procesit të këqyrjes pas zgjedhore të fletëve të votimit, materialit zgjedhor dhe pajisjeve të votimit dhe numërimit elektronik (PEVN) të përdorura në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 Prill 2021".

859 Vendim nr. 01 datë 05.01.2022 "Për shqyrtimin e kërkesës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 02, datë 24.12.2021, drejtuar Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, për vendosje sanksioni administrativ".

860 Vendim nr. 03 datë 10.01.2022 "Për pranimin pjesërisht për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 76, datë 31.12.2021".

861 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 167/2 pika 5 "...Nuk lejohet kryerja e këqyrjes së fletëve të votimit ose të materialit zgjedhor që është këqyrur më parë kryesisht ose me kërkesë të palëve të tjera të interesuara."

e materialeve zgjedhore, ndaj udhëzimi i KQZ-së nuk duhet të kishte patur qasje tërësisht përjashtimore të të dy kutive, pavarësisht së vetëm njëra i ishte nënshtruar hapjes më parë. Për më tepër, që administrata kishte dijeni të plotë se për efekt të ankimimeve në KAS ishin rinumëruar vetëm votat për subjektet zgjedhore, pra ishte hapur vetëm kutia me fletët e votimit.
Duke i përjashtuar totalisht këto qendra votimi, këto QV fitojnë status të privilegjuar dhe përjashtohen nga shorti për auditimin e dy elementeve të tjerë, shumë të rëndësishëm, siç janë këqyrja e votave preferenciale për kandidatët dhe këqyrja e materialeve zgjedhore.
Nga ana tjetër, vlen të theksohet se pavarësisht udhëzimit të miratuar, sërish 11 QV, të cilat ishin hapur njëherë për efekt ankimimesh në KAS, gabimisht dhe në kundërshtim me udhëzimin u ri-hapën edhe gjatë auditimit pas zgjedhor. Vlen të theksohet se nga procesi këqyrjes së këtyre QV-ve, në dy prej tyre u konstatuan probleme që lidheshin me rezultatin dhe respektimin e procedurës administrative.
Udhëzimi për rëndësinë që paraqet dhe risinë që mbart, duhej t'i ishte nënshtruar një diskutimi të thelluar midis strukturave të vetë KQZ-së dhe administratës së saj, për të parashikuar çdo eventualitet të mundshëm, si dhe për të forcuar saktësinë e metodikës së ndjekur dhe efikasitetin e tërë mekanizmit. Do ishte me vend përcaktimi paraprakisht dhe kategorizimi i gabimeve eventuale që mund të konstatoheshin, si dhe parashikimi i mënyrës më të mirë të procedimit të mëpasshëm për secilën kategori problematike.

Gjithashtu, përcaktimi i një marzhi gabimi që do të konsiderohej "gabim njerëzor" duhet të ishte bërë paraprakisht e jo pasi i gjithë procesi i këqyrjes pas zgjedhore të kishte përfunduar. Madje ai duhej të merrte në konsideratë parimin e proporcionalitetit e jo aplikimin në mënyrë të njëjtë të tij për çdo QV, pavarësisht numrit të votuesve në të.
Përsa i përket verifikimit të të dhënave që kanë të bëjnë me respektimin e procedurave të votimit, konstatohet problematik edhe vetë formulari i përdorur nga KQZ-ja për verifikimin e të dhënave.
Problemet me formularin konsistonin kryesisht në mënyrën se si një pjesë e pyetjeve ishin formuluar, ndërkohë që problematik ishte edhe formatimi i pyetësorit fizik që verifikuesit përdorën gjatë procesit të auditimit.

Në lidhje me pyetjet, formulari i përdorur për vlerësim ishte i ndërtuar me pyetje me dy alternativa, po/jo. Pra, nëse fenomeni që hulumtohej në pyetje ishte prezent, qarkohej alternativa "Po" dhe në të kundër alternativa "Jo".
Ndërkohë, një pjesë e konsiderueshme e pyetjeve të pyetësorit janë problematike, pasi brenda një pyetjeje të vetme përfshihen disa të tilla. Në këto raste, qarkimi i alternativës "po" ose "jo", nuk e bën të qartë nëse fenomeni nuk është verifikuar, apo nuk është plotësuar kushti paraprak, çka i bën të dhënat e evidentuara në këtë formular jo të besueshme, deri totalisht të pavlefshme[862] për një analizë të mëpasshme.

Nga ana tjetër, duke gjykuar nga mënyra e plotësimit të pyetjeve nga verifikuesit, duket se në një numër rastesh grupe të ndryshme verifikuesish kanë përdorur standarde të ndryshme në plotësimin e pyetjeve të paqarta, të cilat përfshinin më shumë se një pyetje brenda njërës. Ky është një indikator për paqartësinë e tyre në plotësimin e të dhënave, apo evidenton problematika me mënyrën se si ata janë trajnuar, çka sërish hedh hije dyshimi mbi saktësinë dhe besueshmërinë e të dhënave të mbledhura[863].
Problemi tjetër në lidhje me formularin ka të bëjë me instrumentin specifik që u përdorur nga verifikuesit, i cili ishte i keq formatuar, me karaktere tejet të vogla, dhe ku kutitë ku shënjohej përgjigja ndaj pyetjes nuk ishin në të njëjtën linjë me pyetjen. Madje, në disa raste, ndërkohë që ka një pyetje, nuk ka një kuti respektive ku mund të markohet alternativa "Po" apo "Jo", në lidhje me atë pyetje.

862 Një rast përshkrues i kësaj situate do të ishte pyetja e formuluar: Ne rast se PEI nuk është riparuar apo nuk është zëvendësuar, pas kalimit te tre orëve nga koha e njoftimit te qendrës se asistencës teknike, KQV ka marre vendim per te vijuar votimin pa PEI? Për këtë pyetje, rezultat janë 363 "jo", 10 "po" dhe në 106 raste verifikuesit e kanë lënë pa përgjigje. Në pamje të parë, këto të dhëna thonë se në 363 qendra votimi (rreth 70%) KQV nuk ka marrë vendim për të vijuar votimin pa PEI tre orë pasi është njoftuar KZAZ-ja, çka do të ishte një shkelje e rëndë e procedurave dhe një problem madhor, pasi është një përqindje shumë e lartë. Kjo pyetje nuk lejon të gjykohet se në sa prej 363 qendrave të votimit për të cilat përgjigja është "Jo" nuk ka patur probleme me PEI dhe, si rrjedhim, nuk është njoftuar KZAZ-ja dhe nuk ka patur nevojë të merret vendim për vazhdimin e votimit pa përdorimin e PEI-t. Ndërkohë që, me gjasë, ky është rasti në shumicën e përgjigjeve "Jo", por kjo nuk mund të thuhet me siguri. Në rezultante, kjo e bën të pamundur të gjykosh nëse ka patur raste të tilla dhe, nëse po, sa janë ato.

863 Duke vazhduar rastin e mësipërm, fakti që në rreth 20% të rasteve (106) verifikuesit e kanë lënë pa përgjigje këtë pyetje, mund të interpretohet si fakt se në qendrën përkatëse të votimit nuk ka patur nevojë për zëvendësimin e PEI. Kjo tregon se verifikues të ndryshëm kanë përdorur standard të ndryshëm në vlerësimin e pyetjes dhe në kthimin e përgjigjes.

Ky formatim i paqartë krijoi probleme madhore në hedhjen e të dhënave në bazën e të dhënave elektronike nga ana e KRIIK, vështirësi të cilat u konfirmuan edhe nga operatorët e KQZ-së që hodhën të dhënat në bazën e të dhënave elektronike të KQZ-së.
Përzgjedhja e QV-ve që do t'i nënshtroheshin verifikimit pas zgjedhor u krye në seancë publike në 14 tetor 2021. Pavarësisht se, referuar Kodit Zgjedhor[864], qendrat e votimit të hapura nga KAS në funksion të shqyrtimit të kërkesave ankimore, nuk duhet të ishin pjesë e shortit, kjo nuk u zbatua nga administrata për QV-të e Qarkut Berat. Konkretisht për këtë qark u përzgjodhën 11 QV të cilat u rihapën[865] për verifikim nga grupet e verifikimit edhe pse ishin hapur më parë nga KAS.

Përveçse ishte në kundërshtim me vetë udhëzimin e KQZ-së, kjo shkaktoi probleme të mëtejshme, duke qenë se në një prej këtyre qendrave të votimit u evidentuan problematika gjatë numërimit dhe numëruesit përkatës u vendos nga KQZ-ja që të referoheshin në Prokurori, pasi kishte indicie për veprën penale të falsifikimit të materialeve zgjedhore dhe rezultatit të zgjedhjeve. Numëruesit përkatës e ankimuan vendimin në KAS, i cili e pranoi kërkesën duke vendosur shfuqizimin e gjetjeve të raportit lidhur me QV-në nr. 3305/2, KZAZ nr. 65.
Gjithashtu, u vërejt se serioziteti dhe përgjegjësia e administratës së KQZ e angazhuar në rinumërim nuk ishte në nivelet e duhura. Kjo u reflektua në vonesa në realizimin e procesit, por edhe në gabime materiale përgjatë tij.
Në pjesë të caktuara të verifikimit, procesi realizohej vetëm nga një prej anëtarëve në grupet e numërimit, dhe anëtari i dytë bashkohej me vonesë, duke firmosur më pas një procesverbal me të dhëna që në fakt nuk i kishte konstatuar personalisht, por nëpërmjet kolegut të grupit.
Shumë nga procesverbalet e plotësuara prej verifikuesve figurojnë që nuk janë të plotësuara plotësisht, pasi në to mungojnë të dhëna të ndryshme: si firma, data, numra në vende të ndryshme, shënimi për po ose jo në procesverbalet për verifikimin cilësor të procesit, etj. Këto të dhëna, janë thelbësisht të rëndësishme në plotësimin e detyrimeve administrative nga administrata e KQZ e emëruar për të kryer verifikimin.
Referuar sa më sipër, KRIIK konsideron se *procesi i auditimit do të duhet të realizohet me saktësi, seriozitet dhe përgjegjshmëri më të lartë nga ana e KQZ në proceset zgjedhore në vazhdim. Konsideratë mund t'i jepet plotësimit të të dhënave automatikisht me anë të një programi kompjuterik të dedikuar nga ana e vetë verifikuesve, program i cili të gjenerojë më pas dokumentin zyrtar që të firmoset nga ana e verifikuesve për saktësi proceduriale. Kjo do të kursente kohë dhe mund, pasi të dhënat do të përpunoheshin e analizoheshin në mënyrë të drejtpërdrejt e pa gabime*[866].
Gjithashtu, KQZ do të duhet të rishikojë në themel pyetësorin e përdorur për mbledhjen e të dhënave dhe të angazhojë profesionistë "ekspertë në hartim pyetësorësh" për hartimin e tij, dhe jo të mjaftohet me hartimin e një pyetësori që thjesht liston hapat proceduralë që duhet të kryhen nga administrata zgjedhore.
Pavarësisht rëndësisë që mbart në vetvete procesi i auditimit paszgjedhor, veçanërisht duke marrë në konsideratë faktin se ai po aplikohej për herë të parë, si dhe situatën politike ku partitë politike në opozitë kanë kërkuar hetime të thelluara nga organet kompetentë dhe kanë pjesë të përditshme të diskursit të tyre publik pikërisht manipulimet në procesin zgjedhor, ai rezultoi të ishte jashtë fokusit dhe interesit të tyre për t'u ndjekur e vëzhguar[867].
Kjo mungesë interesi është një indikator shqetësues që evidenton mungesën e interesit real të partive politike për cilësinë e zhvillimit e menaxhimit të procesit zgjedhor, e rrjedhimisht për mundësinë e përmirësimit të mëtejshëm të tij, dhe fokusimin e tyre në mënyrë të kufizuar në rezultatin zgjedhor dhe proceset që mund t'a ndikojnë apo ndryshojnë atë.

864 Kodi Zgjedhor, Neni 167/2 pika 5 "Nuk lejohet kryerja e këqyrjes së fletëve të votimit ose të materialit zgjedhor që është këqyrur më parë kryesisht ose me kërkesë të palëve të tjera të interesuara".

865 QV 3345; QV 3493; QV 35111; QV 3300; QV 33052; QV 3313; QV 3314; QV 3322; QV 3430; QV 3451; QV 35791.

866 Praktika e ndjekur këtë proces duke plotësuar në formularë të dhënat e gjetura fillimisht në mënyrë manuale prej verifikuesve, dhe më pas hedhja e të dhënave të këtyre formularëve në programin kompjuterik nga një tjetër operator, edhe pa marrë në konsideratë problemet e tjera të sipërpërmendura, do të prodhojë minimalisht të dhëna që kanë në përmbajtje faktorin e "gabimit njerëzor", duke relativizuar në këtë mënyrë artificialisht saktësinë e procesit verifikimit.

867 Vetëm Partia Lëvizja Socialiste për Integrim pati vëzhgues përgjatë këtij procesi.

XVII.3. RAPORTI I KQZ-së PËR PROCESIN E AUDITIMIT PASZGJEDHOR

Raporti i hartuar për gjetjet nga këqyrja paszgjedhore e fletëve të votimit dhe materialit zgjedhor, u miratua me vendim[868] nga Komisioneri.
Raporti konsiderohet nga KRIIK si tepër sipërfaqësor dhe jo i plotë. Ndërkohë që formulari i vlerësimit të problematikave ishte tejet shterues, në raport janë përfshirë vetëm një numër i vogël i çështjeve që u verifikuan.
Raporti ka një natyrë thuajse tërësisht përshkruese, analizat në lidhje me arsyet e mundshme të problematikave të vërejtura janë thuajse inekzistente. Sa më sipër evidentohet edhe në rekomandimet e raportit, të cilat fokusohen tërësisht në masa teknike që mund të ndërmerren për të eliminuar gabimet në mbajtjen e dokumentacionit, pra duke i presupozuar tërë problematikat thjesht si "gabime njerëzore" dhe duke mos e konsideruar mundësinë e gabimeve të kryera si vullnet i qëllimtë për të ndikuar apo manipuluar rezultatin zgjedhor.
Një numër i konsiderueshëm i problematikave në raport kalohen me një fjali të vetme përshkruese (u evidentua "x" problem në "n%" të qendrave të votimit). Ky lloj konstatimi jepet edhe në rastin e problematikave të cilat, pavarësisht se janë në dukje minimale në numër dhe teknike në natyrë, japin mundësi për përdorim metodash apo mënyrash për të ndikuar apo manipuluar vullnetitn e qytetarëve dhe rezultatin zgjedhor[869].
Në raportin përfundimtar të miratuar janë evidentuar 32 Qendra Votimi sekretarët e të cilave nuk kishin administruar apo kishin administruar të paplotësuar tërësisht Librin e Protokollit të Mbledhjeve, e për rrjedhojë ata u përcollën për sanksion administrativ në KAS.
Gjatë shqyrtimit të çështjes prej këtij të fundit administrata referoi se ishin vetëm 31 dhe jo 32 QV, duke arsyetuar se një QV ishte gabimisht në listën e përfshirë në raportin përfundimtar mbi gjetjet e auditimit paszgjedhor, çka sërish është një tregues i mos dhënies së rëndësisë së duhur këtij procesi nga ana e administratës.
Në lidhje me gjetjet e Raportit, KAS realizoi 2 seanca publike, njëra e thirrur pas kërkesës së Komisionerit dhe një tjetër pas ankimimit nga anëtarët e GNV nr.4 dhe nr. 8 në KZAZ nr. 65, Bashkia Berat. Kërkesat e tjera ankimore KAS nuk i mori në shqyrtim duke qenë se objekti i tyre për referimin në Prokurori të disa numëruesve, nuk është kompetencë e KAS, por është shprehje e vullnetit të Komisionerit si nëpunës publik.
Në të dyja gjykimet e tij KAS konstatoi probleme lidhur me procesin e realizuar, si dhe parregullsi administrative në drejtim të administrimit të provave e fakteve.
Lidhur me sekretarët e KQV-ve, KAS pavarësisht se vendosi[870] masa administrative sipas kërkesës së Komisionerit[871], vlerësoi se nga ana e Komisionerit nuk ishte zhvilluar një procedurë e mirëfilltë hetimore administrative, sidomos në drejtim të vlerësimit të gjithanshëm dhe të harmonizuar të provave dhe fakteve me qëllim jo vetëm verifikimin e rregullsisë dhe saktësisë së veprimtarisë së administratës zgjedhore përgjatë administrimit të procesit, vlerësimit dhe numërimit të votave, por kryesisht të ngarkimit të tyre me përgjegjësi ligjore në lidhje me funksionin e ngarkuar në procesin zgjedhor. Në këtë kontekst, procedura hetimore e zhvilluar nga KSHZ nuk është e plotë dhe nuk kënaq në mënyrë shteruese kërkesat e ligjit sa i përket hetimit dhe përcaktimit të përgjegjësisë konkrete për secilin nga personat për të cilët është kërkuar masë administrative.
Lidhur me numëruesit e QV 3305/2, KAS shfuqizoi pjesërisht pjesën e raportit që kishte lidhje me të dhënat e numërimit të dala nga QV 3305/2.
KAS arsyetoi se[872] kjo QV nuk duhet të ishte përfshirë në verifikim paszgjedhor dhe Komisioneri nuk kishte ndjekur procedurat e duhura lidhur me verifikimin paszgjedhor dhe hetimin administrativ.

868 Vendimi nr. 470 datë 03.12.2021 "Për miratimin e raporteve mbi gjetjet kyçe të procesit të këqyrjes paszgjedhore të fletëve të votimit, materialit zgjedhor dhe pajisjeve të votimit dhe numërimit elektronik (PEVN) të përdorura në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 Prill 2021."

869 Një rast i tillë është p.sh. fakti se në raport thjesht citohet se në 86% të qendrave të votimit përputhet numri i fletëve të votimit të papërdorura të gjetura në zarfin përkatës me numrin e shënuar në procesverbalin e mbylljes së qendrës së votimit. Kjo do të thotë se në 14% të qendrave të votimit ka patur më shumë apo më pak fletë votimi të papërdorura. Raporti nuk e sqaron se në sa përqind është rasti i parë dhe sa rasti i dytë, por në rastin kur mungojnë fletë votimi të papërdorura, është një sinjal se një fletë votimi mund të ketë dalë jashtë qendrës së votimit, çka hap rrugën për manipulim të rezultatit zgjedhor në të gjithë atë qendër votimi, apo edhe në të tjera të asaj zone zgjedhore.

870 Vendim nr. 01 datë 05.01.2022 "Për shqyrtimin e kërkesës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 02, datë 24.12.2021 drejtuar Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, për vendosje sanksioni administrativ."

871 Kërkesa e Komisionerit u pranua për shkak të pasivitetit të treguar prej 31 sekretarëve, duke mos marrë pjesë në seancën e zhvilluar pavarësisht njoftimit, çka sipas KAS tregon pranim të shkeljes së kryer prej tyre.

872 Vendim nr. 05 datë 12.01.2022 "Për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 76, datë 31.12.2021".

XVII.4. GJETJE MBI TË DHËNAT E DALA NGA PROCESI I VERIFIKIMIT

XVII.4.1. GJETJE NGA VERIFIKIMI SASIOR

Nëpërmjet rinumërimit të fletëve të votimit për çdo subjekt zgjedhor e kandidat, grupet e numërimit në KQZ nxorën rezultatin përkatës të gjetur në çdo kuti votimi për çdo subjekt e kandidat. Sipas udhëzimeve të dhëna, ky grup nuk kishte të drejtë të ndryshonte numrin e fletëve të votimit të cilësuara si të pavlefshme nga numërimi i parë, por vetëm t'i këqyrte ato për të konkluduar në arsyen e pavlefshmërisë. Por, nëse një votë e pavlefshme ishte përllogaritur në favor të ndonjë subjekti apo kandidati, kjo votë do të duhej t'i zbritej. Pra në tërësi numri i votave të pavlefshme nuk mund të ulej.
Pas ri-numërimit të çdo QV-je dhe plotësimit të procesverbalit përkatës, mund të nxirrej diferenca (në rast se kishte), midis rezultatit të pasqyruar në Tabelën Përmbledhëse të Rezultateve dhe rezultatit pas verifikimit. Diferencat e gjetura nga ky proces ishin ndryshimi i numrit të votave midis subjekteve apo kandidatëve, si në kahun negativ edhe atë pozitiv[873].
Pas përfundimit të procesit vërehet se pavarësisht se në nivel jo të lartë apo ndikues në rezultat, kishte vota të përllogaritura për një tjetër subjekt apo kandidat.
Konkretisht në 371 nga 519 QV të rinumëruara (71.5%), grupi i numërimit nuk gjeti diferencë në numrin e votave për subjektet zgjedhore. Në 148 QV (28.5%) u konstatuan diferenca të niveleve të ndryshme, nga 1 në 29 vota.
Kjo shifër është tejet shqetësuese, pasi, duke marrë në konsideratë se të dhënat mund të përgjithësohen për të gjithë vendin, praktikisht do të thotë se në 24.5 deri 32.5% të qendrave të votimit në të gjithë vendin ka patur gabime në numërimin e votave nga ana e numëruesve. Përtej faktit se me sa vota lëviz rezultati dhe nëse kjo ka ndikim ose jo në rezultatin zgjedhor, duke marrë në konsideratë se verifikimi paszgjedhor nuk kishte për qëllim të ndryshonte rezultatin, por të evidentonte parregullsitë dhe të ngarkonte administratorët përkatës të zgjedhjeve me përgjegjësi, gjetjet tregojnë një nivel shumë të ulët përgjegjësie të numëruesve. Nga 17 subjekte zgjedhore të përfshirë në fletën e votimit, për shtatë[874] prej tyre nuk u konstatua asnjë diferencë në rezultatin për subjektin zgjedhor edhe pas këqyrjes. Për 10 subjektet e tjera diferencat ishin të ndryshme[875], por diferenca më e lartë u konstatua për Koalicionin PD-AN me 118 vota më shumë.
Akoma më shqetësuese janë të dhënat e rinumërimit për votat e kandidatëve, pra për votimin preferencial. Vërehet se, në ndryshim nga rezultatet për subjektet zgjedhorë, numri i QV-ve tek të cilat nuk ka patur diferenca është vetëm 26 QV nga 519 të tilla (5%). Në të gjitha 493 QV-të e tjera janë konstatuar diferenca, që fillojnë nga 1 votë në 76 të tilla.
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vendosi që të konsideronte diferencat nga 1 në 20 vota si gabim njerëzor, ndërkohë që numëruesit e 18 QV-ve tek të cilat diferenca në numërimin e votave ishte nga 21 deri në 76 vota u referuan në Prokurori si të dyshuar për veprën penale të falsifikimit të materialeve zgjedhore dhe rezultatit të zgjedhjeve.
Kjo shifër është arbitrare dhe nuk shpjegohet në asnjë rast në raport se cili është arsyetimi i përdorur për të përcaktuar këtë kufi, por përdoret një shprehje tepër e vagullt dhe e përgjithshme se "... ndryshimi i rezultateve nga 1-20 vota për kandidatët është vlerësuar se është një marzh i pranueshëm gabimi njerëzor, referuar edhe standardeve teknike për sa kohe këto diferenca nuk kanë ndikuar në ndryshim domethënës të rezultatit për kandidatë...".

Nuk është e qartë se cilave standarde teknike i referohet pjesa e parë e arsyetimit, ndërkohë që argumenti i dytë, se diferencat nuk kanë ndikuar në rezultat nuk justifikon përcaktimin e kufirit prej 20 votash, pasi po në të njëjtin paragraf të raportit citohet se "...marzhi i gabimit nga grupet e numërimit të votave për subjektet nuk kanë ndikuar në ndryshimin e rezultatit të zgjedhjeve". Mbetet e paqartë, pra, cila është arsyeja e veçimit të këtyre grupeve të numërimit nga të tjerët, pasi në asnjë rast duket se diferencat nuk kanë sjellë ndryshime të rezultatit.

873 Kur diferenca është negative tregon se numri i votave te gjetura nga procesi i këqyrjes është më i vogël se numri i votave plotësuar në tabelën përmbledhëse nga grupi i numërimit të parë. Kur diferenca është pozitive tregon se numri i votave te gjetura nga procesi i këqyrjes është më i madh sesa numri i votave plotësuar në tabelën përmbledhëse nga grupi i numërimit të parë.

874 Partia Balli Kombëtar, Partia Lëvizja për Ndryshim dhe 5 kandidatët e pavarur.

875 PSD me 6 vota më shumë, PLDSH me 3 vota më shumë, BD me 6 vota më shumë, Koalicioni ABEOK me 4 vota më pak, LSI me 19 vota më shumë, NTH me 3 vota më pak, LRE me 3 vota më pak, Koalicioni PD-AN me 118 vota më shumë, ADR me 1 votë më pak, dhe PS me 71 vota më shumë.

Në total figuruan 682 kandidatë[876] nga 1.832 të tillë, për të cilët, pas rinumërimit, u gjetën diferenca në rezultat.
Diferenca më e madhe është gjetur për deputetin e koalicionit PD-AN Z. Lefter Gështenja të cilit i ishin vendosur 116 vota më shumë në tabelat përmbledhëse të rezultateve. Ndërsa kandidati të cilit i është hequr numri më i lartë i votave është në të njëjtin subjekt zgjedhor dhe në të njëjtën zonë zgjedhore, Z. Ardian Zeneli, i cili pas rinumërimit rezultoi ti mungonin 100 vota.
Përgjithësisht diferenca në votat e kandidatëve plotësohen brenda të njëjtit subjekt, pra nëse i hiqen një kandidati të një force politike i shtohen një kandidati tjetër brenda të njëjtit subjekt.

Gjithashtu, numri më i lartë i kandidatëve tek të cilët janë gjetur diferenca është në subjektet të cilat kanë propozuar numëruesit në Grupet e Numërimit të Votave, pra PS, PD dhe LSI.
Sa më sipër, krijojnë dyshime të forta se gabimet janë të qëllimshme, apo edhe të ndikuara nga kandidatë të caktuar. Për më tepër, fakti që votat e kandidatëve kanë lëvizur brenda kandidatëve të së njëjtës forcë politike, është një sinjal tejet shqetësues, pasi është indikacion se numëruesit e partive politike kundërshtare, të pranishëm në procesin e numërimit janë treguar pasivë në mbrojtjen e integritetit të zgjedhjeve, për sa kohë që rezultati për partinë që i ishte emëruar ata mbetej i njëjti. Pra, parësore për këta numërues ka qenë mbrojtja e interesit të partisë që i kishte emëruar dhe jo plotësimi i detyrave si administrator zgjedhor në përputhje me ligjin, duke u sjellë si militantë partiakë dhe jo administratorë të paanshëm të procesit. Lidhur me gjetjet nga këto të dhëna Komisioneri referoi në Prokurori 67 numërues të 18 Grupeve të Numërimit të Votave. KRIIK gjykon se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve do të duhej të kishte ndërmarrë masa më të forta në lidhje me verifikimin e arsyes së këtyre mospërputhjeve, dhe jo të mjaftohej me gjykimin se deri në një numër të caktuar të votave që kanë mospërputhje (numri arbitrar prej 20 votash diferencë) mund të konsiderohet "gabim njerëzor" dhe mbi këtë numër do të ketë referim në Prokurori.

XVII.4.2. VERIFIKIMI CILËSOR

Procesi i administrimit të zgjedhjeve nga komisionerët e qendrave të votimit dhe numëruesit, referuar procesverbaleve të plotësuara nga stafi i KQZ-së, i cili kreu auditimin e tyre, konsiderohet i shoqëruar me shumë problematika.
Nuk është e qartë nëse këto janë probleme për shkak të gabimeve njerëzore, problematikave me formularin e përdorur (shih më sipër) apo si rezultat i të mos paturit të informacionit të nevojshëm lidhur me administrimin e procesit, çka mund të jetë rezultat i mungesës së një trajnimi të plotë të verifikuesve.
Të dhënat e pasqyruara në këto procesverbale, sikurse është përmendur edhe më sipër, nuk janë të plota. Përpos faktit që ka pyetje përgjigja e të cilave nuk është në procesverbal, edhe pyetjet në vetvete në shumë raste janë të paqarta për t'u përmbledhur në përgjigje me "po" dhe "jo", por kërkojnë përgjigje më të shtjelluara.
Sa i përket procesit të votimit, nga të dhënat e auditimit rezulton që në 14% të QV-ve ka filluar pas orës 7.00[877], ndërsa në 16% ky proces është mbyllur pas orës 19.00[878]. Në 3% të QV-ve ka patur pezullim të votimit për arsye të ndryshme, ndërsa 2 QV nga 519 të audituara rezultojnë të kenë kërkuar ndihmën e Policisë së Shtetit.
Lidhur me dokumentacionin e nevojshëm për plotësim nga komisionerët e qendrës së votimit, rezulton të ketë patur probleme serioze, të cilat në raportin e KQZ-së në lidhje me këtë proces janë kaluar me një fjali të vetme përshkruese, ose nuk janë përmendur fare.

Konkretisht, referuar të dhënave të procesit të auditimit pas zgjedhor në 14% të qendrave të votimit vendimet e komisionit nuk kanë qenë të vulosura me vulën e KQV-së, dhe në 5% procesverbalet kanë qenë të pa vulosura.

876 Tek PS ka patur diferenca për 135 nga 153 kandidatë; Tek PD-AN ka patur diferenca për 107 nga 153 kandidatë; Tek LSI ka patur diferenca për 141 nga 153 kandidatë; Tek LN ka patur diferenca për 46 nga 153 kandidatë; Tek ADR ka patur diferenca për 15 nga 153 kandidatë; Tek LRE ka patur diferenca për 30 nga 153 kandidatë; Tek NTH ka patur diferenca për 33 nga 153 kandidatë; Tek ABEOK ka patur diferenca për 13 nga 153 kandidatë; Tek BD ka patur diferenca për 37 nga 153 kandidatë; Tek LDSH ka patur diferenca për 25 nga 153 kandidatë; Tek PBK ka patur diferenca për 24 nga 153 kandidatë; Tek PSD ka patur diferenca për 76 nga 153 kandidatë.

877 Ndërkohë, nga gjetjet e vëzhguesve të KRIIK gjatë ditës së votimit, rezulton se vetëm 66.67% e qendrave të votimit janë hapur në kohë (shih Seksionin "Dita e Votimit" në këtë Raport). Diferenca në shifra me gjasë tregon neglizhencë të komisionerëve në evidentimin si hapje me vonesë për vonesa me disa minuta, çka vëzhguesit e KRIIK e kanë konsideruar hapje me vonesë.

878 Sipas gjetjeve të KRIIK, 14.6% e qendrave të votimit janë mbyllur pas orës 19:00. Duke konsideruar marzhin e gabimit në të dy rastet, kjo shifër konsiderohet të përputhet.

Gjithashtu në 6% të QV-ve, në kutinë e materialeve zgjedhore nuk u gjet procesverbali ku shënohet numri i fletëve të votimit të marra në dorëzim.

Ajo që konsiderohet një shkelje edhe më e rëndë është fakti që në 8% të QV-ve rezulton të ketë patur fletë votimi të pavulosura, një neglizhencë e cila, de facto, e bën të pavlefshme votën e qytetarit që ka përdorur atë fletë votimi.

8 kuti votimi janë konstatuar të dëmtuara prej grupit të rinumërimit, ndërsa 3 nuk kanë qenë të vulosura siç duhet.

Gjithashtu rezultuan 338 qendra votimi të cilat kanë së paku një mungesë të materialeve të nevojshme zgjedhore, të përcaktuara sipas ligjit për të qenë në kuti[879].

Kjo e dhënë tregon një situatë të rëndë në lidhje me aftësinë / përgjegjësinë e komisionerëve të nivelit të tretë për të administruar procesin zgjedhor. Praktikisht, do të thotë se në 65% të qendrave të votimit, materialet zgjedhore nuk janë administruar sipas procedurave në fuqi.

Në 16% të QV-ve procesverbalet të cilat duhet të gjenden brenda kutisë së votimit apo materialeve zgjedhore, nuk janë gjendur aty nga grupi i rinumërimit.

Në 19.6% të QV-ve (102 QV) nuk janë shënuar të dhëna në lidhje më numrin e zgjedhësve sipas kërkesave ligjore[880].

Libri i Protokollit të Mbledhjeve (LPM) është protokolli ku duhet shkruar çdo gjë që ndodh në qendrën e votimit, gjë që është përgjegjësi direkte e sekretarit të QV-së.

Sipas të dhënave të verifikimit, 31 QV nuk e kanë plotësuar fare LPM. Në LPM të 18 QV-ve ka shënime për zgjedhës që kanë tentuar të votojnë më shumë se një herë; në 73 QV ka shënime për zgjedhës që nuk e kanë gjetur emrin në listë; në 37 QV të dhënat e pasqyruara në procesverbale janë të ndryshme nga ato që janë gjendur në LPM, në 39 QV ka patur shënime për dorëheqje apo zëvendësime të anëtarëve të komisionit; në 419 QV nuk kishte asnjë shënim për largimin dhe kthimin e ndonjë anëtari të komisionit.

Duke patur në konsideratë se qëllimi i auditimit pas zgjedhor nuk është vetëm rinumërimi në funksion të rezultateve, por sidomos kontrolli i respektimit të kuadrit ligjor në procedurat e ndjekura nga komisionerët zgjedhorë, *çdo problem i vërejtur do të duhet të shërbejë si indicie për përmirësim jo vetëm të kuadrit rregullator, por edhe në rishikimin e moduleve të trajnimit për komisionerët, veçanërisht kohëzgjatjes dhe periodicitetit të tyre.*

XVII.4.3. VERIFIKIMI I FUNKSIONIMIT TË PAJISJEVE PEI

Procesi i verifikimit të të dhënave daktiloskopike të mbledhura nga Pajisjet Elektronike të Identifikimit (PEI) ishte gjithashtu pjesë e verifikimit nga administrata e KQZ, për QV-të e përzgjedhura për t'u verifikuar.

Në procesverbalin që duhet të plotësohej nga grupi i verifikimit kishte disa pyetje të cilat i referoheshin mbledhjes së të dhënave lidhur më përdorimin e PEI.

Sipas udhëzimit të Komisionit Rregullator, raporti i hapjes dhe i mbylljes i gjeneruar nga pajisja PEI nënshkruhet nga anëtarët e KQV-së dhe futet në kuti.

Raporti i hapjes së procesit të identifikimit elektronik rezultoi se mungonte në 20% të QV-ve, ndërsa ai i mbylljes në 18% të QV-ve.

Gjithashtu, në së paku 15% të QV-ve të audituara, shënohet se është hasur së paku një problem me PEI gjatë ditës së zgjedhjeve.

Implementimi për herë të parë i identifikimit elektronik të zgjedhësve u shoqërua me problematika të ndryshme, të cilat u vërejtën dhe bënë publike edhe gjatë ditës së zgjedhjeve, dhe që janë deri diku të pranueshme nisur edhe nga koha e shkurtër në dispozicion për vënien

879 Në kutinë e materialeve zgjedhore mungojnë dokumente të tilla si:
a) zarfi ku janë vendosur fletët e votimit te papërdorura,
b) zarfi ku janë vendosur "FLETE VOTIMI TE DEMTUARA",
c) zarfi "VERTETIME TE IDENTIFIKIMIT ELEKTRONIK TE ZGJEDHESVE",
ç) lista e zgjedhësve, përfshi edhe regjistrin e posaçëm te zgjedhësve,
d) origjinalet e vendimeve te KQV-së dhe formularët tip të papërdorur te vendimeve te KQV-se,
dh) vula e KQV-së,
e) vula e kryetarit te KQV-së,
ë) vulat me kodet e sigurisë të papërdorura,
f) vulat me kodet e sigurisë të dëmtuara,
g) procesverbali i mbylljes së PEI,
gj) libri i protokollit te mbledhjeve të KQV-së

880 Në procesverbalin e mbylljes ose në librin e protokollit të mbledhjes nuk ka të dhëna lidhur me numrin e zgjedhësve apo të numrit të zgjedhësve femra që kanë votuar.

në funksion të kësaj teknologjie.
KQZ, bazuar edhe në problematikat e vërejtura nga auditimi në përdorimin e PEI, duhet të angazhohet në një fashë më të shtrirë kohore përpara zgjedhjeve të ardhshme për rekrutimin dhe trajnimin periodik të operatorëve të PEI, për të minimizuar dhe përballur problematikat që shoqërojnë këtë proces.

XVII.4.4. VOTAT E PAVLEFSHME

Numri i votave të pavlefshme në procesin zgjedhor të 25 prillit 2021 ishte më i larti i konstatuar ndonjëherë në proceset zgjedhore në Shqipëri (rreth 5%).
Vlerësimi i natyrës së pavlefshmërisë së tyre ishte pjesë e këqyrjes nga grupet e verifikimit. Anëtarët e këtyre grupeve mund vetëm të këqyrnin natyrën e votave të pavlefshme, por nuk mund të gjykonin nëse numëruesit i kishin konstatuar saktë si të tilla apo jo. Ndërkohë ky grup, nëse konstatonte vota dukshëm të pavlefshme të llogaritura për ndonjë subjekt zgjedhor, duhet t'i hiqnin nga subjekti zgjedhor përkatës dhe t'i klasifikonin si të pavlefshme. Në rezultante, pas verifikimit, numri i votave të pavlefshme mund vetëm të rritej.
Sipas të dhënave të verifikimit në formularët e verifikimit të administruar, rezulton të jenë konstatuar vota të pavlefshme për shkak të gjetjes së fletëve të votimit në formë, ngjyrë e përmbajtje të ndryshme me fletën e votimit në katër qendra votimi[881].
Kjo shkelje e konstatuar është shumë më e rëndë se thjesht kategorizimi si votë e pavlefshme, duke qenë se prezenca e një vote të tillë është indikacion se së paku një zgjedhës ka futur në kuti një fletë letre që nuk ka qenë fletë votimi dhe, si rrjedhim, fletën e votimit të marrë prej komisionit mund t'a ketë nxjerrë jashtë qendrës së votimit.

Në një rast të tillë, ekziston mundësia e ndërmarrjes së një mekanizmi apo metode për të manipuluar rezultatin e deformuar vullnetin e zgjedhësve (si psh. mundësia për të votuar me fletë votimi të shënjuara paraprakisht jashtë QV-së).
Asnjë hap i mëtejshëm nuk u ndërmor nga KQZ-ja në lidhje me këto raste, por ato thjesht u cituan në raportin e verifikimit paszgjedhor dhe kjo kategori votash të pavlefshme, e cila është e një natyre tjetër që nxit dinamike të tjera, u përllogarit si e të njëjtës natyrë me kategoritë e tjera të votave të pavlefshme[882].

Sipas raportit të KQZ-së evidentohet se:

- 41 % e votave të pavlefshme janë për shkak se është votuar për më shumë se një nga subjektet zgjedhore në fletën e votimit.
- 25 % e votave te pavlefshme janë për shkak se është votuar për një subjekt zgjedhor dhe për kandidatin e një subjekti tjetër zgjedhor.
- 15 % e votave të pavlefshme janë për shkak se janë me shënime që pamundësojnë vlerësimin e votës nëse është në favor të një subjekti zgjedhor.
- 19 % e votave të pavlefshme janë për arsye të tjera sipas parashikimeve të nenit 117, pika 3 e Kodit Zgjedhor

XVII.5. VERIFIKIMI I QV-VE NË ZAZ NR. 40

Të gjitha Qendrat e Votimit të Zonës së Administrimit Zgjedhor (ZAZ) nr. 40 Bashkia Tiranë ku u implementua për herë të parë votimi dhe numërimi elektronik, i'u nënshtruan procesit të auditimit nga grupet e numërimit në KQZ.
Pas këtij procesi nuk u konstatua asnjë diferencë, si për subjektet edhe për kandidatët. Për këto qendra votimi u krye vetëm verifikim sasior.
Nisur nga suksesi i përdorimit të votimit dhe numërimit elektronik, KQZ-ja duhet të bëjë përpjekje për ta shtrirë atë në më shumë zona zgjedhore, por duke e bashkëshoqëruar këtë proces me një kuadër rregullator të plotë, të detajuar dhe të qartë dhe duke ofruar transparencë të plotë, siguri nga ndërhyrjet kompjuterike dhe fshehtësinë e votës së qytetarëve.

881 QV-07382, Qarku Lezhe; QV-0182, Qarku Shkodër; QV-17951 dhe QV-1532, Qarku Tiranë.

882 Shih Raportin e KQZ-së, faqe 9.

XVIII. REKOMANDIME

REKOMANDIME PARËSORE

Procesi për një reformë të thellë dhe strukturore të kuadrit ligjor që afekton zgjedhjet, përfshirë, por pa u kufizuar në Kodin Zgjedhor, duhet të jetë një nga prioritetet kryesore të Legjislaturës së ardhshme të Kuvendit. Procesi reformues duhet të bazohet në parimet e transparencës së plotë dhe gjithëpërfshirjes reale të aktorëve të interesuar apo atyre me ekspertizë, vendas apo ndërkombëtarë, dhe jo të kufizohet vetëm tek aktorët politikë kryesorë dhe ekspertiza e huaj. Ndryshimet ligjore do të duhet të konsultohen me grupimet qytetare dhe të interesit përpara se të miratohen nga Kuvendi.
Është e domosdoshme që të garantohen mekanizmat për të garantuar një Komision Qendror të Zgjedhjeve si *de jure* ashtu edhe *de facto* të pavarur nga partitë politike dhe interesat e ngushtë dhe afatshkurtër të tyre.
Nëse me ndryshimet ligjore të ardhshme do të ruhet votimi preferencial, do të duhet që alokimi i mandateve të pasqyrojë realisht preferencat e votuesve, pa barriera fiktive ligjore që dëmtojnë përfaqësimin.
Kuadri ligjor dhe mekanizmat që garantojnë transparencën e financave zgjedhore duhet të rishihen në themel dhe të ndryshohen, me qëllim garantimin e një transparence maksimale dhe kontrolli efikas. Transparenca e financimit të partive politike përpara ditës së zgjedhjeve duhet të garantohet.
Kuadri ligjor duhet të parashikojë kufizime për pjesëmarrjen e zyrtarëve të lartë në fushatë, në mënyrë që shteti dhe partia në pushtet të jenë të ndara. Nevojitet mekanizma shumë më efikasë dhe realisht funksionalë që të garantojnë mospërfshirjen e punonjësve publikë në fushatë, dhe veçanërisht që të eliminojnë mundësinë për intimidimin dhe detyrimin e tyre për të marrë pjesë.

REKOMANDIME TË TJERA

E drejta e kryetarëve të partive për të kandiduar në më shumë se një zonë zgjedhore duhet të eliminohet, për të ruajtur parimin e barazisë mes kandidatëve.
Mund të konsiderohet një formulë e cila të jetë më e drejtë në ndarjen e mandateve mes zonave zgjedhore dhe të garantojë barazinë e votës. Një model i bazuar në numrin e shtetasve apo të zgjedhësve, por i korrektuar bazuar në numrin e zgjedhësve që në fakt kanë votuar në një numër zgjedhjesh të mëparshme do të ishte më i drejtë, veçanërisht duke mbajtur në konsideratë se zona të caktuara të vendit kanë lëvizje demografike të ndryshme, qoftë me drejtim brenda apo jashtë vendit.
Kodi Zgjedhor duhet të adresojë pragun ligjor për kandidatët e propozuar nga qytetarët, me qëllim që ata të kenë mundësi reale që të konkurrojnë.
Rekomandohet ngritja e një trupe profesionale komisionerësh zgjedhorë në përbërje të komisioneve zonale të administrimit zgjedhor me individë profesionistë, pa lidhje me forcat politike. Kjo është e domosdoshme të shoqërohet me mekanizma që të garantojnë se këta individë nuk do të ndëshkohen apo shpërblehen për veprimet apo mosveprimet e tyre në zbatim të ligjit gjatë procesit zgjedhor.
Rekomandohet që legjislacioni të parashikojë vendndodhje të përhershme të mjediseve ku trupat e administratës zgjedhore kryejnë aktivitetin e tyre, vendndodhje që mund të rifreskohet në vijimësi nga administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, sipas mundësive në terren. Kjo qasje do të rriste operativitetin e administratës së KQZ-së për pajisjen në kohë të komisioneve me infrastrukturën dhe shërbimet e nevojshme.
KQZ duhet të adoptojë mekanizma që garantojnë rritje të transparencës, të tilla si ofrimi i të dhënave të hapura, publikimi i regjistrimeve video nga tavolinat e numërimit, publikimi i menjëhershëm i vendimeve të komisioneve zonale të nivelit të dytë dhe atij të tretë, etj. Në konsideratë duhet marrë edhe transmetimi video në kohë reale i procesit të numërimit (përfshi mjediset e KZAZ-ve dhe tavolinat e numërimit), apo edhe i procesit të votimit).
Publikimi i vendimeve të administratës zgjedhore në të gjitha nivelet të kryhet në faqen e

internetit të KQZ-së dhe/ose të Njësive të Qeverisjes Vendore në territorin e të cilave këto KZAZ janë vendosur, si p.sh. në faqet ueb të Bashkive, Qarkut apo edhe të Prefekturës.
Në funksion të rritjes së transparencës, denoncimet e paraqitura në KQZ nga aktorë të ndryshëm duhet të shqyrtohen në seanca publike me prezencën e palëve në proces.
Legjislacioni duhet të konsiderojë kufizimin e të drejtës së partive politike për të ndërruar komisionerët e qendrave të votimit dhe anëtarët e grupeve të numërimit të votave në mënyrë të pamotivuar dhe në prag të ditës së zgjedhjeve, pasi kjo gjë pengon trajnimin zyrtar, dhe rrjedhimisht ndikon drejtpërdrejt në efikasitetin e këtyre komisioneve.
Mekanizmat e njoftimit të zgjedhësve për praninë në listë, përfshi publikimin e listave dhe njoftimin me shkrim të zgjedhësve duhet të garantojnë që të gjithë zgjedhësit shqiptarë të kenë mundësinë të informohen. Mekanizmi nuk mund të bazohet vetëm në njoftimin në format elektronik, i cili, pavarësisht se është eficient dhe i thjeshtë në përdorim, mund të mos jetë i përshtatshëm për të gjitha kategoritë e zgjedhësve. Është e nevojshme që të rregullohet në mënyrë më të plotë mekanizmi i njoftimit me shkrim, në të tërë elementët e tij, në mënyrë që të parandalohet vullneti individual apo edhe institucional për sabotimin e këtij procesi.
Në mënyrë që operimi i partive politike të jetë në përputhje me normat demokratike të sanksionuara nga Kushtetuta duhet që në ligjin për partitë politike të përcaktohet qartë, minimalisht, se mandati i kryetarit të partisë dhe organeve drejtuese të saj duhet të ketë një kohëzgjatje të caktuar (një kohëzgjatje tavan mund të parashikohet në ligj) dhe se partia duhet të kryejë zgjedhje brenda afatit të caktuar në ligj.
Përveç sa më sipër, kuadri ligjor duhet të përcaktojë mekanizmat e verifikimit dhe sanksionet ndaj partisë politike që nuk përmbush këtë normë ligjore. Mund të konsiderohet që një nga tagrat e KQZ-së të jetë edhe verifikimi i kritereve minimale të demokracisë së brendshme të partisë, si kusht për regjistrimin si subjekt zgjedhor.
Procesi i verifikimit të kandidatëve duhet të përfundojë përpara ditës së zgjedhjeve. Edhe nëse rezulton i pamundur për shkak të kohës së nevojshme në rastet e verifikimeve edhe jashtë vendit, së paku duhet të bëhen publike rezultatet e verifikimit brenda territorit të Shqipërisë, në funksion të të cilit do mjaftonte vetëm një ndërveprim më i mirë ndërmjet institucioneve.
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duhet të marrë një rol shumë më proaktiv në mbikëqyrjen e financave të subjekteve zgjedhore. Monitorimi i kryer nga KQZ-ja duhet të përfshijë kostimin e aktiviteteve zgjedhore. Në përgjithësi, masa duhet të ndërmerren që monitorimi të jetë eficient dhe të dhënat e siguruara prej monitoruesve të vendosen në dispozicion të publikut në kohë dhe në format të thjeshtë.
Një vëmendje të veçantë duhet të marrë monitorimi i aktiviteteve të partive politike përpara nisjes së fushatës zgjedhore, me qëllim vlerësimin e saktë dhe të vërtetë të shpenzimeve të kryera me qëllime elektorale, duke qenë se partitë politike në Shqipëri, prej vitesh tanimë e nisin fushatën disa muaj përpara fillimit ligjor të saj.
Duhet fuqizuar më tej dhe dhënë një rol më i madh auditëve ligjorë dhe monitoruesve, në kontrollin e finacimit të partive, duke futur teknologjinë në ndihmë të kostimit të aktivitetit elektoral por edhe sigurimit të transparencës maksimale.
Kodi Zgjedhor duhet të përfshijë një seksion të dedikuar sjelljes së mediave gjatë periudhës zgjedhore (jo vetëm fushatës zgjedhore) duke e shkëputur seksionin e fushatës nga ai i sjelljes së mediave. Kodi duhet të përfshijë detyrimin e të gjitha mediave që operojnë në Republikën e Shqipërisë për të përmbushur parimet e paanësisë dhe informimit objektiv të qytetarëve, dhe jo të kufizohet tek detyrimet e mediave audiovizive.
Për të përmbushur misionin e saj për të marrë dhe transmetuar informacion në mënyrë të pavarur, media duhet të ketë sigurinë që të jetë e lirë të mbulojë çdo aktivitet elektoral në bazë të kapaciteteve të saj.
AMA duhet të marrë masa që në të ardhmen mbulimi mediatik të monitorohet si në elementë sasiorë ashtu edhe në elementë cilësorë, të tilla si konteksti apo toni i përdorur nga mediat në mbulimin e fushatës zgjedhore. Duke qenë se subjektet zgjedhore, de facto, e nisin fushatën muaj përpara afatit 30 ditor, duhet që monitorimi i mediave të jetë më i shtrirë në kohë.
Legjislacioni duhet të përcaktojë qartë afatet e kompensimit të hapësirës së munguar mediatike për një subjekt zgjedhor. Këto afate duhet të kenë efekt të menjëhershme përgjatë periudhës së monitorimit, që të mund të sigurojnë një paanshmëri të mbulimin e aktiviteteve zgjedhore.
Subjekteve zgjedhore apo kandidatëve të pavarur duhet t'u jepet hapësirë barabartë e reklamave politike në televizionin publik. Më të njëjtin parim Kodi Zgjedhor duhet t'u japë të gjitha subjekteve zgjedhore, si dhe kandidatëve të pavarur, mundësi të barabarta për të promovuar platformat e tyre në mediat private, duke rritur transparencën e tarifimeve të

reklamave politike në këto media.
Mediat sociale duhet të konsiderohen si mediat e tjera tradicionale në të gjitha aktet rregullatore që kujdesen për pasqyrimin mediatik apo publikimin dhe shpërndarjen e informacionit.
Mekanizmi i monitorimit dhe sanksionimit të sjelljes së mediave duhet të rishikohet në mënyrë që të garantojë që qytetarët do të marrin informacion të paanshëm dhe objektiv përgjatë fushatës zgjedhore. KQZ duhet të shqyrtojë raportet e AMA-s me një frekuencë shumë më të shpeshtë dhe të vendosë afate të qarta për kompensimin e minutazhit të munguar.
KQZ në bashkëpunim me Bashkitë, duhet të përpunojë akte nënligjore të cilat garantojnë aksesueshmërinë e personave më aftësi të kufizuara në procesin zgjedhor. Sugjerohet ndërtimi i një bazë të dhënash të përhershme e cila të mund të përditësohet dhe të kihet në konsideratë në vazhdimësi në përgatitjen e infrastrukturës zgjedhore të radhës.

XIX. MBI KRIIK

MBI ORGANIZATËN

Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK Albania) është një organizatë jofitimprurëse dhe joqeveritare, e themeluar në tetor të vitit 1997 nga një grup studentësh. Qendra e organizatës është në Tiranë, dhe aktiviteti i saj shtrihet në të gjithë vendin, duke operuar nëpërmjet aktivistëve të vet lokalë dhe/ose organizatave partnere. KRIIK është regjistruar në dhjetor 1997, në formën e shoqatës me anëtarësi. Trupa më e lartë vendimmarrëse e organizatës është Mbledhja e Përgjithshme e Anëtarëve, e cila zgjedh organet drejtuese dhe mbikëqyr punën e tyre, si dhe miraton dokumentet e rëndësishme statutore, strategjike dhe politike.
Vlerat themelore në të cilat bazohet aktiviteti i KRIIK janë: angazhimi qytetar vullnetar; paanësia dhe pavarësia; integriteti; konsekuenca në përmbushjen e misionit me profesionalizëm dhe përkushtim; objektiviteti në vlerësimin e fakteve dhe argumenteve; respekti për diversitetin njerëzor dhe atë të opinioneve; transparenca në veprimtari dhe ruajtja e mjedisit.
Vizioni i KRIIK është ai i një shoqërie ku: mbizotëron shteti ligjor; respektohen katërcipërisht dhe pa kompromis të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, liritë qytetare, politike dhe të ndërgjegjes të të gjithë individëve, pa asnjë dallim; ku mbizotëron sensi i komunitetit dhe qytetarët janë të angazhuar në hartimin e politikave publike në mënyrë domethënëse dhe sovrane dhe ku përfaqësuesit e zgjedhur e zyrtarët e tjerë publikë kanë si interes parësor mirëqenien e qytetarëve.
KRIIK punon për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe sigurisë njerëzore, forcimin e shtetit të së drejtës dhe qeverisjes demokratike; nxitjen e aktivizmit dhe angazhimit qytetar dhe nxitjen e llogaridhënies së institucioneve publike dhe politike.

ANGAZHIMI NË LIDHJE ME INTEGRITETIN ZGJEDHOR

KRIIK është angazhuar në vëzhgimin e zgjedhjeve prej themelimit të vet, duke angazhuar aktivistë si vullnetarë në aksione vëzhgimi të zgjedhjeve në kuadër të të tjera organizatave. Prej vitit 2000, KRIIK ka qenë pjesë aksioneve të përbashkëta të vëzhgimit të disa grupimeve të organizatave vendase.
Prej 2005-ës, KRIIK ka qenë anëtar themelues e më pas edhe një nga organizatat drejtuese të Koalicionit të Vëzhguesve Vendorë (KVV), grupimi më i madh i organizatave vendore që kanë vëzhguar zgjedhjet në Shqipëri. Në kuadër të *apo* në bashkëpunim me Koalicionin e Vëzhguesve Vendorë, KRIIK ka vëzhguar të gjitha zgjedhjet e përgjithshme, parlamentare apo lokale, të zhvilluara në Shqipëri prej vitit 2005 deri në vitin 2017, si dhe shumicën e proceseve zgjedhore të pjesshme të zhvilluara gjatë kësaj periudhe. Në vitin 2019, KRIIK vëzhgoi Zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të atij viti, në bashkëpunim me nëntë organizata lokale me eksperiencë në vëzhgimin e zgjedhjeve, të cilët angazhuan burimet e veta në ndihmë të aksionit të vëzhgimit, si dhe aktivistët e tyre si vëzhgues afatgjatë:
KRIIK, në bashkëpunim me *Elections to Conduct Agency* (ECA) kanë realizuar për herë të parë në Shqipëri numërimin paralel të votave në rang vendi, në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2009.
Si pjesë e Rrjetit Europian të Organizatave Vëzhguese të Zgjedhjeve, një rrjet organizatash lider në vëzhgimin e zgjedhjeve në Europën Juglindore dhe Qendrore, Europën Lindore, dhe Azinë Qendrore, KRIIK ka kontribuar prej vitit 2009 në forcimin e integriteti zgjedhor në disa vende të këtij rajoni, duke angazhuar aktivistë të vet si vëzhgues në misione ndërkombëtare vëzhgimi, në të gjitha nivelet e misioneve (Ekip Bazë, përfshi drejtues misioni; vëzhgues afatgjatë dhe vëzhgues afatshkurtër). KRIIK është pjesë e Sekretariatit të ENEMO-s, aktualisht në mandatin e dytë në këtë pozicion.
Përveç angazhimit në vëzhgimin e proceseve zgjedhore, KRIIK ka ndërmarrë një numër iniciativash që synojnë të forcojnë integritetin e zgjedhjeve në Shqipëri dhe ndjek në mënyrë të vazhdueshme (jo vetëm gjatë periudhave zgjedhore) çdo zhvillim politik apo institucional që ka potencialin të ndikojë në integritetin e zgjedhjeve apo të cënojë e shprehjen e vullnetit të lirë të qytetarëve nëpërmjet votës.

XX. AKRONIME

ADR	Partia Aleanca Demokracia e Re
ABEOK	Aleanca Bashkimi Popullor – Emigracioni – Ora e Shpresës dhe Konservatorët
AMA	Autoriteti i Mediave Audiovizive
AP	Avokati i Popullit
DPGJC	Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile
FRD	Partia Fryma e Re Demokratike
GNV	Grupi i Numërimit të Votave
IEVP	Institucion i Ekzekutimit të Veprave Penale
KAS	Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
Komisioneri	Komisioneri Shtetëror për Zgjedhjet
KQV	Komisioni i Qendrës së Votimit
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
KZ	Kolegji Zgjedhor
KZAZ	Komisioni Zonal i Administrimit Zgjedhor
LPM	Libri i Protokollit të Mbledhjeve
LSI	Lëvizja Socialiste për Integrim
LZHK	Lëvizja për Zhvillim Kombëtar
MB	Ministria e Brendshme
NJQV	Njësi e Qeverisjes Vendore
NTH	Partia Nisma Thurje
ODIHR	Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut
PAA	Partia Agrare Ambientaliste
PBD	Partia Bindja Demokratike
PBDNJ	Partia Bashkimi për të drejtat e Njeriut
PBDSH	Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar
PBK	Partia Balli Kombëtar
PEI	Paisja Elektronike e Identifikimit
KMSHC	Komisioneri për Mbikqyrjen e Shërbimit Civil
PBKD	Partia Balli Kombëtar Demokrat
PBLD	Partia Bashkimi Liberal Demokrat
PBPPSH	Partia Bashkimi Popullor i Pensionistëve Shqiptar
PD	Partia Demokratike
PD-AN	Koalicioni Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim
PDIU	Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet
PDKSH	Partia Demokristiane e Shqipërisë
PESH	Partia Emigracioni Shqiptar
PKD	Partia Kristiandemokrate
PKKA	Partia Kombëtare Konservatore Albania
PLDSH	Partia Lëvizja Demokratike Shqiptare
PLL	Partia Lëvizja e Legalitetit
PLN	Partia Lëvizja për Ndryshim
PLR	Partia Lëvizja e Re
POSH	Partia Ora e Shqipërisë
PRDSH	Partia Republikane Shqiptare
PS	Partia Socialiste e Shqipërisë
PSD	Partia Socialdemokrate
QV	Qendër Votimi
GNV	Grup i Numërimit të Votave
RKGJC	Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile
Rregullatori	Komisioni Rregullator
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VNV	Vend i Numërimit të Votave
ZAZ	Zonë e Administrimit Zgjedhor
ZGJC	Zyrë e Gjendjes Civile
ZRZ	Zyrë Rajonale Zgjedhore

KRIIK

KOALICIONI PËR REFORMA, INTEGRIM DHE INSTITUCIONE TË KONSOLIDUARA

COALITION FOR REFORMS, INTEGRATION AND CONSOLIDATED INSTITUTIONS

XXI - SHTOJCA

DEKLARATA PUBLIKE TË KRIIK PËRGJATË PROCESIT ZGJEDHOR

SHTOJCA A

TË DHËNAT STATISTIKORE NGA VËZHGUESIT STACIONARË NË QENDRAT E VOTIMIT

Tabelat më poshtë paraqesin të dhënat nga vëzhguesit stacionarë në Qendrat e Votimit gjatë ditës së zgjedhjeve. Në çdo tabelë paraqiten përqindjet e raportuara nga vëzhguesit, marzhi i gabimit për atë pyetje specifike, limiti i poshtëm (përqindja minimale për fenomenin përkatës në terren) dhe limiti i sipërm (përqindja maksimale për fenomenin në terren). Bazuar në kampionin e përzgjedhur dhe metodën e kampionimit, mund të thuhet me 95% besim se përqindja e fenomenit përkatës në terren është mes kufirit të poshtëm dhe atij të sipërm.

Një pjesë e tabelave i shprehin shifrat me numra e jo me përqindje, ndërkohë që një pjesë tjetër i shpreh me përqindje, por ku nuk paraqitet marzhi i gabimit. Në këto raste bëhet fjalë për pyetje të kushtëzuara (p.sh. nëse ka ndodhur një fenomen i caktuar, në sa raste ai u vërejt). Duke qenë se në këto raste pyetja i referohet një nënkampioni të kampionit kryesor, përllogaritja e marzhit të gabimit nuk është më e besueshme, pasi përllogaritja e marzhit të gabimit mund të kryhet vetëm mbi kampionin, i cili është përzgjedhur sipas rregullave të probabilitetit. Si rrjedhim këto paraqiten me numra rastesh të vërejtura apo përqindje.

Me qëllim që të bëhet një transparencë sa më e plotë mbi të gjithë elementët e vëzhguar dhe që të dhënat e mbledhura të mund të shërbejnë si rekord i gjithë ecurisë së ditës së zgjedhjeve, më poshtë paraqiten përgjigjet e shumicës së pyetjeve të pyetësorëve të përdorur nga vëzhguesit stacionarë gjatë ditës së zgjedhjeve.
Gjithashtu, këto të dhëna, si edhe të tjera të dhëna të detajuara të paraqitura në këtë Raport jepen me qëllimin e përdorimit si të dhëna informuese e bazë për përmirësime të ligjit zgjedhor përgjatë procesit të reformës zgjedhore së ardhshme.

HAPJA E QENDRAVE TË VOTIMIT

ORARI I HAPJES SË QENDRËS SË VOTIMIT	PËRQINDJA	Marzhi i gabimit	Pragu i POSHTËM	Pragu i SIPËRM
A) QV u hap në kohë (07:00)	66.67%	4.91%	61.76%	71.58%
B) QV u hap mes orës 07:00 dhe 07:30	24.58%	4.49%	20.09%	29.06%
C) QV u hap mes orës 07:30 dhe 08:00	5.65%	2.41%	3.24%	8.05%
D) QV u hap mes orës 08:00 dhe 08:30	1.98%	1.45%	0.53%	3.43%
E) QV u hap mes orës 08:30 dhe 09:00	0.85%	0.95%	-0.11%	1.80%
F) QV nuk u hap deri në orën 09:00	0.28%	0.55%	-0.27%	0.84%

ZGJEDHËS QË PRISNIN NË RADHË PËR TË VOTUAR NË MOMENTIN E HAPJES, NËSE QENDRA U HAP ME VONESË	PERQINDJE
A) Po	50.89%
B) Jo	49.11%

NUMRI I ANËTARËVE TË KOMISIONIT TË PRANISHËM NË MOMENTIN E HAPJES SË QV-SË?	PËRQINDJA	Marzhi i gabimit	Pragu i POSHTËM	Pragu i SIPËRM
7 ANETARE	80.23%	4.15%	76.08%	84.38%
6 ANETARE	10.45%	3.19%	7.26%	13.64%
5 ANETARE	5.65%	2.41%	3.24%	8.05%
4 ANETARE	3.67%	1.96%	1.71%	5.63%
3 ANETARE	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%
2 ANETARE	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%
1 ANETAR	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%

KUSH MUNGONTE, NËSE JO TË GJITHË ANËTARËT ISHIN TË PRANISHËM?	NUMËR
A) Kryetari	0
B) Sekretari	0
C) Anëtarë.	70

VENDOSJA E TRYEZAVE, KARRIKEVE DHE DHOMËS SË FSHEHTË NË MËNYRË QË TË SIGUROHEJ FSHEHTËSIA E VOTËS	PËRQINDJA	MARZHI I GABIMIT	PRAGU I POSHTËM	PRAGU I SIPËRM
A) Po	99.15%	0.95%	98.20%	100.11%
B) Jo	0.85%	0.95%	-0.11%	1.80%

VENDOSJA E TRYEZAVE, KARRIKEVE DHE DHOMES SE FSHEHTË NË MËNYRË QË TË SIGUROHEJ LËVIZJA E LIRSHME E ZGJEDHËSVE?	PËRQINDJA	MARZHI I GABIMIT	PRAGU I POSHTËM	PRAGU I SIPËRM
A) Po	98.87%	1.10%	97.77%	99.97%
B) Jo	1.13%	1.10%	0.03%	2.23%

A I HOQI KOMISIONI I QV MATERIALET PROPAGANDISTIKE QË MUND TË NDODHESHIN NË NJË RREZE PREJ 150 METRASH NGA QENDRA?	PËRQINDJA	MARZHI I GABIMIT	PRAGU I POSHTËM	PRAGU I SIPËRM
A) Po	68.64%	4.83%	63.81%	73.48%
B) Jo	7.34%	2.72%	4.63%	10.06%
C) N/A	24.01%	4.45%	19.56%	28.46%

A U PLOTËSUA PROCESVERBALI I HAPJES SË QENDRËS SË VOTIMIT?	PËRQINDJA	MARZHI I GABIMIT	PRAGU I POSHTËM	PRAGU I SIPËRM
A) Po	100.00%	0.00%	100.00%	100.00%
B) Jo	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%

A U KONTROLLUA KUTIA E VOTIMIT NË PRANI TË TË GJITHË ANËTARËVE TË KOMISIONIT DHE VËZHGUESVE?	PËRQINDJA	MARZHI I GABIMIT	PRAGU I POSHTËM	PRAGU I SIPËRM
A) Po	100.00%	0.00%	100.00%	100.00%
B) Jo	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%

A U HOQËN VULAT E SIGURISË NGA PAJISJA E VERIFIKIMIT ELEKTRONIK (PEI) NË PRANI TË TË GJITHË ANËTARËVE TË KQV-SË DHE VËZHGUESVE?	PËRQINDJA	MARZHI I GABIMIT	PRAGU I POSHTËM	PRAGU I SIPËRM
A) Po	95.48%	2.16%	93.32%	97.64%
B) Jo	4.52%	2.16%	2.36%	6.68%

A U AKTIVIZUA PEI NË PRANI TË TË GJITHË ANËTARËVE TË KQV-SË DHE VËZHGUESVE?	PËRQINDJA	MARZHI I GABIMIT	PRAGU I POSHTËM	PRAGU I SIPËRM
A) Po	95.20%	2.23%	92.97%	97.43%
B) Jo	4.80%	2.23%	2.57%	7.03%

A U PRINTUA RAPORTI I HAPJES SË QENDRËS SË VOTIMIT NGA PEI?	PËRQINDJA	MARZHI I GABIMIT	PRAGU I POSHTËM	PRAGU I SIPËRM
A) Po	95.20%	2.23%	92.97%	97.43%
B) Jo	4.80%	2.23%	2.57%	7.03%

A U MBYLLËN DHE VULOSËN KUTITË ME KODET E SIGURISË PËRPARA FILLIMIT TË VOTIMIT?	PËRQINDJA	MARZHI I GABIMIT	PRAGU I POSHTËM	PRAGU I SIPËRM
A) Po	99.72%	0.55%	99.16%	100.27%
B) Jo	0.28%	0.55%	-0.27%	0.84%

A U FUT PROCESVERBALI I VULOSJES SË KUTISË SË VOTIMIT ME KODET E SIGURISË ME TË CILAT U VULOS KUTIA BRENDA NË KUTI PËRPARA FILLIMIT TË VOTIMIT?	PËRQINDJA	MARZHI I GABIMIT	PRAGU I POSHTËM	PRAGU I SIPËRM
A) Po	99.72%	0.55%	99.16%	100.27%
B) Jo	0.28%	0.55%	-0.27%	0.84%

A U FUT PROCESVERBALI I HAPJES SË QENDRËS SË VOTIMIT I PRINTUAR NGA PEI BRENDA NË KUTI PËRPARA FILLIMIT TË VOTIMIT?	PËRQINDJA	MARZHI I GABIMIT	PRAGU I POSHTËM	PRAGU I SIPËRM
A) Po	91.53%	2.90%	88.62%	94.43%
B) Jo	8.47%	2.90%	5.57%	11.38%

A ISHTE E PAJISUR QENDRA ME TË GJITHA MATERIALET E NEVOJSHME PËR PROCESIN E VOTIMIT?	PËRQINDJA	MARZHI I GABIMIT	PRAGU I POSHTËM	PRAGU I SIPËRM
A) Po	98.87%	1.10%	97.77%	99.97%
B) Jo	1.13%	1.10%	0.03%	2.23%

NËSE QENDRA E VOTIMIT NUK ISHTE E PAJISUR ME TË GJITHA MATERIALET E NEVOJSHME, ÇFARË MUNGONTE?	NUMËR
B) Boja për timbrosje	1
D) Proces verbalet	2
G) Zarfet për dokumentacion	1

VLERËSIM I PËRGJITHSHËM I PROCEDURAVE TË HAPJES SË QENDRËS SË VOTIMIT	PËRQINDJA	MARZHI I GABIMIT	PRAGU I POSHTËM	PRAGU I SIPËRM
A) Shumë mirë	66.10%	4.93%	61.17%	71.03%
B) Mirë	28.25%	4.69%	23.56%	32.94%
C) Me probleme	5.65%	2.41%	3.24%	8.05%
D) Shumë problematike	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%

PROCESI I VOTIMIT

NUMRI I KOMISIONEREVE GRA	PËRQINDJA	MARZHI I GABIMIT	PRAGU I POSHTËM	PRAGU I SIPËRM
ASNJË GRUA KOMISIONERE	22.22%	4.29%	17.93%	26.52%
1 GRUA KOMISIONERE	25.56%	4.51%	21.05%	30.06%
2 GRA KOMISIONERE	22.22%	4.29%	17.93%	26.52%
3 GRA KOMISIONERE	17.50%	3.93%	13.57%	21.43%
4 GRA KOMISIONERE	7.50%	2.72%	4.78%	10.22%
5 GRA KOMISIONERE	4.17%	2.06%	2.10%	6.23%
6 GRA KOMISIONERE	0.28%	0.54%	-0.27%	0.82%
7 GRA KOMISIONERE	0.56%	0.77%	-0.21%	1.32%

A VËREJTËT PERSONA TË PAAUTORIZUAR NË QENDRËN E VOTIMIT	PËRQINDJA	MARZHI I GABIMIT	PRAGU I POSHTËM	PRAGU I SIPËRM
A) Po	5.00%	2.25%	2.75%	7.25%
B) Jo	95.00%	2.25%	92.75%	97.25%

NËSE VËREJTËT PERSONA TË PAAUTORIZUAR NË QENDRËN E VOTIMIT, KUSH ISHIN?	NUMËR
B) Partiakë	14
C) Të tjerë (shpjego)	4

A IA KALOI VULËN E KRYETARIT TË QV-SË PËR PËRDORIM ANËTARIT TJETËR ME TË NJËJTËN PËRKATËSI POLITIKE, KUR DOLI NGA QV-JA KRYETARI?	PËRQINDJA	MARZHI I GABIMIT	PRAGU I POSHTËM	PRAGU I SIPËRM
A) Po	56.11%	5.13%	50.98%	61.24%
B) Jo	16.11%	3.80%	12.31%	19.91%
C) N/A	27.78%	4.63%	23.15%	32.40%

A ISHTE VENDOSUR DHOMA E FSHEHTË NË POZICION TË TILLË QË TË MUND TË SHIHEJ NGA TË GJITHË?	PËRQINDJA	MARZHI I GABIMIT	PRAGU I POSHTËM	PRAGU I SIPËRM
A) Po	94.17%	2.42%	91.75%	96.59%
B) Jo	5.83%	2.42%	3.41%	8.25%

A ISHTE E VENDOSUR DHOMA E FSHEHTË NË MËNYRË TË TILLË QË TË MUND TË SIGUROHEJ FSHEHTËSIA E VOTËS?	PËRQINDJA	MARZHI I GABIMIT	PRAGU I POSHTËM	PRAGU I SIPËRM
A) Po	98.33%	1.32%	97.01%	99.66%
B) Jo	1.67%	1.32%	0.34%	2.99%

A ISHTE VENDOSUR KUTIA E VOTIMIT NË POZICION TË TILLË QË TË MUND TË SHIHEJ NGA TË GJITHË?	PËRQINDJA	MARZHI I GABIMIT	PRAGU I POSHTËM	PRAGU I SIPËRM
A) Po	96.67%	1.85%	94.81%	98.52%
B) Jo	3.33%	1.85%	1.48%	5.19%

A ISHIN TË AFISHUAR POSTERA PËR TË SHPJEGUAR PROCEDURAT E VOTIMIT?	PËRQINDJA	MARZHI I GABIMIT	PRAGU I POSHTËM	PRAGU I SIPËRM
A) Po	95.28%	2.19%	93.09%	97.47%
B) Jo	4.72%	2.19%	2.53%	6.91%

A ISHIN TË AFISHUAR POSTERA ME NUMRAT E KANDIDATËVE?	PËRQINDJA	MARZHI I GABIMIT	PRAGU I POSHTËM	PRAGU I SIPËRM
A) Po	95.28%	2.19%	93.09%	97.47%
B) Jo	4.72%	2.19%	2.53%	6.91%

A ISHTE E AFISHUAR LISTA E ZGJEDHËSVE?	PËRQINDJA	MARZHI I GABIMIT	PRAGU I POSHTËM	PRAGU I SIPËRM
A) Po	95.28%	2.19%	93.09%	97.47%
B) Jo	4.72%	2.19%	2.53%	6.91%

A ISHTE QENDRA E PËRSHTATUR PËR TË MUNDËSUAR VOTIMIN PA ASISTENCË TË ZGJEDHËSVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA FIZIKE?	PËRQINDJA	MARZHI I GABIMIT	PRAGU I POSHTËM	PRAGU I SIPËRM
A) Po	48.33%	5.16%	43.17%	53.50%
B) Pjesërisht	37.78%	5.01%	32.77%	42.79%
C) Jo	13.89%	3.57%	10.32%	17.46%

A PATI RASTE KUR FLETA E VOTIMIT NUK U VULOS ME VULËN E KRYETARIT TË KQV-SË DHE VULËN E QV-SË?	PËRQINDJA	MARZHI I GABIMIT	PRAGU I POSHTËM	PRAGU I SIPËRM
A) Po	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%
B) Jo	100.00%	0.00%	100.00%	100.00%

A PATI RASTE KUR ZGJEDHËSIT U PAJISËN ME FLETËN E VOTIMIT PËRPARA SE TË KONTROLLOHESHIN NË TË DY DUART NËSE ISHIN TIMBROSUR MË PARË?	PËRQINDJA	MARZHI I GABIMIT	PRAGU I POSHTËM	PRAGU I SIPËRM
A) Po	1.11%	1.08%	0.03%	2.19%
B) Jo	98.89%	1.08%	97.81%	99.97%

A PATI RASTE TË ZGJEDHËSVE QË U LEJUAN TË VOTOJNË PA PARAQITUR DOKUMENT IDENTIFIKIMI?	PËRQINDJA	MARZHI I GABIMIT	PRAGU I POSHTËM	PRAGU I SIPËRM
A) Po	0.28%	0.54%	-0.27%	0.82%
B) Jo	99.72%	0.54%	99.18%	100.27%

A PATI RASTE TË ZGJEDHËSVE QË U LEJUAN TË VOTOJNË PA VENDOSUR SHENJËN E GISHTIT NË PAJISJEN ELEKTRONIKE TË IDENTIFIKIMIT?	PËRQINDJA	MARZHI I GABIMIT	PRAGU I POSHTËM	PRAGU I SIPËRM
A) Po	5.56%	2.37%	3.19%	7.92%
B) Jo	94.44%	2.37%	92.08%	96.81%

A PATI RASTE TË ZGJEDHËSVE QË U LEJUAN TË VOTOJNË PA U TIMBROSUR ME BOJËN E POSAÇME?	PËRQINDJA	MARZHI I GABIMIT	PRAGU I POSHTËM	PRAGU I SIPËRM
A) Po	2.22%	1.52%	0.70%	3.74%
B) Jo	97.78%	1.52%	96.26%	99.30%

A U PARAQITËN PËR TË VOTUAR ZGJEDHËS QË NUK E KISHIN EMRIN NË LISTËN E ZGJEDHËSVE, ME VENDIM GJYKATE?	PËRQINDJA	MARZHI I GABIMIT	PRAGU I POSHTËM	PRAGU I SIPËRM
A) Po	3.06%	1.78%	1.28%	4.83%
B) Jo	96.94%	1.78%	95.17%	98.72%

24.2. NËSE PATI ZGJEDHËS QË U PARAQITËN ME VENDIM GJYKATE, A U MBAJT SHËNIM EMRI I TYRE SË BASHKU ME NUMRIN E DOKUMENTIT TË IDENTIFIKIMIT NË NJË REGJISTËR TË POSAÇËM?	NUMËR
A) Po	11
B) Jo	0

A PATI RASTE TË ZGJEDHËSVE QË VOTUAN JASHTË DHOMËS SË FSHEHTË?	PËRQINDJA	MARZHI I GABIMIT	PRAGU I POSHTËM	PRAGU I SIPËRM
A) Po	0.56%	0.77%	-0.21%	1.32%
B) Jo	99.44%	0.77%	98.68%	100.21%

A VËREJTËT NDONJË ZGJEDHËS QË PËRDORI TELEFONIN CELULAR BRENDA QENDRËS SË VOTIMIT?	PËRQINDJA	MARZHI I GABIMIT	PRAGU I POSHTËM	PRAGU I SIPËRM
A) Po	5.00%	2.25%	2.75%	7.25%
B) Jo	96.39%	1.93%	94.46%	98.32%

A VËREJTËT NDONJË ZGJEDHËS ME TELEFON CELULAR NË DORË NË DHOMËN E FSHEHTË?	PËRQINDJA	MARZHI I GABIMIT	PRAGU I POSHTËM	PRAGU I SIPËRM
A) Po	3.89%	2.00%	1.89%	5.89%
B) Jo	96.11%	2.00%	94.11%	98.11%

A VËREJTËT RASTE KUR PERSONI QË SHOQËRONTE ZGJEDHËSIT ME AFTËSI TË KUFIZUARA FIZIKE NUK PLOTËSOI DEKLARATËN PËRKATËSE?	PËRQINDJA	MARZHI I GABIMIT	PRAGU I POSHTËM	PRAGU I SIPËRM
A) Po	4.72%	2.19%	2.53%	6.91%
B) Jo	95.28%	2.19%	93.09%	97.47%

A VËREJTËT RASTE KUR NDONJË PERSON NDIHMOI MË SHUMË SE NJË ZGJEDHËS ME AFTËSI TË KUFIZUARA PËR TË VOTUAR?	PËRQINDJA	MARZHI I GABIMIT	PRAGU I POSHTËM	PRAGU I SIPËRM
A) Po	2.22%	1.52%	0.70%	3.74%
B) Jo	97.78%	1.52%	96.26%	99.30%

A VËREJTËT NDONJË ANËTAR TË KOMISIONIT TË QENDRËS SË VOTIMIT TË NDIHMONTE PËR TË VOTUAR ZGJEDHËS ME AFTËSI TË KUFIZUARA PËR TË VOTUAR?	PËRQINDJA	MARZHI I GABIMIT	PRAGU I POSHTËM	PRAGU I SIPËRM
A) Po	0.83%	0.94%	-0.11%	1.77%
B) Jo	99.17%	0.94%	98.23%	100.11%

A PATI ZGJEDHËS QË U PARAQITËN NË QENDRËN E VOTIMIT DHE NUK MUNDËN TË VOTONIN?	PËRQINDJA	MARZHI I GABIMIT	PRAGU I POSHTËM	PRAGU I SIPËRM
A) Po	19.72%	4.11%	15.61%	23.83%
B) Jo	80.28%	4.11%	76.17%	84.39%

NËSE PATI ZGJEDHËS QË NUK MUNDËN TË VOTOJNË, PËR CILAT NGA ARSYET MË POSHTË SI DHE JEPNI NUMRIN PËR SECILIN PREJ RASTEVE NË PYETJET PASARDHËSE:	NUMËR
A) Nuk kishte dokument identifikimi	19
C) Nuk kishte emrin ne listë	50
D) Tjetër (shpjego)	2

A U NDËRPRE VOTIMI NË NDONJË MOMENT GJATË KOHËS SË VËZHGIMIT?	PËRQINDJA	MARZHI I GABIMIT	PRAGU I POSHTËM	PRAGU I SIPËRM
A) Po	7.50%	2.72%	4.78%	10.22%
B) Jo	92.50%	2.72%	89.78%	95.22%

A VËREJTËT RASTE KUR NË DHOMËN E FSHEHTË FUTESHIN MË SHUMË SE NJË PERSON (VOTIMI "NË GRUP" OSE "FAMILJAR")?	PËRQINDJA	MARZHI I GABIMIT	PRAGU I POSHTËM	PRAGU I SIPËRM
A) Po	11.67%	3.32%	8.35%	14.98%
B) Jo	88.33%	3.32%	85.02%	91.65%

A U VERIFIKUA NDONJË RAST I NDONJË ZGJEDHËSI QË KISHTE VOTUAR MË PARË QË U PARAQIT PËR TË VOTUAR SËRISH (P.SH, TË TIMBRUAR)?	PËRQINDJA	MARZHI I GABIMIT	PRAGU I POSHTËM	PRAGU I SIPËRM
A) Po	0.57%	0.65%	-0.07%	1.22%
B) Jo	68.13%	3.99%	64.14%	72.12%

NËSE U PARAQITËN ZGJEDHËS TË TIMBROSUR MË PARË, A U LEJUAN TË VOTOJNË?	NUMËR
A) Po	0
B) Jo	3

NËSE U PARAQITËN ZGJEDHËS TË TIMBROSUR, A IU BË I NJOHUR KY FAKT ANËTARËVE TË TJERË TË KOMISIONIT DHE A U MBAJT SHËNIM EMRI DHE MBIEMRI I TYRE NË LIBRIN E PROTOKOLLIT TË QENDRËS SË VOTIMIT?	NUMËR
A) Po	1
B) Jo	2

A VËREJTËT RASTE KUR NDONJË PERSON VOTOI MË SHUMË SE NJË HERË?	PËRQINDJA	MARZHI I GABIMIT	PRAGU I POSHTËM	PRAGU I SIPËRM
A) Po	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%
B) Jo	100.00%	0.00%	100.00%	100.00%

A VËREJTËT RASTE KUR NDONJË PERSON VOTOI PËR PERSONA TË TJERË QË ISHIN TË PRANISHËM?	PËRQINDJA	MARZHI I GABIMIT	PRAGU I POSHTËM	PRAGU I SIPËRM
A) Po	3.89%	2.00%	1.89%	5.89%
B) Jo	96.11%	2.00%	94.11%	98.11%

A VËREJTËT NDONJË ZGJEDHËS QË FOTOGRAFOI VOTËN?	PËRQINDJA	MARZHI I GABIMIT	PRAGU I POSHTËM	PRAGU I SIPËRM
A) Po	1.94%	1.43%	0.52%	3.37%
B) Jo	98.06%	1.43%	96.63%	99.48%

A VËREJTËT NDONJË PERSON TË ARMATOSUR BRENDA QENDRËS SË VOTIMIT?	PËRQINDJA	MARZHI I GABIMIT	PRAGU I POSHTËM	PRAGU I SIPËRM
A) PO	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%
B) JO	100.00%	0.00%	100.00%	100.00%

A VËREJTËT NDONJË PERSON TË ARMATOSUR NË AFËRSI TË QENDRËS SË VOTIMIT, PËRVEÇ FORCAVE TË RENDIT?	PËRQINDJA	MARZHI I GABIMIT	PRAGU I POSHTËM	PRAGU I SIPËRM
A) Po	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%
B) Jo	100.00%	0.00%	100.00%	100.00%

A PATI MOMENTE KUR NË QENDRËN E VOTIMIT U KRIJUA KAOS APO RRËMUJË?	PËRQINDJA	MARZHI I GABIMIT	PRAGU I POSHTËM	PRAGU I SIPËRM
A) Po	6.67%	2.58%	4.09%	9.24%
B) Jo	93.33%	2.58%	90.76%	95.91%

NËSE PATI MOMENTE RRËMUJE GJATË VOTIMIT, NË GJYKIMIN TUAJ U SHKAKTUA NGA:	NUMËR
A) Numri i madh i zgjedhësve	19
B) Paaftësia e komisionerëve për të menaxhuar situatën	5

A VËREJTËT NË NDONJË MOMENT GJATË VOTIMIT MATERIALE PROPAGANDISTIKË BRENDA QENDRËS SË VOTIMIT?	PËRQINDJA	MARZHI I GABIMIT	PRAGU I POSHTËM	PRAGU I SIPËRM
A) Po	0.83%	0.94%	-0.11%	1.77%
B) Jo	99.17%	0.94%	98.23%	100.11%

A VËREJTËT NDONJË PERSON QË NDËRHYRI NË PUNËN E KOMISIONIT TË QENDRËS SË VOTIMIT?	PËRQINDJA	MARZHI I GABIMIT	PRAGU I POSHTËM	PRAGU I SIPËRM
A) Po	1.11%	1.08%	0.03%	2.19%
B) Jo	98.89%	1.08%	97.81%	99.97%

NËSE VËREJTËT PERSONA QË NDËRHYNË NË PUNËN E KOMISIONIT, KUSH ISHIN?	NUMËR
B) Partiakë	4

A VËREJTËT NDONJË PERSON TË PAAUTORIZUAR QË DREJTONTE PUNËN E KOMISIONIT TË QENDRËS SË VOTIMIT?	PËRQINDJA	MARZHI I GABIMIT	PRAGU I POSHTËM	PRAGU I SIPËRM
A) Po	0.56%	0.77%	-0.21%	1.32%
B) Jo	99.44%	0.77%	98.68%	100.21%

NËSE VËREJTËT NDONJË PERSON TË PAAUTORIZUAR QË DREJTONTE PUNËN E KOMISIONIT, KUSH ISHIN?	NUMËR
B) Partiakë	2

449	Taulanda Jupi	Tiranë	PD-PD / AN
450	Tea Ndrio	Tiranë	LRE
451	Teuta Hoti	Shkodër	LN
452	Thanas Poçi	Korçë	LSI
453	Thoma Papadhimitri	Tiranë	LRE
454	Tomor Alizoti	Berat	PD-PD / AN
455	Tomorr Laze	Berat	LRE
456	Tonin Trupi	Fier	LN
457	Tonin Valca	Lezhë	LN
458	Tritan Shehu	Gjirokastër	PD-PD / AN
459	Valentina Halili	Elbasan	LN
460	Vangjel Dule	Tiranë	PBDNJ-PD/ AN
461	Vangjel Anagnosti	Vlorë	PBDNJ-PD/ AN
462	Vangjel Buda	Berat	LRE
463	Viktor Tushaj	Lezhë	LSI
464	Viktor Përleka	Lezhë	LRE
465	Vilma Gjika	Berat	LRE
466	Vilma Zeqir	Korçë	LN
467	Vilson Lulja	Fier	LRE
468	Violeta Bonaj	Tiranë	LRE
469	Visar Erkoçi	Shkodër	LN
470	Xhavit Nasufi	Tiranë	LRE
471	Xhelal Çiku	Lezhë	LRE
472	Xhelal Mziu	Dibër	PD-PD / AN
473	Xheni Vogli	Durrës	LRE
474	Xheni Hoxha	Berat	LN
475	Xhenis Jano	Korçë	LN
476	Xhensila Ndreu	Dibër	LRE
477	Xhoi Laraku	Korçë	LRE
478	Xhorxhi Foto	Vlorë	LN
479	Xhulio Xhindi	Berat	LRE
480	Ylber Valteri	Tiranë	PD-PD / AN
481	Zef Gjoka	Lezhë	PD-PD / AN
482	Zeliko Shimi	Shkodër	LRE
483	Zheni Gjergji	Elbasan	PD-PD / AN

SHTOJCA T

FONDET E SHPENZUARA DHE TË DEKLARUARA NGA SUBJEKTET ZGJEDHORE DHE KANDIDATËT PËR MEDIA

Shtojca T – Tabela T-1 - Shumat e shpenzuara dhe deklaruara nga subjektet zgjedhore për media

Tabela e mëposhtme përmban një pasqyrë të deklarimeve dhe një përllogaritje të shpenzimeve të subjekteve zgjedhore për media. Në këtë tabelë janë përfshirë vetëm subjektet që kanë deklaruar në raportet e tyre të vetëdeklarimit shpenzime për media.(PDIU, PD, FRD, PR, LN, BD, PS, LSI, NTH, PSD, PBK, PLR, PAA, ADK dhe kandidati i pavarur Pal Shkambi).
Konkretisht kolona e parë përmban emrin e subjektit. Grup-kolona e dytë përmban deklarimet e vetë subjektit (Median e paguar, sipas deklarimit të subjektit zgjedhor si dhe Shumën e deklaruar si të shpenzuar). Grup-kolona e tretë përmban të dhënat mbi bazën e të cilave është kryer përllogaritja e shumës realisht të shpenzuar. Më konkretisht: Media ku është transmetuar reklamë sipas monitorimit të AMA, Koha në minuta e reklamës së transmetuar në atë media sipas AMA, Tarifa mesatare e aplikuar nga televizioni për reklama (në Lekë/sek) bazuar në tarifat e dorëzuara nga media e të publikuara në faqen e internetit të KQZ, si dhe përllogaritja e shumës së paguar. Në kolonën e tarifës mesatare, shenjimi me n/a, nënkupton se media respektive nuk ka dërguar në KQZ tarifat që ajo aplikon për reklamë gjatë fushatës, për rrjedhojë, përllogaritja e shumës përkatëse të shpenzuar nuk është bërë.

		Deklarimi i subjektit zgjedhor		Përllogaritjet nga monitorimi i reklamës së transmetuar			
Nr	Subjekti	Media e paguar, deklaruar nga subjekti	Shuma e deklaruar si e shpenzuar	Media ku është trasmetuar reklamë për subjektin sipas AMA	Koha e reklamës së transmetuar nga media për subjektin sipas AMAs (në minuta)	Tarifa mesatare e aplikuar nga TV për reklamë (Lek/sec)	Përllogaritja e shumës së shpenzuar për reklamën e transmetuar
1	PDIU	TV Gold	60,000				
2	PDIU	Syri TV	456,568	Syri TV	23.48	n/a	0
3	PDIU	Abc News	3,000,000			5,500	0
4	PDIU	News 24	369,420			2,400	0
5	PDIU			Ora News	0.50	1,900	57,000
	SubTotal		**3,885,988**				**57,000**
1	PD	Tv Klan	3,914,262	Tv Klan	257.00	5,500	84,810,000
2	PD	ORA. SH.A	1,298,659	ORA. SH.A	10.17	1,900	1,159,380
3	PD	Euro News	1,305,178	Euro News	112.48	5,000	33,744,000
4	PD	Channel One	1,304,330	Channel One		1,900	0
5	PD	Fax News	1,957,502	Fax News	176.00	1,600	16,896,000
6	PD	Media Vizion	1,303,800	Media Vizion	57.98	2,000	6,957,600
7	PD	Syri TV	1,303,800	Syri TV	222.90	n/a	0
8	PD	Top Channel	6,148,499	Top Channel	176.02	2,000	21,122,400
9	PD	Abc News	1,305,284	Abc News	134.32	5,500	44,325,600
10	PD	A2 CNN	723,310	A2 CNN	100.17	1,000	6,010,200
11	PD			Real TV	73.13	n/a	0
12	PD			TV1 Channel	100.85	n/a	0
13	PD			6+1 Vlora	214.43	n/a	0
14	PD			Klan Plus	283.55	1,200	20,415,600
15	PD			Klan News	226.47	1,200	16,305,840
16	PD			Report TV	0.13	3,000	23,400
17	PD			News 24	132.15	2,400	19,029,600
18	PD			TV Best	62.33	n/a	0
19	PD			Shijak TV	161.98	n/a	0
20	PD			Scan Tv	87.67	n/a	0
21	PD			Apollon	30.90	n/a	0
22	PD			RTV Gjirokastra	27.58	n/a	0

		Deklarimi i subjektit zgjedhor		Përllogaritjet nga monitorimi i reklamës së transmetuar			
Nr	Subjekti	Media e paguar, deklaruar nga subjekti	Shuma e deklaruar si e shpenzuar	Media ku është trasmetuar reklamë për subjektin sipas AMA	Koha e reklamës së transmetuar nga media për subjektin sipas AMAs (në minuta)	Tarifa mesatare e aplikuar nga TV për reklamë (Lek/ sec)	Përllogaritja e shumës së shpenzuar për reklamën e transmetuar
23	PD			Kopliku	25.08	n/a	0
24	PD			Kanali 7	25.03	n/a	0
25	PD			Belsh	21.50	n/a	0
26	PD			Antena Nord	4.00	n/a	0
27	PD			Sot 7	25.41	n/a	0
28	PD			Alpo Tv	2.95	n/a	0
29	PD			Rozafa Tv	27.00	n/a	0
30	PD			RTV Ora	147.75	2,400	21,276,000
31	PD			MCN Tv	4.00	1,000	240,000
32	PD			Bulqiza TV	1.23	n/a	0
	SubTotal		**20,564,624**				**292,315,620**
1	PR	Tv Klan	1,495,000	Tv Klan		5,500	0
2	PR	Top Channel	1,060,000	Top Channel		2,000	0
				Syri TV	11.50	n/a	0
	SubTotal		**2,555,000**				**0**
1	FRD	Syri TV	130,507				0
	SubTotal		**130,507**		**0.00**		**0**
1	LN	Tv Klan	515,425	Tv Klan	2.60	5,500	858,000
2	LN			TV1 Channel	87.00	n/a	0
3	LN			6+1 Vlora	206.05	n/a	0
4	LN			Report TV	64.10	3,000	11,538,000
	SubTotal		**515,425**				**12,396,000**
1	BD	Tv Klan	824,000	Tv Klan	14.45	5,500	4,768,500
2	BD	A2 CNN	522,113	A2 CNN	53.75	1,000	3,225,000
3	BD	Media Vizion	391,140	Media Vizion	20.45	2,000	2,454,000
4	BD			Real TV	702.30	n/a	0
5	BD			6+1 Vlora	19.83	n/a	0
6	BD			Report TV	45.15	3,000	8,127,000
7	BD			TV Best	26.42	n/a	0
8	BD			Kanali 7	24.40	n/a	0
9	BD			Ora News	8.32	1,900	948,480
	SubTotal		**1,737,253**				**19,522,980**
1	PS	Tv Klan	12,713,686	Tv Klan	300.60	5,500	99,198,000
2	PS	Top Channel	12,000,000	Top Channel	288.05	2,000	34,566,000
3	PS	Fax News	6,000,000	Fax News	42.98	1,600	4,126,080
4	PS	Report TV	7,000,000	Report TV	249.67	3,000	44,940,600
5	PS	Media Vizion	4,000,000	Media Vizion	199.12	2,000	23,894,400
6	PS	Euro News	3,000,000	Euro News	151.70	5,000	45,510,000
7	PS	Abc News	530,000	Abc News	175.67	5,500	57,971,100
8	PS			Real TV	210.30	n/a	0
9	PS			Klan Plus	260.00	1,200	18,720,000
10	PS			6+1 Vlora	230.68	n/a	0
11	PS			Klan News	289.65	1,200	20,854,800
12	PS			One Tv Vlora	502.77	n/a	0
13	PS			Neës 24	234.60	2,400	33,782,400
14	PS			RTV Ora	52.95	2,400	7,624,800
15	PS			Top News	237.20	210	2,988,720
16	PS			TV Best	91.62	n/a	0
17	PS			Scan Tv	44.22	n/a	0

		Deklarimi i subjektit zgjedhor		Përllogaritjet nga monitorimi i reklamës së transmetuar			
Nr	Subjekti	Media e paguar, deklaruar nga subjekti	Shuma e deklaruar si e shpenzuar	Media ku është trasmetuar reklamë për subjektin sipas AMA	Koha e reklamës së transmetuar nga media për subjektin sipas AMAs (në minuta)	Tarifa mesatare e aplikuar nga TV për reklamë (Lek/ sec)	Përllogaritja e shumës së shpenzuar për reklamën e transmetuar
18	PS			Apollon TV	15.10	n/a	0
19	PS			RTV Gjirokastra	38.67	n/a	0
20	PS			Tv Kopliku	21.77	n/a	0
21	PS			Kanali 7	3.30	n/a	0
22	PS			Belsh	25.20	n/a	0
23	PS			Sot 7	7.20	n/a	0
24	PS			Alpo TV	26.28	n/a	0
25	PS			MCN Tv	9.75	1,000	585,000
26	PS			Bulqiza TV	0.55	n/a	0
	SubTotal		**45,243,686**				**394,761,900**
1	Pal Shkambi	TV Kopliku	50,000	TV Kopliku			0
2	Pal Shkambi	TV1 Channel	30,000	TV1 Channel	13.07	n/a	0
3	Pal Shkambi	Star Plus	20,000	Star Plus	41.30	n/a	0
4	Pal Shkambi	Radio Jehona	15,000	Radio Jehona			0
	SubTotal		**115,000**				**0**
1	LSI			TV 1 Channel	676.32	n/a	0
2	LSI			Report TV	24.82	3,000	4,467,600
3	LSI			News 24	68.33	2,400	9,839,520
4	LSI			ABC News	10.12	5,500	3,339,600
5	LSI			EuroNews	14.90	5,000	4,470,000
6	LSI			RTV Ora	61.20	2,400	8,812,800
7	LSI			Syri TV	4.40	n/a	0
8	LSI			Fax News	40.53	1,600	3,890,880
9	LSI			TV Best	8.00	n/a	0
10	LSI			Apollon TV	4.65	n/a	0
11	LSI			Sot 7	4.42	n/a	0
	SubTotal		**0**				**34,820,400**
1	NTH			Report TV	78.87	3,000	14,196,600
2	NTH			Top News	11.25	210	141,750
3	NTH			TV Best	29.33	n/a	0
	SubTotal		**0**				**14,338,350**
1	PSD			Top Channel	24.37	2,000	2,924,400
2	PSD			Vizion Plus	0.75	2,000	90,000
3	PSD			Apollon TV	19.90	n/a	0
4	PSD			Antena Nord	33.68	n/a	0
	SubTotal		**0**				**3,014,400**
1	PBK			6+1 Vlora	33.37	n/a	0
	SubTotal		**0**				**0**
1	PLR			Apollon TV	8.13	n/a	0
	SubTotal		**0**				**0**
1	PAA			Syri TV	4.23	n/a	0
	SubTotal		**0**				**0**
1	ADK			ABC News	0.53	5,500	174,900
	SubTotal		**0**				**174,900**

Shtojca T – Tabela T-2 - Shumat e deklaruara të shpenzuara për media nga kandidatët

Tabela e mëposhtme përmban një përmbledhje të deklarimeve të kandidatëve për media. Duke qenë se kandidatët nuk janë subjekt monitorimi nga AMA, nuk mund të kryhet një krahasim sikurse është bërë me subjektet zgjedhore. Kolona e parë pëmban subjektin zgjedhor, nën logon e të cilit kandidati ka garuar, kolona e dytë emrin e kandidatit, kolona e tretë shumën e paguar prej saj/tij dhe kolona e katërt media e cila deklarohet se është paguar.

Nr.	Subjekti	Kandidati	Shuma (Lekë)	Media ku deklarohet pagesa
1	LSI	Luljeta Skura	70,000	Mat TV
2	LSI	Merita Hoxha	35,000	Mat TV
3	LSI	Kejdi Mehmetaj	123,000	Apollon TV
4	LSI	Kejdi Mehmetaj	120,000	Star Plus TV
5	LSI	Floida Kërpaçi	60,000	B.B.F
6	LSI	Faik Basha	123,120	Syri TV
7	LSI	Arben Rroko	10,000	Vizion Plus
8	LRE	Asllan Hoxha	74,200	TV Kukesi
9	PD	Anduena Qefalia	130,465	Syri TV
10	PS	Damian Gjiknuri	200,000	Vizion Plus
11	PS	Bledi Çomo	25,000	Sot 7 TV
12	PS	Lavdim Krashi	390,000	Top Channel (Emisioni Kandidati)
13	PS	Vullnet Sinaj	122,920	Scan TV (Emisioni Refim)
14	PS	Vullnet Sinaj	240,000	Milika Deliaj*
Totali			**1,723,705**	

**Në këtë rast nuk është referuar emri i medias në raport, por vetëm të dhënat e faturës me këtë emër.*

Shtojca T – Tabela T-3 - Diferencat e pagesave të deklaruara me ato të përllogaritura

Në tabelën e mëposhtme është pasqyruar një përmbledhje e të dhënave të pasqyruara sipas deklarimit dhe përllogaritjes, dhe evidentohet diferenca mes tyre. Kolona e parë përmban subjektin; kolona e dytë paraqet shumën e deklaruar të shpenzuar nga subjekti zgjedhor në raportin e tij të vetëdeklarimit; kolona e tretë përmban shumën e përllogaritur të shpenzuar duke shumëzuar minutat e reklamës të trasmetuar sipas AMA-s dhe tarifën mesatare përkatëse të publikuar nga televizioni përkatës (sipas specifikimeve në tabelën 1 të kësaj shtojce); kolona e katërt diferencën midis shumës së deklaruar të shpenzuar dhe asaj të përllogaritur të shpenzuar sipas KRIIK; dhe të njëjtën diferencë sipas përllogaritjeve të KQZ në kolonën e pestë.

Nr.	Subjekti zgjedhor	Shuma e deklaruar si e shpenzuar për media (në lekë)	Shuma e përllogaritur si e shpenzuar sipas minutave të reklamës nga AMA (në lekë)	Diferenca sipas KRIIK (në lekë)	Diferenca sipas KQZ (në lekë)	Deklarime nga kandidatët (në lekë)
1	PD	20,564,624	292,315,620	271,750,996	224,382,561	130,465
2	PR	2,555,000	0	-2,555,000		
3	FRD	130,507	0	-130,507		
4	LN	515,425	12,396,000	11,880,575	14,145,812	
5	BD	2,007,963	19,522,980	17,515,017	16,161,892	
6	PDIU	3,885,988	57,000	-3,828,988		
7	PS	46,577,686	394,761,900	348,184,214	275,956,867	977,920
8	P. Shkambi	115,000	0	-115,000		
9	LSI	0	34,820,400	34,820,400	19,971,980	541,120
10	NTH	0	14,338,350	14,338,350	13,796,462	
11	PSD	0	3,014,400	3,014,400	4,806,270	
12	PAA	0	0	0		
13	PBK	0	0	0		
14	PLR	0	0	0		
15	ADK	0	174,900	174,900		
Total		**76,352,193**	**771,401,550**	**695,049,357**	**569,221,844**	**1,649,505**

SHTOJCA V

DEKLARATA PUBLIKE TË KRIIK LIDHUR ME PROCESIN ZGJEDHOR

Tabela e mëposhtme përmban të gjitha ndryshimet në anëtarësinë e Komisioneve Zonale të Administrimit të Zgjedhjeve (KZAZ) që nga konstituimi i tyre deri në momentin e përfundimit të detyrës si anëtarë të KZAZ-së përkatëse. Në përbërjen e KZAZ-ve në procesin zgjedhor të datës 25 prill ishin 7 anëtare/ë dhe një sekretar/e. Të dhënat e përfshira në tabelë i referohen vendimmarrjes së KQZ dhe përfshijnë: numrin e KZAZ-së; Qarkun ku ndodhet; emrin, mbiemrin, gjininë dhe pozicionin e personave të zëvendësuar dhe atyre që i zëvendësojnë; partinë politike që i ka propozuar; si dhe numrin e datën e vendimit të KQZ nëpërmjet të cilit është miratuar zëvendësimi.

V.1. DEKLARATË *- Trupa aktuale e KQZ-së të përmbyllë procesin e kontrollit të financave të partive politike përgjatë fushatës zgjedhore të 30 Qershorit 2019*

Me dekretimin e datës së zgjedhjeve nga Presidenti i Republikës, qeverisja në vend është vendosur në regjim zgjedhor. Megjithatë, reformimi i kuadrit ligjor zgjedhor ende mbetet i papërfunduar nga legjislatori. Proces që mbart mbi vete edhe konstituimin e një trupe të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve sipas modulit të ri të miratuar[1].
Në këtë kontekst, është përgjegjësi imediate e aktorëve politikë që të përmbyllin sa më shpejt ndryshimet ligjore të pritshme si reflektim i ndryshimeve Kushtetuese, duke funksionalizuar sa më parë Këshillin Politik. Madje, nxiten aktorët politikë që, nëpërmjet punës së këtij të fundit, të asistohet në vazhdim edhe veprimtaria e KQZ-së së re përsa mund të lindë nevoja në rregullimin e aspekteve procedurialë në punën e saj. Asistimi nevojitet të ofrojë një vullnet të dakordësuar politik, veçanërisht lidhur me rregullimin e votimit të emigrantëve dhe të përdorimit të teknologjisë në zgjedhje.
Në kuadër të këtij reformimi, KRIIK risjell në vëmendje që, sërish nëpërmjet Këshillit Politik, të adresohet sa më shpejt edhe rregullimi i zhvillimit të procesit zgjedhor në rrethanat e një situate të rënduar të shëndetit publik, sikurse është situata e tanishme e vendit apo edhe parashikimi i eventualiteteve më të rënduara.
Kjo vëmendje dhe ky angazhim i aktorëve politikë është më se i nevojshëm për të nisur një "etapë të re" të funksionimit të institucionit të ri të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), duke ndërtuar një terren sa më të përshtatshëm ligjor dhe institucional për një funksionalitet me integritet të plotë dhe rezultativ të KQZ-së së Re në përgatitjen e procesit të ardhshëm zgjedhor[2] të 25 prillit 2021.
Aktualisht, është për t'u vlerësuar nisja e shpejtë e punës së Kuvendit për miratimin e trupës së KQZ-së[3] dhe reagimi i shpejtë i partive kryesore parlamentare në caktimin e përfaqësuesve respektiv në komisionin e posaçëm parlamentar përgjegjës për procesin e përzgjedhjes së kandidaturave të paraqitura. Proces, i cili duhet të mbartë rigorozitet ligjor maksimal, maturi të aktorëve parlamentarë e politikë dhe transparencë të plotë për të ftuar dhe përzgjedhur figurat më profesionale dhe më me integritet në vend.
Në vazhdën e kësaj qasje, Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara

1 Ligji Nr. 101/2020, datë 23.07.2020, *"Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar"*, Neni 182 *"Përfundimi i mandatit të anëtarëve të KQZ-së"*, pika 3 *"Komisioneri, nënkomisioneri, anëtarët e Rregullatorit dhe të KAS-it zgjidhen jo më vonë se 60 ditë nga hyrja në fuqi e këtij ligji"*. Më datë 4 gusht 2020 u publikuan në Fletoren Zyrtare amendimet e Kodit Zgjedhor si produkt i dakordësisë së Këshillit Politik. Ndryshime që ndër të tjera parashikojnë ridimensionimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe konstituimin e tre strukturave zgjedhore të reja. Afati kohor i parashikuar është jo më vonë se 60 ditë nga hyrja në fuqi e amendimeve ligjore, që përllogaritet të jetë data 18 tetor 2020.

2 Dekreti nr 11700 i Presidentit të Republikës *"Për caktimin e datës së zgjedhjeve për kuvendin"*, datë 06.09.2020.

3 Njoftim i Kuvendit të Shqipërisë *"Shpallje për hapjen e procedurës së aplikimit për vende vakante në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve"*, datë 29.08.2020.

(KRIIK Albania) nxit të gjithë aktorët përgjegjës për një frymë dhe përvojë të re të zbatimit të ligjit, pa asnjë kompromis dhe ekuivok, prej dhe ndaj partive politike. Kjo frymë, veçanërisht lidhur me financimin e tyre, duhet t'i japë fund një prej vatrave që nxisin pandëshkueshmërinë dhe pazbatueshmërinë e ligjit.

Në gjykimin e KRIIK, një proces i pazëshëm në këto rrethana, por me një peshë specifike kritike, mbetet audimi i veprimtarisë financiare të subjekteve zgjedhore në procesin zgjedhor të 30 Qershorit 2019. Proces në të cilën u aplikua një kuadër më i përmirësuar rregullator mbi financimin e fushatave zgjedhore falë kontributit të aktorëve ndërkombëtarë dhe vendas, politikë ose jo, si dhe të vetë institucionit të KQZ-së aktuale[4].

Në zbatim të tagrave ligjorë[5], pritej nga trupa e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve vendimmarrje mbi procesin e auditimit dhe kontrollit të kryer, e cila u shty në kohë për shkak të rrethanës së emergjencës shëndetësore të periudhës mars – qershor 2020.

Kjo vendimmarrje, megjithëse u deklarua se ishte e gatshme për t'u marrë sapo të mbyllej Gjendja e Fatkeqësisë Natyrore, deri më tani nuk është kryer ende nga Trupa e KQZ-së, megjithëse situata e emergjencës shëndetësore ka kaluar. Trupa deri më tani ka zhvilluar disa mbledhje publike dhe aktualisht vazhdon të jetë në detyrë deri sa të zgjidhet dhe të bëjë betimin KQZ-ja e re[6].

Në një kontekst të tillë, zhvillimet po tregojnë një "abdikim" nga detyrimi ligjor i Trupës të KQZ-së në largim.

Kjo tërheqje nga tagrat e Trupës aktuale do t'a rëndonte akoma edhe më përgjegjësinë individuale dhe kolegjiale të anëtarëve të trupës, duke sjellë një barrë të tepërt për Trupën e re të KQZ-së që pritet të konstituohet. Trupë, që ndër të tjera do të përballet me sfidat përkatëse të natyrshme në ngritjen e një mekanizmi të ri, gjë që mund të sjellë edhe gjetjen e zgjidhjes oportuniste të mënjanimit fare të vendimmarrjes në fjalë.

Një situatë e tillë do të shënonte preludin më të pashëndetshëm të sjelljes institucionale dhe ligjore të Institucionit të ri të KQZ-së, në raport me sfidën e ligjzbatimit dhe ndërshkueshmërisë respektive ndaj partive politike.

Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara ishte organizmi i vetëm që ndoqi në mënyrë integrale procesin e 30 Qershorit 2019, duke monitoruar tërë periudhën prej nëntorit 2018 deri në Shkurt 2020. Gjetjet e monitorimit të ecurisë institucionale që paraprinë dhe ndoqën tërë këtë proces u bënë me dije në publikimin "Sjellja ligjore dhe institucionale e institucioneve dhe aktorëve të përfshirë në procesin zgjedhor të 30 qershorit 2019"[7].

Një prej çështjeve më rëndësi objekt i këtij publikimi, ishte dhe veprimtaria financiare e subjekteve zgjedhore përgjatë fushatës[8], tematikë të cilën KRIIK e ka ndjekur në vijimësi dhe që për herë të parë u publikua si pjesë integrale e një raporti monitorimi së bashku me fazat e tjera të procesit zgjedhor.

Ndër gjetjet kryesore lidhur me veprimtarinë financiare të subjekteve zgjedhore, në raportimin e kryer u evidentuan parregullsi të rënda nga parti politike parlamentare kryesore. Nga këto përmenden si më flagrantet, rasti i moskthimit të fondeve paradhënie nga buxheti apo shpenzime të raportuara tërësisht jashtë elektorale. Veprime këto që sipas kuadrit ligjor marrin penalitete të rënda deri në mosfinancim prej fondeve publike apo edhe përjashtimin nga garimi zgjedhor pasardhës.

4 KRIIK e konsideron Udhëzimin Nr. 1 të KQZ-së, datë 11.04.2019, *"Për procedurën e kontrollit dhe verifikimit të financimeve dhe shpenzimeve të partive politike dhe fushatës zgjedhore"*, si një hap pozitiv të ndërmarrë nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, i mbështetur veçanërisht nga asistenca e huaj dhe që i parapriu edhe ndryshimeve të Kodit Zgjedhor që u miratuan nga Kuvendi në datë 23 korrik 2020.

5 Fjala e Kryetarit të Kryetarit të KQZ-së , z.Klement Zguri lidhur me Raportimin vjetor të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2019-të, në Kuvendin e Shqipërisë, datë 21/05/2020, *"... Aktualisht, KQZ ka përfunduar procesin e verifikimit dhe kontrollit të raporteve, por shqyrtimi i tyre në mbledhje të KQZ-së do të zhvillohet pas normalizimit të situatës nga pandemia COVID-19, pasi mbledhjet e KQZ-së janë publike dhe kërkojnë pjesëmarrjen e shumë personave. KQZ-ja ka ndryshuar sjelljen e saj ndaj raportimeve dhe auditimeve. Ato nuk janë më formalitet, nuk bëhen më për të kaluar radhën. ..."*

6 Më datë 30.07.2020, KRIIK nëpërmjet një shkrese zyrtare, në zbatim edhe të udhëzimit të KQZ-së, i bëri thirrje dhe nxiti Komisionin Qendror të Zgjedhjeve t'i qëndronte me rigorozitet zbatimit të ligjit dhe qasjes institucionale ndaj problematikave, veçanërisht në lidhje me veprimtarinë financiare të partive politike, duke i kërkuar përmbylljen e procesit auditues, proces i cili duhet të ishte përmbyllur që në muajin shkurt 2020.

7 Shih Raportin në faqen e internetit të KRIIK.

8 Shih tek Raporti *"Kapitulli X. Financimi i fushatës zgjedhore"*, faqe 95 – 120.

Sikurse u përmend, gjasat janë drejt një tejkalimi të procesit të kontrollit të veprimtarisë financiare për procesin e 30 Qershorit 2019. Pritshmëri që, duke vazhduar një ecuri anti ligjore të institucionit të KQZ-së, vendos pikënisjen më negative për ridimensionimin e institucionit. Sidomos në një kontekst dhe terren kur kontrolli i financimit dhe burimeve financiare që mund të vijnë nga aktivitete të paligjshme apo kriminale përbëjnë një sfidë të vërtetë të ecurisë demokratike të vendit, përballë sfidave për mos kapjen e pushteteve apo ç'është më e rëndësishmja moskapjen e shtetit.
Lidhur me sa më sipër, KRIIK iu bën thirrje të gjithë aktorëve politikë dhe institucionale dhe Trupës aktuale të KQZ-së se procesi i kontrollit të veprimtarisë financiare të partive politike përgjatë fushatës zgjedhore të 30 Qershorit 2019 meriton të konkludojë në një proces ligjor.
Parregullsitë e evidentuara meritojnë të trajtohen dhe të vendosen në një shtrat ligjor, qoftë edhe si një indulgjencë e kërkuar publikisht nga aktorët kryesorë politikë.
Vetëm një qasje e tillë, e cila konkludon me një sjellje tërësisht ligjore dhe institucionale do të ndihmojë në nisjen me integritet jo vetëm të punës dhe funksionimit të institucionit të ri të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, por edhe të "etapës së re" në administrimin e proceseve të ardhshme zgjedhore.

Tiranë, më 10 shtator 2020!

V.2. QENDRIM PUBLIK *- Ministria e Brendshme të bëjë transparencë të plotë, në mënyrë periodike, mbi tërë procesin e hartimit dhe saktësimit të listës së zgjedhësve*

Ministri i Brendshëm më datë 10 shtator 2020 nxorri udhëzimin "Për procedurat e hartimit të listave të zgjedhësve për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë", konform detyrimit të parashikuar nga Kodi Zgjedhor.
Procesi i hartimit dhe i saktësimit të listave të zgjedhësve është procesi i parë që nisi me futjen e vendit në rregjimin zgjedhor dhe përbën procesin më të rëndësishëm, i cili afekton drejtëpërsëdrejti të drejtat dhe liritë e qytetarëve për të votuar.
Njëkohësisht ky proces ka rëndësi madhore në rastin e këtyre zgjedhjeve parlamentare pasi ndikon, në rradhë të parë, në përcaktimin e numrit të mandateve për deputetë që do të nxjerrë çdo zonë zgjedhore, si dhe në shmangien e lëvizjeve të qëllimta për të ndikuar rezultatet e zgjedhjeve në këto zona. Fenomene negative këto të aplikuara më parë në përvojën problematike të proceseve zgjedhore në vend.
Situata në tërësi në vend dhe konteksti politik shtrojnë me urgjencë përballë të gjithë institucioneve shtetërore që i ngarkon ligji, në rradhë të parë, por edhe ndaj të gjithë aktorëve politikë dhe aktorëve të tjerë të shoqërisë civile, medias dhe vetë qytetarëve, domosdoshmërinë për të patur në vëmendje, ushtruar kontroll dhe presion institucional e qytetar që ky proces të udhëhiqet nga zbatimi katërcipërisht i ligjit dhe nga një transparencë e plotë.
Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK) ka ndjekur me shumë shqetësim ditët e fundit denoncimet e qytetarëve të transmetuara nga Emisioni Investigativ "Boom"[1] i Radiotelevizionit "Ora News", denoncimet e bëra publike edhe në media të tjera dhe veçanërisht prononcimet në media të Ministrit të Brendshëm z. Sandër Lleshaj[2], të Drejtorit të Përgjithshëm të Gjendjes Civile z. Bledar Doracaj[3] dhe zyrtarëve të tjerë, si dhe njoftimet përkatëse në faqen zyrtare të internetit të Ministrisë së Brendshme[4].

1 "BOOM" zbulon skandalin me listat e votuesve: Qeveria po zhvendos votuesit e opozitës nga QV pa dijeninë e tyre – 28 shtator 2020.
"BOOM" – Thellohet skandali i zhvendosjeve, Njësia 4 në Tiranë 'ndan' çiftin, burri shkon në Korçë dhe gruaja te Njësia 7 – 29 shtator 2020.
"BOOM" sjell të tjera dëshmi: Familja me banim në Tiranë zhvendoset në Dibër- 01 tetor 2020.

2 Intervistë e Ministrit të Brendshëm z. Sandër Lleshaj për emisionin *"RealStory"* në RTV *"News24"*. RealStory/ E "kërcënuan" me padi, Lleshaj sfidon PD-në: Qesharake! Le të shkojnë në Prokurori....

3 Gabimi me adresat, Doracaj: S'ka ndryshim vendbanimesh, s'do ketë probleme për zgjedhjet. Intervistë e z. Bledar Doracaj për emisionin *"Ilva Now"* në TV EuroNews Albania, datë 29.09.2020.
Akuzat e PD për manipulimin e listave të zgjedhësve, Bledar Doracaj: Të qëllimshme dhe të pabaza. Intervistë e z. Bledar Doracaj në Report TV.

4 Deklarata/Ministri Lleshaj: Në Shqipëri po zbatohet projekti për sistemin funksional të adresave, nuk ka asnjë lloj ndryshimi të qendrave të votimit për qytetarët, datë 29.09.2020.

Shqetësimet e qytetarëve të denoncuara në media evidentojnë se ndërsa ata kanë shkuar pranë zyrave të gjendjes civile të tyre, iu është deklaruar nga nëpunësi përkatës se gjendja e tyre civile tashmë është transferuar në një tjetër gjendje civile, si pasojë e ndërrimit të adresës së vendbanimit të tyre. Sipas deklarimeve të qytetarëve, **ata nuk kanë bërë asnjë deklarim pranë zyrave të gjendjes civile për ndryshimin e vendbanimit të tyre**.
Nga ndjekja në tërësi e situatës dhe shqyrtimit të rrethanave, KRIIK vëren se, lidhur me këtë problematikë të konstatuar nga media, **nga ana e Ministrisë së Brendshme ka një mungesë serioze transparence dhe njëkohësisht evidentohet një qendrim aspak i përshtatshëm dhe korrekt i** të dy zyrtarëve të lartë të shtetit.
Për më tepër, aludimet se kjo është një çështje e stisur nga partitë opozitare dhe media jo profesionale, **në rradhë të parë, përbëjnë deklarata të drejtëpërdrejta intimidimi ndaj medias** duke cënuar lirinë e investigimit dhe të pasqyrimit të problematikave të qytetarëve në raport me institucionet shtetërore.
Nga ana tjetër, vlerësohet se **sqarimet e dhëna dhe deklarimet e bëra nuk rezultojnë të përbëjnë një qendrim institucional të plotë dhe korrekt** mbi shkakun e ndodhjes së problematikës dhe rrugëzgjidhjen e duhur institucionale të çështjes.
Në thelb, në një mungesë totale transparence, **shpjegimet zyrtare të servirura ngrenë akoma edhe më shumë dyshime mbi atë se çfarë ka ndodhur realisht** me ngatërresat e adresave të vendbanimit të shtetasve, mënyrën si ato janë mbledhur, si është bërë përcaktimi i adresës si vendbanim i qytetarëve dhe se si është bërë migrimi i të dhënave nga Regjistri Kombëtar i Adresave[5] në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGJC)[6].
Nga deklarimet e një zyrtari[7] të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile (DPGJC), konstatohet se procesi i identifikimit dhe popullimit të adresës për çdo shtetas, i nisur fillimisht në 29 shtator 2016 si bashkëpunim me Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike[8] (OSHEE sh.a.), vazhdon ende sot dhe se një prej hallkave të procesit është migrimi i deklaratave të shtetasve për vendbanimin e tyre në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile.
Gjithashtu, sipas tij, ky proces nuk ka të bëjë fare me "numrin zgjedhor" të çdo shtetasi, pasi ato atribute janë të paprekuara.

Reagim i ministrit të Brendshëm Sandër Lleshaj, pas deklaratave të opozitës *"Asnjë ndryshim nuk po ndodh, nuk do të ndodhë dhe nuk mund të ndodhë me qendrat e votimit – Të gjithë kanë nevojë të kenë një adresë"*, datë 30.09.2020. Ministri Lleshaj sqaron në *"Real Story"*, çështjen e pajisjes së shtetasve me adresa vendbanimi dhe hedh poshtë zhurmën për lista zgjedhore, datë 01.10.2020.

5 Ligji Nr. 9270, datë 29.07.2004 *"Për sistemin e adresave"*, Neni 1/1 *"Në kuptim të këtij ligji: 3. "Regjistri vendor i adresave" është dokumenti shtetëror ku hidhen, ruhen dhe pasqyrohen, në mënyrë të vazhdueshme, elementet përbërëse të adresës së ndërtesave, apartamenteve dhe të truallit të lirë për secilën njësi të vetëqeverisjes vendore në territorin e Republikës së Shqipërisë. 4. "Regjistri Kombëtar i Adresave" është dokumenti unik shtetëror, që krijohet nga tërësia e të dhënave të regjistrave vendorë të adresave."*;
Neni 4/1 *"1. Çdo njësi e qeverisjes vendore krijon, përditëson dhe administron të dhënat në regjistrin vendor të adresave. 2. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile krijon dhe administron Regjistrin Kombëtar të Adresave."*

6 Ligji Nr. 10129, datë 11.5.2009 *"Për gjendjen civile"*, Neni 2 *"Përkufizime"*, *"Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime: 1. "Gjendja civile" është tërësia e të dhënave personale të shtetasve shqiptarë, shtetasve të huaj, si dhe të personave pa shtetësi, që janë me banim të përkohshëm apo të përhershëm në Republikën e Shqipërisë, të cilat regjistrohen dhe mbahen në Regjistrin Kombëtar dhe që vërtetojnë lindjen, ekzistencën, individualitetin, lidhjet ose marrëdhëniet ndërmjet tyre. 2. "Regjistri Kombëtar" i vitit 2010 (në vijim Regjistri Kombëtar) është dokumenti shtetëror unik, ku pasqyrohen përbërësit e gjendjes civile të çdo shtetasi shqiptar, shtetasi të huaj dhe çdo personi pa shtetësi, me banim të përkohshëm/të përhershëm në Republikën e Shqipërisë."*

7 *"... Në vitin 2016 kur nisi procesi i popullimit, ku filluan të mblidheshin deklaratat e shtetasve të vendbanimit, shtetasit deklaronin secili vendndodhjen e tyre se ku ndodheshin dhe shtëpinë që ata zotëronin. Ky proces është akoma në vazhdim dhe një prej hallkave të procesit është migrimi i këtyre deklaratave në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile. ...*
Ky proces nuk të bëjë fare me numrin ose le të themi me kodin zgjedhor të çdo shtetasi. Ato atribute janë të paprekuara. ...
Procesi i migrimit të të dhënave është në vijim dhe vazhdon sepse mënyra se si është ngritur infrastruktura dhe se si bëhet bashkëveprimi është që: ne kemi Regjistrin Kombëtar të Adresave ku zyrat e urbanistikës përditësojnë rrugët, numrin e ndërtesave, përditësojnë edhe kufijtë, në fakt me atë merremi edhe ne personalisht, me përcaktimin e kufijve sa më të saktë të bashkive, të njësive administrative. Ky përditësim i rregullt pasqyrohet pastaj dhe në adresën e çdo shtetasi. Kështu që shtetasit, siç e kanë vënë re dhe siç kemi edhe ca deklarata, në çertifikatën e tyre personale që gjenerohet në e-albania kanë vendbanimin e saktë me të gjithë elementët e duhur dhe në çdo referencë, çdo komunikim zyrtar me letër mund të shkojë në adresën e tyre. ...".
Deklarim i z. Vangjush Stavro, Shef i Sistemeve Informative në DPGJC në Emisionin *"Top Talk"* pranë RTV *"Top Channel"*, datë 02.10.2020, minuta 01:49 – 3:39.

8 Artikulli *"Regjistrimi i adresave, projekt i pafinalizuar"*, publikim i organizatës *"Faktoje"*, me mision verifikimin e fakteve përmes një metodologjie të standartizuar profesionale, të vërtetësisë së premtimeve, deklaratave dhe veprimeve të zyrtarëve publikë.

Në ndryshim me deklarimin e fundit të zyrtarit të DPGJC-së, shqetësimi i deritanishëm i qytetarëve për ndryshimin e paautorizuar, sipas tyre, të adresës së vendbanimit[9] të tyre, **merr një gravitet më të rëndë pas hyrjes së vendit në regjim zgjedhor**.
Sipas parashikimeve të Kodit Zgjedhor, jo më vonë se data 21 shtator 2020, zyrat e gjendjes civile duhet të kenë nxjerrë në format elektronik ekstraktin me përbërësit zgjedhorë të të gjithë shtetasve me të drejtë vote në datën e zgjedhjeve (25.04.2021), me përjashtim të shtetasve që kanë mbushur 100 vjeç deri në këtë datë[10].
Brenda datës 6 Tetor 2020 është parashikuar të publikohet ekstrakti i parë i përbërësve zgjedhorë të të gjithë shtetasve që kanë vendbanimin në zonat e qendrave të votimit nën juridiksionin e çdo zyre të gjendjes civile, listë kjo e cila nxirret nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile.
Lista e zgjedhësve është parashikuar të përmbajë emërtimin e zonës zgjedhore "njësinë e qeverisjes vendore, njësinë administrative", llojin dhe datën e zgjedhjeve, numrin e qendrës së votimit dhe përbërësit zgjedhorë të zgjedhësve[11].

Lista e zgjedhësve hartohet për çdo zonë qendre votimi dhe përmban të gjithë zgjedhësit që kanë vendbanimin e regjistruar në RKGJC në atë zonë qendre votimi. **Përfshirja e zgjedhësit në listë bëhet mbi bazën e kodit të vendbanimit**[12], i cili është 1 ndër 9 përbërësit zgjedhorë që parashikon Kodi Zgjedhor[13].
"Kodi i vendbanimit" apo "numri zgjedhor", term i përdorur në listën online të zgjedhësve[14], është një kod shumëshifror i cili ndërtohet duke patur për bazë kodin e banesës. Ky i fundit është një kod treshifror që **përcaktohet sipas adresës së vendbanimit të deklaruar prej zgjedhësit**.

Kodit të banesës[15] i vendoset përpara numri i qendrës së votimit në territorin e së cilës ndodhet banesa e zgjedhësit, dhe më pas i vendoset përpara edhe numri i zyrës së gjendjes civile, duke përfituar kështu "kodin e vendbanimit" apo "numrin zgjedhor".
Rrjedhimisht, **ndryshimi i vendbanimit në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile është i lidhur drejtëpërdrejtë me numrin zgjedhor, pra me listën e zgjedhësve**.
Gjithë sa më sipër, në opinionin e KRIIK, cënon rëndë besimin e qytetarëve ndaj institucioneve shtetërore përgjegjëse për përgatitjen e listës së zgjedhësve që në nisje të këtij procesi.
KRIIK, **i bën thirrje Ministrit të Brendshëm si autoriteti përgjegjës i ngarkuar nga ligji që të bëjë dhe sigurojë në vazhdimësi transparencë**.

Kjo transparencë duhet të jetë tërësore, e detajuar në hapat e ndërmarrë dhe mekanizmat e përdorur, të shoqëruara këto me bazën ligjore të mbështetur, me një gjuhë

9 Ligji Nr. 7850, datë 29.7.1994 *"Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë"*, Kreu I *"Personat fizikë"*, gërma *"Ç. Banimi dhe qëndrimi"*, Neni 12 *"Banimi është vendi ku personi, për shkak të punës apo të shërbimit të përhershëm, të ndodhjes së pasurisë apo të realizimit të interesave të veta, qëndron zakonisht ose të shumtën e kohës. Çdo person madhor ka të drejtë të caktojë lirisht vendbanimin e tij. Personi nuk mund të ketë njëkohësisht me shumë se një vendbanim. ..."*
Ligji Nr. 10129, datë 11.5.2009 *"Për gjendjen civile"*, Neni 14 *"Deklarimi i vendbanimit"*, pika *"1. Shtetasit kanë të drejtë të kenë një apo më shumë banesa për përdorim vetjak apo familjar në territorin e Republikës së Shqipërisë ose jashtë vendit. Shtetasit kanë detyrimin që të deklarojnë adresën e çdo banese për përdorim, sipas kësaj pike. 2. Shtetasit kanë të drejtë të zgjedhin lirisht në cilën banesë të jetojnë zakonisht ose të shumtën e kohës. Banesën, në të cilën shtetasi jeton zakonisht për më shumë se tre muaj pa ndërprerje ose më shumë se gjashtë muaj në një vit kalendarik, ka detyrimin ta deklarojë si vendbanimin e tij"*.
Neni 15 *"Regjistrimi dhe ndryshimi i vendbanimit"*, pika *"1. Regjistrimi fillestar i vendbanimit/adresës së banesës, sipas nenit 14 të këtij ligji, si dhe ndryshimi i vendbanimit/adresës së banesës, si rregull, bëhet në zyrën e gjendjes civile bashki/komunë që ka në juridiksion territorial vendbanimin apo banesën e deklaruar. 2. Nëse një shtetas ka më shumë se një banesë për përdorim, sipas pikës 1 të nenit 14 të këtij ligji, ai duhet të deklarojë banesën, në të cilën ka vendbanimin e tij. Shtetasit nuk mund të deklarojnë njëherazi më shumë se një vendbanim. 3. Në rast ndryshimi të vendbanimit, apo kur një banesë nuk përdoret më për përdorim vetjak apo të familjes, ky ndryshim deklarohet në zyrën e gjendjes civile. Regjistrimi fillestar i vendbanimit apo ndryshimi i tij bëhet jo më vonë se 30 ditë nga ardhja në këtë vendbanim. ..."*

10 Kodi Zgjedhor i Republikë së Shqipërisë, Neni 51 *"Publikimi i ekstraktit të përbërësve zgjedhorë"*, pika 1.

11 Po aty, Neni 48 *"Përmbajtja dhe formati i listës së zgjedhësve"*, pika 1.

12 Po aty, Neni 46 "Lista e zgjedhësve", pika 1.

13 Po aty, Neni 45 "Përbërësit zgjedhorë", pika 1.

14 Shih në formatin video përbërësit zgjedhorë që figurojnë në aplikacionin online të listës së zgjedhësve. Video-spoti *"Verifiko emrin në listën zgjedhore!"*, i publikuar nga Ministria e Brendshme për zgjedhjet lokale 2019, sekonda 37.

15 Shih në formatin video pamje të mënyrës se si ndërtohet Kodi i Vendbanimit (Numri Zgjedhor) apo adresa zgjedhore siç citohet në regjistrimin video të intervistës së Ministrit të Brendshëm z. S. Lleshaj për emisionin *"RealStory"* në RTV *"News24"*. RealStory/ E "kërcënuan" me padi, Lleshaj sfidon PD-në: Qesharake! Le të shkojnë në Prokurori..., minuta 9, sekonda 11.

mundësisht të kuptueshme për publikun e gjerë. Dokumentet ligjorë të publikohen në mënyrë koherente me procesin e saktësimit të listave, në faqet zyrtare të internetit të institucioneve përgjegjëse të ngarkuara nga ligji.
Madje, në gjykimin e KRIIK, **është e domosdoshme që Ministri i Brendshëm së bashku me institucionet e tjera përgjegjëse të bëjnë, gjithashtu, transparencën e plotë** që refuzuan ta bëjnë[16] përgjatë afro 7 muajve të kohëzgjatjes së procesit të hartimit dhe saktësimit të listave të zgjedhësve për zgjedhjet lokale 2019, përgjatë të cilave u bë saktësimi i adresave të vendbanimit për rreth 283,338 zgjedhës, të cilët deri në atë kohë figuronin me adresë të panjohur[17].
Saktësimi i adresës së këtyre zgjedhësve, sot ka peshë direkte së pari në caktimin e numrit të mandateve për çdo zonë zgjedhore, vendimmarrje e cila pritet të merret nga Komisioni Rregullator i KQZ-së së re.

Veçanërisht mbetet me shumë interes **të bëhet transparencë mbi mekanizmin dhe metodologjinë e përdorur,** me anë të së cilës u bë e mundur gjetja dhe saktësimi i adresave të banimit për 229,700 shtetasve në vetëm 59 ditë, pra nga data 04.12.2018 – 01.02.2019, ndërkohë që procesi i njoftimit me shkrim të zgjedhësve nuk kishte filluar ende nga Bashkitë, madje as fondi i nevojshëm financiar nuk iu ishte lëvruar këtyre të fundit për këtë qëllim.
KRIIK ishte organizata e vetme që ndoqi në mënyrë integrale tërë ecurinë institucionale para, gjatë dhe pas procesit të 30.06.2019, duke monitoruar tërë periudhën prej nëntorit 2018 deri në Shkurt 2020, ku një vëmendje të veçantë i kushtoi procesit të përgatitjes së listave të zgjedhësve, sjelljes së Ministrisë së Brendshme, Bashkive, monitorimit të procesit prej dy auditëve të caktuar prej KQZ-së, si dhe sjelljes së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve si mbikqyrëse e të gjithë procesit[18].
Me synim informimin dhe bërjen transparencë mbi ecurinë e tërë procesit, por edhe për sensibilizimin e aktorëve institucionalë, shtetërorë ose jo, **për të nxitur reagimin e tyre mbi gjetjet dhe shkeljet ligjore të vërejtura**, Raporti i Monitorimit iu dërgua të gjithë aktorëve dhe institucioneve me rol në proces, përfshi këtu edhe Ministrinë e Brendshme dhe DPGJC, veçanërisht lidhur me problematikat e vërejtura dhe pikëpyetjet e ngritura mbi procesin e hartimit të listës së zgjedhësve.
Një vend të veçantë në Raport gjen pasqyrimi i gjetjeve të dy auditëve teknicienë të caktuar nga KQZ-ja, **raportimi i njërit prej të cilëve përmban gjetje serioze dhe shumë shqetësuese**, pasi sipas tij administrimi dhe përpunimi i bazës së të dhënave të RKGJC është jo në përputhje me kërkesat teknike dhe administrative të legjislacionin në fuqi[19].
Po sipas këtij auditi, **evidentohen disa raste kodesh të banesave të cilat janë absurde dhe të pamundura**, si p.sh. numër shumë i lartë zgjedhësish të regjistruar në një kod banese që duket se nuk ekziston në hartë (kodi i vendosur në një lulishte), etj.

16 Ministria e Brendshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (DPGJC), ndryshe nga proceset zgjedhore të mëparshme, përgjatë procesit përgatitor të listave për zgjedhjet e 30.06.2019, nuk publikoi asnjë të dhënë zyrtarisht mbi ecurinë e procesit, përveç njoftimit, të bërë më datë 25 maj 2019 në faqen e internetit të Ministrisë, mbi publikimin e listës finale të zgjedhësve.
Gjithashtu, Ministria e Brendshme dhe DPGJC-ja nuk ktheu asnjë përgjigje ndaj dy shkresave zyrtare të dërguara nga KRIIK, ku kërkohej informacion në lidhje me ecurinë e procesit të korrigjimit dhe publikimit të listave të zgjedhësve, duke shkelur Ligjin për të Drejtën e Informimit, por edhe Vendimin e Këshillit të Ministratve nr. 238, datë 10.05.2019, që forconte detyrimin e institucioneve shtetërore për t'iu dhënë informacion organizatave të akredituara si Vëzhguese të procesit zgjedhor, sikundër ishte edhe KRIIK.

17 Zgjedhës me adresë banimi të papërcaktuar ose me kod banimi 000, 888, apo 999.

18 Shih Kapitullin "VIII. Listat e Zgjedhëve" fq. 83-91; Seksionin "VI.2. Ministria e Brendshme" fq. 64-64; si dhe Seksionin "VI.4. Bashkitë" fq. 66-67; tek Raporti i Monitorimit *"Sjellja ligjore dhe institucionale e institucioneve dhe aktorëve të përfshirë në procesin zgjedhor të 30 qershorit 2019"*, publikuar nga KRIIK në Qershor 2020.

19 Raporti i audituesit Zamir Hoxha "Mbi verifikimin e veprimeve në bazën e të dhënave të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile", fq. 15-16, *"...Siç* është *dokumentuar administrimi dhe përpunimi i bazës së të dhënave të RKGCJ* është *jo në përputhje me kërkesat teknike dhe administrative të legjislacionin në fuqi.*
Përveçse shkeljes të legjislacionit kjo ka pamundësuar një vlerësim të plotë të RKGJC si sistemi ku administrohen, përpunohen, mbahen të dhënat e shtetasve dhe nga ku gjëndërohet lista zgjedhore. Gjithashtu kjo ka sjellë limitime në analizat dhe vlerësimet e mundshme mbi ligjshmërinë e veprimeve te përdoruesve mbi elemente zgjedhorë duke cenuar besimin ndaj veprimeve të kryera gjatë proceset të hartimit të listave zgjedhore. Gjenerimin të ekstraktit zgjedhor, u provua që është *një proces i cili kryhet nga një person i vetëm dhe totalisht jashtë sistemit të RKGJC, sistem i cili* është *i vetmi i njohur ligjërisht. Faza e vetme e cila përfshin RKGJC* është *procedura e backup, e cila siç* është *evidentuar dhe në raportet e mëparshme nuk* është *dokumentuar dhe testuar sipas legjislacionit në fuqi, dhe në vetvete nuk* është *një procedure e cila lidhet direkt me procesin zgjedhor. Kryerja e të gjithë procesit të përpunimit dhe përgatitjes të ekstraktit zgjedhor në një ambient jashtë RKGJC krijon mungesë besimi dhe ka rezultuar me probleme të cilat cënojne korrektësinë e listës se zgjedhësve dhe te cilat janë evidentuara në vazhdimësi gjatë procesit te auditimit."*

Në përfundim të ekspertimit prej tij, auditi teknicien konkludon se "në përfundim të periudhës së auditimit duke vlerësuar parregullsitë e hasura dhe në pamundësi për të marrë informacionet e kërkuara nga ana ime në zbatim të dispozitave ligjore gjykoj se të gjitha ndërhyrjet e kryera për ndryshimin e elementëve zgjedhorë ku përfshihem rreth 10% e totalit të zgjedhësve dhe **gjenerimi i listave me procedura manuale me ndërhyrje te personelit** cënojnë rëndë besueshmërinë mbi listën e zgjedhësve, ...[20]".
Gjenerimi i listave me procedura manuale në procesin e 2019-ës, i pranuar edhe nga DPGJC në rastin e zgjedhësve mbi 100 vjeç, shënoi një hap pas në krahasim me proceset për zgjedhjet e 2017 dhe 2015. Nga shqyrtimi i çështjes, KRIIK evidentoi asokohe se menaxhimi manual i të dhënave, pavarësisht arsyeve objektive që mund të parashtroheshin, nuk ishte një zgjidhje e momentit të fundit, por ishte e parashikuar të menaxhohej në mënyrë të tillë.
Kjo pasi **Udhëzimi i Ministrit të Brendshëm i vitit 2018, ishte i ndryshëm nga udhëzimet e hartuara për zgjedhjet e mëparshme** (të viteve 2016[21] dhe 2014[22]), të cilët parashikonin shprehimisht "**gjenerim automatik të listës** nga sistemi i RKGJC-së".

Ndërkohë që Udhëzimi nr. 295/1 datë 06.11.2018 udhëzonte thjesht që të "gjenerohet ekstrakti elektronik i përbërësve zgjedhorë"[23] pa e përcaktuar mënyrën se si të bëhej ky gjenerim, duke lënë, kështu, hapësirë edhe për menaxhim apo gjenerim manual të tij.
Në situatën aktuale mbetet e paqartë dhe shqetësuese se pse Udhëzimi i Ministrit të Brendshëm[24] nr. 298 datë 10.09.2020 për përgatitjen e listës së zgjedhësve për procesin zgjedhor të 25 prillit 2021, është i hartuar në të njëjtën formë sikursë ai i 2018-ës të përmendur më sipër, **duke mos**

20 Po aty, fq. 17.
Po aty, fq 11 - 13. *"... Në analizat e bëra nga ana ime janë identifikuar një listë me kode banesash të cilat kanë më shumë se 300 banorë të cilat konsiderohen anomali. Nga këto raste, lista me më shume se 500 banore për kod banese i është dërguar me email DPGJC duke i kërkuar sqarime mbi këto raste dhe objektet në fjalë. Në përgjigje të kërkesës time nga ana e tyre më është bërë me dije se do ngrihen grupe kontrolli për verifikimin e rasteve. Nëpërmjet email të dërguar me datë 30 Maj 2019 nga ana ime është kërkuar informacion mbi rezultatet e grupit të kontrollit. Në përgjigje të dërguar nga ana e DPGJC thuhet që: lidhur me këtë çështje, ju bëjmë me dije se kontrolli dhe monitorimi qe po realizohet nga ana e DPGJC-se është ne proces dhe akoma nuk eshte konkluduar mbi shqetësimin e paraqituar nga ana juaj.*
Ndërkohë duke bërë verifikime të kodeve të banesave për disa raste në sistemin e hartave të KQZ rezulton që këto objekte nuk mund të kenë në asnjë mënyrë atë nr banorësh. Më konkretisht po sjell në vëmendje 3 nga raste si më poshtë: Në Korçë QV 3636 ka 1051 zgjedhës të regjistruar me numër banese 141 që i përket godinës së Fakultetit të shkencave të natyrës dhe humane dhe 495 zgjedhës të regjistruar me numër banese 529 që siç duket në hartë është lulishte. Në Durres QV 1470 ka 944 zgjedhës me numër banese 22 e cila shihet lehtësisht nga fotot ajrore që është godinë shume e vogël dhe e ka të pamundur të strehojë 944 zgjedhës së bashku me familjet e tyre. Në Elbasan QV 2350 ka 408 zgjedhës me numër banese 27 e cila është një shkalle pjesë e një godine 6 katëshe ndërtuar para viteve 90 dhe dallohet lehtësisht dhe nga foto ajrore që është godinë qe e ka të pamundur të strehojë 408 zgjedhës së bashku me familjet e tyre. Pra siç vihet re në të gjitha rastet kemi të bëjmë me raste flagrante pasaktësish dhe manipulimi të të dhënat e zgjedhësve.
Fakti që është e pamundur të verifikohen hartat dhe kodet e banesave të zgjedhësve dhe gjithashtu nuk mund të verifikohet se si janë ndryshuar kodet e banesave për 350.843 zgjedhës gjatë periudhës së monitorimit duke pamundësuar verifikimin e ligjshmërisë të ndryshimeve në elementët zgjedhor të tyre. Ky numër është mjaft i lartë dhe përfaqëson 10% të listës së zgjedhjeve. ..."

21 Udhëzimi Nr. 671 datë 06.12.2016 *"Për procedurat e hartimit të listave të zgjedhësve për zgjedhjet për Kuvendin"*, pika 1 *"Ekstraktet e përbërësve zgjedhore dhe listat e zgjedhësve gjenerohen automatikisht nga RKGJC-ja, në afatet që parashikon ligji dhe janë të vlefshme në ndërfaqen grafike online të RKGJC-së. Procedura e gjenerimit të ekstrakteve dhe listës së zgjedhësve është funksionalitet i sistemit të RKGjC-së, ku përgjegjësi i zyrës së gjendjes civile shkarkon nga RKGJC përbërësit zgjedhorë për zgjedhësit përkatës, si më poshtë: përzgjedh tek menuja në të majtë të faqes së RKGjC-së, opsionin "Procesi i regjistrimit", "Raportime" dhe zgjedh listën. ...".*

22 Udhëzimi Nr. 364 datë 16.12.2014 *"Për procedurat e hartimit të listave të zgjedhësve për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore"*, pika 1. *"Ekstraktet e përbërësve zgjedhorë dhe listat e zgjedhësve gjenerohen automatikisht nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile, në afatet që parashikon ligji dhe janë të vlefshme për t'u shkarkuar on-line nga aplikacioni përkatës i Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile. Procedura e gjenerimit të ekstrakteve dhe listës së zgjedhësve është funksionalitet i sistemit, Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile, ku përgjegjësi i zyrës së gjendjes civile shkarkon nga ky sistem përbërësit zgjedhorë, për zgjedhësit sipas vendbanimit përkatës, si më poshtë: - përzgjedh në menunë në të majtë të faqes së RKGJC-së, opsionin "Procesi i regjistrimit", "Raportime" dhe zgjedh listën. ...".*

23 Udhëzimi Nr. 295/1 datë 6.11.2018 *"Për procedurat e hartimit të listave të zgjedhësve për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore"*, pika 1 *"Brenda datës 20.11.2018, nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile (RKGJC) i vitit 2010, të gjenerohet ekstrakti elektronik i përbërësve zgjedhorë, në përbërje të të cilit janë të gjithë shtetasit me të drejtë vote, të cilët deri në datën 30.6.2019 kanë mbushur moshën 18 vjeç, të lindur deri në datën 30.6.2001. ...".*

24 Udhëzimi i Ministrit të Brendshëm nr. 298 datë 10.09.2020 *"Për procedurat e hartimit të listave të zgjedhësve për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë"*, pika1 *"1. Brenda datës 21.9.2020, nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile (RKGJC) i vitit 2010, të gjenerohet ekstrakti elektronik i përbërësve zgjedhorë, në përbërje të të cilit janë të gjithë shtetasit me të drejtë vote, të lindur që nga data 25.4.2003, të cilët deri në datën e zhvillimit të zgjedhjeve, më 25.4.2021, do të mbushin 18 vjeç."*

përcaktuar shprehimisht "gjenerimin automatik të listës nga sistemi i RKGJC-së".
Lidhur me gjithë këtë aspekt, konsiderohet më shumë rëndësi që Ministri i Brendshëm të bëjë me dije se DPGJC dhe institucioni që administron Regjistrin Kombëtar **i ka në dispozicion kapacitetet e duhura** për përdorimin dhe menaxhimin në mënyrë automatike të procesit të gjenerimit të ekstrakteve dhe të listave zgjedhore dhe **se i tërë procesi është i garantuar në parametrat maksimalë të sigurisë së tij**.
Gjithashtu, pas shqyrtimit të përmbajtjes së këtij Udhëzimi që po orienton procesin e tanishëm të hartimit të listës së zgjedhësve, KRIIK **konstaton disa pasaktësi dhe mospërmbushje të kërkesave të Kodit Zgjedhor**, të cilat vazhdojnë të mos merren parasysh në vazhdimësi prej institucionit të Ministrit të Brendshëm duke bërë joefikas mekanizmin dhe parashikimet e Kodit Zgjedhor.
Konkretisht, KRIIK i bën thirrje Ministrit të Brendshëm që të korrigjojë dhe përmirësojë Udhëzimin nr. 298 datë 10.09.2020, në mënyrë që ai të përmbushë detyrimet ligjore që rrjedhin prej Kodit Zgjedhor. Sillet në vëmendje se:

a. Në pikën 3 të Udhëzimit parashikohet që numri minimal i zgjedhësve për një qendër votimi të jetë 200 zgjedhës. Ndërkohë me ndryshimet e Kodit Zgjedhor të datës 23.07.2020, ky minimum është ndryshuar nga 200 në 300 zgjedhës, sipas parashikimeve të bëra në nenin 46 "Lista e zgjedhësve" dhe nenin 62 "Caktimi i zonave dhe vendndodhjes së qendrave të votimit"[25].

b. Në pikën 14 të Udhëzimit parashikohet njoftimi me shkrim i zgjedhësve, një proces mjaft i rëndësishëm për saktësimin e të dhënave të qytetarëve në listat e zgjedhësve, i cili duhet të kryhet brenda 60 ditëve prej datës 06.10.2020 – 05.12.2020. Njoftimi përmban "qendrën e votimit, vendndodhjen dhe adresën e saj, si dhe numrin rendor të zgjedhësit në listën e zgjedhësve të qendrës së tij të votimit".

- Lidhur me këtë proces modelet e njoftimit të miratuara, nuk përmbajnë hapësirë të përcaktuar për t'u firmosur nga qytetari që njoftohet në mënyrë që ai të konfirmojë (duke nënshkruar) marrjen e njoftimit me shkrim, sikundër kërkohet nga Kodi Zgjedhor[26];
- Lidhur me ecurinë e procesit, Udhëzimi nuk parashikon në përmbajtje të tij asnjë mekanizëm për llogaridhënie të Kryetarëve të Bashkive mbi procesin e njoftimit me shkrim[27] të zgjedhësve në bashkitë respektive, sikurse kërkohet në Kodin Zgjedhor;
- Udhëzimi nuk përmban asnjë orientim lidhur me mënyrën e menaxhimit të fondit[28] dhe kohën e lëvrimit të tij ndaj Bashkive për kryerjen e procesit të njoftimit me shkrim të zgjedhësve.

Prej zgjedhjeve të vitit 2017 fondi iu është lëvruar Bashkive, por procesi i njoftimit, në rastin më të mirë, nuk është zhvilluar siç duhet. Kjo edhe për faktin e lëvrimit të tij përgjithësisht në fund ose pas kalimit të periudhës 60 ditore të parashikuar për procesin e njoftimit.
Ministria e Brendshme duhet të lëvrojë sa më parë këtë fond në mënyrë që të bëjë funksional procesin e njoftimit me shkrim që prej fillimit të tij më datë 6 tetor 2020.

- Udhëzimi duhet të detajojë shprehimisht, gjenerimin në sistem të Modelit të njoftimit me shkrim të zgjedhësve nga DPGJC që më datë 6 tetor 2020, sipas parashikimit në Kodin Zgjedhor.

Në dy proceset e kaluara është evidentuar që vetë DPGJC nuk ka bërë gjenerimin në kohën e duhur në sistem të Modelit të njoftimit. Madje ka qenë DPGJC që ka orientuar Bashkitë dhe ZGJC për kryerjen e këtij procesi pas shpalljes së listës përfundimtare të zgjedhësve, në kundërshtim të plotë me detyrimet e Kodit Zgjedhor dhe vetë Udhëzimit të MB-së.

c. Në pikën 2 të Udhëzimit, në zbatim të dispozitave të Ligjit të ashtuquajtur të dekriminalizimit[29] dhe Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm Nr. 225, datë 11.05.2016, DPGJC në

25 Në përcaktimin gabim të numrit minimal duket se ka ndikuar referimi vetëm në pikën 2 të nenit 51 *"Publikimi i ekstraktit të përbërësve zgjedhorë"*, i cili përbën një gabim material dhe që tashmë është parashikuar të saktësohet me ndryshimet e reja të Kodit Zgjedhor të parashikuara për t'u miratuar në parlament më datën 5 tetor 2020.

26 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 52 *"Njoftimi me shkrim i zgjedhësve"*, pika 4 "*Personat e ngarkuar me njoftimin e zgjedhësve i dorëzojnë njoftimin zgjedhësit personalisht ose, në mungesë të zgjedhësit, një anëtari madhor të familjes së tij, që gjendet në banesën e zgjedhësit, i cili firmos për marrjen e njoftimit. ...".*

27 Po aty, pika 4 *"... Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore raporton për përmbushjen e këtij detyrimi, sipas udhëzimit të ministrit që mbulon shërbimin e gjendjes civile".*

28 Po aty. Neni 52, pika 5 *"Shpenzimet për njoftimin, sipas këtij neni, mbulohen nga ministria që mbulon shërbimin e gjendjes civile. Fondi përkatës u shpërndahet njësive të qeverisjes vendore në raport me numrin e zgjedhësve që ka* çdo *njësi e qeverisjes vendore".*

29 Ligji nr. 138/2015 datë 17.12.2015*"Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"*

bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, duhet të evidentojnë dhe heqin nga lista e zgjedhësve shtetasit që nuk mund të ushtrojnë të drejtën e votës për shkak të kryerjes së veprave penale specifike të parashikuara. Në dy proceset e kaluara zgjedhore janë evidentuar vonesa dhe pasaktësi të cilat kanë ardhur si pasojë e mungesës së koordinimit ndërmjet institucioneve.

Gjykohet i nevojshëm rregullim më i detajuar për një koordinim sa më të mirë ndër-institucional dhe funksionalitet më të mirë të procesit.

d. Në pikën 13 të tij, Udhëzimi parashikon publikimin e ekstraktit të përbërësve zgjedhorë në ambientet e bashkive/njësive administrative në vende me hyrje të lirë të aksesueshme për publikun.

Ky process është shumë i rëndësishëm për t'iu dhënë mundësi qytetarëve që të mund të konsultojnë apo kontrollojnë listat në çdo kohë dhe pa asnjë kufizim.

Nisur nga problematikat e evidentuara në proceset e mëparshme, nevojitet të përcaktohet që këto ambiente të jenë të lira për t'u aksesuar nga publiku në çdo kohë. Madje duhet të orientohen Bashkitë, sidomos ato në zonat urbane, që publikimin e listave t'a bëjnë në ambiente pranë tyre, dhe jo në ambientet e ndërtesave në të cilat është parashikuar të ngrihen qendrat e votimit.

Publikimi i përqendruar i listave në të njëjtin vend i jep mundësi qytetarëve që nuk e gjejnë emrin në një listë, që të mund t'i konsultojë më lehtë ekstraktet e të gjitha qendrave të tjera të votimit të asaj bashkie.

Në përfundim, KRIIK nxit Ministrinë e Brendshme dhe DPGJC që, menjëherë me publikimin e ekstraktit të parë të përbërësve zgjedhorë të të gjithë zgjedhësve, të bëjë një paraqitje të plotë të të gjithë procesit të ndjekur, si dhe të publikojë të gjithë të dhënat përmbledhëse të këtij esktrakti.

Në veçanti nevojitet t'i kushtohet vëmendje situatës së zgjedhësve me vendbanim të përhershëm jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe që e kanë të regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile adresën e vendbanimit të përhershëm jashtë vendit, pjesëmarrja dhe votimi i të cilëve, për herë të parë do të përcaktohet me vendim të Komisionit Rregullator të KQZ-së së re.

Gjithashtu, KRIIK nxit Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve dhe NënKomisionerin, të cilët pritet të miratohen sot në seancën plenare të Kuvendit të Shqipërisë, që menjëherë me marrjen e detyrës të marrin masa sa më parë të jetë e mundur për emërimin e dy auditëve teknicienë për të siguruar mbikqyrjen e veprimeve në bazën e të dhënave të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile, si dhe mbikqyrjen e procesit të hartimit të listave prej ZGJC-ve dhe DPGJC-së.

KQZ-ja e re duhet t'i kushtojë vëmendje të posaçme mbikqyrjes së procesit që kryhet nga Bashkitë e vendit, si për hartimin dhe saktësimin e listës së zgjedhësve, ashtu edhe për përcaktimin e Qendrave të Votimit, në veçanti ato në zonat rurale ku do të përdoret për herë të parë kriteri minimal i 300 votuesve për një qendër votimi.

Kjo mbikqyrje, në kushtet e një pushteti vendor dhe qendror totalisht të njëanshëm, përbën një rëndësi madhore në rritjen e besueshmërisë së procesit përballë aktorëve politikë garues, por mbi të gjitha për rritjen e besimit qytetar në procesin zgjedhor të ardhshëm.

Tiranë, më 5 Tetor 2020!

V.3. DEKLARATË - *Mirëfunksionimi i KQZ-së së re si domosdoshmëri, jo vetëm për suksesin e përgatitjes së procesit të ardhshëm zgjedhor, por edhe për jetësimin e aspiratës së marrëveshjes politike të 5 qershorit*

Sot, me datë 13.10.2020, përfaqësues të Koalicionit për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK) zhvilluan një takim me Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve të sapoemëruar, z. Ilirjan Celibashi.

Ky takim përgëzimi për detyrën e rëndësishme të marrë, shërbeu si një mundësi për të ndarë konsideratat dhe opinionet e KRIIK mbi përvojën e derisotme dhe situatën faktike të institucionit të KQZ-së, si dhe mbi disa nga çështjet më prioritare lidhur me përgatitjet për procesin zgjedhor të ardhshëm. Konsiderata dhe opinione që gjetën mirëkuptim të plotë të Komisionerit dhe që u pasuan me zotimin **për përmirësimin e mëtejshëm të praktikës institucionale dhe të konsolidimit të KQZ-së si një institucion i pavarur e transparent**.

Amendimet e fundit të Kodit Zgjedhor ri-modeluan trupën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në një strukturë trilaterale. Trupë kjo që tashmë mbart peshën e rëndë për të vendosur një frymë të re të këtij institucioni, por që pritet të përballet me rrethana që do e vështirësojnë edhe më shumë këtë objektiv.
Ridimensionimi i institucionit të KQZ-së është **hapi i parë në zbatim të frymës dhe gërmës së marrëveshjes politike të 5 Qershorit 2020**. Atë të prevalimit të institucioneve të pavarura, me integritet e ligjzbatuese, përkundër modelit të dështuar të ndarjes së tyre mbi bazën e balancimit politik, në vuajtje prej sistemit të patronazhit politik të ndërtuar prej partive politike përgjatë gjithë kësaj periudhe të stërgjatë tranzicioni.
KRIIK solli në vëmendje të Komisionerit këtë perspektivë duke shprehur besimin e plotë se figura e kompletuar dhe me integritet të lartë profesional e tij, sikurse edhe përvojat e mëparshme në drejtim të këtij institucioni apo edhe angazhimet e tjera publike, **përbëjnë një garanci më shumë për jetësimin e kësaj perspektive në institucionin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve**.
Institucioni i KQZ-së **nevojitet të fitojë sa më parë integritetin e munguar si dhe të reflektojë modelin më të mirë të institucioneve të pavarura**, si një institucion ligjzbatues që gëzon besimin e qytetarëve dhe të publikut të gjerë.
Në këtë kuadër, KRIIK shprehu mbështetjen e tij të plotë si një aktor vendor me ekspertizë në çështjet zgjedhore, si dhe me një eskperiencë të gjatë angazhimi në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, në mbështetje të forcimit të rolit, integritetit dhe funksionalitetit më të mirë të KQZ-së, në përmbushje të detyrave të ngarkuara nga tërë kuadri ligjor.
Ndryshimet e rëndësishme që pësoi kuadri ligjor, përbëjnë një sfidë jo të vogël në zbatim, ndërkohë që periudha zgjedhore ka nisur dhe data e zgjedhjeve është vetëm gjashtë muaj larg.
Përpos një game të gjerë rregullimesh, përgatitje dhe mbikqyrje të elementëve të procesit të ardhshëm zgjedhor, përballë KQZ-së paraqitet sfida e ndërmarrjes dhe realizimit për herë të parë e votimit të shtetasve me banim jashtë vendit, si dhe e procesit të verifikimit biometrik të zgjedhësve. E gjitha kjo në kontekstin social të një gjendje kritike për shëndetin publik dhe që mund të preket në vijimësi nga një agravim i mëtejshëm i situatës.
Në adresim të këtij konteksti, KRIIK, në vijimësi të qendrimeve të mëparshme publike, **risolli në vëmendje të Komisionerit dhe morri zotimin e tij për domosdoshmërinë e një transparencë proaktive** në vendimmarrjen e këtij institucioni, përtej parashikimeve ngushtësisht të kërkesave ligjore.
Gjithashtu, në këtë drejtim, përfaqësuesit e **KRIIK parashtruan nevojën për ndërtimin e një procesi konsultativ të vazhdueshëm**, për aq sa mund të bëhet e mundur, në vendimmarrjet e institucionit në aspektet rregullatore të procesit. Për më tepër, për shkak të mosgjetjes së dakordësisë së plotë politike për t'i kryer këto ndryshime legjislative, miratimi i nënakteve ligjore do të duhet balancojë atë unison dakordësie që nuk u arrit nga establishmenti politik.
Në këtë kuadër, **nevojitet që të gjithë aktorët politikë ose jo, si dhe ata institucionalë të përfshirë të vazhdojnë të ofrojnë kontributet dhe opinionet e tyre**, në mbështetje të procesit hartues të akteve rregullatore për procesin zgjedhor sipas planit të përgatitur dhe nevojave që paraqiten prej KQZ-së.
Në përfundim, në raport me nevojat imediate për procesin e ardhshëm zgjedhor, KRIIK **ndau me Komisionerin shqetësimin e miratimit sa më të shpejtë të protokolleve anti Covid** në tërë nivelet e administrimit zgjedhor, si dhe në ndjekjen me përparësi të ecurisë së hartimit të listave të zgjedhësve.
Lidhur me këtë të fundit, KRIIK paraqiti shqetësimin e bërë publik lidhur me mungesën e transparencës në procesin e hartimit të këtyre listave dhe **nxiti Komisionerin dhe NënKomisioneren të emërojnë sa më parë auditët teknicienë** për të mbikqyrur dhe bërë transparencë mbi këtë proces shumë të rëndësishëm, i cili afekton drejtëpërsëdrejtë besimin e qytetarëve në procesin e ardhshëm zgjedhor.

Tiranë, më 13 Tetor 2020!

V.4. DEKLARATË ***- Partia Socialiste si forca qeverisëse dhe me pushtet të pakufizuar, të marrë dhe të ushtrojë përgjegjësinë e saj të plotë në sigurimin e së ardhmes demokratike të vendit, duke u tërhequr dhe pritur Opinionin urgjent të Komisionit të Venecias lidhur me ndryshimet ligjore të njëanshme të ndërmara mbi zgjedhjet***

Marrëveshjet politike të 14 Janarit dhe 5 Qershorit 2020 mes aktorëve politikë[1] përfaqësues të vullnetit popullor të mandatuar nga procesi zgjedhor parlamentar i vitit 2017, në kontekstin e gjendur, morën përgëzimin dhe mbështetjen e aktorëve të brendshëm dhe partnerëve të huaj, ndonëse në vetvete ishin manifesim i një sjellje extra-institucionale, jo transparente, jo gjithëpërfshirëse dhe që nuk siguronte një adresim të plotë të problematikave të duhura.

Në këtë mënyrë, tërë dimensionet e një procesi reformues të një realiteti demokratik dhe institucional, u bënë nul në funksion të një qëllimi madhor që ishte ai i **pranimit të procesit zgjedhor të ardhshëm nga të gjithë palët, si dhe ai i rikthimit të jetës parlamentare në normalitetin demokratik**.

Pa u miratuar ende amendimet e Kodit Zgjedhor sipas Marrëveshjes së 5 Qershorit 2020 të Këshillit Politik, rrjedha legjislative, nën drejtimin e mazhorancës socialiste, mori një kurs të dytë amendues të papritur dhe në shkelje të ligjit, sikurse KRIIK e ka shprehur më parë në Dokumentin[2] e publikuar më datë 17 Korrik 2020.

Mazhoranca socialiste dhe opozita parlamentare ndërmorën në Kuvendin e Shqipërisë një amendim kushtetues mbi çështjet zgjedhore, në kundërshtim me vullnetin e shprehur në marrëveshjen e 5 qershorit dhe pa siguruar dakordësinë e opozitës jashtëparlamentare.

Ndryshimi kushtetues i miratuar në datën 30 korrik 2020[3] u ndoq më pas nga një tjetër paketë amenduese e Kodit Zgjedhor, sërish pa dakordësinë e opozitës jashtëparlamentare.

Paketa amenduese, e cila në thelb ishte e ndryshme dhe tejkaloi frymën e propaganduar prej mazhorancës socialiste gjatë ndërmarrjes së njëanshme të ndryshimeve kushtetuese, u miratua më datën 5 tetor 2020 në Kuvendin e Shqipërisë[4].

Ky amendim i dytë i Kodit Zgjedhor, me Dekret të Presidentit të Republikës të datës 23 tetor 2020, iu kthye për rishqyrtim Kuvendit të Shqipërisë me një arsyetim të gjatë[5] ku ndër të tjera i kërkohet mazhorancës që "të reflektojë duke rishikuar qëndrimin e saj mbi këto rregulla të reja, dhe të sigurojë opinionin final nga Komisioni i Venecias, duke thirrur njëkohësisht dialogun gjithëpërfshirës përmes Këshllit Politik".

Sikurse bëhet me dije Presidenti i Republikës i është drejtuar më datën 21 tetor 2020 Komisionit të Venecias[6] të Këshillit të Europës për një opinion urgjent mbi ndryshimin e njënashëm dhe të përshpejtuar të Kushtetutës dhe të Kodit Zgjedhor.

Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK) në vijueshmëri i ka bërë thirrje aktorëve kryesorë politikë që të shfaqin domosdoshmërisht maturi në ndërmarrjen e reformës së kuadrit ligjor zgjedhor.

Ndonëse ka shprehur dhe ka rezerva të shumta për procesin reformues të kuadrit ligjor zgjedhor të ndërmarrë, me synimin për arritjen e ri-stabilizimit të jetës parlamentare në vend, KRIIK ka nxitur fort aktorët politikë **për dialog gjithëpërfshirës në gjetjen e dakordësisë së nevojshme që do t'i paraprinte një procesi zgjedhor të pranuar nga garuesit**.

KRIIK shpreh shqetësimin e tij se tashmë të gjendur në periudhë zgjedhore, në situatë të

1 Këto marrëveshje u hartuan dhe nënshkruan nga përfaqësues të: - mazhorancës socialiste; - opozitës jashtëparlamentare dhe - opozitës parlamentare, në prezencën edhe të aktorëve të rëndësishëm ndërkombëtarë.

2 KRIIK, Qendrim Publik *"Prishja e Marrëveshjes Politike dhe amendimi i njëanshëm i Kushtetutës, precedent tejet i rrezikshëm për të ardhmen demokratike të vendit"*, publikuar më datë 17.07.2020.

3 Ligji nr. 115/2020 datë 30.07.2020 *"Për disa ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë" të ndryshuar""*.

4 Ligji nr. 118/2020 *"Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar"*.

5 "Arsyet e kthimit të ligjit 118-2020", të paraqitura në përmbajtje të Dekretit Nr. 11797, datë 22.10.2020, *"Për kthimin e Ligjit nr. 118/2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar""*

6 Shkresë e Presidentit të Republikës, Nr. 3620 Prot, datë 21.10.2020, drejtuar Presidentit të Komisionit të Venecias z. Gianni Buquiçhio me lëndë *"Kërkesë për një Opinion urgjent mbi procesin e ndryshimit të njëanshëm dhe të përshpejtuar të Kushtetutës dhe Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë"*.

rënduar të shëndetit publik dhe me një Komision Qendror Zgjedhjesh të sapokonstituuar, ndryshimet legjislative për çështje thelbësore zgjedhore **pa dakordësi politike janë fatale për ecurinë normale demokratike e politike në vend**.
KRIIK shfrytëzon rastin e kthimit të kësaj pakete amenduese në Kuvend për t'i bërë **thirrje aktorëve politikë që të dialogojnë dhe gjejnë sa më shpejt dakordësinë për përmbylljen e procesit reformues**. Madje, kjo dakordësi është e nevojshme të vijojë në ndjekjen dhe në asistimin e KQZ-së të sapokonstituuar për të përballuar sfidat jo të vogla të cilat i janë ngarkuar nga legjislatori. Termat kohorë dhe konteksti i emergjencës së shëndetit publik, përpos të tjerash, po rëndojnë gjithmonë e më shumë në mbarëvajtjen e përgatitjes së procesit zgjedhor të 25 prillit 2021.
Mungesa e Gjykatës Kushtetuese si një mekanizëm thelbësor garantues për respektimin e lirive e të drejtave të qytetarëve, si dhe të garancive të tjera kushtetuese, dikton akoma më shumë mosndërmarrjen e një **procesi amendues të Kodit Zgjedhor pa dakordësi politike**. Një proces i tillë më shumë se sa ka lidhje me fatin e zgjedhjeve pasuese, **është kritik në pasurimin e precedentëve të rrezikshëm për të ardhmen demokratike të vendit**.
Mazhorancat pasardhëse mund të përvijojnë përsëritjen e këtij precedenti duke legjitimuar ndërmarrjen e reformave zgjedhore ngushtësisht të njëanshme e rrjedhimisht antidemokratike. Veçanërisht në realitete parademokratike një sjellje e tillë përbën një tjetër hap pas në traditën shtetformuese, duke zhbërë tashmë edhe standardin e mëparshëm të marrëveshjeve të mbyllura bipartizane me qasje të ngushta interesash.
Aktorët politikë, veçanërisht **Partia Socialiste si forcë qeverisëse dhe me pushtet të pakufizuar, duhet të marrë përgjegjësi të plotë për të ardhmen demokratike të vendit duke siguruar tërë garancitë e nevojshme për të gjithë aktorët** që duan të marrin pjesë në zgjedhje. Praktika gati 30 vjeçare e vuajtjes nga mospranimi i rezultatit zgjedhor nga palët pjesëmarrëse në zgjedhje, duhet të marrë fund.
Pjekuria dhe largpamësia e klasës politike shqiptare, në justifikim dhe përmbushje të angazhimeve demokratike që ka marrë Shqipëria, si vend anëtar i NATO-s, kandidat për në Bashkimin Europian dhe, aktualisht, si kryesuese e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë (OSBE**), duhet të sigurojë sa më parë zgjidhjen e këtij ngërçi të panevojshëm politik nëpërmjet një tryeze të vazhdueshme dialogu** për të mirën e vendit dhe popullit shqiptar, duke pranuar zbatimin paekuivok të aspiratave kushtetuese dhe jetësimin e sjelljes së plotë ligjore e institucionale, e cila, në mungesë të garantit vendor kushtetues, **pranon verdiktin e aktorëve të tretë ndërkombëtarë me potencë, ekspertizë dhe përvojë sikurse është Komisioni i Venecias**.
KRIIK shpreh keqardhje që ky mekanizëm nuk u investua më parë nga aktorët respektivë, sikurse KRIIK bëri thirrje që në muajin korrik në nisje të përplasjeve politike për ndryshimet e njëanshme kushtetuese. Megjithatë, edhe tani në afatet kohore të ngushta përkundrejt përgatitjes së zgjedhjeve të ardhshme, konsideron se periudha kohore deri në marrjen urgjente të Opinionit dhe tematika e cuar per interpretim, nuk sjellin ndonjë komplikim serioz, të drejtëpërdrejtë dhe me pasoja të parikuperueshme në ecurinë përgatitore të procesit zgjedhor të nisur. Tërë kjo, përballë kontekstit aktual dhe shmangies së një situate akoma më shumë problematike që mund të përvijohet gjatë apo pas zgjedhjeve të ardhshme.
Në këtë kuadër, nevojitet së pari që **Mazhoranca Socialiste të tërhiqet dhe të pezullojë menjëherë shqyrtimin sot në parlament**[7] **të dekretit të Presidentit, duke treguar lidership, përgjegjësi dhe largpamësi politike**, sikurse ka treguar edhe më parë lidhur me çështje të cilat janë marrë në shqyrtim prej Komisionit të Venecias.
Nga ana tjetër, në opinionin e KRIIK, **aktorët politikë mund dhe duhet t'i japin jetë menjëherë tryezës së dialogut politik për dakordësimin e qëndrimeve** konform praktikave dhe standardeve më të mira ndërkombëtare, pa pritur momentin e publikimit zyrtar të Opinionit prej Komisionit të Venecias.
Në përfundim, sillet në vëmendje të aktorëve politikë se ndryshimet e Kodit Zgjedhor të 5 tetorit, në gjykimin e KRIIK, **prekin në thelb reflektimin e drejtëpërdrejtë të votës së qytetarit**

7 Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, Mbledhja e datës 27 tetor 2020, Ora:12:00. Ne rend të dites:
1. Shqyrtimi i Dekretit të Presidentit të Republikës nr. 11797, datë 22.10.2020 *"Për kthimin e ligjit nr. 118/2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar"*.

në mandatin përfaqësues të votuar, duke shkuar kështu në kundërshtim me praktikat e mira të caktuara nga Komisioni i Venecias.
Pa hyrë në një analizë të plotë të gjithë ndryshimeve të bëra, KRIIK sjell në vëmendje shqetësimin madhor të bërë të ditur që në krye të herës **për pamundësinë e hapjes së sistemit politik prej establishmentit aktual**.
Ndryshimet ligjore të kryera, megjithëse të frymëzuara nën aspiratën për rritjen e mundësisë së qytetarëve për të zgjedhur vetë kandidatët e preferuar, rezultuan në një liri të kufizuar për të zgjedhur veç nga "shportat" elektorale të kandidatëve të paracaktuar nga lidershipi partiak, **duke pamundësuar zgjedhjen e garuesve të rinj apo të alternativave të reja politike përtej forcave të establishmentit**.
Veçanërisht alarmante në këtë drejtim është **pamundësia e garimit të kandidatëve të pavarur që mund të vijnë nga shoqëria civile dhe që mbështeten nga zgjedhësit**, ndaj të cilëve në një qasje jo parimore dhe jo kushtetuese iu kërkohet që pavarësisht rezultatit në zonën zgjedhore ku ata kandidojnë, që të mund të përllogaritjen në marrjen ose jo të mandatit, iu duhet të kalojnë pragun prej 1% të votave në rang vendi.

Gjithashtu, theksohet se **mekanizimi i kontrollit dhe transparencës financiare nuk është i projektuar për situatën e parashikuar** nga ndryshimet e fundit duke shtuar akoma edhe më problematikat e mbartuara deri sotmi. Formula e propozuar e kandidimit pritet të nxisë akoma më shumë garimin ndërmjet dhe brenda vetë partive politike, për rrjedhojë duke rritur dhe veprimtarinë financiare zgjedhore, e cila **me ndryshimet e bëra mbetet tërësisht janë kontrollit dhe transparencës, qoftë edhe minimaliste të siguruar më parë**.

Tiranë, më 27 Tetor 2020!

V.5. DEKLARATË - *Aktorët politikë dhe institucionalë të tregojnë gatishmërinë dhe vullnetin për të rritur integritetin e procesit zgjedhor për Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të 25 prillit 2021*

Pavarësisht se Kodi Zgjedhor e përcakton qartë se fushata zgjedhore fillon 30 ditë përpara ditës së zgjedhjeve dhe përfundon një ditë përpara tyre, partitë politike janë duke zhvilluar aktivitete me synim qartazi elektoral: bëjnë thirrje që zgjedhësit të votojnë për ta, prezantojnë kandidatë, paraqesin pikat e programnit të tyre qeverisës, etj. Pra de facto, fushata zgjedhor ka nisur, duke u zhvilluar në kundërshtim me kuadrin ligjor.
Fushata zgjedhore e zhvilluar përpara afatit 30 ditor të përcaktuar në ligj bën që këto aktivitete të mos u nënshtrohen rregullave të fushatës, të cilat garantojnë barazinë e mundësive për të gjithë konkurrentët elektoralë si mbulim mediatik i barabartë, kufizime dhe detyrime për të raportuar financimin, etj.
Çështjet për të cilat kërkohet të ri-sillen në vëmendje janë:

1. Integriteti i kandidatëve dhe transparenca zgjedhore;
2. Ndikimin që Covid-19 do të ketë mbi organizmin e procesit zgjedhor, veçanërisht në lidhje me të drejtën e grumbullimit dhe të drejtën e votës;
3. Mundësitë që shqiptarët që jetojnë jashtë vendit të kenë të drejtë të ushtrojnë të drejtën e votës;
4. Përdorimi i burimeve shtetërore gjatë fushatës zgjedhore;

INTEGRITETI I KANDIDATËVE DHE TRANSPARENCA ZGJEDHORE

Integriteti i kandidatëve është një nga çështjet së cilës i është kushtuar vëmendje maksimale nga partnerët e rëndësishëm ndërkombëtarë të Shqipërisë.
Përzgjedhja e kandidatëve për Deputet në Kuvendin e Shqipërisë tashmë ka mbaruar, listat janë mbyllur dhe depozituar në KQZ prej partive politike.
Tanimë është rradha e institucioneve, ndaj mbetet thelbësore që KQZ-ja të zbatojë ligjin për dekriminalizimin në frymën me të cilën ky ligj është miratuar, duke operuar me skrupolozitet dhe seriozitet maksimal përgjatë procesit të verifikimit të formularëve të vetëdeklarimit të kandidatëve. Nxiten në këtë kuadër edhe DPGJC, Gjendja gjyqësore dhe Prokuroria për të intensifikuar dhe

bashkërenduar në mënyrën më të mirë punën dhe koordinimin me KQZ-në për një proces verifikimi sa më të plotë, të saktë dhe efikas.
Parlamenti i ri, si produkt i frymës së marrëveshjes së 5 qershorit nuk duhet të jetë strehë e individëve që janë subjekt i parashikimeve të ligjit të ashtuquajtur të dekriminalizimit dhe madje as i atyre që përfaqësojnë interesa të jashtëligjshme.
Figurat e kandidatëve janë pjesa më e rëndësishme e ofertës elektorale që ndërtohet nga partitë politike dhe që e përfaqësojnë partinë apo koalicionin në kërkimin e vullnetit përfaqësues prej qytetarëve.
Duke konsideruar si mjaft **me rëndësi kthimin e figurës së kandidatit në qendër të procesit garues**, sikundër vlerësohet nga fryma e Kushtetutës,

KRIIK iu drejtohet tashmë drejtëpërdrejtë të gjithë Kandidatëve garues që si shenjë e vullnetit të mirë dhe të transparencës ndaj publikut, të deklarojnë vullnetarisht dhe në mënyrë të plotë:

- biografinë e tyre profesionale dhe të angazhimeve të patura;
- gjendjen e tyre financiare;
- eksperiencën e marrëdhënieve me ligjin; dhe
- ofertën elektorale të personalizuar.

Ky publikim vlen të kryhet, së pari lidhur me domosdoshmërinë që shtrohet për të informuar dhe njohur qytetarët me profilet e plota të kandidatëve që ata do të zgjedhin, por edhe që lidershipet apo partitë propozuese të mbajnë përgjegjësi për ekipin garues të përzgjedhur, si një mjet për reformimin e mekanizmit të brendshëm përgjedhës të vetë partive politike.
Në raport me deklarimin e gjendjes financiare, Kandidatët nxiten të bëjnë publikimin paraprakisht të **tre dimensioneve financiare:**

- asetet financiare që zotërojnë apo ku janë të përfshirë me të afërmit e tyre;
- detyrimet fiskale ose jo që mbartin këto asete, si dhe -
- detyrimet financiare që kanë ndaj të tretëve.

Gjithë sa më sipër konsiderohet një domosdoshmëri në raport me frymën dhe detyrimet kushtetuese e ligjore për të nxitur dhe **siguruar integritetin dhe pacënueshmërinë e figurës së parlamentarit të duhur**, si përfaqësues i vetëm interesave të qytetarëve.
Nga ana tjetër, kjo konsiderohet të përbëjë një hap real dhe efektiv për rikthimin e kandidatëve në qendër të garës elektorale dhe për fuqizimin e lidhjes së qytetarit me të mandatuarin.
Ofrimi dhe sigurimi i transparencës është jetike për një demokraci pjesëmarrëse e funksionale. Veçanërisht në periudhën zgjedhore fryma e kërkuar e transparencës merr një trajtë më të gjerë.
Në kundërshti më këtë frymë, sillet në vëmendje se proceset zgjedhore në vend kanë vuajtur gjithnjë e më shumë nga mungesa e diskutimeve mbi ofertat elektorale dhe mbi profilet e kandidatëve që konkurrojnë. Ato zhvillohen thjesht si procese ku interesi dhe qëllimi primar mbetet se kush nga subjektet ia ka dalë të marrë më shumë vota, duke u shndrruar thelbësisht nga një proces me përballje ofertash elektorale në një proces përplasjeje midis lidershipesh kundërshtare.
KRIIK tërheq vëmendjen dhe iu kërkon partive politike që të shmangin përsëritjen e kësaj përvoje dhe praktike negative të ndjekur deri më tani, duke i dhënë qytetarit shqiptar një fushatë zgjedhore të qetë, etike, me përballje dhe diskutime mbi qasjet vizionare, programet politike dhe profilet e arrira e të pacënuar të kandidatëve të propozuar.
Deklarimet e fundit në media prej mazhorancës e posaçërisht etiketimet e përdorura prej Kryeministrit të vendit, ndaj disa prej kandidatëve kundërshtarë politikë, shkojnë kundër kësaj fryme dhe qasjeje duke përbërë potencialisht fillesa dhe nxitje për retorikë të ashpër joetike, tensionim artificial të toneve të fushatës e rrjedhimisht zhvendosje të fokusit nga platformat dhe programet elektorale të subjekteve garuese.

ZHVILLIMI I PROCESIT ZGJEDHOR NË KUSHTET E PANDEMISË

Urdhri nr. 633, datë 17.11.2020 i Ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ndalon tubimet dhe mbledhjet partiake si dhe grumbullimet mbi 10 persona në vende të mbyllura apo të hapura. Ky ndalim u morr në shqyrtim prej Gjykatës Kushtetuese në seancën plenare të datës 02.03.2021, si çështje e kërkuar prej Partisë Republikane. Sipas vendimit të Gjykatës Kushtetuese të bërë publik nga media, Ministria e Shëndetësisë duhet t'a rishikojë vendimin dhe t'a ndryshojë atë brenda datës 15 mars.
Gjithë sa më sipër është i vetmi rregullim ligjor, nëse mund të quhet kështu, që politika dhe institucionet shqiptare kanë ndërmarrë lidhur me zhvillimin e procesit zgjedhor në kushtet e pandemisë.

Pavarësisht se ishte lehtësisht e parashikueshme që zgjedhjet e 25 prillit do të zhvilloheshin në situatë pandemie, partitë politike nuk e bënë këtë çështje në asnjë moment pjesë të diskutimit në Këshillin Politik, për aq sa dihet dhe është bërë publike.
KRIIK e ka ngritur këtë çështje me Letrën e Hapur të 16 qershorit 2020 dhe u ka bërë thirrje institucioneve dhe partive politike të marrin në konsideratë këtë mundësi dhe të përgatisin skenarë të mundshëm të administrimit të procesit zgjedhor në situatë pandemie, thirrje e cila është përsëritur në vazhdimësi disa herë.
Mungesa e reagimit prej partive politike dhe institucioneve, prej Parlamentit në veçanti, në lidhje me këtë situatë për më shumë se nëntë muaj tregon së paku mungesë të respektit për të drejtën e votës si një e drejtë thelbësore e qytetarëit dhe nga ana tjetër edhe konsiderimin e procesit zgjedhor thjesht si një proces mekanik votimi për mandatimin e një pushteti politik.
Deklarimi së fundi i Kryeministrit të vendit z. Edi Rama lidhur me votimin e shtetasve të infektuar me covid-19 se "do bëjmë të njëjtën gjë që kanë bërë vendet e tjera. Për ata të cilët janë të testuar pozitivë dhe nuk janë negativizuar duhet të qëndrojnë në shtëpi", është një qasje e paplotë për çështjen në tërësi dhe një deklarim i papranueshëm e në shkelje të të drejtave thelbësore kushtetuese.
Shteti shqiptar ka detyrimin t'u garantojë të gjithë shtetasve të vet të drejtën e votës. Është një e drejtë e pamohueshme dhe e pacënueshme që Konventat Ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti shqiptar dhe Kushtetuta e vendit ia njohin shtetasit shqiptar. Kufizimi i saj është i parashikuar në Kushtetutë vetëm kur shtetasi është deklaruar me vendim gjyqësor të formës së prerë si i paaftë mendërisht, apo kur ai është subjekt i ligjit të dekriminalizimit i dënuar për një nga veprat e rënda penale të parashikuara.
Mosushtrimi i së drejtës së votës në çdo rast tjetër është atribut dhe një e drejtë eskluzive e vullnetit të lirë të qytetarit, dhe si e tillë ajo nuk mund të kufizohet nga asnjë rrethanë. Madje është detyrë e shtetit ta sigurojë këtë të drejtë pavarësisht kostove dhe rrethanave.
Nëse ekziston vullneti politik dhe respekti për të drejtën e votës, mundësitë ekzistojnë ende për sa kohë që Kuvendi i Shqipërisë nuk është shpërndarë ende, që të adresohet kjo problematikë me ndërhyrje të momentit të fundit në kuadrin ligjor. Praktika e vendeve të tjera që kanë kryer zgjedhje në periudhë pandemie mund të përdroret si guidë.
Në çdo rast, kufizimi i të drejtës së votës për shtetasit e infektuar me coronavirus ditën e zgjedhjeve apo personat në vetëizolim mund dhe duhet të evitohet.
KRIIK ka sjellë në vëmendje nevojën e një trajtimi të plotë të çështjes dhe rregullimin e saj ligjor, pasi një situatë më e rënduar mund të rrezikojë integritetin dhe administrimin e procesit zgjedhor. Ndërkohë që ndërmarrja e masave të parregulluar me një kuadër ligjor mund të krijojë alibi për delegjitimimin e procesit, mundësi për t'a deformuar atë, apo, edhe me keq, mundësi për të rikthyer situata të mundshme krizash apo destabiliteti.
Sjellim në vëmendje se të ekspozuar përballë rrezikut të shëndetit personal në një situatë të parregulluar janë të gjithë qytetarët, duke filluar nga ata të angazhuar si komisionerë në qendrat e votimit, komisionet zonale të administrimit zgjedhor, grupet e numërimit, vëzhguesit, përfaqësuaesit e mediave e të gjithë qytetarët e tjerë të përfshirë në proces.
Gjithashtu, gjykohet si domosdoshmëri rregullimi i nevojshëm për sigurimin e transparencës së procesit.
Kufizimi në numra i shtetasve të grumbulluar në një ambient bën të pamundur vëzhgimin e fazave të procesit zgjedhor nëpërmjet kontaktit të drejtëpërdrejtë dhe pamjes direkte në qendrat e votimit prej vëzhguesve të partive politike garuese, prej vëzhguesve të pavarur dhe ata ndërkombëtare dhe prej gazetarëve.
Po ashtu bëhet i pamundur ndjekja dhe vëzhgimi i mbledhjeve të Kolegjit Zgjedhor, seancave pranë gjykatave, si dhe të mbledhjeve të organeve të KQZ-së në rastet kur ata mblidhen ne seancë plenare fizikisht në sallë.

VOTA E EMIGRANTËVE

Këshilli Politik nuk arriti të rregullonte votimin e emigrantëve dhe ngarkoi KQZ-në me organizimin e këtij procesi kaq të rëndësishëm, duke u mjaftuar me shprehjen e vullnetit se shqiptarët që jetojnë jashtë vendit duhet të votojnë.
Një situatë e tillë për të deleguar një çështje kaq komplekse, në adresimin e së cilës politika shqiptare kishte dështuar tërë këto vite, një institucioni si KQZ-ja me burime të kufizuara dhe kompetenca të kufizuara, tashmë po përvijohet më qartë se ishte thjesht një taktikë politike dhe aspak një qasje konkrete dhe serioze.
Pasojat e këtij vendimi të pamaturuar mirë dhe mundësia e përballjes me një nismë të

dështuar që në fillim, duket se e detyruan KQZ-në që të jetë e kujdesshme në të gjitha hapat e ndërmarrë në lidhje ndërtimin e procesit që do të mundësonte votën e emigrantëve, duke theksuar nevojën e një konsensusi politik që procesi teknik të funksionojë.
Kjo qasje racionale e KQZ-së duhet përshëndetuar pasi, në kushtet e mungesës së vullnetit politik e institucional, aplikimi arbirtrar i rregullave nga ana e KQZ-së dhe përvijimi i mëpastajshëm mund të sillte apo nxiste humbjen e besimit në procesin zgjedhor si i tërë.
Aktualisht, në gjykimin e KRIIK, duhet pranuar se sigurimi i të drejtës së votës për diasporën është një proces i pamundur tanimë, duke u shënuar si një përgjegjësi e drejtëpërdrejtë e partive kryesore politike.
Rregullimi i plotë i kësaj të drejte dhe reformimi i duhur i kuadrit ligjor respektiv duhet të përbëjë një piketat kryesore në procesin reformues të ardhshëm të kuadrit ligjor zgjedhor.

PËRDORIMI I BURIMEVE SHTETËRORE

Përdorimi i burimeve shtetërore në funksion të fushatave zgjedhore ka qenë dhe mbetet një problematikë madhore për realitetin dhe demokracinë tonë.
Sofistikimi i këtij fenomeni dhe veçanërisht sistemi i patronazhit politik të ngritur, kërkon kontributin dhe ndërveprimin e të gjithë aktorëve dhe të gjithë qytetarëve për çlirimin e vullnetit të votuesit nga detyrimi apo çdo ndikim tjetër i paligjshëm në abuzim të administrimit dhe përgjegjësive shtetërore e publike të marra përsipër.
Përsa i përket risisë që solli rregullimi ligjor i kësaj çështje, duhet vlerësuar por ndërkohë që, sikurse e ka bërë me dije, KRIIK vlerëson dhe thekson se efikasiteti i instrumentit të ngritur varet nga një frymë dhe sjellje ndërvepruese e KQZ-së në vijimësi me institucione të tjera përgjegjëse që ndjekin veprimtarinë e administratës publike në periudhën që paraprin, përgjatë fushatës zgjedhore, apo edhe pas zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë së re, si psh. Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi apo Kontrolli i Lartë i Shtetit.
Duke marrë në konsideratë gravitetin e çështjes që trajtohet dhe pa referuar këtu ecurinë penale të shkeljeve zgjedhore, nevojitet një funksionim unison i tërë hallkave administrative që ky mekanizëm të jetë funksional, i besueshëm dhe të japë kontributin e tij konkret në mbarëvajtjen e procesit zgjedhor.
Nga ana tjetër, sikurse KRIIK e ka bërë me dije edhe më parë, ka shprehur qendrimin e tij se institucioni i KQZ-së është i mbingarkuar në tagra ligjorë, ndërkohë që vuan nga një administratë e kufizuar në numër dhe ekspertizë. Gjithashtu edhe numri i instrumentave ligjorë që i janë atribuar është tepër i kufizuar në zbatimin e tagrave të ngarkuar.
Komisioni Rregullator i KQZ-së, në momentin kur miratoi rregullat për ndalimin e përdorimit të burimeve shtetërore tregoi një të lexuar shumë të ngushtë të ligjit, duke qëndruar në pozita formaliste të gërmës së tij dhe pa marrë në konsideratë terrenin dhe mënyrat se si boshllëqet në kuadrin ligjor mund të përdoren për të abuzuar me burimet shtetërore.
Institucionet shtetërore u treguan shumë të ngadalta në nisjen e raportimit të aktiviteteve. Ritmi i raportimeve u rrit prej datës 7 janar 2021, menjëherë pasi PD dorëzoi në SPAK një padi për abuzim me burimet shtetërore.
Në vazhdim, mund të thuhet se mekanizmi për raportimin e aktiviteteve të institucioneve ka humbur kuptimin e vet dhe i mungon efektiviteti në arritjen e qëllimit të tij, duke u kthyer në një procedurë buroktratike formaliste. Një numër i konsiderueshëm i raportimeve janë pa detaje dhe e bëjnë të pamundur një monitorim efektiv.
KQZ-së i mungojnë burimet financiare dhe njerëzore për të monitoruar në mënyrë efektive dhe e bazon aktivitetin e vet në ankimime.
Përsa iu përket ankimimeve, të dyja sanksionet e vendosura nga Komisioneri janë rrëzuar prej Komisionit për Apelime dhe Sanksione (KAS), duke e bërë mekanizmin akoma më joefektiv.
Evidentohet se KAS, në rastin më të mirë, ka përdorur një të lexuar shumë të ngushtë dhe formalist të legjislacionit.
Sjellja e ofiqarëve të lartë publikë në lidhje me këtë çështje ka qenë jo në linjë me frymën e ligjit, duke përdorur boshllëqet në legjislacion për të anashkaluar zbatimin e duhur të normës dhe frymën e ligjit.
Ofiqarë të lartë publikë janë duke marrë pjesë në aktivitete të cilat përdoren për qëllime elektorale, duke përdorur në këtë mënyrë eventet institucionale për përfitim zgjedhor.

Tiranë, më 11 Mars 2021!

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

KRIIK Albania
Raport përfundimtar vëzhgimi : mbi procesin e zgjedhjeve
për Kuvendin e Shqipërisë të 25 prillit 2021 / Koalicioni
për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara.
– Tiranë : KRIIK Albania, 2021
... f. ; ... cm.

ISBN 978-99927-868-8-5

1.Zgjedhje 2.Monitorime 3.Raporte 4.Shqipëri
324(496.5) "2021" (047)

KRIIK

KOALICIONI PËR REFORMA, INTEGRIM DHE INSTITUCIONE TË KONSOLIDUARA
COALITION FOR REFORMS, INTEGRATION AND CONSOLIDATED INSTITUTIONS

A: Rr. "Ymer Kurti", Nd.4, H.2, Ap.3, Nj.Adm.5, Tirana, 1019
Mailing Address: P.O.Box. 2396 Tirana, 1001, Albania;
T: + 355 4 2245078 | M: + 355 673890174; + 355 682039297
E: info@kriik.al | W: www.kriik.al ;

ISBN 978-99927-868-8-8
9 789992 786888

www.kriik.al